Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Gjykata Supreme

Vrhovni Sud - Supreme Court

VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS

Prishtinë, 2025

VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë 2025

Nëntor 2025

Shtypur në Prishtinë

Hartimi i materialit udhëzues: "Vendime të Përzgjedhura të Gjykatës Supreme" është mundësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, ndërkaq botimi nga Akademia e Drejtësisë.

PARATHËNIE

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, bazuar në kompetencat e përcaktuara me Ligjin për Gjykatat, luan rol thelbësor në unifikimin e praktikës gjyqësore dhe në sigurimin e interpretimit të drejtë dhe unik të ligjit në të gjitha nivelet e gjyqësorit. Përmes vendimmarrjes së saj, ajo kontribuon në forcimin e shtetit të së drejtës, në rritjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor dhe në promovimin e transparencës institucionale.

Vendimet e Gjykatës Supreme, shërbejnë si udhëzues për gjykatat e shkallëve më të ulëta, duke ndihmuar në zbatimin uniform të ligjit dhe në shmangien e praktikave të ndryshme për çështje të ngjashme.

Duke vlerësuar rëndësinë e unifikimit të praktikës gjyqësore, Gjykata Supreme, përveçse përcakton qëndrime parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues, për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës, që nga viti 2023 ka filluar publikimin e Përmbledhjes së Vendimeve të Përzgjedhura nga fushat penale dhe civile. Këto përmbledhje kanë për qëllim të sigurojnë zbatim të njëtrajtshëm të ligjeve dhe t'u ofrojnë gjyqtarëve zgjidhje e udhëzime praktike për çështje që paraqesin dilema gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, gjithmonë në përputhje me parimet e drejtësisë dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

Ky botim është realizuar me mbështetjen e Akademisë së Drejtësisë, e cila në përputhje me mandatin e saj institucional, kontribuon në zhvillimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Publikimi i këtyre vendimeve në faqet zyrtare të Gjykatës Supreme dhe të Akademisë së Drejtësisë do të mundësojë qasje të lehtë për profesionistët e fushës dhe publikun e gjerë.

Përmbledhja e vendimeve të Gjykatës Supreme synon të forcojë unifikimin e praktikës gjyqësore, të rrisë transparencën institucionale dhe të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të standardeve të larta profesionale në sistemin e drejtësisë së Republikës së Kosovës.

Fejzullah REXHEPI

Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës

Tabela e përmbajtjes

Pjesa e parë-Vendime të përzgjedhura nga lëmia penale

Hyrje .....**Error! Bookmark not defined.**

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës PML.Nr.85/2025, datë 18.03.2025 13

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.170/2025, datë 23.04.2025 20

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.171/2025, datë 24.04.2025 27

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.186/2025, datë 10.04.2025 38

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.188/2025, datë 23.04.2025 45

Aktvendim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.198/2025, datë 23.04.2025 51

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.227/2025, datë 24.04.2025 55

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.288/2025, datë 17.06.2025 60

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.339/2025, datë 14.07.2025 66

Aktvendim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.366/2025, datë 15.07.2025 75

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.415/2025, datë 02.09.2025 78

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.88/202, datë 17.03.2025 85

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.100/2025, datë 18.03.2025 89

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.163/2025, datë 16.06.2025 96

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.25/2025, datë 24.02.2025 104

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.46/2025, datë 03.02.2025 115

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.75/2025, datë 25.02.2025 124

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.122/2025, datë 26.03.2025 128

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.185/2025, datë 16.04.2025 133

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.272/2025, datë 13.05.2025 139

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr. 318/2025, datë 26.06.2025 145

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.351/2025, datë 09.07.2025 152

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.387/2025, datë 17.07.2025 159

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.726/2024, datë 05.02.2025 165

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.259/2025, datë 08.05.2025 171

Aktvendim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.313/2025, datë 17.06.2025 176

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.352/2025, datë 07.07.2025 179

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.414/2025, datë 21.08.2025 186

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.429/2025, datë 02.09.2025 190

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.472/2025, datë 08.09.2025 196

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.72/2025, datë 25.02.2025..... 201

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.343/2025, datë 18.06.2025 205

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.682/2024, datë 06.02.2025 212

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr.752/2024, datë 07.05.2025 242

Pjesa e dytë-Vendime të përzgjedhura nga lëmia civile

Aktvendim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës CN.Nr.37/2025, datë 11.09.2025..... 252

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës E.Rev.Nr.36/2024, datë 14.04.2025..... 255

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.240/2024, datë 21.01.2025..... 267

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.31/2024, datë 06.09.2024..... 277

Aktvendim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës C.Nr.44/2023, datë 18.02.2025..... 301

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.328/2024, datë 17.03.2025..... 308

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.366/2024, datë 15.05.2025 316

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.511/2024, datë 20.03.2025 333

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.591/2024, datë 26.06.2025 345

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ.Nr.198/2024, datë 11.06.2025 357

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ.Nr.270/2024, datë 24.12.2024 372

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të KosovësARJ.Nr.261/2024, datë 12.12.2024..... 380

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ.Nr.151/2024, datë 23.01.2025 388

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ.Nr.153/2024, datë 23.01.2025 396

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ.Nr.242/2024, datë 18.02.2025 404

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ.Nr.217/2024, datë 21.02.2025 412

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës PA.Nr.01/2025, datë 20.03.2025 420

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës PA.Nr.02/2025, datë 16.04.2025 425

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës P.A.Nr.07/2025, datë 10.06.2025 449

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës P.A.Nr.08/2025, datë 14.07.2025 465

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të KosovësPA.Nr.2/2025, datë 14.03.2025..... 473

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.253/2025, datë 01.09.2025..... 482

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.16/2025, datë 07.05.2025..... 489

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës E.Rev.Nr.17/2025, datë 13.06.2025..... 502

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.329/2025, datë 04.09.2025..... 512

Aktgjykimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës E.Rev.Nr.36/2025, datë 1.09.2025..... 519

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.252/2025, datë 10.06. 2025..... 526

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme Rev.E.Nr.9/2025, datë 21.05.2025..... 531

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.98/2024, datë 24.12.2024..... 537

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.159/2025, datë 25.09.2025..... 543

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.384/2025, datë 28.08.2025..... 549

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.422/2025, datë 11.09.2025..... 555

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.466/2025, datë 18.09.2025..... 562

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.469/2025, datë 24.09.2025..... 567

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.518/2024 datë 25.11.2024 573

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës AA.Nr.33/2025, datë 05.02.2025 580

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës CML.Nr. 8/23, më datë 22.02.2024 591

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.6/2025, datë 05.03.2025 601

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.89/2025, datë 14.03.2025 613

Aktvendim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.171/24, datë 15.10.2024 633

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.195/2025, datë 07.07.2025 644

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.336/25, datë 07.07.2025 666

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.343/2025, datë 07.07.2025 677

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.473/2024, më 21.01.2025 691

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.481/24, datë 21.10.2024 704

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr. 63/2025, datë 02.06.2025 717

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.73/202, datë 10.06.2025 719

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 126/2025, datë 17.07.2025 721

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 164/2024, datë 22.04.2025 724

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.260/2024, datë 14.01.2025 726

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 295/2024, datë 17.12.2024 728

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr. 348/2025, datë 06.03.2025 731

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr. 433/2024, datë 25.02.2025 733

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.508/2024, datë 10.03.2025 736

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr. 542/24, datë 12.03.2025 738

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës E.Rev.50/2024, datë 18.12.2024 740

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.408/2024, datë 31.01.2025 746

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.190/2025, datë 27.08.2025 752

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës E.Rev.Nr.50/2025, datë 18.12.2024 761

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.18/2025, datë 21.05.2025 772

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.96/2025, datë 16.06.2025 778

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.541/2024, datë 13.01.2025 784

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.157/2025, datë 10.07.2025 794

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr. 5/2025, datë 15.07.2025 801

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr. 129/202, datë 24.06.2025 811

PJESA E PARË

VENDIME TË PËRZGJEDHURA NGA LËMIA PENALE

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës
PML.Nr.85/2025, datë 18.03.2025

’’Në këtë rast, Gjykata Supreme ka gjetur se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, gabimisht kanë konstatuar se në veprimet e të dënuarve ishin konsumuar elementet e veprës penale mashtrimi nga neni 323, andaj Gjykata Supreme ka gjetur se, në veprimet e të dënuarve konsumohen elementet e veprës penale të Vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 313 paragrafi 1, e lidhur me nenin 77 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1, 1.2 1.3 dhe 1.4 e lidhur me paragrafin 4, të KPRK-së.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës së shkallës së parë
   Gjykata themelore ne Prishtinë departamenti i përgjithshëm ka marr aktgjykimin me Nr. P.Nr.260/2021 te datës 18.03.2024, ndaj te pandehurit Shkelzen Jashari, me te cilin aktgjykim është shpallur fajtor, për vepra penale te mashtrimit nga neni 323 paragrafi 1 i KPRK-së, si ne piken I te dispozitivit dhe i ka caktuar dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 6 muaj dhe dënim me gjobe ne shumen prej 300 euro, për vepër penale mashtrim ne bashkëkryerje e mbetur ne tentativë nga neni 323 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 dhe 31 te KPRK-se si ne piken II te dispozitivit, ashtu qe i ka shqiptuar dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 4 muaj dhe dënim me gjobe ne shume prej 200 euro, për vepra penale te mashtrimit nga neni 323 paragrafi 1 i KPRK-së, si ne piken II te dispozitivit, ashtu qe duke zbatuar dispozitat nga neni 76 qe rregullojnë dënimin për bashkim te veprave penale, i ka shqiptuar dënim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 1 viti e 1 muaj burgim dhe dënim me gjobe ne shumen prej 800 euro, te cilat dënime ka përcaktuar se do te ekzekutohen ne afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit, duke njoftuar te pandehurin se ne rast se i njëjti nuk e paguan dënimin me gjobe atëherë dënimi me gjobe do te zëvendësohet ne dënim me burgim duke i llogaritur çdo 20 euro te dënimit me gjobe për një dite burim. Ndërsa te pandehurin Granit Behluli e ka shpallur fajtor për veprën penale te mashtrimit ne

bashkëkryerje e mbetur ne tentativë nga neni 323 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 dhe 31 te KPRK-se si ne piken II te dispozitivit, ashtu qe i ka shqiptuar dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 5 muaj dhe dënim me gjobe ne shume prej 200 euro dhe me pëlqimin e te pandehurit dënimin me burgim ia ka zëvendësuar ne dënim me gjobe ne shumen prej 1500 euro, dhe ka përcaktuar se dënimi me gjobe duhet te ekzekutohet ne afat prej 15 ditëve nga dita qe aktgjykimi te behet i formës se prere, duke njoftuar te pandehurin se ne rast se i njëjti nuk e paguan dënimin me gjobe atëherë dënimi me gjobe do te zëvendësohet ne dënim me burgim duke i llogaritur çdo 20 euro te dënimit me gjobe për një dite burim.

Ka obliguar te pandehurit qe te paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor secili veç e veç ne shume prej 30 euro si dhe ne emër për kompensimin e fondit te viktimave te krimit secili shumen prej 20 euro. Ka konstatuar se te dëmtuarit kanë hequr dore nga kërkesa pasurore juridike.

2. Vendimi i Gjykatës së shkalles së dytë
   Gjykata e Apelit me aktgjykimin, PA1.Nr.716/2024 te datës 25.11.2025, ka refuzuar si te pabazuara ankesën e mbrojtësit te te pandehurit Shkelzen Jashari av. Fitim Klinaku dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës themelore ne Prishtine.

3. Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur
   -mbrojtësi i te dënuarit Shkëlzen Jashari avokati Fitim Klinaku, ka parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë këtë kërkesë si të bazuar, kurse aktgjykimet e kundërshtuara ti ndryshoj, ashtu që të dënuarit ti shqiptoj një dënim më të butë, apo aktgjykimet ti anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

4. Përgjigja në Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë
   Prokurori i shtetit ne përgjigjen KMLP.II.Nr.42/2015 te datës 27.02.2025, ka propozuar qe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë se mbrojtësit të të dënuarit te refuzohet si e pabazuar.

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar

5. Pretendimet e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Mbrojtja pretendon se aktgjykimet e Gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë janë marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nënpargrafi 2.7, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit nuk ka vlerësuar drejt rrethanat që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit dhe se për këto rrethana nuk ka arsye në aktgjykim, shkelje këto që nuk janë eliminuar as nga gjykata e shkallës së dytë, poashtu theksohet se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim ndaj të pandehurit Shkelzen Jashari, ka marre për bazë vetëm rrethanat renduese për lartësinë dhe llojin e dënimit që ka shqiptuar ndaj të njëjtit. Pretendohet se gjykata nuk ka marr për bazë rrethanat lehtësuese dhe nuk ka shqiptuar dënimin ndaj të pandehurit në përputhje me vlerësimin e të gjitha rrethanave si të atyre rënduese dhe atyre lehtësuese. Më konkretisht mbrojtja thekson se nuk është bërë vlerësimi i drejt kur Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar të kaluarën kriminale ndaj të pandehurit, ku ka konstatuar se i pandehuri ka qenë i dënuar për vepër penale të njëjtë, për të gjitha këto arsye ka theksuar se aktgjykimet janë marr edhe me shkelje të ligjit penal që janë të ndërlidhura me shkeljen e dispozitave të procedurës penale.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme pas shikimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, duke qenë se pretendimet e mbrojtjes së të dënuarit për shkelje të ligjit penal janë evidente por jo sa i përket rrethanave që kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit, mirëpo shkelja e ligjit penal ka të bëjë me zbatimin e dispozitës ligjore për të cilën gjykata nuk ka mundur ta zbatoj, pasi që rezulton se ligji penal është zbatuar në dëm të dënuarve, shkelje kjo që parashihet sipas nenit 385 paragrafi 1 nënpargrafi 1.4 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

2. Gjykata Supreme gjen se, në veprimet e të dënuarit Shkëlzen Jashari të përshkruara si në pikën I, II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të kundërshtuar, janë veprimet inkriminuese të njëllojta të ndërmarra, me konkretisht, " *me datë 15.11.2020, gjersa ishte në veturën e tij Golf plus në lagjen U. rr. D. e K., afrohet pranë të dëmtuarit Sh. ku i kërkon shumën prej 800 dollarëve amerikan kinse për ti këmbyer me euro, dhe kur i dëmtuari ja jap ai largohet nga aty me veturë*", poashtu : " *me datë 19.11.2020, gjersa i dënuari ishte në veturën e tij G.P. duke e drejtuar ndalet ne Rr.D. e K. në U. afrohet pran të dëmtuarit A. R. dhe i kërkon shumen prej 900 dollarëve amerikan, ashtu që kur i dëmtuari ia jap shumën prej 500 dollarë hynë në veture kinse për ti numëruar dhe ikën me veturë*", poashtu i dënuari Shkelzen Jashari së bashku me të dënuarin Granit Behluli, " *me datë. 17.12.2020, në lagjen U. rr D. e K., pran P. kryesore pasi që fillimisht janë marr vesh ndërmjet vete, gjersa ishin në veturën G. P.s me targa ., ishin ndalur dhe pa dal nga vetura përmes dritares së hapur iu kërkojnë të dëmtuarve Sh. N. dhe A. R., se duan 2000 dollarë amerikan kinse për ti këmbyer në euro, mirëpo të dëmtuarit kanë njohur automjetin dhe nuk ua japinë të hollat dhe kur janë vërejtur se po fotografohen nga të dëmtuarit të pandehurit kanë ikur me automjetin e tyre".*

3. Nga këto rrethana Gjykata Supreme vëren se në veprimet e të pandehurve ka ekzistuar dashja dhe se veprimet e ndërmarra janë në drejtim të përftimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj, prandaj ka konstatuar se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar duke qenë se Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë gabimisht kanë zbatuar dispozitat ligjore të kodit penal kur kanë gjetur se në veprimet e të dënuarve janë konsumuar elementet e veprës penale të mashtrimit nga neni 323 për çka i ka shpallur fajtorë.

4. Gjykata Supreme vlerëson se është e nevojshme të sqaroj se në këtë situatë të rastit konkret, vepra penale e vjedhjes ka përcaktuar, se: " *Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro, apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet ...."*

5. Elementet e veprës penale të vjedhjes rezultojnë se janë, a) marrja e sendit të tjetrit, b). qëllimi i përvetësimit, c) përvetësimi të jetë i kundërligjshëm, ç) përvetësimi të bëhet qoftë për vete apo për tjetrin.

6. Në dispozitivin e përshkruar nga gjykata e shkallës së parë rezultojnë se veprimet e të pandehurit kanë qenë të drejtuara në marrjen e pasurisë, dhe se marrja e pasurisë konsiston në: dy faktor:
   a). Veprimi shkakton ndërprerjen e mbajtjes së pasurisë nga pronari, dhe b). Pasuria kalon në posedim të kryesit.

7. Në rastin konkret rezulton se është përmbushur marrja e pasurisë pasi që të dëmtuarit janë ndërprerë nga posedimi i pasurisë së tyre dhe ajo pasuri ka kaluar tek të dënuarit. Poashtu rezulton se përvetësimi i pasurisë nga ana e të dënuarve është i kundërligjshëm pasi që nuk kishte asnjë bazë ligjore që të dënuarit tua merrnin parat të dëmtuarve, rrjedhimisht për këto shkaqe Gjykata Supreme ka konkluduar, se në veprimet e të pandehurit Shkelzen përmbushen elementet e veprës penale të vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 paragrafi 1. Ndërsa në veprimet e të pandehurit Granit Behluli, përmbushen elementet e veprës penale të vjedhjes së mbetur në tentative nga neni 318 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Kosovës.

8. Gjykata Supreme ka parasysh se vepra penale e mashtrimit për te cilën të dënuarit janë shpallur fajtor, nga rrethanat e përshkruara në dispozitiv nuk rezulton se janë konsumuar elementet e kësaj vepre penale, duke qenë se, kjo vepër penale kryhet në dy mënyra, a) duke i fshehur faktet, apo b). duke e vënë në lajthim për faktet që si të tilla nuk ekzistojnë.

9. Në rastin konkret nga përshkrimi si në dispozitiv të aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë, nuk rezulton fshehja e ndonjë fakti nga ana e të dënuarve ndaj të dëmtuarve dhe nuk rezulton as vënia në lajthim lidhur me faktet që si të tilla nuk kanë ekzistuar, rrjedhimisht për këto shkaqe kjo gjykate ka gjetur se në veprime e të dënuarve janë

konsumuar elementet e veprës penale të vjedhjes dhe jo të veprës penale të mashtrimit.

10. Andaj për këto arsye kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit Shkelzen Jashari është vlerësuar si e bazuar, ashtu që aktgjykimet janë ndryshuar vetëm sa i përket kualifikimit juridik e rrjedhimisht edhe dënimit marr për bazë se vepra penale që kjo gjykatë ka gjetur se konsumohet nga veprimet e të dënuarit Shkelzen parasheh dënim më të ulët se vepra penale për të cilën ishte shpallur fajtor i dënuari nga dy gjykata e instancave më të ulëta, gjë që kjo ka kushtëzuar ndryshimin e vendimit lidhur me dënimin, për te cilin dënim Gjykata Supreme ka vlerësuar rrethanat që janë marr për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit që ekzistojnë në raport me të dënuarin duke gjetur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që parashihet në nenin 38 të Kodit Penal.

11. Gjykata supreme e ka ndryshuar aktgjykimin edhe sa i përket te dënuarit Grait Behluli duke u bazuar në nenin, 436 paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale, përkundër se i dënuari Granit Behluli dhe mbrojtja e tij nuk kanë parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, mirëpo duke qenë se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ka të bëjë me gjetjet e shkeljes së ligjit penal, sipas kësaj dispozite ligjore edhe e ka ndryshuar aktgjykimin në drejtim të dënuarit Granit Behluli, vetëm përkitazi me kualifikimin juridik, dhe ka gjetur se në veprimet e të dënuarit janë konsumuar elementet e veprës penale të vjedhjes të mbetur në tentativë nga neni 313 par 1 lidhur me nenin 28, e që rrjedhimisht kjo vepër penale ka paraparë një dënim më të butë se sa vepra penale për të cilën ishte shpallur fajtor nga Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, rrjedhimisht kjo ka kushtëzuar ndryshimin e aktgjykimit edhe sa i përket dënimit. Nga Gjykata Supreme eshte vlerësuar se ndaj të dënuarit Granit Behluli, ishte shqiptuar dënim me burgim dhe me gjobë gjë që dënimi me burgim me pëlqimin e të dënuarit ishte zëvendësuar në dënim me gjobë, atëherë kjo gjykatë i ka shqiptuar dënim me gjobë sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

12. Kurse sa i përket aspekteve të tjera, rezulton se në aktgjykimet e kundërshtuara janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe konkrete, duke qenë se është arsyetuar dhe sqaruar çdo fakt vendimtar që ndërlidhet me përgjegjësinë e të dënuarve, dhe se siç rrjedhe nga procesverbali i shqyrtimit fillestar të dënuarit janë deklaruar fajtore gjë që ata nuk kanë kontestuar rrethanat e fakteve, se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të pranimit të fajësisë, ka vlerësuar provat se a mbështesin këtë gjendje faktike për çka edhe ka pranuar fajësinë e të dënuarve, prandaj dashja dhe qëllimi i të dënuarve rezulton i provuar nga rrethanat e rastit dhe provat që mbështesin faktet e kësaj çështje penale.

13. Në këtë mënyrë, nga arsyet e theksuara si më lartë Gjykata Supreme e Kosovës, ka ardhur në përfundimin se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 438 paragrafi 1 nënpargrafi 1.1, të Kodit të Procedurës Penale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.170/2025, datë 23.04.2025

’’Në këtë rast Gjykata Supreme, ka miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, dhe e ka liruara nga akuza të dënuarën, duke gjetur se veprimi për të cilën ngarkohej e akuzuara nuk përbën vepër penale, sepse ndihma në vepër penale të mashtrimit në rrethana të tilla nuk mund të jetë veprim i inkriminuar nëse nuk ka ndikim ndihma në përmbushjen e elementeve të veprës penale për të cilën ndihmohet kryerësi.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës së shkallës së parë
   Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm P.Nr.1970/2024 të datës, 30.10.2024, të dënuarën Jennifer Carolina Oliva Muepaz, e ka shpallur fajtore për veprën penale, ndihma në veprën penale të mashtrimit nga neni 323 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe e ka dënuar me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 600 euro e cila është obliguar që dënimin me gjobë ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi ta merr formën e prerë. Në dënimin me burgim i ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim prej datës 24.07.2024, e deri më datë 03.10.2024. E dënuara është obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale, paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, dhe taksën në emër të kompensimit të viktimave të krimit në shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Ndaj të njëjtës ka shqiptuar dënimin plotësues dëbimin nga territori i vendit dhe ndalimin e hyrjes në kohëzgjatje prej 1 viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas vuajtjes së dënimit kryesor. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

2. Vendimi i Gjykatës së shkallës së dytë
   Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.Nr.2089/2024, e datës

14.01.2025, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të dënuarës Jennifer Carolina Oliva Muepaz, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Mbrojtësja e të dënuarës Jennifer Carolina Oliva Muepaz, avokatja Artiola Xhemajli, ka parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër këtyre aktgjykimeve, për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni 385 paragrafi 1, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljet tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoi kërkesën si të bazuar, ti anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen t'ia ktheji gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

4. Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KMLP.II.Nr.91/2025 e datës 21.03.2025, ka dhënë përgjigje në kërkesë duke propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses e të dënuarës Jennifer Carolina Oliva Muepaz, av. Ariola Xhemajli, të refuzohet si e pabazuar.

5. Konstatimet e Gjykatës Supreme
   Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstaton se:

   - kërkesa është e bazuar.

6. Pretendimet ne kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Mbrojtësja e të dënuarës në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, thekson se shkelja e ligjit penal qëndron në faktin se në veprimet e ngarkuara ndaj të dënuarës nuk formësohen elementet e veprës penale të ndihmës në mashtrim nga neni 323 paragrafi 1 e lidhur me nenin 33 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Mbrojtja thekson se në veprimet e të dënuarës mund të ekzistojnë veprimet nga neni 380

dhënie e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprës penale, mirëpo sipas paragrafit 5 të nenit 380 duke qenë se e dënuara është familjare me të dënuarin që ka kryer veprën penale të mashtrimit e që është babai i të dënuarës. Mbrojtja poashtu thekson se dy aktgjykimet e gjykatave më të ulëta janë marr në shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarës. Për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale mbrojtja në kërkesë thekson se në arsyetimet e aktgjykimeve te gjykatave si në shkallë të pare ashtu të asaj në shkallë të dytë as për së afërmi nuk janë plotësuar kërkesat e dispozitës ligjore nga neni 369 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Pretendohet se Gjykata e Shkallës se Parë fare nuk ka vërtetuar dhe nuk ka arsyetuar në mënyrë të saktë tërësisht rrethanat që janë të rëndësishme për të ardhur deri te marrja e vendimit siç detyrohet nga neni 7 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Të njëjtat shkelje të mungesës së arsyetimit për vërtetimin e rrethanave për të ardhur deri te një vendim ekzistojnë edhe në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit për çka nuk ka dhënë arsye lidhur me pretendimet ankimore. Nga aktgjykimet e kundërshtuara mbrojtja thekson se mbetet hipotetike se cili ishte veprimi i të dënuarës si i kundërligjshëm referuara dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, pasi ka vlerësuar aktgjykimet e atakuar nga ana e mbrojtjes së të dënuarit, ka gjetur se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e bazuar, pasi që aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë është marr në shkeljet ligjit penal në dëm të dënuarës shkelje këto që nuk janë evituar as nga Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes së Ankesës.

2. Gjykata Supreme ka parasysh se e dënuara ngarkohej për veprën penale, ndihmë në kryerjen e veprës penale të mashtrimit nga neni 323 paragrafi 1 e lidhur me nenin 33 të Kodit Penal të Kosovës.

3. Ndërsa veprimet që i viheshin në barrë të dënuarës, siç rrjedhë nga dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë janë, se: " Me dashje ndihmon personin tjetër gjegjësisht Raul M. Oliva Rosero, shkon në kryerjen e veprës penale të "Mashtrimit" në atë mënyrë që, deri sa i pandehuri Raul, me veprimet e tij me anë të mashtrimit përvetëson shumën e parave prej 1300 dollarë amerikan, këtu e pandehura Jennifer e pret jashtë lokalit bënë roje dhe siç vërehet në video incizim kur Raul del nga "EX C." të dy së bashku vrapojnë në drejtim të panjohur dhe më pas e pandehura Jennifer së bashku me të pandehurin Raul, paratë e përvetësuara përmes mashtrimit arrijnë ti fshehin në një kuti në veturën G. të marrë nga Raul dhe Jennifer në renta-car "H.".

4. Fillimisht Gjykata Supreme, ka parasysh se ndihma në kryerjen e veprës penale, sipas nenit 33 paragrafi 1 ka përcaktuar se: "1. Kushdo që me dashje ndihmon personin tjetër për kryerjen e veprës penale dënohet më dënim më të butë sesa kryesi i veprës", ndërsa paragrafi 2 ka përcaktuar se: " Ndihma për të kryer një vepër penale përfshin, por nuk kufizohet në: dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale". Ndërsa veprimi i të dënuarës rezulton se ishte duke bërë roje gjersa i dënuari Raul M. Oliva Rosero ka kryer veprimin e mashtrimit ndaj të dëmtuarit në këmbimoren "EX C.".

5. Gjykata Supreme rikujton se dispozita nga paragrafi 2 i nenit 33, të Kodit Penal të Kosovës, ka përcaktuar disa forma se si mund të konsiderohet veprimi i ndihmës së kryerjes së veprës penale por nuk ka kufizuar edhe ndonjë formë tjetër të ndihmës.

6. Në rrethana të rastit konkret kjo Gjykatë duke marr për bazë se veprimi që i vihet në barrë si formë e ndihmës ndaj të dënuarës ishte, " Bërja e

rojës gjersa i dënuari Raul M. Oliva Rosero, ne keombimore kryern veprimin e mashtrimit".

7. Në radhë të parë në raport me veprën penale të mashtrimit, duhet të kemi parasysh se bërja e rojës, nuk konsiston në ndihmë, as në krijimin e kushteve për kryerjen e veprës penale të mashtrimit, as në mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale të mashtrimit, gjithnjë duke pasur parasysh elementet e veçanta të veprës penale që duhet të përmbushen për Mashtirm nga neni 323 paragrafi 1.

8. Per tu konsideruar bërja e rojës si veprim i ndihmës që do të kishte të bënte me ndonjë forme tjetër siç paragrafi 2 i nenit 33 qe forma e ndihmës nuk kufizohet, Gjykata Supreme vlerëson se, ndihma duhet të jetë objektive – që konsiston në krijimin e kushteve të lehtësimit të kryerjes së veprës penale.

9. Në këtë këndvështrim duke vlerësuar veprimin që i vihej në barrë të dënuarës, " bërja e rojës para lokalit ku i dënuari Raul kishte hyrë në këmbimore dhe kishte kryer veprën penale të mashtrimit", duhet të vlerësohet bërja e rojës së të dënuarës, a kishte ndikim në lehtësimin e veprës penale të mashtrimit që duhet të vlerësohet në raport me rrethanat e rastit, si ishte kryer vepra penale e mashtrimit në çfarë rrethanash.

10. Gjykata Supreme ka parasysh se në veprimet e të dënuarit Raul M. Oliva Rosero se ai me veprimet mashtruese të këmbimit të monedhave nga dollari amerikan në euro mashtron të dëmtuarin për vlerën prej 1300 dollar, të cilat i përvetëson, në këto rrethana kjo Gjykatë konkludon se, bërja e rojës nga e dënuara Jennifer Carolina Oliva Muepaz, gjersa i dënuari Raul M. Oliva Rosero, kishte këmbyer të hollat për çka të dëmtuarin në këmbimore i kishte dhënë shuma më të ulëta të vlerave monetare.

11. Marrë për bazë faktin se vepra penale e mashtrimit kryhet kur përmbushen këto elemente të veprës penale:

a) duke e vu në lajthim të dëmtuarin, apo

b) duke ia paraqitur faktet e rreme,
c) me qëllim të përfitimit për veten apo për tjetrin, dhe i dëmtuari të veproj në dëm të pasurisë së tij.

12. Këtu shtrohet çështja vendimtare, se qëndrimi si roje para lokalit nga e dënuara, si e lehtësoj kryerjen e veprës penale qoftë në duke vu ne lajthim apo duke paraqitur faktet e rreme, Rrjedhimisht Gjykata Supreme, konkludon se e dënuara me veprimin e saj "të bërjes së rojës para lokalit të këmbimores" nuk kishte asnjë ndikim objektiv të ndihmës në realizimin e veprës penale nga i dënuari Raul M. Oliva Rosero, pasi që qëndrimi para lokalit të këmbimores nuk kishte lehtësuar në asnjë rrethanë që të mundësonte kryerjen e veprës penale nga i dënuari Raul.

13. Gjykata Supreme ka parasysh, se e dënuara ngarkohej me veprimet e saja qe së bashku me të dënuarin Raul, pasi që largohen nga lokali i këmbimores, arrijnë që ti fshehin të hollat në veturën G., që e kishin marr me qera.

14. Për sa i përket kësaj rrethana që do të përbënte ndihmë në përputhje me nenin 33 paragrafi 2 që parashihet se, " premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale". Provat që janë administruar në shqyrtimin Gjyqësor, si dëgjimit të dëshmitarëve provat materiale, fotografit, raportet policore, nuk provojnë një veprim të tillë se e dënuara ka fshehur parat në veturën G., që ishte marr me qera nga e dënuara Jenifer dhe i dënuari Raul, rrjedhimisht Gjykata Supreme vlerëson se ky fakt vendimtar nuk provohet me asnjë provë nga e cila varet edhe aplikimi i dispozitës nga nenit 33 paragrafi 2, për tu konsideruar se e dënuara ka konsumuar elementet e veprës penale të dhënies së ndihmës në veprën penale të Mashtrimit nga neni 323 paragrafi 1, i Kodit Penal të Kosovës.

15. Ndërsa për veprimet e të dënuarës që ngarkohej se ditën kur e njëjta ka shkuar në qendrën e paraburgimit ne Lipjan ka pasur të fshehura

shumën prej 7.000 euro dhe nuk i ka deklaruar, Gjykata Supreme rikujton se këto nuk përbëjnë rrethana inkriminuese të ndonjë vepre penale, dhe nuk kanë të bëjnë me rrethanat e ndihmës qe ngarkohej e dënuara, që do të ndërlidheshin me përgjegjësin penale të dënuarës.

16. Prandaj për këto arsye Gjykata Supreme, ka gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykatës së Shkallës së dytë, janë marr me shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarës, nga neni 385 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Kodit Penal të Kosovës, dhe i ka ndryshuar aktgjykimet e këtyre dy gjykatave ashtu që të dënuarën e ka liruar nga akuza, pasi që nuk provohet se e njëjta ka konsumuar elementet e veprës penale, ndihmës në veprën penale të Mashtrimit nga neni 323 paragrafi 1 e lidhur me nenin 33, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

17. Për këto shkaqe, Gjykata Supreme ka gjetur se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar dhe konform nenit 438 paragrafi 1 nënpargrafi 1.1 e lidhur me nenin 363 paragrafi 1 nënpargrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.171/2025, datë 24.04.2025

’’Në këtë rast Gjykata Supreme, nuk kishte gjetur të bazuar pretendimet në kërkesë, për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal apo shkelje tjera të dispozitave që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit, duke u referuar në standardet e GJEDNJ-ës për arsyetimin e aktgjykimit si kërkesë e nenit 6, të Konventës për të drejtat dhe liritë e njeriut, dhe se Gjykata Supreme ka arsyetuar se gjykatat e instancave më të ulëta i kanë përmbushur standardet e tilla të arsyetimit të Aktgjykimit.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës së shkallës së parë
   Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.Nr.33/2023 të datës 04.03.2024, i dënuari Rrahmon Xhafa është shpallur fajtor për veprën penale vrasja e rëndë e mbetur në tentativë nga neni 147 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 lidhur me nenin 28, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, dhe është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit prej datës 2805.2008 deri me date 21.07.2008. I dënuari është obliguar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumë prej 200 (dyqind) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 10 (njëqind) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. I është konfiskuar thika e llojit patentë si mjet që ka shërbyer në kryerjen e veprës penale. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesë pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko - civil.

2. Vendimi i Gjykatës së shkallës së dytë
   Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.Nr.268/2024, të datës. 27.12.2024, ka refuzuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe

ankesën e mbrojtësit të dënuarit, dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

3. Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur
   Mbrojtësi i të dënuarit Rrahmon Xhafa av. Mahmut Halimi, ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së nenit 440 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, dhe shkeljes së Ligjit Penal, duke propozuar që Gjykata Supreme ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, dhe ti ndryshoj aktgjykimet e Gjykatës së shkallës së parë dhe atë të Gjykatës së Apelit dhe të dënuarin ta liroj nga akuza duke konstatuar se veprimet e tij nuk përbëjnë vepër penale duke konstatuar se ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, e në rastin më të pavolitshëm të ndryshoj aktgjykimet e goditura dhe të konstatoj se në veprimet e të dënuarit janë konsumuar elementet e veprës penale të lëndimit të rëndë trupor nga neni 154 paragrafi 1 nënpargrafi 1.3 dhe lëndimit të lehtë trupor nga neni 153 paragrafi 1 nënpargrafi 1.1, për të cilat ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale andaj ka propozuar që akuza të refuzohet.

4. Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Prokurori i Shtetit ka parashtruara përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, KMLP.II.Nr.92/2025 të datës 26.03.2025, me të cilën ka propozuar që Gjykata Supreme ta refuzoj si të pabazuar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit.

5. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 paragrafi 1 dhe 436 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoj pretendimet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

   - *kërkesa është e pa bazuar.*

6. Pretendimet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë

a. Mbrojtja në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1

nën paragrafi 1.10 lidhur me nenin 432 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 e në kundërshtim me nenin 350 paragrafi 2, pasi që nuk është paraqitur fare analizë e provave gjegjësisht dëshmitarëve R. B. të dhënë në zyrën e prokurorit dhe tani të ndjerit S.B. dhe po ashtu nuk ka paraqitur as arsyetim se përse këto prova nuk janë arsyetuar.

b. Si pasoj e mungesës së arsyeve për këto prova rezulton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 369 paragrafi 7 te Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, e cila dispozitë kërkon që të arsyetohet në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i ka konsideruar të vërtetuara apo të pavërtetuara dhe po ashtu kërkon që në mënyrë të veçantë të vlerësohet saktësia e provave. Mbrojtja thekson se deklarata e dëshmitarit S. B. vërteton një fakte tërësisht tjetër nga ajo që ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, nga se ky dëshmitar ka sqaruar situatën se përderisa i dëmtuari ka qenë në S. P.për ta marr raportin e aksidentit aty ka pasur një sjellje arrogante me Policinë dhe po ashtu të dënuarin e kishte kanosur, si dhe kur dëshmitari S. kishte qenë në pikën e kontrollit tek Ura kur ishte kërkuar intervenim nga policia, ai kishte theksuar se kanë qenë tre persona duke u konfrontuar me të dënuarin. Mbrojtja pretendon se shkeljet nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 janë evidente edhe në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, nga se i mungon tërësisht arsyetimi që parashihet sipas nenit 401 paragrafi 1 i Kodit të procedurës Penale të Kosovës. Më konkretisht mbrojtja thekson se Gjykata e Apelit në aktgjykimin e goditur ka konstatuar se, " ....janë përfshirë të gjitha rrethanat dhe faktet përkitazi me ngjarjen duke përfshirë edhe ato përkitazi me motivin e kryerjes së veprës penale ....." por nga ana tjetër provat e në veçanti deklarata e dëshmitarit S. që zbulon faktin e motivit është cunguar në të dy aktgjykimet e goditura, nga se askund nuk flitet për sjelljet e të dëmtuarit K., kur atij i ishte kërkuar që në stacionin policor të kthehej më vonë për ta marr raportin nga se nuk ishte gati e ku i dëmtuari kishte shpërthyer papërmbajtshëm, duke deklaruar se, " .... ju nuk dini të punoni, këtë rast do ta zgjidhi vet dhe do ta vras personin që më ka shkaktuar aksident..." fakt ky që tregon anën e drejt të motivit që ishte në anën e të dëmtuarit K., andaj duhet për këto rrethana ti besohet

deklaratës se të pandehurit Rrahmon që ka sqaruar për rrethanat e ngjarjes siç kanë ndodhur ditën kritike që kishte sqaruar se derisa ai ishte duke telefonuar personin e quajtur D., i dënuari ka dëgjuar britmën "ku je o hajvan, o kali që e qon kryet si qenë përpjetë, kemi me të bo llom se nuk po merr parasysh dëmin që ma ke shkaktuar" e pastaj vërsuljen e tre personave mbi të ashtu që fillimisht ishte përpjekur ti zmbrapste duke ua tërhequr vërejtjen " ikni se ju qoj poshtë" por që sulmi i tyre kishte vazhduar si pasoj e të cilit sulm ai kishte vazhduar që të mbrohej me lëvizje të thikës andaj edhe numri i goditjeve me thikë ishte pasoj e sulmit të pandërprerë të dëmtuarve ndaj të dënuarit. Ai ishte i përgjakur dhe në momentin e arritjes se policisë ai zbatoi urdhrin dhe e lëshoj thikën ndërsa njeri nga personat e përfshirë dëshmitari S. S. kishte ikur nga vendi i ngjarjes. Ndërsa i dënuari Rrahmon nuk kishte asnjë motiv sepse aksidenti që kishte ndodhur dy ditë më parë ai i kishte shprehur të dëmtuarve keqardhje dhe ishte në gjendje tua kompensonte dëmin.

c. Mbrojtja në kërkesë thekson se me aktgjykimet e goditura është shkelur ligji penal, nga se duke munguar motivi te i dënuari e që nga provat rezulton se motivin e tillë e kishte i dëmtuari K. dhe ka filluar sulmin ku i ishte bashkangjitur edhe i dëmtuari V., ndërsa i dënuari ishte mbrojtur duke u përpjekur që sulmin ta largonte nga vetja, këto janë veprime që përjashtojnë përgjegjësinë penale e të dënuarit nga se i njëjti veproj në mbrojtje të nevojshme që e njeh neni 8 paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës, ndërsa në rastin me të papërshtatshëm veprimet e të dënuarit do të duhej trajtuar brenda nenit 8 paragrafi 3 dhe 4, për shkak të disproporcionit të mjetit që ka përdorur e që do të kualifikoheshin veprimet vrasje e rëndë në tentativë në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 147 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 lidhur me nenin 20 e lidhur me nenin 8 paragrafi 3 dhe 4, për çka do të kishte ndikim edhe në lartësinë e dënimit e posaçërisht duke marr për bazë periudhën kohore që ka kaluar prej 20 vitesh nga koha që është kryer vepra penale e që as para dhe as pas nuk ka të dhëna se i dënuari ka shkelur ligjin ndonjëherë, ka fëmijë dhe është i vetmi ushqyes i familjes.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet në kërkesën e mbrojtjes se të dënuarit janë të pabazuara, dhe se aktgjykimet e Gjykatës së shkallës së parë dhe të Gjykatës së Apelit nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

2. Fillimisht Gjykata Supreme vëren se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën e dispozitivit, ka të përshkruara të gjitha rrethanat nga të cilat varet edhe zbatimi i dispozitave materiale, gjegjësisht ka të përshkruara rrethanat nga të cilat rezultojnë elementet që e përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën është dënuar, duke përfshirë, kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe pasojën e shkaktuar nga veprimi i tillë. Rrjedhimisht Gjykata Supreme vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit nuk përmban paqartësi të fakteve lidhur me elementet e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor.

3. Në arsyetim të aktgjykimit, rrjedh se gjykata e shkallës së parë është kujdesur që të arsyetoj faktet e përshkruara në dispozitiv nga të cilat varet zbatimi i dispozitës materiale, si dhe arsyetimin e provave përmes të cilave ka ardhur deri te një konkludim kur ka shpallur fajtor të dënuarin.

4. Gjykata Supreme vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10, e cila dispozitë ka përcaktuar se: " aktgjykimit i mungon plotësisht arsyetimi", e që mbrojtja e ndërlidh mungesën e arsyetimit të aktgjykimit me deklarata e dy dëshmitarëve, R.B. dhe S.B. që ndërlidhet me rrethanat e ngjarjes në raport me elementet e veprës penale.

5. Gjykata Supreme gjen se, deklaratat e dy dëshmitarëve që mbrojtja pretendon se nuk janë vlerësuar, nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë rrjedh se në faqe 11, pasuesi i dytë ka konstatuar se, "Gjykata ka vlerësuar deklaratën e dëshmitarit R. B. ndërsa në pasuesin 3 ka

konstatuar se, "Gjykata ka vlerësuar edhe deklaratën e dëshmitarit S. B.....", ndërsa po ashtu ne faqe 12, të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë pasuesi i dytë, rezulton se është arsyetuar dhe është vlerësuar deklarata e dëshmitarit R. B., se cilat fakte i ka vërtetuar përmes deklaratës së këtij dëshmitari. Po ashtu në faqe 13 pasuesi i dytë të aktgjykimit të Gjykatës së Shkallës së parë rrjedh arsyetimi se, është vlerësuar deklarata e dëshmitarit S. B., nga e cila deklaratë rezulton se cilat fakte i ka provuar gjykata e shkalles së parë kur ka ardhur në përfundimin se i dënuari ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

6. Ndërsa nga aktgjykimi i Gjykatës së Apelit me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore, rrjedh se Gjykata e Apelit ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e mbrojtjes së të pandehurit. Më konkretisht Gjykata e Apelit në aktgjykim ka arsyetuar si për sa i përket pretendimeve të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe pretendimeve për sa i përket sanksionit penal, dhe se me rastin e trajtimit të pretendimeve ankimore edhe sa i përket deklaratës së dëshmitarëve, R.I. dhe S. B., rrjedh se në faqe 3 të arsyetimit të aktgjykimit pasuesi i fundit, dhe faqe 4 pasuesi i parë, ka arsyetuar se përse i mbështet konkludimet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me provat që i referohen edhe motivit të veprës penale, andaj Gjykata Supreme gjen se pretendimet e mbrojtjes së të dënuarit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë janë të pabazuara dhe vlerëson se, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 lidhur me nenin 369 paragrafi 7 i Kodit të Procedurës penale e lidhur me nenin 401 të Kodit të procedurës Penale të Kosovës.

7. Lidhur me pretendimet e mbrojtjes që theksohen në kërkesë se deklarata e dëshmitareve R. dhe S. është cunguar në vlerësim dhe arsyetim me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykatës së Apelit, Gjykata Supreme e Kosovës këto pretendime i gjen te pabazuara, dhe kjo gjykatë, rikujton se Konventa Evropiane për të

Drejtat dhe Liritë e njeriut e cila gjen zbatim të drejtpërdrejt sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në kuadër të nenit 6, përcakton të drejtën e një procesi të rregullt gjyqësor, në të cilën dispozitë përfshihet edhe detyrimi i arsyetimit te vendimit gjyqësor, dhe se sipas Praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, në rastet e trajtuar lidhur me nivelin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, ka konstatuar se: "Shtrirja e detyrës për arsyetim të vendimit mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit dhe duhet të analizohet në dritën e rrethanave të çështjes – Rasti Nr.18390/91 R. T. k. S., " po ashtu ka përcaktuar se: " Ndonëse një gjykatë nuk është e detyruar të japë përgjigje të hollësishme për çdo argument të ngritur Rasti Nr.16034/90 V.de H. k. H." si dhe ka konstatuar se: " Nga vendimi duhet të dalë qartë që janë prekur pikat thelbësore të ngritura në çështje – Rasti 19997/02 B. k. R..

8. Në këtë kuptim Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut ka përcaktuar kritere se arsyetimi i një vendimi kërkon që:
   a) Shtrirja e arsyetimit të ndërlidhet me rrethanat e çështjes;
   b) Nuk detyrohet që të jepen përgjigje të hollësishme për çdo pretendim të ngritur;
   c) Arsyet nga vendimi duhet të dalin të qarta se janë prekur pikat thelbësore të ngritura.

9. Në rastin konkret Gjykata Supreme vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë kanë përmbushur këto kërkesa edhe sa i përket deklaratave të dëshmitarëve R. dhe S., pasi që siç u theksua gjykata e shkallës së parë përveç se ka arsyetuar këto dy deklarata rezulton se ka vlerësuar tërësinë e provave që janë administruar në shqyrtimin gjyqësore dhe pas vlerësimit në raport me faktet ka ardhur deri te një konkludim racional për fajësinë e të dënuarit kur e ka shpallur fajtor, ndërsa Gjykata e Apelit me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka dhënë arsye lidhur me pretendimet e ndërlidhura për rrethanat e çështjes dhe se janë prekur pikat thelbësore të çështjes që në rastin konkret ka të bëjë me motivin dhe ekzistimin e sulmit që mbrojtja e të pandehurit pretendon se ka ndodhur nga ana e të dëmtuarve ndaj të dënuarit, por nga arsyetimet e aktgjykimeve të dy gjykatat si ne shkallë të parë ashtu edhe ne shkalle te dyte, rrjedhë se

kanë arsyetuar mbi provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor, qe pretendimet e mbrojtjes së të dënuarit për ekzistimin e sulmit nuk provohen andaj edhe kanë konkluduar se i dënuari ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

10. Prandaj Gjykata Supreme vlerëson se arsyet e dhëna nga dy gjykata e shkallëve më të ulëta, në tërësinë e rrethanave të provave të tjera duke vlerësuar edhe deklaratat e dëshmitarëve, R. dhe S. janë të drejta dhe te ligjshme dhe se këto arsye mbështesin konkludimet e nxjerra lidhur me dënimin e të dënuarit.

11. Gjykata Supreme ka parasysh pretendimet e mbrojtjes për sa i përket pretendimeve për mos vlerësim të deklaratave të dëshmitarëve R. dhe S., që si të tilla këto prova për pasoj duke mos u vlerësuar, kanë rezultuar me shkeljen e ligjit penal në dëm të dënuarit pasi që mbrojtja thekson se duke qenë se nga deklarata e dëshmitarit S. i cili në prokurori nder te tjera ka deklaruar se (i kam parë tre persona duke e sulmuar të dënuarin), kjo gjykatë ka parasysh se pretendimet ndërlidhen me aspekt të gjendjes faktike për çka kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk lejohet që të parashtrohet por se, si të tilla ndërlidhen edhe me aspektin e shkeljes së ligjit penal andaj do i trajtoj në drejtim të pretendimeve të shkeljes së ligjit penal.

12. Nga rrethanat e rastit rrjedh se, vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari, kishte ndodhur 28.05.2008 në M. pranë urës së l. I., ku i dënuari rrjedh se ka goditur me një thike patentë, të dëmtuarin K. me 5 goditje, në regjionin e kraharorit afër zemrës, bark, shpinë dhe dorën e majtë, si dhe të dëmtuarin V. Z. ka goditur gjithsej 9 herë me thikë dhe ka shkaktuar plagë prerëse shpuese dhe atë në toraks, pjesën e komblikut dhe në regjionin e parakrahut të majtë, ku si pasoj ka ardhur deri te prezenca e ajrit në hapësirën e majtë torakale të shkaktuar nga mjeti prerës shpues. Po ashtu rrjedh se i dënuari dhe të dëmtuarit nuk kishin asnjë mosmarrëveshje tjetër përveç se aksidentit të komunikacionit që kishte ndodhur me datë 26.05.2008.

13. Nga këto rrethana Gjykata Supreme, ka parasysh se motivi gjithnjë duhet vlerësuar mbi bazën e rrethanave të rastit, andaj në dritën e këtyre rrethanave, kjo gjykatë vlerëson se motiv i kryerjes së veprës penale rrjedh vetëm nga mosmarrëveshja që ekzistonte si pasojë e aksidentit në komunikacion dhe nuk ka asnjë rrethanë që do të krijonte ndonjë besueshmëri tjetër për ekzistimin e ndonjë motivi.

14. Ndërsa për deklarimin e dëshmitarit S. që ka pohuar ndër të tjera në prokurori se, "meqenëse ishin shumë afër, dëshmitari S. së bashku me kolegun e tij R. janë nisur në drejtim të vendit të ngjarjes dhe kur janë afruar kanë vërejtur që tre persona e sulmonin një person, me tu afruar më afër e ka vërejtur se i sulmuari Rrahmon Xhafa dhe atë nga K. Z., të cilin e ka njohur menjëherë pasi që më herët e kishte parë në stacion dhe së bashku me të kanë qenë edhe dy persona tjerë, njëri prej të cilëve ka ikur, kurse tjetri ishte V. Z., ku dëshmitari ka deklaruar se iu është drejtuar me urdhër verbal që të shpërndahen, të njëjtit kanë vepruar sipas urdhrit dhe janë shpërndarë e ku me këtë rast dëshmitari S. B. e ka vërejtur të pandehurin Rrahmon Xhafa i cili ishte i përgjakur në fytyrë, ndërsa në dorë e ka vërejtur se mbante një brisk. Nuk e ka parë fare se V. dhe K. kanë qenë të lënduar, këtë e ka marr vesh më vonë nga kolegët të cilët kanë raportuar nga Shtëpia e Shëndetit. Kjo gjykatë ka parasysh se i njëjti dëshmitar ka dhënë edhe deklaratën – raportin lidhur me rrethanat e ngjarjes, në polici me datë 28.05.2008, i cili nuk ka pohuar rrethanat e tilla të cilat i kishte deklaruar në prokurori dhe më thelbësorja kur ka përpiluar raportin e tillë për rrethanat e ngjarjes në asnjë pjesë të raportit nuk thekson dëshmitari se - tre persona ishin duke e sulmuar të dënuarin-. Nga ana tjetër dëshmitari R.B., i cili ishte po ashtu zyrtar policor dhe në intervenim së bashku me dëshmitarin tjetër S. B., në deklaratën e dhënë në prokurori me datë 18.07.2008, ka deklaruar se "Jemi nisur në drejtim të vendit të ngjarjes dhe kur jemi afruar kam vërejtur se B. P. dhe K. B. ishin duke u rrahur, që ua kam mësuar emrat më vonë kurse më poshtë ishin duke u rrahur Rrahmon Xhafa dhe V. Z. ndërsa personi i tretë ka ikur. As nga deklarata e dëshmitarit S. të dhënë në polici e as nga deklarata e dëshmitarit R. të dhënë në prokurori, nuk mbështetet versioni i pretenduar nga mbrojtja në deklaratën e dëshmitarit S., se dëshmitari S. kishte deklaruar në

prokurori se të dëmtuarit e kanë sulmuar të dënuarin, për tu kualifikuar fakti i tillë si veprim i zmbrapsjes së sulmit".

15. Prandaj në këtë kontekst të deklarimeve për këto rrethana edhe Gjykata Supreme e pranon si të arsyetuar dhe bindës arsyen e dhënë nga gjykata e shkallës së parë në faqe, 11 dhe 12 që përshkruhet deklarata e dëshmitarit S. në faqe 13, kur ka vlerësuar këtë deklaratë të atij dëshmitari, që ka konstatuar se: " Nuk e ka parë të dënuarin duke sulmuar të dëmtuarit, por ka parë të dëmtuarit duke sulmuar të dënuarin. Nuk ka parë se të dëmtuarit kanë qenë të goditur me thikë", në rrjedh logjike siç ka vlerësuar këtë deklaratë gjykata e shkallës së parë edhe për këtë gjykatë, rezulton se i dënuari ka goditur të dëmtuarit me thikë e kjo mbështet me provat si raportet mjekësore dhe foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes dhe deklaratë e te dëmtuarve, ndërsa faktin e theksuar nga dëshmitari se të dëmtuarit e kanë goditur të dënuarin kjo mund të ketë ndodhur por jo para se i dënuari t'i ketë goditur me thikë të dëmtuarit pasi që edhe vet dëshmitari thekson se ai nuk e ka parë të dënuarin që i ka sulmuar me thikë të dëmtuarit por vetëm të dëmtuarit kur e kanë sulmuar të dënuarin dhe se ai kur ka dhënë urdhër, veprimet e mëtejshme janë ndalur, pra logjikisht rrjedh se goditjet me thikë kanë ndodhur para se dëshmitari t'i ketë parë se të dëmtuarit e kanë goditur të dënuarin, pasi që më tej nuk kishte veprime të askujt sepse kishte urdhëruar dëshmitari si zyrtar policor dhe veprimet ishin ndalur sepse vet dëshmitari ka pohuar se u janë bindur urdhrave të policisë personat që ishin të përfshirë në rast.

16. Andaj as me deklaratën e këtij dëshmitari nuk mund të provohet pretendimi i mbrojtjes se ka ekzistuar sulmi i të dëmtuarve ndaj të dënuarit për të legjitimuar ndërmarrjen e veprimeve të tij në drejtim të zmbrapsjes, rrjedhimisht për këto arsye Gjykata Supreme, mbështet arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë dhe i vlerëson pretendimet e mbrojtjes si të pabazuara për shkelje të ligjit penal, duke gjetur se ligji penal është zbatuar drejt nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, pasi që në veprimet e të dënuarit janë përmbushur elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë të mbetur në tentativë nga neni 147 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, e lidhur me nenin 28 te Kodit

të Përkohshëm Penal të Kosovës, dhe se vepra nuk rezulton se është kryer në rrethana të mbrojtjes së nevojshme dhe as në tejkalim të rrethanave të mbrojtjes së nevojshme.

17. Nga arsyet e cekura më lart dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.186/2025, datë 10.04.2025

’’Në këtë rast, Gjykata Supreme nuk ka pranuar si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe ka arsyetuar se edhe kur dënimi për veprën penale parashihet deri në 3 vite burgim dhe kur të miturit i janë shqiptuar masa për vepra tjera penale por nuk arrihet qëllimi të miturit mund ti shqiptohet, Masa e Edukuese institucionale – Dërgimi në institucionin Edukativo – Korrektues sipas nenit 29 paragrafi 2 e Kodit të Drejtësisë për të Mitur.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës së shkallës së parë.
   Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për të mitur, me aktvendimin, PM.Nr.100/2024 e datës 18.10.2024, të miturit D. R., për shkak të dy veprave penale vjedhja nga neni 313 par.1, të KPRK-së, dhe një vepër penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1, të KPRK-së, i ka shqiptuar Masën Edukuese Institucionale - Dërgimi në Institucionin Edukativo - Korrektues, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, e cila masë do të ekzekutohet nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, në të cilën masë do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim deri sa aktvendimi do të marrë formën e prerë por jo më gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga dita e arrestimit. Është urdhëruar Shërbimi Sprovues i Kosovës, që të bëjë verifikimin lidhur me ekzekutimin e kësaj mase. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës. Të dëmtuarit S. M., J.K. dhe A.I., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

2. Vendimi i Gjykatës së shkallës së dytë.
   Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për të mitur, me aktvendimin PAM.Nr.147/2024, të datës 30.12.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të miturit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.
   - mbrojtësi i të miturit D. R., avokati R. S., nga P., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale e ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, kërkesën ta aprovoj, ashtu që ti ndryshojë aktvendimet e kundërshtuara dhe të miturit t'ia zvogëlojë masën e shqiptuar, ose lëndën ta kthejë në rigjykim dhe vendim për ta nxjerrë një aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

4. Pergjigja në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.
   Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.Nr.101/2025, e datës 27.03.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të miturit D.R., av. R. S., të refuzohet si e pabazuar.

5. Vleresimi i Gjykatës Supreme.
   Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtojë të gjitha shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, par.1 lidhur me nenin 436, par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

   - kërkesa është e pabazuar.

6. Pretendimet e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.
   Mbrojtësi i të miturit në kërkesë pretendon se gjykatat e instancave me të ulëta kanë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Sipas mbrojtësit masa e shqiptuar është tepër e rëndë kur dihet se i mituri në kohen e kryerjes së veprave penale ka qenë i mitur i ri, dhe se i ka pasur 14 vjet, kurse kur ju ka shqiptuar masa i ka pasur 15 vjet. Tutje mbrojtësi thekson se të dy gjykatat nuk kanë marrë parasysh mirëqenien e të miturit, interesin e tij më të mirë dhe se privimi i lirisë ndaj të miturit shqiptohet vetëm si mjet i fundit. Koha e kufizuar nga liria duhet të kufizohet në afatin sa më të shkurt të mundshëm, pasi që të miturit edhe pas shqiptimit të masës nuk ju ka ndërprerë masa e

paraburgimit dhe se kjo mund të ndikojë negativisht tek i njëjti ngase ai nuk mund të perceptojë drejtë masën e privimit nga liria për shkak të moshës e cila mund të lë pasoja të pariparueshme në zhvillimin e tij intelektual. Gjithashtu mbrojtësi ka shtuar se gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat relevante për të mitur në kuptim të nenit 69, 70, 71 e 72 të KPRK-së dhe nenit 22 të KDM, kur shihet se rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit dhe kufijtë e zbutjes së dënimit. Po ashtu, thekson se në rastin konkret kur të merret parasysh mosha e të miturit gjykata është dashur që të shkojë në minimumin e dënimit nëse jo edhe më poshtë. Mbrojtësi i të miturit shton se aktvendimet janë marrë edhe me shkelje të ligjit penal ngase ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të miturit ngase mosha e të miturit dhe pesha e veprave penale e mundësojnë këtë dhe se në rastin konkret përveç dëmit material nuk kemi të bëjmë me dëmtim fizik apo ndonjë dëm tjetër, po kemi të bëjmë vetëm me vjedhje të biçikletave nga ana e të mituri, andaj, propozon si më lartë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, pretendimet e mbrojtësit të të miturit se aktvendimet e kundërshtuara ai i gjykatës së shkallës së parë dhe i shkallës së dytë janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me shkelje të ligjit penal janë të pabazuara.

2. Aktvendimet e kundërshtuara janë të qarta, të kuptueshme dhe nuk përmbajnë kundërthënie me vetveten ose me arsyet e paraqitura. Përshkrimet e dhëna në arsyetimin e aktvendimeve të kundërshtuara me kërkesë përmbajnë të gjitha arsyet për faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërthënës.

3. Gjykata Supreme vëren nga aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë se pasi që i mituri ka pranuar fajësinë për 3 veprat penale që ngarkohej nga propozimi i prokurorisë, Gjykata ka shqyrtuar pranueshmërinë e deklarimit të fajësisë nëse 242 i Kodit të Procedurës Penale. Mbi rrethanat e tilla faktike rezultojnë se janë konsumuar veprat penale

sipas propozimit të prokurorisë dhe atë dy vepra penale të vjedhjes nga neni 313 paragrafi 1 dhe një vepër penale vjedhje e rëndë sipas nenit 315 paragrafi 1. Rrjedhimisht arsyetimi i aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë nuk rezulton me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale qoftë për faktet vendimtare si dhe rezulton se kishte marr për bazë personalitetin e të miturit, se ka vlerësuar anketën sociale që ishte paraqitur nga shërbimi sprovues dhe ku kanë rezultuar gjetje e konstatuara si në anketë. Tutje nga arsyetimi i aktvendimit pasi që kishte konstatuar të gjeturat lidhur me personalitetin e të miturit, se ka vlerësuar të gjitha rrethanat që kanë ndikuar për të marrë vendim për vendosjen e masës edukuese institucionale – Dërgimi në institucionin edukativo korrektues si dhe kohëzgjatjen e kësaj mase. Prandaj nga të gjitha këto arsye që përmban aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga nenit 384 paragrafi 1 dhe 2.

4. Gjykata Supreme po ashtu gjen se aktvendimi i Gjykatës së Apelit nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga i cili aktvendim rezulton se janë trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga mbrojtësi i të miturit si për sa i përket pretendimeve për shkelje esenciale dhe po ashtu rezulton se është shqyrtuar aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë nëse është shkelur ligji penal në dëm te të miturit, ndërsa nga arsyetimi rrjedh se ka shqyrtuar pretendimet e mbrojtjes edhe sa i përket pretendimeve për rrethanat që janë marr me rastin e shqiptimit të masës Edukuese Institucionale – dërgimit në institucionin edukativo korrektues, për çka nga arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës së Apelit, janë dhënë arsye se cilat rrethana i ka gjetur janë marr për bazë nga gjykata e shkallës së parë për shqiptimin e kësaj mase dhe përse masa e tillë është shqiptuar në kohëzgjatjen e tillë, duke dhënë arsye se përse këto rrethana janë të qëndrueshme dhe të pranueshme për gjykatën e Apelit, andaj arsyet e dhëna nga Gjykata e Apelit janë të qarta dhe të pranueshme për Gjykatën Supreme, rrjedhimisht kjo gjykatë konstaton se aktvendimi i Gjykatës së Apelit nuk është i përfshirë me shkelje esenciale nga neni 384 paragrafi 1 dhe 2 i Kodit të Procedurës Penale.

5. Lidhur me pretendimet e kërkesës së aktvendimet janë përfshirë me shkelje të ligjit penal, duke pretenduar se, i mituri në kohën e kryerjes se veprës penale ishte i Mitur i Ri dhe po ashtu në kohën e gjykimit, Gjykata Supreme rikujton se, shqiptimi i masës edukuese – Dërgimi në Entinë institucional Korrektues, sipas nenit 29 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur që përcaktohen kushtet ligjore për shqiptimin e kësaj mase, nuk përcaktojnë si kusht ligjor moshën e të miturit që duhet të përmbushet për tu shqiptuar kjo masë. Ndërsa lidhur me pretendimet se Gjykata e Apelit ka konstatuar se vepra penale vjedhje nga neni 316, parasheh dënimin mbi tri vite, Gjykata Supreme ka parasysh se, shqiptimi i masës Edukative Institucionale – dërgimi në institucionin Edukues – Korrektues, në nenin 29 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur ka përcaktuar në paragrafin 1 se: *" Gjykata e shqipton masën e dërgimit në një institucion edukativo-korrektues kur i mituri i cili ka kryer vepër penale të dënueshme me burgim prej më shumë se tre (3) vjet, ka nevojë për edukim të specializuar dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të të miturit". Ndërsa në paragrafin 2; " Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, gjykata mund ta shqipton masën e dërgimit në institucion edukativo-korrektues kur i mituri ka kryer vepër penale të dënueshme deri në tri (3) vite, kur masat e tjera të shqiptuara ndaj të miturit, nuk e kanë arritur qëllimin"*, në rrethana të rastit konkret rezulton se vepra penale e vjedhjes nga neni 313 paragrafi 1 ka paraparë dënim me gjobë dhe me burgim deri në 3 vite, ndërsa vepra penale vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1 ka paraparë dënimin me gjobë dhe me burgim prej 3 deri në 7 vite.

6. Gjykata Supreme gjen se neni 29 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur ka parapare kushtet e shqiptimit te masës, edukuese – dërgimi në Institucionin Edukativo – Korrektues, duke qenë se kemi të bëjmë me një vepër penale që përmbushen kushtet sipas paragrafit 1 të nenit 29, ndërsa marrë për bazë se nga Anketa sociale rrjedhin të dhënat se ndaj të miturit janë shqiptuar masat për vepra tjera penale, mirëpo rezulton se nuk ishte arritur qëllimi, për çka edhe në raport me dy veprat penale të vjedhjes nga neni 316 paragrafi 1, që përcaktojnë dënimin me gjobë dhe burgim deri në 3 vite, në raport me nenin 29 paragrafi 2 janë plotësuar kushtet ligjore për shqiptimin e masës Edukuese

institucionale – Dërgimi në institucionin Edukativo – Korrektues, nga këto arsye Gjykata Supreme nuk i gjen të bazuara pretendimet se aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të shkallës së dytë janë marrë me shkelje të ligjit penal.

7. Gjykata Supreme ka vlerësuar pretendimet e mbrojtjes lidhur me rrethanat që janë marr për bazë me rastin e shqiptimit të llojit të masës dhe kohëzgjatjes së masës që i është shqiptuar të miturit, kjo gjykatë ka gjetur se rrethanat e vlerësuar, gjegjësisht rrethanat lehtësuese që janë marrë për bazë, si pranimin e përgjegjësisë, premtimi që është bërë nga i mituri që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, pendimin për veprimet e ndërmarra ne kryerjen e veprave penale si dhe moshën e tij të re. Ndërsa si rrethana rënduese që janë vlerësuar të dhënat nga anketa sociale që rezultojnë se i mituri në të kaluarën ka ra ndesh me ligjin për vepra penale të natyrës së njëjtë, po ashtu faktin se i mituri nuk jeton me familjen e tij por me një të mitur tjetër çka e bënë të ekspozuar për rrugë marrë për bazë se s'ka përkujdesje familjare, po ashtu se sigurimi i të miturit është bërë përmes urdhërarrestit dhe në momentin e arrestimit ka rezultuar se i mituri është zënë në flagrancë në kryerje të një vepre tjetër penale në një market, të gjitha këto rrethana që janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë që i ka vlerësuar se ekzistojnë edhe gjykata e shkallës së dytë, për Gjykatën Supreme ekzistojnë dhe kanë peshën e tyre për të vlerësuar se masa e shqiptuar dhe kohëzgjatja është në interes të të miturit, marr për bazë edhe faktin e peshën e veprave penale dhe karakteristikat e të miturit, prandaj pretendimet e mbrojtësit në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, për një tjetër masë apo për kohëzgjatje më të shkurtër të masës, kjo gjykatë i ka gjetur të pabazuara. Gjykata Supreme rikujton se lloji i masës dhe kohëzgjatja i takon gjykatave të instancave më të ulëta që mbi bazën e rrethanave që ekzistojnë ta shqiptojnë si llojin ashtu edhe kohëzgjatjen që vlerësohet se është në funksion të qëllimit më të mirë të të miturit, ndërsa nuk është në kompetencën e Gjykatës Supreme që të shqyrtoj pretendime që lidhen me rrethanat për dënimin gjegjësisht masën, megjithatë marr për bazë dispozitën nga neni 13 paragrafi 1 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, që parasheh se: "

8. Kur ndaj të miturit shqiptohet ndonjë masë apo dënim, gjykata në radhë të parë merr parasysh interesin më të mirë të të mituri ...” andaj në funksion të kësaj dispozite ligjore Gjykata Supreme ka vlerësuar nëse rrethanat që janë marr për bazë dhe masa e shqiptuar ndaj të miturit është në funksion të interesit më të mirë të të miturit, gjë që nga tërësia e rrethanave dhe posaçërisht, sjelljes së të miturit që rezultojnë nga ankesat sociale dhe fakti se i mituri nuk është nën përkujdesjen e familjes që e bënë lehtësisht të ekspozuar ndaj sjelljeve devijonte, vlerëson se masa e shqiptuar si për nga lloji, ashtu edhe për nga kohëzgjatja është në funksion të interesit të të miturit.

9. Në anën tjetër, sa i përket çështjes së shqiptimit të llojit të masës dhe kohëzgjatjes, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton se, sipas nenit 385, paragrafi 5 të KPP-së, shkelje të ligjit penal konsiderohen vetëm rastet kur gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore gjatë marrjes së vendimit për masën e shqiptuar. Pra, sipas kësaj dispozite ligjore, tejkalimi i kompetencave ligjore nga ana e gjykatës në shqiptimin e dënimit konsiderohet shkelje e ligjit penal. Në këtë çështje penale, gjykatat e instancave më të ulëta, duke vlerësuar rrethanat përkatëse, i kanë shqiptuar masën Edukuese Institucionale – Dërgimi në Institucionin Edukativo Korrektues, brenda kufijve të parashikuar sipas nenit 29 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, kjo do të thotë se gjykatat nuk kanë tejkaluar kompetencat ligjore.

10. Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.188/2025, datë 23.04.2025

’’Gjykata Supreme ka miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe ka anuluar aktgjykimin e dy gjykatave duke kthyer çështjen penale në rigjykim, pasi që gjykata e shkallës së parë dhe as ajo e shkallës së dytë nuk kishin vendosur për propozimin e mbrojtjes së të dënuarit për zbatimin e ekzaminimit psikiatrik për të konstatuar nëse i dënuari, i kishte kryer veprat penale në gjendje të paaftësisë apo aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, dhe ishte vë në dyshim zbatimi i ligjit penal nëse i dënuari mund të ishte penalisht përgjegjës për shkak të gjendjes së tij mendore.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë
   Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i përgjithshëm P.Nr.533/2022 të datës, 09.02.2024, të dënuarin Burim Sylejmani e ka shpallur fajtor për veprën penale shkatërrimi apo dëmtimi i pronës nga neni 321 par.2 e par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe veprës penale pengimi i personit zyrtar nga neni 401 par.5, 4 e 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe është gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 07.06.2022, e deri më datë 04.07.2022. I dënuari është obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën mjeko-ligjore shumën prej 20 euro, paushallin gjyqësor në shumë prej 30 euro, dhe taksën në emër të kompensimit të viktimave të krimit në shumë prej 20 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

2. Vendimi i gjykatës së shkallës së dytë

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.Nr.628/2024, e datës 26.11.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit Burim Sylejmani, ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Mbrojtësi i të dënuarit Burim Sylejmani, avokati Arton Haziri nga Gj., ka parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër këtyre aktgjykimeve, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 lidhur me neni 508 të Kodit të Procedurës Penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoi kërkesën dhe ti ndryshoi aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që të dënuarin ta liroi na akuza, ose ti anuloi aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen t'ia ktheji gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

4. Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KMLP.II.Nr.103/2025 e datës 04.04.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit Burim Sylejmani, av. Arton Haziri, të refuzohet si e pabazuar.

5. Konstatimet e Gjykatës Supreme
   Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstaton se:

   - kërkesa është e bazuar.

6. Pretendimet ne kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesë pretendon se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulëta përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 e lidhur me nenin 508, 257 dhe 369 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, duke theksuar se nuk është vendosur për propozimin për ekzaminim

psikiatrik ndaj te dënuarit si dhe për faktin se i dënuari është shpallur fajtor duke u bazuar ekskluzivisht në deklaratën e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit për të cilën nuk është dhënë mundësia të kundërshtohet nga i dënuari për mes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale. Po ashtu mbrojtësi thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se nuk janë paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye gjykata i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme ligjore për vërtetimin e saktë dhe të plotë të fakteve dhe rrethanave vendimtare, andaj arsyetimet e dhëna janë në kundërshtim me vetveten.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, pasi ka vlerësuar aktgjykimet e atakuar nga ana e mbrojtjes së të dënuarit, ka gjetur se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e bazuar, pasi që aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje këto që nuk janë eliminuar as nga Gjykata e Apelit, me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore, e të cilat shkelje kushtëzojnë anulimin e aktgjykimeve të dy gjykatave.

2. Siç rezulton nga shkresat e lëndës mbrojtja e të dënuarit, në këtë çështje penale i është drejtuar Gjykatës Themelore në Gjilan, me kërkesën e datës: 25.07.2022, për zbatimin e ekzaminimit psikiatrik, me dy pretendime: a) konstatimin e gjendjes psikike në kohen e kryerjes së veprës penale, dhe b) konstatimin nëse i dënuari është i afte për t'iu nënshtruar gjykimit. Nga kërkesa rezulton se e njëjta mbështetej në dokumentet mjekësore nga të cilat vërehet se i dënuari ishte trajtuar te psikiatri dr. A. C., në periudhën: 09.01.2019, 02.09.2019, 10.09.2019 dhe 25.07.2022. Ndërsa nga procesverbali i shqyrtimit fillestar rezulton se seanca e shqyrtimit fillestar është mbajtur me date. 04.07.2022, gjë që kërkesa për zbatimin e ekzaminimit psikiatrik i ishte drejtuar Gjyqtarit që i ishte ndarë lënda penale për gjykim. Nga shkresat e lëndës nuk rezulton asnjë aktvendim i veçantë, që të jetë

vendosur lidhur me kërkesën e parashtruar nga mbrojtja e të dënuarit për ekzaminimin psikiatrik.

3. Nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.Nr. 533/2022 i datës. 09.02.2023, në asnjë pjesë të aktgjykimit, nuk ishte trajtuar propozimi i palës në procedurë, lidhur me kërkesën për ekzaminim psikiatrik, që rrjedhë se gjykata e shkallës së parë në aktgjykim, fare nuk jep arsye lidhur me pretendimin e palës, pretendim ky që lidhet me vërtetimin e një çështjes thelbësore në procedurë dhe që ka të bëjë me gjendjen mendore të dënuarit, nga e cila varet edhe çështja e konstatimit, se i njëjti a mund të jetë me përgjegjësie penale sipas 17, të Kodit Penal të Kosovës, apo duhet i dënuari të kualifikohet si person me paaftësi mendore gjegjësisht me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore sipas nenit 18 të Kodit Penal të Kosovës.

4. Mungesa e arsyetimit të tërësishëm nga gjykata e shkallës së parë, për sa i përket propozimit me shkrim të deponuar nga mbrojtja e të dënuarit, e bënë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë që të jetë i përfshirë me shkelje nga neni 384 paragrafi 2, nënpargrafi 2.7, e lidhur me nenin 369 paragrafi 7, e cila dispozite përcakton se: "*Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij",* për çka kjo gjykatë, i ka gjetur si të bazuara pretendimet e mbrojtjes në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

5. Në aktgjykimin e Gjykatës Themelore ne Gjilan, rrjedhë se gjykata ka shqyrtuar çështjen e provueshmërisë së fakteve, mirëpo nuk i referohet në asnjë pjesë propozimit të parashtruar nga mbrojtësi i të dënuarit për ta ekzaminuar të dënuarin në mënyrë që të vërtetohet edhe aspekti i drejt i zbatimit të Kodit Penal, pasi që rrethanat e tilla të propozuara

nga mbrojtja e të dënuarit, janë thelbësore për tu konstatuar se a kemi të bëjmë me gjendjen e përgjegjësisë se plotë penale për çka rregullohet sipas nenit 17, të Kodit Penal të Kosovës, apo kemi të bëjmë me paaftësi mendore gjegjësisht me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore me nenin 18 i Kodi Penal të Kosovës.

6. Mos trajtimi dhe shpërfillja e tërësishme e propozimit të mbrojtjes së të dënuarit, përveç se e bëjnë aktgjykimin me të meta në raport me nenin 369 paragrafi 7, e cila dispozitë kërkon që: "*aktgjykimi duhet të përfshij arsyet e mosmiratimit të propozimeve të palëve*", dhe që aktgjykimi të arsyetohet, "*veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit*", nga se duke qenë përball propozimit të mbrojtësit të dënuarit dhe duke mos e trajtuar propozimin e tillë, kjo e bënë aktgjykimin, që përveç se është marr me shkelje nga neni 384 paragrafi 2 nënpargrafi 2.7, lidhur me nenin 369 paragrafi 7, ka efekt edhe në zbatim të drejt të ligjit penal në raport me nenin 17 gjegjësisht 18 të Kodit Penal.

7. Gjykata Supreme gjen, se përveç që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, edhe aktgjykimi i Gjykatës se Apelit nuk ka eliminuar shkeljet e tilla të theksuara si më sipër me rastin e shqyrtimit të ankesës, për rrjedhojë edhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

8. Gjykata Supreme vëren, se në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, nuk është shqyrtuar fare pretendimi i mbrojtjes së të dënuarit që ishte i parashtruar në ankesë, me konkretisht mbrojtja kishte pretenduar se gjykata e shkallës së parë, nuk ka vendosur lidhur me propozimin për ekzaminim psikiatrik dhe nuk ka dhënë arsye, ashtu që mbrojtja për këto shkaqe kishte theksuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është i përfshirë me shkelje esenciale.

9. Nga aktgjykimi i Gjykatës se Apelit në faqe 3, të arsyetimit të aktgjykimit parashtrohen pretendimet e mbrojtjes, mirëpo kur paraqiten arsyet lidhur me pretendimet në faqe 4, të arsyetimit te

aktgjykimit, nuk paraqet asnjë arsyetim lidhur me propozimin që nuk ishte vendosur dhe nuk është dhënë asnjë arsyetim në aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Andaj, mungesa e arsyetimit në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit e bënë që i njëjti të jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës penale nga neni 401 lidhur me nenin 384 paragrafi 2 nënpargrafi 2.7, e lidhur me nenin 369 paragrafi 7, i Kodit të Procedurës Penale, pasi që nuk janë dhënë arsye lidhur me pretendimet e parashtruara në ankesën e mbrojtjes së të dënuarit.

10. Në rigjykim Gjykata Themelore ne Gjilan, duhet ti eliminoj të gjeturat e konstatuara nga Gjykata Supreme, dhe pastaj të marr vendim në përputhje me dispozitat ligjore.

11. Për këto shkaqe, Gjykata Supreme ka gjetur se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar dhe konform nenit 438 paragrafi 2 nënpargrafi 1.2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktvendim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.198/2025, datë 23.04.2025

''Gjykata Supreme ka hudhur si të papranueshme kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të mbrojtësit të dënuarit, pasi që kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit ligjor.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë
   Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për krime të rënda PKR.Nr.201/2022 të datës 18.12.2023, të dënuarin Açif Vasija e ka shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi.3, nënpargrafi.3.1 të KPRK-së, dhe e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 15.11.2022 e deri më datë 18.12.2023. I dënuari është obliguar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumë prej 300 (treqind) euro, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. Pala e dëmtuar B. V., për realizimin e kërkesë pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civilo-juridik.

2. Vendimi i gjykatës së shkallës së dytë
   Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PAKR.Nr.97/2024 e datës 01.11.2024, ka refuzuar si të bazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

3. Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:
   Prokurori i Shtetit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1, nënparagrafi.1.10 të Kodit të Procedurës Penale e lidhur me nenin 369 paragrafi 6 e 7 të KPP-së, si dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 385 të KPP-ës, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj si të bazuar kërkesën dhe

konform nenit 438 paragrafi 1, nënpargrafi 1.3 dhe paragrafi 2 i KPP-së, të konstatoi se aktgjykimet e kundërshtuar janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal.

4. Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Ndaj kërkesës së Prokurori i Shtetit, është përgjigjur mbrojtësi i të të dënuarit Açif Vasija, avokat Forti Skoro, me propozim që kërkesa e prokurorit të hudhet poshtë si e pasafatshme, për arsye se është paraqitur jashtë afatit ligjor të paraparë me dispozitën e nenit 433 paragrafi 2 të KPP-së.

5. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 paragrafi1 dhe 436 paragrafi1 të KPP-së, vlerësoj pretendimet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

   - kërkesa është e papranueshme.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme, fillimisht ka vlerësuar nëse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka përmbushur kushtet procedurale për tu trajtuar në themel.

2. Gjykata Supreme rikujton se, dispozita nga neni 433 e KPP-së, ka paraparë, palët e autorizuara për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe afatin për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërie. Më konkretisht paragrafi 2, i nenit 433 ka përcaktuar: "Zyra e Kryeprokurorit të shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe personat e paraparë në nenin 424, paragrafin 1 të këtij Kodi mund të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajve nga dita e dorëzimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Nëse kundër vendimit të gjykatës Themelore nuk paraqitet ankesë, afati rrjedh nga dita kur vendimi merr formë të prerë".

3. Në rastin konkret, rezulton se kërkesa është paraqitur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, andaj referuara dispozitës së lartcekur

rezulton se është palë që mund të paraqes kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Ndërsa nga shkresat e lëndës rrjedhë se Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda kishte marr aktgjykimin, PKR.Nr.201/2022 me datë 29.12.2023. Ndërsa duke vepruar sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesës së përfaqësuesit të dëmtuarit B. V., av. Gent Gjini, Gjykata e Apelit e Kosovës kishte marr aktgjykimin PAKR.Nr.97/2024 me datë 01.11.2024.

4. Nga shkresat e lëndës rezulton se, Prokuroria Themelore në Prizren kishte pranuar aktgjykimin e gjykatës së Apelit si vendim i formës së prerë me datë: 26.11.2024, fakt ky që rezulton nga flet kthesa e Gjykatës Themelore në Prizren dhe që vërteton se Prokuroria Themelore në Prizren ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës se Apelit të Kosovës me datën e lartë theksuar.

5. Ndërsa kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë (që si akt i prokurorisë mban datën 11.03.2025) nga Prokurori i Shtetit ishte deponuar në Gjykatën Themelore në Prizren me datë: 17.03.2025, që është evidentuar nga zyra e pranimit përmes sistemit smil me numër të lëndës: 2022:240774, dhe numër të dokumentit, 06998815.

6. Gjykata Supreme nga tërësia e këtyre rrethanave ka konstatuar se, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës si vendim i formës së prerë ishte pranuar me datë 26.11.2024, nga Prokuroria Themelore në Prizren, dhe se nga data e pranimit të aktgjykimit të formës së prerë rezulton se afati për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë përfundonte me datë. 25.02.2025.

7. Mirëpo nga shkresat e lëndës është gjetur se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mban datën 11.03.2025, ndërsa sipas datës që është deponuar në Gjykatën Themelore në Prizren, rezulton se është përtej afatit ligjor që është parapare me nenin 433 paragrafi 2, pasi që rrjedhë se ishte paraqitur në gjykatë në ditën e 111, nga dita kur prokuroria kishte pranuar aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit të

Kosovës, e qe rezulton se kërkesa është paraqitur pas afatit ligjor përtej tre muajve.

8. Andaj duke konstatuar se kërkesa nuk përmbush kushtet procedurale, Gjykata Supreme meqë ka gjetur se kërkesa është e pasafateshme nuk është lëshuar në meritat e pretendimeve që paraqiten në kërkesë.

9. Nga arsyet e cekura më lart dhe në pajtim me dispozitën e nenit 435 paragrafi 2 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të ketij aktvendimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.227/2025, datë 24.04.2025

’’Gjykata Supreme ka refuzuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë me të cilën ishte kërkuar ndryshimi i aktgjykimeve të gjykatave në instanca më të ulëta dhe kërkohej kthimi i armës që ishte konfiskuar. Gjykata Supreme në këtë rast ka konstatuar se i dënuari kishte leje për armën por nuk kishte leje për bartjen e saj. Ai ishte shpallur fajtor për veprën penale që armën e kishte bartur pa leje. Në këtë rast mbrojtja kërkonte kthimin e armës me arsyetimin se arma e konfiskuar ishte me leje te vlefshme nga organi administrativ. Gjykata Supreme kishte konstatuar se mbështetur ne dispozitën ligjore nga neni 366 paragrafi 3 që përcakton se: “Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet”, dhe se nuk ka baze ligjore për kthimin e armës pasi që mbajtja e armës ishte bërë në kundërshtim me ligjin për armët, sepse i dënuari ka pasur leje për armë por jo edhe për bartjen e saj rrjedhimisht kontrolli ishte në kundërshtim me nenin 366 te Kodit Penal të Kosovës e lidhur me ligjin për armët.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës së shkallës së parë
   Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Themelore në Prishtine Dega në Fushë Kosovë - Departamenti i Përgjithshëm me Nr. P.Nr.604/2024 të datës 30.09.2024, i dënuari Petrit Muleta është shpallur fajtor për veprën penale te Mbajtjes ne pronësi, kontroll apo posedim te pa autorizuar te armeve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së, ashtu qe i është shqiptuar dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muaj, dhe me pëlqimin e te dënuarit ky dënim i është zëvendësuar ne dënim me gjobe ne shumen prej 900 (nëntëqind) euro, ashtu që e ka detyruar të dënuarit që dënimin me gjobë ta paguaj në këste, duke përcaktuar se dënimi duhet të paguhet në 4 (katër) këste për secilin këstë në shumën prej 225 euro, dhe pagesa e dënimit duhet të filloj pas plotfuqishmërisë e aktgjykimit, ndërsa këstet tjera në çdo muaj pasues, duke përcaktuar se nëse i dënuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë i njëjti dënim do të revokohet dhe

do ti zëvendësohet me dënim me burgim duke i llogaritur çdo 20 (njëzet) euro të gjobës për 1 (një) ditë burgim. Ka obliguar të dënuarin që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë, shumën prej 30 (tridhjetë) euro në emër të paushallit gjyqësor, ndërsa shumën prej 20 (njëzet) euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit. Ka konfiskuar armën e zjarrit p. ndaj të dënuarit, të llojit S. – S.9, me Nr. .. " . dhe një k.".

2. Vendimi i Gjykatës së shkallës së dytë
   Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.Nr.1882/2024 e datës 18.12.2024, e ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

3. Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur
   Mbrojtësi i të dënuarit Petrit Mulesa ka parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, edhe pse nuk ka theksuar se për cilat baza ligjore nga përmbajtja e kërkesës rezulton se pretendohet ne shkelje te ligjit penal, andaj ka propozuar qe Gjykata Supreme ta aprovon si te bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe te Gjykatës se Apelit ta ndryshoj vetëm sa i përket pjesës se konfiskimit te armës qe lidhet me sanksionin penal, si dhe sanksionit penal ashtu qe ti shqiptohet vërejtje gjyqësor apo që aktgjykimet të anulohen dhe çështja penale të kthehet në rigjykim pranë gjykatës së shkallës së parë.

4. Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Prokurori i shtetit ka dhënë përgjigje ne kërkesën për mbrojtjen e ligjshmëri, KMLP.II.Nr.120/2025 te datës 14.04.2025, me te cilën ka propozuar qe kërkesa e mbrojtësit te te dënuarit te refuzohet si e pabazuar.

5. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 paragrafi 1 dhe 436 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoj pretendimet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa është e pa bazuar.

6. Pretendimet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të dënuarit, pretendon se rrethanat për dënimin nuk janë marr për bazë sa duhet nga Gjykata e Shkallës së parë dhe ajo e Shkallës se dytë, kur është shqiptuar dënimi ndaj të dënuarit, poashtu thekson se konfiskimi i armës është bërë pa kurrfarë bazë ligjore, pasi që i dënuari posedon lejen për armen dhe kartelën e regjistrimit të armës për shenjëtari. Thekson se ditën kritike arma nuk është përdorur dhe se nuk është shkaktuar asnjë dëm nga arma e konfiskuar, mirëpo ditën kritike i dënuari ka qenë duke u zhvendosur nga fshati i tij i banimit në F. K. dhe kur ka arritur në F. K.është sulmuar nga M. S., dhe ai në rrjedhë e sipër e ka nxjerr armën vetëm për ta zmbrapsur atë sulm, arma nuk ka qenë e mbushur e madje as karikator nuk ka pasur të vendosur. Thekson se i dënuari ditën kritike nuk ka mundur që të shkoj në polici për ta njoftuar policinë për lëvizje me armen e tij, për pasoj nga ngjarja e ditës kritike, dhe detyrimet e tij për zhvendosje ai e ka marr armën me vete, për këto arsye mbrojtja thekson se Gjykata e Shkallës së parë por edhe ajo e shkallës së dytë gabimisht kanë konfiskuar armën që i dënuari ka leje., andaj edhe ka propozuar si me lartë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Fillimisht Gjykata Supreme gjen se në këtë çështje penale ekziston marrëveshje për pranimin e fajësisë ndërmjet të dënuarit dhe mbrojtësit të tij si dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë, se nga marrëveshja rezulton se i dënuari ka pranuar fajësinë për veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll apo posedim të armëve nga neni 366 paragrafi 1, për çka edhe është rekomanduar dënimi në kuadër të marrëveshjes prej 6 (gjashte) muaj burgim dhe me pëlqimin e të dënuarit i njëjti të zëvendësohet me dënim me gjobë ndërmjet shumës prej 800 (tetëqind) deri në 1000 (njëmijë) euro.

2. Nga shkresat e lëndës rrjedhë se Gjykata e Shkallës së parë ka hyrë në seancë për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, dhe me rastin e shqyrtimit i dënuari ka deklaruar se mbetet pranë marrëveshjes dhe pasi që ka vlerësuar se marrëveshja plotëson kushtet ligjore sipas nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Gjykata e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, dhe me atë rast e ka shpallur fajtor të dënuarin dhe e ka dënuar me dënimin e rekomanduar sipas marrëveshjes.

3. Gjykata Supreme, rikujton se kur ka marrëveshje për pranimin e fajësisë lidhur me çështjen e dënimit nuk është e lejuar fare ankesa për dënim, përveç nëse shqiptohet dënimi përtej rekomandimit sipas marrëveshjes në dëm të ndonjërës palë gjithnjë sipas nenit 230 paragrafi 12 të Kodit te Procedurës Penale të Kosovës.

4. Përndryshe, Gjykata Supreme e Kosovës edhe në këtë çështje penale rithekson se matja e dënimeve dhe vlerësimi i rrethanave përkatëse relevante është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, varësisht nga rrethanat e rastit, ndërsa duke u bazuar në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së, këto pretendime në lidhje me shqiptimin e dënimeve më të buta, nuk mund të jetë arsye për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

5. Lidhur me pretendimet e kërkesës për mbrojtje te ligjshmërisë për sa i përket konfiskimit të armës, Gjykata Supreme këto pretendime i gjen të pabazuara, për faktin se konfiskimi i armës nuk i nënshtrohet kushtit ligjor siç mbrojtja pretendon se nuk është shkaktuar asnjë dëm nga arma e të dënuarit, por që sipas dispozitës së nenit 366 paragrafi 3 te Kodit Penal te Kosovës, parashihet se: "*Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni* ***konfiskohet****".*

6. Nga kjo dispozitë, kushti ligjor është që në rrethana kur konstatohet fajësia për këtë vepër penale arma e cila ka qenë në, kontroll, posedim apo pronësi, duhet të konfiskohet dhe këtu konfiskimi është imperativ duke qenë se dispozita ligjore përcakton shprehimisht vetëm një

alternativ dhe atë konfiskimin, që nuk mundëson diskrecion apo vlerësim të ndonjë rrethane nga gjykata por është dispozitë imperativë.

7. Andaj për këto shkaqe Gjykata Supreme pretendimet e mbrojtëse së të dënuarit për sa i përket kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë lidhur me konfiskimin e armës, i gjen si të pabazuara, duke konstatuar se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së parë dhe ai i Shkallës së dytë nuk është marr me shkelje të ligjit penal nga neni 385 paragrafi 1 nënpargrafi 1. 5 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

8. Nga arsyet e cekura më lart dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.288/2025, datë 17.06.2025

''Gjykata Supreme ka miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe e ka ndryshuar aktgjykimin duke e liruar të dënuarin nga akuza, pasi që ka konstatuar se i dënuari ishte shpallur fajtor për një vepër penale që në kohen e kryerjes së veprës penale nuk ishte e inkriminuar. Në këtë rast Gjykata Supreme ka gjetur se Gjykata e Apelit ka zbatuar me efekt prapaveprues ligjin penal në dëm të të dënuarit.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës Themelore
   Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për të Mitur, me aktgjykimin PKR.Nr.34/2021 e datës 15.03.2022, të dënuarin X. X. e ka shpallur fajtor për veprën penale sulmi seksual nga neni 232 par.3, nënpar.3.7 e 3.10 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite. Në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 21.01.2019 e deri më datë 24.07..2019 si dhe koha e kaluar në arreste shtëpiak prej datës 24.07.2019 e deri më datë 10.08.2020, të cilin dënim do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Të dënuarit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të profesionit të mësimdhënësit në kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve, i cili dënim do të fillon të ekzekutohet pas vuajtjes së dënimit me burgi të shqiptuar. I dënuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 200 (dyqind) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 100 (njëqind) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Të dëmtuarat e mitura X.X., X. X., X.X., X. X., X. X., X. X., X. X. dhe X. X., përmes përfaqësuesve ligjore, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

2. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për të Mitur, me aktgjykimin PAKR.Nr.366/2022 e datës 26.02.2025, I. ka aprovuar kërkesën e mbrojtësve të të dënuarit dhe sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë përkitazi me përshkrimin faktik të dispozitivit, cilësimin juridik dhe vendimin për dënim, ashtu që të fjalisë "... me veprimet konkrete me qëllim seksual duke i prekur dhe ledhatuar me duar ....", duhet të jetë "... me veprimet konkrete të natyrës seksuale duke i prekur dhe ledhatuar me duar ...", të dënuarin duke e shpallur fajtor për shkak të veprës penale ngacmimi seksual nga neni 183 par.3 të KPRK-së (Kodi.Nr..... viti ....), duke e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 21.01.2019 e deri më datë 10.08.2020, II. Ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë e ka hudhur si të palejuar. III. Në pjesët e tjera të aktgjykimi ka mbetur i pa ndryshuar.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësit e të dënuarit X. X., avokatet T. dhe K. B. nga Gj., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 e neni 432 të KPP-së, ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza për shkak se vepra për të cilën ngarkohet nuk përbën vepër penale dhe nuk është provuar se ka kryer vepër penale e cila i vihet në barrë, ose aktgjykimet të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

4. Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit
   Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.Nr.155/2025 e datës 12.05.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarit X. X., av. T. e X. X., të refuzohet si e pabazuar.

5. Pretendimet e paraqitura në kërkesa

Në kërkesën e mbrojtësve të të dënuarit pretendohet për shkelje të ligjit penal nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, me rastin e aprovimit te ankesës ka konstatuar se ne veprimet e te dënuarit janë konsumuar elementet e veprës penale ngacmim seksual nga neni 183 paragrafi 3 i KPRK-së duke i shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, me arsyetim se kishte gjetur se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale në fjalë. Mirëpo pretendohet se gjykata e shkallës se dyte ka shkelur ligjin penal në dëm të të dënuari pasi që vepra penale për te cilën është shpallur fajtor nuk ka qenë e inkriminuar si vepër penale në kohën e kryerjes që është akuzuari i dënuari. Për më tepër, pretendohet se gjykata e shkallës së dytë e cila me aktgjykimin e saj sipas detyrës zyrtare ka vlerësuar se kemi të bëjmë me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit nga gjykata e shkallës së parë, përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, theksohet se edhe gjykata e shkallës së dytë ka shkelur ligjin penal duke e gjykuar të dënuarin për një vepër që nuk ka qenë e inkriminuar.

6. Në kërkesën e të pandehurit pretendohet se në këtë çështje penale është shkelur ligji penal nga ana e gjykatës së shkallës së dytë pasi që rrjedhimisht vepra penale më të cilën është dënuar i pandehuri nuk ka ekzistuar fare në kohën në të cilën pretendohet se është kryer. Pretendohet se në mënyrë të drejtpërdrejtë gjykata e shkallës së dytë ka shkelur ligjin penal, respektivisht dispozitën e nenit 3 par.2 të KPRK-së, pasi që vepra penale e ri cilësuar nuk ishte paraparë si vepër penale, respektivisht veprimet e të njëjtit në këtë kohë sipas aktakuzës apo aktgjykimeve nuk janë sanksionuar me ligj.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesa, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

2. Gjykata Supreme e Kosovës duke shqyrtuar pretendimet e paraqitura në kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë përkitazi me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë në tërësi pajtohet me pretendimet e theksuara se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë është shkelur ligji penal i përcaktuar me dispozitë e nenit 385 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, pasi që vepra për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor dhe është gjykuar nuk ishte e inkriminuar si vepër penale në kohën kur i pandehuri kishte kryer veprimet inkriminuese.

3. Nga shkresat e kësaj çështje penale del se gjykata e shkallës së parë të pandehurin e kishte shpallur fajtor dhe e kishte gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, për shkak të veprës penale sulmi seksual i personit nga neni 232 par.3, nënpar.3.7 e 3.10 e lidhur me par.1 të KPRK-së, me ç'rast kishte zbatuar ligjin që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, përkatësisht Kodin Penal Nr.04/L-082. Mirëpo, gjykata e shkallës së dytë duke vepruar sipas ankesës së mbrojtëses së të pandehurit dhe sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dënuarin duke e shpallur fajtor për shkak të veprës penale ngacmimi seksual nga neni 183 par.3 të KPRK-së dhe duke e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, me ç'rast si ligj penal më të favorshëm ka aplikuar Kodin Penal 06/L-074 e që me këtë rast ka shkelur ligjin penal në dëm të të pandehurit.

4. Gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e aktgjykimit të saj në mënyrë të qartë e potencon faktin se vepra penale e ricilësuar (vepra penale ngacmimi seksual) nuk ka ekzistuar në Kodin Penal të mëparshëm, gjegjësisht në kohën kur i pandehuri kishte kryer veprimet inkriminuese, megjithatë kishte aplikuar këtë dispozitë ligjore në mënyrë krejtësisht të gabuar dhe arbitrare duke bërë interpretim të gabuar dhe te pjesshëm vetëm të dispozitës së nenit 3 par.2 të KPRK-së dhe duke anashkaluar interpretimin e tërësishëm të dispozitës ligjore e cila rregullon në mënyrë të detajuar zbatimin e ligjit më të favorshëm, e që si rezultat i këtij interpretimi të gabuar të pandehurin e shpallë

fajtor dhe e gjykon për një vepër penale e cila nuk ishte ekzistuese në kohën e kryerjes së veprimeve nga ana e të pandehurit.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se dispozita ligjore e nenit 3 të KPRK-së ka normuar zbatimin e ligjit më të favorshëm duke përcaktuar se:

"5.1. Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

5.2. Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.

5.3. Nëse ligji i ri nuk e inkriminon veprën, por kryesi është dënuar me aktgjykim të formës së prerë në pajtim me ligjin e mëparshëm, sanksioni penal nuk fillon të ekzekutohet ose ndërpritet në rast se ka filluar.

5.4. Një ligj i cili shprehimisht ka qenë në fuqi vetëm për një kohë të caktuar, zbatohet për ato vepra penale që janë kryer gjatë kohës kur ai ligj ka qenë në fuqi edhe në rastin kur nuk është më në fuqi, përveç nëse vetë ligji shprehimisht përcakton ndryshe".

6. Me këtë rast gjykata e shkallës së dytë pa analizuar paragrafin e parë të nenit të sipër cituar i cili ka përcaktuar se ndaj kryerësit zbatohet ligji që është në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale e që nënkuptohet se nuk do të mund të zbatohet asnjë ligj tjetër i cili nuk ishte në fuqi, meqë kjo paraqet edhe parimin bazë të aspektit penal. Përtej kësaj, gjykata e shkallës së dytë ka bërë interpretim tërësisht arbitrar të dispozitës vijuese gjegjësisht nenit 3 par.2 të KPRK-së, meqë kjo dispozitë nuk aplikohet në rastet kur ligji penal paraprak nuk ka paraparë fare veprimin inkriminues si vepër penale. Në parim aplikimi i kësaj dispozite bëhet ekskluzivisht në rastet kur kemi inkriminim të dyfishtë, pra në të dy kodet penale edhe në kodin që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale e po ashtu edhe në kodin e ri që hyn në fuqi pas kryerjes së veprës penale dhe pastaj i mundësohet gjykatës përkatëse që të bëj krahasime mes këtyre dy kodeve që inkriminojnë veprimin e tillë dhe pa marrë parasysh

emërtimin e veprave penale (por duhet çmuar veprimet inkriminuese) dhe tek atëherë përcaktohet aplikimi i ligjit më të favorshëm.

7. Interpretimi i pjesshëm në këtë mënyrë siç ka bërë gjykata e shkallës së dytë, përkitazi me ligjin më të favorshëm bie në kundërshtim edhe me paragrafin vijues, gjegjësisht paragrafin e tretë të saj, me ç'rast në mënyrë imperative është përcaktuar se nëse vepra penale nuk inkriminohet në kodin e ri, atëherë edhe sanksioni i shqiptuar penal i shqiptuar nuk ekzekutohet dhe nëse ka filluar ekzekutimi atëherë ndërpritet, kjo për faktin se nuk inkriminohet si vepër penale e që në mënyrë të qartë dhe të plotë paraqet intencën e ligjvënësit se si të veprohet në këto raste dhe njëkohësisht interpretimin tërësisht të gabuar të kësaj dispozite nga ana e gjykatës së shkallës së dytë duke aplikuar një dispozitë ligjore e cila fare nuk ka inkriminuar sjelljen e tillë si vepër penale.

8. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje të ligjit penal dhe për këtë arsye u vendos që konform nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.339/2025, datë 14.07.2025

''Gjykata Supreme nuk e ka gjetur të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtjes së të dënuarit, si pretendim për shkeljen e parimit reformatio in peius, kur gjykata e shkallës së parë nga vepra penale që ngarkohej i akuzuari me akuzë për veprën penale Shantazhi nga neni 341, e ka ri kualifikuar dhe e ka shpallur fajtor për veprën penale të shtrëngimit nga neni 195. Në këtë rast kishte akuzë për një vepër penale nga kapitulli i veprave penale kundër pasurisë, ndërsa gjykata me rikualifikim e kishte shpallur fajtor dhe dënuar për një vepër penale nga kapitulli i veprave penale kundër të drejtave dhe lirive të njeriut.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës Themelore
   Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.Nr.4149/2017 e datës 12.01.2024, të dënuarin N. S. e ka shpallur fajtor për shkak veprës penale shtrëngimi nga neni 195 par.2, nënpar.2.4 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga 10 (dhjetë) muaj, në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohen e kaluar në paraburgim prej datës 19.03.2017 e deri më datë 18.04.2017. I dënuari është obliguar të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për paushallin gjyqësorë shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, shumën prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nënë kërcënimin e përmbarimit me detyrim. Pala e dëmtuar X. X., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

2. Vendimi i Gjykatës së Apelit
   Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.Nr.617/2024 e datës 16.12.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses se të dënuarit X. X., ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

   Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësja i të dënuarit X. X., avokatja B. H. nga P., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënpar.1.9 e1.10 të KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulojë dhe të pandehurin ta liroi në mungesë të provave, ose çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

   Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.Nr.180/2025, e datës 09.06.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses se të dënuarit X.X., av. B. H., të refuzohet si e pabazuar.

5. Vlerësimi i Gjykatës Supreme

   Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

   - kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

6. Pretendimet e paraqitura në kërkesë

   Në kërkesë mbrojtësja e të dënuarit pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënpar.1.9 dhe 1.10 të KPP-së, pasi që arsyetimi i aktgjykimit nuk ka paraqitur qartë se cilat fakte janë të provuara dhe cilat janë të paprovuara dhe nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara e gjithashtu nuk ka paraqitur dhe vlerësuar në mënyrë të saktë provat kundërthënëse me rastin e vendosjes së kësaj çështje.

7. Pretendohet se vetëm dëshmia e të dëmtuarës nuk mund të merret për bazë për tu akuzuar dhe gjykuar i pandehuri, për një vepër penale për të cilën nuk ka prova të besueshme se i njëjti ka kryer të njëjtën. Gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë shqyrtuar dhe vërtetuar një fakt të rëndësishëm se fotografit e publikuara në instagramin e hapur "Q. B.-K." ishin fotografit e dërguara nga vetë e dëmtuara te llogaria "f." e i.....

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, janë të pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave ka parashtruar kërkesë, nuk përmbajnë shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale për të cilat pretendohet.

2. Gjykata Supreme, vëren se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën e dispozitivit, ka të përshkruara rrethanat e sakta faktike nga të cilat rezultojnë edhe elementet që e përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, më konkretisht në dispozitiv rezultojnë, koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale, mënyra e veprimeve inkriminuese që është vërtetuar se i dënuari i ka ndërmarr për ta kryer veprën penale e për të cilën është gjetur fajtor.

3. Ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës se shkallës së parë, rezulton se aktgjykimi i kundërshtuar, fillimisht bënë përshkrimin e provave që janë administruara dhe po ashtu ka vlerësim të veçantë lidhur me rrethanat faktike dhe elementet e veprës penale që prokuroria e ngarkonte të dënuarin për veprën penale të shantazhit, ndërsa gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka ri kualifikuar veprën penale dhe e ka shpallur fajtor të dënuarin për shtrëngim nga neni 195 paragrafi 2 nënpargrafi 2.4. të KPRK-së.

4. Në këtë rikualifikim Gjykata Supreme vëren se, Gjykata e shkallës së parë, ka zbatuar ligjin që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe se rikualifikimi nuk e rendon pozitën e të dënuarit, duke qenë se për dy veprat penale si për atë të akuzuar ashtu edhe për atë të

ri kualifikuar maksimumi i veçantë si dënim me burgim është paraparë dënimi deri në 5 vite burgim, ndërsa minimumi i veçantë të vepra penale e shantazhit nga neni 341 paragrafi 1 përcaktohet dënimi me burgim prej 6 muajve, ndërsa për veprën penale të shtrëngimit nga neni 195 par.2, nënpar.2.4 si minimum i veçantë parashihet dënimi me burgim prej 3 muaj, ndërsa rrethanat e fakteve rezultojnë se konsumojnë elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari, andaj kjo gjykatë e vlerëson se ri cilësimi i veprës penale është i drejte dhe në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore.

5. Po ashtu në arsyetimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë, në faqe 8 deri në faqe 10, ka dhënë arsye në mënyrë të hollësishme sa i përket fakteve që i ka vërtetuar ashtu edhe se cilat fakte kane qenë jo kontestuese dhe mbi cilat prova janë mbështetur ato fakte e po ashtu edhe se cilat fakte ishin kontestuese dhe mbi cilat prova janë vërtetuar faktet që ishin kontestuese, duke arsyetuar edhe provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor që janë vlerësuar një nga një dhe të gjitha së bashku ku edhe ka ardhur në konkludimet se i dënuari është përgjegjës për veprën penale që është dënuar, konkludim ky që nga arsyet e dhëna në aktgjykim, e përkrah si të drejtë dhe të ligjshëm edhe kjo gjykate. Rrjedhimisht aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk rezulton që të jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke qenë se është i bazuar në prova që vërtetojnë faktet e çështjes, se janë dhënë arsye për faktet vendimtare dhe se nuk është i mbështetur aktgjykimi në prova të papranueshme, andaj për këto shkaqe Gjykata Supreme nuk e gjen të bazuar pretendimin e mbrojtjes se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave nga neni 384 par.1 nënpar.1.19 dhe 1.10 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

6. Gjykata Supreme ka vlerësuar pretendimet e kërkesës së mbrojtjes edhe në raport me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, që pretendohet se i njëjti është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

7. Gjykata Supreme vëren se, aktgjykimi i Gjykatës se Apelit, me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore të mbrojtjes ka dhënë arsye në raport me secilën bazë të ankesës të parshashtuar, por njëkohësisht ka dhënë arsye edhe në raport me shkeljet që Gjykata e Apelit ka për detyrim ti shqyrtoj sipas detyrës zyrtare.

8. Më konkretisht Gjykata e Apelit, ka dhënë arsye për sa i përket pretendimit ankimore për shkelje esenciale në mënyrë të hollësishme kur ka konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës se pare nuk është i përfshirë me shkelje esenciale, po ashtu edhe në raport me pretendimet e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike janë dhënë arsye në mënyrë të hollësishme nga Gjykata e Apelit, si dhe për pretendimet e shkeljes së ligjit penal dhe për vendimin mbi sanksionin penal, andaj vlerësuar duke vlerësuar arsyet e dhëna nga Gjykata e Apelit në aktgjykimin e kundërshtuar, Gjykata Supreme vlerëson se aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënpar.1.10, pasi qe aktgjykimi përmban arsye për faktet vendimtare të ngritura si pretendime në ankesën e mbrojtjes dhe se, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit nuk është cenuar dispozita nga neni 395 e Kodit të Procedurës penale kur mbrojtja e ndërlidh këtë shkelje me ri cilësimin e veprës penale nga gjykata e shkallës së parë.

9. Andaj, për te gjitha këto arsye Gjykata Supreme, nuk i ka gjetur të bazuara pretendimet e mbrojtjes në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

10. Lidhur me pretendimet e mbrojtjes në kërkesë për shkelje të ligjit penal, Gjykata Supreme ka parasysh se mbrojtja pretendimin e shkeljes së ligjit penal e parashtron në raport me të provuarit e fakteve dhe veprën penale, si dhe në raport me ri cilësimin e veprës penale që është bërë nga gjykata e shkallës së parë.

11. Gjykata Supreme rikujton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të parashtrohet për vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes

faktike, mirëpo në rrethana të rastit konkret kjo Gjykatë do ti shqyrtoj pretendimet në drejtim të shkeljes së ligjit penal.

12. Gjykata Supreme ka parasysh, se, i dënuari ngarkohej sipas aktakuzës së Prokurorisë për veprën penale të Shantazhit nga neni 341 par.1, e cila vepër penale, parasheh se: *Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, kanos personin tjetër se do të zbulojë diç në lidhje me të apo personat e afërm të tij që do të dëmtojë nderin apo autoritetin e tyre dhe në këtë mënyrë e detyron personin e tillë të kryej apo të mos kryejë ndonjë veprim në dëm të pasurisë së tij apo të personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet".*

13. Gjykata themelore pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me rastin e vendosjes, ka ri cilësuar veprën penale dhe e ka gjykuar të dënuarin për veprën penale të shtrëngimit nga neni 195 par.2, nënpar.2.4, e cila vepër penale parasheh se, : Neni 195 paragrafi 1 Kushdo që e detyron personin tjetër me forcë apo kanosje serioze që të kryejë ose të mos kryejë një veprim ose të pajtohet me një veprim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit" Paragrafi 2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë prej rrethanave në vijim, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet, nënpargrafi 2.4: kryesi ka kryer veprën ndaj viktimës së ndjeshme.

14. Nga rrethanat e gjendjes së fakteve, rrjedhe se, i dënuari pasi që me të miturën më parë kishte qenë në banesë, i njëjti me datë 16.03.2017, përmes llogaris në rrjetin social, " N._N._....", i ka kërkuar foto n.. duke e kanosur se nëse si dërgon fotot ai do ia publikoj fotot n. që i kanë realizuar në banesë kur ka qenë e dëmtuara, pasi që e dëmtuara i bindet kësaj kërkesë dhe i dërgon foto n., i njëjti sërish me datë 17.03.2017, i kërkon video incizim ku e dëmtuara të shihet e zh... dhe t'ia dërgoj dhe kur ajo refuzon, i njëjti hap një llogari në rrjetet sociale me përmbajtjen, "Q. B. K." dhe ua dërgon shoqeve të të dëmtuarës.

15. Në këto rrethana të fakteve përveç se gjykata e shkallës së parë, me rastin e ri cilësimit të veprës penale, ka zbatuar ligjin penal që ka qenë

në fuqi në kohen e kryerjes së veprës penale, gjegjësisht Kodin Penal Nr.04/L-082, njëkohësisht me rastin e ri cilësimit të veprës penale, nuk ka rënduar pozitën e të dënuarit dhe rrjedhimisht nuk ka cenuar identitetin subjektiv dhe objektiv të akuzës, duke qenë se aktgjykimi për veprimet e të dënuarit i referohet vetëm të dënuarit, ndërsa në kuptim të identitetit objektiv të akuzës me aktgjykimin, nuk ka ndryshim të gjendjes së fakteve në mënyrë thelbësore për sa i përket veprës penale që ngarkohej me akuzë dhe veprës penale që është ri cilësuar dhe shpallur fajtor, dhe se faktet e paraqitura në akuzë dhe faktet e paraqitura në aktgjykim kanë ruajtur substancën e tyre si për sa i përket, vendit, kohës, mënyrës së veprimit, nga të cilat rezulton se janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari dhe jo për veprën penale që ngarkohej sipas akuzës, duke qenë se vepra penale që ngarkohej sipas akuzës, parasheh një ndër elementet e veprës qëllimin e përfitimit të dobisë pasurore për veten apo për tjetrin, ndërsa në veprimet e të dënuarit saktësisht ky element nuk rezulton se ishte konsumuar, përderisa te vepra penale e ri cilësuar nga gjykata parashihet, detyrimi i personit tjetër qoftë përmes forcës apo kanosjes që të kryej një veprim apo të pajtohet me një veprim, dhe se nga rrethanat e fakteve kanosja ishte në drejtim të cenimit të dinjitetit me publikimin e fotove n...., dhe kërkesa ishte për foto dhe video n..., që duhej të kryente e dëmtuara dhe të pajtohej me këtë veprim. Prandaj Gjykata Supreme gjen se me rastin e ricilesimit nuk është zbatuar ligji penal në dëm të të dënuarit, por se është zbatuar drejt ligji penal me rastin e ri cilësimit të veprës penale nga gjykata e shkallës së parë, duke qenë se është vërtetuar se nga veprimet e të dënuarit janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar.

16. Lidhur me pretendimet e mbrojtjes për shkelje të ligjit penal, që i referohet çështjes së të provuarit të gjendjes faktike, Gjykata Supreme vlerëson se nga provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor dhe që janë arsyetuar në aktgjykimet e dy gjykatave, nuk vihet në mëdyshje përgjegjësia penale e të dënuarit, andaj nuk ka zbatim të gabuar të ligjit penal në dëm të të dënuarit kur është shpallur fajtor dhe është dënuar për veprën penale të shtrëngimit. Megjithatë Gjykata Supreme

vlerëson të nevojshme që të jap përgjigje në pretendimin që mbrojtja thekson se nuk është vërtetuar se llogaria e rrjeteve sociale të ketë qenë në përdorim të të dënuarit, dhe atë llogaria N.....name_.... dhe, Q...B.K., dhe si pasoj ligji penal është zbatuar në dëm të të dënuarit.

17. Gjykata Supreme, ka parasysh se nga tërësia e fakteve në këtë çështje penale, mund të nxirret vetëm një konkludim, se këto llogari ishin përdorur nga i dënuari. Fillimisht askush nuk ishte në dijeni se e mitura kishte shkuar në banesën e të dënuarit, askush nuk ishte në dijeni se aty kishin bërë foto n... të të miturës nga ana e të dënuarit.

18. Këto dy fakte janë thelbësore për të ardhur vetëm në një konkludim se llogarit e përdorura në kryerjen e veprës penale ishin përdorur nga i dënuari. Kjo për faktin se kur të miturës i ishte kërkuar dërgimi i fotove n..., ajo ishte kërcënuar se, në rast se nuk i dërgon atëherë fotot e bëra në banesë do ti publikoheshin, dhe po ashtu kur ajo pranon dhe dërgon foto n.., sipas kësaj kërkese kërcënuese, atëherë nga llogaria N....., i kërkohet video incizim të miturës që të jetë e zhveshur, dhe kur ajo refuzon, nga llogaria Q. B. K., shpërndahen fotot tek shoqet e të njëjtës.

19. Nga rrethanat e rastit rezulton vetëm një konkludim se vetëm i dënuari kishte në përdorim këto dy llogari që ishin përdorur në kryerjen e veprës penale, duke qenë se vetëm ai dhe e mitura ishin në dijeni se kishin qenë në banesë dhe duke qenë se vetëm ai dhe e mitura ishin në dijeni se janë bere foto n. ndaj te miturës në banesë, dhe se veprimi kërcënues për ta detyruara të miturën ishte pikërisht kjo rrethanë, ***prezenca në banesë e të miturës dhe fotot e bëra në banesë ndaj të miturës***, andaj logjikshëm përfundimi është se vetëm i dënuari që kishte qenë në banesë me të miturën ka përdorur edhe llogarit në kryerjen e veprës penale për të cilën është dënuar, dhe nuk mund te ketë asnjë mëdyshje se një person tjetër ka përdorur këto llogari, rrjedhimisht është konkudimi i vetëm që përjashton përdorimin e këtyre llogarive sociale nga ndokush tjetër përveç të dënuarit.

20. Për këto arsye Gjykata Supreme vlerëson se, nga provat që janë administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk vihet në mëdyshje

përgjegjësia penale e të dënuarit për veprën penale që është shpallur fajtor dhe se ligji penal nuk është zbatuar në dëm të të dënuarit.

21. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktvendim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.366/2025, datë 15.07.2025

Në këtë rast, Gjykata Supreme e kishte hedhur kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të papranueshme, pasi që ishte parashtruar ndaj aktgjykimit të Gjykatës Supreme që kishte shqyrtuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për veprën e njëjtë penale, dhe se dispozitat e kodit të procedurës penale nuk lejojnë parashtrimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë ndaj aktgjykimit të Gjykatës Supreme me të cilin është vendosur për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës Themelore
   Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.Nr.1400/2023 e datës 13.11.2024, të dënuarin Enis Zakuti e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, duke e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) €. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 20 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimin e kundërshtuar.

3. Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit
   Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.Nr.198/2025 të datës 20.06.2025, me te cilën ka njoftuar Gjykatën Supreme te Kosovës se kërkesa e paraqitur nga i dënuari nuk

është trajtuar fare nga zyra e Kryeprokurorit te Shtetit, me arsyet se është vendosur nga Gjykata Supreme me aktgjykimin PML.Nr. 208/2025 te datës 22.04.2025 ne këtë çështje penale, andaj është theksuar se kërkesa e tille është e palejueshme për prokurorin e shtetit.

4. Pretendimet e paraqitura në kërkesë
   Në kërkesë i dënuari thekson se gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit fillestar nuk është siguruar se i dënuari është njoftuar për pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë dhe i njëjti nuk ka kuptuar sqarimet në lidhje me aktakuzën dhe veprimet e tij. Nga fakti se i dënuari nuk e ka kuptuar veprën penale për të cilën është akuzuar, si dhe pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë duke konsideruar se do të dënohet me dënim me gjobë dhe nuk ka ushtruar fare mjetin juridik, gjegjësisht ankesë kundër këtij aktgjykimi deri sa ka pranuar urdhrin për ekzekutimin e dënimit me burgim.

5. Pretendohet se shkeljet me rastin e pranimit të fajësisë qëndrojnë në faktin se i dënuari gjatë shqyrtimit fillestar kishte pohuar faktin se është fajtor për veprën penale sipas aktakuzës dhe se në ndërkohë nuk ishte duke përdorur substanca narkotike. Mirëpo gjykata e shkallës së parë bën pranimin e fajësisë të dënuarit edhe pse kjo vepër penale kryhet me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes e që kjo nënkupton se i njëjti është vetëm përdorues dhe jo shitës i lëndës narkotike.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 432 par 1 dhe 2 lidhur me nenin 435 par.2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të kërkesës nëse është e pranueshme, gjeti se:

- kërkesa duhet të hudhet si e papranueshme.

2. Gjykata Supreme me rastin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, për të vlerësuar nëse kërkesa është e pranueshme, ka gjetur se, Gjykata Themelore në Prizren Departamenti i përgjithshëm ka shpallur fajtor dhe ka dënuar të dënuarin për veprën penale të

posedimit te paautorizuar të narkotikeve apo substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës.

3. Nga shkresat e lëndës po ashtu rezulton se, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, i dënuari kishte parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, me datë 19.03.2025.

4. Lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga i dënuari, me të cilën ishte kundërshtuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Gjykata Supreme e Kosovës, ka marr aktgjykimin PML.Nr. 208/2025 datë, 22.04.2025, çka do të thotë se lidhur me aktgjykimin e formës së prerë ishte vendosur nga Gjykata Supreme.

5. Në rrethana te këtyre fakteve që kolegji i kësaj gjykate ka konstatuar e që rrjedhin nga shkresat e lëndës, fillimisht Gjykata Supreme ka parasysh se, sipas nenit 432 paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale është paraparë se: " Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, ***as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë".***

6. Në bazë të kësaj dispozite ligjore, kolegji ka konstatuar se lidhur me aktgjykimin e gjykatës themelore është vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë që ishte parashtruar nga i dënuari. Andaj kërkesa e serishme për mbrojtjen e ligjshmërisë pas vendosjes nga Gjykata Supreme e Kosovës, duhet trajtuar si e papranueshme, duke qenë se dispozita e sipër theksuar nuk lejon parashtrimin e serishëm të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

7. Andaj Gjykata Supreme mbështetur në dispozitën nga neni 435 paragrafi 2, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e hedhur si te papranueshme kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nga ana e te dënuarit.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.415/2025, datë 02.09.2025

’’Gjykata Supreme nuk e kishte gjetur të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, që mbrojtja pretendonte se për shkak të cenimit të gjuhës në procedurë (ku ishte përdorur gjuha serbe ne përkthim ndërsa i dënuari ishte i nacionalitetit boshnjak dhe njihte këtë gjuhë), i dënuari është lajthitur me rastin e deklarimit fajtor nga ana e tij para gjykatës. Gjykata Supreme kishte parasysh se pretendimi i mbrojtjes nuk mohonte veprimin fizik që ishte kryer vepra penale por pretendimi kishte të bënte se goditja nuk ishte bërë me grusht por me shuplak. Në këtë rast Gjykata Supreme, ka gjetur se si pasoj e veprimit fizik të goditjes ishte shkaktuar pasoja e lëndimit trupor, mënyra e kryerjes së veprës penale e lëndimit të lehtë trupor nuk e parasheh si formë të veçantë neni 185 paragrafi 1, ndërsa se vepra ishte kryer ndaj viktimës së ndjeshme – fëmijës i dënuari ishte shpallur fajtor për formën e kualifikuar nga paragrafi 3 i nenit 185, për shkak të viktimës së ndjeshme dhe jo për shkak të mënyrës së shkaktimit të lëndimit.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë
   Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm P.Nr.578/2024 të datës 21.06.2024, i dënuari Zahir Saiti, është shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 185 paragrafi 3, nënpar.3.1 lidhur me par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së, ashtu që i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 2700 (dymijeshtatëqind) euro, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak nga data 13.05.2024 e deri më datë 18.06.2024, 36 (tridhjetegjashtë) ditë apo barabartë me 720 (shtatëqind) euro. Pjesa tjetër e dënimit me gjobë në shumën prej 1980 (njëmijenëntëqindetetëdhjetë) euro, është obliguar që ta paguajë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë aktgjykimi. Nëse i dënuari dënimin me gjobë nuk ekzekutohet në afatin ligjor i njëjti do ti zëvendësohet me 99 (nëntëdhjetenëntë) ditë burg duke i llogaritur

për çdo 20 (njëzetë) euro, 1 (një) ditë burg. Është detyruar i dënuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën mjeko-ligjore, shumën prej 20 (njëzetë) euro,, shpenzimet e paushallit gjyqësor shumën prej 30 (tridhjetë) euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I dëmtuari R. Sh., i përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor E. Sh.për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

2. Vendimi i gjykatës së shkallës së dytë
   Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.Nr.1484/2024 e datës 23.04.2025, i ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorit të Themelores në Prizren dhe ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

3. Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Mbrojtësi i të dënuarit Zahir Saiti, avokati Afrim Paçarizi nga Prizreni ka paraqitur kërkesë, për shkak të shkeljes së nenit 384 par.1, nënpar.1.4 të KPP-së, lidhur me nenin 30 pika 3 e Kushtetutës, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë si të bazuar kërkesën dhe e t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

4. Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, ka dhënë përgjigje ne kërkesën për mbrojtjen e ligjshmëri, KMLP.II.Nr.222/2025 të datës 14.07.2025, me të cilën ka propozuar që kërkesa e mbrojtësit të të dënuarit Zahir Saiti, av. Afrim Paçarizi, të refuzohet si e pabazuar.

5. Pretendimet në kërkesë
   Mbrojtësi pretendon se Gjykata Themelore në Prizren, të mbrojturin e tij (i cili është nacionalitetit boshnjak) ia ka siguruar përkthyesin shqip-serbisht, dhe me rastin e leximit të dispozitivit të aktakuzës nga ana e prokurorit dhe përkthimit të drejtpërdrejt nga përkthyes, i mbrojturi i

tij është vë në lajthitje (nga mos përkthimi adekuat) në lidhje me përshkrimin e gjendjes faktike e sidomos në pjesën ku shkruan " ***me dashje e godet me grusht në fytyrë-hundë***" kjo sepse i pandehuri të miturin e ka goditur me shpullë/pëllëmbë, e jo me grusht. Ndërkohë që përkthyesi fjalët grusht të pandehuri ia ka përkthyer si "sh.", që në gjuhën shqipe do të thotë "sh.", ashtu që përkthimi adekuat ka qenë dashur të jetë "p." që nënkupton grushtin.

6. Vlerësimet e Gjykatës Supreme
   Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoj pretendimet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

   - kërkesa është e pabazuar.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme me rastin e shqyrtimit te kërkesës, duke analizuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, ka gjetur se asnjeri nga aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1, nënpargrafi 1.4 i Kodit të Procedurës Penale.

2. Gjykata Supreme vëren, se në seancën e shqyrtimit fillestar pranë Gjykatës Themelore, pasi qe është konstatuar se seanca gjyqësore do të zhvillohet në gjuhën shqipe dhe meqenëse i pandehuri nuk e kupton gjuhen shqipe i është siguruara përkthyeri gjyqësor L. R.. Pas këtij veprimi procedural ku i pandehuri përfaqësohej nga mbrojtësi i tij, është lexuar akuza dhe i pandehuri ishte deklaruar fajtor për veprën penale. Me rastin e deklarimit fajtor, kanë dhënë mendimin, Prokurori i Shtetit që ka propozuar të miratohet fajësia e të dënuarit, përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit që kishte propozuar të miratohet fajësia e të dënuarit, dhe mbrojtësi i të dënuarit që kishte deklaruar se: "Pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin tim, me vullnet të lirë e ka pranuar fajësinë dhe e ftoj gjykatën që të ja pranoj fajësinë të

pandehurit". Tutje nga procesverbali rezulton se gjykata e shkallës së parë, pasi që e ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 242 paragrafi 2, nënpargrafi 1.2 deri në 1.4, ka miratuar pranimin e fajësisë së të dënuarit, në mbështetje të nenit 242 paragrafi 6 i Kodit të Procedurës Penale.

3. Ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës se Apelit, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të mbrojtësit, rrjedhë se ka arsye të bazuara dhe të qëndrueshme për shkaqet që Gjykata e Apelit nuk i ka gjetur të bazuara pretendimet ankimore, duke dhënë arsye konkrete si për shkeljet esenciale nga neni 384 paragrafi 2 nënpargrafi 2.7 e lidhur me nenin 369 paragrafi 8 kur ka konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, po ashtu ka konstatuar se ankesa nuk ishte parashtruar për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke qenë se ishte pranuar fajësia nga i dënuari, njëkohësisht ka dhënë arsye se nuk ka shkelje të ligjit penal dhe arsyet lidhur me sanksionin penal, arsye këto që i përkrah si të drejta dhe të ligjshme edhe Gjykata Supreme.

4. Gjykata Supreme me konkretisht ka parasysh pretendimin thelbësor të kërkesës, që parashtrohet nga mbrojtësi e që ndërlidhet me të drejtën e gjuhës së të pandehurit në procedurë, e cila ndërlidhet edhe me aspektin e gjendjes faktike nga e cila varet edhe zbatimi i drejt i ligjit penal. Gjykata Supreme ka parasysh se ,mbrojtësi thekson se: " i mbrojturi i tij është vë në lajthitje (nga mos përkthimi adekuat) në lidhje me përshkrimin e gjendjes faktike e sidomos në pjesën ku shkruan "***me dashje e godet me grusht në fytyrë-hundë***", kjo sepse i pandehuri të miturin e ka goditur me shpullë/pëllëmbë, e jo me grusht. Ndërkohë që përkthyesi fjalët grusht të pandehuri ia ka përkthyer si "sh.", që në gjuhën shqipe do të thotë "sh.", ashtu që përkthimi adekuat ka qenë dashur të jetë "pesnica" që nënkupton grushtin".

5. Për këto pretendime, Gjykata Supreme ka parasysh se, në seancën e shqyrtimit fillestar kur i dënuari ka pranuar fajësinë për veprën penale me prezencën e përkthyesit në gjuhën që ai e kupton, nuk kishte

vërejtje në asnjë pjesë qoftë lidhur me përkthimin jo korrekt apo jo cilësor, apo edhe lidhur me akuzën, kjo nënkupton se i dënuari ishte deklaruar se ai e kupton akuzën që ishte lexuar nga prokurori në shqyrtimin fillestar. Rrjedhimisht kjo gjykatë, nuk e gjen të bazuar pretendimin e mbrojtësit në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, se i dënuari ishte në lajthim për faktet e akuzës që e ngarkonin. Gjykata vlerëson se baza e vërtetësisë së saktësisë së thënieve duhet të rezultojë nga procesverbali i seancës, dhe palët prandaj kanë të drejtë që të japin vërejtjet e tyre gjithnjë nëse vlerësojnë se ka pasaktësi të cilat vërejtje duhet të konstatohen në procesverbal, për çka në rastin konkret nuk rrjedhë ndonjë vërejtje qoftë për pasaktësitë në procesverbalin e shqyrtimit fillestar, për mos kuptimin e fakteve që kishte akuza apo për jo korrektësinë e gjuhës nga përkthyesi lidhur me terminologjinë në gjuhën që përkthehej.

6. Megjithatë Gjykata Supreme, vlerëson se edhe nën supozimin se ekziston një përkthim jo adekuat i termeve nga ana e përkthyesit në gjuhën që i pandehuri e kupton, siç pretendohej se ishte, ***"sh.", dhe jo "g.",*** në kontekstin ligjor të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor kjo nuk e ndikon ligjshmërinë e aktgjykimit dhe nuk cenon të drejtën e tij në procedurën penale për gjuhen dhe të drejtën e tij në përkthim.

7. Gjykata Supreme ka parasysh se i dënuari ishte shpallur fajtor për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3, nënpargrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1, nënpargrafi 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

8. Duhet te kemi parasysh se inkriminimi i veprës penale te, lëndimit te lehtë trupor, nga neni 185 paragrafi 1, ka parapare se: "***1. Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në:"*** , ndërsa nënpargrafi 1.4 ka parapare se: ***" 1.4. dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet"***.

9. Ndërsa paragrafi 3 i nenit 185 ka parapare se: ***" Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, ose është e motivuar sipas kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura kryesi dënohet me"***, ndërsa nënpargrafi 3.1 ka parapare se: ***"burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni".***

10. Nisur nga vepra penale për te cilën i dënuari është shpallur fajtor, rrjedhë se, nuk është përcaktuar mënyra e formës së veprimit (se lëndimi a është shkaktuar me shuplak apo me grusht) si forme e kualifikuar që ishte shpallur fajtor i dënuari, por i dënuari ishte shpallur fajtor për shkak të elementit kualifikues, "Viktimës së ndjeshme – të miturin që e kishte goditur" që parashihet në paragrafin 3 të nenit 185. Në anenë tjetër i dënuari nuk ka mohuar veprimin që e ka shkaktuar dhe madje edhe në kërkesë nuk mohohet veprimi i ndërmarr nga i dënuari, por pretendohet se veprimi i ndërmarr ishte shuplaka dhe jo grushti siç është konstatuar në aktgjykim.

11. Gjykata Supreme po ashtu ka parasysh se pasoja nuk vihej në mëdyshje që kishte ardhur si pasoj e veprimit të ndërmarr nga i dënuari, duke qenë se edhe vet i dënuari e ka pohuar se ai e ka goditur të miturin, rrjedhimisht si pasoj e veprimit të ndërmarr ka rezultuar lidhja kauzale me pasojën të i mituri, ku është konstatuar së është dëmtim i përkohshëm i shëndetit, e që këtë kategori të pasojës e ka paraparë nënpargrafi 1.4, në paragrafin 1 të nenit 185.

12. Prandaj në kontekst të llojit të veprimit se a është grusht apo shuplak përderisa është vërtetuar se ka ekzistuar veprimi inkriminues dhe është vërtetuar lidhja kauzale se pasoja ka ardhur nga ai veprim, nuk cenohet ligjshmëria e aktgjykimit duke u thirrur në pretendimin e parashtruar nga mbrojtësi, së i dënuari ka qenë i lajthitur sepse e ka goditur me shuplak dhe jo me grusht, sepse cilado formë e goditjes e ka formën e njëjti të kualifikimit të cilësuar vetëm nga fakti se ishte viktima e

ndjeshme dhe jo nga forma e veprimit goditës se a është shuplak apo grusht.

13. Në anenë tjetër, Gjykata Supreme ka parasysh se për këtë vepër penale i dënuari ka pranuar fajësinë, dhe në këtë kuptim me rrethana të rastit konkret kjo gjykate ka parasysh dispozitën nga neni 242 paragrafi 3, që parasheh se: *Gjatë këtij diskutimi ndërmjet gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues me të pandehurin në lidhje me bazën faktike për pranimin e fajësisë,* ***mospranimi i çdo pretendimi në aktakuzë lidhur me mënyrën se si është kryer vepra penale nuk do të jetë arsye për të refuzuar pranimin e fajësisë, nëse pranimi nga i pandehuri e vërteton çdo element të veprës penale".***

14. Andaj, bazuar edhe sipas kësaj dispozite ligjore edhe nën supozimin që i pandehuri nuk e ka pranuar veprimin që ishte ngarkuar se e ka goditur të miturin me grusht, por ka pranuar se ka goditur me shuplak, nga e cila goditje ka ardhur pasoja që është vërtetuar, dhe përderisa forma e veprimit inkriminues në kryerjen e veprës penale ka shkaktuar pasojën, rezultojnë elementet e veprës penale që është shpallur fajtor, dhe kjo nuk e bënë aktgjykimin që të jete marr me shkelje të dispozitave të procedurës penale që pretendohet në lajthim lidhur me përkthimin, përkundër se siç u theksua nga procesverbali nuk rrjedhe asnjë vërejtje që është dhënë qoftë me të kuptuarit e akuzës apo me çështjet e përkthimit por rezulton se procesverbali është nënshkruar nga të gjitha palët dhe nënshkrimi ishte bërë pa vërejtje.

15. Andaj, për këto arsye Gjykata Supreme nuk gjen të bazuara pretendimet e kërkesës se aktgjykimet janë marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1, nënpargrafi 1.4, i Kodit të Procedurës Penale, dhe e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën.

16. Nga arsyet e cekura më lart dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.88/202, datë 17.03.2025

’’Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të miturit janë të bazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet në kërkesë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas dispozitës së nenit 384 par.2, nënpar.2..1 të KPP-së lidhur me neni 348 par.3 të KPP me rastin e ndryshimit të propozimit për masë.’’

I. Rrethanat e rastit

1. Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PM.Nr.51/2024 e datës 11.10.2024, të miturin NN e ka shpallur përgjegjës për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.4 lidhur me par.6 e 1 të KPRK-së, duke i shqiptuar Masën Edukative Institucionale - Dërgimi në Institucionin Edukativo Korrektues në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore te KGJK-së. Të dëmtuarit NN, NN dhe NN, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

2. Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PAM.Nr.127/2024 e datës 11.12.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të miturit, ndërsa ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur:
   - mbrojtësi i të miturit NN, avokat NN, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, dispozitave të KDM, shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të dënuarin ta liroj

nga akuza ose të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit
   Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.Nr. 45/2025 e datës 21. 02.20252, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohen si të pabazuara.

5. Pretendimet e paraqitura në kërkesë
   Në kërkesë mbrojtësi i të miturit NN, thekson se aktvendimi është marrë në shkelje të dispozitave të procedurës penale, për faktin se ndryshimi i propozimit për shqiptimin e masës nga prokurori është bërë në fjalën përfundimtare të palëve, pasi që i mituri ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale të cilën gjykata e ka vlerësuar dhe pranuar, si dhe njëkohësisht përkundër këtij ndryshimi gjykata nuk i ka dhënë mundësinë që të deklarohen se a kanë nevojë për ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor që të përgatiten për mbrojtjen, duke vlerësuar se aktvendimi është marr në shkelje të dispozitës nga neni 384 par.2 nënpar.2.1 të KPP-së si dhe ndryshimi konsideron se është bërë në kundërshtim me nenin 348 të KPP-së.

6. Gjithashtu sqaron se të dy gjykatat në aktvendimet e tyre, nuk kanë dhënë arsye të mjaftueshme se me shqiptimin e masave tjera edukative, duke përfshirë edhe masën e propozuar me propozim, a mundë të arrihet qëllimi i masës edukative, në kuptim të nenit 22 të KDM-së.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

   - kërkesa është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të miturit janë të bazuara, ngase aktgjykimet kundër të

cilave është parashtruar kërkesa, përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet në kërkesë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas dispozitës së nenit 384 par.2, nënpar.2..1 të KPP-së lidhur me neni 348 par.3 të KPP me rastin e ndryshimit të propozimit për masë.

3. Nga faktet e çështjes rezulton se në shqyrtimin gjyqësor pas leximit të propozimit për shqiptimin e masës edukuese mbikëqyrja e shtuar e prindërve, i mituri ka pranuar fajësinë për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 4 lidhur me paragrafët 6 e 1 të KPRK-së. Gjykata në bazë të nenit 322 par. 1 të KPP-së aprovon pranimin e fajësisë duke konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore lidhur me pranimin e fajësisë, pasi propozimi i prokurorisë nuk përmban shkelje ligjore as faktike dhe është bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës. Në fjalën përfundimtare prokurori bënë ndryshimin e propozimit për masë, ashtu nga masa e mbikëqyrjes së shtuar e prindit, propozon të shqiptohet masa institucionale dërgimi në entin edukativo korrektues.

4. Kolegji vëren se ndryshimi konsiston që është bërë pas pranimit të fajësisë dhe pasi gjykata ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore, një ndryshim i tillë është i papranueshëm dhe nuk justifikohet nga këndvështrimi ligjor. Propozimi për masë, paraqet aktin akuzues sipas KDM-së, bazuar në specifikat e procedurës së të mitur, i cili përveç përshkrimit të veprës penale për të cilën ngarkohet i mituri përmban edhe propozimin për shqiptimin e masës së caktuar, për rrjedhojë ky propozim është i integruar në kuadër të vet aktit. Pranimi i fajësisë bëhet si nga aspekti faktik dhe legal, përfshirë edhe çështjen e masës së caktuar, pasi që i mituri dhe mbrojtja janë njoftuar dhe e kanë të qartë pranimin i cili bart edhe konsekuencat e parashikueshme që derivojnë nga ky akt.

5. Sipas këndvështrimit të kolegjit, nëse do të interpretohet që prokurori të bëjë këso ndryshime në fjalë përfundimtare kur kemi të bëjmë me çështjet e pranimit të fajësisë, do të nënkuptonte që mbrojtja të befasohet dhe të bie në pozicion të disfavorshëm pa arsye, njëkohësisht

do të ndikonte do të vënte në pyetje rregullsinë e procesit të drejtë gjyqësor.

6. Ndryshimi i aktit akuzues e ka kuptimin në rastet e shqyrtimit të akuzave kur nuk janë në pyetje situatat e pranimit të fajësisë, por si rezultat i zbatimit të provave mund të ndryshoj gjendja e fakteve cila sipas vlerësimit të prokurorit duhet të ndryshoj nga ajo që është paraqitur fillimisht si nga aspekti faktik ashtu edhe ligjor, prandaj një praktik e ndryshimeve pas pranimit të fajësisë është e jo e rregullt, jo ligjore, minon institutin e pranimit të fajësisë, krijon pasiguri juridike dhe paparishikueshmëri për pasojat të cilat do ti bartin palët me rastin e pranimit të fajësisë.

7. Nga arsyet e sipërcekura, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2, nënpar.2.1, lidhur me nen 348 par.3 të KPP-së, të cilat shkelje nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, dhe kanë ndikuar në rregullsinë dhe ligjshmërinë vendimit.

8. Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim, ti eliminoj shkeljet e konstatuara, pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

9. Nga arsyet e shpjeguara më lartë e në kuptim të nenit 438 par.1, nënpar.1.2 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.100/2025, datë 18.03.2025

''Sipas aktgjykimit e gjykatës së shkallës së parë ishte konstatuar fakti se në rastin konkret ishin plotësuar kriteret për pranimin e fajësisë të përcaktuara me dispozitën e nenit 242 par.2 të KPP-së, mirëpo me këtë rast sipas pikëpamjes të Gjykatës Supreme të Kosovës, me rastin e pranimit të fajësisë nuk ishin plotësuar kriteret e kërkuara ligjore.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, Nr.2024:113296 të datës 08.07.2024, të akuzuarit Arlind Murtezi dhe Blendrit Fazliu, janë shpallur fajtorë për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.2 nën par.2.1 lidhur me par.1 dhe nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, për të cilën secilit veç e veç i'u është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilat dënime i'u është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 19.03.2024 deri me datë 11.06.2024, gjithashtu i akuzuari Bleart Krasniqi është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.2 nën par 2.1 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 19.03.2024 deri me date 11.06.2024.

2. Të akuzuarit janë obliguar qe secili veç e veç të paguajnë shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej nga 20 (njëzet) euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave secili veç e veç shumen prej nga 30 (tridhjetë) euro, e te gjitha këto ne afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

3. I dëmtuarit L. T. për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar ne kontest civil.

4. Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.Nr.1332/2024 e datës 26.11.202 ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve së të akuzuarve Arlind Murtezi, Bleart Krasniqi dhe Blendrit Fazliu si dhe ankesa e vet te akuzuarit Bleart Krasniqi, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkalles së parë e ka vërtetuar.

5. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër këtij aktgjykimi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Nezir Bytyçi nga F., për shkak te shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kane ndikuar ne ligjshmërinë e vendimit gjyqësor sipas nenit 432 par.1.3 te KPP-së ashtu që të ndryshohet aktgjykimi dhe ti shqiptohet një dënim më i butë, ose që ky aktgjykim të prishet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim të sërishëm.

6. Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit
   Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.Nr.55/2025 e datës 27.02.2025 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e bazuar dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

7. Pretendimet e paraqitura në kërkesë
   Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe si pasojë e kësaj shkelje duhet anuluar aktgjykimi i kundërshtuara.

8. Në këtë çështje penale, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me arsyetimin, sepse duhet të përmbajë edhe përshkrimin e fakteve relevante dhe vendimtare, veprimet konkrete të akuzuarit i cili në asnjë mënyrë nuk ka përdorur forcën në kryerjen e veprës penale, vlera e sendeve të përvetësuara nuk e kalon e shumën prej 5.000,oo € siç theksohet në aktgjykimin e shkallës se parë, në veprimet e tij mund të ketë elemente të veprës penale vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

9. Sipas mbrojtjes i akuzuari ka pranuar fajësinë, ka shprehur pendim te thellë, me premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, ka kërkuar falje publike, këto janë rrethana te reja që duhet të merren parasysh me rastin e vendosjes sipas kësaj kërkese dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim me i butë, si dënim me kusht me të cilin do të arrihet qëllimi ndëshkimor. Pranimi i fajësisë nuk është marre parasysh sa duhet si rrethane posaçërisht lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit nën kufijtë e zbutjes sipas nenit 72 te KPRK-së, është hera e parë që përgjigjet para gjykatës.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

   - kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

2. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se janë të bazuara pretendimet e paraqitura se gjatë procedurës penale është shkelur dispozita e procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.1 të KPP-së, pasi që gabimisht është zbatuar dispozita e nenit 242 par.2, nënpar.2.3 të KPP -së.
3. Bazuar në procesverbalin e shqyrtimit fillestar rezulton se i dënuari kishte bërë pranimin e fajësisë për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.2 nën par.2.1 lidhur me par.1dhe nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, gjykata më pas konstatoi se janë plotësuar kriteret e pranimit të fajësisë sipas nenit 242 të KPP-së, andaj ishte vazhduar me shqiptimin e dënimit. Sipas aktgjykimit e gjykatës së shkallës së parë ishte konstatuar fakti se në rastin konkret ishin plotësuar kriteret për pranimin e fajësisë të përcaktuara me dispozitën e nenit 242 par.2 të KPP-së, mirëpo me këtë rast sipas pikëpamjes të Gjykatës Supreme të Kosovës, me rastin e pranimit të fajësisë nuk ishin plotësuar kriteret e kërkuara ligjore. Dispozita e nenit 242 par.2 të KPP-së ka përcaktuar se:

4. "Kur i akuzuari pranon fajësinë për secilën ose disa pika të aktakuzës sipas nenit 241 të këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton nëse:

   2.1. i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;

   2.2. pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me avokatin mbrojtës, nëse i akuzuari ka mbrojtës dhe pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, përveç premtimeve të cekura në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë sipas nenit 230 të këtij kodi;

   2.3. pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i akuzuari dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i akuzuari dhe

   2.4. aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime

   faktike.".

5. Nga leximi i dispozitës ligjore nënkuptohet se për tu bërë pranimi i fajësisë të gjitha kriteret duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, në të kundërtën pranimi i fajësisë nuk do të ishte në pajtueshmëri me dispozitën ligjore.

6. Nga përmbajtja e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, rrjedh se i dënuari është shpall fajtor për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.2, nënpar.2.1 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, se me datat 31. 01. 2024, 04.02.2023 dhe 10.02.2024, gjatë orëve të natës në Ferizaj, saktësisht në objektin banesor "M.", të pandehurit duke vepruar ne bashkëkryerje, në vazhdimësi me qëllim të përvetësimit të pasurisë ne mënyrë të kundërligjshme për vete, i'a marrin pasurinë e personit tjetër të dëmtuarit L. T., në atë mënyrë qe fillimisht me date 31.01.2024 gjatë orëve te natës shkojnë tek vendi i lartpërmendur, hyjnë brenda objektit banesor dhe nga aty arrijnë të marrin një sasi të konsiderueshme të

kabllove elektrike duke i shkëputur nga muri i tavanit, ku ishin të vendosura dhe këtë veprime e përsëritin edhe me date 04 . 02 .2024 dhe 10.02. 2024, ku me datë 04.02.2024 merr pjesë edhe i pandehuri Bleart Krasniqi, duke shkëputur kabllot elektrike nga muri dhe me pas të njëjtat kabllo i bartin me një automjet dhe i dërgojnë ne fshatin G. dhe C. komuna e Sh., të cilat i djegin dhe i dërgojnë për ti shitur ne hekurishte tek i pandehuri Nazif Salihi, me ç'rast të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material prej 5000, oo €.

7. Sipas këndvështrimit të Kolegjit, pranimi i fajësisë duhet të mbështet në faktet dhe provat e çështjes, në rastin konkret një prej çështjeve relevante është vlera e kabllove elektrike të vjedhura, e cila përshkruhet të jetë mbi 5000 €, që njëkohësisht paraqet tipar kualifikues i veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.2 nën par.2.1 lidhur me par.1 të KPRK-së. Kjo vlerë duhet të derivoj saktë nga ndonjëra prej provave të potencuara, të cilat gjykata i vlerëson si të mjaftueshme për të konstatuar një fakt të tillë që ka të bëjë me këtë tipar kualifikues.

8. Kolegji vëren se nga faktet e çështjes rezulton se dy dëshmitë të listuara në aktgjykim dhe të konstatuara në procesverbalin e shqyrtimit fillestar, flasin për dëmin e shkaktuar, siç janë deklarata e të dëmtuarit L. T. dhe përfaqësuesi i tij F. T., .

9. I dëmtuari F. T., në dëshminë e dhënë me datë 10.02.2024, ka theksuar se vlera e kabllove elektrike është diku rreth 2000€, duke shpjeguar se me 04.02.2024 kanë vjedhur kabllo në vlerë prej 4000 €, ndërsa me datë 10.02.2024 kanë vjedhur kabllo në vlerë prej 1200 €, ndërsa në pyetjen e konstatuar në faqen e tretë të procesverbalit të marrjes në pyetje të dëmtuarit, "sa është vlera e dëmit të vjedhjes", deklaron: "se është rreth 2000 €". Siç vërehet, kjo nuk përputhet me shpjegimet e dhëna mbi shumën e dëmit që është bërë, nëse bëhet fjalë për gabim teknik kjo çështje ka qenë e nevojshme të adresohet dhe të qartësohet.

10. Ndërsa përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, F. T. ka shpjeguar dëmin e shkaktuar nga kryerja e kësaj vepre penale. Në dëshminë e

dhënë me datë 04.04.2024 në Prokurorinë e Shteti, i njëjti në pyetjen e prokurorit: " a keni bërë ndonjë kalkulim për të ditur saktë se sa është vlera e dëmit në këtë rast?, I dëmtuari përgjigjet: " Sa i përket kësaj, ne kemi angazhuar një elektricist, i cili ka bërë riparimet e të gjitha dëmeve e po ashtu edhe kabllot janë blerë dhe zëvendësuar, për këtë gjatë ditëve në vijim do të dorëzoj dëshminë me shkrim". Në shkresat e lëndës nuk gjendet ndonjë dëshmi të jetë dorëzuar lidhur me këtë.

11. Rrjedhimisht, konstatimi sipas aktgjykimi të atakuar se pranimi i fajësisë bazohet në faktet dhe provat e kësaj lënde penale, nuk është i qëndrueshëm, pasi që pranimi i fajësisë për një vepër penale, duhet të jetë harmonik dhe kompatibil në tërësi si në raport me kualifikimin ligjor, faktet vendimtare dhe provat konkrete mbi të cilat bazohet ekzistimi i këtyre fakteve, në mënyrë qartë, të saktë dhe jo dubioze. Prandaj në rastin konkret mungon dëshmia e qartë, për vlerën e sendeve të vjedhura, nga i cili fakt varet edhe cilësimi juridik i veprës penale.

12. Nga arsyet e sipërcekura, Kolegji arrin në përfundim se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.1 të KPP-së, pasi që gabimisht është zbatuar dispozita e nenit 242 par.2. nënpar.2.3 të KPP-së, dhe me këtë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjykimit të kundërshtuar dhe shqyrtim të sërishëm të kësaj çështje penale.

13. Duke pasur parasysh faktin se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur vetëm në dobi të dënuarit Arlind Murtezi, Gjykata Supreme e Kosovës, konform dispozitës së nenit 436 par.2 të KPP-së, ka aplikuar institutin *beneficium cohaesionis,* meqë shkaqet për të cilat ka marrë vendim në dobi të dënuarit Arlind Murtezi, nuk janë të natyrës personale dhe shkojnë në dobi edhe për të dënuarit tjerë Blendrit Fazliu dhe Bleart Krasniqi, të cilët nuk kanë paraqitur kërkesë.

14. Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet që të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim, pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

15. Nga këto arsye, kjo gjykatë konform nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.163/2025, datë 16.06.2025

’’Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të dënuarit, se në rastin konkret kemi të bëjmë me dekriminalizim të veprës penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet nga neni 198 par.5 nënpar.6 lidhur me par.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), si dhe nëse gjendet fajtor i dënuari ka qenë dashtë që të aplikohet si ligj më i favorshëm vepra penale sulmi seksual nga neni 195 par.4 e sanksionuar sipas Kodit Penal të Përkohshëm.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për të Mitur, me aktgjykimin PM.Nr.89/2022 e datës 27.02.2023, të dënuarin NN e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale keqpërdorimi i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet nga neni 198 par. 5 nën par. 6 lidhur me par. 2 të KPK, duke e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Koha e kaluar në arrest shtëpiak, prej datës 21.01.2012 e deri me datën 17.04.2019, do t’i llogaritet në dënimin e shqiptuar. Është obliguar i dënuari që t’i paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 1000 (njëmijë) €, ndërsa në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. E dëmtuara NN, përfaqësuesi i saj ligjor si dhe përfaqësuesi i autorizuar i saj nuk kanë paraqitur kërkesë pasurore juridike.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për të Mitur, PAKR.Nr.246/2023, datë 18.07.2024, me aprovimin e pjesshëm të ankesës së mbrojtësit të dënuarit, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për të Mitur, PM.Nr.89/2023 i datës 27.02.2023, është ndryshuar sa i përket cilësimit juridik të veprës

penale ashtu që kjo Gjykatë veprimet e të dënuarit të përshkruara si në dispozitivin e aktgjykimit i cilëson si vepër penale sulmi seksual, parashikuar me nenin 229 par. 3 nën-par. 3.7 dhe 3.10 të KPRK. Aktgjykimi i cekur ndryshohet edhe sa i përket vendimit për dënimin, dhe kjo gjykatë të dënuarin për veprën penale të lartcekur e gjykon me 1 (një) vit burgim konform nenit 48 të KPRK, dënimi i shqiptuar nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën kohore prej 2 (dy) viteve. Në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 21.01.2012 e deri me 17.14.2019. Ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, e përfaqësuesit të dëmtuarës dhe ankesa e mbrojtësit të dënuarit NN për bazat tjera ankimore janë refuzuar si të pabazuara.

3. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit NN, av. NN, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën si të bazuar ashtu që të ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarin ta lirojë nga përgjegjësia penale për veprën penale për të cilën akuzohet, ose t'i anulojë aktgjykimet dhe çështjen penale t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.Nr.90/2025 e datës 01.03.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

5. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

   - kërkesa është e pabazuar.

6. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit pretendon se Gjykata e Apelit gabimisht e ka aplikuar ligjin penal me rastin e aprovimit të pjesshëm të ankesës, me të cilin e ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale

dhe atë nga vepra penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet nga neni 198 par.5 nënpar.6 lidhur me par.2 të KPPK në veprën penale sulmi seksual, parashikuar me nenin 229 par.3 nënpar.3.7 dhe 3.10 të KPRK.

7. Mbrojtësi i të dënuarit thekson se teoria e së drejtës penale parasheh rastet kur aplikohet ligji më i favorshëm, dhe askund nuk është gjetur mundësia ligjore, që në emër të ligjit më të favorshëm, vepra penale e cila nuk parashihet më si vepër penale, të zëvendësohet me një vepër tjetër penale, duke e cilësuar atë në aplikimin e ligjit më të favorshëm. Sikurse kolegji të kishte aplikuar drejtë institutin juridik të ligjit më të favorshëm, të dënuarin është dashtë ta liroj nga përgjegjësia penale, për faktin se vepra konkrete keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare (në kohën e kryerjes së veprës penale), në kohën e gjykimit të dënuarit, me kodin aktual nuk parashihet si vepër penale.

8. Mbrojtja ndan mendimin se vepra penale sulmi seksual i paraparë me kodin penal në fuqi deri me datën 21.01.2012, është me e favorshme për të dënuarin, kuptohet nëse kishte për ta kryer këtë vepër penale, se sa vepra penale e sulmit seksual e paraparë me kodin penal në fuqi. Vendim i drejtë i kolegjit të apelit kishte me qenë nëse i dënuari do të lirohej nga përgjegjësia penale, për shkakun se vepra penale për të cilën është akuzuar dhe dënuar nuk parashihet si vepër penale me kodin penal në kohën e shpalljes së dënimit. Sipas mbrojtjes gjykata e apelit e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë me qëllim të evitimit të shkeljeve nga ana e shkallës së parë, por në vend që ta liron të dënuarin nga përgjegjësia penale, gabimisht e aplikon institutin e ligjit më të favorshëm. Gjithashtu, gjykata e shkallës së dytë pa bazë ligjore ka refuzuar si të pabazuar pretendimet në lidhje me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, që kanë të bëjnë me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të dënuarit si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të dënuarit dhe veprës së tij.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të dënuarit, se në rastin konkret kemi të bëjmë me dekriminalizim të veprës penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet nga neni 198 par.5 nënpar.6 lidhur me par.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), si dhe nëse gjendet fajtor i dënuari ka qenë dashtë që të aplikohet si ligj më i favorshëm vepra penale sulmi seksual nga neni 195 par.4 e sanksionuar sipas Kodit Penal të Përkohshëm.

2. Gjykata Supreme vëren se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i cili si vepër të posaçme ka sanksionuar veprën penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet nga neni 198 par.5 nënpar.6 lidhur me par.2 të KPPK:

   (1) Kushdo që e detyron personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet për të kryer akt seksual dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

   (2) Kushdo që për qëllime seksuale e prek personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet ose e cyt personin nën gjashtëmbëdhjetë vjet që të prekë kryerësin ose personin e tretë për qëllime seksuale dënohet me burgim deri në pesë vjet".

   (5) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet në një ose në më shumë rrethana të mëposhtme, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në njëzet vjet.... kur:
   1) Veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose është përcjellur me tortura ose trajtim çnjerëzor;
   2) Kryerësi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë të shëndetit mendor dhe fizik të personit;
   6) Kryerës është arsimtar, punëtor shëndetësor ose person të cilit i është besuar rritja, edukimi ose kujdesi i personit të tillë.

3. Ndërsa, vepra penale sulmi seksual e paraparë në nenin 229 par. 1 të KPRK, përcakton se:

" Kushdo që prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin e tillë të prekë kryesin apo personin tjetër për qëllim seksual, pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet" kurse si formë e kualifikuar par. 3 kur vepra penale nga par. 1 ose par 2 kryhet një apo më shumë rrethana, kryesi dënohet prej tre deri në dhjetë vite, kur:

3.1. veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura apo trajtimi çnjerëzor;

3.2. kryesi e përdor forcën;

3.3. kryesi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik të personit ose viktima tenton të bëjë vetëvrasje pas veprës penale;

3.10. kryesi është mësimdhënës, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit.

5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, kryesi dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet.

7. Nëse vepra penale nga paragrafi 5 ose 6 i këtij neni kryhet nën një ose më shumë nga rrethanat e parapara në paragrafin 2 ose 3 të këtij neni, kryesi dënohet me burgim prej së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet

4. Kolegji vëren se vepra penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet nga neni 198 par. 5 nën par. 6 lidhur me par. 2 të KPPK, nuk është e përcaktuar si vepër e veçantë penale sipas KPRK-së (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 Janar 2019, Prishtinë), mirëpo, kjo nuk nënkupton se është dekriminalizuar, për faktin se përmbajtja e njëjtë inkriminuese është në kuadër të veprës penale sulmi seksual nga neni nenin 229 par.1 të KPRK, dhe se format cilësuese të këtij neni të sanksionuara në par.3.10 si profesionist i kujdesit shëndetësor dhe paragrafit 7, i cili i referohet veprës së kryer ndaj personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet sipas paragrafit 5 të këtij neni:

"Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, dhe për të cilën parasheh dënim burgimi në kohëzgjatje prej së paku pesëmbëdhjetë vjet burgim".

5. Mbi këtë bazë, rrjedh konkludimi se veprimet e tilla janë sanksionuar edhe sipas kodit penal të mëvonshëm, andaj nuk mund të interpretohet se nuk ka qenë vullneti i ligjvënësve që të mos jenë edhe më tutje të ndëshkuara në kuptimin penal.

6. Për sa i përket pretendimit se vepra penale sulmi seksual ka qenë e sanksionuar edhe sipas KPPK (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, në fuqi prej 06.04.2004) në nenin 195, kurse si formë kualifikuese është përcaktuar në paragrafin 4, nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, kryerësi dënohet me burgim prej pesë deri në dhjetë vjet, dhe se mund të jetë ligj më i favorshëm nëse i dënuari gjendet fajtor.

7. Sipas këndvështrimit të Kolegjit, në kohën e kryerjes së veprës penale, keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet nga neni 198 të KPK-së ka qenë vepër penale specifike, në raport me veprën penale sulmi seksual nga neni 195 të KPK-së, pasi që është paraparë dhe dedikuar në mënyrë të posaçme për të mbrojtur integritetin seksual të fëmijëve si inkriminim dhe sanksionim primar, dhe në këtë situatë vepra penale specifike mbizotëron në relacion me veprën penale të natyrës së përgjithshme në aspektin e zbatueshmërisë, andaj se cila vepër penale do aplikohet, duhet të bëhet nga ky kriter dhe jo nga shkalla e ndëshkueshmërisë.

8. Gjykata Supreme në raport me aplikimin e ligjit më të favorshëm ndan pikëpamjen se Gjykata e Apelit gabimisht ka zbatuar ligjin penal, me rastin e ri cilësimit të veprës penale keqpërdorimi i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet nga neni 198 par. 5 nën par. 6 lidhur me par. 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), në veprën penale sulmi seksual, parashikuar me nenin 229 par. 3 nën-par. 3.7 dhe 3.10 të KPRK.

9. Ngase dispozita nenit 229 par. 6 të KPRK-së parasheh nëse vepra penale është kryer ndaj personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet kryerës dënohet prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet, ndërsa paragrafi 7 i këtij neni, përcakton formën më të rëndë kualifikuese, nëse vepra penale nga paragrafi 5 dhe 6 kryhet në rrethanat parapara në nenin 2 dhe 3 të këtij neni kryesi dënohet me burgim së paku prej pesëmbëdhjetë vjet, meqenëse nuk është paraparë kufiri i epërm i dënimit, atëherë dënimi maksimal i dënimit konsiderohet të jetë maksimumi i përgjithshëm që është dënimi me burgim prej njëzet e pesë vjet, për dallim prej veprës penale keqpërdorimi i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet nga neni 198 par. 5 nën par. 6 lidhur me par. 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), që është e dënueshme prej tre deri në njëzet vjet.

10. Rrjedhimisht, rezulton se është shkelur ligji penal në favor të dënuarit, duke i cilësuar veprimet e të dënuarit në veprën penale sulmi seksual parashikuar me nenin 229 par. 3 nën-par. 3.7 dhe 3.10 të KPRK e dënueshme prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet, i cili kualifikim nuk përkon me veprimet e konstatuara të dënuarit që subsumohen në kuadër të paragrafit 7 të nenit 229 të KPRK-së, që sanksionon kur kjo vepër penale kryhet ndaj personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet në rrethana cilësuese, por që është e ndëshkuar me dënim minimal prej pesëmbëdhjetë vjet, që krahasuar me veprën penale keqpërdorimi i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet nga neni 198 par. 5 nën par. 6 lidhur me par. 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) është më e rëndë.

11. Gjykata Supreme lidhur me pretendimet e tjera në kërkesë që i referohen shkeljeve nga neni 384 par. 2.pika 7 lidhur me nenin 369 par. 6 dhe 7 të KPP-së, gjeti se nuk qëndrojnë, me që aktgjykimet e ankimuara nga ky aspekt përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe nuk janë përfshirë në shkeljet e potencuara.

12. Gjykata e Apelit i është përgjigjur pretendimeve thelbësore në ankesën e parashtruar nga i dënuari, si dhe aktgjykimi i gjykatës së

shkallës së parë përmban shpjegimet e duhura për veprën penale për të cilën është shpall fajtor dhe dënuar, dhe se nga veprimet e përshkruara në dispozitiv (vendi, koha, mënyra e kryerjes së veprës penale, etj.) formësohen të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të veprës penale, pasi që rreth orës 14:00, në ordinancën private "Joni Dent", në Ulpianë gjegjësisht në afërsi të shkollës fillore "Hasan Prishtina", derisa e dëmtuara – e mitura NN nën moshën 16 vjeçare e lindur me dt. XX, kishte shkuar për tretman mjekësor për shkak të dhimbjes së dhëmbit, gjatë kohës derisa të dëmtuarës – të miturës, i pandehuri NN në cilësinë e mjekut – stomatolog, ia kishte dhënë anestezionin, i njëjti kishte filluar me pyetje jo të zakonshme siç janë: "Çka është me rëndësi për jetën e sajë dhe çka do të thotë fjala intuitë" dhe njëkohësisht ai për qëllime seksuale kishte filluar ta ledhatonte të dëmtuarën në pjesën e qafës, e kishte puthur të njëjtën kur e dëmtuara e mitur ka filluar të largohet nga i pandehuri, i njëjti i kishte thënë "se është i besueshëm dhe për çdo problem do t'i ndihmoj edhe për anën financiare", pastaj i njëjti është ngritur në këmbë duke e ulur të dëmtuarën në prehrin e tij, me ç'rast e dëmtuara- e mitura pasi që ka kërkuar të dij se a ka përfunduar intervenimin e dhëmbit, largohet nga i pandehuri dhe në dalje nga ordinanca përsëri i njëjti pa pëlqimin e sajë ka filluar ta përqafonte duke e shtrënguar për kraharori, me ç'rast tek e dëmtuara e mitur ka shkaktuar shqetësim.

13. Mbi bazën e kësaj, është i pabazuar pretendimi i mbrojtësit se në veprimet e të dënuarit nuk plotësohen tiparet e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor dhe është gjykuar si më lartë.

14. Për këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës ka arritur në përfundimin se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.25/2025, datë 24.02.2025

’’Ky rast është i rëndësishëm për faktin se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka pretenduar se me rastin e ricilësimit të veprës penale ka ndodhur shkelja e ligjit penal dhe gjithashtu është trajtuar vazhdimi i shqyrtimit gjyqësor si rezultat i hapjes së tij e që të dy këto situata janë ndërlidhur me pretendimin se me këtë rast bëhet fjalë për vendim qartazi të papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë duke kërkuar kthimin e çështjes në rigjykim, mirëpo këto pretendime janë cilësuar si të pabazuara dhe si të tilla janë refuzuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës Themelore
   Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.Nr.50/2023 e datës 15.03.2024, të dënuarin Shaban Gogaj e ka shpallur fajtor për veprën penale vrasja nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së dhe i ka caktuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, kurse për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe i ka caktuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite duke e gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite e 6 (gjashtë) muaj në të cilin dënim është llogaritur masa e paraburgimit nga data 23.09.2018 e tutje. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 500 (pesëqind) €, në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 500 (pesëqind) €, në emër të shpenzimeve të procedurës penale, si dhe shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore- juridike janë udhëzuar në kontest civil.

2. Me të njëjtin aktgjykim i dënuari Isuf Cacaj është shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe i ka caktuar dënim me

gjobë në shumë prej 2000 (dymijë) €. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 200 (dyqind) €, në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 300 (treqind) €, në emër të shpenzimeve të procedurës penale, si dhe shumën prej 50 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit.

3. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës
   Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.Nr.422/2024 e datës 03.10.2024, ka aprovuar si të bazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit Shaban Gogaj duke ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe i ka caktuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe duke e gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite e 6 (gjashtë) muaj. Kurse ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjilan, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar dhe mbrojtësit të të dënuarit për pjesën tjetër të aktgjykimit janë refuzuar si të pabazuara.

4. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të konstatoj shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal apo të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështja të kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

5. Mendimi i mbrojtësit të të dënuarit
   Mbrojtësi i të dënuarit, avokati Besnik Berisha, me shkresën e datës 30.01.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të hudhet si e palejuar apo të refuzohet si e pabazuar.

6. Pretendimet e paraqitura në kërkesë

a. Në kërkesë pretendohet se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të nenit 384 par.2, nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPP-së, me ç'rast është cituar dispozita në fjalë dhe theksohet se nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe nga shkresat e tjera rezulton se nuk janë vlerësuar dhe analizuar në mënyrë të duhur të gjitha provat e administruara dhe si pasojë e kësaj janë nxjerrë konkludime të gabuara. Së pari konstatimi nga ana e ekspertëve të balistikës me numër të referencës AKF/2019 të datës 19.04.2019 nga AKF, respektivisht ekspertët Qëndrim Topalli dhe Lutfi Raci të cilët në bazë të video incizimeve kanë konstatuar njohuritë e të dënuarit për përdorimin e armës se i njëjti ka pasur njohuri për mbushjen e armës, repetimin e saj, shënjestrimin dhe të gjitha këto veprime të tij dëshmojnë se i dënuari ka kryer veprën penale me dashje vrasja e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së duke rrezikuar edhe pjesëmarrësit e tjerë dhe duke e ditur pasojat që mund të ketë përdorimi i armës, si një person që ka njohuri për përdorimin e armës ose do të duhej ta dinte pasojat e përdorimit të armës me gaz apo armës së vërtetë nga distanca e cila është përdorur. Për më tepër, këto konstatime të ekspertëve janë theksuar edhe gjatë rishqyrtimit gjyqësor përkitazi me funksionalitetin e armëve e posaçërisht armës "B..." e cila është konstatuar se ka qenë funksionale dhe nuk ka pasur defekt apo ngecje. Kurse gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë këto konstatime, por ka marrë për bazë vetëm disa fjali brenda konstatimeve të tyre të cilat shkojnë në favor të të dënuarit.

b. Nga kjo arsye nuk mund të akceptohet përfundimi i gjykatës së shkallës së dytë se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e që pas procedimit të provave ka ardhur në përfundim të gabuar se në veprimet e të dënuarit janë realizuar elementet e veprës penale vrasja nga pakujdesia nga neni 181 i KPRK-së, e kjo duke u bazuar në deklarimin e të dënuarit se në asnjë mënyrë nuk ka pasur për qëllim privimin nga jeta tani të ndjerit A.T., me të cilin ka punuar së bashku, përkatësisht arma e përdorur ka pasur bindjen se nuk ka qenë arma e llojit "B...", por arma me gaz për të cilën kishte marrë informacione nga axha i tij se arma me gaz gjendet në fiokë. Pretendohet se deklarimit të të

dënuarit është për tu habitur se si gjykata i ka falur besimin dhe i cili deklarim është bërë vetëm për të i ikur përgjegjësisë penale dhe dënimit për veprën penale vrasja e rëndë, për më tepër, deklarimi i të dënuarit nuk korrespondon me video incizimin dhe ekspertizat e ekspertëve të balistikës dhe sikurse qëllimi i të dënuarit të mos ishte privimi nga jeta i tani të ndjerit të njëjtin nuk do ta kishte shënjestruar, por do të kishte shtënë në ajër. Kjo duke pasur parasysh video incizimin nga vendi i ngjarjes ku vërtetohet se i dënuari pasi që ishte rrethuar nga disa persona, punëtor dhe vajzën e hallës së tij dhe pas bisedave të zhvilluara mes tyre në momentin që merr telefonatë dhe fillon të flas në telefon, pas disa sekondash, punëtorët ndërrojnë mimikat e fytyrave dhe fillojnë të lëvizin dhe largohen nga aty dhe pasi që ndryshon atmosfera i njëjti pasi e kryen telefonatën me një shprehje të nervozes ku edhe vjen motivi i vrasjes, ulet në karrige shikon anash dritares nga ana e djathtë, hap fiokën e tavolinës, nxjerr armën e mbush me fishekë dhe e merr në shënjestër tani të ndjerin dhe me këtë rrezikon jetën edhe të dy personave tjerë që ishin afër tij.

c. Në vijim të kërkesës si referencë theksohet mendimi mospajtues nga ana e kryetares së trupit gjykues përkitazi me kualifikimin juridik të veprës penale nga vrasja e rëndë në veprën penale vrasja nga pakujdesia dhe se këtë mospajtim e arsyeton me faktin se veprimet e tani të dënuarit në ditën kritike që nga momenti i marrjes së armës e deri te përfundimi i veprës penale nuk mund të cilësohen si pakujdesi për faktin se nuk ka pasur një vlerësim të tërësishëm të provave dhe vlerësim faktik të çështjes që paraqesin mos përputhje mes dispozitivit të aktgjykimit dhe përshkrimit faktik të veprës penale dhe për këto arsye vjen deri te cilësimi i gabuar i veprimeve të të dënuarit si vepër penale e kryer nga pakujdesia. Mirëpo nga vështrimi dhe analizimi i çdo veprimi, pretendohet se tek i akuzuari ka ekzistuar dashja për kryerjen e veprës penale të vrasjes, meqë tek i dënuari ka ekzistuar motivi, vetëdija mbi pasojën e shkaktuar dhe i njëjti me përgatitje dhe paramendim vepron në drejtim të kryerjes së veprës penale.

d. Më tutje pretendohet se duke u bazuar në CD-të që gjenden në shkresat e lëndës dhe se nga shikimi i tyre shihet lëvizja e të dënuarit i cili me dashje e privon nga jeta tani të ndjerin duke e vënë në rrezik jetën e dy të dëmtuarve A.H. dhe F.Z., në atë mënyrë që pasi që i dënuari merr

një telefonatë nga N.M., nga e cila bisedë shihet se është dukshëm i acaruar dhe tani i ndjeri menjëherë largohet në drejtim të stogjeve përball tij në distancë prej 4.70 metra, e kështu veprojnë edhe të dëmtuarit A.H. dhe F.Z., dhe posa përfundon kjo bisedë, i dënuari nga karriga në skajin e anës së majtë të banakut kalon në karrigen tjetër që gjendet në mes të banakut, lakohet dhe nxjerr nga sirtari i fundit në anën e djathtë të tij revolen e tipit "B..." model ..., vendos karikatorin dhe e repeton duke e marrë në shenjë të ndjerin A.T. i cili në ato momente ishte mes të të dëmtuarve A.H. dhe F.Z., pothuajse ngjitur me ta duke qëlluar një herë në drejtim të tij dhe e kthen armën ku e kishte marrë dhe menjëherë ngritët nga karriga. Si pasojë e kësaj tani i ndjeri merr plagë në kokë konkretisht në mollëzën e djathtë të fytyrës e që predha kishte depërtuar nëpër kockën zigomatike kalon nëpër nofullën e sipërme të djathtë dhe vazhdon në indet e buta të qafës dhe nën bazën e kafkës duke përfunduar në pjesën e pasme të qafës mu në mesin e saj si vrimë dalëse, me ç'rast shkaktohet gjakderdhja e jashtme dhe gjakderdhja në cipat e buta të trurit dhe të trurit të vogël e si rrjedhojë e kësaj shkaktohet vdekja e menjëhershme e tani të ndjerit. E që këto veprime dëshmojnë përgatitjen dhe planin kriminal që kishte i dënuari për të kryer vrasjen pasi që ishte i vetëdijshëm që arma ndodhet në sirtar e që ndërmerr veprimin e hapjes së tij e merr armën në dorë e vendos karikatorin dhe e repeton armën duke e marrë në shenjë dhe qëlluar tani të ndjerin e të cilat veprime në tërësinë e tyre dëshmojnë përgatitjen dhe planin kriminal që kishte për të kryer vrasjen, meqë i dënuari ishte i vetëdijshëm se me veprimet e tij do të shkaktohet pasoja e ndaluar dhe i njëjti e ka dashur shkaktimin e kësaj pasoje.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

   - kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i prokurorit të shtetit është i pabazuar, ngase aktgjykimet e kundërshtuara, nuk përmbajnë shkelje të pretenduara. Në rastin konkret nuk është i bazuar pretendimi, siç është theksuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë bërë shkelje për të cilat pretendohen.

3. Gjykata Supreme e Kosovës e Kosovës fillimisht e sheh të nevojshme të bëj një rikapitulim të kësaj çështje penale, me ç'rast gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë del se prokurori i shtetit para fjalës përfundimtare kishte bërë ricilësimin e veprës penale nga vepra penale vrasja e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së në veprën penale vrasja nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së e që pas kësaj gjykata e shkallës së parë i kishte dhënë mundësi të deklarimit të tani të dënuarit përkitazi me fajësinë në veprën penale të ricilësuar dhe i cili ishte deklaruar fajtor për këtë vepër penale dhe gjithashtu i cili pranim ishte aprovuar dhe ishte caktuar data e shpalljes së aktgjykimit. Mirëpo në ndërkohë duke vepruar sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan është rihapur shqyrtimi gjyqësor, me ç'rast është vazhduar me shqyrtimin gjyqësor sipas aktakuzës fillestare. Megjithëse, kërkesa për rihapjen e shqyrtimit gjyqësor ishte bërë me qëllim të propozimit të provave të reja të cilat ishin paraqitur në kërkesë dhe atë: video incizimi i vendit të ngjarjes dhe dëgjimi i dëshmitarëve S.S., H.D., A.H. dhe M.S., por sipas gjykatës së shkallës së parë provat e propozuara nuk ishin prova të reja pasi që të njëjtat ishin administruara edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor.

4. Sipas pikëpamjes së gjykatës së shkallës së parë e theksuar në aktgjykimin e saj del se prokuroria pa pasur bazë ligjore dhe pa prova të reja nuk ka të drejtë të qëndroj sërish pranë aktakuzës fillestare pasi që në seancën e datës 16.03.2021 kishte bërë ricilësimin e veprës penale dhe kjo situatë duhet të interpretohet në favor të të dënuarit edhe përkitazi me ricilësimin juridik të veprës penale e që duhet theksuar se qëndrim të njëjtë ka paraqitur edhe gjykata e shkallës së dytë e që

pikëpamjet e gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore në tërësi i aprovon edhe kjo gjykatë.

5. Përtej kësaj, duke analizuar arsyetimet e aktgjykimeve të dy instancave më të ulëta gjyqësore, Gjykata Supreme e Kosovës tërheqë vëmendjen në disa aspekte të rëndësishme procedurale, së pari organi i akuzës, gjegjësisht prokuroria e shtetit bazuar në dispozitat e KPP-së dhe Ligjit për Prokurorinë e Shtetit ka kompetenca të plota në ngritjen dhe përfaqësimin e aktakuzës deri në fazën e ndryshimit dhe zgjerimit të saj, mirëpo pas kësaj faze çështja kalon në shqyrtim nga ana e trupit gjykues i cili ka dy mundësi për marrjen e provave tjera dhe atë: mundësia e parë pas fjalës përfundimtare, me ç'rast çmohet se nuk duhet marrë prova tjera dhe shqyrtimi gjyqësor shpallet i përfunduar dhe trupi gjykues tërhiqet në seancën për këshillim dhe votim (neni 355 par.1 dhe 2 i KPP-së) dhe mundësia e dytë kur gjatë marrjes së aktgjykimit, përkatësisht seancës së këshillimit dhe votimit, me ç'rast gjithashtu fillimisht shqyrtohet nevoja për plotësimin e procedurës së provave dhe sqarimin e ndonjë çështje konkrete (neni 358 par.1 i KPP-së). Por në të dy rastet e cekura më lartë kjo kompetencë është ekskluzive e anëtarëve të trupit gjykues dhe nuk ka mundësi që kjo të bëhet edhe përmes ndërhyrjes së palëve tjera në procedurë penale, kurse në rastin konkret duhet rikujtuar faktin se në këtë çështje penale prokurori i shtetit kishte bërë ricilësimin e veprës penale nga vrasja e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së në veprën penale vrasja nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së dhe menjëherë pas kësaj i dënuari ishte deklaruar fajtor për veprën penale të ricilësuar dhe shpallja e aktgjykimit ishte shtyrë për datë tjetër. Andaj, e gjithë kjo situatë e krijuar, përkatësisht hapja e shqyrtimit gjyqësor si rezultat i kërkesës së prokurorit të shtetit dhe vazhdimi i shqyrtimit gjyqësor pas rihapjes del se nuk kishte mbështetje ligjore sipas dispozitave të KPP-së.

6. Gjykata Supreme e Kosovës rikujton faktin se në këtë çështje penale nuk ishin kontestuese faktet të cilat paraqiten në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe atë: se si pasojë e një të shtëne me armën e tipit "B..." model ..." ishte shkaktuar vdekja e tani të ndjerit A.T., i

cili kishte marrë një plagë në kokë konkretisht në mollëzën e djathtë të fytyrës e që predha kishte depërtuar nëpër kockën zigomatike duke kaluar nëpër nofullën e sipërme të djathtë dhe vazhdon në indet e buta të qafës dhe nën bazën e kafkës duke përfunduar në pjesën e pasme të qafës mu në mesin e saj si vrimë dalëse, me ç'rast shkaktohet gjakderdhja e jashtme dhe gjakderdhja në cipat e buta të trurit dhe të trurit të vogël e si rrjedhojë e kësaj shkaktohet vdekja e menjëhershme e tani të ndjerit. Gjithashtu nuk ishte kontestues fakti se tani i ndjeri ishte mes tani të dëmtuarve A.H. dhe F.Z. dhe se distanca mes tani të dënuarit dhe të ndjerit ishte 4-5 metra. Mirëpo, ashtu siç me të drejtë është konstatuar nga gjykata e shkallës së parë ricilësimi i veprës penale nga ana e prokurorisë ishte bërë për faktin se i dënuari kishte menduar se ishte duke shtënë me armën e gazit dhe kjo kishte qenë arsyeja që prokurori i shtetit kishte bërë ri cilësimin e veprës penale.

7. Në këtë kontekst është e rëndësishme të trajtohet në mënyrë të posaçme pretendimi i theksuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë përkitazi me motivin e të dënuarit për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë e që sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës është një pretendim tërësisht i pabazuar dhe bie në kundërshtim me aktakuzën e prokurorisë dhe atë për faktin se edhe sipas aktakuzës fillestare të paraqitur, por edhe shkresave të kësaj çështje penale asnjëherë nuk është paraqitur motivi për kryerjen e kësaj vepre penale, kjo për faktin se aktakuza është ngritur sipas dispozitës së nenit 173 par.1, nënpar.1.5 të KPRK-së, që përcakton privimin nga jeta të personit dhe me atë rast me dashje vë në rrezik jetën e një ose më shumë persona. Pra as në variantin më të pafavorshëm kundër tani të dënuarit as vet prokuroria përmes aktakuzës së saj nuk ka përcaktuar motivin për kryerjen e kësaj vepre penale.

8. Pretendimi i theksuar përkitazi me faktin se gjykata e shkallës së parë i ka besuar mbrojtjes së të dënuarit duke anashkaluar provat e tjera të administruara e që sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës kjo nuk qëndron pasi që me aktgjykimet e kundërshtuara janë analizuar dhe vlerësuar të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor deri sa është hapur shqyrtimi gjyqësor, dhe për më tepër, të gjitha

provat janë vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të qartë e posaçërisht me këtë rast është vlerësuar mendimi i ekspertëve të balistikës dhe përkundër faktit se mendimi i tyre ishte vlerësuar gjatë shqyrtimit të parë, gjegjësisht aktgjykimit të datës 14.10.2022. Përtej kësaj, mendimi i ekspertëve Qëndrim Topalli dhe Lutfi Rraci nuk kishte ndryshuar as pas rihapjes së shqyrtimit gjyqësor, meqë mendimet e tyre ishin të njëjta pa asnjë ndryshim në raport me mendimin e tyre të dhënë deri sa ishte rihapur shqyrtimi gjyqësor. Kurse mendimi i tyre në cilësi të ekspertëve të balistikës duke u bazuar në video incizim përkitazi me aftësitë e të dënuarit për demonstrimin me armë, përkatësisht përcaktimi i njohurive për vendosjen e karikatorit, repetimin dhe shënjestrimin në asnjë rrethanë nuk ka ndryshuar dhe nuk ka qenë përcaktues për të determinuar se të gjitha këto veprime të përcaktojnë se i dënuari ka kryer veprën penale me dashje vrasja e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së apo veprën penale vrasja nga pakujdesia nga neni 181 i KPRK-së.

9. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë çështje penale e rëndësishme është të potencohet fakti se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore dhe veçanërisht gjykata e shkallës së parë i është përmbajtur parimit se rihapja e shqyrtimit gjyqësor është bërë pa ofruar prova të reja nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, meqë provat e propozuara ishin administruar paraprakisht dhe se është konstatuar se ricilësimi i veprës penale nga vepra penale vrasja e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së në veprën penale vrasja nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së nga ana e prokurorit të shtetit nuk mund të ndryshohet në dëm të të dënuarit dhe se bazuar në këtë ricilësim, përkatësisht për veprën penale vrasja nga pakujdesia është proceduar tutje me shqyrtimin gjyqësor dhe me këtë arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është bazuar dhe mbështetur edhe nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

10. Duke vlerësuar pretendimet përkitazi me mendimin mospajtues të paraqitur në formë të shkruar nga ana e kryetares së trupit gjykues, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se bazuar në dispozitën e nenit 368 të KPP-së, anëtari i trupit gjykues mund të paraqes mendim

mospajtues për çështjet juridike ose faktike dhe mendimi i tillë i bashkëngjitet aktgjykimit e që edhe është bërë nga ana e kryetares së trupit gjykues, mirëpo duke u bazuar në faktin se kemi një vendim të shumicës së trupit gjykues, atëherë nuk është në kompetencën e kësaj gjykate vlerësimi i mendimit mospajtues bazuar në faktin se objekt i shqyrtimit edhe sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë është aktgjykimi i shumicës dhe jo edhe vlerësimi i mendimit mospajtues të kryetares së trupit gjykues, dhe për më tepër, i cili mendim është i natyrës faktike dhe si i tillë duhet të refuzohet bazuar në nenin 437 të KPP-së.

11. Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë konstaton faktin se në kërkesë janë paraqitur propozime alternative e para konstatimi i shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe shkelja e ligjit penal dhe që çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Mirëpo, përkundër këtij propozimi në kërkesë janë paraqitur pretendime për shkelje të natyrës së zakonshme, përkatësisht shkelje të ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, përkatësisht duke pasur në fokus aspektin e ricilësimit të veprës penale nga vrasja e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së në veprën penale vrasja nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së. Mbi këtë bazë, vlerësojmë se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të kishte në fokus të shkeljes qartësimin e pretendimit dhe evidentimin e shkeljeve se vendimet e kundërshtuara janë vendime qartazi të papërshtatshme ose të bazuara në gabim të rëndë (e të cilat shkelje nuk janë potencuar në kërkesë), meqë nga interpretimi i dispozitës së nenit 438 par.2 të KPP-së, në parim Gjykata Supreme e Kosovës vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, kurse vetëm në situata përjashtuese (në vendimet qartazi të papërshtatshme ose të bazuara në gabime të rënda), atëherë vjen në shprehje aplikimi i propozimit të theksuar nga ana e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që çështja të kthehet në rigjykim. Për më tepër, bazuar në konceptin e përgjithshëm të dispozitave të procedurës penale është në barrën e prokurorisë së shtetit evidentimi dhe bërja e besueshme e fakteve se gjykatat kanë nxjerrë vendim qartazi të papërshtatshëm apo vendimin e tyre e kanë bazuar në gabim

të rëndë dhe kjo në ndërlidhje me dispozitën e nenit 436 par.1 të KPP-së, me ç'rast është përcaktuar se: "...*Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon*".

12. Gjithashtu ky konstatim është edhe në frymën e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për rastet e bashkuara Nr. KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23, me ç'rast është theksuar fakti se "...*neni 438 paragrafi 2 i KPP-së, duhet interpretuar në kuadër të garancive procedurale të përcaktuara në nenet 29 dhe 31 të Kushtetutës dhe nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së*", respektivisht, Gjykata Supreme e Kosovës duhet të ketë parasysh normat kushtetuese, përfshirë nenit 53 të Kushtetutës që përcakton se interpretimi i të drejtave të njeriut bëhet në pajtim me vendimet e GJEDNJ-së, detyrim ky që vlen për të gjitha gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën Supreme të Kosovës dhe se vendosja në dëm të të pandehurit, vjen në shprehje vetëm në raste shumë përjashtimore e që këto përjashtime mund të zbatohen vetëm në raste të shkeljeve serioze të ligjit nga gjykatat më të ulëta, kurse në rrethana të tjera, Gjykata Supreme e Kosovës, duhet t'i përmbahet parimit që vendimi në dëm të të pandehurit, ka vetëm efekt deklarativ.

13. Andaj, mbi bazën e arsyetimit të lartë cekur, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi faktin se në këtë çështje penale nuk u evidentuan shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal dhe rrjedhimisht nuk kishte bazë për të konstatuar shkelje të kësaj natyre dhe po ashtu edhe për të konstatuar faktin se aktgjykimet e kundërshtuara janë qartazi të papërshtatshme ose të bazuara në gabime të rënda, siç ishte propozuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga ana e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

14. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.46/2025, datë 03.02.2025

’’Ky rast është i rëndësishëm për faktin se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka pretenduar se me rastin e aktgjykimit lirues nga gjykata e shkallës së parë ka ndodhur shkelja e ligjit penal me pretendimin se me këtë rast bëhet fjalë për vendim qartazi të papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë duke kërkuar kthimin e çështjes në rigjykim, mirëpo këto pretendime janë cilësuar si të pabazuara dhe si të tilla janë refuzuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës Themelore
   Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin P.Nr. 103/2019 të datës 24.10.2023, në bazë të dispozitës se nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së i ka liruar nga akuza të pandehurit: Levent Kasemi, Fejzë Kabashi, Refik Shaqiri, Ares Shporta dhe Ganimete Babuna, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së. Shpenzimet e procedurës penale janë ngarkuar buxhetit të kësaj gjykate, kurse përfaqësuesi i palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

2. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës
   Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.Nr.89/2024 të datës 25.03.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës në Prishtinë, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me

propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të konstatohet se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal në favor të të pandehurve dhe që vendimet janë qartazi të papërshtatshëm dhe i bazuar në gabim të rëndë dhe për mënjanimin e këtyre shkeljeve çështja të kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

4. Pretendimet e paraqitura në kërkesë

a. Në kërkesë pretendohet se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të nenit 384 par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.7 dhe 10 të KPPK-së, pasi që dispozitat në fjalë kanë përcaktuar që kur ka prova kundërthënëse, atëherë në mënyrë obligative të vlerësoj saktësinë e tyre, meqë dy gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë paraqitur në mënyrë të plotë dhe të saktë arsyetimet se në cilat fakte dhe prova janë bazuar me rastin e marrjes së aktgjykimit lirues. Pretendohet se bazuar në provat e administruara është vërtetuar përtej çdo dyshimi se të pandehurit me veprimet e tyre kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar pasi që kanë vepruar në kundërshtim të plotë me Ligjin Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe me këtë rast kanë tejkaluar kompetencat e tyre me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për vete apo personin tjetër apo të i shkaktoj dëm personit tjetër. Neni 5 par.3 i Ligjit Nr.04/L-144, ka përcaktuar procedurat për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës bëhet përmes procedurave të ankandit publik të cilat rregullohen me akt nënligjor. Ndërsa neni 6 par.2 i Rregullores Nr. 23/2013 ka përcaktuar se përmes ankandit publik bëhet përzgjedhja e fituesit në bazë të çmimit më të lartë të ofruar. Kurse në rastin konkret të pandehurit kanë vepruar në kundërshtim me këto dispozita duke eliminuar fituesin real – të dëmtuarin A. D. i cili kishte ofertuar me çmimin më të larët prej 25.20 € për m^2 në lokalin e evidentuar me numër ... në sheshin "..." në Prizren

dhe duke favorizuar ofertën e F. B. e cila kishte ofertuar me çmimin prej 20.60 € për m^2 e që me këtë rast të dëmtuarit i kishte shkaktuar dëm për fitimin e humbur për periudhën prej kate viteve e dëmi i është shkaktuar edhe Komunës së Prizrenit. Theksohet fakti se Ligji dhe Rregullorja përcaktojnë në mënyrë të qartë kriterin në bazë të së cilës zgjidhet një ofertues në ankand publik, pra çmimi më i lartë, ndërsa kriteret tjera të sajuara nga ana e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit janë të kundërligjshme dhe nuk gjejnë bazë ligjore.

b. Në vazhdim të kërkesës pretendohet për shkelje të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor pasi që gjykata e shkallës së parë nuk arsyeton fare provat e dëshmitarëve dhe nuk merr për bazë Ligjin Nr.04/L-144 dhe Rregulloren Nr. 23/2013, përkatësisht deklarimet e dëshmitarit K. K. i cili nuk është pajtuar me qëndrimin e anëtarëve të komisionit vlerësues pasi që ata nuk i janë përmbajtur sugjerimeve të organit të shkallës së dytë që lokali të i jepet ofertuesit të çmim më të lartë e cila dëshmi ka qenë bindëse dhe kruciale. Pretendohet se gjykata e shkallës së parë gjithashtu nuk ka marrë për bazë dëshminë e dëshmitarit G. S. i cili gjithashtu ka theksuar faktin se zgjidhja e fituesit do të duhej të bëhej sipas kriterit të përcaktuar me nenin 6 par.2 të Rregullores Nr. 23/2013 dhe si kriter do të duhej të ishte çmimi më i lartë. Për më tepër, theksohet fakti se me këtë rast gjykata e shkallës së parë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore nuk ka aprovuar propozimin e prokurorit për caktimin e ekspertit financiar lidhur me dëmin e shkaktuar nga përzgjedhja e ofertuesit me çmim më të ulët, meqë ekspertiza do të ishte kruciale për të vërtetuar dhe pasqyruar dëmin e shkaktuar Komunës së Prizrenit.

c. Më tutje pretendohet për shkeljen e ligjit penal duke pohuar faktin se në rastin konkret në veprimet e të pandehurve janë realizuar të gjitha elemente te veprës penale në bashkëkryerje keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për faktin se të njëjtit kanë vepruar në kundërshtim të plotë me Ligjin Nr.04/L-144 dhe Rregulloren Nr. 23/2013 dhe me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për vete apo personin tjetër nuk i kanë përmbushur detyrat zyrtare të përcaktuara me ligj dhe njëkohësisht i kanë tejkaluar kompetencat e tyre ligjore, për faktin se përzgjedhja e fituesit është dashur të bëhej në

bazë të kriterit çmimit më të lartë të ofruar, por kanë vendosur kritere të cilat nuk parashihen për dhënien në shfrytëzim të afatshkurtër të pronave të paluajtshme. Gjithashtu nuk kanë vepruar sipas sugjerimeve të komisionit të shkallës së dytë i cili ka gjetur shkelje dhe vërejtje konkrete dhe nga këto shkelje shihen se të pandehurit kanë pasur qëllime inkriminuese duke ndërmarrë veprime konkrete, përkatësisht duke vendosur kritere shtesë në ankand dhe përmes këtyre veprimeve krijohet bindja e plotë se të njëjtit kishin për qëllim fitimin e çfarëdo dobie pasurore për vete apo tjetrin dhe në rastin konkret edhe dëmin e shkaktuar Komunës së Prizrenit.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

   - kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i prokurorit të shtetit është i pabazuar, ngase aktgjykimet e kundërshtuara, nuk përmbajnë shkelje të pretenduara. Në rastin konkret nuk është i bazuar pretendimi, siç është theksuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë bërë shkelje për të cilat pretendohen.

3. Gjykata e shkallës së parë bazuar në provat e administruara ka marrë aktgjykim lirues ndaj të pandehurve dhe me këtë rast ka pasur parasysh edhe provat të cilat prokurori i shtetit i ka potencuar në kërkesë, por ka konstatuar se me asnjë provë nuk është vërtetuar se në veprimet e të pandehurve janë manifestuar elementet e veprës penale në fjalë. Për më tepër, pikërisht mbi bazën e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe veçanërisht duke pasur parasysh Ligjin Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të

Pronës së Paluajtshme të Komunës e që me këtë rast gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka dhënë arsyetim përkitazi me mos realizimit të elementeve të kësaj vepre penale. Për më tepër, akuza e prokurorisë bazohet në faktin se përmes veprimeve të pandehurit kanë tejkaluar kompetencat e tyre me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo personit tjetër apo shkaktimin e dëmit personit tjetër. Kurse nga i cili përshkrim është mjaft konfuz dhe i paqartë, meqë për realizimin e elementeve të kësaj vepre penale mjafton njëra nga këto veprime të vërtetohen. Megjithatë bazuar në përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del se në rastin konkret bëhet fjalë që të pandehurit i kanë shkaktuar dëm të dëmtuarit A. D. i cili përkundër ofertës më të lartë nuk ka arritur që të marrë me qira lokalin me numër 29 në sheshin "Shatërvan" në Prizren, përkatësisht thelbi i akuzës ishte në përcaktimin e kritereve shtesë nga ana e komisionit, siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës kanë shpikur edhe kritere tjera shtesë dhe mbi bazën e këtyre kritereve edhe ishte përcaktuar fituesi tjetër, përkatësisht i dëmtuari A. D. i cili kishte ofertuar me çmim më të lartë prej 25.20 € për m^2.

4. Nga këndvështrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës në këtë çështje penale duhet nisur nga fillimi i procesit për ankandin publik të lokaleve e që duhet të bëhet i qartë fakti se Komuna e Prizrenit kishte shpallur ankand publik për dhënien me qira të 38 lokaleve, me ç'rast ishte formuar komisioni nga ana e Kuvendit Komunal të Prizrenit e përbërë nga shtatë anëtarë dhe atë tre drejtor të drejtorive komunale, tre delegatë të Komunës së Prizrenit dhe një person nga shoqëria civile dhe i cili komision duke u bazuar në dispozitën e nenit 3 par.1 nënpar.1.11 të Ligjit Nr.04/L-144, kishte përcaktuar kushtet për pjesëmarrje dhe kriteret e përcaktuara si kritere shtesë për faktin se zona kishte specifika të posaçme. Duhet pasur parasysh faktin se, komisioni përveç çmimit më të larët të ofertuar kishte përcaktuar edhe gjashtë kritere shtesë dhe atë: krijimi i vendeve të punës, ideja e cila sjell inovacione në lëmine e turizmit në Komunën e Prizrenit, menaxhimi i biznesit dhe ofrimi i punës së personave të gjinisë femërore, përvoja e përhershme për menaxhimin dhe zhvillimin e biznesit dhe plani i biznesit në të cilën përfshihen të gjitha aktivitetet

dhe mundësia e investimit dhe zhvillimit të biznesit, për më tepër, për të gjitha këto kritere ishin përcaktuar shkalla maksimale e pikëve dhe të cilat kritere ishin të përshkruara edhe në njoftimin për ankandin publik e që të gjithë aplikuesit paraprakisht kishin pasur njohuri përkitazi me këto kritere dhe bazuar në këto kritere edhe ishin përcaktuar fituesit në të gjitha lokalet e shpallura përmes ankandit publik.

5. Ashtu siç del nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është evidente se fitues i ankandit për lokalin me numër ... ishte personi F. B. e cili kishte ofertuar me çmim më të ulët, sipas kriterit të parë, por se komisioni poentimin e kishte zbatuar tërësinë e kritereve dhe bazuar në këto kritere del se fitues ishte oferta e cila kishte plotësuar të gjitha kriteret dhe me këtë rast fitues ishte shpallur oferta e Fatmire Berishës e cila ishte poentuar me 74.5 pikë, kurse në ndërkohë ofertuesi A. D. duke aplikuar në emër të subjektit ... "..." kishte arritur që për të gjitha kriteret e përcaktuara kishte arritur 71 pikë, përkundër faktit se në kriterin e çmimit më të lartë kishte përfituar më shumë pikë, mirëpo nuk kishte marrë asnjë pikë në kriterin e menaxhimit të biznesit dhe ofrimit të punës së personave të gjinisë femërore e që kishte ndikuar që për këtë kriter të mos merr asnjë pikë dhe njëkohësisht të ketë poentim më të ulët.

6. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin e provave në mënyrë të baraspeshuar dhe ka vlerësuar secilën provë veç e veç dhe në tërësinë e tyre dhe posaçërisht edhe dëshmitë e dëshmitarëve K. K. dhe G. S. dhe për të cilat ka paraqitur arsyetim të plotë, kurse fakti se organi i shkallës së dytë kishte kthyer çështjen në rivendosje dhe komisioni i shkallës së parë edhe në rivendosje kishte vendosur në mënyrë të njëjtë, megjithatë kjo në asnjë rrethanë nuk nënkupton se në veprimet e tyre janë realizuar elementet e kësaj vepre penale, meqë është në kompetencën e komisionit që të veproj brenda kompetencave të tyre dhe në asnjë rrethanë me automatizëm nuk nënkupton edhe përfshirjen e tyre në veprime të natyrës penale.

7. Duke vlerësuar pretendimet përkitazi me shkeljen e ligjit penal, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore me të drejtë kanë konstatuar se në veprimet e të pandehurve nuk janë realizuar elementet e veprës penale në fjalë dhe konkludimet e gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore i aprovon edhe kjo gjykatë. Kjo për faktin se në veprimet e të pandehurve nuk është vërtetuar tejkalimi i kompetencave të tyre ligjore pasi që anëtarët e komisionit kanë përmbushur në tërësi të gjitha detyrat zyrtare në kuadër të kompetencave të tyre dhe atë prej fillimit të punës së komisionit duke filluar nga përcaktimi i kushteve dhe kritereve për konkurrim në ankand publik e të cilat kushte dhe kritere janë publikuar në njoftimin për ankandin publik dhe deri te vlerësimi i plotësimi dhe poentimi i secilit kriter veç e veç dhe duke mbledhur pikët e grumbulluara për të gjitha kriteret dhe që bazuar në tërësinë pikëve del se fitues ishte F. B. pasi që ofertuesi tjetër A. D. duke aplikuar në emër të subjektit ... "..." në kriterin "menaxhimi i biznesit dhe ofrimi në punë për gjininë femërore " nuk kishte marrë asnjë pikë dhe kjo kishte ndikim edhe në totalin e pikëve në raport me ofertën fituese. Përkatësisht nuk është vërtetuar ana subjektive e të pandehurve, gjegjësisht dashja për të kryer këtë vepër penale e që është në pajtim me konstatimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore se në veprimet e të dënuarit nuk janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale dhe me të drejtë ka rezultuar me aktgjykim lirues. Përtej kësaj *dispozita ligjore e përcaktuar me nenin 21 par.2 i KPRK-së, ka përcaktuar se: "Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj", dhe e cila ndërlidhet me dispozitën e nenit 22 i KPRK-së, se: "Dijenia, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike". Bazuar në këtë, del se dashja si element subjektiv i veprës penale duhet të vlerësohet bazuar në rrethanat objektive të veprimeve të të pandehurve dhe duke u bazuar në veprimet konkrete të tyre duhet të arrihet konkludimi se a manifestohen apo jo elementet e kësaj vepre penale e posaçërisht dashja direkte e tyre. Kurse duke analizuar kronologjinë e kësaj çështje penale dhe veçanërisht faktet e pakontestueshme se të pandehurit kishin vepruar si anëtarë të komisionit për ndarjen e*

lokaleve sipas ankandit publik dhe duke vepruar konform nenit 3 par.1 nënpar.1.11 të Ligjit Nr.04/L-144 kishin përcaktuar edhe gjashtë kritere shtesë për shkak të specifikave të posaçme gjeografike të këtyre lokaleve dhe duke përcaktuar maksimumin e pikëve për secilin kriter, atëherë do të ishte jashtë çdo rezoni logjik dhe juridik se të njëjtit kishin pasur për qëllim që të përcaktojnë fituesin e lokalit Nr.29 dhe njëkohësisht të i shkaktonin dëm të dëmtuarit, meqë kriteret e vendosura ishin të vlefshme për 38 lokalet e shpallura në ankandin publik dhe jo vetëm për lokalin i cili ishte objekt i kësaj çështje penale.

8. *Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë konstaton faktin se në kërkesë është propozuar që* çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, meqë vendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë qartazi të papërshtatshme dhe të bazuara në gabime të rënda. Mirëpo, përkundër këtij propozimi në kërkesë janë paraqitur pretendime për shkelje të natyrës së zakonshme, përkatësisht shkelje të ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Mbi këtë bazë, vlerësojmë se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të kishte në fokus të shkeljes qartësimin e pretendimit dhe evidentimin e shkeljeve se vendimet e kundërshtuara janë vendime qartazi të papërshtatshme ose të bazuara në gabim të rëndë, meqë nga interpretimi i dispozitës së nenit 438 par.2 të KPP-së, në parim Gjykata Supreme e Kosovës vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, kurse vetëm në situata përjashtuese (në vendimet qartazi të papërshtatshme ose të bazuara në gabime të rënda), atëherë vjen në shprehje aplikimi i propozimit të theksuar nga ana e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që çështja të kthehet në rigjykim. Për më tepër, bazuar në konceptin e përgjithshëm të dispozitave të procedurës penale është në barrën e prokurorisë së shtetit evidentimi dhe bërja e besueshme e fakteve se gjykatat kanë nxjerrë vendim qartazi të papërshtatshëm apo vendimin e tyre e kanë bazuar në gabim të rëndë dhe kjo në ndërlidhje me dispozitën e nenit 436 par.1 të KPP-së, me ç'rast është përcaktuar se: "...*Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet*

vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon".

9. Gjithashtu ky konstatim është edhe në frymën e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për rastet e bashkuara Nr. KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23, me ç'rast është theksuar fakti se "*...neni 438 paragrafi 2 i KPP-së, duhet interpretuar në kuadër të garancive procedurale të përcaktuara në nenet 29 dhe 31 të Kushtetutës dhe nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së*", respektivisht, Gjykata Supreme e Kosovës duhet të ketë parasysh normat kushtetuese, përfshirë nenit 53 të Kushtetutës që përcakton se interpretimi i të drejtave të njeriut bëhet në pajtim me vendimet e GJEDNJ-së, detyrim ky që vlen për të gjitha gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën Supreme të Kosovës dhe se vendosja në dëm të të pandehurit, vjen në shprehje vetëm në raste shumë përjashtimore e që këto përjashtime mund të zbatohen vetëm në raste të shkeljeve serioze të ligjit nga gjykatat më të ulëta, kurse në rrethana të tjera, Gjykata Supreme e Kosovës, duhet t'i përmbahet parimit që vendimi në dëm të të pandehurit, ka vetëm efekt deklarativ.

10. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.75/2025, datë 25.02.2025

’’Ky rast është i rëndësishëm për faktin se është pretenduar se i dënuari ka kryer veprën penale të lëndimit trupor dhe jo të veprës penale të vrasjes në tentativë, por një pretendim i tillë është refuzuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës Themelore
   Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.Nr.89/2023 të datës 13.05.2024, të dënuarin Gentonis Imeraj e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173 par.1 nënpar.11 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite dhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 300 €, në emër të shpenzimeve të procedurës penale, , shumën prej 50 € në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 50 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, kurse të dëmtuarit për realizimin e kërkesave pasurore juridike i ka udhëzuar në kontest civil.

2. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës
   Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.Nr.480/2024 të datës 30.09.2024, ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe mbrojtëses së të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e

kundërshtuara dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit
   Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.Nr.35/2025 e datës 13.02.2025 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

5. Pretendimet e paraqitura në kërkesë
   Në kërkesë mbrojtësja e të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe juridikisht të qëndrueshme sa i përket cilësimit juridik të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor dhe është gjykuar. Kjo për faktin se te i dënuari nuk ka ekzistuar dashja për të kryer këtë vepër penale në raport me të dëmtuarit, përkatësisht me asnjë provë bindëse nuk janë vërtetuar elementet objektive dhe subjektive të veprës penale vrasja e rëndë e mbetur në tentativë. Pretendohet se nuk është vërtetuar dashja dhe as motivi për kryerjen e kësaj vepre penale, por veprimet e tij kanë ardhur si pasojë e sëmundjes së tij, meqë i njëjti nuk ka qenë në gjendje të i kontrolloj veprimet e tij.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

   - kërkesa nuk është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtëses së të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave kanë parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

3. Duke vlerësuar pretendimet e theksuara në kërkesë përkitazi me faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar mjaftueshëm aktgjykimin

e saj, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës del se një pretendim i tillë nuk është i bazuar, meqë nga përmbajtja e arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rrjedh se është paraqitur arsyetim i qartë dhe i plotë për faktet vendimtare dhe posaçërisht përkitazi me veprimet inkriminuese të të dënuarit përkitazi me veprën penale të shpallur fajtor. Për më tepër, për secilën provë të administruar është paraqitur arsyetim i qartë dhe i plotë duke filluar nga dëshmitë e dëshmitarëve – të dëmtuarve, ekspertizat mjeko-ligjore lidhur me lëndimet e të dëmtuarve, videoincizimet, si dhe vet mbrojtja e të dënuarit i cili nuk konteston veprimet inkriminuese, mirëpo konteston kualifikimin ligjor të veprës penale e si rezultat i kësaj është ardhur në përfundim se në veprimet e të dënuarit janë realizuar elementet e veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173 par.1 nënpar.11 lidhur me nenin 28 të KPRK-së. Në këtë aspekt duhet pasur parasysh faktin se i dënuari ka ndërmarrë veprime për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, por vepra nuk është realizuar.

4. E rëndësishme është së pari të vërtetohet dashja e të dënuarit përkatësisht aspekti subjektiv i tij se a ishte qëllimi i privimit nga jeta i të dëmtuarve apo shkaktimin e lëndimit trupor dhe duke u nisur nga kjo pikënisje dhe nga fakti se dashja e të dënuarit duhet të vërtetohet duke u bazuar në aspektet objektive, përkatësisht veprimet e tij të manifestuara në rastin konkret, përkatësisht mjetin e përdorur, pjesët e trupit ku është drejtuar sulmi kundër të dëmtuarve dhe mënyra e të vepruarit të të dënuarit, atëherë duke vlerësuar dy aspekte arrihet deri te përfundimi që manifeston dashjen përkatësisht qëllimin e të dënuarit për të kryer veprën penale të vrasjes në tentativë apo të lëndimit të rëndë trupor. Bazuar në shkresat e lëndës dhe rrjedhën e ngjarjes vërtetohet se i dënuari ka përdorur si mjet të kryerjes së veprës penale një thikë (mjet ky i përshtatshëm për të shkaktuar vdekjen), sulmi është drejtuar në pjesë vitale të trupit dhe atë tek i dëmtuari E. G. (plagë shpuese dhe tej shkuese në regjionin e barkut e shoqëruar me lëndimin e lobit të mëlqisë), kurse tek i dëmtuari Z. Gj. (plagë prerëse shpuese dhe shqyese në regjionin e djathtë ijor dhe regjionin e sipërm të djathtë të kreshtës iliake), prandaj në rastin konkret sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës që të dy elementet e lartëcekura janë

realizuar në mënyrë kumulative dhe në tërësinë e saj shpie vetëm në një konkludim se qëllimi i të dënuarit ishte privimi nga jeta i të dëmtuarve. Nga kjo rrjedh se me të drejtë është konstatuar nga ana e gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar elementet e figurës së veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173 par.1 nënpar.11 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, kështu që gjetjet dhe konkludimet e gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore në tërësi i aprovon dhe i mbështetë edhe kjo gjykatë. Përtej kësaj, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për tu realizuar kjo vepër penale nuk është i nevojshëm të ketë ndonjë motiv të caktuar pasi edhe kualifikimi ligjor i veprës penale është kur me dashje kryhen dy apo më shumë vrasje e në rastin konkret objekt i sulmit ishin dy persona, mirëpo vepra penale nuk ishte realizuar, përkatësisht kishte mbetur në tentativë.

5. Sa i përket pretendimit përkitazi me faktin se i dënuari nuk ka mundur të i kontrolloj veprimet e tij dhe si pasojë e gjendjes së tij shëndetësore edhe është kryer kjo vepër penale, Gjykata Supreme e Kosovës, rikujton faktin se gjatë zhvillimit të procedurës penale ndaj të dënuarit është urdhëruar ekspertiza psikiatrike e përpiluar nga ana e grupit të ekspertëve të psikiatrisë, me ç'rast eksperti Dr. Nysret Pepaj edhe është dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor e që bazuar në këto të dhëna është ardhur deri te konkludimi se i dënuari veprën penale e ka kryer në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar, për shkak të çrregullimit psikotik paranoid e që duke u bazuar në këtë ekspertizë, gjykata e shkallës së parë të dënuarin e ka shpallur fajtor për këtë vepër penale dhe njëkohësisht krahas dënimit të shqiptuar ka përcaktuar se dënimi i shqiptuar do të ekzekutohet në Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë duke përcaktuar detyrime shtesë që të përcillet progresi i gjendjes së shëndetit mendor të të dënuarit, kjo si rezultat i faktit se veprën penale e kishte kryer në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore.

6. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.122/2025, datë 26.03.2025

’’Ky rast është i rëndësishëm për faktin se është pretenduar për kolezion mes nenit 93 par.2 të KPRK-së dhe të nenit 65 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës – Ligji Nr.04/L-042, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës ka konkuduar se në rastin konkret është shkelur dispozita e Ligjit për Prokurimin Publik e cila kërkon nga operatori ekonomik që aplikon për tender publik të paraqes të dhënat që kërkohen sipas kësaj dispozite ligjore.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës Themelore
   Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.Nr.200/2023 e datës 08.04.2024, të dënuarin Naim Sallahu e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurimin publik nga neni 415 par.1 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) € dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit i është shndërruar në dënim me gjobë në shumë prej 4000 (katërmijë) €, dhe i është shqiptuar dënimi unik në shumë prej 4700 (katërmijë e shtatëqind) €. Të dënuarit i është shqiptuar dënimi plotësues ndalimi i pjesëmarrjes në procedurat për dhënien e kontratave në prokurimin publik në kohëzgjatje prej 1 (një) viti pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë dhe është obliguar në pagesën e shumës prej 100 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumës prej nga 50 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

2. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës
   Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.Nr.409/2024 e datës 20.09.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

   Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të e aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen në atë mënyrë që i dënuari të lirohet nga akuza.

4. Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

   Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.Nr.67/2025 e datës 10.03.2025 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

5. Pretendimet e paraqitura në kërkesë

   a. Në kërkesë i dënuari fillimisht përshkruan kronologjinë e procedurës penale në këtë çështje duke paraqitur vendimet e dy instancave gjyqësore dhe duke pretenduar se me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur ligji penal, përkatësisht është shkelur dispozita e nenit 93 par.2 të KPRK-së, ku theksohet se pasojat juridike të dënimit nuk krijohen kur kryerësit i shqiptohet gjoba apo vërejtja gjyqësore, kjo duke marrë parasysh faktin se nuk është paraparë afati i rehabilitimit për rastet kur shqiptohet dënimi me gjobë apo vërejtja gjyqësore.
   b. Në vijim të kërkesës theksohet fakti se i dënuari sipas aktgjykimit PKR.Nr.94/2018 i datës 26.04.2018 është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj dhe i cili dënim i ishte shndërruar në dënim me gjobë në lartësi prej 3000 (tremijë) € dhe i cili dënim ishte ekzekutuar me datë 04.06.2018, ashtu që fakti se i dënuari nuk kishte paraqitur këtë aktgjykim para se të konkurronte për dhënien e kontratës së prokurimit publik të Komunës së V,, për ndërtimin e rrugës K,- V, nuk duhej të konsiderohej si mos paraqitje e këtij fakti, pasi që kjo nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 93 par.2 të KPRK-së pasi që dënimi me gjobë si në rastin konkret nuk do të paraqiste pasoja juridike për të mos konkurruar në këtë tender publik. Për më tepër, theksohet fakti se edhe vet fakti se i dënuari nuk është shpallur fitues në këtë procedurë të prokurimit përkundër faktit se ka qenë më i lirë

se konkurrentët e tjerë vë në pikëpyetje mashtrimin në raport me këtë procedurë.

c. Pretendohet se shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara e nenin 384 par.1, nënpar.1.2 lidhur me nenin 38 të KPP-së janë evidentuar për faktin se gjykata e shkallës së dytë me rastin e kthimit të çështjes në rigjykim sipas aktvendimit PAKR.Nr.452/2023 të datës 20.09.2023 është theksuar se këtë çështje në rigjykim të e procedoj një kolegj tjetër në gjykatën e shkallës së parë e kjo është në kundërshtim me faktin se në gjykatën e shkallës së parë vendoset nga ana e trupit gjykues dhe jo kolegjit, kurse përkundër kësaj në rigjykim është ndryshuar vetëm kryetari i trupit gjykues, kurse dy anëtarët kanë mbetur të njëjtë sikurse në çështjen penale PKR.Nr.200/2023 të datës 04.04.2023.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

   - kërkesa nuk është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

3. Duke shqyrtuar pretendimet konkrete të paraqitura në kërkesën e të dënuarit se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje të ligjit penal për faktin se është shkelur dispozita e nenit 93 par.2 të KPRK-së e cila ka përcaktuar se me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë apo vërejtjes gjyqësore nuk krijohen pasojat juridike, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se pretendimi në fjalë është i pabazuar, përkundër faktit se dispozita e cekur (neni 93 par.2 të KPRK-së) ka përcaktuar përjashtimet ligjore të pasojës juridike të

dënimit të shqiptuar me gjobë siç ka qenë rasti i aktgjykimit PKR.Nr.94/2018 i datës 26.04.2018 të marrë kundër tani të dënuarit. Megjithatë, dispozita në fjalë ka përcaktuar pasojën përkitazi me gëzimin e ndonjë të drejte të qytetarëve, mirëpo bazuar në dispozitat e nenit 65 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës – Ligji, Nr.04/L-042, paraqet detyrim ligjor që operatori ekonomik përmes deklaratës nën betim të paraqiste të gjitha të dhënat e gjithashtu edhe faktin se ndaj tij ishte marrë aktgjykim dënues pa marrë parasysh llojin e dënimit të shqiptuar, megjithëse me aktgjykimin PKR.Nr.94/2018 i datës 26.04.2018 ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar për shkak të veprës penale falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 398 par.2 të KPRK-së. Nga leximi i dispozitës ligjore të nenit 93 par.2 të KPRK-së dhe të nenit 65 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës – Ligji Nr.04/L-042, rezulton se pasoja juridike e dënimit nuk e përjashton faktin që operatori ekonomik me rastin e paraqitjes së deklaratës nën betim të paraqiste edhe faktin e dënimit të shqiptuar dhe se detyrimi i paraqitjes së kësaj të dhëne të saktë nuk ndërlidhet me pasojat e dënimit të shqiptuar, por ndërlidhet me vlerësimin e kushteve në ofertën e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik e që dispozita ligjore ka përcaktuar paraqitjen në mënyrë të saktë të të gjitha të dhënave e gjithashtu edhe faktin përkitazi me aktgjykimin dënues të shqiptuar ndaj tij.

4. Duke vlerësuar pretendimet e theksuara në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë përkitazi me shkeljet e pretenduara të përcaktuara me dispozitën e nenit 384 par.1, nënpar.1.2 lidhur me nenin 38 të KPP-së, që ndërlidhen me vendimin e gjykatës së shkallës së dytë PAKR.452/2023 të datës 20.09.2023 për ndryshimin e kolegjit penal të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Supreme e Kosovës duke u bazuar në shkresat e lëndës, konstatoi se gjykata e shkallës së dytë kishte kërkuar ndryshimin e trupit gjykues edhe pse kishte përdorur terminologjinë kolegjit penal, por kjo është e nënkuptueshme dhe i cili vendim në tërësi ishte respektuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, meqë të gjithë anëtarët e trupit gjykues ishin ndryshuar në raport me aktgjykimin PKR.Nr.22/2023 të datës 09.06.2023 pasi që

me aktgjykimin vijues - PKR.Nr.200/2023 të datës 03.05.2024 kishin marrë pjesë trup gjykues tjetër, andaj si i tillë pretendimi i theksuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë është i pabazuar.

5. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.185/2025, datë 16.04.2025

’’Ky rast është i rëndësishëm për faktin e lëshimit të urdhrave për masat e veçanta hetimore pa ditur identitetin e saktë të personit e që Gjykata Supreme e Kosovës ka konkuduar se në rastin konkret nuk është shkelur dispozita e nenit 84 par.2 të KPP-së (i cili Kod ishte në fuqi në kohën e urdhërimit të masave) dhe gjithashtu në harmoni edhe me dispozitën e nenit 86 par.3 dhe 4 të KPP-së që aktualisht është në fuqi pasi që lëshimi i masave mund të bëhet edhe pa pasur njohuri për identitetin e personit ndaj të cilit urdhërohen masat e tilla.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës Themelore
   Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.Nr.108/2022 të datës 07.03.2024, të dënuarin Adhurim Shehu e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK-së duke e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 2000 (dymijë) € në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 30.04.2022 deri me datë 24.01.2023, kurse të dënuarin Mentor Xhiha e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK-së duke e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 3 (tre) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) €. Të dënuarit janë obliguar në pagesën e shumës prej nga 100 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 50 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

2. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës
   Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.Nr.318/2024 e datës 04.07.2024, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe

mbrojtësve të të dënuarve kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit Mentor Xhiha, avokati Korab Bokshi nga Gj., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarin të e liroj nga akuza apo aktgjykimet e kundërshtuara të i anuloj dhe çështjen të e kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit
   Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.Nr.100/2025 e datës 26.03.2025 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

5. Pretendimet e paraqitura në kërkesë

a. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë gabimisht i dënuari Mentor Xhiha është shpallur fajtor dhe është dënuar për veprën penale në fjalë edhe pse nuk ka poseduar as edhe një gram të lëndë narkotike. Në rastin konkret pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara arsyetohen lehtësisht duke u bazuar në deklarimin e dëshmitares E. S. T. dhe i cili deklarim është dhënë në prokurori, me ç'rast nga e njëjta është pohuar fakti se tani i dënuari Mentor Xhiha i kishte shitur disa herë substanca narkotike, mirëpo këto substanca nuk janë gjetur e i cili arsyetim i dhënë nga ana e gjykatës së shkallës së dytë e cenon në mënyrë të rëndë parimin in "dubio pro reo", duke i besuar dëshmisë së kësaj dëshmitare e cila në asnjë fazë të procedurës penale nuk ka qenë koherente në deklarimet e saja pasi që në vazhdimësi i ka ndryshuar deklarimet. Përtej kësaj me këtë rast mbrojtjes nuk i është dhënë mundësia për të ballafaquar këtë dëshmitare me deklarimet e saj gjatë procedurës hetimore, kurse

gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore kanë përdorur standarde të dyfishta përkitazi me këtë dëshmitare pasi që i janë besuar deklarimeve të saja në polici dhe prokurori dhe jo atyre gjatë shqyrtimit gjyqësor e që kjo bie në kundërshtim me nenin 256 të KPP-së.

b. Pretendohet se në këtë rast në mënyrë të kundërligjshme janë përdorur masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit në raport me të dënuarin Mentor Xhiha dhe atë fillimisht për shkak të faktit se me asnjë provë nuk është vërtetuar se personat që dëgjohen gjatë bisedave telefonike është i përfshirë edhe ky i dënuar dhe nuk ndërlidhet me veprimet inkriminuese të tij, kjo për faktin se hetimet formale kundër tij janë filluar me aktvendimin për fillimin e hetimeve PPI.Nr.04/2022 të datës 14.02.2022, kurse këto masa janë lëshuar para nxjerrjes së aktvendimit për fillimin e hetimit. Mirëpo gjykata e shkallës së parë dhe gjithashtu edhe e shkallës së dytë me rastin e arsyetimit të aktgjykimeve të tyre i referohen dispozitave të nenit 95 par.3 të KPP-së edhe ose hetimet janë zhvilluar gjatë vitit 2021 dhe 2021, përkatësisht në kohën kur në fuqi nuk ka qenë KPP në të cilën referohen këto gjykata.

c. Në vijim të kërkesës janë paraqitur pretendime përkitazi me shkeljen e ligjit penal dhe atë se dy gjykatat e instancave më të ulëta gjyqësore nuk kanë vërtetuar elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën i dënuari është gjykuar pasi që nuk është vërtetuar koha, vendi, mënyra, dashja dhe qëllimi i të dënuarit për kryerjen e kësaj vepre penale, e për më tepër, pretendohet se edhe po të ishte vërtetuar kryerja e veprës penale që i është vënë në barrë të dënuarit, megjithatë dënimi i shqiptuar është shumë i ashpër kur të kemi parasysh faktin se i dënuari më herët nuk ka qenë i dënuar është familjar dhe me punën e tij siguron të ardhura për familjen e tij.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit Penal të Kosovës (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

1. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

2. Pretendimet e paraqitura në kërkesën e të dënuarit se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore aktgjykimet e tyre i kanë mbështetur në deklarimet e dëshmitares E. S.-T., sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë pretendime të pabazuara, meqë në rastin konkret bazuar fillimisht në aktgjykimin e gjykatës së parë del se nuk është i bazuar vetëm në deklarimin e dëshmitares E. S.-T., por në këtë çështje penale janë administruar edhe prova të tjera për të cilat në mënyrë të gjithanshme është paraqitur arsyetim i plotë dhe i qartë për të gjitha faktet vendimtare përkitazi me këtë çështje penale e veçanërisht përkitazi me veprimet konkrete të të dënuarit. Për më tepër, fakti se i dënuari në momentin e arrestimit të tij nuk kishte poseduar lëndë narkotike në asnjë rrethanë nuk i shpërbën veprimet e tij pasi që edhe sipas dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del se i dënuari shitjen e lëndës narkotike e kishte bërë për një periudhë më të gjatë kohore, mirëpo duke u specifikuar posaçërisht shitjet e bëra tani dëshmitarëve E. S.-T. dhe A. B. e që i dënuari vetëm për këto shitje edhe ishte shpallur fajtor dhe ishte gjykuar.

3. Pretendimi se gjykata e shkallës së parë i ka besuar deklarimeve të dëshmitares E. S.-T. të dhëna në prokurori dhe jo atyre gjatë shqyrtimit gjyqësor, del gjithashtu se është pretendim i pabazuar, meqë me këtë rast në asnjë rrethanë nuk është cenuar dispozita e nenit 256 të KPP-së, meqë është në diskrecion të plotë të gjykatës së shkallës së parë trajtimi i kronologjisë së deklarimeve të dëshmitares dhe gjithashtu edhe aspekti se cilit deklarim të saj do të i fal besimin, pra në asnjë rrethanë nuk nënkuptohet se a priori duhet të i besohet deklarimit të saj gjatë shqyrtimit gjyqësor, por të krahasoj deklarimet gjatë gjitha fazave të procedurës penale dhe pastaj të e çmoj si të besueshme deklarimin të cilin e konsideron se ndërlidhet edhe me provat e tjera të

administruara, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret. Për më tepër, edhe gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka paraqitur arsyetim të hollësishëm, andaj Gjykata Supreme e Kosovës i aprovon në tërësi arsyetimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore.

4. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore në aktgjykimet e tyre në mënyrë të hollësishme kanë arsyetuar aplikimin e masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe me të drejtë kanë konstatuar se përmes aplikimit të këtyre masave është arritur zbulimi dhe identifikimi i kryerësve të kësaj vepre penale. Ndonëse është e qartë se këto masa ishin aplikuar si rezultat i urdhrit nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe ishin lëshuar urdhri për fotografimin e fshehtë ose vëzhgim me video në vende publike, urdhri për fotografimin e fshehtë ose vëzhgim me video në vende private, shfrytëzim i mjeteve më përcjellje të vendndodhjes dhe përgjimi i telekomunikimeve dhe monitorimi i bisedave. Megjithëse kundër tani të dënuarit Mentor Xhiha hetimet kishin filluar pas lëshimit të këtyre masave, mirëpo këto masa njëkohësisht kishin shërbyer edhe për identifikimin e kryerësve të kësaj vepre penale që është plotësisht në harmoni me dispozitën e nenit 84 par.2 të KPP-së (i cili Kod ishte në fuqi në kohën e urdhërimit të masave) dhe gjithashtu në harmoni edhe me dispozitën e nenit 86 par.3 dhe 4 të KPP-së që aktualisht është në fuqi. Pra, Gjykata Supreme e Kosovës e mbështetë në tërësi arsyetimin e dy instancave më të ulëta gjyqësore përkitazi me aplikimin e këtyre masave edhe në rastin kur ende nuk dihet identiteti i personit apo personave që janë duke kryer apo së shpejti do të kryejnë veprën penale, meqë mbështetet në dispozitat e lartë cekura.

5. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore në aktgjykimet e tyre me të drejtë kanë konstatuar se në veprimet të dënuarit janë realizuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK-së, kurse fakti se nuk janë vërtetuar në mënyrë të plotë koha, vendi, mënyra, dashja edhe qëllimi për kryerjen e kësaj vepre penale dalin të jenë të paqëndrueshëm pasi që në dispozitivin e

aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë përshkruar të gjitha këto aspekte dhe atë fillimisht koha duke u potencuar muaji mars i vitit 2022, pastaj vendi duke u theksuar si vend i kryerjes Komuna e Gjakovës e gjithashtu është përcaktuar dashja dhe qëllimi i shitjes së lëndëve narkotike duke përcaktuar edhe personave të cilëve u kishte shitur lëndën narkotike, përkatësisht personave E. S.-T. dhe A. B., andaj pretendimet e theksuara në kërkesë dalin se janë të pabazuara.

6. Duke vlerësuar pretendimet përkitazi me vlerësimin e rrethanave me rastin e shqiptimit të dënimit, Gjykata Supreme e Kosovës vëren faktin se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal nga të dy gjykatat e instancave më të ulëta dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar brenda kornizës së minimumit dhe maksimumit të dënimit të përcaktuar për veprën penale të shpallur fajtor. Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPP-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, shkelja e ligjit penal bëhet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkaluar kompetencat ligjore. Pra, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimit të shqiptuar, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkaluar kompetencat ligjore dhe arsyet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale. Për më tepër, duke vlerësuar arsyetimet e aktgjykimeve të dy instancave më të ulëta gjyqësore e posaçërisht gjykatës së shkallës së parë vërehet fakti se e në arsyetimin e pjesës përkitazi me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit është paraqitur arsyetim i hollësishëm dhe janë vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse rrethanat lehtësuese dhe rënduese, mirëpo bazuar në të gjitha rrethanat e përshkruara është ardhur në përfundim se përmes dënimit të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit dhe Gjykata Supreme e Kosovës në tërësi i aprovon arsyetimet e paraqitura nga ana e dy instancave më të ulëta gjyqësore përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit të shqiptuar në rastin konkret.
7. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.272/2025, datë 13.05.2025

’’Ky rast është i rëndësishëm për faktin se në mënyrë të gabuar ka vepruar gjykata e shkallës së parë duke ricilësuar veprën penale nga vepra penale nxitja e akteve seksuale, prekjes apo aktiviteteve nga personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare nga neni 236 par.3 i KPRK-së në veprën penale ngacmimi nga neni 186 par.1 të KPRK-së dhe atë pa ndryshuar përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit në fjalë dhe si rezultat i kësaj Gjykata Supreme e Kosovës ka konkuduar se në rastin konkret veprimet e të pandehurit nuk përbënin elementet e veprës penale të ricilësuar, dhe për më tepër, kthimi i veprës sipas aktakuzës nuk ishte i mundur për shkak se binte ndesh me *zbatimin e ligjit më të favorshëm.’’*

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës Themelore
   Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për të Mitur, me aktgjykimin PM.Nr.127/2019 të datës 10.07.2023, të dënuarin NN e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 186 par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 2000 (dymijë) €. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 50 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 50 €, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, kurse përfaqësuesi i palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

2. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës
   Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për të Mitur, me aktgjykimin PAKR.Nr.614/2023 e datës 19.02.2025, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati NN nga Lipjani, për shkak të

shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të i anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen të e kthen në rigjykim ose i dënuari të lirohet nga akuza.

4. Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit
   Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.Nr.145/2025 e datës 07.05.2025 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

5. Pretendimet e paraqitura në kërkesë

a. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale pasi që ka vazhduar procedurën penale pa pasur aktvendim për fillim të hetimeve nga ana e prokurorisë, meqë nga shkresat e lëndës shihet se mungon aktvendimi për fillimin e hetimit dhe gjithashtu në aktakuzë dhe në aktgjykim nuk përmendet se është marrë aktvendim për fillim të hetimit.
b. Pretendohet se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar ligjin penal, përkatësisht dispozitën e nenit 385 par.1, nënpar.1 lidhur me nenin 3 të KPRK-së, meqë nuk ka aplikuar ligjin më të favorshëm kundër tani të dënuarit. Me ç'rast në kërkesë është përshkruar kronologjia e kësaj çështje penale ku theksohet fakti se i dënuari është akuzuar se me datë 20.01.2019 ka kryer veprën penale nxitja e akteve seksuale, prekjes apo aktiviteteve nga personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare nga neni 236 par.3 i KPRK-së, kurse aktakuza është deponuar në gjykatë me datë 05.04.2019, kurse nga data 15.04.2019 ka hyrë në fuqi Kodi i Ri Penal - Kodi.Nr.06/L-074. Për këtë arsye mbrojtja ka propozuar që kundër të dënuarit të aplikohet Ligji i Ri Penal, si ligj më i favorshëm pasi që ligji i ri gjegjësisht Kodi.Nr.06/L-074 nuk e ka paraparë veprën penale për të cilën ishte ngritur aktakuza, gjegjësisht veprën penale nxitja e akteve seksuale, prekjes apo aktiviteteve nga personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare nga neni 236 par.3 i KPRK-së. Mirëpo gjykata e shkallës së parë nuk e ka përfillur propozimin e mbrojtjes por ka aplikuar Kodin e

Vjetër Penal dhe me këtë rast ka bërë ricilësimin e veprës penale kundër të dënuarit duke e shpallur fajtor dhe gjykuar për veprën penale ngacmimi nga neni 186 par.1 të KPRK-së.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:
   - kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

2. Duke u bazuar në shkresat e kësaj çështje penale dhe në provat e administruara në këtë çështje penale del se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë në shkelje të ligjit penal nga neni 385 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, pasi që vepra për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor dhe është dënuar nuk përbën vepër penale. Pra, provat e administruara nga ana e dy gjykatave më të ulëta gjyqësore janë interpretuar në mënyrë të gabueshme dhe rrjedhimisht janë nxjerr konkludime të gabuara, dhe atë në dëm të të pandehurit, andaj, kjo e bën të mundur ndryshimin e aktgjykimeve duke e vendosur këtë çështje në mënyrë meritore.

3. Gjykata e shkallës së parë të pandehurin e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 186 par.1 të KPRK-së, duke ricilësuar nga vepra penale nxitja e akteve seksuale, prekjes apo aktiviteteve nga personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare nga neni 236 par.3 i KPRK-së dhe atë pa ndryshuar në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës dhe nga i cili përshkrim del se i pandehuri: "*...e kishte shoqëruar rreth 300 metra deri te shtëpia e kulturës dhe gjatë kësaj kohe i kishte thënë "unë ty të kam loqkë, sa i bukur qenke, më ke rënë në sy, a po vjen me mua në hotel, kur të kesh kohë të lirë më lajmërohesh dhe i ka dhënë numrin e telefonit XX*".

4. Gjykata Supreme e Kosovës në tërësi pajtohet me konkludimet e nxjerra nga dy instancat më të ulëta gjyqësore se në rastin konkret

sipas asaj që ceket në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë nuk rezultojnë të jenë kontestuese rrethanat se:

- i pandehuri kishte paguar shumën prej katër eurove të gjerave ushqimore;
- se i njëjtit e kishte shoqëruar të dëmtuarin rreth 300 metra deri te shtëpia e kulturës; dhe
- se i ishte drejtuar me fjalët në ty të kam loqkë, sa i bukur qenke, më ke rënë në sy, a po vjen me mua në hotel, kur të kesh kohë të lirë më lajmërohesh dhe i ka dhënë numrin e telefonit XX.

5. Mirëpo, nga këto rrethana, del se kontestues është fakti se përmes këtyre veprimeve (siç janë përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit) a ishin përmbushur elementet e veprës penale në fjalë dhe se veprimi i të pandehurit a kishte për qëllim ngacmimin e të dëmtuarit apo jo dhe se ishin pikërisht këto aspekte që kanë bërë dallimin mes interpretimit të bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe të cilin konstatim e kishte pranuar edhe gjykata e shkallës së dytë në njërën anë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës në anën tjetër.

6. Fillimisht në këtë çështje penale është e nevojshme analiza e dispozitës së nenit 186 par.1 të KPRK-së, e cila ka përcaktuar se: "*Kushdo që përfshihet në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikon me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake ose kushdo që vë tjetrin nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake; dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional....*"

7. Nga leximi i kësaj dispozite dhe përshkrimi i dispozitivit të aktgjykimit të gjykatë së shkallës së parë vërehet një paqartësi e interpretimit të kësaj dispozite pasi që dispozita ligjore është e

formuluar duke përcaktuar veprimin në dy forma alternative të kryerjes së veprës penale dhe atë: në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikon me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake dhe vënia e tjetrit nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake; dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional, kurse në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë që në fakt është përshkrim i dispozitivit të aktakuzës është përshkruar një formë e cila nuk është e përfshirë në dispozitën ligjore, pra me këtë rast dispozita ligjore nuk përshkruan formën e ngacmimit seksual i cili në fakt ka ndodhur në rastin konkret, meqë qëllimi i kryerësit dhe sjellja e tij ishte e natyrës seksuale dhe që nuk i përgjigjet veprës penale të ricilësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

8. Përtej kësaj, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore elementet e kësaj vepre penale do të duhej interpretuar në tërësinë e saj, përkatësisht në elementet e saj objektive dhe subjektive dhe të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative dhe jo në mënyrë fragmentare, siç janë interpretuar nga ana e gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore. Andaj, fillimisht është e rëndësishme të përcaktohen elementet e kësaj vepre penale dhe më pas të konstatohet se a janë përmbushur apo jo elementet e kërkuara. Siç u tha në pjesën e epërme të këtij aktgjykimi dhe duke u bazuar në shkresat e kësaj çështje penale, konkludimet e nxjerra nga dy instancat gjyqësore se në rastin konkret sipas asaj që ceket në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë nuk rezultojnë të jenë kontestuese rrethanat objektive të rastit, mirëpo kontestuese janë rrethanat subjektive, përkatësisht fakti se a ishte qëllimi i të pandehurit ngacmimi, përkatësisht tërheqja e vazhdueshme e vëmendjes dhe komunikimi me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër

ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake. Pra në rastin konkret ngacmimi kishte qëllim primar aspektin seksual të kryesit të veprës penale dhe në asnjë rrethanë aspektet e tjera të përcaktuara me veprën penale të ngacmimit për të cilat gjykata e shkallës së parë e ka gjetur fajtor dhe e ka gjykuar dhe ishte pikërisht ky aspekt që bëri dallimin mes interpretimit të bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe të cilin konstatim e kishte pranuar edhe gjykata e shkallës së dytë në njërën anë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës në anën tjetër.

9. Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes pati parasysh gjithsesi edhe ndryshimet ligjore përkatësisht faktin se gjatë zhvillimit të procedurës penale kishte hyrë në fuqi Kodi Penal i Republikës së Kosovës – Kodi Nr.06/L-074. Mirëpo, gjykata e shkallës së pare ricilësimin juridik të veprës penale ishte bërë sipas Kodit që kishte qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, përkatësisht Kodit Penal i Republikës së Kosovës - Kodi.Nr.04/L-082, dhe për më tepër, sipas dispozitave të kodit të atëhershëm ishte inkriminuar edhe vepra penale e ngacmimit nga neni 186 par.1 të KPRK-së dhe gjithashtu kjo vepër penale është inkriminuar edhe në nenin 182 të KPRK-së - Kodi.Nr.06/L-074. Mirëpo në këtë aspekt është e rëndësishme të potencohet edhe fakti se dispozita ligjore e nenit 183 të KPRK-së - Kodi.Nr.06/L-074, ka inkriminuar edhe veprën penale ngacmimi seksual, mirëpo kjo dispozitë ligjore nuk mund të aplikohet për shkak të zbatimit të ligjit më të favorshëm, përkatësisht neni 3 i KPRK-së.

10. Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje të ligjit penal dhe të cilat shkelje nuk janë mënjanuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë e cila vendosi sipas mjetit të rregullt juridik dhe njëkohësisht pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit i paraqitur në kërkesë ishte i bazuar, andaj për këtë arsye u vendos që konform nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-PML.Nr. 318/2025, datë 26.06.2025

''Ky rast është i rëndësishëm për faktin se ekspertiza mjeko-ligjore përkitazi me natyrën e lëndimeve trupore të shkaktuara nga i dënuari nuk paraqesin relevacë në kryerjen e veprës penale vrasja e rëndë në tentativë. Meqë kjo ekspertiza mjeko ligjor paraqet raport përkitazi me llojin dhe natyrën e lëndimeve trupore dhe shkallën e dëmtimit të të dëmtuarit, kurse për tu realizuar elementet e veprës penale vrasja e rëndë në tentativë duhet të merren rrethanat e natyrës faktike dhe qëllimi i kryerësit pa marrë parasysh natyrën e lëndimeve trupore.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës Themelore
   Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.Nr.137/2017 të datës 18.10.2024, të dënuarin Gazmend Segashi, e ka shpallur fajtor për veprën penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni nga neni 179 par.1 nënpar.1.8 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 100 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 50 € në[emër të kompensimit të viktimave të krimit, kurse i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

2. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës
   Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.Nr.704/2024 e datës 24.03.2025, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Kushtrim Salihu nga V., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës

penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, aktgjykimet të ndryshohen dhe vepra penale të ricilësohet nga vepra penale vrasja e rëndë në tentativë në veprën penale lëndimi i lehtë trupor dhe me këtë rast të refuzon akuzën duke konstatuar se ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale, kurse në rastin më të pavolitshëm të dënuarit të i shqiptoj një dënim më të butë.

4. Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit
   Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.Nr.167/2025 e datës 30.05.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar.

5. Pretendimet e paraqitura në kërkesë

a. Në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit pretendohet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara me dispozitën e nenit 384 par.2 nënpar.2.5 të KPP-së, meqë në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk është përshkruar fare natyra e lëndimeve që ka pësuar i dëmtuari edhe përkundër faktit se në ekspertizën mjeko-ligjore është konstatuar natyra e lëndimeve, përkatësisht se i dëmtuari kishte pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin. Për më tepër, në përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit është përshkruar se i dënuari e kishte goditur katër herë të dëmtuarin dhe atë: një herë afër zemrës, dy herë në bark dhe një herë në krahun e majtë, kurse në akt ekspertimin mjeko-ligjor konstatohen tri goditje dhe atë plagë prerëse shpuese në regjionin e kraharorit, abdomenit dhe krahun e majtë, e që pretendohet se qëndron një mospërputhje mes të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe konstatimit të ekspertizës mjeko-ligjor pasi që nuk është sqaruar fakti se i dëmtuari është goditur tri herë apo katër herë me thikë dhe të cilat rrethana do të sqaroheshin me rastin e kthimit të çështjes në rigjykim dhe dëgjimin e ndonjërit nga anëtarët e komisionit të cilët kanë përpiluar ekspertizën mjeko-ligjore.

b. Pretendohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 369 par.6 dhe 7 të KPP-së pasi që dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me arsyetimin pasi që mungon arsyetimi përkitazi me faktet vendimtare përkitazi me veprën penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, kjo për faktin se mungon arsyetimi për faktin e ndërmarrjes e veprimeve inkriminuese nga ana e të dënuarit, përkatësisht fajësia e të dënuarit nuk është e mbështetur në prova konkrete, të artikulueshme dhe të besueshme në drejtim të veprës penale për të cilën i njëjti është gjykuar.
c. Tutje në kërkesë janë paraqitur pretendime për shkeljen e ligjit penal në dëm të të dënuarit pasi që në veprimet e të dënuarit nuk janë realizuar elementet e tipareve të figurës së veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 nënpar.1.8 të KPP-së, pasi që nuk është plotësuar elementi qenësor i kësaj vepre penale gjegjësisht qëllimi i tij për kryerjen e kësaj vepre penale, por procedura penale do të duhej të zhvillohej për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor pasi që qëllimi i të dënuarit ishte shkaktimi i lëndimit të lehtë trupor dhe në asnjë rrethanë privimi nga jeta i të dënuarit. Për më tepër, kontestohet edhe fakti i thikës së konfiskuar për të cilën pretendohet se kjo nuk ishte thika me të cilën ishte shkaktuar lëndimi trupor pasi që e njëjta ishte konfiskuar në shtëpinë e të dënuarit dhe ishte një thikë e cila është përdorur për nevoja shtëpiake dhe nuk është mjeti me të cilin ishte kryer vepra penale në fjalë.
d. Në kërkesë gjithashtu pretendohet për shkelje të ligjit penal duke e cilësuar dënimin e shqiptuar si dënim shumë të ashpër dhe që nuk mund të justifikohet duke pasur parasysh edhe gjendjen e tij personale se i dënuari jeton vetëm me nënën e tij e cila është në gjendje të rënduar shëndetësore e paralizuar dhe me kujdes të vazhdueshëm nga ana e të dënuarit dhe kjo duke u ndërlidhur edhe me faktin se i dënuari dhe i dëmtuari tani më kanë tejkaluar problemet e mëparshme.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit

të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave kanë parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.
3. Duke vlerësuar pretendimet e theksuara në kërkesë përkitazi me shpërputhjen mes dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe ekspertizës së përpiluar nga ana e ekspertëve të mjekësisë ligjore përkitazi me numrin e goditjeve të pësuar nga ana e të dëmtuarit, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara, meqë ashtu siç është theksuar në faqen e pestë të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë eksperti i mjekësisë ligjore Dr. Flamur Blakaj në sqarimet e ekspertizës gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ekzaminimit fizik të tani të dëmtuarit ka sqaruar se i njëjti kishte pësuar katër plagë dhe atë: një plagë në pjesën e sipërme të krahut të majtë, një plagë në anën e majtë të gjoksit, një plagë në regjionin e djathtë të barkut dhe një plagë në anën e majtë të barkut e i cili përshkrim është në sinkron me përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, me ç'rast është përshkruar se i dëmtuari ishte goditur katër herë nga i dënuari dhe atë: një herë afër zemrës, dy herë në bark dhe një herë në krahun e majtë lëndime trupore pjesën e sipërme të krahut të majtë.

4. Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimet e paraqitura në kërkesë përkitazi me faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 369 par.6 dhe 7 të KPP-së, konstaton se ky pretendim nuk mbështet në ndonjë argumentim dhe konkretizim të qartë pos citimit të bazës ligjore, kjo për faktin se në kërkesë nuk është specifikuar përmes ndonjë pretendimi të konkretizuar dhe të qartë përkitazi me mungesën e arsyetimit për faktet vendimtare të kësaj çështje penale. Përtej kësaj është konkludim i përgjithshëm i kësaj gjykatë se aktgjykimet e

kundërshtuara të dy instancave më të ulëta gjyqësore kanë paraqitur arsyetim përkitazi me faktet vendimtare. Së pari aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur arsyetim për të gjitha çështjet kontestuese veçanërisht përkitazi me veprimet e të dënuarit dhe duke i cilësuar si veprime në drejtim të veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 nënpar.1.8 të KPRK-së dhe atë duke u bazuar në faktin se kësaj vepre penale paraprakisht i kishte paraprirë një ngatërrese mes tani të dëmtuarit dhe të dënuarit e cila kishte përfunduar me një sulm fizik që tani i dëmtuari i kishte bërë të dënuarit. Gjithashtu edhe gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj kishte dhënë arsyetime konkrete dhe të qarta përkitazi me të gjitha pretendimet ankimore, andaj arsyetimet e dy gjykatave më të ulëta gjyqësor i mbështet në tersi edhe kjo gjykatë.

5. Duke vlerësuar pretendimet përkitazi me shkeljen e ligjit penal në dëm të të dënuarit, përkatësisht se tek i dënuari nuk janë realizuar elementet e veprës penale të vrasja e rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 nënpar.1.8 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, konstaton se ky pretendim është i pabazuar, meqë në veprimet e të dënuarit janë realizuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën është gjykuar. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore në mënyrë të drejtë kanë vërtetuar se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale në fjalë, andaj gjetjet dhe konkludimet e këtyre gjykatave i mbështetë në tërësi edhe kjo gjykatë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet në fjalë nuk janë të bazuara, për arsyet që do të paraqiten në vijim dhe atë fillimisht përmes analizës së dispozitës së nenit 179 par.1 nënpar.1.8 të KPRK-së që ka përcaktuar se: "*privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt*."

6. Në këtë aspekt duke u bazuar në shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë në faqet 11 dhe 12 të aktgjykimit të saj dhe gjithashtu edhe gjykata e shkallë së dytë në faqen e tetë dhe të nëntë të aktgjykimit të saj kanë konstatuar se vrasja ishte bërë me motive të hakmarrjes së paskrupullt, andaj edhe Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet në tërësi me të gjeturat e gjykatave e instancave më të ulëta gjyqësore duke

rivlerësuar edhe një herë të gjitha rrethanat në të cilat ishte kryer vepra penale dhe atë: së pari është e pakontestueshme se mes tani të dëmtuarit A M. dhe të dënuarit 2- 3 muaj para këtij rasti kishte pasur një konflikt paraprak, me ç'rast tani i dënuari ishte goditur me një skallper në këmbë nga ana e tani të dëmtuarit dhe i cili konflikti kishte ndodhur pas një zënke mes tyre dhe se në këtë konflikt lëndime kishte pësuar tani i dënuari Gazmend Segashi. Andaj të gjitha këto rrethana të lartë cekura në tërësi e vërtetojnë faktin se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 nënpar.1.8 të KPRK-së dhe atë së pari konflikti i mëparshëm dhe lëndimi i pësuar me këtë rast nga ana e tani të dënuarit tregon motivin e tij të qartë të hakmarrjes së paskrupullt. Përtej kësaj motivi i hakmarrjes së paskrupullt nuk mund të jetë i përcaktuar taksativisht dhe nuk mund të ketë ndonjë kufi se deri kur konsiderohet se përmbushet ky motiv, siç pretendohet nga ana e mbrojtësit të të dënuarit, por kjo duhet të ndërlidhet me ndonjë ngjarje apo rrethanë që paraprakisht ka ndodhur dhe që e rëndësishme është të përcaktohet baza e kësaj hakmarrje, përkatësisht të shkaktohen pasoja më të rënda në krahasim me të keqen e pësuar e që në tërësi është realizuar në rastin konkret, meqë për shkak të një vepre të lëndimit trupor është shkaktuar tentativa për privimin nga jeta të personit tjetër. Andaj, pretendimet se në rastin konkret bëhet fjalë për vepër penale të lëndimit të lehtë trupor, përkundër faktit se lëndimet e të dëmtuarit janë të natyrës së lehtë (të konstatuar përmes ekspertizës mjeko-ligjore), megjithatë duke u ndërlidhur me mënyrën e veprimit dhe rrethanat e kryerjes së kësaj vepre penale e posaçërisht duke e ndërlidhur me faktin se i dëmtuari ishte goditur katër herë me thikë, atëherë rezulton se qëllimi i tij ishte privimi nga jeta i tani të dëmtuarit dhe në asnjë rrethanë shkaktimi i lëndimit të lehtë trupor, siç pa të drejtë pretendon mbrojtësi i të dënuarit.

7. Gjykata Supreme e Kosovës vëren faktin se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal nga të dy gjykatat e instancave më të ulëta dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar brenda kornizës së minimumit dhe maksimumit të dënimit të përcaktuar për veprën penale të shpallur fajtor. Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5

të KPP-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, shkelja e ligjit penal bëhet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkaluar kompetencat ligjore. Pra, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimit të shqiptuar, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkaluar kompetencat ligjore dhe arsyet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale.

8. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.351/2025, datë 09.07.2025

’’Ky rast është i rëndësishëm për faktin se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka pretenduar se gjykata e shkallës së dytë ka gabuar me rastin e ndryshimit të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë përkitazi me konfiskimin sipas Ligjit Nr. 06/L-87 - për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, me ç’rast nuk është kërkuar në mënyrë decidive nga ana e paraqitësit të kërkesës anulimi i aktvendimit në fjalë e që për këtë arsye kërkesa për mbrojtën e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës Themelore

   Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktvendimin PNDS.Nr. 6/2024 të datës 22.10.2024, ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS. Nr. 44/2013 të datës 27.06.2024 në atë mënyrë që ka caktuar urdhrin kufizues përfundimtar për sigurimin e pasurisë për të mirëmbajtur pronën dhe ekuivalentin e saj dhe për të parandaluar humbjen e vlerës, me ç’rast i është ndaluar të dënuarit Florim Zekaj dhe çdo personi tjetër të ndërmerr çfarëdo veprimi për shitjen, transferimin, dhurimi apo çfarëdo veprimi tjetër për tjetërsimin apo uljen e vlerës për pasurinë e njësisë së objektit numër ..., shtëpi familjare me sipërfaqe prej 250 m^2 dhe objekt komercial 110 m^2, që gjendet në adresën rr. “...” ..., Zona Kadastrale .... I cili urdhër ka efekt për Odën e Noterëve të Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës - Drejtoria e Kadastrit në Komunën e ..., Oda e Përmbaruesve Privat, Oda e Ndërmjetësuesve të Kosovës dhe çdo pale apo institucioni tjetër që pranon urdhër dhe i cili urdhër mbetet në fuqi deri në ndryshimin apo anulimin e tij nga ndonjë urdhër tjetër i gjykatës.

2. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

   Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktvendimin PN.S.Nr.80/2024 të datës 11.03.2025, ka aprovuar si të bazuar

ankesën e mbrojtësit të të dënuarit Florim Zekaj avokatit Ramadan Shatri duke ndryshuar urdhrin kufizues përfundimtar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktvendimin PNDS.Nr. 6/2024 të datës 22.10.2024 për lëshimin e urdhrit kufizues përfundimtar dhe duke shfuqizuar urdhrin kufizues përfundimtar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PNDS.Nr.6/2024 të datës 22.10.2024, me të cilin ishte caktuar masa e përkohshme për sigurimin e pasurisë: hapa të arsyeshëm për të mirëmbajtur pronën dhe ekuivalentin e saj dhe për të parandaluar humbjen e vlerës, me ç'rast i është ndaluar të dënuarit Florim Zekaj dhe çdo personi tjetër të ndërmerr çfarëdo veprimi për shitjen, transferimin, dhurimi apo çfarëdo veprimi tjetër për tjetërsimin apo uljen e vlerës për pasurinë e njësisë së objektit numër 30610881, shtëpi familjare me sipërfaqe prej 250 $m^{2,}$ dhe objekt komercial 110 m^2 , që gjendet në adresën rr. "..." ...., Zona Kadastrale I.. Urdhër me efekt për Odën e Noterëve të Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës - Drejtoria e Kadastrit në Komunën e I., Oda e Përmbaruesve Privat, Oda e Ndërmjetësuesve të Kosovës dhe çdo pale apo institucioni tjetër që pranon urdhër dhe i cili urdhër mbetet në fuqi deri në ndryshimin apo anulimin e tij nga ndonjë urdhër tjetër i gjykatës.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

   Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit Nr.06/L-87 - për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë nga neni 17 par.1 i këtij ligji, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të prishë aktvendimin e Gjykatës së Apelit e Kosovës - Departamenti Special, PN.S.Nr.80/2024 të datës 11.03.2025 dhe çështjen t'ia ktheji në rivendosje në të njëjtën gjykatë.

4. Mendimi i mbrojtësit të të dënuarit

   Mbrojtësi i të dënuarit, avokati Ramadan Shatri, me shkresën e datës 27.06.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të hudhet si e palejuar apo të refuzohet si e pabazuar.

5. Pretendimet e paraqitura në kërkesë

a. Në kërkesë fillimisht është potencuar kronologjia e kësaj çështje gjyqësore duke theksuar faktin se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për lëshimin e urdhrit kufizuar përfundimtar të pasurisë dhe pretendohet se gjykata e shkallës së dytë me rastin e konstatimit se urdhri kufizues përfundimtar është lëshuar pa aktvendim për inicimin e hetimit për konfiskim për faktin se procedura nuk është zbatuar në përputhje me dispozitën e nenit 17 par.1 nënpar.1.5 të Ligjit Nr.06/L-87 - për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Ngase dispozita në fjalë përdorë shprehjen mund dhe jo duhet dhe se ky formulim sugjeron një mundësi dhe jo detyrim për prokurorin e shtetit , pra shprehja mund i jep Prokurorit të Shtetit diskrecion për të vendosur nëse do të inicioj një hetim për konfiskim, pra paraqet mundësinë dhe jo detyrimin për veprimin e prokurorit të shtetit nëse ka dyshime se pasuria mund të jetë përfituar në mënyrë të paligjshme.
b. Pretendohet se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka gjetur se në procedure janë respektuar afatet kohore të përcaktuara me Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë ngase aktgjykimi me të cilin i dënuari është shpallur fajtor ka marrë formën e prerë me datë 29.07.2019, ndërsa kërkesa për verifikimin e pasurisë nga ana e PSRK-së, është dorëzuar me datë 27.06.2024, që nënkupton se kërkesa është bërë brenda afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën e nenit 4 par.1, nënpar.1.5.1 të LKZK-së, e po ashtu është respektuar edhe dispozita e nenit 3 par.1 nënpar.1.5.1 të LKZK-së, duke përcaktuar se pasuria e dyshuar duhet të jetë e regjistruar ose e fituar brenda një periudhe kohore 10 vjeçare para fillimit të hetimeve e që në shkresat e lëndës rezulton se pasuria në fjalë është regjistruar në vitin 2007 dhe 2009 e që nënkupton se kërkesa është brenda afatit ligjor, kurse kjo masë është shumë e rëndësishme dhe e nevojshme me qëllim të parandalimit të shitjes dhe tjetërsimit të pronave nga i dënuari apo personat tjerë.
c. Në vazhdim të kërkesës theksohet fakti se masa e përcaktuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë ka pasur qëllim mirëmbajtjen e pronës ose ekuivalentin e saj për të parandaluar humbjen e vlerës dhe duke ndaluar ndërmarrjen e çfarëdo veprimi për tjetërsimin apo humbjen e

vlerës së pasurisë e përveç kësaj pasuria mbetet në dispozicion për konfiskim në të ardhmen pas vlerësimit të kërkesës për verifikimin e pasurisë dhe ka efekt në ndalimin e shitjes apo tjetërsimit deri në përfundim të procedurës sipas kërkesës për verifikimin e pasurisë. Për më tepër, nga shkresat e kësaj çështje vërtetohet fakti se i dënuari mes tjerash është dënuar edhe për veprën penale shpëlarja e parave nga neni 32 par.2.1 dhe 2.2 të Ligjit 03/L-196 që është vepër penale e përcaktuar me dispozitën e nenit 2 par.1 të LKZK-së, e për rrjedhojë pasuria e tij mund të i nënshtrohet konfiskimit pavarësisht faktit se nuk ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor ose i konfiskimit në procedurë ku është dënuar e gjithashtu pasuria e propozuar për masën e urdhrit kufizues përfundimtar është e regjistruar në emër të tij. Mbrojtja në këtë fazë nuk ka parashtruar asnjë provë se kjo pasuri i përket personave tjerë ose nuk është pasuri e të dënuarit edhe pse kishte detyrim ligjor, kurse pretendimi se kjo pasuri nuk mund të i nënshtrohet konfiskimit ngase kjo pronë është blerë në vitin 1999, pra shumë kohë para se i dënuari të dënohej dhe i cili pretendim nuk gjen mbështetje në prova.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:
   - kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i prokurorit të shtetit është i pabazuar, ngase aktvendimi i kundërshtuar nuk përmbajnë shkelje të pretenduara. Në rastin konkret nuk është i bazuar pretendimi, siç është theksuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë se me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë janë bërë shkelje për të cilat pretendohen.

3. Gjykata e shkallës së dytë bazuar në provat e administruara ka marrë aktvendim për ndryshimin e masës së urdhrit kufizues përfundimtar dhe refuzimin e kërkesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së

Kosovës e evidentuar me numrin PPS.Nr.44/2013 të datës 27.06.2024 duke shfuqizuar urdhrin kufizues përfundimtar duke arsyetuar në faktin se kjo kërkesë ishte në kundërshtim me dispozitën e nenit 17 par.1, nënpar.1.5 të LKZK-së, dhe atë përkundër faktit se ishin plotësuar kushtet ligjore, përveç mungesës së bazës për urdhër të tillë nga fakti se nuk ishte marrë aktvendim për inicimin e hetimit për konfiskim dhe i cili kusht theksohet se është i rëndësishëm për të garantuar respektimin e të drejtave procedurale dhe për të shmangur vendime të paarsyetuara ose arbitrare, përkatësisht procedura në këtë rast nuk ishte formalizuar me aktvendim për inicimin e hetimeve për konfiskim. Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kjo padyshim se paraqet një interpretim të gabuar të dispozitës ligjore të nenit 17 par.1, nënpar.1.5 dhe par.2 të LKZK-së, meqë e njëjta në mënyrë eksplicite ka përcaktuar se për të kërkuar një urdhër për kufizues përfundimtar dhe për të paraqitur kërkesë për verifikim të pasurisë mund të inicioj një hetim për konfiskim e që kjo nuk lë dyshim se shprehja mund paraqet një mundësi për Prokurorinë e Shtetit dhe jo detyrim të saj, pra i lë diskrecion të plotë Prokurorisë së Shtetit për inicimin apo jo të një hetimi për konfiskim dhe kjo varësisht prej situatës konkrete dhe në asnjë rrethanë nuk do të duhet të interpretohet si ndalesë absolute se mos inicimi i hetimit paraqet ndalesë për paraqitjen e urdhrit kufizues përfundimtar. Kjo edhe për faktin se urdhri kufizues përfundimtar ka për qëllim sigurimin e mos tjetërsimit të pasurisë deri te konfiskimi eventual i saj, përkatësisht që të mos kemi një proces të konfiskimit e në anën tjetër pasuria e cila është objekt i konfiskimit të tjetërsohet.

4. Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës përmes këtij aktgjykimi do të shqyrtoj dhe të paraqes konkludime përkitazi me dy segmente të rëndësishme të cilat do të shërbejnë me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore dhe atë: së pari në përmbajtjen e kërkesës së Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, propozimin e saj dhe bazës ligjore për kthimin e çështjes në rivendosje. Nga përmbajtja e kërkesës del se, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka paraqitur kërkesë për anulimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe kthimin e çështjes në rivendosje në të njëjtën gjykatë dhe duke përcaktuar bazën ligjore për

shkelje të zakonshme të dispozitës së nenit 17 par.1, nënpar.1.5 të Ligjit Nr.06/L-87 - për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.

5. Mirëpo, veprimi i tillë i Gjykatës Supreme të Kosovës, përkatësisht anulimi i aktvendimit dhe kthimi i çështjes në rivendosje është i kufizuar vetëm në dy situata: kur vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë. Kurse, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përveç propozimit për anulim nuk ka argumentuar se në rastin konkret cilat janë shkeljet që aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë e karakterizojnë si vendim qartazi të papërshtatshëm ose të bazuar në gabim të rëndë, por të gjitha pretendimet dhe argumentet e paraqitura theksojnë shkelje të natyrës së zakonshme të dispozitës së nenit 17 par.2 të LKZK-së, përkatësisht interpretim të gabuar të kësaj dispozite nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

6. Mbi këtë bazë, vlerësojmë se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të kishte në fokus të shkeljes qartësimin e pretendimit dhe evidentimin e shkeljeve se vendimi i kundërshtuar është vendim qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë, meqë nga interpretimi i dispozitës së nenit 438 par.2 të KPP-së, në parim Gjykata Supreme e Kosovës vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, kurse vetëm në situata përjashtuese e ligjvënësi ka përdorur shprehjen përveç (në vendimet qartazi të papërshtatshme ose të bazuara në gabime të rënda), atëherë mund të vjen në shprehje aplikimi i propozimit të theksuar nga ana e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që çështja të kthehet në rivendosje. Për më tepër, bazuar në konceptin e përgjithshëm të dispozitave të procedurës penale është në barrën e prokurorisë së shtetit evidentimi dhe bërja e besueshme e fakteve se gjykata në rastin konkret ka nxjerrë vendim qartazi të papërshtatshëm apo vendimin e tyre e kanë bazuar në gabim të rëndë dhe kjo në ndërlidhje me dispozitën e nenit 436 par.1 të KPP-së, me ç'rast është përcaktuar se: "*...Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon*". Përtej kësaj, në kërkesën për mbrojtjen e

ligjshmërisë të paraqitur nga ana e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, përveç mungesës së arsyetimit përkitazi me bazën për shkeljet se vendimi është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabime të rënda i mungon edhe formalisht potencimi i kësaj dispozite ligjore (neni 438 par.2 i KPP-së), pra fare nuk ceket në kërkesë, andaj Gjykata Supreme e Kosovës mbetet në të njëjtën linjë me aktgjykimet e saj PML.Nr.25/2025, më 24 shkurt 2025 dhe PML.Nr.46/2025 të datës 03 shkurt 2025, se shkeljet e pretenduara duhet të argumentohen nga ana e paraqitësit të kërkesës dhe në asnjë rrethanë këto shkelje të evidentohen dhe të përcaktohen nga ana e kësaj gjykate, meqë kjo do të cenonte barazinë e palëve në procedurë e përcaktuar me dispozitën e nenit 9 të KPP-së.

7. Gjithashtu ky aktgjykim është edhe në frymën e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për rastet e bashkuara Nr. KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23, me ç'rast është theksuar fakti se "*...neni 438 paragrafi 2 i KPP-së, duhet interpretuar në kuadër të garancive procedurale të përcaktuara në nenet 29 dhe 31 të Kushtetutës dhe nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së*", respektivisht, Gjykata Supreme e Kosovës duhet të ketë parasysh normat kushtetuese, përfshirë nenit 53 të Kushtetutës që përcakton se interpretimi i të drejtave të njeriut bëhet në pajtim me vendimet e GJEDNJ-së, detyrim ky që vlen për të gjitha gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën Supreme të Kosovës dhe se vendosja në dëm të të pandehurit, vjen në shprehje vetëm në raste shumë përjashtimore e që këto përjashtime mund të zbatohen vetëm në raste të shkeljeve serioze të ligjit nga gjykatat më të ulëta, kurse në rrethana të tjera, Gjykata Supreme e Kosovës, duhet t'i përmbahet parimit që vendimi në dëm të të pandehurit, ka vetëm efekt deklarativ, mirëpo i cili efekt nuk ka mundur të zbatohet në këtë aktgjykim për shkak të mungesës së propozimit të tillë nga ana e parashtruesit të kërkesës.

8. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.387/2025, datë 17.07.2025

''Ky rast është i rëndësishëm për faktin e konfiskimit të mjetit me të cilin janë transportuar mallrat e kontrabanduara dhe si rezultat i kësaj Gjykata Supreme e Kosovës ka konkluduar se në rastin konkret është brenda suazave ligjore konfiskimi i automjetit.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës Themelore
   Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Leposaviç, me aktgjykimin P.Nr.76/2024 e datës 03.09.2024, të dënuarin Senad Emroviç e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën kohore prej 1 (një) viti. I dënuarit është obliguar në pagesën e shumës prej 30 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 € në fondin për kompensimin e viktimave të krimit. Në kuptim të nenit 311 par.7 të KPRK-së dhe neneve 269 dhe 270 të KPP-së të dënuarit i është konfiskuar automjeti i tipit ..., ..., me numër të shasisë ..., ngjyrë e ..., me targa të regjistrimit ..., çelësi i veturës dhe dokumenti i regjistrimit.

2. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës
   Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.Nr.1719/2024 e datës 14.04.2025, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i dënuarit, avokati Sabit Pllana nga ..., për shkak të shkeljeve të procedurës penale, shkeljes të ligjit penal, vendimit mbi shqiptimin e sanksionit penal dhe vendimit për konfiskimin e sendeve, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshohen aktgjykimet e

kundërshtuara në atë mënyrë që të e liroj automjetin e konfiskuar apo çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë për shkak të mungesës së aktvendimit për hetime.

4. Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit
   Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.Nr.208/2025 e datës 04.07.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

5. Pretendimet e paraqitura në kërkesë

a. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përmban shkelje të ligjit penal, përkatësisht interpretim të gabuar të nenit 311 par.7 të KPRK-së dhe kjo me rastin e konfiskimit të veturës së të dënuarit pasi që sipas kësaj dispozite ligjore për veprën penale për të cilën i dënuari është gjykuar nuk është përcaktuar konfiskimi i detyrueshëm, me ç'rast është bërë krahasimi i dispozitave ligjore ku është përcaktuar konfiskimi obligativ e që nuk është edhe në rastin konkret. Pretendohet se në këtë rast ligjvënësi nuk ka paraparë, por as praktika gjyqësore nuk ka përcaktuar konfiskim të detyrueshëm, por i lë mundësinë gjykatës që brenda diskrecionit të saj të konfiskoj sendin e që me këtë rast duhet ti ketë parasysh disa aspekte dhe atë karakteristikat e automjetit i cili është për përdorim personal dhe se nuk ka karakteristika të përshtatshme për kontrabandim të mallrave, se automjetit nuk i është ndryshuar destinimi gjegjësisht përshtatja për kontrabandim të mallrave dhe se vlera e automjetit është më e lartë se shuma e mallit të kontrabanduar. Pra shuma e mallit të kontrabanduar është vlerësuar në 12.104.60 €, kurse vlera e tregut e automjetit të konfiskuar është 15.000-17.000 €.
b. Pretendohet se me rastin e konfiskimit është shkelur edhe neni 1 Protokolli 1 i KEDLNj, pasi që përmes këtij neni kërkohet balancimi mes interesave publik dhe të drejtave individuale dhe se masa e konfiskimit duhet të parashikohet me ligj, në funksion të interesit publik dhe proporcional në raport me qëllimin e ndëshkimit dhe se ndërhyrja jo proporcionale përbën ndërhyrje të tepruar e theksuar ehe përmes vendimit të GJEDLNJ në rastin ... ... & ...ë dhe ... & ..., me

ç'rast është konstatuar se konfiskimi nuk mund të jetë qëllim në vetvete, por rezultat i një analize të drejtë të proporcionalitetit dhe nevojës reale të shtetit për ndërhyrje.

c. Në vijim të kërkesës pretendohet për shkelje të natyrës procedurale duke u theksuar fakti se Prokuroria nuk ka përmbushur detyrimin e saj ligjor duke mbledhur prova dhe dorëzuar aktakuzën pa aktvendim për fillim të hetimit e që kjo bie ndesh me dispozitat në fjalë dhe aktgjykimin me shkelje procedurale. Gjithashtu urdhri për konfiskim nuk përmban elementet e kërkuara e posaçërisht vlerën monetare të pasurisë, përkatësisht nuk është përcaktuar vlera monetare e pasurisë së konfiskuar sipas vlerës reale të tregut dhe gjithashtu nuk është potencuar qëllimi i konfiskimit a përbën përfitim të paligjshëm apo objekt të padeklaruar që paraqet cenim të drejtpërdrejtë të pronës e kjo duke u ndërlidhur me personalitetin e të dënuarit i cili për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin dhe se duke pasur parasysh faktin se sipas teorisë bashkëkohore edhe konfiskimi është sanksion penal, atëherë del se nuk janë trajtuar edhe rrethanat lehtësuese.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

   - kërkesa nuk është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

3. Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit fillimisht duhet theksuar faktin se i dënuari në shqyrtimin fillestar kishte bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara, pranimi i fajësisë është aprovuar. Në dritën e

kësaj është e rëndësishme të potencohet fakti se nga shkresat e lëndës, përkatësisht procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, del se i dënuari në prezencë të mbrojtësit të tij dhe në mënyrë vullnetare ka bërë pranimin e fajësisë duke u njoftuar edhe për pasojat e pranimit të fajësisë e që mes pasojave të pranimit të fajësisë ishte edhe propozimi në aktakuzë për konfiskimin e automjetit i cili kishte shërbyer për kryerjen e veprës penale, ashtu që gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar se pranimi i fajësisë ishte në harmoni të plotë me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së, përkatësisht edhe për pasojat e tij.

4. Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimet e theksuara përkitazi me konfiskimin e automjetit të *tipit "...", ..., me numër të shasisë* ..., ngjyrë e ..., me targa të regjistrimit ... dhe faktin se me dispozitën e nenit 311 par.7 të KPRK-së nuk është përcaktuar konfiskimi obligativ i automjetit, vlerësoj se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal nga ana e gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore dhe kjo përkundër faktit se dispozita ligjore nuk ka përcaktuar konfiskim të detyrueshëm.

5. Megjithatë me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është paraqitur arsyetim i hollësishëm se konfiskimi i automjetit është bërë krahas dispozitave të ligjit penal (neni 311 par.7 të KPRK-së) gjithashtu janë aplikuar edhe dispozitat e neneve 269 par.1 dhe 270 par.1 të KPP- së. Në rastin konkret me dispozitat e lartë cekura është përcaktuar konfiskimi në rastet kur provohet se pasuria ishte mjet i kryerjes së veprës penale për të cilën i dënuari është gjykuar. Për më tepër, me dispozitën e nenit 19 par. 1 nënpar.1.38 të KPP-së është definuar shprehja mjet i veprës penale, me ç'rast është përcaktuar se: "Mjet i veprës penale – nënkupton: Pasuritë e përdorura për kryerjen e ndonjë veprimi në drejtim të veprës penale, përfshirë pasurinë e përdorur për të udhëtuar në apo nga vendi në të cilin është kryer ndonjë element i veprës penale, pavarësisht nëse mjetet e transportit janë përshtatur për të lehtësuar kryerjen e veprës penale ose jo".

6. Nga këndvështrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës del se mjetet për kryerjen e veprës penale nuk është e domosdoshme të përshtaten për

kryerjen e veprës penale, siç pa bazë pretendon mbrojtësi i të dënuarit, e gjithashtu nuk është i rëndësishëm përcaktimi i vlerës së sendit të konfiskuar në raport me vlerën e sendeve të kontrabanduar, por e rëndësishme është fakti se mjeti në fjalë ka shërbyer për qëllim të veprës penale, andaj në asnjë rrethanë nuk del se me rastin e konfiskimit është cenuar proporcionaliteti dhe se ndërhyrja, përkatësisht konfiskimi konsiderohet legjitim i parashikuar me dispozita ligjore dhe në funksion të interesit të përgjithshëm dhe me këtë rast nuk cenohet as neni 1 i Protokollit 1 të KEDLNJ, meqë edhe sipas kësaj dispozite por edhe standardeve të përcaktuara nga ana e GJEDNJ theksohet fakti se ndërhyrja në pronë mund të bëhet në interes të përgjithshëm dhe në kushte të parapara me ligj, kurse në rastin konkret të dy këto parime janë përmbushur pasi që është potencuar interesi i përgjithshëm dhe njëkohësisht konfiskimi është i parashikuar përmes dispozitave të përcaktuara të KPRK-së dhe KPP-së.

7. Gjykata Supreme e Kosovës duke u bazuar në shkresat e lëndës konstatoi se prokurori i çështjes kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimit me datën 03.11.2023 dhe i cili aktvendim gjendet në shkresat e kësaj çështje, andaj pretendimi në fjalë del të jetë i pabazuar.

8. Gjykata Supreme e Kosovës ka vërejtur faktin se kërkesës i janë bashkëngjitur aktgjykimet e kësaj gjykate: PML.Nr.178/2022 i datës 16.05.2022, PML.Nr.44/2023 i datës 08.03.2023 dhe PML.Nr.289/2023 i datës 26.06.2023 si referencë se me rastin e konfiskimit Gjykata Supreme e Kosovës kishte gjetur shkelje nga gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore, me ç'rast në njërin rast automjeti ishte kthyer, kurse në dy raste aktgjykimet ishin anuluar. Mirëpo, duke vlerësuar aktgjykimet e cekura më lartë del se këto raste nuk kanë ngjashmëri, siç pa të drejtë pretendohet në kërkesë, rasti PML.Nr.289/2023 i datës 26.06.2023 është kthyer në rigjykim për shkak të arsyetimit të pamjaftueshëm e që kjo nuk ka ndodhë edhe në këtë çështje penale pasi që siç është cekur edhe në pjesën e epërme të këtij aktgjykimi përmban arsyetim të hollësishëm përkitazi konfiskimit, kurse dy rastet tjera (PML.Nr.178/2022 i datës 16.05.2022, PML.Nr.44/2023 i datës 08.03.2023) del se automjetet

përkatëse kanë pasur pronar personat e tretë dhe jo personin e dënuar, siç është rasti në këtë çështje penale.

9. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.726/2024, datë 05.02.2025

’’Ky rast është i rëndësishëm për faktin se në mënyrë të gabuar ka vepruar gjykata e shkallës së dytë duke ri cilësuar veprën penale nga vepra penale *keqpërdorimi seksual i personit nën moshën 16 vjeçare nga neni 235 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së në veprën penale ngacmimi seksual nga neni 183 par.1 të KPRK-së* dhe me këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës ka konkluduar se në rastin konkret gjykata e shkallës së dytë ka vepruar në mënyrë të gabuar duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën për ligjin më të favorshëm.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i Gjykatës Themelore
   Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për të Mitur, me aktgjykimin PKR.Nr.57/2019 e datës 27.02.2024, të dënuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare nga neni 235 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 150 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 50 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

2. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës
   Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për të Mitur, me aktgjykimin PAKR.Nr.281/2024 e datës 21.08.2024, ka aprovuar kërkesën e mbrojtëses së të dënuarit dhe sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dënuarin duke e shpallur fajtor për shkak të veprës penale ngacmimi seksual nga neni 183 par.1 të KPRK-së dhe duke e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, kurse pjesët e tjera të aktgjykimit kanë mbetur të paprekura.

3. Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kanë paraqitur:

- mbrojtësja i të dënuarit, avokate NN nga Prishtina, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulon dhe çështjen të e kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë; dhe

- i pandehuri për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe aktgjykimet e kundërshtuara t'i ndryshon dhe çështjen të e vendos në favor të të pandehurit.

4. Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit
   Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.Nr.412/2024 e datës 26.11.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

5. Pretendimet e paraqitura në kërkesa

a. Në kërkesën e mbrojtëses së të dënuarit pretendohet për shkelje të ligjit penal nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, kjo për faktin se kjo gjykatë e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar të dënuarin për shkak të veprës penale keqpërdorimi seksual i personit nën moshën 16 vjeçare nga neni 235 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së duke i shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, me arsyetim se kishte gjetur se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale në fjalë. Mirëpo pretendohet se gjykata e shkallës së parë me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të e mbështes vendimin e saj ngase në veprimet e të dënuarit nuk janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale të cilat i janë vënë në barrë. Për më tepër, këtë e ka vërtetuar edhe gjykata e shkallës së dytë e cila me aktgjykimin e saj sipas detyrës zyrtare ka vlerësuar se kemi të bëjmë me shkelje të ligjit

penal në dëm të të dënuarit, përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, për faktin se nga përshkrimi ligjor rezulton se në veprimet e të dënuarit nuk manifestohen elementet e veprës penale për të cilat është gjykuar dhe shpallur fajtor.

b. Në kërkesën e të pandehurit pretendohet se në këtë çështje penale është shkelur ligji penal nga ana e gjykatës së shkallës së dytë pasi që rrjedhimisht vepra penale më të cilën është dënuar i pandehuri nuk ka ekzistuar fare në kohën në të cilën pretendohet se është kryer. Pretendohet se në mënyrë të drejtpërdrejtë gjykata e shkallës së dytë ka shkelur ligjin penal, respektivisht dispozitën e nenit 3 par.2 të KPRK-së, pasi që vepra penale e ri cilësuar nuk ishte paraparë si vepër penale, respektivisht veprimet e të njëjtit në këtë kohë sipas aktakuzës apo aktgjykimeve nuk janë sanksionuar me ligj.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesa, gjeti se:

   - kërkesat janë të bazuara.

2. Gjykata Supreme e Kosovës duke shqyrtuar pretendimet e paraqitura në kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë përkitazi me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë në tërësi pajtohet me pretendimet e theksuara se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë është shkelur ligji penal i përcaktuar me dispozitë e nenit 385 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, pasi që vepra për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor dhe është gjykuar nuk ishte e inkriminuar si vepër penale në kohën kur i pandehuri kishte kryer veprimet inkriminuese.

3. Nga shkresat e kësaj çështje penale del se gjykata e shkallës së parë të pandehurin e kishte shpallur fajtor dhe e kishte gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, për shkak të veprës penale keqpërdorimi seksual i personit nën moshën 16 vjeçare nga neni 235

par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, me ç'rast kishte zbatuar ligjin që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, përkatësisht Kodin Nr.04/L-082. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë në faqen e tetë të aktgjykimit të saj kishte refuzuar pretendimin e mbrojtëses së të dënuarit për ricilësimin e veprës penale. Mirëpo, përkundër kësaj gjykata e shkallës së dytë duke vepruar sipas ankesës së mbrojtëses së të pandehurit dhe sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dënuarin duke e shpallur fajtor për shkak të veprës penale ngacmimi seksual nga neni 183 par.1 të KPRK-së dhe duke e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, me ç'rast si ligj penal më të favorshëm ka aplikuar Kodin 06/L-074 e që me këtë rast ka shkelur ligjin penal në dëm të të pandehurit.

4. Gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e aktgjykimit të saj në mënyrë të qartë e potencon faktin se vepra penale e ricilësuar (vepra penale ngacmimi seksual) nuk ka ekzistuar në Kodin e mëparshëm penal, gjegjësisht në kohën kur i pandehuri kishte kryer veprimet inkriminuese, megjithatë kishte aplikuar këtë dispozitë ligjore në mënyrë krejtësisht të gabuar dhe arbitrare duke bërë interpretim të gabuar dhe fragmentar vetëm të dispozitës së nenit 3 par.2 të KPRK-së dhe duke anashkaluar interpretimin e tërësishëm të dispozitës ligjore e cila rregullon në mënyrë të detajuar zbatimin e ligjit më të favorshëm, e që si rezultat i këtij interpretimi të gabuar të pandehurin e shpallë fajtor dhe e gjykon për një vepër penale e cila nuk ishte ekzistuese në kohën e kryerjes së veprimeve nga ana e të pandehurit.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se dispozita ligjore e nenit 3 të KPRK-së ka normuar zbatimin e ligjit më të favorshëm duke përcaktuar se:

"*1. Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.*

2. Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.

3. Nëse ligji i ri nuk e inkriminon veprën, por kryesi është dënuar me aktgjykim të formës së prerë në pajtim me ligjin e mëparshëm, sanksioni penal nuk fillon të ekzekutohet ose ndërpritet në rast se ka filluar.

4. Një ligj i cili shprehimisht ka qenë në fuqi vetëm për një kohë të caktuar, zbatohet për ato vepra penale që janë kryer gjatë kohës kur ai ligj ka qenë në fuqi edhe në rastin kur nuk është më në fuqi, përveç nëse vetë ligji shprehimisht përcakton ndryshe."

6. Me këtë rast gjykata e shkallës së dytë pa analizuar paragrafin e parë të nenit të sipër cituar i cili ka përcaktuar se ndaj kryerësit zbatohet ligji që është në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale e që nënkuptohet se nuk do të mund të zbatohet asnjë ligj tjetër i cili nuk ishte në fuqi, meqë kjo paraqet edhe parimin bazë të aspektit penal. Përtej kësaj, gjykata e shkallës së dytë ka bërë interpretim tërësisht arbitrar të dispozitës vijuese gjegjësisht nenit 3 par.2 të KPRK-së, meqë kjo dispozitë nuk aplikohet në rastet kur ligji penal paraprak nuk ka paraparë fare veprimin inkriminues si vepër penale. Në parim aplikimi i kësaj dispozite bëhet ekskluzivisht në rastet kur kemi inkriminim e dyfishtë, pra në të dy kodet penale edhe në kodin që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale e po ashtu edhe në kodin e ri që hyn në fuqi pas kryerjes së veprës penale dhe pastaj i mundësohet gjykatës përkatëse që të bëj krahasime mes këtyre dy kodeve që inkriminojnë veprimin e tillë dhe pa marrë parasysh emërtimin e veprave penale (por duhet çmuar veprimet inkriminuese) dhe tek atëherë përcaktohet aplikimi i ligjit më të favorshëm.

7. Interpretimi fragmentar në këtë mënyrë siç ka bërë gjykata e shkallës së dytë, përkitazi me ligjin më të favorshëm bie në kundërshtim edhe me paragrafin vijues, gjegjësisht paragrafin e tretë të saj, me ç'rast në mënyrë imperative është përcaktuar se nëse vepra penale nuk inkriminohet në kodin e ri, atëherë edhe sanksioni i shqiptuar penal i shqiptuar nuk ekzekutohet dhe nëse ka filluar ekzekutimi atëherë ndërpritet, kjo për faktin se nuk inkriminohet si vepër penale e që në mënyrë të qartë dhe të plotë paraqet intencën e ligjvënësit se si të veprohet në këto raste dhe njëkohësisht interpretimin totalisht të

gabuar të kësaj dispozite nga ana e gjykatës së shkallës së dytë duke aplikuar një dispozitë ligjore e cila fare nuk ka inkriminuar sjelljen e tillë si vepër penale.

8. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje të ligjit penal dhe për këtë arsye u vendos që konform nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.259/2025, datë 08.05.2025

"Mos vlerësimi i pretendimeve thelbësore të palëve nga Gjykata e Apelit e Kosovës, përveç që përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, paraqet edhe shkelje të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë
   Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, P.Nr.582/2024, datë 11.06.2024, i dënuari S. S. është shpallur fajtor për shkak të veprave penale "Dhuna në familje", nga neni 248, paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së (pika I. e dispozitivit) dhe "Kanosja", nga neni 181, paragrafi 2 të KPRK-së (pika II. e dispozitivit). Për shkak të veprës penale nga pika I. e dispozitivit, ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, kurse për shkak të veprës penale nga pika II. e dispozitivit të aktgjykimit, është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) euro, ndërsa në kuptim të nenit 76, paragrafët 1 dhe 2, nën-paragrafi 2.4. të KPRK-së, ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej tetëqind (800) euro, dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 16.05.2024 deri më 11.06.2024. Dënimin me gjobë, i dënuari do ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa në rast të mos pagesës, i njëjti do të zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që çdo njëzet (20) euro e dënimit me gjobë do të zëvendësohet me një (1) ditë dënim me burgim. Është detyruar i dënuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sado të bëhen ato, në bazë të llogaritjes së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej njëzet (20) euro, kurse në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej

njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. Palët e dëmtuara – B. S. dhe I. N., që të dy nga f. M., k.e P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civilo-juridik.

2. Vendimi i gjykatës së shkallës së dytë
   Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.Nr.1485/2024, datë 25.02.2025 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur:
   - mbrojtësi i të dënuarit X.X., avokati L. V. ku nga përmbajtja e kërkesës, shihet se është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit për shqiptimin e sanksioneve penale, duke propozuar që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa të ndryshohen aktgjykimet e kundërshtuara apo të njëjtat të anulohen.

4. Përgjigja në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë
   Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.Nr.138/2024, datë 06.05.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

5. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës
   Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoi se:

   - kërkesa është e bazuar.

6. Pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Mbrojtësi i të dënuarit X. X., pretendon se gjykata e shkallës së dytë nuk ka shqyrtuar pretendimet e paraqitura në ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, sa i përket çështjes së paligjshmërisë së rrethanës rënduese që është marrë për bazë me rastin e matjes së dënimeve, e që i referohet të kaluarës penale të të dënuarit. Thekson se gjykata e shkallës së dytë nuk ka shqyrtuar fare pretendimin e mbrojtjes se gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë si rrethanë rënduese faktin se i dënuari ka të kaluar penale, duke qenë se i njëjti më parë është shpallur fajtor për vepra penale sipas aktgjykimeve P.Nr.362/2007, P.Nr.129/2011 dhe P.Nr.566/2014 dhe është dënuar me gjobë dhe me kusht, vepra penale këto të kryera para 17, përkatësisht 13 vjetëve, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 93, paragrafi 2 të KPRK-së, dispozita ligjore, këto që ju referohen pasojave juridike të dënimit. Gjithashtu, gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me nenin 98, paragrafi 2 të KPRK-së, ku është përcaktuar se nga dosja penale mund të zbulohen vetëm dënimet të cilat nuk janë shlyer nga dosja penale, ndërsa në rastin konkret, janë zbuluar të dhënat për vepra penale që janë shlyer nga dosja penale. Sipas mbrojtësit, për të gjitha këto çështje, mbrojtja nuk ka marrë përgjigje, pasi që gjykata e shkallës së dytë nuk i ka trajtuar këto pretendime, edhe pse të njëjtat kanë qenë pretendime të paraqitura në ankesën kundër aktgjykimit.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit X. X., janë të bazuara, pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin lidhur me nenin 369, paragrafi 6 dhe nenin 404, paragrafi 1 të KPP-së. Kjo për faktin se gjykata në fjalë nuk ka vlerësuar dhe arsyetuar pretendimet thelbësore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, që i referohen pasojave juridike të dënimeve dhe zbulimit të të dhënave nga dosja penale, edhe pse këto aspekte, kanë qenë pretendime të

paraqitura edhe në ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

2. Gjykata Supreme e Kosovës edhe në këtë çështje penale e sheh të nevojshme që të sqaron se referuar nenit 404, paragrafi 1 të KPP-së, Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë ka përgjegjësinë që t'i vlerëson pretendimet e paraqitura në ankesë dhe të tregon shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare. Megjithatë, duhet theksuar se detyrimi i gjykatave (në këtë rast edhe i Gjykatës së Apelit të Kosovës) që të paraqesin arsye në vendimet përkatëse gjyqësore, nuk nënkupton përgjigje të hollësishme në çdo pretendim dhe argument të palëve, por që vëllimi dhe shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye, ndryshon varësisht nga natyra e vendimit gjyqësor dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të secilit rast veç e veç. Në këtë drejtim, është e rëndësishme që të sqarohet se janë argumentet thelbësore të palëve që duhet të adresohen dhe vlerësohen, ndërsa aspekte të tilla janë theksuar qartësisht edhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në praktikën e saj gjyqësore (rasti "H.B. kundër S.", aktgjykimi i datës 09.12.1994, paragrafi 27; rasti "V. de H. k. H.", aktgjykimi i datës 19.04.1994, paragrafi 61; rasti "H. dhe të tjerët kundër .F.", aktgjykimi i datës 19.02.1998, paragrafi 42; rasti "P. k. F.", aktgjykimi i datës 12.02.2004, paragrafi 81, etj.). Kurse, se çka konsiderohet argument dhe pretendim thelbësor, varet nga specifikat e secilit rast veç e veç, ndërsa në këtë çështje penale, rezulton se Gjykata e Apelit e Kosovës nuk i ka vlerësuar dhe shqyrtuar pretendimet kryesore dhe thelbësore të mbrojtësit të të dënuarit që janë ngritur në ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, por që është mjaftuar me disa arsyetime, në lidhje me rrethanat që janë që janë marrë për bazë me rastin e caktimit të dënimit, pa dhënë përgjigje në çështjet që kanë të bëjnë me pasojat juridike të dënimit dhe zbulimin e të dhënave nga dosja penale.

3. Në këtë mënyrë, bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, rezulton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, andaj edhe si rezultat i

kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovon si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e anuloi këtë aktgjykim, duke e kthyer çështjen në rigjykim. Kjo për faktin se shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilat është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur të evitohet nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në këtë gjykatë.

4. Në rigjykim, gjykata e shkallës së dytë duhet që t'i evitoj shkeljet e cekura më lart dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve thelbësore ankimore, të vendosë në mënyrë meritore, duke paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me këto pretendime dhe shkeljet tjera, për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare.

5. Duke u bazuar në këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara dhe në kuptim të nenit 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktvendim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.313/2025, datë 17.06.2025

"Nuk lejohet paraqitja e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është anuluar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, dhe çështja penale është kthyer në rigjykim në këtë gjykatë".

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë
   Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin P.Nr.126/2018, datë 02.05.2024, të akuzuarit Hysni Syla, Shaip Bujupi dhe Albulena Musliu, i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale "Shantazhi", nga neni 268, paragrafi 2 lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së dhe ndaj secilit prej të akuzuarve ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga dy (2) vjet burgim, të cilat dënime do të ekzekutohen, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Janë detyruar të akuzuarit që secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej njëqind (100) euro, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. I dëmtuari F. P. dhe përfaqësuesi i autorizuar i tij, avokati Bekim Kafexholli, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

2. Vendimi i gjykatës së shkallës së dytë
   Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PA1.Nr.1606/2024, datë 16.12.2024, i ka aprovuar ankesat e paraqitura nga: mbrojtësi i të akuzuarit Hysni Syla, avokati Besnik Berisha, i akuzuari Shaip Bujupi dhe mbrojtësja e të akuzuarës Albulena Musliu, avokatja Erina Berisha, kurse e ka anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e kthyer çështjen në rigjykim dhe vendim.

3. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë
   Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, për shkak të shkeljes së dispozitës ligjore të nenit 392, paragrafi 2 të

Kodit të Procedurës Penale (KPP), duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që ta anulon aktvendimin në fjalë dhe çështjen t'ia kthej në rivendosje gjykatës së shkallës së dytë.

4. Përgjigja në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë
   Në përgjigjen ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësi i të akuzuarit Hysni Syla, avokati Besnik Berisha, ka theksuar se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e papranueshme, pasi që nuk është përmbushur parakushti ligjor i ekzistimit të vendimit të formës së prerë, duke qenë se me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë, çështja është kthyer në rigjykim dhe procedura është në zhvillim e sipër.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:

   - kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e papranueshme.

2. Siç është cekur edhe më lart, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, e cila duke aprovuar ankesat e paraqitura nga mbrojtja, kishte anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim dhe vendim.

3. Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se duke u bazuar në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të ushtrohet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë.

4. Në rastin konkret, siç rezulton nga shkresat e çështjes, procedura penale nuk ka përfunduar me vendim të formës së prerë, por ajo ndodhet në fazën e shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë,

prandaj kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk është e lejuar. Në këtë mënyrë, është e rëndësishme të theksohet se vendimi i gjykatës së shkallës së dytë, me të cilin anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk e ka cilësinë e "vendimit gjyqësor të formës së prerë", në kuptim të nenit 432, paragrafi 1 të KPP-së, pasi që procedura penale është në vazhdim e sipër, kështu që kundër një vendimi të tillë nuk mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

5. Andaj, nga arsyet që janë theksuar më lart dhe në bazë të nenit 435, paragrafi 2 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.352/2025, datë 07.07.2025

"Fakti që i dënuari është shpallur fajtor edhe për dy (2) raste tjera të natyrës së njëjtë, nuk mund konsiderohet si provë mbi bazën e së cilës do të mund të vihet deri tek përfundimi se i dënuari është kryerës i veprës penale për të cilën është akuzuar, kjo pasi që një gjë e tillë do të mund të bie ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë, sipas nenit 3 paragrafi 1 të KPP-së dhe nenit 31 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E kaluara penale e të dënuarit, në kushtet e përcaktuara me dispozita ligjore, do të mund të merret për bazë me rastin e vlerësimit të kredibilitetit dhe besueshmërisë së deklarimit të të pandehurit dhe gjatë matjes së dënimit, mirëpo një aspekt i tillë nuk mund të shërben si provë për të përcaktuar fajësinë e të dënuarit për kryerjen e veprës penale. I pandehuri mund të jetë recidivist i shumëfishtë i veprave penale, por që mos të jetë fajtor për kryerjen e veprës penale tjetër që është duke u shqyrtuar".

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë
   Gjykata Themelore në Ferizaj - dega në Kaçanik, me aktgjykimin Nr.2024:120781, datë 01.08.2024, të dënuarin X. X., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale "Dhuna në familje", nga neni 248, paragrafi 1 të KPRK-së dhe e gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej tre (300) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej shtatëdhjeteshtatë (77) ditëve, në të cilin dënim, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 12.04.2024 deri më datën 28.06.2024. Është detyruar i dënuari që dënimin me gjobë ta paguajë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve, por jo më gjatë se dy (2) muaj, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë dhe atë në tre (3) këste. Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë, atëherë gjykata do t'ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur shumën prej njëzet (20) euro për çdo ditë të dënimit me burgim. Është detyruar i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro dhe shumën prej

njëzet (20) euro për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. E dëmtuara X. X. nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

2. Vendimi i gjykatës së shkallës së dytë
   Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin e theksuar më lart, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:
   - mbrojtësi i të dënuarit X. X., avokati E. D., për shkak të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore dhe shkeljes së ligjit penal, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që ta miratoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që dënuarin ta liroj nga akuza, ose aktgjykimet e lartcekura, të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim.

4. Përgjigja në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë
   Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.Nr.188/2025, datë 17.06.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

5. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës
   Gjykata Supreme e Kosovës, pas i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:- kërkesa është e bazuar.

6. Pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

a. Mbrojtësi i të dënuarit X. X., pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.7. të KPP-së, pasi që nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të KPP-së

dhe këto aktgjykime nuk janë hartuar në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 369, paragrafët 6 dhe 7, si dhe nenit 404, paragrafi 1 të KPP-së. Gjykata e shkallës së parë ka dështuar të jap arsyetim të qartë, të plotë dhe të arsyeshëm për secilin prej pretendimeve të parashtruara nga pala mbrojtëse, si dhe nuk është bërë analiza e pavarur e provave, meqë nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë provat që e kanë vërtetuar fajësinë e të dënuarit, dhe njëkohësisht nuk janë marrë parasysh provat të cilat e kanë vërtetuar pafajësinë e të dënuarit. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është mbështetur vetëm në deklarimin e të dëmtuarës, pa u shoqëruar me ekspertiza mjeko-ligjore, psikologjike, dëshmi të dëshmitarëve apo prova tjera materiale, duke cenuar kështu të drejtën për një proces të rregullt dhe të drejtë, ashtu siç parashihet në nenin 7 të KPP-së. Faktet vendimtare në këtë çështje penale kanë qenë nëse e dëmtuara, ditën kritike ka qenë e frikësuar apo vetëm e kishte lajmëruar policinë për të bërë të mundur dërgimin e të pandehurit në ekzaminim psikiatrik.

b. Në këtë çështje është pretenduar për dhunë fizike dhe dhunë psikologjike, mirëpo nuk është paraqitur asnjë provë materiale me të cilët dëshmohet dhuna fizike apo dhuna psikologjike. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar dhe arsyetuar pretendimet thelbësore të paraqitura në ankesën e datës 21.08.2024, të cilat i janë referuar të gjitha bazave ankimore, kurse gjykata në fjalë vetëm në mënyrë të përgjithësuar i ka shqyrtuar këto pretendime ankimore. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka e ka shqyrtuar fare pretendimin ankimor të paraqitur në faqen 2 të ankesës, që i referohet konstatimit të gjykatës së shkallës së parë të paraqitur në faqen 7 të aktgjykimit, ku është theksuar se "..., si dhe bazuar në evidencën e gjykatës, të kaluarën e tij, nga e cila vërtetohet se i pandehuri edhe më parë është gjykuar me aktgjykim të plotfuqishëm për dy raste të kësaj natyre, arrin në përfundimin se i pandehuri me veprimet e tij ditën kritike ka shkaktuar frikë dhe pasiguri tek e dëmtuara...". Sipas mbrojtësit, me këtë konstatim është shkelur parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi që kjo rrethanë e përdorur nga gjykata e shkallës së parë, e cila nuk është shqyrtuar fare nga gjykata e shkallës së dytë, ka ndikuar në vlerësim jo të drejtë të çështjes penale, pasi që aplikimi rrethanës se ka qenë dy herë më parë i dënuar me aktgjykime të formës së prerë është i gabuar

nga pikëpamja juridike, ndërsa dënimet e shqiptuara do të mund të përdoren vetëm për matjen e dënimit, por nuk mund të merren parasysh për të përcaktuar fajësinë.

c. Në këtë mënyrë, përdorimi i dënimeve të mëparshme, cenon të drejtën e të pandehurit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe është në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 2 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ndërsa një gjë e tillë, është konstatuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin PML.Nr.57/2023, datë 02.03.2023 (arsyetimi i aktgjykimit faqe ....). Përveç këtyre, gjykata e shkallës së dytë nuk ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera ankimore që ndërlidhen me gjendjen faktike, ku me këtë rast, janë bërë edhe shkelje tjera esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe është shkelur ligji penal, pasi që nuk janë përmbushur elementet përbërëse të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shikoi dhe analizoi të gjitha shkresat e lëndës ka ardhur në përfundim se pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit X. X. janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 6 dhe 7 të KPP-së, ndërsa këto shkelje, për shkak të natyrës së tyre, kanë ndikuar në drejtshmërinë dhe ligjshmërinë e këtij aktgjykimi.

2. Siç me të drejtë pretendon edhe mbrojtësi i të dënuarit, gjykata e shkallës së parë me rastin e konstatimit të fajësisë së të dënuarit, përveç tjerash, e kishte marrë për bazë faktin se i dënuari edhe më parë ishte shpallur fajtor për dy (2) raste penale të natyrës së njëjtë. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, pasi që fakti që i dënuari është shpallur fajtor edhe për dy (2) raste tjera të natyrës së njëjtë, nuk mund konsiderohet si provë mbi bazën e së cilës do të mund të vihet deri tek përfundimi se i dënuari është kryerës i veprës penale për të cilën është akuzuar, kjo pasi që një gjë e tillë do të mund të bie ndesh me parimin

e prezumimit të pafajësisë, sipas nenit 3, paragrafi 1 të KPP-së dhe nenit 31, paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E kaluara penale e të dënuarit, në kushtet e përcaktuara me dispozita ligjore, do të mund të merret për bazë me rastin e vlerësimit të kredibilitetit dhe besueshmërisë së deklarimit të të pandehurit dhe gjatë matjes së dënimit, mirëpo një aspekt i tillë nuk mund të shërben si provë për të përcaktuar fajësinë e të dënuarit për kryerjen e veprës penale. I pandehuri mund të jetë recidivist i shumëfishtë i veprave penale, por që mos të jetë fajtor për kryerjen e veprës penale tjetër që është duke u shqyrtuar. Gjithashtu, e kaluara penale e të pandehurit, përkatësisht fakti se i njëjti ka qenë i dënuar edhe më parë për vepra penale të caktuara, në kushtet e parashikuara me ligj, mund të jetë kriter përcaktues i kualifikimit juridik të veprave penale të caktuara (p.sh. vepra penale "Vrasja e rëndë", nga neni 173, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.12. të KPRK-së, në të cilën dispozitë ligjore është përcaktuar "privimi nga jeta i personit tjetër, nga kryesi i cili edhe më parë ka qenë i dënuar për vrasje, përveç veprave të cilat janë të parapara në nenin 174 dhe 176 të KPRK-së; vepra penale "Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge", nga neni 269, paragrafi 2 të KPRK-së kryhet në rastet kur "kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë, …", etj.), por nuk mund të trajtohet si provë vendimtare për të përcaktuar fajësinë e të pandehurit për kryerjen e veprës penale tjetër, siç është vepruar në rastin konkret.

3. Përveç që konstatimi i lartcekur nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore, edhe pjesa që i referohet të kaluarës penale të të dënuarit nuk është e qartë dhe e arsyetuar mjaftueshëm. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë është mjaftuar vetëm me konstatimin se i dënuari ka patur edhe dy (2) raste tjera, të cilat edhe ashtu janë marrë për bazë si rrethanë e posaçme rënduese me rastin e matjes së dënimit, mirëpo, nuk ka përcaktuar detaje tjera më të rëndësishme sa i përket këtyre dy (2) rasteve, siç janë: konkretisht veprat penale për të cilët është shpallur fajtor, të dhënat e aktgjykimeve (numri i lëndëve, data e marrjes, datat kur janë të bërë së formës së prerë, etj.), të dhëna në lidhje me dënimet e shqiptuara, nëse janë ekzekutuar dënimet dhe data kur i dënuari ka

mbajtur, përkatësisht paguar dënimin, nëse është fjala për dënimin me gjobë, nëse janë shlyer nga evidenca e të dënuarve, etj. Sa i përket kësaj çështje, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton dispozitën ligjore të nenit 69, paragrafi 4 të KPRK-së, në të cilën është përcaktuar se "Kur cakton dënimin për recidivistin, gjykata posaçërisht merr parasysh nëse kryesi më parë ka kryer vepër penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të dy veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur ose i falur".

4. Përveç këtyre, që u theksuan më lart, gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që të paraqes arsye të mjaftueshme në lidhje me mosmiratimin e propozimit konkret të palëve, në veçanti propozimin e mbrojtjes për caktimin e një eksperti nga lëmi i psikologjisë, për të vlerësuar aspekte psikologjike që ndërlidhen me dhunën psikologjike.

5. Përndryshe, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton parimin themelor të procedurës penale se "jo çdo propozim i palëve për administrimin e provave të caktuara duhet të detyrimisht që të aprovohet nga gjykata".

6. Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se është nën autoritetin e gjykatave që të vlerësojnë në çdo rast konkret, nëse duhet aprovuar apo jo propozimet e tilla, duke i pasur parasysh natyrën e çështjes dhe specifikat e saj, rëndësinë e provës, si dhe fakteve që pretendohet të vërtetohen përmes provës së propozuar. Përndryshe, në nenin 252, paragrafi 2 të KPP-së janë parashikuar situatat kur gjykata mund të mos e aprovojë propozimin e palëve për administrimin e provave të caktuara, por që gjykatat duhet që të paraqesin arsye konkrete dhe të mjaftueshme në lidhje me refuzimin e administrimit të provave tjera, gjë që në këtë rast nuk është vepruar në këtë mënyrë.

7. Po ashtu, siç rezulton edhe nga shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë e ka administruar dhe marrë për bazë si provë edhe deklarimin e të dënuarit të dhënë në polici më datë 12.04.2024, megjithatë nuk ka arritur që të vlerëson në mënyrën e duhur nëse një deklarim i tillë është siguruar në harmoni me dispozitat ligjore të KPP-së. Kjo për faktin se nga Raporti i Vlerësimit të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të

Kosovës, datë 13.05.2024, shihet që aftësia mendore e të dënuarit për të kuptuar rëndësinë e veprës, si dhe kontrolli ndaj veprimeve të tij ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale. Në këtë mënyrë, bazuar në nenin 56, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, i pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste nga marrja në pyetje për herë të parë e deri në përfundim të procedurës penale me vendim të formës së prerë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses, kurse nga procesverbali i datës 12.04.2024, nuk rezulton që i dënuari të ketë patur avokat mbrojtës, me të cilin do të mund të konsultohej në lidhje me këtë çështje penale.

8. Në këtë mënyrë, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovon si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të anulojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. Kjo për faktin se shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara më lart, me të cilat është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e të cilat nuk janë evituar as me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

9. Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitojë të gjitha shkeljet e lartcekura, duke administruar sërish të gjitha provat, ndërsa më pastaj, duke marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm për çdo pikë të aktgjykimit, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.
10. Duke u bazuar në këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar dhe në pajtim me nenin 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.414/2025, datë 21.08.2025

"Mos njoftimi i palëve për seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në rastet kur me aktgjykimin e gjykatës së shkallës parë është shqiptuar dënim me burgim, përveç që përbën shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, paraqet edhe shkelje të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë
   Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, P.Nr.511/2024, datë 29.04.2025, i dënuari Shahin Abdullahu, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale "Sulmi", nga neni 184, paragrafi 1 të KPRK-së dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqindepesëdhjetë (150) ditëve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Është detyruar që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej pesëdhjetë (50) euro, dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm. E dëmtuara B. I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

2. Vendimi i gjykatës së shkallës së dytë
   Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e theksuar më parë, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Mentor Neziri, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke propozuar që aktgjykimi në fjalë, të anulohet, ashtu që kjo çështje t'i kthehet në rigjykim kësaj gjykate.

4. Përgjigja në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë
   Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.Nr.221/2025, datë 16.07.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar.

5. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës
   Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:- kërkesa është e bazuar.

6. Pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që gjykata në fjalë është dashur që të cakton seancën e kolegjit dhe t'i ftojë palët për të parë pjesë në seancë, duke u bazuar në nenin 390, paragrafi 1 të KPP-së, duke qenë se ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim me burgim efektiv.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të bazuara, pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 390, paragrafi 1 të KPP-së, për faktin se seanca e kolegjit e gjykatës së shkallës së dytë është mbajtur pa i njoftuar paraprakisht palët dhe përfaqësuesit e tyre, ndërsa kjo shkelje, për shkak të natyrës së saj dhe

rrethanave specifike të rastit, ka ndikuar në ligjshmërinë dhe drejtshmërinë e vendimit gjyqësor.

2. Siç u theksua edhe më parë, ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim me burgim, kurse, nga shkresat e lëndës nuk rezulton që gjykata e shkallës së dytë t'i ketë njoftuar palët dhe përfaqësuesit e tyre, për seancën e kolegjit, edhe pse ka qenë e detyruar që ta bëjë një gjë të tillë, duke u bazuar në nenin 390, paragrafi 1 të KPP-së, në të cilën dispozitë ligjore është parashikuar se në rastet kur ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim me burgim, atëherë njoftimi i palëve dhe përfaqësuesve të tyre për seancën e kolegjit është i detyrueshëm.

3. Përndryshe, në situata të tilla, mos njoftimi i palëve për seancën e kolegjit, përveç që përbën shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale të theksuar më lart, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, paraqet edhe shkelje të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj). Mandej, edhe me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kl.Nr.104/2016, datë 29.05.2017, është konstatuar se garancitë e përmbajtura në nenin 6, paragrafët 1 dhe 3 të KEDNj-së, vazhdojnë të zbatohen në të gjitha fazat e procedurës penale. E drejta për mbrojtje, sipas dispozitës së lartcekur të KEDNj-së, përfshin të drejtën e të akuzuarit për të mbrojtur veten, të drejtën për ndihmë juridike, duke përfshirë ndihmën juridike falas, si dhe të drejtën e të akuzuarit që të jetë i pranishëm në të gjitha veprimet në procedurë. Duke mos ia mundësuar të akuzuarit që të merr pjesë në seancën e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me akuzën penale kundër tij, sipas konstatimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me KEDNj.

4. Në anën tjetër, edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në disa raste nga jurisprudenca e saj e ka trajtuar në hollësi çështjen e njoftimit të të akuzuarit për pjesëmarrje në seancë pranë gjykatës së apelit, duke e konsideruar këtë aspekt si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces

të rregullt, nga neni 6, paragrafi 1 i KEDNj-së (rasti "Tierce dhe të tjerët kundër S. M.", aktgjykimi i datës 25.07.2000, paragrafët 85-102; rasti "Ekbatani kundër S.", aktgjykimi i datës 26.05.1988, paragrafët 23-33, etj.).

5. Në këtë mënyrë, bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, rezulton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si më lart, andaj edhe si rezultat i kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovon si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ndërsa e anuloi këtë aktgjykim, duke e kthyer çështjen në rigjykim. Kjo për faktin se shkelja esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilën është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është e asaj natyre që nuk ka mundur që të evitohet nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që kjo ka qenë arsye që ka imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në këtë gjykatë.

6. Në rigjykim, gjykata e shkallës së dytë duhet që ta evitoj shkeljen e cekur më lartë, duke i njoftuar paraprakisht palët dhe përfaqësuesit e palëve për datën dhe orën e mbajtjes së seancës së kolegjit, kurse pasi që t'i vlerësojë dhe shqyrtojë pretendimet thelbësore ankimore, të vendos në mënyrë meritore dhe të paraqes arsye të mjaftueshme në lidhje me këto pretendime dhe shkeljet tjera, për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare.

7. Duke u bazuar në këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar dhe në kuptim të nenit 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.429/2025, datë 02.09.2025

"Konsumimi i veprës penale paraprake nga vepra penale pasuese".

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimet e gjykatës së shkallës së parë

a. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, P.Nr.3434/2021, datë 11.07.2024, i dënuari Ismet Berisha, është shpallur fajtor për shkak të veprave penale: "Falsifikimi i dokumenteve", nga neni 398 paragrafi 2 të KPRK-së (pika I. e dispozitivit) dhe "Legalizimi i përmbajtjes së rreme", nga neni 403 paragrafi 1 të KPRK-së (pika II. e dispozitivit), dhe është gjykuar: për veprën penale nga pika I. e dispozitivit është shqiptuar dënim me burgim në shumë prej pesëqind (500) euro, të cilin dënim, i dënuari është detyruar që ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, por jo më gjatë se tre (3) muaj, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, kurse për veprën penale nga pika II. e dispozitivit të aktgjykimit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në periudhën verifikuese prej një (1) viti, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet, atëherë gjykata do t'ia cakton të dënuarit një (1) ditë burgim për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë. Është detyruar i dënuari që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësore shumën prej pesëdhjetë (50) euro, kurse në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, por jo më gjatë se tre (3) muaj, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Në bazë të dispozitës ligjore të nenit 112 të KPP-së, është urdhëruar anulimi i kontratës së faljes së aksioneve të Kompanisë "N. K.W.P.", Sh.p.k., datë 15.03.2010; Aneks statuti i Kompanisë "N. K.W. P.", Sh.p.k., datë 15.03.2010; Vendimi i datës 15.03.2010, për ndryshimin e statutit të Kompanisë "N.K. W. P.", Sh.p.k.; Autorizimi i datës 15.03.2010 për ARBK-në; Autorizimi

i vërtetuar nga Gjykata Themelore në Krushevc, Republika e Serbisë, me shenjën OV I.br..... dhe ....., datë 24.10.2014 (në të dy versionet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe), dhe të gjitha veprimet juridike të ndërmarra mbi bazën e këtij autorizimi. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

b. Me aktvendimin përmirësues të gjyqtares së vetme gjykuese, datë 22.08.2024, është përmirësuar aktgjykim i lartcekur i gjykatës së shkallës së parë, ashtu që në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit në fjalë është hequr fjalia "Autorizimi i vërtetuar nga Gjykata Themelore në Krushevc, Republika e Serbisë, me shenjën OV I. br..... dhe ....., datë ..... (në të dy versionet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe), dhe të gjitha veprimet juridike të ndërmarra mbi bazën e këtij autorizimi".

2. Vendimet e gjykatës së shkallës së dytë

a. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e theksuar më parë, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e Prokurorit të Shtetit, duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që të dënuarit, për shkak të veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", nga neni 398 paragrafi 2 të KPRK-së (pika I. e dispozitivit), i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej tremijë (3.000) euro, të cilën dënim është detyruar që ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, por jo më gjatë se tre (3) muaj, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë, atëherë, gjykata duke u bazuar në nenin 46 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimin e gjobë do t'ia zëvendëson me dënim me burgim, ku një (1) ditë e dënimit me burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro të dënimit me gjobë. Ndërsa, për shkak të veprës penale "Legalizimi i përmbajtjes së rreme", nga neni 403 paragrafi 1 të KPRK-së (pika II. e dispozitivit), i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i dënuari në periudhën verifikuese prej dy (2) vjetëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Në pjesët tjera, aktgjykimi mbetet i pandryshuar.

3. Me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë, datë 25.04.2025, është përmirësuar aktgjykimi i lartcekur, vetëm sa i përket pjesës II të dispozitivit, ku duhet të jetë - "Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit Ismet Berisha, av.Ibrahim Maxhuni, ndërsa pjesa e parë I e dispozitivit, si dhe vetë aktgjykimi në pjesën tjetër mbetet e pandryshuar".

4. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër aktgjykimit të lartcekura, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Ibrahim Maxhuni, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të anulohet, ashtu që çështja t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së dytë, në mënyrë që të vendos edhe përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, apo që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen, ashtu që kjo çështje t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

5. Përgjigjet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

a. Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.Nr.232/2025, datë 21.07.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar, ashtu që të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe çështja t'i kthehet në rigjykim kësaj gjykate, ngase gjykata e njëjtë nuk ka vendosur në lidhje me ankesën e mbrojtësit të të dënuarit.
b. Përfaqësuesit e palëve të dëmtuara, avokatët: T.Rr. dhe A. T. Rr., përmes përgjigjes së tyre, datë 25.08.2025, kanë propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar, duke konsideruar se pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit nuk qëndrojnë.

6. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës
   Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435 paragrafi 1 lidhur me nenin 436 paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:

- kërkesa është e bazuar.

7. Pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

a. Mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkeljet e lartcekura, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që gjykata në fjalë, ka vendosur vetëm në lidhje me ankesën e prokurorit të shtetit, por nuk ka vendosur në lidhje me ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, e cila ishte paraqitur për tre (3) baza juridike. Po ashtu, thekson se gjykata e shkallës së dytë nuk ka përmbushur detyrimet sipas dispozitës ligjore të nenit 404 të KPP-së, për të vlerësuar pretendimet e ankesës së mbrojtësit të të dënuarit. Në këtë aspekt, kontestohet edhe përmbajtja e arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, duke pretenduar se në të, vetëm është përshkruar përmbajtja e disa provave, pa një përfundim dhe vlerësim të duhur, në raport me pretendimet ankimore.

b. Gjithashtu, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se shkeljet e lartcekura i referohen edhe faktit se gjykatat nuk kanë arsyetuar se pse kemi të bëjmë me bashkim real të veprave, duke qenë se i dënuari ishte shpallur fajtor për dy (2) vepra penale.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të bazuara, pasi që aktgjykimet e kundërshtuara janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin lidhur me nenin 369 paragrafi 6 dhe nenin 404 paragrafi 1 të KPP-së, dhe me shkelje të ligjit penal nga neni 385 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, sa i përket veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", nga neni 398 paragrafi 2 të KPRK-së.

2. Ndërsa, sa i përket veprës penale "Legalizimi i përmbajtjes së rreme", nga neni 403 paragrafi 1 të KPRK-së, gjykatat e instancave më të ulëta kanë arsyetuar mjaftueshëm të gjitha çështjet e rëndësishme që

ndërlidhen me përgjegjësinë penale të të dënuarit, dhe me të drejtë kanë konstatuar se në veprimet e të dënuarit janë përmbushur të gjitha elementet subjektive dhe objektive të kësaj vepre penale.

3. Qëndron pretendimi se në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë nuk është vendosur në lidhje me ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, mirëpo, një gjë e tillë është përmirësuar me aktvendimin e kësaj gjykate të datës 25.04.2025, kështu që kjo shkelje është evituar. Ndërsa, siç u theksua edhe më parë, në mënyrë të njëjtë është vepruar edhe me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, i cili është përmirësuar, me një aktvendim tjetër të kësaj gjykate.

4. Mirëpo, sa i përket veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", nga neni 398 paragrafi 2 të KPRK-së, aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkeljet e lartcekura, pasi që veprimet të dënuarit të përshkruara në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk mund të konsiderohen si vepër penale e veçantë apo e pavarur, duke qenë se këto veprime janë konsumuar nga vepra penale pasuese, e përcaktuar në pikën II. të dispozitivit. Në këtë rast, kemi të bëjmë me bashkim fiktiv të veprave penale dhe se veprimet e të dënuarit të përshkruara në pikat I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i përbëjnë të gjitha elementet e figurës së veprës penale "Legalizimi i përmbajtjes së rreme", nga neni 403 paragrafi 1 të KPRK-së, duke e zbatuar parimin e konsumimit të njërës vepër penale nga vepra tjetër penale. Kjo për faktin se si te pika I. e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe të pika II. e dispozitivit, bëhet fjalë për dokumente të njëjta që janë përdorur, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, duke bërë ndryshime të pronësisë së aksioneve të Kompanisë "N.K.. W. P.", Sh.p.k., nga i ndjeri N. B. në emër të të dënuarit Ismet Berisha, dokumente këto, të cilat janë përdorur si provë pranë ARBK-së.

5. Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se në situata të tilla, vepra penale paraprake konsumohet nga vepra penale pasuese, kështu që mbi bazën e saj, kryesi mund të shpallet fajtor vetëm për veprën penale pasuese, kështu që, mbi bazën e kësaj, veprimet e përshkruara në pikën I. të

dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të kualifikohen si vepër penale e veçantë, andaj, edhe si rezultat i kësaj, gjykatat e instancave më të ulëta e kanë shkelur ligjin penal nga neni 385 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, kur të dënuarin e kanë shpallur fajtor për shkak të dy (2) veprave penale të veçanta.

6. Duke qenë se aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i mungon një arsyetim i mirëfilltë në lidhje me vlerësimin e rrethanave përkatëse lehtësuese dhe rënduese (duke i vlerësuar elementet e figurës së veprës penale si rrethana rëndësuese), atëherë, Gjykata e Supreme e Kosovës e ka marrë si të mirëqenë vlerësimin e këtyre rrethanave të bërë nga gjykata e shkallës së parë, dhe mbi bazën e kësaj, e ka marrë si të vërtetuar edhe dënimin me kusht të shqiptuar nga kjo gjykatë, në atë mënyrë që ndaj të dënuarit Ismet Berisha, ka caktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i dënuari në afat prej një (1) viti, nga data kur aktgjykimi është bërë i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindjen se më një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 41 të KPRK-së.

7. Duke u bazuar në këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar dhe në kuptim të nenit 438 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.472/2025, datë 08.09.2025

"Kur është në pyetje dënimi me gjobë, atëherë, gjykatat duhet që të paraqesin arsye të mjaftueshme në lidhje me gjendjen ekonomike të të pandehurit/akuzuarit, dhe posaçërisht shumën e të ardhurave personale, të ardhurat e tjera, pasurinë dhe detyrimet e tij. Është e rëndësishme të theksohet, se duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 69 paragrafi 5 të KPRK-së, gjykatat nuk duhet që të caktojnë dënime me gjobë në shuma që i tejkalojnë mundësitë e të pandehurit/akuzuarit. Normalisht, që një gjë e tillë, varet edhe nga specifikat e secilit rast veç e veç, si dhe nga natyra e veprës penale".

I. Rrethanat e çështjes

1. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë

a. Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.Nr.488/2023, datë 02.10.2024, të dënuarin Bayhan Lopari, e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale "Lëndimi i lehtë trupor", nga neni 185 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 pika 3.1. të KPRK-së, dhe ndaj të njëjtit ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim me propozimin e të dënuarit, në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 44 të KPRK-së, është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej tetëqind (800) euro, të cilin dënim, i dënuari është detyruar që të paguajë në tre (3) këste mujore, në çdo fillim të muajit, në datat prej 01-05 të muajit vijues, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

b. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë gjykata në bazë të nenit 43, paragrafi 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë, do t'ia zëvendësojë në dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzet (20) euro do të llogaritet një (1) ditë burgim. E dëmtuara M. L., nga P., rr."...K..", Nr....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civilo-juridik. Është detyruar i dënuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumën prej njëzet (20) euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej njëzet (20) euro, si dhe

në emër të të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

2. Vendimi i gjykatës së shkallës së dytë
   Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin e theksuar më parë, i ka aprovuar pjesërisht si të bazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesën e palës së dëmtuar – M. L., ashtu që ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, vetëm sa i përket dënimit të shqiptuar, ashtu që ndaj të dënuarit Bayhan Lopari ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) euro, të cilin gjobë i dënuari është detyruar për ta paguar në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse i dënuari nuk dëshiron apo nuk mundet ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë do të llogaritet një (1) ditë burgim.

3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
   Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari Bayhan Lopari, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të anulohet, ashtu që çështja t'i kthehet në rigjykim të njëjtës gjykatë, apo që aktgjykimi në fjalë të ndryshohet, ashtu që të vërtetohet dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë.

4. Përgjigja në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë
   Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.Nr.247/2025, datë 14.08.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

5. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës
   Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në

kuptim të nenit 435 paragrafi 1 lidhur me nenin 436 paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:- kërkesa është e bazuar.

6. Pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

7. I dënuari Bayhan Lopari, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se gjykata e shkallës së dytë nuk ka marrë parasysh gjendjen ekonomike të të dënuarit, pasi që i njëjti nuk ka ndonjë punë të rregullt, punon si kamarier me pagë mujore prej katërqind (400) euro. Gjithashtu, duke qenë se i dënuari është shkurorëzuar me të dëmtuarën, i njëjti është i detyruar që të paguajë alimentacion për ruajtjen, edukimin dhe kujdesin ndaj f.. të tyre. Prandaj, dënimi me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) euro, do ta dëmtonte tej mase ekzistencën e të dënuarit dhe në një farë mënyre, edhe të djalit të tij, për të cilin është i detyruar që të paguaj alimentacionin.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se pretendimet e të dënuarit janë të bazuara, pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2 nënparagrafi 2.7. lidhur me nenin lidhur me nenin 369 paragrafi 6 të KPP-së. Kjo për faktin se gjykata në fjalë nuk ka paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me atë se pse ka vendosur që të dënuarit t'ia ashpërsojë dënimin me gjobë dhe t'ia shkurtoj periudhën kohore, brenda të cilit i njëjti duhet që ta paguaj dënimin me gjobë.

2. Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë nuk rezulton që gjykata në fjalë ta ketë marrë parasysh gjendjen ekonomike të të dënuarit, dhe aspekte tjera të rëndësishme, siç është parashikuar në dispozitën ligjore të nenit 69 paragrafi 5 të KPRK-së, në të cilën dispozitë ligjore është parashikuar se "Me rastin e caktimit të dënimit me gjobë, gjykata merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryesit dhe posaçërisht merr parasysh shumën e të ardhurave personale, të ardhurat e tjera, pasurinë dhe detyrimet e tij. Gjykata nuk cakton gjobë në

lartësinë që është mbi mundësitë e kryesit". Përkundrazi, gjykata e shkallës së dytë është mjaftuar me konstatimin se gjykata e shkallës së parë ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese, por pa marrë parasysh gjendjen ekonomike, dhe aspekte të tjera të theksuara më lart, aq më parë kur ka vendosur që të dënuarit t'ia ashpërojë dënimin e shqiptuar me gjobë, nga tetëqind (800) euro në dymijë (2.000) euro, si dhe t'ia shkurtojë kohëzgjatjen e pagesës së dënimit me gjobë, duke ja pamundësuar të njejtit që këtë dënim ta paguaj me këste.

3. Përndyrshe, edhe në këtë çështje penale, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që të sqaron se duke u bazuar në nenin 369 paragrafi 6 të KPP-së, gjykatat, në arsyetimet e aktgjykimeve duhet të paraqesin arsyet për çdo pikë të aktgjykimit. Kjo nënkupton që në arsyetim të aktgjykimit duhet të paraqiten arsye për fajësinë e të dënuarit, veprën penale, dispozitat përkatëse ligjore, dënimet, konfiskimin, paraburgimin, shpenzimet e procedurës penale, si dhe çështjet tjera më specifike.

4. Kur është në pyetje dënimi me gjobë, atëherë, gjykatat duhet që të paraqesin arsye të mjaftueshme në lidhje me gjendjen ekonomike të të pandehurit/akuzuarit, dhe posaçërisht shumën e të ardhurave personale, të ardhurat e tjera, pasurinë dhe detyrimet e tij. Është e rëndësishme të theksohet, se duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 69, paragrafi 5 të KPRK-së, gjykatat nuk duhet që të caktojnë dënime me gjobë në shuma që i tejkalojnë mundësitë e të pandehurit/akuzuarit. Normalisht, që një gjë e tillë, varet edhe nga specifikat e secilit rast veç e veç, si dhe nga natyra e veprës penale.

5. Në këtë mënyrë, bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, rezulton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara më parë, andaj edhe si rezultat i kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovon si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ndërsa e anuloi këtë aktgjykim, duke e kthyer çështjen në rigjykim. Kjo për faktin se shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale me të cilën është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është e

asaj natyre që nuk ka mundur të evitohet nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që e njëjta ka qenë arsye që ka imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në këtë gjykatë.

6. Në rigjykim, gjykata e shkallës së dytë duhet që ta evitoj shkeljen e cekur më lart, dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve thelbësore ankimore, të vendosë në mënyrë meritore, duke e hartuar një vendim të qartë dhe duke paraqitur arsye të mjaftueshme në për të gjitha pikat e aktgjykimit.

7. Duke u bazuar në këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar dhe në kuptim të nenit 438 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2. të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.72/2025, datë 25.02.2025

''Me këtë aktgjykim , Gjykata Supreme ka vlerësuar vetëm faktin se gjykata e shkallës së dytë nuk e ka shqyrtuar fare ankesën e të dënuarit e cila ishte ushtruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata Supreme rikujton obligimin e gjykatës së shkallës së dytë që rrjedh nga dispozita e nenit 389 par.3 të KPP-së, me të cilën përcaktohet se Gjykata e Apelit vendos për të gjitha ankesat kundër të njëjtit aktgjykim me një vendim. Po ashtu, Gjykata Supreme vlerësoi se nuk mund të shqyrtohen as shkeljet tjera të pretenduara e as aktgjykimi i shkallës së parë, kundër të cilit janë ushtruar kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë , meqë fillimisht ,gjykata e shkallës së dytë duhet të vendos lidhur me ankesat e ushtruara kundër aktgjykimit të shkallës së parë, nga i cili vendim pastaj varet se çfarë kundërshtimi eventualisht mund të kemi pran kësaj gjykata.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, P.Nr.496/2019 të datës 29.11.2023, i dënuari Mentor Salihu, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, dhe i është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 7000 (shtatëmijë) €, të cilin dënim është obliguar ta paguaj në këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse i dënuari nuk e paguan këstin me kohë. Nëse i dënuari refuzon apo nuk mundet ta paguaj dënimin me gjobë, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 € të gjobës do t'i caktohet një ditë burg.

2. I dënuari është obliguar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe atë për paushallin gjyqësor shumën prej 100 € si dhe 20 € në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të

Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

3. I dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt juridik.

4. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin, PA1.Nr.407/2024 e datës 29.10.2024, ka aprovuar pjesërisht ankesën e mbrojtësit të dënuarit, ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimi, ashtu që të dënuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) €, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 3 muajsh, në të kundërtën, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 € të gjobës do t'i caktohet një ditë burg. Në pjesët tjera aktgjykimi ka mbetur i paprekur.

5. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur:

   - mbrojtësi i të dënuarit, avokati, Asdren Saramati, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuara të ndryshohen apo të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim si dhe

   - vet i dënuari Mentor Salihu, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuara të ndryshohen apo të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

6. Prokuroria e Shtetit e Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KMLP.II.Nr.33/2025 e datës 20.02.2025, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit dhe i dënuari ashtu që aktgjykimi i gjykatës së

shkallës së dytë të anulohet dhe çështja të kthehet në gjykatën e njëjtë për rivendosje.

7. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

   - kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, janë të bazuara.

8. Në kërkesë, përveç pretendimeve tjera, mbrojtësi i dënuarit, avokati, Asdren Saramati, pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarit dhe me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale meqenëse gjykata e shkallës së dytë fare nuk ka shqyrtuar ankesën e të dënuarit ndërsa të njëjtin pretendim e ka paraqitur edhe vet i dënuari.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme, duke mos u lëshuar fare në shqyrtim të pretendimeve të cilat janë paraqitur por duke vlerësuar vetëm faktin se gjykata e shkallës së dytë nuk e ka shqyrtuar fare ankesën e të dënuarit e cila ishte ushtruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë, gjen se me të drejtë potencohet nga mbrojtësi dhe vet i dënuari, se gjykata e shkallës së dytë nuk e ka vlerësuar dhe shqyrtuar ankesën e të dënuarit. Pas shikimit të shkresave të çështjes, kjo gjykatë gjen se në shkresa është edhe ankesa e cila ishte ushtruar nga i dënuari e kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe ashtu sikur që edhe vërehet nga aktgjykimi i shkallës së dytë, e njëjta fare nuk është shqyrtuar.

2. Duke u nisur nga dispozita e nenit 389 par.3 të KPP-së, me të cilën përcaktohet se Gjykata e Apelit vendos për të gjitha ankesat kundër të njëjtit aktgjykim me një vendim, kjo gjykatë konsideron se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës penale të cilat kushtëzojnë anulimin e tij.

3. Po ashtu duhet të theksohet se kjo gjykatë nuk i vlerësoi as shkeljet tjera të pretenduara e as aktgjykimin e shkallës së parë, kundër të cilit janë ushtruar kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, meqë fillimisht ,gjykata e shkallës së dytë duhet të vendos lidhur me ankesat e ushtruara kundër aktgjykimit të shkallës së parë, nga i cili vendim pastaj varet se çfarë kundërshtimi eventualisht mund të kemi pran kësaj gjykata.

4. Në rigjykim, Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë duhet të vlerësoj dhe shqyrtoj të gjitha ankesat e drejtuara kundër aktgjykimit të shkallës së parë, e pastaj të merë vendim meritor në raport me ankesat e ushtruara.

5. Nga të gjitha këto që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitës së nenit 438 të KPP-së.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.343/2025, datë 18.06.2025

’’Me këtë aktgjykim Gjykata Supreme potencon se konstatimet e gjykatës së shkallës së parë duhet të kenë mbështetje në prova konkrete e jo të bazohen në supozime dhe hamendje. Po ashtu edhe janë sqaruar edhe njëherë se ndihma si formë e bashkëpunimit sipas nenit 33 par.2 të KPRK-së “përfshin por nuk kufizohet në: dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale”. Gjykata po ashtu ka sqaruar se për të pasur ndihmë duhet të ekzistoj dashja tek kryesi dhe ajo ndihmë duhet të jetë konkrete. Po ashtu duhet të ekzistoj lidhja kauzale në mes të veprimeve të personit që jep ndihmën për kryerjen e veprës penale me veprimet e kryesit të saj. Për më tepër duhet të ekzistoj dashja e përbashkët e ndihmësit dhe kryesit për shkaktimin e pasojës së dëshiruar.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër 2022:092767 të datës 25.09.2024 i dënuari Lirim Tusha është shpallur fajtor për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasja e rëndë nga neni 173 par.1, nënpar.1.5 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, dhe është gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 16.6.2023 derisa aktgjykimi të merr formën e prerë por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar. Ndërsa, me aktvendimin përmirësues Nr... datë 13.3.2025 gjykata ka përmirësuar aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën ku të dënuarit i është llogaritur paraburgimi ashtu që në dënimin e shqiptuar të dënuarit i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 21.7.2023 deri më datën 16.9.2023 në Republikën

Federale të Gj. si dhe nga data e ekstradimit me datë 16.9.2023 e tutje derisa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar. I dënuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 euro, në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 50 euro si dhe në emër të Fondit për Kompensimit të Viktimave të Krimit shumën prej 50 euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Të dëmtuarit H. B. dhe K. B., nga fshati D., komuna e K., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

2. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PAKR.Nr.733/2024 të datës 22.01.2025, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e përfaqësuesit të dëmtuarve dhe mbrojtësit të të dënuarit ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është vërtetuar.

3. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. Ardian Jashari nga F., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPP-së, shkeljes së Ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza ose të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

4. Prokuroria e Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.Nr.182/2025 e datës 10.6.2025, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të pandehurit.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP),

vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e bazuar.

6. Në kërkesë mbrojtësi pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale meqenëse gjykata në arsyetim nuk ka dhënë sqarime lidhur me faktet vendimtare mbi të cilat është vendosur për fajësinë e të dënuarit. Aktgjykimi është i bazuar kryesisht në provat dhe atë deklarimin e të dëmtuarit K. B., dëshmitarëve P. K., F. K. dhe B. P. edhe pse asnjë nga këto dëshmi nuk e involvojnë të pandehurin Lirim përveç se të dëmtuarit K. B., i cili thotë se e ka dëgjuar të pandehurin duke thënë ”gjuaj, gjuaj” por asnjëherë nuk pohon se “e ka parë duke mbajtur derën hapur”. Prandaj, mbrojtja konsideron se gjykata nuk mund ta shpallë të pandehurin fajtor duke u bazuar vetëm në një deklaratë apo dëshmi të vetme. Gjykata gabimisht ka marrë qëndrim se mbajtja e derës së hapur derisa janë krijuar kushte, është vepër penale meqë ky veprim fare nuk ka ekzistuar dhe nuk është argumentuar as me prova e as me fakte. Po ashtu, edhe nëse i pandehuri ka theksuar fjalët “gjuaj, gjuaj” (e të cilat nuk i ka pranuar asnjëherë) këto fjalë nuk mund të interpretohen si ndihmë sepse ndihma nuk mund të jepet pa ndonjë veprim konkret, e vetëm me fjalë, për më tepër këto fjalë mund të cilësohen si shtytje, edhe pas për këtë nuk kemi akuzë dhe në këtë rast eventualisht mund të flitet vetëm për shtytje të pasuksesshme, sepse i pandehuri tjetër Hyqmet Qorri qysh më parë kishte vendosur të kryej veprën penale ashtu sikur edhe vet Prokuroria në fjalën përfundimtare të dhënë me datë 23.9.2024, kishte cekur.

7. Mbrojtja po ashtu konsideron se mbajtja e derës së hapur është supozim juridik i pa vërtetuar sikur edhe fakti se arma ... nuk mund të mbahet me një dorë dhe se ky fakt as në shqyrtim nuk është vërtetuar.

8. Sa i përket shkeljes së Ligjit penal, mbrojtësi konsideron se asnjëra gjykatë nuk ka arritur që të vërtetojë në veprimet e të pandehurit elementet qenësore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor,

ndërsa me këtë është shkelë ligji penal në dëm të të njëjtit sikurse edhe nga fakti se me rastin e shqiptimit të dënimit, gjykata ka vlerësuar si rrethana rënduese peshën e veprës penale dhe rrezikshmërinë e veprës penale si dhe ka cekur aktgjykimin e plotfuqishëm P.Nr.185/2019 të datës 27.10.2020, me të cilin i pandehuri është dënuar me gjobë, kurse sipas nenit 93 par.2 të Kodit Penal, pasojat juridike të kryesit, nuk krijohen kur kryesit i shqiptohet gjoba apo vërejtja gjyqësore. Po ashtu, gjykata ka marrë si rrethana rënduese edhe faktin se i njëjti është përsëritës i veprave penale por një gjë e tillë nuk është sqaruar dhe nuk janë dhënë arsye në aspektin e vlerësimit të kësaj rrethane, ndërsa Gjykata e Apelit nuk ka mënjanuar këtë shkelje.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe bazuar në shkresat e çështjes gjen se janë të bazuara pretendimet mbrojtësit e të pandehurit dhe se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje të ligjit penal në dëm të pandehurit Eduard Arifaj, e të cilat shkelje kanë kushtëzuar ndryshimin e tyre.

2. Duke u nisur nga fakti se në këtë çështje penale nuk është kontestuese se ditën kritike se i dëmtuari K. B. së bashku me të ndjerin H., deri sa ishin në rrugës për F., nga i pandehuri Hyqmet kishte pranuar një sms "hajde se jam ty të prit te varrezat e dëshmorëve në K." dhe së bashku me të ndjerin H., ishte nisur në drejtim të kafeterisë "..." dhe ishte e kishte ndalur veturën në parking përball të kafeterisë. Nga shkresat është vërtetuar se i pari ka dal i ndjeri H., ndërsa pas tij i dëmtuari K., i cili posa ka vënë njërën këmbë në tokë, e ka pa tek dera hyrëse të lokalit të pandehurin Hyqmet dhe Lirim, në distancë prej 4-5 m dh e ka dëgjuar Lirimin duke thënë "gjuaj-gjuaj" përderisa i ndjeri H. e ka ngrit dorën dhe ka thënë "mos gjuaj", por në ato momente është goditur nga plumbat dhe e ka humbur vetëdijen. Po ashtu nga shkresat është vërtetuar se armën e llojit ... në dorë e kishte i pandehuri Hyqmet, i cilin edhe ka shtënë disa herë në drejtim të ndjerit H. dhe të dëmtuarit K. , i cili edhe ka pësuar lëndime të rënda trupore më hollësisht të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore. Sa i përket

motivit të mosmarrëveshjes, nga shkresat e çështjes nuk është kontestuese se i ndjeri Hyqmet i kishte huazuar të pandehurit Hyqmet, shumën prej 5000 (pesëmijë) €, ku i njëjti ia kishte kthyer borxhin në shumë prej 1500 (njëmijepesëqind) €, por kishte mbetur pa kthyer edhe pjesën tjetër në shumë prej 3500 (tremijepesëqind) € dhe si njëjti i ishte shmangur takimit me të, edhe pse e kishte kërkuar në shtëpinë e tij në fshatin S. . Edhe fakti se i pandehuri Lirim, ka qenë në kafeteri ditën kritike dhe se aty ka ardhur vet e veturën e tij, pak para se të ndodh ngjarja, ku i ishte bashkangjitur në tavolinë të pandehurit Hyqmet, i cili kishte ardhur më herët dhe ishte duke pirë një gotë raki, nuk është kontestues. Sikur edhe fakti se pas të shtënave i pandehuri së bashku me të pandehurin Hyqmet janë larguar në drejtim të panjohur.

3. Fakte kontestuese kanë mbetur në këtë çështje penale se a kishte qëllim i pandehuri Lirim, që me fjalët "gjuaj-gjuaj" ta ndihmonte të pandehurin Hyqmet që të kryej vrasjen e të ndjerit H. dhe lëndimin e të dëmtuarit Kastriot, ashtu sikur ka konstatuar gjykata e shkallës së parë në aktgjykim të vërtetuar me aktgjykim të shkallës së dytë. Po ashtu, është fakt kontestues, se a e kishte mbajtur derën e hapur për të mënjanuar pengesat që i pandehuri Hyqmet i kishte pasi që e kishte në dorë armën ... , duke u nisur nga fakti se ai ishte në lokal dhe ishte duke qëndruar me të.

4. Kjo gjykatë, pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa si dhe bazuar në shkresat e çështjes, gjen se me të drejtë potencon mbrojtësi se gabimisht kishte konstatuar gjykata e shkallës së parë, se i pandehuri i kishte dhënë ndihmë respektivisht me krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale, që ndërlidhen me hapjen e derës së kafeterisë dhe mbajtjen e saj deri në momentin kur zbresin nga vetura viktimat dhe i pandehuri Lirim thotë "gjuaj-gjuaj" disa herë, ku i pandehuri Hyqmet më pas shtënë në drejtim të tyre.

5. Të gjitha këto konstatime të gjykatës së shkallës së parë sipas vlerësimit ë kësaj gjykate nuk kanë mbështetje në prova konkrete por

bazohen në supozime dhe hamendje. Ndihma si formë e bashkëpunimit sipas nenit 33 par.2 të KPRK-së *"përfshin por nuk kufizohet në: dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale"* dhe duke mbështetur në këtë dispozitë, kjo gjykatë gjen se, fakti se i pandehuri kishte qenë te dera e lokalit ku ka ndodhur ngjarja dhe i kishte thënë të pandehurit Hyqmet "gjuaj-gjuaj" ,nuk është ndihma para kryerjes së veprës penale, sepse për të pasur ndihmë duhet të ekzistoj dashja dhe ajo ndihmë duhet të jetë konkrete. Po ashtu, duhet të ekzistoj lidhja kauzale në mes të veprimeve të personit që jep ndihmën për kryerjen e veprës penale me veprimet e kryesit të saj. Për më tepër duhet të ekzistoj dashja e përbashkët e ndihmësit dhe kryesit për shkaktimin e pasojës së dëshiruar. Në rastin konkret, i pandehuri Lirim nuk e mohon se ka qenë në lokal dhe se ka pirë raki me të pandehurin Hyqmet, por nga asnjë deklaratë e dëshmitarëve nuk mund të vërtetohet se i njëjti e dinte se ai kishte ardhur për të kryer veprën penale apo se i jep ndonjë udhëzim apo i jep sinjal se do të ndihmoj në çfarëdo mënyre kryerjen e saj. Për më tepër konstatime të tilla në aktgjykim nuk kanë mbështetje as në prova dhe Gjykata e shkallës së parë ka dështuar që të vërtetoj një gjë të tillë dhe për pasojë edhe ka shkel ligjin penal kur ka gjet se i pandehuri e ka dhënë ndihmë për kryerjen e veprës penale, të pandehurit Hyqmet.

6. Sa i përket konstatimit të gjykatës së shkallës së parë se i pandehuri ka ndihmuar të pandehurin Hyqmet gjatë kryerjes së veprës penale, me faktin se deri sa deri sa ai e kishte ekzekutuar viktimën ai kishte qëndruar tek dera duke e mbajt dhe duke i thënë "gjuaj-gjuaj", kjo gjykatë gjen se as në këtë rast nuk mund të konsiderohet ndihmë gjatë kryerjes së veprës penale duke u nisur nga fakti se kjo kryhet me "krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale" dhe nga shkresat edhe nga provat e administruara nuk

mund të vërtetohet se i pandehuri Lirim kishte krijuar kushte për kryerjen e veprës penale e as nuk i kishte mënjanuar pengesat, ashtu sikur kërkohet me nenin 33 të KPRK-së. Sikur që është cekur më lartë, fakti se i pandehuri Lirim ishte në lokal dhe i thoshte "gjuaj-gjuaj", nuk mund të konsiderohet apriori ndihmë gjatë kryerjes së veprës penale, sepse, sikur që u tha, Lirimi, do të duhej të kishte një marrëveshje paraprake apo të kishte dijeni se Hyqmeti, do të vjen me pushkë me qëllim që të ekzekutoj të ndjerin dhe të kishte dijeni se i ndjeri do të vjen në ato momente nga shtëpia. Të gjitha këto çështje kanë mbetur të pa vërtetuara me fakte konkrete dhe si të tilla nuk mund të merren në dëm të pandehurit e për më tepër nuk mund të mbesin çështje të supozuara dhe të konkluduara pa fakte të vërtetuara. Për më tepër, nga asnjë deklaratë e dëshmitarëve e as nga vet deklarata e të dëmtuarit K. , nuk është vërtetuar se i pandehuri Lirim ishte në çfarëdo lidhje me të dëmtuarit apo se kishte ndonjë mosmarrëveshje qoftë aty për aty apo ditë më parë sikur edhe fakti se ai e mbante derën deri sa i pandehuri Hyqmet kishte shtënë në të dëmtuarit.

7. Andaj, kjo gjykatë gjen se në veprimet e të pandehurit nuk formohen elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe se gabimisht është aplikuar ligji penal, gjegjësisht janë nxjerrë konkludime të gabuara dhe ishte i drejtë pretendimi në kërkesë se në dëm të pandehurit është bërë shkelja e ligjit penal nga neni 385 pika 4 të KPP-së, ashtu që pretendimi u aprovua dhe u vendos që i pandehuri të lirohet nga akuza.

8. Për shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike u vendos komfor nenit 453 dhe 462 të KPP-së.

9. Nga të gjitha këto që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitës së nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.682/2024, datë 06.02.2025

’’Me këtë aktgjykim Gjykata Supreme ka treguar se si duhet të vlerësohen elementet e veprës penale të mashtrimit dhe se është e qartë, se në rastin konkret, bëhet fjalë për raport të pastër civilo-juridik, e jo për veprën penale të mashtrimit, siç pretendon prokurori me aktakuzë dhe siç kanë gjetur dy gjykatat instancionale, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se biznesit të të dënuarës nuk i kanë shkuar punët mbarë, sipas parashikimeve dhe dinamikës së planifikuara, për pengesa të ndryshme, duke përfshirë edhe ato administrative komunale dhe zvarritje e tilla e kanë falimentuar biznesin e saj. Nuk konsiderohet vepër penale çdo mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale, për faktin se, kontestet e tilla mbrohet me ligjet tjera civile e jo me KP. Po ashtu janë vlerësuar edhe çështjet e parashkrimit ngase nga përshkrimi faktik i veprës penale në dispozitivin 1. të aktgjykimit, rezulton se të gjitha para kontratat me të dëmtuarit, për të cilat prokuroria ka pretenduar se janë lidhur me mashtrim dhe këtë pretendim të prokurorisë e kanë pranuar edhe dy gjykatat instancionale, janë kryer në periudhën 2009 -2012, kur në fuqi ishte KP i viti 2004. Ky kod, veprën penale të mashtrimit e parashihte në nenin 261 i cili kishte dy paragrafë, paragrafi 2 ishte cilësues, për shkak të vlerës së dëmit mbi 15,000 € dhe parashihte dënim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vite. Në nenin 90 par.1, nënpar.1.5 të KPK, parashihej që afati relativ i parashkrimit për vepra penale të dënueshme deri në pesë (5) vjet është pesë (5) vite, ndërsa në nenin 92 .par.6 theksohej se ndjekja penale ndalohet nëse ka kaluar dyfishi i kohës së paraparë. Nga viti 2009-2012 e deri më datë 24.08.2024, kur aktgjykimi ka marr formën e prerë, kanë kaluar mbi 10 deri në 15 vite, ndërsa për veprën penale nga neni 261 par.2 të KPK, që ishte në fuqi kur janë lidhë para kontratat, afati absolut është 10 vite .d.m.th. në kohën e gjykimit këto vepra penale ishin të parashkruar. Ndërsa janë vlerësuar edhe cilësimi juridik i veprës penale shpëlarja e parave , të parashikuar nga neni 32 par.2, nënpar.2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPK.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.Nr.60/2023 të datës 17.11.2023, të pandehurit: Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku dhe Burim Vokrri, janë shpallur fajtorë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.2 e par.1 e lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së, dhe konform nenit 80 të KPRK-së, si dhe të pandehurit: Estrida Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokrri dhe Valon Orllani janë shpallur fajtor për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale shpëlarja e parave nga neni 32 par.2, nënpar.2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së.

2. Të pandehurës Estrida Bunjaku, i është shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vite, si dhe me gjobë në shumë prej 120.000 (njëqindenjëzet mijë) euro. Në dënimin me burg i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 15.05.2014 deri më datë 15.05.2015, nga data 15.06.2022 e deri më datë 16.05.2023, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 16.05.2023 e deri më datë 19.10.2023. Dënimi me burg do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse e pandehura dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, dënimi do t'i zëvendësohet me dënim me burg, duke ia llogaritur për 1 (një) ditë burg 20 (njëzetë) euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkalon 3 (tri) vite. E pandehura është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 500 (pesëqind) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 200 (dyqind) euro si dhe në emër të fondit për kompensim të viktimave të krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro.

3. I pandehuri Burim Vokrri, me të njëjtin aktgjykim pasi që është shpallur fajtor për veprat e cekura si më lartë, konform nenit 80 të KPRK-së, i është shqiptuar dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si dhe dënim me gjobë në shumë prej 60.000

(gjashtëdhjetëmijë) euro. Në këtë dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 15.06.2022 e deri më datë 16.05.2023 si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 16.05.2023 e deri më datë 19.10.2023. Dënimi me burg do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, dënimi do t'i zëvendësohet me dënim me burg, duke ia llogaritur për një ditë burg 20 euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkalon 3 (tri) vite. I pandehuri është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 500 (pesëqind) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 200 (dyqind) euro si dhe në emër të Fondit për Kompensim të Viktimave të Krimit shumën prej 50 euro.

4. Të pandehurit Vigan Bunjaku, pasi që është shpallur fajtor i është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 10.000 (dhjetëmijë) euro, ndërsa në dënimin me burgim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 15.06.2022 deri më datë 16.05.2023 si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 15.05.2014 deri më datë 14.10.2014 si dhe nga data 16.05.2023 deri më datë 19.10.2023. Dënimi me burg do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, dënimi do t'i zëvendësohet me dënim me burg, duke ia llogaritur për 1 (një) një ditë burg 20 (njëzetë) euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkalon 3 (tri) vite. I pandehuri është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 500 (pesëqind) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 200 (dyqind) euro si dhe në emër të fondit për kompensim të viktimave të krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro.

5. Të pandehurit Xhemajl Arifi, i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 50.000 (pesëdhjetëmijë) euro, ku dënimi me burg do të ekzekutohet

pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muaj, nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg, duke ia llogaritur 1 (një) një ditë për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkalojë 3 (tri) vite. I pandehuri është obliguar që të paguaj në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 200 (dyqind) euro, në emër të paushallit gjyqësor 120 (njëqindenjëzet) euro, si dhe në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit, shumën prej 50 (peëdhjetë) euro.

6. Të pandehurit Valon Orllani për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 50.000 (pesëdhjetëmijë) euro, ku dënimi me burg do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muaj, nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg, duke ia llogaritur 1 (një) ditë për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkalojë 3 (tri) vite. I pandehuri është obliguar që të paguaj në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 200 (dyqind) euro, në emër të paushallit gjyqësor 120 (njëqindenjëzet) euro, si dhe në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit, shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro. Nga i pandehuri Valon Orllani është konfiskuar trualli në fshatin Ll., komuna e P. në sipërfaqe prej... ari (... m2) sipas certifikatës së pronësisë P-... .

7. Të pandehurit: Estrida Bunjaku, Burim Vokrri, Vigan Bunjaku, Xhemajl Arifi dhe Valon Orllani, janë obliguar që në mënyrë solidare dhe nën kërcënim të përmbarimit me dhunë të paguajnë dëmshpërblim në lartësinë e pagesave të bëra të dëmtuarve dhe atë:

1. A. D.shumën prej ..... 10.000 (dhjetëmijë) euro,
2. A. G.shumën prej .... 10,000 (dhjetëmijë) euro,

3. A.V. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
4. A. M. shumën prej ..... 10.000 (dhjetëmijë) euro,
5. A. G. shumën prej ..... 2.500 (dymijepesëqind) euro,
6. A. H.shumën prej ..... 10,300 (dhjetëmijetreqind) euro,
7. A. M. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
8. A. H. shumën prej ..... 11,700 (njëmbëdhjetëmijeshtatëqind) euro,
9. A. B. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
10. A. K. shumën prej .... 10,600 (dhjetëmijegjashtëqind) euro,
11. A. K. shumën prej ...11,640 (njëmbëdhjetëmijegjashtëqindedyzet) euro,
12. A. S. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
13. A. M.-K. shumën prej ....10,000 (dhjetëmijë) euro,
14. A. Q.shumën prej ..... 17,070 (shtatëmbëdhjetëmijeshtatëdhjetë) euro,
15. A. M. shumën prej ..... 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
16. B. S. shumën prej .....15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
17. B. G. shumën prej .....10,000 (dhjetëmijë) euro,
18. B. P. shumën prej .....16,100 (gjashtëmbëdhjetëmijenjëqind) euro,
19. B. S. shumën prej .....12,000 (dymbëdhjetëmijë) euro,
20. B. Sh. shumën prej .....12,600 (dymbëdhjetëmijegjashtëqind) euro,
21. B. H. shumën prej ..... 30,000 (tridhjetëmijë) euro,
22. B. K. shumën prej ...31,950 (tridhjetenjëmijenëntëqindepesëdhjetë) euro,
23. D. B. shumën prej ..... 10,00 (dhjetëmijë) euro,
24. D2 B. shumën prej .....15 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
25. D. L. shumën prej .....10, 000 (dhjetëmijë) euro,
26. D. O. shumën prej ..... 21,300 (njëzetenjëmijetreqind) euro,
27. E. V. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
28. E. U. shumën prej ..... 10,340 (dhjetëmijetreqindekatër dhjetë) euro,
29. E. K. shumën prej ..... 3,900 (tremijenëntëqind) euro,
30. E. Xh. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
31. E. S. shumën prej ..... 26,000 (njëzetegjashtëmijë) euro,

32. E. F. shumën prej.....11,316 (njëmbëdhjetëmijetreqindegjashtëmbëdhjetë) euro,
33. F. K. shumën prej ..... 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
34. F. Sh. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
35. F. Z. shumën prej ..... 14,500 (katërmbëdhjetëmijepesëqind) euro,
36. F. G. shumën prej .....10,00 (dhjetëmijë) euro,
37. F. D. shumën prej .....10,180 (dhjetëmijenjëqindetetëdhjetë) euro,
38. F. H. shumën prej ..... 10.822 (dhjetëmijetetëqindenjëzetedy) euro,
39. F. H. shumën prej ..... 24,000 (njëzetekatërmijë) euro,
40. F. Zh. shumën prej ..... 6,000 (gjashtëmijë) euro,
41. F. E. shumën prej ..... 5,000 (pesëmijë) euro,
42. F. E. shumën prej ..... 5,171 (pesëmijenjëqindeshtatëdhjetenjë) euro,
43. G. N. shumën prej ..... 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
44. G. M. shumën prej .....10,000 (dhjetëmijë) euro,
45. G. H. shumën prej ..... 10, 000 (dhjetëmijë) euro,
46. H. K. shumën prej ..... 12,000 (dymbëdhjetëmijë) euro,
47. H. D. shumën prej .....13,000 (trembëdhjetëmijë) euro,
48. H. Th. shumën prej...12,550 (dymbëdhjetëmijepesëqindepesëdhjetë) euro,
49. I. K. shumën prej .....10,000 (dhjetëmijë) euro,
50. I. G. shumën prej ..... 5,000 (pesëmijë) euro,
51. I. K. shumën prej ..... 5,000 (pesëmijë) euro,
52. I. H. shumën prej ..... 11,500 (njëmbëdhjetëmijekatërqind) euro,
53. I. dhe L. B. shumën prej .... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
54. I. H. shumën prej ..... 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
55. I. R. shumën prej .....10,000 (dhjetëmijë) euro,
56. K. T. shumën prej .....10,412 (dhjetëmijekatërqindedymbëdhjetë) euro,
57. J. D. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
58. J. P. shumën prej .....10,400 (dhjetëmijekatërqind) euro,
59. L. P. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
60. L. D. shumën prej ..... 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
61. L. A. shumën prej ..... 6,000 (gjashtëmijë) euro,

62. L. Sh. shumën prej ..... 46,150 (katër dhjetë e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë) euro,
63. M. K. shumën prej .....16,34.60 (gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e katër euro e gjashtëdhjetë cent),
64. M. B. shumën prej .....12,400 (dymbëdhjetëmijë e katërqind) euro,
65. M. S. shumën prej ..... 8,000 (tetëmijë) euro,
66. M. C. dhe I. A. shumën prej .....10,000 (dhjetëmijë) euro,
67. M. S. E. shumën prej ..... 14,000 (katërmbëdhjetëmijë) euro,
68. M. G. shumën prej .....11,771 (njëmbëdhjetëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një) euro,
69. M. K. shumën prej .....6,440 (gjashtëmijë e katërqind e katër dhjetë) euro,
70. M. H. shumën prej ..... 7,500 (shtatëmijepesëqind) euro,
71. M. B. shumën prej ..... 20,000 (njëzetmijë) euro,
72. Naim Llugaliu shumën prej ..... 30,000 (tridhjetëmijë) euro,
73. N. M. shumën prej ..... 5,840 (pesëmijetetëqind e katër dhjetë) euro,
74. N. S. shumën prej ..... 31,000 (tridhjetenjëmijë) euro,
75. N. P. shumën prej ..... 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro,
76. N. D. shumën prej ..... 20,000 (njëzetmijë) euro,
77. N. Ll. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
78. P. L.shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
79. Q. K. shumën prej ..... 18,000 (tetëmbëdhjetëmijë) euro,
80. Q., J. dhe R. Berisha shumën prej .....34,000 (tridhjetë e katërt mijë) euro,
81. Q. R. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
82. R. K. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
83. R. M. shumën prej..... 25,000 (njëzetepesëmijë) euro,
84. R. S. shumën prej..... 12,000 (dymbëdhjetëmijë) euro,
85. R. B. shumën prej ..... 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
86. K. G. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
87. S. Sh. shumën prej..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
88. S. Z. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
89. S. H. shumën prej ..... 43,000 (katër dhjetë e tremijë) euro,

90. S. S. shumën prej ..... 2,000 (dymijë) euro,
91. S. Sh. shumën prej..... 7,000 (shtatëmijë) euro,
92. S. M. shumën prej.....10.000 (dhjetëmijë) euro,
93. S. M. shumën prej .....10,000 (dhjetëmijë) euro,
94. Sh. S. shumën prej .....11,200 (njëmbëdhjetë mijë) euro,
95. Sh. K. shumën prej .....12,800 (dymbëdhjetëmijë e tetëqind) euro,
96. Sh. Sh. shumën prej .....25,000 (njëzetë e pesë mijë) euro,
97. Sh. P. shumën prej .....12,200 (dymbëdhjetëmijë e dyqind) euro,
98. Sh. K. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
99. Sh. A.shumën prej..... 8,000 (tetëmijë) euro,

100.S. B. shumën prej .....11,500 (njëmbëdhjetëmijepesëqind) euro,

101.E. dhe S. F. shumën prej .....11,440 (njëmbëdhjetëmijë e katërqind e katër dhjetë) euro,

102.S. Xh. shumën prej ..... 8.000 (tetëmijë) euro,

103.S. S. shumën prej .....10,000 (dhjetëmijë) euro,

104.T. P. shumën prej.....17,500 (shtatëmbëdhjetëmijë e pesëqind) euro,

105. T. P. shumën prej ..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,

106. V. K. shumën prej .....14,500 (katërmbëdhjetëmijë e pesëqind) euro,

107. V. dhe A. I. shumën prej .....18,300 (tetëmbëdhjetëmijë e treqind) euro,

108. V. D. shumën prej ..... 11,000 (njëmbëdhjetë mijë) euro,

109. V. S. shumën prej..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,

110. V. L. shumën prej ..... 10.000 (dhjetëmijë) euro,

111. V. M. shumën prej ..... 10,600 (dhjetëmijë e gjashtëqind) euro,

112. Xh. S. shumën prej ..... 17,292 (shtatëmbëdhjetëmijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy) euro,

113. Xh. B. shumën prej ..... 17,376 (shtatëmbëdhjetëmijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) euro,

114. Xh. K. shumën prej ..... 32,500 (tridhjetedymijë e pesëqind) euro,

115. Xh. Xh. shumën prej .....5,000 (pesëmijë) euro,

116. Z. P. shumën prej .....6,500 (gjashtëmijë e pesëqind) euro,

117. Z. F. J. shumën prej .....15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,

118. Z. H. shumën prej .....8.000 (tetëmijë) euro.

8. Përtej shumës së gjykuar palët e dëmtuara të cekura më lartë, janë udhëzuar në kontest civil.

9. Të dëmtuarit: V. I., I. I., S. B., N. B., V. dhe R. H., S. B., F. M., F. Gj., H. K., H. H. dhe D. H., të paraqitur në aktakuzë si të dëmtuar, janë udhëzuar në kontest civil.

10. Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.Nr.5/2024 e datës 22.4.2024, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e ushtruara nga mbrojtësit e të pandehurve dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

11. Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

    - mbrojtësi i të pandehurës Estrida Bunjaku, av. Liridon Tafa, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ose të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, po ashtu është propozuar që në bazë të nenit 434 par.4 të KPP-së, të shtyhet ekzekutimi i sanksionit penal deri në marrjen e vendimit sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, apo të caktojë shtyrjen përkatësisht ndërprerjen e ekzekutimit të sanksionit penal;

- mbrojtësi i të pandehurit Vigan Bunjaku, av. Murat Demolli, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

- mbrojtësi i të pandehurit Burim Vokrri, av. Fanol R.Krasniqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet apo të ndryshohen dhe i pandehuri në mungesë të provave të lirohet nga akuza;

- i pandehuri Xhemajl Arifi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe i pandehuri të lirohet nga akuza ose të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;

- mbrojtësi i të pandehurit Xhemajl Arifi, av. Naim Q.Rudari, për shkak të shkeljes së Ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuar atë anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim apo të ndryshohen dhe i pandehuri të lirohet nga akuza në mungesë të provave, si dhe;

- mbrojtësi i të pandehurit Valon Orllani, av. Ramiz Krasniqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

12. Prokuroria e Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtresat KMLP.II.Nr.394/2024 të datës 12.11.2024 dhe 2.12.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruara nga

mbrojtësit e të pandehurve; Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokrri e Valon Orllani si dhe kërkesa e të pandehurit Xhemajl Arifi, të refuzohen si të pabazuara.

13. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, janë të bazuara.

15. Pretendimet nga kërkesat

a. Në kërkesë, mbrojtësi i të pandehurës Estrida Bunjaku, av. Liridon Tafa, nga P., pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat shkelje kanë të bëjnë me shkelje nga neni 384 par.2, nënpar.2.7 të KPP-së, pasi që aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përpiluar në pajtim me nenit 369 të KPP-së dhe në kundërshtim me par.7 të dispozitës së cekur. Kjo nga fakti se në aktgjykimin e saj, gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë mbi faktet vendimtare dhe të cilat përbëjnë elementet e veprave penale për të cilat është shpallur fajtore. Po ashtu, gjykata nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës së shkallës së dytë në rigjykim. Më tutje, mbrojtësi i referohet udhëzimeve nga Gjykata e Apelit e Kosovës, e cila në aktgjykim me të cilin është anuluar aktgjykimi i shkallës së parë, ka kërkuar që të vërtetohet fakti se a ka pasur pengesa reale ndërtimi ku për pasojë është shpërfaqur një gyp dhe për këtë është dashur të kërkohet nga Ujësjellësi Rajonal i Prishtinës. Gjykata e shkallës së parë, pasi që ka marrë përgjigjen në të cilën është konstatuar se pronarët e tokave (pa investitorin) kanë aplikuar për kushte teknike me datë 22.03.2010 dhe me datë 07.04.2010 është lëshuar dokumenti për kushtet teknike të pjesshme dhe është konstatuar që mund të ndërtohen vetëm 2 objekte, ndërsa 2 objekte tjera jo, për arsye se gypi që ka qenë nuk lejon të ndërtohen edhe dy të tjera. Fakt ky që gjykata fare nuk e konsideroi e sidomos faktin se pronarët e tokave duke anashkaluar investitorin bëjnë vet kërkesë për këtë gyp. Ndërsa gjykata e shkallës së dytë gjithashtu e anashkalon këtë fakt.

b. Sa i përket shkeljes së ligjit penal, mbrojtësi konsideron se ka pasur shkelje duke aplikuar gabimisht ligjin në kohën kur është supozuar se është kryer vepra penale dhe duke konstatuar "siç rezulton nga të cekurat më lartë periudha kohore e kryerjes së veprës penale përfshinë edhe kohën kur kishte ndryshime ligjore, pra, periudhën nga 02.09.2009 e deri më 31.12.2012 kur ishte në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës i vitit 2013 dhe periudha 01.01.2013 e gjer më datën 15.5.2014 kur ishte në fuqi Kodi Penal Nr.04/L-082 të cilat kode e sanksionojnë veprën penale të mashtrimit, edhe pse Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës i vitit 2004 ishte më i favorshëm sa i përket lartësisë së dënimit me burgim, ku është përcaktuar maksimumi prej 5 vite". Gjykata ka bërë rikualifikimin e veprës penale konform kodit penal që ishte në fuqi kur ishin ndërmarrë veprimet e fundit e duke u bazuar në Udhëzuesin e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, lidhur me nenin 7 i datës 30 prill 2017, ndërsa gjykata e shkallës së dytë jep arsyetim se "aktakuza është ngritur sipas Kodit Penal që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, megjithatë të akuzuarit janë shpallur fajtorë për veprën penale mashtrimi të kryer në vazhdim pasi që veprimet inkriminuese përfshinë edhe periudhën kohore pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal i cili ka hyrë në fuqi nga data 1 janar 2013, pasi që njëjtit kanë vazhduar t'i mbajnë në lajthitje të dëmtuarit për ndërtimin e banesave. Lidhur me këtë ekzistojnë para kontrata edhe gjatë vitit 2013, siç është rasti i S. F. B., me të cilën e akuzuara Estrida Bunjaku, e cila ka lidhur para kontratë mbi shitblerjen me datën 15.03.2013 si dhe marrëveshja e datës 25 janar 2013 e lidhur me S. M., për pagimin e qerasë, pra ka vazhduar aktiviteti inkriminues dhe si i tillë duhet të trajtohet në tërësi, andaj në këto situata meqë kemi të bëjmë me një vepër penale, zbatohet ligji i cili ka qenë në fuqi në momentin e ndërmarrjes së veprimit të fundit, pavarësisht që shumica e veprimeve janë kryer në kohën kur ka qenë në fuqi Kodi Penal i datës 6 prill 2004. Kolegji i gjykatës së apelit rikujton se vepra penale mashtrimi nga neni 355 par.5 të KPRK-së është e dënueshme prej 3-5 vjet burgim, ndërsa në kuptim të nenit 106 par.3 të KPRK-së, parashkrimi i ndjekjes penale përcakton periudhën kohore prej 10 vjet nga kryerja e veprës penale e dënueshme me më shumë se 5 vjet burgim, ndërsa dyfishi i kohës së parashkrimit të ndjekjes penale në

kuptim të nenit 107 par.8 të KPRK-së është 20 vite, andaj, edhe nuk është arritur edhe afati i parashkrimit". Gjykata e Apelit fare nuk e ka marrë parasysh nenin 2 të Kodit Penal të vitit 2013, ku zbatimi i ligjit më të favorshëm për të pandehurin do të duhej të zbatohej edhe nëse ka qenë vepër penale e vazhduar në të dy periudhat kohore, ku pretendohet se janë kryer veprat penale, andaj mbrojtja konsideron që ka ardhur deri te parashkrimi i veprës penale.

c. Mbrojtësi i të pandehurit Vigan Bunjaku, av. Murat Demolli, nga P., në kërkesë pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënpar.1.10 dhe par.2, nënpar.2.6 dhe 2.7 të KPP-së, e të cilat shkelje qëndrojnë në faktin se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe në të nuk janë paraqitur arsye lidhur me faktet vendimtare dhe se ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetim e lidhur me përmbajtjen e shkresave të çështjes, ku si rrjedhojë aktgjykimi i tillë nuk është përpiluar konform dispozitave të nenit 369 të KPP-së.
d. Këto paqartësi dhe kundërthënie qëndrojnë se me veprimet e përbashkëta (neni 31 i KPRK-së) të akuzuarve prej nga kjo rezulton me elementet qenësore të veprës penale të mashtrimit për çka edhe janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar të akuzuarit. Edhe pse, nga dispozitivi i aktgjykimit nuk rezulton se si janë marrë vesh të akuzuarit dhe cila ishte detyra apo kontributi i të dënuarit Vigan Bunjaku në këtë vepër penale e për të cilat pretendime Gjykata e Apelit fare nuk ka dhënë arsye. Mbrojtja në kërkesë thekson se si është e mundur që një punëtor i cili punon në kompani dhe kryen punët e veta të përcaktuara në atë vend pune edhe pse i njëjti nuk ka nënshkruar asnjë parakontratë e as që ka pranuar mjete financiare, përveç pagës mujore.
e. Sa i përket shkeljes së ligjit penal, mbrojtja konsideron se pasi që gjendja faktike është vërtetuar gabimisht ka edhe shkelje të drejtës materiale me rastin se shqiptimit të dënimit e sidomos pasi që i njëjti është obliguar me të dënuarit tjerë që në mënyrë solidare të paguaj dëmshpërblimin në lartësinë e pagesave të bëra të dëmtuarve.
f. Mbrojtësi i të pandehurit Burim Vokrri, av. Fanol R. Krasniqi nga P., në kërkesë pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1,

nënpar.1.9, 1.10 dhe par.2, nënpar.2.1, 2.4, 2.6 dhe 2.7 e lidhur me nenet 359, 364, 369 par.4 dhe me nenin 385 par.1.2, 1,3 dhe 1.4 të KPP-së, e të cilat shkelje konsistojnë në faktin se aktgjykimet janë të pakuptueshme, kundërthënëse në brendinë e tyre dhe në to nuk janë paraqitur arsye lidhur me faktet vendimtare, ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimet e tyre lidhur me përmbajtjen e shkresave të çështjes. Kështu, aktgjykimet janë marrë me shkelje të parimit "reformatio in peius" nga neni 395 të KPP-së, ngase përveç që është tejkaluar aktakuza nga gjykata e shkallës së parë, edhe Gjykata e Apelit në mungesë të ankesës së prokurorisë, tejkalon edhe aktgjykimin të cilin e vërteton në arsyetim edhe pse gjykata e shkallës së parë vërteton se prova e datës 15.03.2013 është jo relevante për periudhën që përfshihet në aktakuzë, Gjykata e Apelit, konstaton se pikërisht kjo provë është relevante për të mbështetur rikualifikimin e veprës penale, me qëllim për të zbatuar Kodin Penal të vitit 2012 dhe për të mbështetur vazhdimin e kryer të veprës penale edhe për këtë periudhë.

g. Sa i përket veprës penale të shpëlarjes së parave, gjykatat janë referuar dispozitave nga neni 32 të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, të cilat nuk e rregullojnë sanksionimin penal, por ka vetëm përkufizime, pra, gjykata fare nuk ka dhënë arsyetim lidhur me rrethanat për shqiptimin e dënimit për këtë vepër. Edhe fakti se gjykata me rikualifikimin e veprave penale "ex officio" e me të vetmin qëllim për t'iu shmangur parashkrimit. Më tutje, mbrojtësi konsideron se dispozitivët e aktgjykimeve janë të paqartë e që pasqyrohet nga fakti se nuk dihet se nga cilat prova materiale ka buruar, që i akuzuari Burim Vokrri ka shtyrë persona për të blerë banesa duke e ditur se nuk do të ndërtoheshin, ngase gjykatat nuk japin fare arsyetim për këtë fakt. Sa i përket shkeljes së ligjit penal, mbrojtja konsideron se aktgjykimet janë në kundërshtim me nenin 2 dhe 3 të KPRK-së, duke mos zbatuar ligjin në fuqi dhe ligjin më të favorshëm për të dënuarit (arsye pothuajse identike si në kërkesën e mbrojtësit të pandehurës Estrida Bunjaku).

h. Po ashtu, mbrojtja konsideron se në veprimet e të pandehurit Burim Vokrri, sa i përket veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.5 të KPRK-së, nuk është arsyetuar se cilat janë veprimet të cilat përbëjnë

elemente të kësaj vepre penale e sidomos paraqitja e rreme e fakteve apo fshehja e tyre.

i. Sa i përket vendimit për veprën penale shpëlarja e parave të dy gjykatat janë kundërthënëse me vetveten ngase konstatojnë se Burim Vokrri asnjëherë nuk ka pranuar nga Estrida Bunjaku banesë, lokal apo garazhe ku i njëjti në këtë rast edhe është i dëmtuar sepse i ka dhënë 7000 € hua të pandehurës Estrida Bunjaku dhe për këtë ka marrë si dëmshpërblim një veturë të tipit "...", ndërsa gjykatat si shpëlarje të parave konsiderojnë faktin se i njëjti me rastin e martesës ka pranuar një dhuratë dhomë fjetjeje dhe shpenzimet e dasmës e që është në kundërshtim me format e shpëlarjes së parave. Mbrojtja konsideron se gjykata duke zbatuar dispozitat e Kodit Penal ka rënë ndesh me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore dhe Ligjit për Ndërtimin, të cilat rregullojnë pikërisht veprimet të cilat përshkruhen në vendimet e goditura dhe bazuar në këto dispozita, veprimet e Burim Vokrrit, nuk përbëjnë figurën e veprës penale. Kjo ngase është e qartë se të gjitha veprimet janë në raport juridiko-civil ngase për ndërmjetësim, urdhërdhënësi detyrohet t'i paguajë shpërblim të caktuar nëse kjo kontratë do të lidhet dhe pikërisht këtë situatë e përshkruajnë vendimet e goditura në raport me të dënuarin edhe pse nuk përshkruhet se i njëjti ka qenë i suksesshëm në gjetjen e klientëve. Pavarësisht nga këto gjykata është dashur të arsyetojë elementin e dashjes dhe dijenisë për mashtrim posaçërisht të lidhjes së kontratës së punës në mes të dënuarit dhe kompanisë apo themelimin e kësaj të fundit për qëllim mashtrimi.

j. Mbrojtësi i të pandehurit Xhemajl Arifi, av. Naim Rudari nga P., pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje konsistojnë në faktin se në fazën e rigjykimit, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nuk kemi të bëjmë me veprën penale "krimi i organizuar" por ka gjetur se është kryer vepra penale e mashtrimit nga neni 335 par.5 lidhur me par.2 dhe 1 dhe nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, si vepër penale bazë e më pas kinse është kryer vepra penale nga i pandehuri Xhemajl Arifi "shpëlarja e parave" nga neni 32 sipas Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit lidhur me nenin 31 dhe nenin 81 të KPRK-së. Edhe pse gjykata nuk ka evituar shkeljet e

bëra më parë sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit për të vërtetuar se a kemi të bëjmë me mashtrim apo jo dhe cili është mashtrimi.

k. Mbrojtësi më tutje potencon edhe shkelje nga neni 384 par.1, nënpar.1.3 të KPP-së ngase në shqyrtime gjyqësore nuk janë ftuar të dëmtuarit madje palët e dëmtuara si palë në procedurë nuk janë ftuar të gjithë. Edhe fakti se aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme, pra në supozimin se e dënuara Estrida Bunjaku ka kryer veprën penale të mashtrimit dhe se i dënuari Xhemajl Arifi e ka ditur se paratë e përfituara janë nga veprimtaria kriminale dhe e ka ndihmuar në fshehjen e gjurmëve të pasurisë edhe pse nga gjykata është anashkaluar fakti se vet Estrida ka deklaruar se kishte marrë hua 400.000,oo €, nga i dënuari Xhemajl Arifi, ku më pas i kishte kthyer 50.000 € dhe se i kishte mbetur borxh pjesën tjetër, çka vërtetohet edhe me deklarimet e pronarëve të tokave të cilët kishin deklaruar se Xhemajli i kishte lutur ata që ta vazhdonin kontratën me Estridën dhe të përfundonin projektin e me qëllim që ai ta realizonte pjesën e tij të pagesës të cilën e kishte bërë me një marrëveshje ku ato para që ishin dhënë në emër të borxhin të llogariteshin si investim dhe të merrte sipërfaqe në ndërtesa për atë shumë parash.

l. Sa i përket shkeljes së Ligjit Penal mbrojtësi konsideron se ka shkelje të nenit 385 par.1, nënpar.1.1 të KPP-së, sepse nuk është vërtetuar se në veprimet e të dënuarit janë formuar elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor. Po ashtu, mbrojtja konsideron se ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes së veprës penale ngase dispozita e nenit 261 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës ku parashihet vepra penale mashtrimi, është paraparë dënim me burgim prej 6 muajve deri në 5 vjet, ndërsa neni 91 i të njëjtit ligj, parasheh se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës ës afatit të parashkrimit, nëse e marrim se vepra penale shpëlarja e parave sipas prokurorisë është kryer deri më datën 16 janar 2012, ndërsa vepra penale mashtrimi është kryer shumë më herët, atëherë rrjedhimisht me vet parashkrimin e veprës penale mashtrimi nuk mund të ekzistojë as vepra penale shpëlarja e parave. Sa i përket rikualifikimit të veprës penale në vepër penale të vazhdueshme, gjykata ka cituar dhe ka interpretuar gabimisht nenin 7 të Udhëzuesit të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut të datës 30 prill 2017 ku

në fund të këtij citati, i cili nuk është cituar në tërësi thuhet "Gjykata ka verifikuar gjithashtu se masa e dënimit që i ishte dhënë të interesuarit mbi bazën e veprës penale të vazhduar, nuk ishte më e rëndë se sa ajo që do t'i ishte dhënë atij në qoftë se aktet e kryera prej tij përpara formës legjislative do të ishin vlerësuar në mënyrë të veçuar nga ato të kryera pas asaj. Anasjelltas në qoftë se dënimi për vepër penale të vazhdueshme nuk ka qenë i parashikueshëm në vështrim të së drejtës kombëtare të zbatueshme në kohën përkatëse dhe ai ka sjellë si pasojë rëndimin e masës së dënimit që i është dhënë të interesuarit, atëherë gjykata del me konkluzion se ka pasur një zbatim prapa veprues të Ligjit Penal në dëm të këtij të fundit (Veeber K.Estonisë dhe Puhk. K. Estonisë).

m. Pra, edhe Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës ka rregulluar këtë çështje me nenin 2 ku në mënyrë eksplicite parashihet se ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, andaj ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm, e të cilat dispozita janë të njëjta edhe me Kodin Penal të vitit 2013 dhe 2018.

n. Mbrojtësi i të pandehurit Valon Orllani, av. Ramiz Krasniqi nga P., pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje konsistojnë në faktin se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetim e lidhur me përmbajtjen e shkresave të çështjes ku si pasojë aktgjykimi i tij nuk është përpiluar konform dispozitave të nenit 369 të KPP-së, të cilat shkelje Gjykata e Apelit nuk i trajton. Mbrojtësi pretendon se këto paqartësi dhe kundërthënie kanë të bëjnë jo vetëm me veprimet e përbashkëta të akuzuarve prej nga do të rezultonin elementet qenësore të veprës penale (shpërlarja e parave) për çka janë shpallur fajtorë dhe dënuar të akuzuarit, e që Gjykata e Apelit konsideron se nuk kemi të bëjmë m kundërthënie. Kështu, nga dispozitivi i aktgjykimit nuk rezulton se si janë marrë vesh të akuzuarit për të vepruar bashkërisht, cilat ishin detyrat e secilit, apo çka kishte kontribuar Valon Orllani në këtë vepër penale. Për më tepër,

asnjëra nga gjykatat nuk jep arsye lidhur me faktin se si janë bashkekzekutorë të pandehurit dhe ku qëndrojnë elementet e veprës penale. Për më tepër kolegji i Gjykatës së Apelit pothuajse me përbërje të njëjtë, në rastin e njëjtë, jo vetëm që nuk i përfillë vërejtjet e dhëna me aktgjykimin e mëparshëm, por del edhe në kundërshtim të plotë me këto vërejtje duke konstatuar tani se nuk ka asnjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale edhe pse aktgjykimet e shkallës së parë kanë autorët e njëjtë dhe këto aktgjykime janë pothuajse identike.

o. Sa i përket shkeljet së ligjit penal, mbrojtja konsideron se gjykata në rishqyrtim nuk ka sqaruar dilemat se ku qëndrojnë veprimet e të dënuarit Valon Orllani dhe cilat nga karakteristikat e veprës penale shpëlarja e parave janë përmbushur në këto veprime, kur kemi parasysh se i dënuari ka pranuar 16.000 €, nëpërmjet W. U. dhe ku qëndron pastrimi i parave nga i njëjti. Ndërsa sa i përket çështjes së truallit në fshatin Ll. në sipërfaqe prej 5 ari, i njëjti nuk është në lagjen "..." por është në fshatin Ll., është blerë nga N. K. e jo nga B. G. dhe kontrata është lidhur dhe paguar nga Valon Orllani. Për më tepër, si mundet të vendoset që Valon Orllani t'i kompensojë solidarisht të dëmtuarit në lartësinë e pagesave të bëra të dëmtuarve kur asnjë i dëmtuar as nuk e përmend emrin e tij dhe asnjë nga ta nuk thotë se i ka paguar para nga banesat e blera nga Estrida Bunjaku.

p. Në kërkesë i pandehuri Xhemajl Arifi të paraqitur nga ai vet pretendon se, aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje qëndrojnë në faktin se në pikën 2 të dispozitivit konstatohet "duke tentuar t'i konvertoj" ndërsa në cilësim juridik thuhet se kanë kryer dhe këto kontradikta e bëjnë të pa qartë aktgjykimin, sepse nuk dihet se a është kryer vepra penale apo është tentuar. Po ashtu, me asnjë fjali nuk është arsyetuar ku qëndron bashkëkryerja, pra elementi subjektiv se ata janë marrë vesh dhe elementi i dytë se ata kanë marrë pjesë në veprimin e kryerjes apo thellësisht kanë kontribuar në shkaktimin e pasojës. Gjykata ka parafrazuar nenin 32 par.2, nënpar.2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, por me asnjë fjalë nuk ka dhënë arsye se për cilën nga këto forma alternative që Ligji parasheh bëhet fjalë. Po ashtu, në arsyetim nuk ka asnjë fjalë se kur e dënuara Estrida

na ka dhënë shumën e parave prej 1.872,719 €, kujt ia ka dhënë dhe kush sa ka marrë nga totali i këtyre parave. Po ashtu, gjykata anashkalon faktin se me një autorizim nga e njëjta, unë kam ndërtuar dhe përfunduar objektin me pëlqim urbanistik e që nuk është kontestuese si dhe faktin se e dënuara Estrida kishte deklaruar se kishte marrë nga unë shumën prej 350.000,oo ose 400.000,oo €.

q. Sa i përket shkeljes së ligjit penal, i pandehuri Xhemajl Arifi konsideron se në veprimet e tij nuk ka elemente të veprës penale për të cilën është shpall fajtor por ka një raport të pastër civilo-juridik.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, gjen se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje të ligjit penal në dëm të pandehurve e të cilat shkelje do të përshkruhen më poshtë.

2. Fillimisht duhet të theksohet se Prokuroria Speciale e Kosovës, kishte ngritur aktakuzë PPS.Nr.04/20215 të datës 12.05.2016, kundër të akuzuarve: Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku dhe Burim Vokrri, për shkak të veprës penale krimi i organizuar nga neni 274 par.1 lidhur me par.2 në raport me Estrida Bunjaku, par.3 të KPK-së, lidhur me veprën penale mashtrimi nga neni 261 par.1 lidhur me par.2 të KPK-së, si dhe kundër të pandehurve: Estrida Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokrri, Valon Orllani dhe Faton Orllani, për shkak të veprës penale shpërlarja e parave nga neni 32 par.2 pika 2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit lidhur me nenin 31 të KPK-së. Ndaj të pandehurës Estrida Bunjaku edhe për veprën penale shkaktimi i falimentimit nga neni 234 të KPK-së, dhe shmangie nga tatimi nga neni 249 par.1 lidhur me par.2 të KPK-së.

3. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.Nr.06/2019 të datës 15.06.2022, të pandehurit: Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku dhe Burim Vokrri, janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale krimi i organizuar nga neni 283 par.1, lidhur

në raport me Estrida Bunjaku, par.2 të KPRK-së lidhur me veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.5 e lidhur me par.1 dhe 2 të KPRK-së. Të pandehurit: Estrida Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokrri, Valon Orllani, janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale shpërlarja e parave nga neni 32 par.2 pika 2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa i pandehuri Faton Orllani është liruar nga akuza. E pandehura Estrida Bunjaku, është liruar nga akuza për shkak të veprës penale shkaktimi i falimentimit nga neni 234 të KPK-së dhe shmangie nga tatimi nga neni 249 par.1 lidhur me par.2 të KPK.

4. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.Nr.41/2022 e datës 24.03.2023, duke vepruar sipas ankesave të palëve, ka anuluar aktgjykimin sa i përket pjesës dënuese dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim ndërsa në pjesën liruese e ka refuzuar akuzën për shkak të parashkrimit.

5. Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim të pandehurit: Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku dhe Burim Vokrri janë shpallur fajtorë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.2 dhe par.1 dhe me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, si dhe të pandehurit: Estrida Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokrri dhe Valon Orllani, janë shpallur fajtor për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale shpëlarja e parave nga neni 32 par.2, nënpar.2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së. Pra, gjykata e shkallës së parë, ka bërë ri kualifikimin juridik të veprës penale, fillimisht duke e eliminuar krimin e organizuar si dhe duke gjetur se vepra penale e mashtrimit nga neni 335 (sipas Kodit Penal të vitit 2012) është kryer në vazhdim (neni 81 të KPRK-së) si dhe duke gjet se vepra penale shpëlarja e parave nga neni 32 par.2, nënpar.2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit e lidhur me nenin 31 është kryer në vazhdim (neni 81 të KPRK).

6. Gjykata Supreme ka vlerësuar aktgjykimet e dy instancave në raport me pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe ka gjetur se të gjitha kërkesat po thuajse kanë pretendime të ngjashme lidhur me shkeljet e ligjit penal dhe vlerëson se me të drejtë pretendojnë mbrojtësit e të pandehurve se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje procedurale esenciale dhe me shkelje të Ligjit Penale, për arsye si në vijim:

a. Nuk është kontestuese se e pandehura Estrida Bunjaku, ka themeluar kompaninë "V. O G." në vitin 2010, e me qëllim primar ndërtimi i objekteve banesore. E njëjta, për këtë qëllim ka marrë zyrën dhe ka punësuar të pandehurin Burim Vokrri, të cilin e ka njohur që nga koha kur ka punuar në R. B.dhe i cili ka marrë pozitën zyrtar i shitjes deri në vitin 2012. Pagesa e pagës për të është bërë nëpërmjet llogarisë së bankës si dhe me kohë është punësuar dhe i pandehuri Vigan Bunjaku (vëllai i të pandehurës Estrida). Po ashtu, nuk është kontestuese se e pandehura Estrida për të realizuar planin e saj – ndërtimin e një kompleksi banesor kishte kontaktuar me pronarët e tokave në lagjen "..." dhe atë me 12 pronarë dhe me ta kishte një kontratë mbi ndërtimin e përbashkët ku ajo ka hyrë me 71%, ndërsa pronarët e tokave me 29%. Kjo kontratë është vërtetuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe pas nënshkrimit e njëjta ka bërë kërkesë në Komunën e Prishtinës për kushtet urbanistike për çka edhe ka marrë përgjigje se është i lejuar ndërtimi i lartë. Pas kësaj është dërguar projekti ideor dhe nga Drejtorati Komunal i Urbanizmit është aprovuar leje urbanistike që ka të bëjë me kushte ndërtimore. Për të filluar ndërtimin e pandehura Estrida kishte lidhur marrëveshje me kompaninë "V. A." të cilët edhe kanë filluar punimet dhe është bërë ndërtimi i vrazhdë deri në katin e V-të në ndërtesën A1, ndërsa kanë vazhduar edhe punimet në rrëmihje për objektin e dytë dhe se me këtë rast është zbuluar se në atë vend është një gyp i Kompanisë K.. "P." dhe është pamundësuar vazhdimi i punës. Po ashtu, është fakti i pakontestueshëm se K. "P." fillimisht ka dhënë pëlqim për kushtet teknike të pjesshëm me arsyetimin se në lokacionin në fjalë shtrihet gypi furnizues magjistral ... mm., i ujit dhe se ndërtesat A2 dhe 3 nuk mund të ndërtohen. Më tutje, në procedurën administrative të shqyrtimit dhe vendosjes së kërkesës për leje ndërtimore, ka dhënë kushte teknike për ndërtimin e ndërtesave A3 dhe

A4 bazuar në lejen urbanistike e cila ishte siguruar nga investitorët të cilët e kanë vazhduar ndërtimin pasi që e pandehura Estrida i kishte shkëputur marrëveshjen me pronarët e tokave. Gjithashtu, qëndron fakti se e pandehura Estrida kishte filluar shitjen e banesave në kompleksin në lagjen ... dhe se me këtë rast kishte lidhur para kontrata me një numër të madh të personave të cilit kishin paguar shuma të ndryshme të parave duke filluar prej 5000 € e më lartë e në emër të paradhënies. Të gjitha këto fakte janë vërtetuar drejtë nga dy gjykatat e instancave më të ulëta e gjithashtu është vërtetuar edhe fakti se e pandehura Estrida pas marrjes së kushteve urbanistike kishte aplikuar edhe për leje për ndërtimin e banesave dhe kishte marrë përgjigjen ku ishte përcaktuar edhe shuma prej 246,204.84 € si kompensim për rregullimin e tokës ndërtimore e cila shumë në qoftë se nuk do të paguhej brenda afateve të caktuara do të pasojë pezullimi i procedurës për lëshimin e lejes ndërtimore në bazë të së cilës edhe është llogaritur kompensimi. Meqenëse e pandehura kishte filluar ndërtimin e objekteve bazuar në kushtet urbanistike (sepse në atë kohë kjo ishte e mundur bazuar në rregullativën ligjore), kishte filluar edhe shitjen e banesave. Në pamundësi të pagesës së shumës së përcaktuar nga Drejtoria e Urbanizmit, kishte filluar edhe stagnimi i punimeve e për më tepër është paraqitur edhe problemi i gypit për të cilin janë kërkuar 200.000,00 € për largimin e të njëjtit dhe në këto momente firma "V. O G." është bllokuar. Pronarët e tokave me të vërejtur se është ndërprerë puna, kanë kërkuar nga e pandehura që të vazhdojë punën apo t'i tregojnë arsyet e mos vazhdimit të punimeve. Përkundër të gjitha kërkesave e pandehura në pamundësi financiare është detyruar që me pronarët e tokave të shkëputë kontratën e cila është vërtetuar në gjykatë dhe t'ia bartë të gjitha autorizimet të pandehurit Xhemajl Arifi, i cili është autorizuar të ndërmerre veprime të nevojshme me pronarët e tokave ndërsa e pandehura Estrida ka marrë të gjitha obligimet e krijuara ndaj personave të tretë (blerësve të banesave apo lokaleve, punë kryesve etj.) ndërsa pronarët e tokave janë pajtuar që të bëjnë shkëputjen formale të kontratës për ndërtimin e përbashkët e po ashtu janë pajtuar që investimi i bërë në paluajtshmëritë e pronave t'i kompensohet investitores (Estridës) sipas vlerësimit i cili do të bëhet nga një grup ekspertësh profesional nga lëmi i ndërtimtarisë. Me të

njëjtën marrëveshje pronarët e tokave janë pajtuar që ky investim i vlerësuar do të kompensohet në para apo në ndërtim me investitorin e ardhshëm për vazhdimin e projektit të aprovuar nga Drejtoria Komunale për Urbanizëm. Po ashtu, është vërtetuar se i pandehuri Xhemajl Arifi në cilësinë e investitorit tashmë, ka lidhur kontratë me pronarët e tokave të cilët janë pajtuar që të vazhdojnë ndërtimin e objekteve dhe kanë lidhur kontratë me kompaninë "A. G." SH.A për vazhdimin e ndërtimit të objekteve për të cilat tashmë kanë ekzistuar-lejet përkatëse, ndërsa me të njëjtën kontratë e cila është vërtetuar në gjykatë, është përcaktuar se i pandehuri Xhemajl Arifi, i cili tashmë kishte autorizim nga Estrida Bunjaku, ku të gjitha obligimet e dala nga kontrata paraprake bien mbi investitorin "V. O G.", ndërsa investimi i bërë i deri tashëm mbetet në pronësi të Xhemajl Arifit. Po ashtu, kjo gjykatë gjen se të gjitha këto janë marrëdhënie civilo-juridike të cilat dalin nga kontratat e lidhura në mes të palëve kontraktuese. Ndërsa, nga provat të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor gjen se gabimisht të dy gjykatat e kanë vlerësuar faktin se i pandehuri Xhemajl Arifi ia kishte dhënë hua të pandehurës Estrida shumën prej 400.000,oo € nga të cilat e njëjta i kishte kthyer 50.000,oo €, ndërsa për pjesën tjetër të parave ekziston marrëveshja për kompensim me sipërfaqe banimi prej 1000 m2 në objektin i cili ishte ndërtuar nga e pandehura Estrida. Kjo duke u nisur se në shkresa përveç deklarimit të pandehurës Estrida dhe të pandehurit Burim Vokrri, i cili në deklaratën e tij konfirmon se ka qenë prezent kur është bërë dorëzimi i parave, gjendet edhe deklarata e vërtetuar në gjykatë me datën 8.9.2009 sipas numrit Vr.Nr. ... ku e njëjta deklaron se nga i pandehuri Xhemajl ka pranuar mjete financiare në shumë prej 350.000,oo € për fillimin e ndërtimit të objekteve banesore dhe se afati i kthimit ka qenë me datën 30.10.2009, e në rast të moskthimit të këtyre mjeteve e njëjta është pajtuar që të pandehurin Xhemajl Arifi t'ia kompensojë me hapësirë banesore prej 1000 m2 në hapësirat banesore .... Gjykata e shkallës së parë në arsyetim gabimisht konstaton se deklarata e vërtetuar dhe e vulosur në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Graqanicë, me numër Vr.Nr.7408/09 datë 8.9.2009 ngase nuk kishte kontratë të vërtetuar në gjykatë dhe se deklaratat e të pandehurve ishin kontradiktore e po ashtu konstaton se kjo dëshmi nuk është vulosur në

gjykatë e që bie ndesh me provat materiale të cilat gjenden në shkresa të lëndës.

b. Nga shkresat po ashtu, vërtetohet se e pandehura ka tentuar që të vazhdojë ndërtimin duke lidhur kontratë me pronarë tjerë të tokave dhe atë N. S. A. dhe R. H. A., me të njëjtat kushte sikur edhe me pronarët tjerë, e cila kontratë është lidhur dhe vërtetuar në gjykatë me datën 19.04.2012. Lokacioni ishte në lagjen M. dhe e pandehura kishte filluar ndërtimin e objekteve banesore, por punimet ishin ndërpre pasi që Inspektorati Komunal kishte konstatuar se lidhur me këto parcela kishte kontest gjyqësor dhe se deri në vendosje punët duhet të ndërpriten.
c. Gjykatë fillimisht vlerësoi kërkesat e mbrojtësve të pandehurve Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku dhe Burim Vokrri sa i përket veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.2, nenin 31 dhe 81 të KPRK-së dhe konstatoi se në veprimet e tyre nuk formohen elementet e veprës penale për të cilën janë, shpallur fajtorë për arsye si në vijim:

7. Çka është vepra penale e mashtrimit si vepër penale kudër pasurisë?

a. Mashtrimi është një vepër penale e orientuar kundër pasurisë (*së luajtshme dhe të paluajtshme),* duke përfshirë edhe të drejtat dhe interesat pasurore. Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale qëndron në paraqitjen **e rrejshme të fakteve a duke i fshehur faktet**.
b. Me paraqitjen e rrejshme të fakteve nënkuptohet pohimi për ekzistimin e ndonjë fakti që nuk ekziston, përkatësisht paraqitja e fakteve ndryshe nga ajo që vërtet ekziston, (ajo që ekziston tregohet jo saktësisht). Fshehja e fakteve ekziston kur kryerësi ndonjë person e mashtron për mosekzistimin e fakteve ekzistuese apo e hesht ekzistimin e tyre, përkatësisht përmbajtjen e tyre, nëse ka ekzistuar detyrimi i tij që ato fakte t'i tregonte. Ndërkaq, te tregimi i rrejshëm, kryerësi e bind ndonjë person për ekzistimin e ndonjë fakti që nuk ekziston, d.m.th., te fshehja ai pengon personin që t'i mësojë faktet që vërtet ekzistojnë e të cilat janë relevante për pasjen në dispozicion të pasurisë së tij dhe pasurisë së huaj dhe të cilat do ta zmbrapsin nga pasojat e dëmshme në raport me këtë pasuri.

c. Si prokurori në aktakuzën e tij, sikundër gjykata që e ka gjykuar çështjen, formalisht përdorin shprehjet e Kodit Penal për mashtrimin, citojmë " **me paraqitje të rrejshme apo duke i fshehur faktet** "por nuk e japin asnjë arsye se cilat fakte i paska fsheh e dënuara Estrida Bunjaku dhe në çfarë dimensioni qenka prezantuar rrejshëm, ngase ligji i parasheh dy alternative të mundshme të mashtrimet, si prokuroria në aktakuzë sikundër gjykata që e ka gjykuar çështjen, nuk japin asnjë shpjegim në këtë drejtim, ngase nuk ekziston as fshehja e as prezantimi i rrejshëm, e pa këto rrethana kjo vepër penal nuk mund të ekzistoj.
d. E dënuara, me të gjithë blerësit e interesuar, kishte lidhur para kontrata në përputhje me ligjin, ashtu siç funksionon tregu i ndërtimit, në para kontratat u përcaktuan detyrimet e kontraktuesve dhe dinamika e përmbushjes së detyrimeve reciproke, pastaj pasojat e mos përmbushjes së kontratës, asgjë nuk ka fshehë, por nuk i ka kryer-përmbushur obligimet kontaktuese ndaj blerësve, e njëjta gjë hipotetikisht ka mund t'u ndodhë palës tjetër kontraktuese - blerësve, që të vendosen në apartamente dhe mos t'i përmbushin detyrimet nga kontrata, ngase janë rënë vështirësi financiare.
e. E dënuara kishte biznesin e saj legalisht të regjistruar, që atë e legjitimonte të merret më ndërtime dhe kështu kishte vepruar, sigurisht ka kalkuluar se është në gjendjet që t'i përmbush detyrimet kontraktuale dhe ka hyrë në aranzhime të tilla, më shumë blerës të interesuar për banesa, mirëpo gjatë procesit të punës së saj, nuk i kanë shkuar punët ashtu si ajo ka llogaritur dhe nuk ka mundur t'i përmbush obligimet kontraktuale ndaj blerëseve me të cilit kishte lidhur para kontrata, e që s'do mend se mos përmbushja e obligimeve kontraktuale është veprim i paligjshëm, por jo vepër penale, pa ekzistuar qëllimi mashtrues i të dënuarës, e që në rastin konkret, nuk ka asnjë provë që e argumenton një veprim të tillë dhe prova të tilla nuk janë prezantuar dhe arsyetuar në këtë aktgjykim.
f. Qëllimi i mashtrimit është **përfitimi i dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme**. E dënuara lidhi para kontratë me të gjithë blerësit e interesuar në përputhje me çmimin e tregut që ishte atë kohë, te vepra penale e mashtrimit, kryesi i veprës penale paraprakisht shpreh qëllimin mashtrues (*prezantohet rrejshëm apo i fshehë faktet*), u sqarua

më sipër asnjëri nga elemente e mashtrimit nuk ishin të pranishëm në veprimet e të dënuarës. Po mos të ishte e dënuara e bindur se është në gjendje t'i përmbush detyrimet, në asnjë mënyrë nuk do futej në rreziqe të tilla, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se ajo, **jo që ka përfituar materialisht**, e që përfitimi i kundërligjshëm është element primar i kësaj vepre penale, por përpos që ka dëmtuar kontraktuesit -blerësit e interesuar (*nuk ua ka përfunduar apartamentet sipas kontratës*) e dënuara ka bankrotuar edhe vet veten dhe familjen e saj, ngase për t'ua kthyer borxhet kontraktuesve ka shitur edhe shtëpinë e babi të saj duke i lënë në rrugën familjen e saj dhe duke u futur në borxhe të mëdha tek personat tjerë.

g. Do mund të thuhej se bëhet fjalë për mashtrim duke u prezantuar rrejshëm, sikurse në rastin konkret e dënuara Estrida Bunjaku, blerësve-dhënëseve të tokës për ndërtim, t'iu thoshte se posedon ndërmarrje ndërtimore e që realisht nuk e kishte, apo se ka blerë toka për ndërtimin e banesave, pa i blerë fare, mirëpo në rastin konkret nuk kishin një situatë të tillë, ajo kishte biznesin e saj për ndërtim, kishte blerë toka për ndërtim dhe në të gjitha objektet që i kishte filluar me i ndërtuar kishte pëlqim urbanistik.
h. Është fare e qartë, se në rastin konkret, bëhet fjalë për raport të pastër civilo- juridik, e jo për vepre penale të mashtrimit, siç pretendon prokurori me aktakuzë dhe siç kanë gjetur dy gjykatat instancionale, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se biznesit të të dënuarës nuk i kanë shkuar punët mbarë, sipas parashikimeve dhe dinamikës së planifikuara, për pengesa të ndryshme, duke përfshirë edhe ato administrative komunale dhe zvarritje e tilla e kanë falimentuar biznesin e saj. Nuk konsiderohet vepër penale çdo mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale, për faktin se, kontestet e tilla mbrohet me ligjet tjera civile e jo me KP.
i. Nëse e shihet kronologjia e ndërtimit të akti akuzues, rezulton se çështje penale ndahet në dy periudha të ndryshme kohore, me vepra penale të ndryshme edhe atë: Periudha kur tani e dënuara Estrida Bunjaku, si pronare e kompanisë "V. O G." me disa kontaktues kishte lidhur para kontrata për blerjen e banesave, me disa të tjerë kontratë për bashkimin e punës dhe mjeteve, e që të gjitha para vitit 2013, ku ka filluar të aplikohet Ligji i vitit 2012, e që nga prokuroria dhe dy

gjykatat po konsiderohet si vepër **penale e mashtrimit** dhe periudhën e dytë, kur kjo e dënuar ka kontraktuar nënkontraktues të ndryshëm, për punë të ndryshme, për përfundimet e objekteve që ajo kishte detyrim t'i ndërtonte, e të cilat veprime nga prokurori dhe dy gjykatat instatncionale po konsiderohen, për të dënuarën Estrida Bunjaku dhe të dënuarit e tjerë **shpëlarje e parasë**.

j. Edhe sikur të ekzistonte vepra penale e mashtrimit, u sqarua më sipër se bëhet për raport të pastër civile- juridike, çështja rezulton e parashkruar për këto arsye:

- Nga përshkrimi faktik i veprës penale në dispozitivin 1.të aktgjykimit, rezulton se të gjitha para kontratat me të dëmtuarit, për të cilat prokuroria ka pretenduar se janë **lidhur me mashtrim** dhe këtë pretendim të prokurorisë e kanë pranuar edhe dy gjykatat instancionale, janë kryer në periudhën 2009 -2012, kur në fuqi ishte KP i viti 2004. Ky kod, veprën penale të mashtrimit e parashihte në nenin 261 i cili kishte dy paragrafë, paragrafi 2 ishte cilësues, për shkak të vlerës së dëmit mbi 15,000 € dhe parashihte dënim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vite. Në nenin 90 par.1, nënpar.1.5 të KPK, parashihej që afati relativ i parashkrimit për vepra penale të dënueshme deri në pesë (5) vjet është pesë (5) vite, ndërsa në nenin 92 .par.6 theksohej se ndjekja penale ndalohet nëse ka kaluar dyfishi i kohës së paraparë.
- Nga viti 2009-2012 e deri më datë 24.08.2024, kur aktgjykimi ka marr formën e prerë, kanë kaluar mbi 10 deri në 15 vite, ndërsa për veprën penale nga neni 261 par.2 të KPK, që ishte në fuqi kur janë lidhë para kontratat, afati absolut është 10 vite .d.m.th. në kohën e gjykimit këto vepra penale ishin të parashkruar.
- Në shqyrtim gjyqësor prokurori e ri cilësoi veprën penale sipas KPK të viti 2012, për ta shmangë parashkrimin e veprës penale të mashtrimit, dhe me këtë cilësim të paligjshëm, u pajtuan edhe dy gjykatat instancionale, ngase lidhur me veprën penale të mashtrimit edhe po të ekzistonte , në asnjë mënyrë nuk ka mundur të zbatohet ligji i vitit 2012, siç gabimisht ka vepruar gjykata e shkallës së parë, ngase me këtë ka cenuar një parim fondamental në të drejtën penale, se ndaj kryesit të veprës penale aplikohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, ndërsa

ligji i më vonshëm vetëm nëse është ma i favorshëm për të pandehurin, e që në rastin konkret nuk kemi një situatë të tillë, ngase neni 335 i KPK të vitit 2012 (që ka hyrë në fuqi nga 01.01.2013), të cilin e ka aplikuar Gjykata ndaj të dënuarve është dukshëm më i ashpër se neni 261 i KPK që ishte në fuqi në kohën kur pretendohet se ishin kryer të gjitha veprat penale të mashtrimit, për faktin se përmban edhe 4 paragrafë që Kodi në fuqi nuk i kishte dhe të gjithë paragrafët janë dukshëm më të ashpër se ato dy paragrafë nga neni 261 i KPK të vitit 2004.

8. Shpëlarja e parasë

a. Në rastin konkret, vepra penale e shpëlarjes së parave, organikisht është e lidhur me veprën penale të mashtrim, për të cilën u sqaruar më sipër se nuk ekziston, por edhe sikur të ekzistonte është parashkruar, Gjykata Supreme e sheh të nevojshme që edhe këtë dimension ta sqaroj. Të dënuarit Xhemajl Arifi i vihet në ngarkesë vepra penale e shpëlarjes së parasë, fakti se ai është autorizuar nga e dënuara Estrida Bunjaku që të vazhdoj me ndërtimin e objektit të cilën ajo tanimë e kishte filluar por kishte ngecur për shkak të vështirësive financiare dhe borxhit që e dënuara Estrida ia kishte Xhemajlit, të dënuarit Burim Vokrri i vihet ë ngarkesë vepra penale e shpëlarjes së parasë, fakti se ai kishte marrë një automjet ..., një dhomë të fjetjes, shpenzime për dasmë, shpenzime verore e shpenzime të tjera, të dënuarit Valon Orllani si shpëlarje të parasë, i vihet nga ngarkesë fakti se: gjatë viti 2009, në xhirollogarinë personale ka pranuar 16.000 €, në vitin 2010, nga A. B., ka pranuar 14.600 € në emër të pagesës për banesën e blerë, nga Estrida Bunjaku ka pranuar një xhipin "... "në vlerë prej 35.300 € dhe ka blerë një truall në fshatin Ll., në sipërfaqen prej ... ari. Asnjë nga veprimet e përshkruara më sipër nuk përmbajnë asnjë element të veprës penale të shpëlarjes së parasë, po janë raporte kontraktuale në mes të palëve.

b. Nga shkresat e lëndës përtej çdo dyshimi rezulton se i dënuari Xhemajl Arifi, nuk ka marr para nga Estrida Bunjaku për t'i mundësuar asaj shpëlarjen, siç gabimisht është konstatuar në aktgjykimin e atakuar, por përkundrazi, meqenëse ajo ndodhjen në vështirësi financiare, i dënuar Xhemajl, i ka dhënë 4000.000 € hua, ky fakt i provuar me prova

të pakontestueshme, pretendimet e prokurorit dhe gjetjet e gjykatës se i dënuari Arifi, paska marr para nga e dënuara Estrida Bunjaku etj., për t'i ndihmua shpëlarjen e parave, që ajo i kishte përfituar me veprime kriminale-me mashtrim, janë konstatime me hamendësime dhe të pambështetura në asnjë provë, në çka me të drejtë tërheq vërejtën mbrojtësi në kërkesën e tij edhe sikur t'i kishte marr nga Estrida Bunjaku "*shumën e pacaktuar të parave*" i dënuari Xhemajl, nuk do konsiderohej ndihmë në shpëlarje të parasë, ngase i ka investuar në objektin ku ajo kishte pëlqim urbanistik për ndërtim po edhe detyrim karshi kontraktuesve-blerësve, **edhe veprimet e dy** dënuarve të tjerë; Burim Vokrri dhe Valon Orllani, nuk kanë të bëjnë fare me këtë vepre penale. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar, se të pandehurit, duke e ditur se e pandehura Estrida parat i ka përfituar me vepër penale, bashkërisht i kanë ndihmuar që t'i shpërlaj ato, pa dhen asnjë arsye të vetme se ku i mbështetë përfundimet e tilla, se ata e paskan ditur dhe pa dhënë asnjë të vetmin sqarim se si paskan bashkëvepruar, kur qenkan marrë veshë, ku, si, gjithashtu gjykata nuk ka dhënë asnjë arsye të vetme se: **kur, ku dhe** sa para, ka dhënë e dënuara Estrida Bunjaku, secilit nga të dënuarit për t'ia shpërlarë ato para.

c. Aktgjykimi është i paqartë edhe sa i përket cilësimit juridik, ngase të dënuarit: Estrida Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokrri dhe Valon Orllani, që të gjithë janë shpallë fajtorë për veprën penale të shpëlarjes së parasë, të parashikuar nga neni 32 par.2, nënpar.2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPK, për faktin se secilit të dënuar i vihen në ngarkesë veprime të ndryshme, e që nga gjykata po konsiderohet shpëlarje e parasë, ndërsa veprimet e të gjithëve cilësohen me paragraf dhe nën paragrafë të njëjtë (2.1,2.2, 2.5, 2.6), ndërsa neni 32 ka gjithsejtë tetë (8) nën paragraf që rregullojnë dhe sanksionojnë situata të ndryshme, nuk është e mundur që veprime e ndryshme të të dënuarve të vihen nën normën e njëjtë penale juridike.

9. Me të drejtë me kërkesën e të pandehurit Xhemail Arifit dhe të tjerëve pretendohet se Gjykata e Apelit me ankesat e para i pranoj ankesat dhe anuloj aktgjykimin e ankimuar PKR.Nr.06/2019 datë 15.06.2022, me konstatimi se është i përfshirë me shkelje procedurale, ligjore,

konstatim të gabuar të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë në rigjykim, vetëm ka rihap formalisht çështjen, por asgjë nuk ka ndryshuar, asnjë veprim shtesë nuk ka marr dhe aktgjykimi i dytë është në tërësi i njëjtë me atë të parin, përpos me vendimin për dënimi, ku të pandehurve u është ulë dënimin. Aktgjykimi i dytë PKR.Nr.60/2023 dt.17.11.2023, (*me rastin e rigjykimit*) i përmban po të njëjta shkelje që i përmbante aktgjykimi i parë, për të cilat Gjykata e Apelit e kishte anuluar, mbrojtësit e të pandehurve me rastin ankesave të dyta, ndaj këtij aktgjykimi kishin vënë në pah, po të njëjta shkelje që realisht ekzistonin, për çudi Gjykata e Apelit, i refuzon ankesën dhe vërteton aktgjykimin e dytë edhe pse u përshkruar më sipër ishte i njëjtë me atë të parin, pos me vendimin për dënimin, tani shfaqen dilema, se njëri vendim i gjykatës së Apelit rezulton i paligjshëm, aktgjykimi APS.nr41/2022 datë 24.03.2023, me të cilin ka anuluar aktgjykimin PKR.Nr.06/2019 datë 15.06.2022, apo aktgjykimi APS.nr41/2022 datë 24.03.2023, me të cilin aktgjykimin e shkallës së parë PKR.Nr.60/2023 datë 17.11.2023, e vërteton.

10. Gjykata meqë të dënuarit i liroi akuza, vendosi që trualli i konfiskuar nga i dënuari Valon Orllani, në fshatin Ll., t'i kthehet në pronësi pronarit, për faktin edhe sikur të mbetej aktgjykimi dënues nuk kishte as një bazë ligjore që t'i konfiskohej, ngase këtë truall ky i dënuar e kishte blerë nga personat tjerë, e që nuk kishin asnjë lidhshmëri me të dënuarën Estrida Bunjaku.

11. Meqenëse të dënuarit janë liruar nga akuza, gjykata ka vendosur që konform nenit 453 të KPPK shpenzimet e procedurës të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

12. Vendimi për udhëzimin e të dëmtarëve në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është i bazuar në nenin 462 par.3 i KPP-së.

13. Nga të gjitha këto që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitës së nenit 438 të KPP-së.

Aktgjykim i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës-
PML.Nr.752/2024, datë 07.05.2025

’’Me këtë aktgjykim Gjykata Supreme ka dhënë sqarime lidhur me përcaktimin se kur mund të konsiderohet se janë përmbushur elementet e veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje nga neni 178 lidhur me nenin 33 të KPRK-së. Po ashtu me këtë aktgjykim , gjykata ka potencuar se Gjykata e Apelit është e obliguar që sipas detyrës zyrtare të kujdeset lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, ashtu sikur e parasheh KPP-ja dhe duhet të jep arsye ligjore lidhur me shkeljet esenciale të pretenduara në ankesë.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.Nr.198/2021 të datës 28.02.2024, i pandehuri Prek Gjugja, është shpallë fajtor për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasja nga neni 178 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, dhe i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vite, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 16.02.2021 e deri më datë 13.01.2022, të cilin dënim do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dëmtuarit K. (M.) B., V.(M.) B. dhe A.(M.) N., të tre nga fshati M., komuna e Gj., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil. I pandehuri është obliguar që t’i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 400 € si dhe në emër të Fondit për Kompensimit e Viktimave të krimit, shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

2. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PAKR.Nr.305/2024 e datës 13.06.2024, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të përfaqësuesve të dëmtuarve si dhe ankesën e mbrojtësit të pandehurit dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

3. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit Prek Gjugja, av. Salih Mekaj, nga P., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.1., 2.2, 2.6 dhe 2.7 lidhur me nenin 7 par.2, neni 9 par. 2, lidhur me nenin 369 par. 6 dhe 7 KPP-së, si dhe për shkak të ligjit penal me propozim që kërkesa të aprovohet, aktgjykimet të anulohen dhe çështja të kthehet për rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë apo të ndryshohen në atë mënyrë që i pandehuri të lirohet nga akuza në bazë të nenit 363 par 1 pika 1.1. dhe 1.4 të KPP-së.

4. Përgjigje në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur përfaqësuesi i të dëmtuarve V.B. dhe K. B., av. Natal Bullakaj, me propozim që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruar nga mbrojtësi i të pandehurit, të refuzohet dhe aktgjykimet e atakuara të vërtetohen apo të ndryshohen dhe të pandehurit t'i shqiptohet një dënim më i lartë.

5. Prokuroria e Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KMLP.II.Nr.431/2024 datë 13.12.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të pandehurit.

6. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

   - kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e bazuar.

7. Në kërkesë, mbrojtësi i pandehurit, avokati Salih Mekaj, pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.1., 2.2, 2.6 dhe 2.7 lidhur me nenin 7 par.2, neni 9 par.2, lidhur me nenin 369 par.6 dhe 7 KPP-

së, ngase në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme, të plota e të qarta se pse gjykata i quan të pabazuara pretendimet e mbrojtjes lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale. Edhe pse Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare për shkeljet e tjera esenciale, megjithatë kjo gjykatë nuk ka dhënë arsyetim lidhur me këtë shkelje. Sa i përket gjykatës së shkallës së parë, mbrojtja pretendon se e njëjta ka tejkaluar aktakuzën meqenëse në dispozitiv të aktgjykimit të saj, janë shtuar fakte të reja inkriminuese e të cilat nuk kanë qenë të përfshira me aktakuzën e Prokurorisë së Shtetit të ndryshuar me parashtresën PP/I.Nr.26/2021 të paraqitur në gjykatë në shqyrtimin gjyqësor të datës 12.2.2021. Kështu, në rreshtin e dytë ndër të tjera thuhet se i akuzuari Prek Gjugja: "... me dashje ndihmon personin tjetër këtu të pandehurin Alfred Gjugja, duke i krijuar kushte në kryerjen e veprës penale të vrasjes, në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjes pronësore, me tani të ndjerin T. B., i cili ditën kritike me Z. K. dhe L.B., janë mbledhur të bisedojnë në odën e A. N., pasi rruga ishte pakrye, i pandehuri automjetin e tij të markës "..." me tabela regjistrimi ... e parkon pas automjetit të markës "...", me tabela të regjistrimit ..., pronë e të ndjerit T. B., të cilin nuk e largon edhe pse i është kërkuar nga i ndjeri, pasi nuk merren vesh mes veti, duke dalë nga oda, përmes telefonit ... e thërret këtu të pandehurin Alfred, të cilin e njofton se nuk ka marrëveshje mes tyre ...". Sipas aktakuzës këto janë veprimet e ndihmës në vrasje sipas nenit 178 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, për të cilën vepër ishte akuzuar Prek Gjugja, ndërsa gjykata e shkallës së parë kishte shtuar fjalët "... pasi pjesa tjetër e rrugës ishte me baltë dhe ishte një kanal, i akuzuari me qëllim që ta pengonte lëvizjen e të ndjerit, nuk e largon veturën e tij të cilës ia kishte hapur derën e shoferit dhe po qëndronte aty, ngase ishte në dijeni se i pandehuri Alfred po vinte nga shtëpia..., ku i pandehuri me atë rast e kishte marrë pushkën automatike, dhe kur arrin në vendin e ngjarjes gjuan në drejtim të automjetit të tani të ndjerit ...". Veprimet e përshkruara, nuk janë pjesë e përshkrimit të veprimeve të paraqitura në aktakuzë, ato janë veprime inkriminuese që janë shtuar e modifikuar në dispozitiv dhe e tejkalojnë vëllimin e veprimeve që përbëjnë elementet qenësore të veprës penale edhe pse këto fakte dhe

rrethana të shtuara ishin të pavërtetuara me asnjë provë. Fakti se në dispozitiv shtohen fjalët se i akuzuari Prek "ka qenë në dijeni" se djali i tij është duke ardhur, përbën komponentin psikologjik të ndihmës si element subjektiv në kryerjen e kësaj vepre penale e që nënkupton ekzistimin e një marrëveshje paraprake e vrasjes së tani të ndjerit T. dhe nga arsyetimi i aktgjykimeve shihet se të njëjtat janë bazuar pikërisht në rrethanat e shtuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

8. Mbrojtja, më tutje pretendon se gjykata shkallës së parë , gabimisht e konstaton se i ndjeri e ka pasur të pamundur të lëvizë me veturën e tij dhe të largohet sepse e njëjta ishte bllokuar me qëllim nga i pandehuri Prekë, duke u bazuar në deklaratat kundërthënëse të dëshmitarit A. N., i cili e ndërron dëshminë disa herë sa i përket mu këtij fakti dhe pasi ballafaqohet me këto dëshmi ai në shqyrtimin e fundit deklaron se "ndoshta edhe kam harruar pasi që janë bërë katër vite". Kjo dëshmi e tij, gabimisht është marrë si deklarata mbi bazën e të cilës gjykata ka vendosur mbi fajësinë e të pandehurit. Pra, sipas mbrojtjes , gjykata e shkallës së parë gabimisht i merre si të vërtetuara, duke u bazuar në faktet qenësore të paraqitura në dispozitiv, e të cilat nuk kanë qenë pjesë e aktakuzës, si që është qëllimi i të pandehurit Prekë për pengimin e të ndjerit T. pasi që ai ishte në dijeni se A. po vinte nga shtëpia.

9. Sa i përket shkeljes së ligjit penal, mbrojtja konsideron se, edhe pse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet për shkak të gjendjes së fakteve, megjithatë gjendja e fakteve e vërtetuar në mënyrë të gabuar, ka rezultuar edhe me shkelje të ligjit penal në dëm të pandehurit. Nga provat, rezulton se ngjarja e ditës kritike është zhvilluar jashtë vetëdijes dhe vullnetit të pandehurit Prekë dhe pa ndihmën e tij qoftë fizike apo psikologjike ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenit 33 të KPRK-së. Për të ekzistuar ndihma në kryerjen e veprës penale duhet të ekzistoj dashja konkrete dhe të ekzistoj lidhja kauzale në mes të veprimeve të personit që jep ndihmë me kryesin e veprës penale. Në rastin konkret nuk është vërtetuar me asnjë provë, se i pandehuri i ka krijuar kushte të dënuarit Alfred për kryerjen e veprës penale të vrasjes, pasi që nuk ka asnjë provë që vërteton se i

pandehuri Prekë e ka penguar tani të ndjerin T., të largohet nga vendi i ngjarjes para se të vinte djali i tij Alfredi dhe të përfundonte veprën dhe as që është vërtetuar ekzistimi i ndonjë marrëveshje paraprake për realizimin e veprës penale. Qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, i vërtetuar edhe me aktgjykim të shkallës së dytë, se "me mosveprimin e të akuzuarit Prekë, është krijuar dashja eventuale", pra ai ka dashur që pasoja të shkaktohet, tregon se i pandehuri nuk ka pas dashje për të kryer veprën penale, por kjo është krijuar nga momenti kur ai nuk ka vepruar për ta parandaluar veprën penale, e që sipas mbrojtje, për mosveprim, në rastin konkret nuk ka përgjegjësi penale të pandehurit, sepse për mosveprim mund të përgjigjet vetëm nëse ka qenë i detyruar të veproj dhe nuk ka vepruar.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme te Kosovës

1. Gjykata Supreme, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, përgjigjja e përfaqësuesit të palëve të dëmtuara si dhe bazuar në shkresat e çështjes gjen se janë të bazuara pretendimet mbrojtësit e të pandehurit dhe se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje të ligjit penal në dëm të pandehurit Prekë Gjugja e të cilat shkelje kanë kushtëzuar ndryshimin e tyre.

2. Duke u nisur nga fakti se në këtë çështje penale nuk është kontestuese se ditën kritike i pandehuri Prekë së bashku edhe me dajën e tij Z. K., kanë shkuar në odën e A. N., për t'u takuar me tani të ndjerin T. B., e sipas kërkesës së vet të ndjerit, për të biseduar lidhur me pronën e shitur dhe për të cilën pronë kishin çështje të pazgjidhura. Po ashtu nuk është kontestuese se kur ishin nisur nga shtëpia e të pandehurit, në shtëpi nuk ishte i dënuari Alfred Gjugja, por i njëjti kishte ardhur në momentin kur ata ishin duke u nisur. Pasi që kishin shkuar në odën e A., ku kanë qenë prezentë tani i ndjeri T., i pandehuri Prekë dhe Z. K., dhe pas diku rreth 20 minutave të bisedimeve nga shtëpia e A. pa ndonjë marrëveshje, të gjithë kanë dal nga oda dhe janë nisur në drejtim të veturave ,fillimisht ka dal Z. dhe me veturën e tij e cila ishte e parkuar paralel me veturën e të pandehurit Prekë, është nisur në shtëpi të tij dhe pas disa minutave ka dëgjuar krisma të armës dhe është

kthyer duke e lënë veturën para shtëpisë së V. N. dhe ishte nisur në odën e A., ku e kishte parë të ndjerin T. të shtrirë dhe A. të plagosur. Po ashtu nga shkresat del se nuk është kontestuese se ditën kritike tani i dënuari Alfred, kishte biseduar telefon me babën e tij, P., pak momente para se të nisej me armë për në odë të A. N., ku edhe pasi që e kryen vrasjen e të ndjerit T. dhe pasi që plagos të dëmtuarin A., me veturën e babës së tij P., që të dy kthehen në shtëpi dhe pas pak dorëzohet në polici. Kjo gjykatë gjen se edhe fakti se vetura e të pandehurit Prekë ishte parkuar pas veturës së T. nuk është kontestues ,por edhe fakti se vetura nuk kishte ku tjetër të parkohet po ashtu nuk është kontestues, ndërsa fakti se vetura e Z. K. ishte parkuar paralel me veturën e të pandehurit Prekë dhe me këtë pamundësohej lëvizja e të veturës së të ndjerit T. po ashtu nuk është fakt kontestues, dhe se Z. K. ishte larguar me veturën e tij dhe me këtë lëvizja e të ndjerit T. nuk ishte e pamundur. Megjithatë kjo gjykatë gjen se edhe ky fakt nuk ishte kontestues, ngase nga shkresat si dhe nga deklarata e dëshmitarit A. N. se "nuk e di a ka qenë i larguar automjeti i Z., por nëse ka qenë, ka mujt me dalë", të cilën deklaratë gjatë procedurës disa herë e ndryshon këtë deklaratë të cilën e kishte dhënë në prokurori me datë 27.05.2019 dhe me të cilën ishte ballafaquar më vonë në shqyrtim gjyqësor , ku kishte deklaruar se ndoshta kam harru se kanë kaluar katër vjet. Se Z. K. ishte larguar me veturë e vërtetojnë edhe dëshmitarët tjerë që kanë qenë në vendin e ngjarjes sikur edhe është konstatuar në vet aktgjykim të gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu kjo gjykatë gjen se nuk është kontestuese i pandehuri Prekë, pasi që kishin dal nga oda e A. N. dhe pasi që Z.K. largohet me veturën e tij, hyn në veturë e ndez dhe e hap derën.

3. Fakte kontestuese kanë mbetur në këtë çështje penale se a kishte qëllim i pandehuri Prekë që me hapjen e derës së veturës ta ndihmonte të dënuarin Alfred që të kryej vrasjen e të ndjerit T., ashtu sikur ka konstatuar gjykata e shkallës së parë në aktgjykim të vërtetuar me aktgjykim të shkallës së dytë. Po ashtu është fakt kontestues, se a e kishte thirre i pandehuri Prekë djalin e tij A., që të shkonte dhe me armë të vriste tani të ndjerin T., duke u nisur nga fakti se ai kishte

biseduar me telefon me te pak çaste para se ai të nisej me armë ,për në odën e A. .

4. Kjo gjykatë, pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa si dhe bazuar në shkresat e çështjes, gjen se me të drejtë potencon mbrojtësi se gabimisht kishte konstatuar gjykata e shkallës së parë, se i pandehuri i kishte dhënë ndihmë para kryerjes së veprës, pasi që e kishte njoftuar djalin e tij se gjendet te shtëpia e A. (me çka kishte kryer ndihmën para kryerjes së veprës penale) dhe se pastaj kishte hy në veturën e tij të cilën e kishte ndezur dhe e kishte hap derën e shoferit që të pengonte lëvizjen e të ndjerit T. (me çka kishte dhënë ndihmë gjatë kryerjes së veprës penale) dhe pasi që i dënuari Alfred e kishte kryer veprën penale të vrasjes, nuk mundohet që të ndaloj të njëjtin (me çka me mos veprim e kishte ndihmuar të njëjtin). Më tutje, gjykata shkallës së parë kishte konstatuar se me mos ndalimin e djalit që të kryej veprën penale, me dashje eventuale e kishte ndihmuar të njëjtin. Të gjitha këto konstatime të gjykatës së shkallës së parë sipas vlerësimit ë kësaj gjykate nuk kanë mbështetje në prova konkrete por bazohen në supozime dhe hamendje. Ndihma si formë e bashkëpunimit sipas nenit 33 par.2 të KPRK-së *"përfshin por nuk kufizohet në: dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale"* dhe duke mbështetur në këtë dispozitë, kjo gjykatë gjen se, fakti se i pandehuri kishte biseduar me telefon dhe e kishte njoftuar të dënuarin Alfred se gjendet te shpija e A., nuk është ndihma para kryerjes së veprës penale, sepse për të pasur ndihmë duhet të ekzistoj dashja dhe ajo ndihmë duhet të jetë konkrete. Po ashtu duhet të ekzistoj lidhja kauzale në mes të veprimeve të personit që jep ndihmën për kryerjen e veprës penale me veprimet e kryesit të saj. Për më tepër duhet të ekzistoj dashja e përbashkët e ndihmësit dhe kryesit për shkaktimin e pasojës së dëshiruar. Në rastin konkret, i pandehuri Prekë nuk e mohon se ka biseduar me të birin, por nga asnjë deklaratë e dëshmitarëve nuk mund të vërtetohet se i njëjti e

dinte se ai po vjen nga shtëpia dhe se i jep ndonjë udhëzim apo një çfarëdo mënyra i jep sinjal që të vjen dhe të kryej veprën apo se do të ndihmoj në çfarëdo mënyre kryerjen e saj. Për më tepër konstatime të tilla në dispozitiv të aktgjykimit (të cilat janë shtuar nga vet gjykata) nuk kanë mbështetje as në prova por as në aktakuzë të precizuar nga prokurori i çështjes. Gjykata e shkallës së parë ka dështuar që të vërtetoj një gjë të tillë dhe për pasojë edhe ka shkel ligjin penal kur ka gjet se i pandehuri e ka dhënë ndihmë para kryerjes së veprës penale të dënuarit Alfred.

5. Sa i përket konstatimit të gjykatës së shkallës së parë se i pandehuri ka ndihmuar të dënuarin Afred gjatë kryerjes së veprës penale, me faktin se deri sa ai e kishte ekzekutuar viktimën tek vetura e viktimës, ku A. ishte tek dera e parë ndërsa P. kishte qëndruar pas tij tek dera prapa, kjo gjykatë gjen se as në këtë rast nuk mund të konsiderohet ndihmë gjatë kryerjes së veprës penale duke u nisur nga fakti se kjo kryhet me " krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale" dhe nga shkresat edhe nga provat e administruara nuk mund të vërtetohet se i pandehuri Prekë kishte krijuar kushte për kryerjen e veprës penale e as nuk i kishte mënjanuar pengesat, ashtu sikur kërkohet me nenin 33 të KPRK-së. Sikur që është cekur më lartë, fakti se vetura e të ndjerit ishte parkuar në drejtim të Gj. dhe se para saj ishte vetura e të pandehurit Prekën nuk mund të konsiderohet apriori ndihmë gjatë kryerjes së veprës penale, sepse, sikur që u tha, Preka do të duhej të kishte një marrëveshje paraprake apo të kishte dijeni se Alfredi do të vjen me pushkë me qëllim që të ekzekutoj të ndjerin dhe të kishte dijeni se i ndjeri do të del nga shtëpia e A. për të shkuar me veturë dhe ta parandalonte të njëjtin që të largohet. Të gjitha këto çështje kanë mbetur të pa vërtetuara me fakte konkrete dhe si të tilla nuk mund të merren në dëm të pandehurit e për më tepër nuk mund të mbesin çështje të supozuara dhe të konkluduara pa fakte të vërtetuara. Edhe vet fakti se a mund të largohej i ndjeri T. me veturë apo jo ka mbetur në dubiozë, marrë parasysh deklaratat kontroverse të dëshmitarit okular dhe të dëmtuarit A..

6. Ndërsa sa i përket konstatimit të gjykatës së shkallës së parë se pasi që i dënuari Alfred e kishte kryer veprën penale të vrasjes, i pandehuri nuk mundohet që të ndaloj të njëjtin (me çka me mos veprim e kishte ndihmuar të njëjtin) dhe me dashje eventuale e kishte ndihmuar të njëjtin, kjo gjykatë gjen se ndihma në kryerjen e veprës penale mund të kryhet vetëm me veprim e jo edhe me mosveprim dhe në rastin konkret nuk ka përgjegjësi penale të pandehurit , sepse për mosveprim mund të përgjigjet vetëm nëse ka qenë i detyruar të veproj dhe nuk ka vepruar, sikur me të drejtë pretendon mbrojtja. Në rastin konkret cili do të ishte veprimi që i pandehuri Prekë do të kishte obligim që të ndërmerr e të cilin nuk e ka ndërmarr e me të cilin do ta ndihmonte të dënuarin Alfred në kryerjen e veprës penale, sepse sipas kësaj logjike të gjithë të pranishmit kanë mundur ta ndalojnë të njëjtin të kryej veprën penale apo kanë pasur obligim që ta ndalojnë. Andaj, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë edhe pse ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, gabimisht ka aplikuar ligjin penal, gjegjësisht janë nxjerrë konkludime të gabuara dhe ishte i drejtë pretendimi në kërkesë se në dëm të pandehurit është bërë shkelja e ligjit penal nga neni 385 pika 4 të KPP-së, ashtu që pretendimi u aprovua dhe u vendos që i pandehuri të lirohet nga akuza.

7. Për shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike u vendos komfor nenit 453 dhe 462 të KPP-së.

8. Nga të gjitha këto që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitës së nenit 438 par.1, nënpar.1.1 të KPP-së.

PJESA E DYTË

VENDIME TË PËRZGJEDHURA NGA LËMIA CIVILE

Aktvendim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
CN.Nr.37/2025, datë 11.09.2025

"Në rastet e kompensimit të pronës së paluajtshme, lidhur me vendosjen për konflikt kompetence, me rastin e zbatimit të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorit edhe në rastet kur debitori paraqet prapësim, pavarësisht faktit se kemi të bëjmë me persona juridik, kur nuk kemi të bëjmë me çështje të ndërsjella tregtare, kompetente për vendosje është Gjykata Themelore, pasi që kompetenca e Gjykatës Komerciale ekziston vetëm nëse plotësohen njëkohësisht dy kushte 1) që të dyja palët të jenë persona juridikë dhe 2) kontesti të ketë karakter tregtar, pra të lindë nga raportet e ndërsjella afariste. Nëse mungon njëri nga këto dy elementë, ku marrëdhënia nuk ka natyrë tregtare, atëherë Gjykata Komerciale nuk është kompetente për shqyrtimin e çështjes, prandaj, vlerësohet se trajtimi i kësaj çështjeje i takon kompetencës së Gjykatës Themelore".

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.Nr.595/22, të datës 14.03.2023, në pikën I të dispozitivit është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për procedimin e kësaj çështje juridike, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka vendosur që pasi që të bëhet i formës së prerë ky aktvendim, lënda i dërgohet në kompetencë Gjykatës Komerciale, në Prishtinë.

2. Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.Nr.2200/23 të datës 26.06.2025, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të hapë konflikt kompetence në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit "K,Company" SH.P.K., dhe debitorit K.P. Në pikën II të dispozitivit ka vendosur që, për të

vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Në bazë të nenit 25 paragrafi 2 të LPK-së, konfliktin lidhur me kompetencën midis gjykatave të llojit të ndryshëm e zgjidhë Gjykata Supreme e Kosovës. Në këtë rast Gjykata e Supreme e Kosovës, si gjykatë më e lartë dhe e përbashkët për gjykatat në konflikt ka kompetencë lidhur me zgjidhjen e konfliktit të kompetencës, ndërsa në bazë të nenit l5 paragrafi 3, të LPK-së, përcaktohet se: "Zgjidhjen e konfliktit për kompetencë territoriale dhe zgjidhjen e konfliktit për kompetencë e cakton trupi gjykues prej tre gjykatësve".

2. Në këtë rast kemi të bëjmë me çështjen përmbarimore midis kreditorit "K - Company" SH.P.K., me seli në Prishtinë, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, për kompensimin e pronës së paluajtshme.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm dhe Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, gjeti se kompetente lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike është Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, për arsye se:
4. Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, përcaktohet se: "Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbarues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe." Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat Nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, përcaktohet që: "Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe". Me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: "Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1.

kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, dhe 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate".

5. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike, sipas padisë së paditësit është Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, për faktin se me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës e duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cituara më lart, erdhi në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me zbatimin e përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorit lidhur me kompensimin e pronës së paluajtshme dhe sipas Gjykatës Supreme të Kosovës, në këtë rast edhe pse debitori ka paraqitë prapësim dhe pavarësisht faktit se kemi të bëjmë me persona juridik, nuk kemi të bëjmë me çështje të ndërsjella tregtare, e që sipas dispozitave ligjore të lartcekura, është kusht që palët të jenë persona juridik dhe njëkohësisht kontesti të ketë të bëjë me çështje të ndërsjella tregtare, pra të plotësohen këto dy kushte në mënyrë komulative. Në këtë rast çështja mes këtyre subjekteve nuk është tregtare pra nuk është raport afarist, andaj mbi këtë bazë është vlerësuar se nuk është në kompetencë të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë dhe të Dytë, për të gjykuar në këtë çështje juridike.
6. Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, nisur nga fakti se objekt i kontestit realisht është në mes dy personave juridik, lidhur me çështjen e kompensimit të pronës së paluajtshme, bazuar në dispozitat e lartcekura, vendosi që çështje duhet të trajtohet nga Gjykata Themelore në Prishtinë.
7. Nga sa u tha më lart, e në kuptim të nenit 15 paragrafi 3 dhe 25 paragrafi 2 të LPK-së, e lidhur me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat me Nr. 06/L-054 i datës 23.11.2018, si dhe nenin 13 paragraf 1, pika 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
E.Rev.Nr.36/2024, datë 14.04.2025

"Shpallja si fitues në një procedurë të prokurimit nuk krijon automatikisht raport detyrimesh, por konsiderohet si një hap drejt finalizimit të një raporti kontraktues. Tenderi i fituar paraqet mundësi për palën paditëse që ta realizoj një fitim nga aktivitetit i saj afarist, por për ta realizuar këtë fitim, është e domosdoshme nënshkrimi i kontratës dhe zbatimi i saj. Shpallja fitues i një kontrate për furnizim, për licencë, nuk nënkupton domosdoshmërisht edhe të drejtën në kompensim dëmi dhe fitim të humbur pa u vërtetuar saktë dëmi i shkaktuar, respektivisht pa u vërtetuar se ekziston përgjegjësia e të paditurës dhe lidhja shkakore (kauzale) ndërmjet veprimeve të së paditurës dhe dëmit të pësuar".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, KE.Nr.422/22 të datës 23.02.2023, në pikën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit "C.C" Sh.p.k., me seli në Prishtinë, e datës 20.03.2013 parashtruar kundër të paditurës K.E. e Kosovës (K..) Sh.a., me seli në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit është detyruar e paditura K.E. Kosovës (K..) Sh.a., me seli në Prishtinë, që në emër të fitimit të humbur nga mos nënshkrimi i kontratës së aktivitetit të prokurimit me Nr. KEKO 12039111, t'i paguajë paditësit "C. C." SHPK me seli në Prishtinë shumën 73,596.86 € (shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë euro e tetëdhjetë e gjashtë cent), me kamatëvonesë e llogaritur si për mjetet e deponuara pa destinim në ndonjërën nga bankat komerciale të Kosovës për një vit, llogaritur nga data e parashtrimit të padisë 20.03.2013 e deri në datën e përmbarimit të këtij vendimi, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Në pikën III të dispozitivit është refuzuar e pabazuar kërkesëpadia e paditësit "C.C." SH.P.K., me seli në Prishtinë e datës 20.03.2013, parashtruar kundër të paditurës K. E. Kosovës (K..) Sh.a., me seli në Prishtinë përtej shumës së gjykuar si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi,

dhe në pikën IV të dispozitivit është detyruar e paditura K.E. K (K..) Sh.a., me seli në Prishtinë, t'ia kompensojë paditësit "C,C" Sh.p.k., me seli në Prishtinë të gjitha shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë, dhe atë në lartësinë 3,542.72 € (tremijë e pesëqind e dyzet e dy euro e shtatëdhjetë e dy cent), në afat prej 7 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

2. Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktgjykimin K.DH.SH.II.Nr.635/23 të datës 21.09.2023, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar si të bazuar ankesën e të padituresë K.E. e Kosovës (K..) Sh.a., ka ndryshuar pikën I (një) dhe II (dy) të aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.Nr.422/22 të datës 23.02.2023 dhe ka gjykuar si vijon: refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit "C.C" Sh.p.k., me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura K. E. Kosovës (K..) Sh.a., me seli në Prishtinë, që në emër të fitimit të humbur nga mos nënshkrimi i kontratës së aktivitetit të prokurimit me Nr. KEKO 12039111, t'i paguajë paditësit "C.C." Sh.p.k., me seli në Prishtinë shumën 73,596.86 € (shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë euro e tetëdhjetë e gjashtë cent), me kamatëvonesë e llogaritur si për mjetet e deponuara pa destinim në ndonjërën nga bankat komerciale të Kosovës për një vit, llogaritur nga data e parashtrimit të padisë 20.03.2013 e deri në datën e përmbarimit të këtij vendimi, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Në pikën II të dispozitivit ka vendosur që pika III (tre) e aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.Nr.422/22 i datës 23.02.2023, mbetet e pashqyrtuar, dhe në pikën IV të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, i autorizuari i paditësit, me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, me

propozim që Gjykata Supreme të pranoj si të bazuar revizionin, të prishë aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, ashtu që lënda ti kthehet Dhomave të Shkallës së Dytë në rivendosje, apo të ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, ashtu që të refuzoj ankesën e të paditurës dhe të vërtetoj aktgjykimin e Dhomave të Shkallës së Parë, si dhe të detyroj të paditurën në pagesën e shpenzimeve për paraqitjen e revizionit.

4. Pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e palës paditëse.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, pretendimet e ngritura në revizion, si dhe shkresat e lëndës, dhe gjeti se:

6. Revizioni i të autorizuarit të paditësit është i pathemeltë.

8. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi më datë 20.03.2013 ka paraqitur padi në gjykatë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të fitimit të humbur nga mosnënshkrimi i kontratës sipas tenderit të fituar, t'ia paguajë paditësit shumën në lartësi prej 94,858.17 €.

9. Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Rev.48/2015 të datës 17.12.2015, kishte aprovuar revizionin e të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.Nr.175/2013, datë 07.08.2015, duke e prishë të njëjtin dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, IC Nr.142, datë 28.10.2013 dhe lëndën i'a ka kthyer në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

10. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin I.C.Nr.81/2016 të datës 01.02.2017, ka miratuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa Gjykata e Apelit me aktvendimin Ae.Nr.90/2017 të datës 22.11.2019, me

aprovimin e ankesës së paditësit e ka prishur aktgjykimin e shkallës së parë, dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

11. Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në arsyetim të aktgjykimit mes tjerash ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se aktiviteti i prokurimit publik i të padituërës me Nr. prokurimit KEKO 12039111, ka nxjerrë për fitues të tenderit me çmimin më të ultë paditësin. Kontestues ishte fakti se e paditura duke shkelur rregullat e prokurimit publik dhe pa pasur autorizim ligjor e ka bërë njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit, si pasojë e së cilit nuk është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik - fituesin e tenderit për furnizim me licencë përdorimi të programeve Autocad dhe Matlab, fakt ky nga i cili paditësi pretendon për dëmin e shkaktuar, konkretisht fitimin e humbur nga mos nënshkrimi dhe mosrealizimi i kontratës së lartcekur me të padituërën.

12. Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, padisë dhe parashtresave të palëve ndërgjyqëse, si dhe provave të propozuara e të bashkëngjitura në shkresat e lëndës, duke marrë në konsideratë edhe nxjerrjen e provës me ekspertiza nga lëmi financiar nga ekspertët V. I. dhe R. B., gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj të njëjtën e aprovoj pjesërisht, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit. Sipas kësaj gjykate pala paditëse është njoftuar me rezultatin e përzgjedhjes së saj si fitues nga aktiviteti i prokurimit publik të të padituërës K.. për furnizim me licencë përdorimi për programet Autocad dhe Matlab. Fakt vendimtar për vendosje se a i takon apo jo paditësit ndonjë lloj i kompensimit të dëmit është dhënia e njoftimit për shpalljen e fituesit të aktivitetit të prokurimit publik dhe detyrimet ligjore të autoritetit kontraktues që rrjedhin nga dhënia e një njoftimi të tillë. Duke marrë për bazë nenin 10 paragraf 3 pika (i) të LPP-së, kjo gjykatë ka vlerësuar se aktiviteti i prokurimit KEKO 12039111 quhet i mbyllur më datën 18.04.2012, dhe kontrata me operatorin ekonomik - këtu paditësin C.C.Sh.p.k., është dashur të nënshkruhet.

13. Sipas gjykatës së shkallës së parë, e paditura duke shkelur rregullat e prokurimit publik dhe pa pasur autorizim ligjor e ka bërë Njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit e duke marrë për bazë edhe shkresat e lëndës, si dhe Urdhëresën e Organit Shqyrtues të Prokurimit të datës 14.01.2013 (Prova Nr. 13), sipas të cilës në pikën III është urdhëruar Autoriteti Kontraktues - këtu e paditura KEK që të respektojë Njoftimin për dhënie të kontratës të shpallur në faqen e KRPP-së më datën 18.04.2012, vlerësoj se e paditura ka shkelur rregullat e prokurimit publik, andaj edhe aprovoj pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësit në shumën e lartcekur si në dispozitiv të aktgjykimit.

14. Gjykata e shkallës së parë mori parasysh edhe kumtimet nga e paditura me të cilat e njëjta së pari kishte njoftuar OSHP-në se nuk i posedojnë dosjet në origjinal të tenderit për furnizim me Licencë me Autocad dhe Metlab, si dhe më pas letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm me të cilën e ka njoftuar palët paditëse për tenderin e pasuksesshëm. Në këtë letër, e paditura kishte përmendur shkaqet e mos suksesit të tenderit dhe atë "Mos përfshirja e mjeteve financiare në planifikimin e prokurimit për vitin 2013 në vlerën e publikuar për kontraktim 258.208.17 €, si dhe dërgimi i e-mailit nga zyrtari autorizues Mosdisponueshmëria e mjeteve për nënshkrimin kontratës “Furnizim me Licenca për Autocad dhe Matlab" Lot 1". Mirëpo, Gjykata nuk mundi të pranojë këtë arsyetim sepse vlerësoj se një veprim i tillë i të paditurës në procedurë të prokurimit bie ndesh me nenin 10 - paragrafi 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, e për më tepër e paditura ka përmbyllur aktivitetin e prokurimit në mënyrë të suksesshme dhe ka shpallur për fitues paditësin, duke e vlerësuar të mbështetshme kërkesën e paditësit dhe në papajtueshmëri me nenin 9 dhe 10 të Ligjit për Prokurimin Publik.

15. Lartësinë e detyrimit të paditurës në shumën e lartcekur në emër të fitimit të humbur gjykata e ka mbështetur në ekspertizat financiare të nxjerra si provë në këtë çështje, ndërsa si çështje është trajtuar në bazë të parimeve të përgjithshme të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 (LMD) neni 1, 12 dhe 16, si dhe neneve 154 paragraf 1

dhe 198 paragraf 1 dhe 3 të LMD-së, duke ia njohur paditësit të drejtën për kompensimin e fitimit të humbur, për çka edhe e detyroi të padituren K.. që ta kompensojë paditësin në shumën prej 73.596.86 €.

16. Lidhur me kamatëvonesën në përmbushje të detyrimit, gjykata ka vendosur konform nenit 277 të LMD-së të vitit 1978, lidhur me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme për caktimin dhe llogaritjen e kamatës Nr.265/2020, pika I, IV dhe XIV, ndërsa vendimin për caktimin e shpenzimeve procedurale gjykata e ka marrë konform nenit 452. 1 të LPK-së.

17. Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vendosur sipas ankesës së të padituruës ka aprovuar të bazuar ankesën, me vlerësim se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore ku për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar ka pasur zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë konstaton një gjendje tjetër faktike nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit del të jetë e pabazuar, me ç'rast edhe e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar.

18. Kjo gjykatë ka vlerësuar se detyrimi për shpërblimin e dëmit duhet të përmbajë prezumimet siç janë: dëmi i shkaktuar, veprimi i kundërligjshëm, lidhja shkakore (kauzale) në mes të veprimit dhe dëmit të shkaktuar dhe pasoja, dhe duke u nisur nga gjendja e këtillë faktike, ka gjetur se qëndrimi i tillë juridik i gjykatës së instancës me

të ulët nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, mbi gjendjen e vërtetuar faktike, gabimisht është aplikuar e drejta materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, duke mos e vërtetuar në mënyrë të sigurt lidhjen shkakore në mes të veprimeve të padituërës dhe dëmit të shkaktuar, me ç'rast ka rezultuar se e paditura nuk mund të jetë përgjegjëse për shpërblimin e dëmit paditësit. Pra, gjykata e shkallës së parë pavarësisht provave të ekspertit lidhur me fitimin e humbur nuk ka vërtetuar përgjegjësinë e të padituërës në raport me dëmin e shkaktuar, pasi sipas nenit 136 të LMD-së, për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit duhet të përmbushen kushtet e përgjegjësisë: të ekzistojë përgjegjësia e të padituri, të ekzistojë fakti dëmtues, lidhja shkakore ndërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar dhe kundërligjshmëria e veprimit më të cilin është shkaktuar dëmi, ndërsa obligimi për kompensimin e dëmit ekziston vetëm në rastet që vërtetohet se dëmi është shkaktuar me fajin e dëmtuesit dhe në qoftë se i dëmtuari ka ndërmarrë veprime (masa) për parandalimin e dëmit apo për zvogëlimin e tij.

19. Është vlerësim i gjykatës së shkallës së dytë se dhomat e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar nenin 154 të LMD-së, si në kuptim të bazës juridike ashtu edhe vëllimit të dëmit të aprovuar, me vlerësim se nuk janë përmbushur elementet themelore të nenit të lartcekur - lidhja kauzale ndërmjet veprimit dhe pasojës. Në rastin konkret asnjë dispozitë ligjore nuk e njeh dëmin e pësuar si pasojë e mosfitimit të kontratës nga një ofertë publike. Baza ligjore do të krijohej në momentin e lidhjes së kontratës dhe moszbatimit të saj nga njëra palë, por edhe në këtë rast duhet vlerësuar se cila është pasoja e shkaktuar nga veprimet e të padituërës, respektivisht çfarë dëmi ka pësuar paditësi si pasojë e këtyre veprimeve, kjo pasi që fitimi i një kontrate publike nuk është e drejtë e garantuar por vetëm mundësi për operatorët ekonomik, andaj të njëjtëve me ligj iu mundësohet kompensimi i dëmeve reale që mund t`i pësojnë nga procedurat jo të rregullta të prokurimit.

20. Gjykata e shkallës së dytë, marrë për bazë nenin 185 të LMD-së, ka vlerësuar se rivendosja e gjendjes para se të shkaktohej dëmi, nënkupton kompensimin e shpenzimeve të procedurës së prokurimit dhe shpenzimeve tjera që ndërlidhen me procedurën e jo edhe fitimin e humbur, sepse fitimi i pritur nuk mund të konsiderohet si gjendje ekzistuese para shkaktimit të dëmit por gjendje e ardhshme e supozuar, e cila edhe mund të realizohet në të ardhmen sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave, por jo domosdoshmërisht. Ndërsa duke marrë për bazë nenin 189 paragrafi 3 të LMD-së ka vlerësuar se fitimi i munguar si pjesë integrale e kompensimit për dëmin e pësuar mund të njihet vetëm nëse ai do të realizohej gjithsesi, sipas procesit të rregullt të sendeve, në rast se nuk do të parandalohej me veprimet dëmtuese. Prandaj ka vlerësuar se nuk mund të merret parasysh fitimi i cili sipas vlerësimeve dhe deklarimeve të njëanshme të njërës palë supozohet se do të ndodhë, por vetëm ai fitim i cili në bazë të rrethanave objektive në mënyrë të bazuar pritet të ndodhë. Kjo nënkupton se dispozitat e sipërcituara njohin të dëmtuarit të drejtën për kompensimin e fitimit të munguar i cili do të ndodhte gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij të rregullt, ndërsa fitimi nga tenderët nuk përbën aktivitet të rregullt për subjektet afariste por përjashtim nga aktivitetet e rregullta afariste.

21. Nga faktet e prezantuara në shkresat e lëndës dhe duke marrë parasysh edhe rekomandimet e Gjykatës Supreme të Kosovës të dhëna në vendimin e lartecekur, Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë ka ardhur në përfundim, se pala paditëse nuk ka mundur të dëshmoj me prova konkrete faktike pasi që nuk janë vërtetuar faktet se në çka manifestohet humbja e fitimit me mosnënshtrimin e kontratës nëse paditësi ka porositur mallin sipas tenderit, nëse ka pasur prishje ose dëmtim të mallit të porositur, nëse e ka pasuar ndonjë vend (qira) për deponimin e mallit dhe të gjitha faktet tjera relevante të dokumentuara me prova për fitimin e humbur. Pra gjykata ka gjetur se paditësi nuk ka ofruar prova për të vërtetuar se ekziston përgjegjësia e të paditurës dhe lidhja shkakore (kauzale) ndërmjet veprimeve të së paditurës dhe dëmit të pësuar.

22. Gjykata e shkallës së dytë ka vendosur si në pikën III të këtij aktgjykimi, pasi që pika III e aktgjykimit të ankimuar, nuk ka qenë objekt ankimimi.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Kjo gjykatë vlerëson se Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura nga pala e paditur dhe ka dhënë arsye të qarta në lidhje me çështjet e ngritura që kanë të bëjnë me shkeljen esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe me zbatimin e gabuar të dispozitave materiale. Gjykata Komerciale me arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar me revizion ka përmbushur kërkesat ligjore nga neni 204 të LPK-së, si në pikëpamje të kufijve të shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe në aspektin e dhënies së arsyeve për të gjitha çështjet e ngritura në ankesë.

3. Pala e paditëse në revizionin e paraqitur pretendon se aktgjykimi i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, që konsiston në faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten, respektivisht të njëjtit i mungojnë arsyet për faktet vendimtare, arsyet që janë dhënë në aktgjykim janë në kundërthënie edhe me përmbajtjen e shkresave të lëndës. Gjykata Supreme vlerëson se Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar

pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale. Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë qartë ka deklaruar se e paditura nuk mbanë përgjegjësinë në kompensimin e dëmit si rezultat i fitimit të humbur të pretenduar nga pala paditëset, pasi që nuk është vërtetuar që është shkaktuar dëmi i pretenduar, respektivisht nuk janë përmbushur kushtet ligjore për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit të pretenduar.

4. Gjykata Supreme e Kosovës e ka pranuar qëndrimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, në përputhje me gjendjen faktike të provuar. Me nenin 154 të LMD-së së vitit 1978, është përcaktuar se: "Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij", ndërsa me nenin 189 paragraf 1 dhe 3 të të njëjtit ligj është përcaktuar se: "I dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar. Shuma e dëmit të thjesht caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor me përjashtim të rastit kur ligji urdhëron diçka tjetër. Gjatë vlerësimit të shumës së përfitimit të munguar merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga ometimi".

5. Referuar dispozitave të sipërcituara kjo gjykatë e vlerëson të drejtë përfundimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, kjo pasi që fitimi i humbur në të cilin pretendon pala paditëse është i supozuar dhe i pasigurt. Fakti që pala paditëse ka fituar tenderin, përkatësisht në prokurim publik është shpallë fituese e tenderit për furnizim me Licencë Lot.1 Licencë për AutoCad, ndërsa nuk ka nënshkruar kontratë me palën e paditur, kjo nënkupton se nënshkrimi i kontratës ishte kusht që nuk u realizua në këtë rast. Sipas kësaj gjykate, shpallja si fitues në një procedurë të prokurimit nuk krijon automatikisht raport detyrimesh, por konsiderohet si një hap drejt

finalizimit të një raporti kontraktues. Çështja e njoftimit të OSHP dhe konstatimit se e paditura nuk ka pasur të drejtë të anuloj aktivitetin e prokurimit, kjo për këtë gjykatë flet për procedurën e tenderimit dhe të drejtat që në këtë fazë i ipen palës paditëse, por që në asnjë rrethanë kjo nuk mund të trajtohet se pala paditëse në këtë rast ka pasur fitim të humbur. Tenderi i fituar paraqet mundësi për palën paditëse që ta realizoj një fitim nga aktivitetit i saj afarist, por për ta realizuar këtë fitim, është e domosdoshme nënshkrimi i kontratës dhe zbatimi i saj.

6. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë rast pala paditëse ka fituar tenderin, por që nuk ka asnjë provë që dëshmohet se ajo do ta kishte realizuar fitimin e pretenduar si të humbur, kjo pasi që kontrata nuk është nënshkruar dhe njëherit nuk është bërë asnjë transaksion financiar. Përveç kësaj, ky nuk është një rast i aktivitetit të zakonshëm dhe të parashikueshëm të aktivitetit afarist të paditësit por një rast i një veprimi që nuk ka ndodhur, përkatësisht supozimit që do të mund të ndodhte. Pra nuk ka pasur një lidhje kontraktuale dhe një transaksion të konkretizuar, andaj nuk ka asnjë bazë që fitimi i humbur i pretenduar nga pala paditëse të konsiderohet i sigurt dhe i realizueshëm. Përveç kësaj, është i saktë vlerësimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë se në këtë rast pala paditëse ka dështuar që të siguroj prova për të dëshmuar kushtin tjetër esencial për të ndërtuar bazën në kompensim të dëmit, që në këtë rast është ekzistimi i lidhjes kauzale ndërmjet veprimeve ose mosveprimeve të palës së paditur dhe dëmit të pretenduar nga pala paditëse.

7. Sipas kësaj gjykate pala paditëse në asnjë fazë të procedurës nuk ka arritur të vërtetoj faktin se dëmi i shkaktuar të cilin e pretendon bie në përgjegjësinë e të padituës, respektivisht me asnjë provë nuk është vërtetuar se cili ka qenë dëmi që ka pësuar paditësi si pasojë e veprimeve të padituës, kjo pasi që vetëm shpallja fitues i një kontrate për furnizim, për licencë, nuk nënkupton domosdoshmërisht edhe të drejtën në kompensim dëmi dhe fitim të humbur pa u vërtetuar saktë dëmi i shkaktuar. Pra gjykata ka gjetur se paditësi nuk ka ofruar prova për të vërtetuar se ekziston përgjegjësia e të padituës dhe lidhja

shkakore (kauzale) ndërmjet veprimeve të së padituerës dhe dëmit të pësuar.

8. Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

9. Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.240/2024, datë 21.01.2025

"Te rasti i vërtetimit të atësisë kur fëmija shpreh kundërshtim lidhur me testin e AND-së, është përgjegjësi e prindërve që të sigurojnë që të drejtat ligjore të fëmijës të mbrohen dhe të realizohen. Nëse fëmija është shumë i ri për të kuptuar plotësisht rëndësinë e testit të ADN-së, është përgjegjësi e prindit që të sigurohet që testi të bëhet në përputhje me ligjin dhe në interesin më të mirë të fëmijës, duke e mbështetur emocionalisht dhe duke i siguruar që testi është një hap për të mirën e tij".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.../.., të datës ..., është vendosur si në vijim: "I.APROVOHET kërkesëpadia e paditësit X.X. nga Prishtina, si e bazuar. II.VËRTETOHET se paditësi X.X., i lindur me datë ..., është i ati natyror i fëmijës së mitur Y.Y, i lindur më datë ... në Prishtinë, DETYROHET e paditura X.Y, e lindur me datë ..., që paditësit të ja njoh të drejtën e atësisë dhe ta lejoj që ta regjistroj në librat amë të të lindurve pranë Komunës së Prishtinës, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. III. Fëmija i mitur Y.Y, i lindur me datë ..., në Prishtinë, i besohet në ruajtje mbajtje dhe edukim të paditurës nënës së tij X.Y. IV. DETYROHET e paditura X.Y, që paditësit X.X, të ja mundësoj kontaktin, me fëmijën e mitur Y.Y, si në vijim: -dy (2) herë në muaj, të premten e parë dhe të katërt të muajit, përmes Qendrës për Punë Sociale "..." në Prishtinë, nga ora 10:00 deri në ora 15:00. - t'i mundësohet paditësit kontakti me fëmijën Y.Y, për ditëlindjen e fëmijës, ditën e dytë të ditëlindjes, dhe ditën e dytë të festave fetare e shtetërore. IV. DETYROHET paditësi X.X, që në emër të pagesës së alimentacionit për fëmijën e mitur Y.Y, të paguaj çdo muaj shumën nga 150.00 €, në llogarinë bankare të paditurës, X.Y, më së largu deri me datë 5 të secilit muaj, për muajin paraprak, duke filluar nga data ..., e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore. V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale".

2. Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin Ac.Nr..../... të datës ..., ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e të paditurës X.Y, nga Prishtina, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.Nr..../..., të datës ...

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i të paditurës ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin e si të bazuar, ta anuloj aktgjykimin e shkallës së dytë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. E autorizuara e paditësit ka paraqitur përgjigje në revizion duke kërkuar që revizioni të hudhet si i palejuar ose të refuzohet i pathemeltë.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215, gjeti se:

6. Revizioni i të autorizuarit të paditurës është i pathemeltë.

7. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në padi dhe gjatë gjithë fazave të procedurës ka deklaruar se me të paditurën ka jetuar në bashkësi jashtëmartesore dhe se nga kjo bashkëjetesë kanë një fëmijë të përbashkët i cili ka lindur me datë ... në Prishtinë. Raportet me të paditurën ndërkohë janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe se me datë ... e paditura ka braktisë jetën bashkëshortore dhe pa ndonjë vendim ka marr kujdesin ndaj fëmijës ndërsa atij ja ka mohuar këtë kujdes. Sipas paditësit kriter bazë për vërtetim të atësisë së tij është bashkësia faktike ose martesore me rastin e nxënies së fëmijës dhe lindjes së tij, ndërsa burri i nënës së fëmijës është i ati i fëmijës i cili në momentin e nxënies ka qenë në lidhje martesore me nënën e fëmijës. Mbi këtë bazë ka kërkuar vërtetimin e atësisë së tij në raport më fëmijën Y.Y.

8. Gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara ka nxjerr përfundimin se në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, me arsyetim se është vërtetuar fakti se e paditura X.Y, ka jetuar në bashkësi faktike martesore me paditësin, nga data ... deri më datë ... dhe se përgjatë kësaj kohe e paditura ka mbetur shtatzënë, ku me testin e shtatzënisë të bërë më datë ..., është vërtetuar shtatzënia e saj, ndërsa fëmija Y.Y ka lindur me datë ..., shtatë muaj pas ndarjes. Në këtë drejtim gjykata vlerëson se LFK-ja e jep supozimin juridik se at i fëmijës është, respektivisht konsiderohet burri i cili është martuar me nënën e fëmijës dhe se ky fëmijë duhet të jetë i tyre, përderisa nuk ka ndonjë kundërshtim nga vetë i ati, nëna e fëmijës, fëmiu ose ndonjë person tjetër i cili mund ta konsiderojë vetën si baba i fëmijës. Meqenëse përgjatë zhvillimit të kësaj procedure, e paditura nuk është deklaruar për atësinë e fëmijës dhe në pyetje të gjykatës se a e kundërshton se paditësi është baba i fëmijës, e njëjta është përgjigjur "për këtë çështje nuk dua të deklarohem" respektivisht të njëjtën nuk e ka mohuar.

9. Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor ka revokuar aktvendimin e marrë më datë ..., për nxjerrjen e provës së ADN-së, pasi që nga Agjencioni i Kosovës për Forenzikë ka pranuar email, me të cilin është njoftuar se e paditura nuk e ka dërguar fëmijën e mitur Y.Y, për dhënien e mostrës së ADN-së, në mënyrë që të vërtetohet se paditësi është baba i tij biologjik, kjo për faktin se gjykata vlerëson se pala e paditur në këtë rast, nuk është e detyruar të ju nënshtrohet mënyrave të tilla të të provuarit, dhënies së mostrës së ADN-së, së fëmiut të mitur Y.Y dhe se në asnjë mënyrë nuk mund të merret prova kundër vullnetit të palës, përveç rasteve që përcaktohet me ligj. Faktin se e paditura nuk e ka dërguar të miturin për analizën e ADN-së, gjykata e ka vlerësuar si sjellje, sipas diskrecionit të paditurës, pasi që gjykata nuk ka mundësi që ta detyroj me dhunë realizimin e analizës së ADN-së, por mos pranimi i analizës së ADN-së, e vlerësuar si rrethanë edhe në kuadër të rrethanave tjera, nënkupton se paditësi e ka provuar kërkesën se është at i fëmijës. Mos përballja me analizën e ADN-së, sipas vlerësimit të gjykatës, si rrethanë merret e provuar së bashku me rrethanat e tjera në favor të pretendimeve të paditësit sepse edhe rrethanat tjera siç janë: bashkësia faktike dhe lidhja e palëve gjyqësore

e konfirmojnë në masë të besueshme prezumimin se burri i nënës së fëmijës është baba i fëmijës. Në këtë rast nocioni burri i nënës së fëmijës është analog me personin që ndodhet në bashkësi faktike siç është rasti i palëve ndërgjyqësore. Andaj nga vlerësimi i të gjitha rrethanave ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet aprovuar si e bazuar.

10. Duke u nisur nga fakti që është aprovuar kërkesa e paditësit për vërtetimin e atësisë dhe të njëjtit i ka njohur atësinë për fëmijën e mitur G.M, gjykata e shkallës së parë sipas detyrës zyrtare ka vendosur edhe për besimin e fëmijës, kontaktet dhe alimentacionin. Është vendosur që fëmija i mitur G.M, t'i besohet të paditurës nënës së tij F.M, për përkujdesje, ruajtje dhe edukim, kjo për faktin se fëmija që nga momenti i lindjes e deri me tani jeton me të paditurën dhe se lidhja e tij emocionale është me nënën e tij, ndërsa fëmija ende nuk e njeh dhe nuk e ka takuar babain e tij biologjik, A.P. Për mënyrën e kontaktit, ju ka referuar nenit 145, paragrafi 2, të Ligjit për Familjen, kurse lidhur me alimentacionin për fëmijën e mitur, gjykata ka vendosur bazuar në nenin 290, paragrafi 1, të Ligjit Për Familjen dhe sipas detyrës zyrtare edhe për lartësinë e tij, duke marrë për bazë faktin se të dy prindërit janë në marrëdhënie pune dhe realizojnë të ardhura si dhe duke pas parasysh nevojat e fëmijës që sipas vlerësimit të gjykatës, shuma prej 150 €, është në proporcion me nevojat e fëmijës së mitur konform me shpenzimet e një fëmije të moshës së tij.

11. Gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka mbështetur në bazën ligjore, nenin 99 paragrafi.1 dhe 100, paragrafi 2 dhe 4, nenin 125, paragrafi 2, nenin 139, 145, 290 paragrafi 1, të LFK-së, si dhe nenit 3 paragrafi 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe nenit 22, paragrafi 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Vendimin për shpenzimet e ka marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së.

12. Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesën e paditësit, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë me vlerësim se i njëjti nuk është përfshi në shkelje esenciale të dispozitave procedurale në të cilat është thirr

pala në ankesë dhe as shkelje për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

13. Gjykata e Apelit ka pranuar në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me çështjen e vërtetimit të atësisë, referuar zbatimit të së drejtës materiale, përkatësisht dispozitës së nenit 99 paragrafi 1 të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK), është përcaktuar se "At i fëmijës së lindur në martesë, do të konsiderohet burri i nënës së fëmijës, nëse fëmija është lindur gjatë martesës ose brenda afatit prej 300 ditësh pas mbarimit të martesës". Sipas interpretimit të kësaj dispozite vlen supozimi juridik se përderisa personi që pretendon se është babai i fëmijës – këtu paditësi, nuk ka ndonjë kundërshtim përkundrazi ka ngritur padinë për vërtetimin e atësisë, ndërsa nëna e fëmijës-këtu e paditura në asnjë rast gjatë gjithë zhvillimit të procedurës në këtë çështje kontestimore nuk ka kundërshtuar-mohuar atësinë e paditësit, mirëpo vetëm ka heshtur në këtë drejtim. Ndërsa as fëmija ose ndonjë person tjetër i cili mund ta konsiderojë vetën si baba i fëmijës nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim, duke pas parasysh rrethanat e rastit konkret dhe zbrazëtinë ligjore ku nuk parashihet ndonjë mekanizëm ligjor detyrues me të cilin gjykata do ta detyronte që mostrat e ADN-së të merren forcërisht përveç përpjekjeve të shumta, të sqaruara si më lartë, nuk ka pasur hapësirë për diçka tjetër, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe i ka njohur atësinë e fëmijës paditësit, përkatësisht se ky fëmijë duhet të jetë i tyre kështu duke vlerësuar qëndrimin e saj në harmoni me provat e tjera të elaboruara si më lartë. Kjo për faktin se e drejta e fshehtësisë apo heshtja për atin e prezumuar nuk mund të konkurrojë interesin jetësor të fëmijës për identifikimin personal, pra në çdo rast kur është në pyetje fëmiu, gjithmonë duhet të mbizotëron interesi i tij më i mirë, e në këtë rast për ta ditur se kënd e ka baba biologjik të tij.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Në lidhje me pretendimet e ngritura në revizion që kanë të bëjnë me shkelje të dispozitave procedurale nga neni 182.2, pika n), kjo gjykatë vlerëson se kemi parafrazim të dispozitës së LPK-së, ndërsa nuk ka ndonjë pretendim të bazuar për shkeljet e pretenduara. Në lidhje me çështjen e nxjerrjes së provës së AND-së, Gjykata e Apelit ka trajtuar në detaje këtë çështje dhe ka dhënë arsye të qarta për përfundimin e nxjerr në raport me veprimet e gjykatës së shkallës së parë për nxjerrjen e kësaj prove. Marrë për bazë kërkesën e paditësit, është vlerësuar se është në interes të fëmijës të dijë për prindin e tij, por që e paditura përkatësisht nëna e fëmijës nuk ka bashkëpunuar në këtë aspekt dhe nuk ka pranuar që të bëhet kjo analizë. Marrë për bazë faktin që fëmija ka qenë nën përkujdesjen e saj ajo është dashur që të ndërmerr të gjithë hapat e me qëllim të mbrojtjes së interesave të fëmijës dhe ta realizoj nxjerrjen e provës me ekspertizë të AND-së. Të dy gjykata kanë shprehur qartë për përpjekjet që janë bërë në këtë aspekt, ku gjykata e shkallës së parë në vazhdimësi ka ndërmarrë veprime dhe ka bërë përpjeke që të realizohet nxjerrja e provës përmes analizës së ADN-së.

3. Gjykata e shkallës së parë në seancën e datës ... përsëri ka vendosur që të nxjerret prova përmes ekspertizës së ADN-së dhe i është drejtuar Agjencisë së Forenzikës, ndërsa me aktvendim të veçantë C.Nr..../..., të datës ... edhe një herë ka caktuar nxjerrjen e provës me anë të ekspertizës së ADN-së dhe dita e ekspertizës dhe paraqitja e palëve në Agjencinë e Forenzikës ishte caktuar për datën ..., në ora ...:00. E paditura me anë të parashtresave pastaj i ishte drejtuar gjykatës duke deklaruar se parimisht e njëjta nuk e kundërshton nxjerrjen e provës me anë të analizës së ADN-së, mirëpo jo në mënyrën se si ka vendosur

gjykata pasi që sipas të padituerës Agjencioni i Forenzikës nuk ka kushte që të kryej analiza të tilla dhe ajo nuk dëshiron që mostrat t'i dërgohen ndonjë eksperti ligjor individual apo jashtë Kosovës apo që mostrat të dërgohen jashtë vendit për analiza. Nga njoftimi përmes e-mail, të cilin e ka dërguar F.A, biolog, ekspert i ADN-së dhe Shef i Laboratorit të ADN-së dhe Serologjisë Agjencia e Kosovës për Forenzikë të datës ..., ka njoftuar se marrja e mostrave për analizën e ADN-së ka dështuar pasi që palët, me përjashtim të X.X, nuk janë paraqitur me datën e caktuar për t'i dhënë mostrat e nevojshme. Lidhur me mos veprimin e të padituerës konform aktvendimit C.Nr...../..., të datës ..., gjykata kishte nxjerrë aktvendim të veçantë C.Nr..../..., të datës ... me të cilin e kishte urdhëruar të padituerën X.Y që në afat prej 15 ditësh, të veproj konform aktvendimit C.Nr..../..., të datës ... ose në të kundërtën i shqiptohet gjoba në shumën prej 500 €. Duke mos vepruar sipas aktvendimit në fjalë, gjykata kishte nxjerrë aktvendimin C.Nr..../..., të datës ... me të cilin edhe i kishte shqiptuar gjobën të padituerës në shumën 500 €. Pasi që rasti është kthyer në rivendosje, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendimin C.Nr.../..., të datës ... me të cilin ka caktuar nxjerrjen e provës me Analizë të ADN - së për testin e atësisë në Agjencionin e Kosovës për Forenzikë - Laboratori i Serologjisë dhe ADN-së, ndërsa mendimin dhe konstatimin e gjendjes, Agjencioni ta jap në formë të shkruar brenda afatit prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së mostrës dhe raportin me të gjeturat e ekspertizës të ia dorëzojnë gjykatës.

4. Në lidhje me zbatimin e këtij aktvendimi, Agjencioni i Kosovës për Forenzikë me datën ... i është drejtuar të padituerës me njoftim për caktimin e terminit për dhënien e mostrave për analizën e ADN-së për të miturin Y.Y, për datën ..., në ora ...:00. Agjencioni i Kosovës për Forenzikë, përkatësisht shefi i Laboratorit i Serologjisë dhe ADN-së, me datën ..., përmes e-mailit e ka njoftuar gjykatën që pala e paditur nuk e ka sjellë fëmijën e saj të miturin Y.Y për dhënien e mostrave të ADN-së, duke shtuar se paditësi X.X është paraqitur në agjencion dhe i kryer procedurat e nevojshme, mirëpo pa kompletimin e mostrave nuk mund të procedohet tutje rasti.

5. E paditura ka theksuar në revizion se ajo nuk ka kundërshtuar nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së AND-së, por që kjo provë nuk ka mundur të realizohet për shkaqe objektive- kundërshtimi të miturit që të shkojë në institucionin ku kryhet analiza.

6. Sipas kësaj gjykate një pretendim i tillë nuk rezulton nga shkresat e lëndës, ndërsa nga argumentet e paraqitura më lartë shihet se gjykata e shkallës së parë ka bërë të gjitha përpjekjet ligjore për nxjerrjen e kësaj prove. Por pavarësisht nga kjo, kundërshtimin e tillë kjo gjykatë e ka trajtuar në aspektin e përgjegjësisë ligjore të nënës nën përkujdesjen e të cilës është fëmija. Pra nëna ka përgjegjësinë ligjore për të vepruar në interesin e fëmijës, duke përfshirë edhe trajtimin e kërkesave ligjore që lidhen me vërtetimin e atësisë. Pavarësisht kundërshtimit të fëmijës, nëna, si prind, ka detyrimin për të siguruar që kërkesat ligjore të përmbushen dhe që interesat e fëmijës të mbrohen. Nëse fëmija është shumë i ri për të kuptuar plotësisht rëndësinë e testit të ADN-së, është përgjegjësi e prindit që të sigurohet që testi të bëhet në përputhje me ligjin dhe në interesin më të mirë të fëmijës, që në këtë rast pala e paditur këtë nuk e ka bërë. Në këtë rast, nëna ka qenë ajo që ka pas mundësinë të ndihmojë fëmijën të përballojë këtë proces, duke e mbështetur emocionalisht dhe duke i siguruar që testi është një hap për të mirën e tij. Kjo gjykatë vlerëson se edhe nëse jemi në situatën që fëmija shpreh kundërshtim, është përgjegjësi e prindërve që të sigurojnë që të drejtat ligjore të fëmijës të mbrohen dhe të realizohen.

7. Kjo gjykatë vlerëson të pathemeltë edhe pretendimin që ka të bëjë me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, duke vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale në këtë rast nenin 99 të LFK.

8. Dispozita ligjore nga neni 99 i LFK-së, që thotë: "At i fëmijës së lindur në martesë, do të konsiderohet burri i nënës së fëmijës, nëse fëmija është lindur gjatë martesës ose brenda afatit prej 300 ditësh pas mbarimit të martesës", ka për qëllim të përcaktojë, në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë, se kush do të konsiderohet babai ligjor i fëmijës në raste të caktuara. Kjo dispozitë është një rregull që ka të bëjë me

prezumimin ligjor të atësisë dhe është e rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe stabilizimin e lidhjeve familjare. Kjo është një normë që mbështetet në parimin se është në interesin e fëmijës që ai të ketë një baba të njohur ligjërisht dhe të sigurojë stabilitetin dhe përkujdesjen për fëmijën. Në rastin e paditësit ai me padi dhe gjatë procesit gjyqësor ka deklaruar se me paditësen ka qenë në bashkëjetesë dhe se fëmija është zënë në kohën sa ata kanë qenë duke bashkëjetuar, ndërsa e paditura ka pohuar që ka qenë duke jetuar me paditësin mirëpo para gjykatës nuk ka dashur të deklaroj se paditësi a është baba i fëmijës. Në rrethana të rastit, marrë për bazë provat tjera, deklarimet e palëve ndërgjyqëse, kjo gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë çështjen e kanë trajtuar në aspektin e të drejtës së babait për të kërkuar vërtetimin e atësisë mbi bazën e këtij prezumimi, ndërsa pavarësisht kundërshtimit të nënës apo fëmijës për nxjerrjen e provës së ADN-së, babai ka të drejtë të vërtetojë atësinë për të marrë pjesë në jetën e fëmijës dhe për të kontribuar për mirëqenien e tij.

9. Kjo gjykatë vlerëson se në rrethana të rastit është dashur që të njihet atësia e paditësit mbi këtë bazë, duke arsyetuar se dispozita ligjore është e qartë dhe parashikon që burri i nënës është babai i fëmijës në përputhje me rrethanat e tij. Kjo është një masë për të siguruar një status të qartë dhe të qëndrueshëm për fëmijën dhe për të shmangur pasiguri juridike në lidhje me identitetin e babait. Kjo duhet të shikohet në të drejtën e fëmijës që ta njoh babain e tij ligjor, edhe nëse nuk bëhet testi i ADN-së, ndërsa kjo e drejtë nuk mund të kufizohen nga një mosmarrëveshje midis prindërve të tij. Përmes kësaj dispozite ligjore garantohet stabiliteti dhe siguria ligjore për fëmijën, duke siguruar që ai ka një babë të njohur ligjërisht, me të cilin mund të lidhë të drejtat e tij si përkujdesi, mbështetja financiare dhe trashëgimia.

10. Përkundër faktit që pala e paditur në revizion nuk ka trajtuar fare çështjen e vendosjes në raport me besimin e fëmijës dhe kontaktit, megjithatë kjo gjykatë vlerëson se vendimi për besim të fëmijës nënës është vendim që ndjek interesat e fëmijës, kjo pasi që nga lindja e në vazhdimësi fëmija ka jetuar me nënën. Ndërsa rregullimi i kontakteve me babain është vendim që po ashtu ndjek interesat e fëmijës, kjo pasi

që babait i është njohur atësia në raport me fëmijën dhe fëmija ka të drejtë që të njohë babain e tij dhe të ketë kontakte të vazhdueshme, ndërsa kjo i ndihmon në zhvillimin emocional dhe psikologjik të fëmijës, duke siguruar që ai të ketë mundësinë të zhvillojë marrëdhënie të shëndetshme dhe të plotë me të dy prindërit.

11. Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.31/2024, datë 06.09.2024

"Fakti se ka ndodhë shitblerja bazuar në marrëveshjen gojore, e njëjta marrëveshje nuk mund të shërbej si titull për të fituar pronësinë dhe as që mund të konvalidohet. Megjithatë poseduesit ia krijon cilësinë e poseduesit me mirëbesim, marrë për bazë edhe faktin që paditësi është në posedim të kësaj paluajtshmërie pa ndërprerë e për më shumë se 20 vite.

Gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kundërpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë në ngastrën kontestuese, mirëpo në këtë rast është dashur të hedhet padia për mungesë të interesit juridik, kjo pasi që paditësi ka figuruar pronar."

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.96/2018 të datës 23.01.2019, në pikën I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit-kundërtëpaditurit R.R.B nga Gjllani, ndaj të paditurit-kundërpaditësit, R.O.L. nga Prishtina dhe të paditurve R.A, Sh.A, Sh1.A, F.A, F1.A, F2.A, A,A, S.A, T.A, M.A, M1.A, nga Gjilani, vërtetohet se paditësi-kundëripadituri R.B., nga Gjilani, në bazë të punës veprimit juridik/kontratës verbale për shitblerjen e pasurisë së paluajtshme në vitin 1965 për çmimin kontraktues në shumën prej 43000 Banka, babai i tij R.B., tani i ndjerë, e ka blerë ngastrën kadastrale Nr. P-....., ZK Gjilan, e cila gjendet në v.q. "P...", me kulturë arë e kl. III, në sipërfaqe prej 0.55.83 ha, sipas gjendjes faktike edhe shtëpi, e regjistruar sipas fletës poseduese Nr.l, ZK Gjilan, e lëshuar më datë 10.07.2007, nga DGJKP Komuna Gjilan, në emër të ndjerit O.Sh. L., ish nga Prishtina dhe në bazë të mbajtjes-parashkrimit fitues të pa ndërprerë mbi 20 vite, në mënyrë të ligjshme dhe me mirëbesim, paditësi R.B., nga Gjilani, e ka fituar të drejtën e pronësisë për ngastrën kadastrale Nr. P-..., ZK Gjilan, tani e regjistruar në emër të R.O.L. nga Prishtina, sipas certifikatës nga lënda Nr. ..., e lëshuar më datë ...., nga DGJKP, Komuna Gjilan dhe detyrohen i padituri-kundërpaditësi, R.L. nga Prishtina dhe të paditurit R.Q.A., Sh, Sh1., F1., F2., F3. A. A., trashëgimtarët e të ndjerit Sh.Q. A., ish nga Gjilani, S., T., M., M. A.,

trashëgimtarët e të ndjerit F.Q.A., ish nga Gjilani, të gjithë nga Gjilani, t'ia njohin paditësit - kundër të padituri, të drejtën e pronësisë, të përmbahen dhe të durojnë, ndërsa R.B., pasurinë e paluajtshme në bazë të këtij aktgjykimi ta regjistrojnë në emër të tij në DGJKP, Komuna e Gjilanit, këtë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me vërejtje të përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën II të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kundërkërkespadia e të padituri-kundërpaditësit R. L., nga Prishtina, ndaj paditësit-kundër të padituri, R.B., nga Gjilani, për vërtetimin dhe njohjen e të drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, përkatësisht ngastrën kadastrale Nr. P-..., ZK Gjilan, e cila gjendet në v.q. "P...", me kulturë arë e kl.lll, në sipërfaqe prej 0.55.83 ha, sipas gjendjes faktike edhe shtëpi, tani e regjistruar në emër të R.O. L., nga Prishtina, sipas çertifikatës nga lënda Nr...., e lëshuar më datë ..., nga DGJKP, në Gjilan. Në pikën III të dispozitivit refuzohet si i pabazuar propozimi i R. L. nga Prishtina, ndaj kundërpropozuesit R. B. nga Gjilani, për caktimin e masës së përkohshme, të kryejë punët bujqësore dhe punë tjera në pasurinë e paluajtshme kontestuese, përkatësisht ngastrën kadastrale P-..., ZK Gjilan, e cila gjendet në v.q. "P...", me kulturë arë e kl.III, në sipërfaqe prej 0.55.83 ha, sipas gjendjes faktike edhe shtëpi. Në pikën IV të dispozitivit detyrohen i padituri-kundërpaditësi, R.L. nga Prishtina, ti paguaj 1/2 e shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe 1/2 e pjesës tjetër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t'ia paguajnë të padituri, R.,Sh., Sh., F1., F2., F3., A1., A2. N. m.v, A, S., M., T. e M.A nga Gjilani, t ia paguajnë paditësit - kundërtëpadituri R.B., nga Gjilani dhe atë për hartimin e padisë shumën prej 86 €, për taksën gjyqësore shumën prej 20 €, për konstatimin e hartuar nga vendi i ngjarjes shumën prej 130 €, për tre seanca të përfaqësimit shumën prej 405,60 €, të gjitha të llogaritura në lartësi prej gjithsej 641,60 €, këtë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me vërejtje të përmbarimit të detyruar.

2. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së të padituri - kundërpaditësit, me aktgjykimin Ac.Nr.2016/2019 të datës 29.11.2023, ka vendosur që të refuzoj të pathemeltë ankesën e të padituri - kundërpaditësit R.L. nga Prishtina, ndërsa ka vërtetuar

aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.Nr.../18 të datës 23.01.2019.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i të padituri - kundërpaditësit R.L, në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin, aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta t'i ndryshoj, ashtu që të aprovoj kundërkërkesëpadinë e të padituri – kundërpaditësit si të themeltë, apo aktgjykimet e lartcekura ti anuloj dhe lëndën ta kthejë në rivendosje.
4. I autorizuari i paditësit - të kundërpadituri R.B., nuk ka paraqitur përgjigje në revizioni i të autorizuarit të padituri - kundërpaditësit R.L. Përgjigje në revizionin e të padituri - kundërpaditësit, nuk kanë paraqitur as të padituri tjerë.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215, gjeti se:

6. Revizioni i të autorizuarit të padituri - kundërpaditësit R. L, është i pathemeltë.

7. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi në ish Gjykatën Komunale në Gjilan, më datë 11.07.2003 ka paraqitur padi kundër të padituve, lidhur me çështjen vërtetim i të drejtës së pronësisë, ndërsa me precizimin e kërkesëpadisë të datës 15.03.2018, ka kërkuar vërtetimin e pronësisë në ngastrën kadastrale Nr. P-..., ZK Gjilan, parcelë në vendin e quajtur Poretin, në sipërfaqe prej 5583 m2, në bazë të shitblerjes por edhe parashkrimit fitues, e cila udhëhiqet në emër të R.O.L. Paditësi me të njëjtën parashtresë ka kërkuar që gjykata të caktojë masë të përkohshme, me të cilën të padituri i ndalohet çfarëdolloj transaksioni apo të lënies në hipotekë të kësaj ngastre. I padituri i parë R.O.L, më datë 06.04.2010 ka paraqitur kundërpadi, me të cilën ka kërkuar që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit për vërtetimin e pronësisë në ngastrën kadastrale Nr. 70, në vendin e

quajtur P..., me sipërfaqe prej 5583 ha, ndërsa të vërtetohet se kundërpaditësit janë pronarë të kësaj paluajtshmërie.

8. Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, sipas udhëzimeve të dhëna me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ka rihapur seancën gjyqësore ku pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.Nr...../2018 të datës 23.01.2019, me të cilin ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa ka refuzuar kërkesëpadinë e të padituri - kundërpaditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

9. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë mes tjerash ka theksuar se bazueshmëria e kërkesëpadisë mbështetet në faktin se palët kontraktuese kishin hyrë në marrëdhënie kontraktuale, sipas kontratës verbale mbi shitblerjen e kësaj palujatshmërie në mes të tani të ndjerit Q.A si blerës dhe O.L, tani i ndjerë si shitës, e që ishin përmbushur obligimet kontraktuese dhe që nga vitin 1963 Q.A ishte futur në posedim dhe shfrytëzim të pasurisë kontestuese. Gjykata më tej ka shtuar se në vitet 60 nuk ka patur Ligj mbi Marrëdhëniet Detyrimore, deri sa Q. A ia shet arën kontestuese tani të ndjerit R. B - babai i paditësit, në vitin 1965 për çmimin kontraktues në shumën prej 43000 Banka, e me rastin e dorëzimit të parave në emër të çmimit kontraktues blerësi i atëhershëm R.B tani i ndjerë, ishte futur në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar nga shitësi i atëhershëm, i ndjeri Q. A, ish nga Gjilani.

10. Gjykata konstatoi se ishin lidhur dy kontrata verbale për shitblerjen e pasurisë së paluajtshme, të cilat ishin konvaliduar, por me deklaratat personale të palëve kontraktuese nuk ishte bartur objekti i shitblerjes-prona në emër të blerësit, edhe pse në kohën sa e kishin patur blerësit në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar apo shqetësuar nga shitësit apo personat e tretë. Në bazë të këtij fakti gjykata vlerësoi se paditësi R.B, në bazë të kontratës verbale mbi shitblerjen e pasurisë së paluajtshme që kishte bërë paraardhësi-babai i tij, i ndjeri R.B, e ka fituar të drejtën e pronësisë.

11. Gjykata e shkallë së parë vlerësoj se paditësi të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese e ka fituar edhe në bazë të parashkrimit fitues, mbajtjes me mirëbesim duke e mbajtur, shfrytëzuar dhe punuar mbi 20 vite, në bazë të nenit 28 al.4 të Ligjit Themelor mbi Marrëdhëniet Pronësoro Juridike, me të cilën është përcaktuar se: "mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, e fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vitesh". Sipas kësaj baze është dëshmuar se paraardhësi i paditësit dhe paditësi këtë paluajtshmëri e shfrytëzojnë që nga viti 1965 e deri më tani, pa u penguar - shqetësuar nga të padituri apo personat tjerë.

12. Gjykata e ka refuzuar si të pabazuar kundër kërkesëpadinë e të padituri - kundërpaditësit, për faktin se në bazë të nenit të lartcekur, nga viti 1963, përkatësisht viti 1965, të padituri asnjëherë nuk kishin inicuar procedurë kontestimore ndaj paditësit për pengim posedim, për kthimin e paluajtshmërisë, vërtetimin dhe njohjen e të drejtës së pronësisë kundër paditësit, përderisa paditësi e mban në shfrytëzim dhe posedim arën kontestuese, ndërsa kundërpadia ishte ushtruar pas 50 viteve, duke e llogaritur nga viti 1963, kur për herë të parë ishte tjetërsuar prona kontestuese, me çka kishte kaluar koha maksimale për inicimin-zhvillimin e kontestit pas kalimit të afatit mbi 50 vite. Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit-kundërtëpadituri është aprovuar në tërësi si e bazuar, ndërsa kundërkërkesapadia e të padituri-kundërpaditësit është refuzuar si e pa bazuar, duke refuzuar edhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme si në dispozitiv të aktgjykimit, kurse të padituri nga familja Asllani e kanë pohuar padinë dhe e kanë pranuar kërkesëpadinë e paditësit-kundërtëpadituri në tërësi si të bazuar.

13. Për bazë ligjore gjykata i është referuar nenit 28 paragrafi 4, të LMTHJP-së, nenit 3 paragrafi 6 dhe 7 të Ligjit mbi Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe nenit 143 të LPK-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës vendosi në bazë të nenit 452 të LPK-së.

14. Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës të autorizuarit të paditurit - kundërpaditësit, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e të paditurit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke vlerësuar se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

15. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftuara për faktet vendimtare të çështjes, se paditësi – kundër i padituri e ka mbajtur me mirëbesim ngastrën kontestuese nga viti 1965 dhe në posedim ai kishte hyrë me mirëbesim, pasi e kishte blerë këtë paluajtshmëri nga Q.A, e ky i fundit paluajtshmërinë kontestuese e kishte blerë nga babai i të paditurit. Ky fakt është konstatuar nga deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar, si dhe deklaratat e palëve ndërgjyqëse, prej të cilave është konstatuar se paditësi e ka në posedim paluajshmërinë lëndore për më shumë se 40 vite, në posedim ka hyrë me mirëbesim duke e paguar çmimin shitblerës, gjatë këtyre viteve që ka qenë në posedim asnjëherë nuk është penguar nga i padituri - kundërpaditësi dhe as nga ndonjë person i tretë në posedimin e qetë të paluajtshmërisë kontestuese.

16. Është konstatuar se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka konstatuar gjendjen faktike, ku me dëgjimin e palëve ndërgjyqëse por edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve, si dhe këqyrja e vendit të ngjarjes, është konstatuar fakti se paditësi – kundër i padituri me mbajtje me mirëbesim e ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese, pasi që këtë paluajtshmëri e ka në posedim me mirëbesim për më shumë se 40 vite. I padituri – kundërpaditësi për tërë këto 40 vite nuk ka kërkuar mbrojtje gjyqësore, me qëllim që ta pengoj paditësin - kundër të padituri në posedimin e kësaj paluajtshmërie dhe pas kalimit të kohës prej njëzet viteve paditësi – kundër i padituri e ka fituar të drejtën e pronësisë me mbajtje. Së pari

është konstatuar se paditësi – kundër i padituri e ka mbajtur më shumë se 20 vite këtë paluajtshmëri në posedim, e po ashtu këtë e ka bërë me mirëbesim (e ka blerë nga paraardhësi i të paditurve, e ky këtë paluajtshmëri e ka blerë prej paraardhësit të paditurit të parë), duke plotësuar kushtet për fitimin e së drejtës së pronësisë me mbajtje.

17. Janë vlerësuar të paqëndrueshme pretendimet ankimore të paditurit – kundërpaditësit, se paditësi – i kundër padituri e ka uzurpuar dhe se këtë ngastër e ka pasur në shfrytëzim të përkohshëm me marrëveshje me të paditurin, pasi që së pari bëhet fjalë për kohë të gjatë mbi 40 vite dhe së dyti i padituri nuk ka ofruar ndonjë provë se ia ka dhënë në shfrytëzim këtë paluajtshmëri paditësit, apo që paditësi të ketë paguar qira për shfrytëzimin e kësaj paluajtshmërie. Kjo gjykatë ka vlerësuar pretendimet ankimore të paditurit - kundërpaditësit lidhur me pjesën e dispozitivit ku është vendosur për kundërpadinë, ku i padituri – kundërpaditësi ka kërkuar vërtetimin e së drejtës së pronësisë në raport me paditësin – kundër të paditurin për paluajtshmërinë kontestuese, përkundër faktit që ai është pronar, pra paditësi nuk ka pasur interes juridik që të parashtroj padi të tillë, pasi të drejtën e pronësisë deri në vendosjen meritore e ka pasur të regjistruar, por për këtë shkak meqë kërkesë kundërpadia është refuzuar, gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme ta prishë në këtë pjesë aktgjykimin dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

18. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, bazuar në dispozitën e nenit 28 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, nga ka rezultuar se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore, pasi që së pari ka kaluar koha prej 20 vitesh, ashtu siç e kërkon dispozita e lartcekur, e po ashtu paditësi – kundër i padituri me mirëbesim e ka mbajtur këtë pjesë të paluajtshmërisë në posedim nga viti 1965. I padituri asnjëherë përmes rrugëve gjyqësore nuk ka kërkuar mbrojtje për të penguar posedimin e paditësit – kundër të paditurit dhe mbi këtë bazë del se përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm.

19. Gjykata e Apelit ka konstatuar se paditësi – kundër i padituri nuk e ka fituar të drejtën e pronësisë sipas punës juridike ashtu siç i referohet gjykata e shkallës së parë, por në bazë të mbajtjes. Kjo gjykatë vlerëson se për fitimin e së drejtës së pronësisë me shitblerje kontrata duhet të lidhet me shkrim në një zyre kompetente, e që në këtë rast nuk është bërë, ndërsa gabimisht gjykata e shkallës së parë i është referuar marrëveshjes verbale për shitblerje si bazë për fitimin e të drejtës së pronësisë dhe se marrëveshjen gojore për shitblerje gjykata e shkallës së parë është dashur ta vlerësoi si rrethanë për të konstatuar mirëbesimin dhe jo si bazë për fitimin e së drejtës së pronësisë. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së, lidhur me vendosjen për shpenzimet të procedurës sikurse në lartësinë si ka vendosur kjo gjykatë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

2. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi që aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së kujdeset sipas detyrës zyrtare.

3. I autorizuari i të padituri – kundërpaditësit, në revizionin e paraqitur pretendon se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2, pika n), lidhur me nenin 160 paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së. Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e tilla janë të pa bazuara, kjo pasi që gjykata e shkallës së parë por edhe ajo e shkallës së dytë në procedurën gjyqësore të zhvilluar në këtë çështje kanë garantuar objektivitetin e procesit gjyqësor, barazinë e palëve në proces dhe ligjshmërinë e vendimmarrjes përmes vlerësimit të kërkesave ligjore si në aspektin procedural por edhe në aspektin e zbatimit të drejtës materiale. Aktgjykimet e atakuara me revizion janë

mjaft të qarta, të rregullta në strukturë dhe përmbajtje. Gjykata e Apelit ka paraqitur arsye të qarta për të gjitha pretendimet ankimore të ngritura nga përfaqësuesi i të padituri – kundërpaditësit, njëherit janë dhënë arsye të qarta për kushtet që duhet plotësuar sipas të drejtës materiale për të fituar të drejtën e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, që në këtë rast mbi bazën e fakteve dhe provave të paraqitura është vlerësuar se paditësi ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmëritë kontestuese sipas bazës së parashkrimit fitues, por jo mbi bazën e punës - juridike, ashtu siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë.

4. Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes për fitimin e pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues dhe qëndrimin e Gjykatës së Apelit, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar drejtë është aplikuar e drejta materiale në këtë rast neni 28 paragrafi 4 i LMTHPJ, që ka përcaktuar se: "*Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrim fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh*". Kjo pasi që gjykatat e instancës më të ulët kanë dhënë vlerësime dhe arsye të qarta se paditësi ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitën e këtij nenin e që kanë të bëjnë me mbajtjen e sendit të paluajtshëm, mirëbesimin dhe kalimin e kohës së caktuar.

5. Instituti i parashkrimit fitues i paraparë në dispozitën e sipërcituar ka si element thelbësor mirëbesimin dhe posedimin e qetë dhe të pandërprerë të sendit të paluajtshëm për 20 vite. Nga faktet e paraqitura rezulton se paraardhësi i paditësit dhe paditësi kanë qenë në posedim të paluajtshmërisë kontestuese që nga viti 1963, respektivisht 1965 e në vazhdimësi, kjo pasi që këtë paluajtshmëri fillimisht e kishte blerë Q.A nga ish pronari O.L, ka hy në posedim të të njëjtës, ndërsa në vitin 1965 ia ka shitur paraardhësit të paditësit, i cili që nga ky vit e ka shfrytëzuar pa u penguar nga askush. Fakti se ka ndodhë shitblerja bazuar në marrëveshjen gojore kjo është vërtetuar me deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar në këtë proces, që dëshmojnë se paraardhësi

dhe paditësi kanë hyrë në posedim sipas një marrëveshje gojore, që sipas kësaj gjykate marrëveshja e tillë nuk mund të shërbej si titull për të fituar pronësinë dhe as që mund të konvalidohet, por që poseduesit ia krijon cilësinë e poseduesit me mirëbesim, marrë për bazë edhe faktin që paditësi është në posedim të kësaj paluajtshmërie pa ndërprerë e për më shumë se 20 vite.

6. Paditësi dhe paraardhësi i tij që nga koha kur kanë hyrë në posedim të kësaj paluajtshmërie janë sjellë si të ishin pronar të sendit, ndërsa kjo është konstatuar edhe nga dëshmitarët e dëgjuar në këtë proces, ku është pohuar se paditësi dhe paraardhësi i tij vazhdimisht e kanë punuar këtë paluajtshmëri dhe se në të ka të ndërtuar edhe shtëpi. Ndërkaq nga faktet e çështjes rezulton se as paraardhësi i të padituri e as i padituri-kundërpaditësi R.L, në emrin e të cilit figuron paluajtshmëria, nuk kanë kërkuar në ndonjë mënyrë mbrojte për të drejtën e pretenduara në paluajtshmërinë kontestuese, pra as nuk kanë paraqitur padi për kthim të paluajtshmërisë, e as padi për pengim posedim por kanë pritur që të paraqesin kundërpadi në vitin 2010, duke kërkuar vërtetimin e pronësisë në paluajtshmërinë në të cilën veç janë pronarë. Në këtë rast i padituri – kundërpaditësi nuk mund ë kërkoj mbrojtje të tillë pasi që për këtë nuk ka interes juridik, ngase ai veç figuron pronar.
7. Nga kjo rezulton se paraardhësi dhe paditësi kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 28 i LMTHPJ për fitimin e pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues, ndërsa pronari i mëparshëm i kësaj paluajtshmërie ka humbur të drejtën e pronësisë, kjo pasi që posedimi i paraardhësit dhe i paditësit trajtohet si posedim me mirëbesim, posedim i pandërprerë dhe i pa penguar nga askush për më shumë se 20 vite, e për rrjedhojë ka sjellë lindjen apo fitimin e të drejtës së pronësisë për paditësin. Në rrethana të tilla, Gjykata e Supreme vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale mbi bazën e të cilës paditësit ia njohin të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese dhe atë mbi bazën e parashkrimit fitues, ashtu siç është përcaktuar në nenin 28, paragrafi 4 të LMTHPJ.
8. Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.64/2024, datë 03.12.2024

"Në rastet kur ekziston një kontratë për mbajtje të përjetshme dhe nuk është argumentuar se ajo është lidhur në kundërshtim me ligjin, atëherë, nga momenti i vdekjes së marrësit të mbajtjes, kontrata prodhon efekt juridik. Si rrjedhojë, pasuria që ka qenë objekt i kontratës nuk mund të kalojë tek trashëgimtarët e marrësit të mbajtjes.

Kërkesa për anulimin e kontratës së mbajtjes së përjetshme nuk qëndron, ngase gjatë shqyrtimit të çështjes nuk është provuar se kontrata nuk është përmbushur, apo se është lidhur në kundërshtim me dispozitat e nenit 103 dhe nenit 111 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). Në këtë drejtim, nuk është dëshmuar se kontrata është lidhur në kundërshtim me parimet e rendit juridik kushtetues, me dispozitat imperative, apo nga ndonjë prej shkaqeve që cenojnë vlefshmërinë e kontratës, siç janë mashtrimi, kërcënimi, lajthimi, (*vi, clam, precario*). Për pasojë, kontrata mbetet e vlefshme dhe prodhon pasoja juridike sipas përcaktimeve ligjore dhe të marrëveshjes ndërmjet palëve."

I. Rrethanat e çështjes

9. Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Viti, me aktgjykimin C.Nr..../2017 të datës 28.06.2021, ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit - kundër të padituri N.R., nga Vitia, e ushtruar kundër të padituve H.I, Q.I dhe B.I, që të tre nga fshati R..., Komuna e Vitisë dhe vërtetohet se paditësi - kundër i padituri N.R., nga Vitia, në bazë të trashëgimisë është pronar i njësisë kadastrale me numër P-..., ZK Viti, në sipërfaqe të përgjitshme prej 507 m^2, e cila në DGJKP në Viti evidentohet sipas certifikatës me numër të lëndës .../... të datës 08.03.2021 në emër të B.I, e cila në pjesën veriore kufizohet me parcelën ... në gjatësi prej 32.44 metra, në pjesën lindore kufizohet me dy parcela dhe atë me parcelën me numër ... me kufi të gjatësisë 5.71 metra dhe parcela ... me gjatësi prej 10.20 metra, në pjesën jugore kufizohet me parcelën ... me gjatësi prej 32.23 metra dhe pjesën perëndimore me gjatësi prej 15.81 metra, e që kufizohet me parcelën ..., që është rrugë publike si dhe pronar i parcelës me numër të njësisë

kadastrale P-..., ZK Viti, në sipërfaqe të përgjithshme prej 125m^2, e cila në DGJKP në Viti evidentohet sipas certifikatës me numër të lëndës ... të datës ..., në emër të Q.I, e cila parcelë në pjesën veriore kufizohet me parcelën me numër ... me gjatësi prej 32.33 metra, në pjesën lindore kufizohet me parcelën .... në gjerësi prej 4 metrave, në pjesën jugore kufizohet me parcelën ... me gjatësi 32.17 metra, ndërsa në anën perëndimore kufizohet me parcelën ... e cila është rrugë publike me gjerësi prej 4 metra. Në pikën II të dispozitivit janë detyruar kundërtëpaditurit B.I., nga fshati R..., Komuna e Vitisë dhe Q.I., nga fshati R..., që paditësit -kundërtëpaditurit N.R., nga Vitia, t'ia lirojnë dhe dorëzojnë në pronësi, shfrytëzim dhe posedim parcelat P-..., ZK Viti, në sipërfaqe të përgjithshme prej 507 m^2, e cila në DGJKP në Viti evidentohet sipas certifikatës me numër të lëndës ... të datës ... në emër të B.I., dhe parcelën P-..., ZK Viti, në sipërfaqe të përgjithshme prej 125m^2, e cila në DGJKP në Viti evidentohet sipas certifikatës me numër të lëndës ... të datës ..., në emër të Q.I, në afat prej 15 ditësh pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat ligjore të përmbarimit të dhunshëm ligjor. Në pikën III të dispozitivit refuzohet në tërësi si e pabazuar kundërkërkesëpadia e të padituve – kundërpaditësve H.I., dhe Q.I, me të cilën kanë kërkuar që të anulohet Kontrata për Mbajtjen e Përjetshme me numër VR.Nr.... e datës ..., e lidhur në mes të H.R., dhe V.R., që të dy nga Vitia dhe në pikën IV të dispozitivit janë obliguar të padituri që në mënyrë solidare t'ia paguajnë të padituri-kundërpaditësit N.R., shpenzimet e procedurës, në shumën e përgjithshme prej 1.360,00 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

10. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac.Nr.7769/2021 të datës 06.11.2023, janë refuzuar të pathemelta ankesat e të padituve – kundërpaditësve H.I, Q.I dhe B.I, që të tre nga fshati R..., Komuna e Vitisë, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, C.Nr...../2017 i datës 28.06.2021.

11. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, revizion ka paraqitur i autorizuari i të padituve - kundërpaditësve për shkak të

shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të aprovoj si të themeltë revizionin e të padituve, të prishë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, ashtu që çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në vendosje të sërishme, apo i njëjti aktgjykim të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

12. I autorizuari i paditësit - kundërtëpatiturit nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të padituve - kundërpaditësve.

13. Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, revizionin e të autorizuarit të padituve, si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se:

14. Revizioni i të autorizuarit të padituve - kundërpaditësve është i pathemeltë.

15. Nga shkresat e lëndës rezulton se fillimisht paditësja, H.R., nga Vitia (tani e ndjerë), me datë 03.06.2009 në gjykatën e shkallës së parë kishte ushtruar padi për vërtetimin e pronësisë në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përjetshme, kundër të padituave H.I, dhe Q.I, që të dyja nga fshati Remnik, Komuna e Vitisë dhe kishte kërkuar që të vërtetohet e drejta e pronësisë në parcelat me numër P-..., ZK Viti, në sipërfaqe prej 507 m², e cila evidentohej në emër të padituës H.I., dhe parcelës me numër P-..., ZK Viti, në sipërfaqe prej 125 m², e cila evidentohej në emër të padituës Q.I.

16. Duke vepruar sipas asaj padie, gjykata e shkallës së parë kishte zhvilluar procedurë gjyqësore dhe kishte nxjerrë aktgjykimin C.Nr...../2009 të datës 16.02.2010, sipas të cilit aktgjykim ishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditëses H.R. Kundër këtij aktgjykimi ishte ushtruar ankesë në gjykatën e shkallës së dytë ish-Gjykata e Qarkut në Gjilan, e cila me aktvendimin e saj

AC.Nr.192/2010, të datës 09.03.2010 e kishte kthyer lëndën në rivendosje.

17. Në procedurën e rivendosjes, të paditurat H.I., dhe Q.I., kishin paraqitur kundërpadi ndaj paditëses-kundërpaditurës H.R., me të cilën kishin kërkuar që të anulohet kontrata mbi mbajtjen e përjetshme e lidhur në mes të paditëses-kundërpaditurës H.R., si dhënëse e ushqimisë dhe të ndjerit V.R., në anën tjetër si marrës i ushqimisë.

18. Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Viti, me aktgjykimin C.Nr..../2011 të datës 30.08.2013, kishte aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses-kundërpaditurës H.R., ndërsa e kishte refuzuar në tërësi kundërpadinë e të paditurave-kundërpaditësve H.I., dhe Q.I., Kundër këtij aktgjykimi ishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, e cila me aktvendimin AC.Nr.3886/2013 të datës 09.10.2017, e kishte kthyer lëndën sërish në rivendosje.

19. Në procedurën e rivendosjes për herën e dytë, gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas vërejtjeve dhe sygjerimeve të Gjykatës së Apelit, ka caktuar shqyrtimin gjyqësor, ku e autorizuara e paditëses ka njoftuar gjykatën se paditësja H.R. ka vdekur dhe atë sipas Certifikatës së vdekjes me numër Serik V... e njëjta ka vdekur në Prishtinë, më datë ..., ashtu që ka bërë precizimin e padisë në aspektin subjektiv dhe atë objektiv ku procedura në cilësi të paditësit- kundër të paditurit është vazhduar në emër të N.R., si trashëgimtar i vetëm ligjor i rendit të parë të trashëgimisë, ndërsa po ashtu ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit-kundërpaditurit N.R. nga Gjilani, e ushtruar kundër të paditurave H.I., Q.I. dhe B.I., që të tre nga fshati R... Komuna e Vitisë.

20. Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit-kundërpaditurit dhe kundërpadisë së të paditurve-kundërpaditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe pas vlerësimit të këtyre provave dhe të të gjitha

shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykim e atakuar C.Nr..../2017 të datës 28.06.2021, me të cilin ka vendosur si në dispozitiv të tij.

21. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, ndër të tjera, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, ka rezultuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se i ndjeri V.R., në kohën e lidhjes dhe vërtetimit të Kontratës mbi Mbajtjen e Përjetshme VR.Nr..../... të datës ..., ishte bartës dhe titullar i të drejtës së pronësisë në ngastrën kadastrale Nr. ... në sipërfaqe prej 633 m2 dhe se i njëjti kishte vdekur më datë ... në Viti, e po ashtu nuk ishte kontestuese se H.R., ishte bashkëshortja e tij martesore, e cila po ashtu ka vdekur më datë 07.12.2020 në Prishtinë dhe pas vdekjes e ndjera si trashëgimtarë ligjor ka lënë djalin N.R., dhe vajzën tani të martuar N.S., e lindur R. Po ashtu nuk ka qenë kontestuese se e ndjera H.R., ka jetuar në bashkësi martesore me të ndjerin V.R., deri në vdekjen e tij dhe ka përmbushur të gjitha detyrimet si bashkëshorte e të ndjerit dhe konform detyrimeve të marra nga Kontrata mbi Mbajtjen e Përjetshme, VR.nr ..../... e datës ..., të lidhur në mes të V.R., si marrës i ushqimisë dhe H.R., si dhënëse e ushqimisë.

22. Sipas gjykatës së shkallës së parë në vitin 1996 në mes të ndjerit V.R., dhe bashkëshortes së tij H.R., është lidhur Kontrata mbi Mbajtjen e Përjetshme, e cila është vërtetuar në ish Gjykatën Komunale në Viti dhe është regjistruar me shifrën VR.Nr.../... e datës ... dhe se dhënësja e ushqimisë H.R., ka përmbushur detyrat që dalin nga kontrata, pasi që është kujdesur për bashkëshortin deri në vdekjen e tij në vitin 2002 dhe ka qëndruar deri në vdekjen e saj në vitin 2020. Tutje ka shtuar se me këtë kontratë nuk është cenuar e drejta e pronësisë së trashëgimtareve të tjerë, ngase edhe sipas deklaratës së dëshmitarit N.R, - djali i të ndjerit V.R, ndarja e bashkësisë ekonomike dhe familjare është bërë në vitin 1995, pra pak kohë para se të lidhej kontrata mbi mbajtjen e përjetshme, ku secili ka marr hisen e tij nga 6 ari me shtëpi dhe oborr, kurse babai i tij së bashku me bashkëshorten ka mbetur të jetoj në shtëpinë e vjetër, në parcelën Nr. ..., në sipërfaqe prej 633 m².

23. Në lidhje me vendosjen si në pikën I dhe II të dispozitivit kjo gjykatë ka vlerësuar se paditësi si trashëgimtar ligjor i të ndjerës H.R, dhe i të ndjerit V.R, është pronarë i paluajtshmërive të cekura si në dispozitiv të aktgjykimit, konform nenit 20 lidhur me nenin 36 të Ligji mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike (LMTHJP), Ligji që ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të detyrimeve dhe themelimit të raportit juridik civil.

24. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në pikën III të dispozitivit, duke refuzuar si të pabazuar kundërkërkespadinë e kundërpaditësve H.I dhe Q.I për anulimin e Kontratës mbi Mbajtjen e Përjetshme Vr.Nr.... /... të datës ..., pasi që nga konstatimi i ekspertëve gjyqësor, Dr.B. O psikiatër, Dr. S. A, neurologe dhe Dr.V. B-R psikiatër, të datës 17.05.2021, ndër të tjera kanë deklaruar se me rastin e përpilimit të ekspertizës kanë shfrytëzuar dokumentacionin mjekësor ku i ndjeri V. R kishte qenë i hospitalizuar nga data 05.12.2001 e deri më datën 12.12.2001, nga i cili dokumentacion ka rezultuar se i njëjti ishte diagnostifikuar me një krizë celebrovaskulare e cila nuk kishte ndikuar tek i njëjti në aftësinë kognitive - të vetëdijes dhe se të dhënat dhe konstatimet nga Raporti i Klinikës së Neurologjisë me numër ... për të ndjerin V.R tregojnë se i njëjti ka qenë i dezorientuar në kohë dhe hapësirë në kohën kur ka pasur krizat mendore, por që pas kalimit të këtyre krizave i njëjti nuk ka pasur dezorientim në kohë, hapësire dhe ndaj të tjerëve, ashtu që ekspertët në konkludimin përfundimtar të tyre kanë konsideruar se i ndjeri V.R në ditën e nënshkrimit të kontratës kontestuese kishte pasur aftësi për të gjykuar për veprimet e veta.

25. Gjykata ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e të paditurve për anulimin e kontratës, ngase anulimi i kontratës mbi mbajtjen e përjetshme por edhe të kontratave në përgjithësi për shkaqe të nulitetit relativ mund të kërkohet vetëm po që se kontrata e tillë është e lidhur me kërcënim, lajthim apo mashtrim ashtu siç është përcaktuar në nenin 98 dhe nenin 89 të LMD-së.

26. Gjykata ka vendosur që shpenzimet e procedurës ti bartin të padituri në mënyrë solidare, konform nenit 452.1 të LPK-së.

27. Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës së të autorizuarit të padituve - kundërpaditësve, ka refuzuar si të pathemeltë ankesën, ndërsa ka pranuar qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

28. Kjo gjykatë ka vlerësuar se vendosja sikurse në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, është e drejtë dhe e ligjshme, ngase kjo gjykatë drejt ka zbatuar ligjin material në rastin konkret duke vërtetuar se paditësi-kundër i padituri N.R., si trashëgimtar ligjor i të ndjerës H.R., dhe i të ndjerit V.R, është pronar i paluajtshmërisë së specifikuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar konform nenit 20 lidhur me nenin 36 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike (ligj ky i zbatueshëm për rastin konkret, pasi i njëjti ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të detyrimeve dhe themelimit të raportit juridik civil).

29. Sipas Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore lidhur me të metat juridike të Kontratës për Mbajtjen e Përjetshme, VR.Nr...../... të datës ..., e lidhur në mes të V.R si marrës i ushqimisë dhe H.R., si dhënëse e ushqimisë, ngase gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka konstatuar se kontrata në fjalë është vërtetuar në ish Gjykatën Komunale në Viti dhe është regjistruar me shifrën VR.Nr..../...., datë ... dhe se objekt i kontratës është parcela Nr... në sipërfaqe prej 633 m², ku pas vdekjes së të ndjerit V, bartja e të drejtës së pronësisë është dashur të kryhet zyrtarisht. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor lidhur me dyshimin e pavlefshmërisë, përkatësisht falsifikimin e Kontratës për Mbajtjen e Përjetshme të lartcekur, pasi që pavarësisht se e njëjta nuk është gjendur si dosje fizike e ruajtur në gjykatë, kontrata në fjalë gjendet në shkresat e lëndës dhe atë në origjinal, gjë që nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor e as nuk ekziston ndonjë provë me të cilën dëshmohet se është inicuar apo është duke u zhvilluar ndonjë procedurë lidhur me falsifikimin e dokumentit në fjalë.
30. Lidhur me efektin e Kontratës për Mbajtjen e Përjetshme, kjo gjykatë vlerëson se kontrata e lidhur mes V.R., si marrës i ushqimisë dhe H.R.,

si dhënëse e ushqimisë, tanimë është kontratë e shuar, me rastin e vdekjes së të ndjerit V.R., si palë kontraktuese dhe për të njëjtën, rrethanat e rastit tregojnë se është përmbushur, kjo edhe duke qenë se vet marrësi i ushqimisë, nuk është ankuar asnjëherë lidhur me mospërmbushjen e kontratës nga pala tjetër kontraktuese, përkatësisht dhënësja e ushqimisë. Lidhur me atë nëse kontrata në fjalë është lidhur me vullnetin e shprehur të marrësit të ushqimisë dhe nëse marrësi i ushqimisë në momentin e nënshkrimit të kontratës ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar faktet e rëndësishme, pasi që drejt është bazuar në mendimin e komisionit të ekspertëve gjyqësor Dr. B. O-psikiatër, Dr. S.A- neurologe dhe Dr. V. B-R - psikiatër, të datës 17.05.2021, të cilët në konkludimin përfundimtar të tyre kanë ardhur në përfundim se i ndjeri V. R në ditën e nënshkrimit të kontratës kontestuese kishte pasur aftësi për të gjykuar për veprimet e veta. Si rrjedhojë, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore palëve ankuese të paraqitura me ankesë, pasi që të njëjtit me asnjë mënyrë apo formë nuk e kanë argumentuar faktin se paditësit - të kundërpaditurit nuk i takon e drejta e pronësisë siç është vendosur në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, ndërsa me asnjë provë nuk kanë arritur të argumentojnë se kundërpadia e palës së paditur-kundërpaditëse është e bazuar.

31. Për bazë ligjore gjykata i është referuar nenit 20, 36 dhe 124 të LMTHJP, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur bazuar në nenin 452.1 të LPK-së.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura nga të padituri dhe ka dhënë arsye të qarta në lidhje me çështjet e ngritura që kanë të bëjnë me shkeljen esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe me zbatimin e gabuar të dispozitave materiale. Gjykata e shkallës së dytë me arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar me revizion ka përmbushur kërkesat ligjore nga neni 204 të LPK-së, si në pikëpamje të kufijve të shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe në aspektin e dhënies së arsyeve për të gjitha çështjet e ngritura në ankesë.

3. Të paditurit - kundërpaditësit në revizionin e paraqitur pretendojnë se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) dhe o) të LPK-së. Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e tilla janë të pabazuara dhe të pa argumentuara nga pala që ka paraqitë revizion. Në raport me shkeljen e pretenduar nga neni 182, paragrafi 2, pika n), përkundër që shkelja e pretenduar në revizion nuk është argumentuar, kjo gjykatë vlerëson se një pretendim i tillë është i pabazuar kjo pasi që të dy gjykata e instancës më të ulët secila në rolin e vet kanë dhënë arsye të qarta në lidhje me faktet vendimtare që kanë të bëjnë me kërkesën e padisë dhe kundërpadisë. Çështja e ngritur në padi ka të bëjë me fitimin e pronësisë sipas bazës së kontratës mbi mbajtjen e përjetshme, andaj gjykata e shkallës së parë ka trajtuar faktet thelbësore dhe ka dhënë arsye të qarta në lidhje me rëndësinë e kontratës për mbajtjen e përjetshme për të fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese, çështjen e përmbushjes së kontratës nga palët kontraktuese dhe pasojat që shkaktohen nga kontrata pas vdekjes së marrësit të mbajtjes, pastaj janë dhënë arsye të qarta nga të dy gjykatat se pasuria që është pjesë e kontratës për mbajtjen e përjetshme nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit të trashëgimisë, pra nuk mund të kaloj tek trashëgimtarët e trashëgimlënësit edhe nëse kjo paluajtshmeri figuron në emër të trashëgimlënësit që ka lënë kontrata për mbajtjen e përjetshme.

4. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta në lidhje me vendosjen sipas kërkesës nga kundërpadia e të padituve-kundërpaditësve, ku janë trajtuar pretendimet për anulim të kontratës për mbajtjen e përjetshme, andaj mbi bazën e provave të administruara dhe të vlerësuara është qartësuar se nuk ekziston asnjë nga kushtet ligjore për anulim të kontratës për mbajtjen e përjetshme në pikëpamje të shkaqeve që kanë të bëjnë me anulimin absolut të kësaj kontrate apo të shkaqeve që kanë të bëjnë me anulimin relativ, përkatësisht të meta në vullnetin e shprehur nga palët kontraktuese.

5. Gjykata e Apelit ka trajtuar pretendimet thelbësore të ngritura në ankesë nga palët e paditura – kundërpaditësit si në aspektin e shkeljeve procedurale të pretenduara po ashtu edhe ne aspektin e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të drejtës materiale, duke dhënë arsye të qarta për refuzimin e ankesës së palëve të paditura. Kjo gjykatë ka vlerësuar të pathemeltë edhe pretendimin në revizion në lidhje me shkelje të dispozitave procedurale, përkatësisht për shkelje të nenit 182.2, pika o) të LPK-së, kjo pasi që gjykata e shkallës së parë ka vepruar brenda kufijve të kërkesave të palëve ndërgjyqëse, në këtë rast të kërkesëpadisë së palës paditëse, ndërsa gjykata e shkallës së dytë nuk ka mundur ta bëjë këtë shkelje pasi që nuk ka hapur seancë gjyqësore dhe as që ka vendosur ndryshe lidhur me kërkesëpadinë e palëve por vetëm ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

6. Nga përmbajtja e revizionit rezulton se përfaqësuesi i palëve të paditura-kundërpaditësve në pjesën dërmuese i është referuar vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si shkak të paraqitjes së revizionit, mirëpo pretendimet e tilla kjo gjykatë nuk ka mundur ti merr për bazë pasi që vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike nuk mund të jetë shkak për paraqitjen e revizionit kjo pasi që është e ndaluar shprehimisht me dispozitën nga neni 214.2 LPK-së.

7. Gjykata Supreme ka trajtuar çështjen e zbatimit të drejtës materiale nga gjykatat e instancës më të ulët. Kjo gjykatë vlerëson se paditësi si

trashëgimtarë i të ndjerës H.R ka qenë i legjitimuar të kërkojë mbrojtje gjyqësore në raport me paluajtshmërinë objekt shqyrtimi, e cila paluajtshmëri ka derivuar nga një raport kontraktues – kontrata mbi mbajtjen e përjetshme të lidhur mes të H.R dhe të V.R. Siç rezulton nga shkresat e lëndës kjo kontratë është përmbushur nga të dy palët, pra nëna e paditësit ka përmbushur obligimet e marra me kontratën për mbajtje të përjetshme në raport me marrësin e mbajtjes, këtu bashkëshortin – babain e paditësit i cili ka vdekur me datë 08.01.2002. Gjatë gjithë procesit gjyqësor nuk është kontestuar çështja e përmbushjes së obligimeve sipas kontratës për mbajtjen e përjetshme nga paraardhësja e paditësit- nëna e tij, por që është kontestuar çështja e aftësisë së V.R., si marrës i mbajtjes për të lidhur kontratën në atë kohë.

8. Ligji mbi Trashëgiminë i datës 1974 (në fuqi në kohën kur është lidhë kontrata), me dispozitën nga neni 105 al. 4 ka përcaktuar se: *"Kontrata mbi ushqimin e përjetshëm duhet të përpilohet me shkresë dhe të legalizohet nga gjykata, ndërsa me dispozitën e nenit 15 al. 5 parashihet se në rastin e legalizimit gjyqtari do të lexoj kontratën dhe do t'iu tregoj kontraktuesve pasojat e kontratës*. Sipas kësaj gjykate, nga shkresat e lëndës rezulton se kontrata është lidhur në procedurën e përcaktuar me dispozitat e sipërcituara, pra është lidhur para gjyqtarit të rastit dhe sipas procedurave të përcaktuara ku ka qenë obligim që tu lexohet palëve kontrata dhe të njoftohen për pasojat dhe më pas është vërtetuar në gjykatë me shenjën Vr.Nr...../.., datë ...

9. Të padituri me kundërpadi kanë kërkuar anulimin e kontratës për mbajtjen e përjetshme, e lidhur mes babait të tyre V.R., dhe gruas së tij të dytë H.R, me pretendim se ata kanë të drejtën e pronësisë në ngastrat kadastrale, P-..., ZK Viti, në sipërfaqe prej 507 m², e cila evidentohet në emër të paditurës H.I., dhe P-..., ZK Viti, në sipërfaqe prej 125 m², përkatësisht përjashtimin e paditësit nga kjo pjesë, ku të padituri figurojnë si pronarë, ndërsa këtë e mbështesin në faktin se kontrata për mbajtjen e përjetshme e lidhur mes babait të tyre dhe ish paditëses, është lidhur pa ekzistuar vullneti i shprehur i ushqimmarrësit V.R, respektivisht pa u vlerësuar gjendja shëndetësore, mosha e shtyrë

dhe aftësia fizike e mendore e tani të ndjerit (baba i të paditurve), duke mos ditur se çka po nënshkruan.

10. Gjykatat e instancës më të ulët kanë trajtuar pretendimet e të paditurëve - kundër paditësve në lidhje me kërkesën për anulim të kontratës dhe me provat e siguruara, përkatësisht nga ekspertiza e komisionit të ekspertëve gjyqësor Dr. B.O-psikiatër, Dr. S.A-neurologe dhe Dr. V.B-R - psikiatër, të datës 17.05.2021 dhe sqarimet e tyre të dhëna në seancën e datës 30.04.2021, është vërtetuar fakti që tani i ndjeri V.R në ditën e nënshkrimit të kontratës kontestuese kishte pasur aftësi për të gjykuar për veprimet e veta. Në raport me pretendimin e paraqitura në revizion se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar ekspertizën tjetër të ekspertëve F.D etj, sipas kësaj gjykate një pretendim i tillë është i pathemeltë, kjo pasi që ekspertiza që i referohen të padituri-kundërpaditësit është vlerësuar nga gjykata e madje nga mënyra se si është argumentuar kjo ekspertizë nga ekspertë gjatë seancës ku ata janë dëgjuar është vlerësuar se në këtë rast është e nevojshme një ekspertizë e re me ekspert të tjerë. Nevojën për ekspertizë të re e kanë diktuar paqartësinë që janë shfaqur në lidhje me çështjen e aftësisë për të gjykuar të V.R., në kohën kur ka lidhur kontratën, marrë për bazë kohën kur është lidhur kontrata dhe provat që kanë ekzistuar në shkresa të lëndës sa i përket gjendjes shëndetësore të tij. Në pikëpamje të sqarimit të fakteve që kanë të bëjnë me aftësinë e V.R., për të lidhur kontratën për mbajtjen e përjetshme, kjo gjykatë në tërësi mbështetë qëndrimin e dhënë nga gjykatat e instancës më të ulët, si në aspektin e vlerësimit të ekspertizave mjekësore dhe në aspektin e aplikimit të dispozitave materiale. Andaj, është vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë kanë refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e të paditurve-kundërpaditësve për anulimin e kontratës për mbajtjen e përjetshme, kjo pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar se e njëjta kontratë nuk është përmbushur, apo të jetë lidhur në kundërshtim me dispozitat e nenit 103 dhe nenit 111 të LMD-së, pra, me parimet dhe rendin juridik kushtetues, me dispozitat imperative etj, të njëjtat nuk janë lidhur me (vi, clam, precario) me mashtrim, kërcënim apo lajthim.

11. Meqë në këtë rast ka pasur kontratë për mbajtjen e përjetshme, pra nuk është arritur të argumentohet që e njëjta është lidhur në kundërshtim me ligjin, atëherë rezulton se që nga koha kur marrësi i mbajtjes ka vdekur kontrata ka prodhuar efekt juridik dhe pasuria e cila ka qenë objekt i kontratës nuk ka mundur të kaloj tek trashëgimtarët e marrësit të mbajtjes. Në rastin konkrete përkundër që kjo kontratë ka ekzistuar, të padituri – kundërpaditësit kanë shqyrtuar trashëgiminë në bazë të aktvendimit T.Nr..../..., datë ..., kanë bërë bartjen e paluajtshmërisë objekt shqyrtimi në emrin e tyre dhe njëherit kanë bërë ndarjen fizike të saj, ndërsa në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë kanë përjashtuar si trashëgimtare H.R, bashkëshortja e të ndjerit. Me nenit 105 al. 1 të Ligjit mbi Trashëgiminë i datës 30.12.1974, është përcaktuar se: "*Kontrata me të cilin një kontraktues obligohet të ushqej për tërë jetën kontraktuesin tjetër, ose ndonjë person të tretë, e në të cilën kontraktuesi tjetër deklaron se i lënë tërë pasurinë e tij ose një pjesë të saj si trashëgim, nuk është kontratë mbi trashëgiminë, por kontratë mbi tjetërsimin me shpërblim të gjitha sendeve të paluajtshme, që i takojnë ushqim marrësit, në kohën e lidhjes së kontratës, ose një pjesë të caktuar të këtyre sendeve, dorëzimi i të cilave ushqim dhënësit i është shtyrë gjerë me vdekjen e ushqim marrësit (kontrata mbi ushqimin e përjetshëm)"*. Nga kjo rezulton se për nga natyra juridike kjo kontratë nuk është kontratë për trashëgimi por është kontratë me prestime dhe detyrime të dyanshme, me të cilën ushqimmarrësi disponon gjatë jetës me pasurinë e tij. Me këtë kontratë tjetërsohet pasuria e cila është objekt i saj, prandaj, pasuria e cila është objekt i kontratës nuk bën pjesë në masën trashëgimore të ushqimmarrësit dhe e cila nuk mund të shqyrtohet më rastin e shqyrtimit të trashëgimisë së tij, pasi që gjatë jetës së tij është tjetërsuar nga ai. Madje as trashëgimtarët e domosdoshëm nuk mund t'a atakojnë atë as për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme.

12. Nga arsyet e paraqitura kjo gjykatë nxjerr përfundimin se paluajtshmëria objekt shqyrtimi ka qenë e V.R tani i ndjerë, e cila në bazë të kontratës për mbajtjen e përjetshme ka kaluar në ish paditësen, tani të ndjerën H.R., (bashkëshortja e V.R), andaj e njëjta mbi bazën e kontratës së lartcekur ka fituar të drejtën e pronësisë, e si rrjedhojë e

kësaj këtu paditësit, trashëgimtarit ligjor të saj, i takon e drejta e pronësisë, si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, të vërtetuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, e mbështetur në nenin 36 të LMTHJP, me të cilin është përcaktuar se: *"E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim, e drejta e pronësisë mbi sendin fitohet me anë të trashëgimit në momentin e hapjes së trashëgimisë, po që se me ligj nuk është caktuar ndryshe".*

13. Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

14. Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktvendim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës C.Nr.44/2023, datë 18.02.2025

"Për tu lejuar përsëritja e procedurës nga baza e nenit 232 pika c) e LPK-së, pala që e paraqet propozimin, ka për obligim që me prova konkrete të vërtetoj se vendimi përfundimtar është bazuar në deklarata të rreme të dëshmitarit apo ekspertit ose në dokumentin që është falsifikuar apo në të cilin është verifikuar përmbajtja e pasaktë dhe se për këtë dëshmitari apo eksperti është dënuar me aktgjykim penal të formës së prerë, ndërsa deklarata e tillë ka qenë bazë për nxjerrjen e vendimit, ose për dokumentin që është falsifikuar apo në të cilin është verifikuar përmbajtja e pasaktë, duhet të ketë po ashtu aktgjykim penal të formës së prerë. Kësisoj, propozimi për përsëritje të procedurës duke u thirrur në atë se aktgjykimi i shkallës së parë është marr si rezultat i dokumentit të falsifikuar, respektivisht nënshkrimit të falsifikuar në dokument, nuk mund të shërbejë si bazë për të lejuar përsëritjen e procedurës, ngase shkaku për të cilin kërkohet përsëritja e procedurës duhet që të ketë aktgjykim penal të formës së prerë që dëshmon për falsifikim të dokumentit, e rrjedhimisht nuk paraqet bazë nga neni 232 pika c) të LPK-së për përsëritje të procedurës".

I. Rrethanat e çështjes

2. Me aktgjykimin e ish Gjykatës Komunale në Gjakovë, C.Nr.19/07 të datës 04.11.2009, në pjesën e parë të dispozitivit është vërtetuar se paditësi F.I.P., nga Gjakova, është pronar i 6/7 pjesë ideale të paluajtshmërisë e cila evidentohet si ngastër kadastrale Nr...., në kompleksin "O...", me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 0-02-73 ha dhe me kulturë oborr, në sipërfaqe prej 0-02-57 ha., përkatësisht në sipërfaqe prej 0-05-30 ha., sipas Certifikatës UL-...., ZK Gjakovë-J qytet, në kuadër të së cilës gjendet edhe dyqani, për çka i padituri I.A, nga Gjakova, detyrohet që t'ia njehë këtë të drejtë, ndërsa, të padituri L.A, bashkëshortja e tani të ndjerit U.A, të miturit L, L1, L2, B. dhe B2.U.A, të cilët i përfaqëson përfaqësuesja ligjore, e ëma L.A, që të gjithë nga Gjakova, dhe t'ia dorëzojnë në posedim pjesën të cilët e mbajnë në posedim dhe atë pjesën e katit mbi përdhesë të paluajtshmërisë në fjalë, dhe këtë në afatin prej 15 ditësh, nga dita kur

ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe nën kërcënim të përmbarimit. Në pjesën e dytë të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

3. Duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, ish Gjykata e Qarkut në Pejë, me aktgjykimin Ac.Nr.187/2010 të datës 05.12.2011 në pjesën e parë të dispozitivit ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, C.Nr.19/07 të datës 04.11.2009, dhe gjykohet si vijon: refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit F.I.P, nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar të vërtetohet se është pronar i 6/7 të pjesëve ideale të patundshmërisë e cila evidentohet si ngastër kadastrale Nr. ..., në kompleksin "O..." me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 0.02,73 ha dhe me kulturë oborr në sipërfaqe prej 0.02,57 ha., e në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.05,30 ha., sipas Çertifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme Nr. UL-...., ZK Gjakovë-J. qytet, në kuadër të së cilës gjendet edhe dyqani dhe i padituri I.B.A, nga Gjakova, detyrohet që t'ia njeh këtë të drejtë, ndërsa të paditurit L.A, bashkëshortja e tani të ndjerit U.B.A, e cila si përfaqësuese ligjore-nënë i përfaqëson të paditurit e mitur L.A, L1.A, L2.A, B.A dhe B1.A, të gjithë nga Gjakova, të detyrohen t'ia dorëzojnë në posedim pjesën të cilën e mbajnë në posedim dhe atë pjesën e katit mbi përdhesë të paluajtshmërisë në fjalë, e në afat prej 15 ditësh, prej ditës kur aktgjykimi të merr formën e prerë, e nën kërcënim të përmbarimit. Në pjesën e dytë të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

4. Duke vendosur sipas revizioni të autorizuarit të paditësit, Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Rev.Nr.46/2012, të datës 06.12.2013 ka pranuar si të bazuar revizionin e paditësit dhe ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac.Nr.187/2010 të datës 05.12.2011, ashtu që ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, C.Nr.19/07 të datës 04.11.2009.

5. Kundër këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës propozim për përsëritje të procedurës ka paraqitur i padituri dhe atë mbi bazën e nenit 232 paragrafi 1, pika c) të LPK-së, me propozim që të lejohet

përsëritja e procedurës të aktgjykimit të plotfuqishëm të ish Gjykatës Komunale në Gjakovë C.Nr.19/2007 të datës 04.11.2009.

6. Gjykata e Apelit me aktvendimin e gjyqtares individuale CN.Nr.10/2019 të datës 10.07.2020, ka refuzuar të pathemeltë propozimin e propozuesit I.A nga Gjakova për përsëritjen e procedurës së përfunduar me aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.46/2012, datë 06.12.2013.

7. Kundër aktvendimit të lartcekur i padituri ka paraqitë ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin Ac.Nr.5200/2020 të datës 10.10.2023, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar të themeltë ankesën e propozuesit I.A. nga Gjakova, rr. "...." Nr.... dhe ka anuluar aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, numër CN.Nr.10/2019, datë 10.07.2020. Në pikën II të dispozitivit ka vendosur që propozimi për përsëritjen e procedurës, bashkë me shkresat e lëndës, i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

8. Pala paditëse ka paraqitur përgjigje në propozimin për përsëritjen e procedurës së të autorizuarit të padituri, me propozim që propozimi për përsëritje të procedurës të hudhet poshtë si i pasafatshëm.

9. Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të propozimit për përsëritjen e procedurës në mbështetje të nenit 235 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjeti se:

10. Propozimi për përsëritjen e procedurës është i pathemeltë.

11. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi F.P., në gjykatën e shkallës së parë, më datë 19.01.2007 ka paraqitur padi ndaj të padituri I.A, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë me propozim për caktimin e masës së përkohshme, të cilën padi më vonë e ka zgjeruar edhe ndaj të padituri U.A, e pas vdekjes së tij edhe ndaj bashkëshortes së tij L.A, dhe fëmjëve L1.A, L2.A, L3.A, B.A dhe B1.A.

12. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur lidhur me këtë çështje, ashtu siç është përcaktuar me aktgjykimin e ish Gjykatës Komunale në Gjakovë C.Nr.19/07 të datës 04.11.2009, elaboruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

13. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i padituri ka paraqitur ankesë, ndërsa ish Gjykata e Qarkut në Pejë me aktgjykimin e saj, AC.Nr.187/2010 të datës 05.12.2011, ka vendosur që të ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, C.Nr.19/07 të datës 04.11.2009 dhe të refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, elaboruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

14. Nga përmbajtja e propozimit për përsëritje të procedurës shihet se propozuesi ka kërkuar që të anulohet aktgjykimi i shkallës së parë, duke përfshirë edhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme numër Rev.Nr.46/2012 të datës 06.12.2013.

15. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit përkundër faktit që propozimi për përsëritjen e procedurës ka të bëjë edhe me vendimin e Gjykatës Supreme është lëshuar në shqyrtimin e propozimit dhe ka vendosur në mënyrë meritore, duke refuzuar të njëjtin, ashtu siç u elaborua më lartë.

16. Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjyqtari individual i kësaj gjykate ka vepruar në kundërshtim me nenin 235 të LPK-së, përkatësisht atë e ka zbatuar në mënyrë të gabuar, nga fakti se në rastet kur paraqitet propozim për përsëritjen e procedurës në të cilën kërkohet anulimi i vendimeve të Gjykatës Supreme, si instancë e fundit, kjo dispozitë nuk mund të zbatohet, pasi që gjykatat në instanca më të ulëta nuk mund ti prishin vendimet e gjykatës së instancës më të lartë. Kjo gjykatë më tej ka thekuar se, me dispozitën e nenit 235 të LPK-së përcaktohet se: "*Mbi propozimin për përsëritjen e procedurës vendosë gjykata e shkallës së dytë, dhe atë gjyqtari individual i cili nuk ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të shkallës së dytë në procedurën e mëparshme"*, megjithatë në praktikën gjyqësore ka përjashtim nga ky rregull bazë dhe atë në rastet kur paraqitet propozimi për përsëritjen e procedurës me të cilën kërkohet lejimi i përsëritjes së procedurës në të

cilat paraprakisht sipas mjeteve tjera të jashtëzakonshme (revizionit dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) ka vendosur Gjykata Supreme e Kosovës, atëherë për propozimin për përsëritje të procedurës nuk vendosë gjykata e shkallës së dytë, por gjykata e shkallës së tretë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata e Supreme pasi që shqyrtoi propozimin për përsëritjen e procedurës sipas shkaqeve të pretenduara që mund të përbëjnë bazë për përsëritjen e procedurës, gjeti se nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara që të lejohet përsëritja e procedurës sipas pretendimeve të propozuesit.

2. Propozuesi propozimin për përsëritjen e procedurës e ka mbështetur në dispozitën e nenit 232 paragrafi 1, pika c) e LPK-së, me të cilën është përcaktuar se: "*Në qoftë se vendimi përfundimtar i gjykatës është bazuar në deklarata të rreme të dëshmitarëve apo të ekspertëve ose në dokumentin që është falsifikuar apo në të cilin është verifikuar përmbajtja e pasaktë"*.

3. Nga kërkesa për përsëritjen e procedurës rezulton se pretendimet e palës së paditur kanë të bëjnë me atë se gjatë procedurës në shkallës të parë, përkatësisht aktgjykimi i shkallës së parë është marrë si rezultat i një nënshkrimi në kuponin No..., kinse të nënshkruar nga vëllezërit I dhe U.A, lidhur me pranimin e kaparit për shitblerjen e paluajtshmërisë në vlerë prej 150.000 €. Pretendon se gjatë gjithë kohës ka mohuar se ka pranuar para nga F.P apo të ketë nënshkruar dokument të shitblerjes, ndërsa përkundër këtyre mohimeve Gjykata Supreme nuk e ka parapa të arsyeshme të bëhet ekspertizë tekniko - grafike e nënshkrimit të tij. I padituri këtë ekspertizë e ka nxjerrë privatisht përmes Shoqatës së Shkencave Ligjore - Qendra e Kërkimeve dhe Ekspertimeve Kriminalistike, nga e cila është vërtetuar se në kuponin me numrin e lartcekur rezulton se nuk është nënshkrimi i tij, dhe mbi këtë bazë ka kërkuar që të lejohet propozimi për përsëritjen e procedurës.

4. Gjykata Supreme pretendimin e tillë të paraqitur në propozim e vlerëson si të pathemeltë, kjo pasi që baza mbi të cilën është kërkuar përsëritja e procedurës kërkon që të ketë aktgjykim penal të formës së prerë që tregon se dokumenti është falsifikuar. Përveç kësaj, pala e paditur ka marrë pjesë në proces gjyqësor përmes përfaqësuesit të përkohshëm në shkallë të parë, përmes ankesës në shkallë të dytë ku ka pasur mundësi që çështjen e falsifikimit të nënshkrimit në kuponin No.... ta ngrit në të gjitha fazat e procedurës. Pra kjo ka qenë provë që është administruar në proces gjyqësor dhe pala-përfaqësuesi i të padituri ka pasur të gjitha mundësitë ligjore që ta kontestoj në të gjitha aspektet, përfshirë këtu edhe çështjen e falsifikimit. Siç rezulton nga shkresat e lëndës kjo nuk ka ndodh, ndërsa në kohën kur rasti ka qenë duke u trajtuar në këtë gjykatë sipas revizionit nuk ka qenë e mundur të sigurohet prova që pretendon pala e paditur në propozimin për përsëritjen e procedurës. Pra pala ka mundur që çështjen e nënshkrimit apo falsifikimit të nënshkrimit të kuponit ta ngrit gjatë gjykimit në shkallë të parë, ndërsa për këtë të propozoj edhe ekspertizë të grafologjisë, përfshirë këtu edhe çështjen e procedurës penale në raport me pretendimin për falsifikim. Në fazën kur lënda ka qenë duke u trajtuar sipas revizionit, Gjykata Supreme nuk ka mundur të siguroj prova të tilla siç pretendon pala në propozimin për përsëritje të procedurës, kjo pasi që nuk ekziston një mundësi e tillë ligjore marrë për bazë shkaqet për të cilat mund të atakohet vendimi i shkallës së dytë dhe kufijtë ligjor brenda të cilëve gjykata vendos sipas mjeteve juridike të jashtëzakonshme.

5. Gjykata Supreme vlerëson se prova që ka siguruar pala e paditur, ekspertiza tekniko grafike e dokumenteve dhe e nënshkrimeve e datës 21.12.2018 e ekspertit të kriminalistikës PhD. S.K, nuk mund të shërbejë si bazë për të lejuar përsëritjen e procedurës ngase shkaku për të cilin kërkohet përsëritja e procedurës duhet që të ketë aktgjykim penal të formës së prerë që dëshmon për falsifikim të dokumentit. Përveç kësaj, rruga e ndjekur nga pala e paditur për sigurimin e kësaj prove është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPK që rregullojnë marrjen e një prove në një proces kontestimor, konkretisht me nenin 356 të LPK-së, dhe plotësim ndryshimit të këtij ligji, përcaktohet se:

"Gjykata, ex officio ose me propozimin e palëve mundë të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes". Neni 361 po ashtu ka përcaktuar se*: "Marrjen e provës me anë të ekspertizës gjykata e cakton me vendim i cili duhet të përmbajë: a) emrin, mbiemrin dhe profesionin e ekspertit; b) objektin e kontestit; c) vëllimin dhe lëndën e ekspertimit; d) afatin për paraqitjen me shkrim të konstatimit dhe mendimit".* Me nenin 23 të Ligjit për Plotësim Ndryshimin e Ligjit për Procedurën Kontestimore, është riformuluar paragrafi 1 i nenit 364 të ligjit bazik, si në vijim: 1. *"Eksperti konstatimin dhe mendimin e tij ia dërgon me shkrim Gjykatës".* Gjykata Supreme vlerëson se ekspertiza e tillë ka mundur të propozohet gjatë fazave të mëhershme të procedurës së zhvilluar para gjykatës së shkallës së parë, andaj, përveç mënyrës së nxjerrjes, kjo ekspertizë nuk mund të pranohet si bazë për të vërtetuar ekzistimin e shkakut për përsëritje të procedurës të përcaktuar me nenin 232 paragrafi 1, pika c) e LPK-së.

6. Nga këto arsye Gjykata Supreme vlerëson se i padituri në propozimin për përsëritjen e procedurës nuk ka dhënë ndonjë arsye për këtë bazë dhe nga shikimi i shkresave të lëndës konstatohet se nuk ekzistojnë rrethanat për të lejuar përsëritjen e procedurës, sipas shkaqeve të përcaktuara në nenin 232.1, pika c) e LPK-së.

7. Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 235 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.328/2024, datë 17.03.2025

"Paditësi është i legjitimuar të kërkoj lirimin e paluajtshmërisë nga pala e paditur, kjo për faktin se i njëjti është pronar i paluajtshmërisë ndërsa pala e paditur nuk ka pasur kërkesë për vërtetim të drejtës së pronësisë përveç pretendimeve për shfrytëzim të saj. Gjykata në këtë rast është dashur ta konfirmoj të drejtën e pronarit për të poseduar sendin, ndërsa nuk mundet që ta refuzoj kërkesën e pronarit vetëm për faktin se i padituri ka paraqitur pretendime për posedim të paluajtshmërisë, pa pasur kërkesë konkrete për vërtetimin e pronësisë, që më pas gjykata të ketë mundësi që të vendosë për pretendime të tilla referuar kërkesës konkrete."

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, C.Nr.42/2018 të datës 26.02.2021, është aprovuar në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit E. H nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson E.Gj, avokate nga Prizreni, ashtu që në pikën I të dispozitivit është obliguar i padituri Sh.S.G., nga fshati ..., Komuna e Suharekës, që paditësit t'ia dorëzojë në posedim të lirë paluajtshmërinë, ngastrën kadastrale ... Z.K. ..., me kulturë bujqësore arë e klasit të 4, me sipërfaqe prej 4922 m², e cila gjendet në vendin e quajtur "T...". Kjo ngastër sipas kësaj ekspertize ka këto koordinata: fillon nga pjesa veri-perëndimore nga pika ... në drejtim të veri-lindjes deri te pika .... me gjatësi prej 45.00 m, vazhdon në drejtim të njëjtë deri tek pika ... me gjatësi 47.70 m pikë tremexhëshe. Vazhdon në drejtim të njëjtë deri te pika ... me gjatësi 42.30 m, e cila vazhdon në drejtim te pika ... me gjatësi prej 45.00 m, e cila vazhdon në drejtim të njëjtë deri te pika ..., me gjatësi 42.66 m pikë tremexhëshe. Vazhdon në drejtim të jug-lindjes deri te pika ..., me gjatësi 7.19m, e cila vazhdon në drejtim të jug-lindjes deri te pika ..., me gjatësi 17.32m, pikë tremexhëshe, vazhdon në drejtim të jug-perëndimit deri te pika ..., me gjatësi prej 49.54m. Vazhdon në drejtim të njëjtë deri te pika ... me gjatësi 30.60 m, vazhdon në drejtim të njëjtë deri te pika ... me gjatësi prej 26.40 m, vazhdon në drejtim të njëjtë deri te pika ..., me gjatësi

prej 49.31 m, vazhdon në drejtim të jug-perëndimit deri te pika ..., me gjatësi prej 7.47 m. Po ashtu vazhdon në drejtim të jug-lindjes deri te pika ..., me gjatësi prej 7.61 m, pikë tremexhëshe, vazhdon në drejtim të jugut deri te pika ..., me gjatësi prej 10.34 m, vazhdon në drejtim të jug-perëndimit deri te pika ..., me gjatësi prej 25.60 m. Vazhdon në drejtim të jug-perëndimit deri te pika ..., me gjatësi prej 44.70 m, pikë tremexhëshe, vazhdon në drejtim të veri-perëndimit deri te pika ..., me gjatësi prej 40.18 m, pikë tremexhëse, nga këtu ngastra mbyllet në drejtim të veri-perëndimit në pikën ..., me gjatësi prej 1473 m. Në pikën II të dispozitivit është obliguar i padituri që paditësit ti paguajë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumën prej 891.60 € (tetëqind e nëntëdhjetë e një euro), ku të gjitha këto si në pikën 1 (një) dhe 2 (dy) të këtij dispozitivi, obligohet e paditura që ti kryej brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

2. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarës së të padituri me aktgjykimin, Ac.Nr.3024/2021 të datës 05.07.2024, ka vendosur që të refuzoj të pathemeltë ankesën e të padituri Sh.S.G., nga fshati ..., Komuna e Suharekës, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, C.Nr.42/2018 të datës 26.02.2021.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e autorizuara e të padituri në afat ligjor ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin, ashtu që të prishë aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

4. I autorizuari i paditësit nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarës të padituri.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me

revizion, revizionin e të autorizuarës të padituri, si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se:

6. Revizioni i të autorizuarës të padituri është i pathemeltë.

7. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarës së tij, në gjykatën e shkallës së parë më datë 22.01.2018, ka ushtruar padi kundër të padituri për dorëzimin e paluajtshmërive ngastra kadastrale Nr.... dhe Nr.... ZK ..., ndërsa me parashtresën e datës 29.01.2018, për precizimin e padisë ndaj të padituri të parë H.B.G., e ka tërheqë padinë, me arsyetimin se kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, ndërsa ka propozuar që procedura të vazhdohet për të padituri Sh.S.G për ngastrën kadastrale Nr.....

8. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur lidhur me këtë çështje, ashtu siç është përcaktuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, C.Nr.42/2018 të datës 26.02.2021, elaboruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

9. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se, pas administrimit dhe vlerësimit të provave, është vërtetuar fakti se paditësi është pronar juridik i ngastrës ... Z.K. G..., dhe atë nga certifikata e pronësisë e lëshuar nga ZK Suharekë, më ..., si dhe certifikata e bashkangjitur në ekspertizën e gjeodetit e datës .... Kurse, faktin tjetër se prej cilës periudhë këtu paditësi është pronar, gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e gjeodetit H.D., e datës 11.02.2020, nga rezulton se që nga viti 1970 si pronar i parcelës me Nr...., ka qenë S.E.H., nga Prizreni, ndërsa në vitin 1983 kjo parcelë ka kaluar në emër të S.H., (e veja/ bashkëshortja e S..), kurse në vitin 1990 sipas Aktvendimit të Trashëgimisë T.Nr..../... të datës ..., të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Suharekë, kjo parcelë është bartur tek këtu paditësi E.H. Pra fillimisht kjo parcelë është evidentuar si parcela ..., në vitin 2011 parcela me Nr.... ka pësuar ndryshime në parcelën me Nr. ... (tani këtu objekt kontesti), ... dhe ... Z.K. G..., ku këto dy parcelat e fundit janë shitur nga këtu paditësi tek personat e tretë.

10. Gjykata e shkallës së parë më tej ka theksuar se pretendimeve të palës së paditur se i njëjti parcelën kontestuese e ka në shfrytëzim me mirëbesim nuk ua fali besimin, kjo pasi që nga provat e administruara gjykata vërtetoi gjendje tjetër faktike, pasi që paditësi për parcelën me Nr. ... ka parashtruar padi në gjykatë që nga viti 1990, me objekt të njëjtë të kontestit (evidentuar si C.Nr.274/90), ka kërkuar dorëzimin e ngastrës këtu objekt të çështjes, pra nga kjo provë gjykata ka vërtetuar faktin se këtu i padituri në ngastrën në fjalë nuk është me mirëbesim, shto këtu faktin se objekt lëndor ka qenë dorëzimi e jo vërtetimi i pronësisë. Pra, për nga natyra e objektit të kontestit, padia e pronarit për dorëzimin apo rikthimin e sendit nuk parashkruhet, kur kësaj ia shtojmë edhe provat dhe pretendimet e palës të parashtruara gjatë procesit gjyqësor të cilat nuk ishin bindëse për gjykatën që të vendosej ndryshe, andaj gjykata vendosi si më lartë. Ndërsa vërtetimin e saktë të gjendjes faktike të terrenit, gjykata e ka bërë nga shikimi i drejtpërdrejt së bashku me ekspertin gjeodet dhe palët, ku ka konstatuar se parcela objekt kontesti sa i përket aspektit faktik është e lirë dhe mund të dorëzohet, pasi që në të njëjtën nuk ka të ndërtuar as nga i padituri apo personat e tretë, ndërsa sa i përket përkufizimit juridik të kësaj ngastre kjo është bërë nga ana e gjeodetit H.D., të datës 11.02.2010, sipas objektit të ekspertizës të përcaktuar nga gjykata.

11. Për bazë ligjore gjykata i është referuar neneve: 37 dhe 93 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 452 paragraf 1 të LPK-së.

12. Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës të autorizuarës së të paditurit ka refuzuar të pa themeltë ankesën dhe ka vlerësuar se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Po ashtu, ky aktgjykim

nuk është i përfshirë as në shkelje tjera ligjore të pretenduara nga pala ankuese në ankesë.

13. Sipas gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka konstatuar gjendjen faktike, kjo pasi që paditësi është pronar juridik i ngastrës ... Z.K. G..., sipas certifikatës së pronësisë e lëshuar nga ZK Suharekë, ndërsa përmes ekspertizës së gjeodezisë e përpiluar nga eksperti H.D., më datë 11.02.2020, është konstatuar se në vitin 1971, si pronar i parcelës me Nr. ..., ka qenë S.E.H nga Prizreni, ndërsa në vitin 1983 kjo parcelë ka kaluar në emër të S.H., (e veja/ bashkëshortja e S..), kurse në vitin 1990 sipas Aktvendimit të Trashëgimisë TNr..../... të datës ...., të vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Suharekë, kjo parcelë është bartur tek këtu paditësi E.H.

14. Po ashtu, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të paqëndrueshme pretendimet ankimore të padituri, se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë I.G., të përpiluar me datë 11.02.1998, sipas lëndës C.Nr.274/90, sipas së cilës me Vendimin e datës ..., me numër ... dhe Vendimin e lëshuar nga Këshilli Popullor i Rrethit në Suharekë, 04 Nr...., datë ..., paraardhësit të paditësit i është marrë prona, ku do të shihej se ngastra ... kishte pronar faktik dhe juridik B.N.G nga fshati G..., Komuna Suharekë, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se paditësi për parcelën me Nr. ... ka parashtruar padi në gjykatë qysh në vitin 1990, për dorëzim të palujtshmërisë, kundër të padituris Komuna Suharekë dhe S.G., nga fshati G, e nga shkresat e lëndës është vërtetuar se po e njëjta ngastër nga vitet e 70-ta, është e evidentuar në emër të paraardhësve të tij, e më pastaj edhe në emër të paditësit. Mbi këtë bazë referuar nenit 36 paragrafi 1 të LPDS, ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në

aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura nga i padituri dhe ka dhënë arsye të qarta në lidhje me çështjet e ngritura që kanë të bëjnë me shkeljen esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe me zbatimin e gabuar të dispozitave materiale. Gjykata e shkallës së dytë me arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar me revizion ka përmbushur kërkesat ligjore nga neni 204 të LPK-së, si në pikëpamje të kufijve të shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe në aspektin e dhënies së arsyeve për të gjitha çështjet e ngritura në ankesë.

3. E autorizuara e të paditurit në revizionin e paraqitur pretendon se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së. Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e tilla janë të pa bazuara, kjo pasi që gjykatat e instancave më të ulëta në procedurën gjyqësore të zhvilluar në këtë çështje kanë garantuar objektivitetin e procesit gjyqësor, barazinë e palëve në proces dhe ligjshmërinë e vendimmarrjes përmes vlerësimit të kërkesave ligjore si në aspektin procedural por edhe në aspektin e zbatimit të drejtës materiale. Aktgjykimet e atakuara me revizion janë mjaft të qarta, të rregullta në strukturë dhe përmbajtje. Gjykata e shkallës së dytë ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë.

4. Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë e që është pranuar edhe nga

gjykata e shkallës së dytë, rezulton se nga gjykatat e instancës më të ulët e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme nga ka rezultuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Sa i përket të drejtës së paditësit në dorëzimin e paluajtshmërisë, Gjykata Supreme pranon qëndrimin e instancave më të ulëta, duke vlerësuar se të njëjtit i takon e drejta e kërkesës për dorëzimin e paluajtshmërisë, kjo pasi që nga faktet e paraqitura rezulton se paditësi është pronar i paluajtshmërisë objekt kontesti. Paditësi kërkon dorëzimin e paluajtshmërisë, respektivisht ngastrës kadastrale ... Z.K. G... me pretendim se në bazë të certifikatës së pronësisë së datës ..., si dhe nga certifikata e datës ..., e lëshuar nga ZK Suharekë, e bashkangjitur në ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë, i njëjti evidentohet si pronar i kësaj ngastre.

5. Kjo gjykatë vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta kanë dhënë arsye të qarta dhe të mbështetura në prova të administruara, posaçërisht nga përfundimet e nxjerra nga ekspertiza e ekspertit gjeodet H.D, e datës 11.02.2020, ku në mënyrë të qartë është konstatuar se që nga viti 1970 si pronar i parcelës me Nr. ..., ka qenë S.E.H., nga Prizreni, ndërsa në vitin 1983 kjo parcelë ka kaluar në emër të S.H., (e veja/ bashkëshortja e S..), kurse në vitin 1990 sipas Aktvendimit të Trashëgimisë TNr..../... të datës ..., të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Suharekë, kjo parcelë është bartur tek këtu paditësi E.H. Pra fillimisht kjo parcelë është evidentuar si parcela ..., në vitin 2011 parcela me Nr.... k pësuar ndryshime në parcelën me Nr. ... (tani këtu objekt kontesti), ... dhe .... Z.K. G..., ku këto dy parcelat e fundit janë shitur nga këtu paditësi tek personat e tretë, që do të thotë se paluajtshmëria e lartcekur fillimisht ka qenë në pronësi të paraardhësve të paditësit e më vonë ka kaluar në pronësi të paditësit.

6. Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta në këtë rast drejtë kanë aplikuar nenin 36 paragrafi 1 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, me të cilin përcaktohet se: "*Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në*

paluajtshmëri", andaj në rrethana të tilla rezulton se paditësi ka plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin e lartcekur, pasi që nga certifikata e pronësisë rezulton se i njëjti është pronar i ngastrës Z.K. G... Me nenin 93 të LPDTS po ashtu përcaktohet se: *"Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi".* Mbi këtë bazë Gjykata Supreme vlerëson se paditësi është i legjitimuar të kërkoj lirimin e paluajtshmërisë nga pala e paditur, kjo për faktin se i njëjti është pronar i paluajtshmërisë ndërsa pala e paditur nuk ka pasur kërkesë për vërtetim të drejtës së pronësisë përveç pretendimeve për shfrytëzim të saj. Gjykata në këtë rast është dashur ta konfirmoj të drejtën e pronarit për të poseduar sendin, ndërsa nuk mundet që ta refuzoj kërkesën e pronarit vetëm për faktin se i padituri ka paraqitur pretendime për posedim të paluajtshmërisë, pa pasur kërkesë konkrete që mbi bazën e fakteve të tilla të kërkojë vërtetimin e pronësisë, që më pas gjykata të ketë mundësi që të vendos për pretendime të tilla referuar kërkesës konkrete. Përveç kësaj, nga shkresat e lëndës rezulton se që nga viti 1990 paditësi me padi ka kërkuar dorëzimin e paluajtshmërisë objekt kontesti, gjë që rezulton se në vazhdimësi është kërkuar mbrojtje gjyqësore lidhur me dorëzimin e paluajtshmërisë objekt kontesti, andaj me të drejtë gjykatat e instancave më të ulëta kanë aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

7. Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij revizioni, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

8. Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.366/2024, datë 15.05.2025

"Të paditurit-kundërpaditësit nuk kanë legjitimitet aktiv për të kërkuar zgjidhjen e kontratës për mbajtje të përjetshme, pasi nuk janë palë në kontratë, kjo e drejtë u takon vetëm palëve kontraktuese, pra dhënësit ose marrësit të mbajtjes, ndërsa në mungesë të kërkesës për zgjidhje të kontratës për shkak të mospërmbushjes nga marrësi i mbajtjes sa ishte gjallë, respektivisht në mungesë të kërkesës për zgjidhje të kontratës në pikëpamje të ekzistimit të vullnetit të ushqimarrësit, apo aftësisë së tij, nuk ka asnjë bazë ligjore për të konsideruar se një e drejtë e tillë të ketë kaluar te të paditurit-kundërpaditësit".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.1235/2017 të datës 16.04.2021, në pikën I të dispozitivit është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit-kundërpaditurit B.K. nga Prizreni. Në pikën II të dispozitivit është anuluar kontrata e dhuratës e lidhur në mes të dhuratëdhënësit F.K. dhe dhuratëmarrësit N.K, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren me numër Leg.Nr.... të datës .... Në pikën III të dispozitivit është anuluar kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e lidhur në mes shitësit N.K dhe blerësit V.D, e vërtetuar tek noteri B.M, me numër LRP.Nr... dhe Ref.Nr.... të datës .... Në pikën IV të dispozitivit është vërtetuar se paditësi-kundërpadituri B.K., nga Prizreni, në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përjetshme të vërtetuar me numër Leg.Nr..../... të datës ...., është pronar i paluajtshmërisë me kulturë banesë, e cila gjendet në rr. "B...." Nr..., banesa Nr...., e cila ka sipërfaqen prej 41.40 m2 dhe e cila shtrihet në parcelën Nr. ...., ZK Prizren, ndërsa e paditura e dytë V.D obligohet ta pranoj këtë dhe në bazë të këtij aktgjykimi e drejta e pronësisë në banesë të regjistrohet në elaboratin kadastral pranë Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren në emër dhe në favor të paditësit-kundërpaditurit si dhe paluajtshmërinë e përmendur - banesën t'ia dorëzoj në pronësi dhe shfrytëzim të lirë paditësit dhe në afat prej 15 dite nga dita e

plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Në pikën V të dispozitivit është refuzuar si e pa bazuar kundërpadia e të paditurëve-kundërpaditësve me të cilën kanë kërkuar që të anulohet kontrata mbi mbajtjen e përjetshme, e vërtetuar pranë gjykatës komunale në Prizren si Ndr.Nr.../...të datës ...., të lidhur ndërmjet F. dhe B.K. Në pikën VI të dispozitivit është vendosur që të mbetet në fuqi masa e sigurimit e caktuar me aktvendimin e kësaj Gjykate, C.Nr.1235/17 të datës 16.04.2018 deri në një vendim tjetër, dhe në pikën VII të dispozitivit janë obliguar të paditurit-kundërpaditësit, që paditësit ti paguajnë shpenzimet e procedurës paditësit-kundërpaditurit në mënyrë solidare në shumën prej 1485,00 €, (një mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë euro).

2. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurve - kundërpaditësve, me aktgjykimin Ac.Nr.6069/2021 të datës 28.05.2024, ka refuzuar të pa themeltë ankesën e të paditurëve, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.1235/2017, të datës 16.04.2021.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i të paditurit - kundërpaditësit B.K nga Prizreni, në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes qenësore të dispozitave procedurale dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranoj revizionin e të paditurit - kundërpaditësit, të ndryshoj aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, ashtu që refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazë, ose aktgjykimet e lartcekura ti prishë dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.

4. Revizion ka ushtruar edhe e paditura - kundërpaditësja V.D nga Prizreni, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni i të paditurës - kundërpaditëses së dytë, ashtu që aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta ti ndryshoj, ashtu që të refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të

pabazë, ose aktgjykimet e lartcekura ti prishë dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.

5. I autorizuari i paditësit - të kundërpaditurit, me përgjigje në revizion ka kërkuar që revizionet e të paditurve - kundërpaditësve të refuzohen në tërësi si të pabazuara.

6. Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, revizionet e të paditurve - kundërpaditësve, si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se:

7. Revizioni i të paditurit - kundërpaditësit B.K dhe revizioni i të paditurës - kundërpaditëses V.D, janë të pathemelta.

8. Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësi - i kundërpadituri, përmes të autorizuarit të tij, më datë 29.12.2019 në gjykatën e shkallës së parë shkallës së parë, ka paraqitë padi kundër të paditurve - kundërpaditësve, për anulimin e kontratës mbi dhuratën dhe kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, si dhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të kontratës për mbajtjen e përjetshme. Të paditurit - kundërpaditësit me kundërpadinë e paraqitur kanë kërkuar që të anulohet kontrata mbi mbajtjen e përjetshme, e vërtetuar në gjykatën komunale në Prizren, e lidhur ndërmjet F. dhe B.K.

9. Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësit - të kundërpaditurit, si dhe kundërpadisë së të paditurve - kundërpaditësve, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe pas vlerësimit dhe administrimit të provave në shkresat e lëndës ka marrë aktgjykimin, C.Nr.1235/17 të datës 16.04.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit - të kundërpaditurit si të bazuar, ndërsa ka refuzuar si të pabazuar kundërpadinë e të paditurve - kundërpaditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, elaboruar në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi.

10. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit mes tjerash ka theksuar se F.K., sa ishte gjallë përkatësisht në vitin 2006 me djalin e tij B.K lidh kontratën për mbajtjen e përjetshme pranë Gjykatës Komunale në Prizren. Po ashtu në lidhje me banesën kontestuese sa ka qenë i gjallë F.K në vitin 2011, ka lidhur edhe një kontratë mbi dhuratën me bashkëshorten e tij N.K tani e ndjerë, kontrata është lidhur pranë zyrës së avokatit Y.K dhe është legalizuar në Gjykatën Komunale në Prizren LEG.Nr.../..., datë .... Më pas në vitin 2015 N.K si dhuratmarrëse e banesës ka lidhur kontratë për shitblerjen e banesës me tani të padituren kundërpaditësen D.V, pranë zyrës së noterit B.M. me Nr.LRP.Nr..../... dhe numër të referencës ... të datës .... N.K. kontratën pranë noterit e ka lidhur më datën .., ndërsa më datë ... ka vdekur në Prizren. Po ashtu një vit më pas më datë ... ka vdekur edhe F.K. në Prizren, i cili gjatë jetës së tij i ka lidhur dy kontrata, në vitin 2006 kontratën për mbajtjen e përjetshme, ndërsa në vitin 2011 kishte lidhur kontratën për dhuratën. Tani, pronar juridik i banesës është e paditura D.V sipas kontratës së vitit 2015, e lidhur në mes N.K dhe D.V. Gjykata e shkallës së parë në këtë rast ka gjetur se konstestuese në mes palëve ndërgjyqëse është kontrata për mbajtjen e përjetshme e lidhur në mes të F.K., dhe B.K., në Gjykatën Komunale në Prizren, kontestuese ishte edhe e drejta e pronësisë në njësi të ndërtesës në banesë, po ashtu kontestuese ishin edhe kontrata për dhuratën e lidhur në mes të F.K dhe N.K në vitin 2011, si dhe kontrata për shitblerjen e banesës e lidhur në mes të N.K dhe D.V pranë noterit B.M., prandaj duke u bazuar në provat e lartcekura ka vendosur si në vijim.

11. Gjykata e shkallës së parë, ka vendosur sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit dhe e ka anuluar kontratën e dhuratës e lidhur në mes të dhuratëdhënësit F.K dhe dhuratëmarrësit N.K, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren, me numër Leg.Nr..../.... të datës ...., sepse në kohën kur është lidhur kjo kontratë njëkohësisht ka ekzistuar edhe kontrata për mbajtjen e përjetshme, e cila ishte e lidhur në vitin 2006 nga F.K., me djalin e tij B.K, për të njëjtën banesë për të cilën është lidhur edhe kjo kontratë në vitin 2011 me bashkëshorten e tij N.K. Në fakt F.K., si marrës i mbajtjes paraprakisht nuk ka ndonjë provë materiale që e dëshmon se e ka kërkuar zgjidhjen e kontratës për

mbajtjen e përjetshme në mënyrë që të lidh edhe kontrata dhe të vendosë detyrime tjera në këtë banesë. Po ashtu F.K., si palë kontraktuese e ka ditur se ekziston një kontratë e tillë, madje këtë fakt ju ka treguar edhe të padituri B.K., dhe familjarëve të tjerë ku të njëjtit kanë ndërmarrë veprime në gjykatë për revokimin e testamentit kinse për anulimin e kësaj kontrate.

12. Gjykata e shkallës së parë kishte vendosur sikurse në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, ku ka anuluar kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, e lidhur në mes shitësit N.K dhe blerësit V.D, e vërtetuar tek noteri B.M, me numër LRP.Nr.../... dhe Ref.Nr..../... të datës ..., sepse në kohën kur është lidhur kjo kontratë ka qenë në fuqi kontrata për mbajtjen e përjetshme. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kjo kontratë është lidhur pas kontratës mbi dhuratën çka e bënë të pa qëndrueshme, pasi që me anulimin e kontratës mbi dhuratën mungon edhe baza juridike për kontratën e shitblerjes, sepse palët kontraktuese e kanë fshehur ekzistimin e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme, sidomos i padituri B.K.,dhe e nderja N.K., e kanë ditur këtë fakt, ashtu siç ka deklaruar edhe vetë i padituri B.K., në dëgjimin e tij në shqyrtim kryesor.

13. Gjykata e shkallës së parë kishte vendosur sikurse në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit, duke vërtetuar të drejtën e pronësisë në banesën në vendin e quajtur Prizren, në sipërfaqe prej 41 m2, banesa 1 (një) dhomëshe, kati përdhese, numri i njësisë kadastrale ..., sepse paditësi në vitin 2006 ka lidhur kontratën mbi mbajtjen e përjetshme me pronarin e atëhershëm F.K., me detyrime të dyanshme, andaj edhe mbi këtë bazë i njeh të drejtën e pronësisë. Po ashtu edhe ka obliguar të paditurën kundërpaditësin D.V., që banesën në fjalë t'ia dorëzoj në posedim të lirë paditësit B.K., pasi që i njëjti e ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përjetshme, ndërsa aktualisht banesën e ka në posedim e paditura D.V., sipas certifikatës së pronësisë, me Nr. .... të lëshuar më datë .... Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit, duke e refuzuat kundërpadinë e të paditurëve-kundërpaditësve me të cilën

kanë kërkuar që të anulohet kontrata mbi mbajtën e përjetshme e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Prizren, si Ndr.Nr..../.... të datës ...., të lidhur ndërmjet F dhe B.K., duke marrë për bazë se të padituri nuk kanë ofruar prova me të cilat do ti vërtetonin faktet se këtë kontratë e bëjnë të pa qëndrueshme, të padituri vetëm kanë kërkuar nulimin e kësaj kontrate me faktin se nuk janë përmbushur detyrimet në mes dhënësit të mbajtjes dhe marrësit të mbajtës.

14. Gjykata e shkallës së parë në fund ka theksuar se tek kontratat për mbajtjen e përjetshme, shkëputjen e tyre mund ta kërkojnë vetëm palët kontraktuese dhe se anulimi i kësaj kontrate në këtë situatë kur marrësi i mbajtjes është i ndjerë mund të bëhet vetëm nëse kjo kontratë nuk është lidhur në formën dhe mënyrën e përcaktuar me ligj, ndërsa gjatë jetës marrësi i mbajtjes mund ta kërkoj zgjidhjen e kontratës për shkak të mos përmbushjes deri në momentin e vdekjes së tij. E në këtë rast nga palët gjykatës nuk i është ofruar asnjë provë me të cilën mund të konstatohet se një kontratë e tillë është kundërshtuar nga marrësi i mbajtjes F.K. Në lidhje me masën e përkohshme gjykata e shkallës së parë e ka lënë në fuqi deri në zgjidhjen e çështjes duke pasur parasysh edhe qëllimin e saj për të cilën është caktuar.

15. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë i është referuar Ligjit mbi Trashëgiminë i vitit 1974, si ligj i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është lidhur kontrata për mbajtjen e përjetshme, respektivisht nenin 105 të këtij ligji, nenit 20 paragraf 1 dhe 2, nenit 33 dhe nenit 41 të Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, datë 30 janar 1980. Ndërsa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 453 dhe 454 të LPK-së.

16. Gjykata e Apelit të Kosovës ka mbështetur në tërsi qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe në tërsi ka refuzuar ankesën e të padituve - kundërpaditësve, me vlerësim se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përfshi në asnjë shkelje të dispozitave procedurale, drejtë dhe plotësisht është vërtetuar gjendja faktike si dhe drejtë është

aplikuar e drejta materiale. Kjo gjykatë ka vlerësuar të paqëndrueshme edhe pretendimet ankimore lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, me referencë në nenin 105 të Ligjit për Trashëgiminë i vitit 1947, si dhe nenin 41 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore, duke vlerësuar se të drejtat pronësore janë të drejta absolute dhe ndaj të cilave nuk ka afat të parashkrimit pra nuk parashkruhen. Në rastin konkret paditësi përmes padisë ka kërkuar vërtetimin e pronësisë mbi bazën e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme, dhe po ashtu anulimin e kontratave që kanë pasur pas kontratës mbi mbajtjen e përjetshme, e që janë: kontrata mbi dhuratën dhe kontrata mbi shitblerjen. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se kontrata mbi dhuratën edhe për nga baza është kontratë më e dobët, sepse ka detyrime vetëm në njërën anë, ndërsa kontrata mbi mbajtjen e përjetshme është kontratë me prestime të dyanshme. Në këtë rast është vlerësuar se dhënësi i dhuratës nuk ka pasë të drejtën e disponimit në raport me objektin e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme pa e anuluar të njëjtën, sepse objekti i asaj kontrate ka qenë i siguruar, dhe se fillimisht ka qenë dashur që të anulojë kontratën mbi mbajtjen e përjetshme, e pastaj të lidhë kontratë të re përndryshe nuk e ka pasur të drejtën e disponimit, pasi kontrata mbi mbajtjen e përjetshme ka qenë e lidhur në formën dhe procedurën e paraparë me ligj, dhe se i ndjeri paraardhësi i paditësit dhe të padituri të parë, babai i tyre, ka qenë i njoftuar nga ana e gjykatës me pasojat e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme.

17. Gjykata e Apelit më tej ka vlerësuar se me nënshkrimin e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme palët ndërgjyqëse marrin obligime nga kjo kontratë, pra kjo kontratë ka pasoja në raport me palët, gjë që njëra ndër pasojat është se pranuesi apo marrësi i mbajtjes në raport me pronën që është objekt i kontratës nuk e ka të drejtën e disponimit përderisa është në fuqi kontrata dhe nuk është anuluar e njëjta. Në atë kohë nuk ka qenë kusht që kontrata mbi mbajtjen e përjetshme të regjistrohet si ndalesë në kadastër, por ka mjaftu legalizimi i kontratës pranë gjykatës, dhe palët janë njoftuar me pasojat e kontratës. Kontrata mbi mbajtjen e përjetshme është e vetmja kontratë që përmes saj mund të cenohet pjesa e domosdoshme e trashëgimtarëve dhe mbi këtë bazë trashëgimtarët nuk kanë të drejtë të kërkojnë anulimin e kontratës në

fjalë, gjë që kjo nuk vlen për kontratën mbi dhuratën. Pra kontrata mbi dhuratën nuk ka qenë valide, sepse objekt të vetin e ka një paluajtshmëri, apo pronë e cila nuk mund të jetë në disponim derisa është në fuqi kontrata mbi mbajtjen e përjetshme. Andaj meqenëse i ndjeri nuk ka pasur të drejtë të disponojë për bartje përmes çfarëdo forme të dhurimit apo edhe shitblerjes të banesës që ka qenë objekt i kontratës për mbajtje të përjetshme, edhe punët tjera juridike si kontrata mbi shitblerjen janë punë absolutisht nule dhe nuk duhet të prodhojë efekt juridik, në të kundërtën kjo do të përbënte pasiguri juridike.

18. Gjykata e Apelit në fund ka shtuar se meqenëse e drejta e pronës nuk parashkruhet rrjedhimisht edhe padia e paditësit për anulimin e kontratës mbi dhuratën dhe ajo e shitblerjes nuk parashkruhen, sepse paditësi të drejtën e tij të pronës, do ta fitonte në kushte normale menjëherë pas vdekjes së të ndjerit babait të tij në vitin 2016, dhe se deri atëherë ai do të ishte pronar i "supozuar" dhe me kusht sepse kushti do të ishte që kontrata mbi mbajtjen e përjetshme mos të anulohej dhe i ndjeri babai i tij të mos ishte në jetë. Palët e paditura nuk kanë arritur të vërtetojnë se i ndjeri babai i paditësit të ketë provuar, inicuar apo tentuar që të anulojë kontratën mbi mbajtjen e përjetshme. E ndjera nëna e paditësit ka qenë në dijeni për kontratën mbi mbajtjen e përjetshme, andaj ka qenë dashur ta dijë se nuk mund të fiton diçka që në atë moment të drejtën e disponimit nuk e ka as pronari përderisa është në fuqi një kontratë e tillë. Siguria juridike në raste të tilla shkon në drejtim të ofrimit të garancisë se në të gjitha rastet që ka kontrata mbi mbajtje të përjetshme, pronari i sendit nuk ia cenon të drejtat marrësit të mbajtjes përmes formave tjera duke rrezikuar objektin e kontratës mbi mbajtje që mund të jetë pronësia apo një pjesë e pronës së dhënësit të mbajtjes.

19. Në raport me kundërpadinë për anulimin e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të njëjtën e ka refuzuar, pasi nuk plotësohet asnjë kusht për anulimin e të njëjtës, sepse anulimin e asaj kontrate fillimisht e kanë palët ndërgjyqëse, ndërsa personat e tretë vetëm nëse

arrijnë të vërtetojnë se ka pasur të meta në shprehjen e vullnetit të njërës palë në aspektin psikik, nëse ka lënduar nga ndonjë sëmundje (marrësi apo pranuesi i mbajtjes), në të kundërtën kontrata për shkaqe tjera nuk mund të anulohet se është kontratë e veçantë, e që në të kaluarën është rregulluar me Ligjin për Trashëgiminë, ndërsa tani rregullohet me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë, ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura nga të padituri - kundërpaditësit dhe ka dhënë arsye të qarta në lidhje me çështjet e ngritura që kanë të bëjnë me shkeljen esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe me zbatimin e gabuar të dispozitave materiale. Kjo gjykatë me arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar me revizion ka përmbushur kërkesat ligjore nga neni 204 të LPK-së, si në pikëpamje të kufijve të shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe në aspektin e dhënies së arsyeve për të gjitha çështjet e ngritura në ankesë.

3. I padituri i parë - kundërpaditësi ashtu si edhe e paditura e dytë - e kundërpaditura në revizionet e paraqitura pretendojnë se aktgjykimet e atakuara janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 1 dhe 2, pika n) të LPK-së, që konsiston në faktin se aktgjykimet në fjalë kanë të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, të njëjtat janë të pakuptueshme apo kontradiktore dhe në vete përmbajnë kundërthënie në mes të vendimit dhe arsyetimit, respektivisht të njëjtat nuk

përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante, çka i bënë kundërthënëse dhe të paarsyetuara. Gjykata Supreme vlerëson se që të dy gjykatat e instancës më të ulët secila në rolin e vet kanë dhënë arsye të qarta në lidhje me faktet vendimtare që kanë të bëjnë me kërkesën e padisë dhe kundërpadisë. Çështja e ngritur në padi ka të bëjë me fitimin e pronësisë sipas bazës së kontratës mbi mbajtjen e përjetshme, andaj gjykata e shkallës së parë ka trajtuar faktet thelbësore dhe ka dhënë arsye të qarta në lidhje me rëndësinë e kontratës për mbajtjen e përjetshme për të fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese, çështjen e përmbushjes së kontratës nga palët kontraktuese dhe pasojat që shkaktohen nga kontrata pas vdekjes së marrësit të mbajtjes, pastaj janë dhënë arsye të qarta nga të dy gjykatat edhe lidhur me anulimin e kontratës së dhuratës, dhe kontratës së shitblerjes, kjo pasi që me rastin e lidhjes së këtyre kontratave njëkohësisht ka ekzistuar edhe kontrata për mbajtjen e përjetshme, e cila ishte e lidhur në vitin 2006 nga F.K., me djalin e tij B.K., për të njëjtën banesë e cila është objekt kontesti.

4. Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta në lidhje me vendosjen sipas kërkesës nga kundërpadia e të paditurve-kundërpaditësve, ku janë trajtuar pretendimet për anulim të kontratës për mbajtjen e përjetshme, andaj mbi bazën e provave të administruara dhe të vlerësuara është qartësuar se nuk ekziston asnjë nga kushtet ligjore për anulim të kontratës për mbajtjen e përjetshme në pikëpamje të shkaqeve që kanë të bëjnë me anulimin absolut të kësaj kontrate apo të shkaqeve që kanë të bëjnë me anulimin relativ, përkatësisht të meta në vullnetin e shprehur nga palët kontraktuese. Gjykata Supreme po ashtu ka vlerësuar se Gjykata e Apelit ka trajtuar pretendimet thelbësore të ngritura në ankesë nga palët e paditura - kundërpaditësit si në aspektin e shkeljeve procedurale të pretenduara po ashtu edhe në aspektin e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të drejtës materiale, duke dhënë arsye të qarta për refuzimin e ankesës së palëve të paditura - kundërpaditëse. Kjo gjykatë ka vlerësuar të pathemeltë edhe pretendimin në revizion të paditurit të parë - kundërpaditësit në lidhje me shkelje të dispozitave procedurale, përkatësisht për shkelje të nenit 182.2, pika o) të LPK-së,

kjo pasi që gjykata e shkallës së parë ka vepruar brenda kufijve të kërkesave të palëve ndërgjyqëse, në këtë rast të kërkesëpadisë së palës paditëse, ndërsa gjykata e shkallës së dytë nuk ka mundur ta bëjë këtë shkelje pasi që nuk ka hapur seancë gjyqësore dhe as që ka vendosur ndryshe lidhur me kërkesëpadinë e palëve por vetëm ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë. Në këtë mënyrë aktgjykimet, ligjshmëria e të cilave kontestohet përmes revizionit, janë mjaft të qarta, të rregullta në strukturë dhe përmbajtje.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Kjo gjykatë vlerëson se paditësi si trashëgimtarë i të ndjerit F.K., ka qenë i legjitimuar të kërkojë mbrojtje gjyqësore në raport me paluajtshmërinë objekt shqyrtimi, e cila paluajtshmëri ka derivuar nga një raport kontraktues - kontrata mbi mbajtjen e përjetshme të lidhur mes tij dhe babait F.K. Gjatë procesit gjyqësor është kontestuar çështja e përmbushjes së obligimeve sipas kontratës për mbajtjen e përjetshme nga pasardhësi tjetër, respektivisht i padituri i dytë - kundërpaditësi, si dhe e paditura e dytë - kundërpaditësja si blerëse e banesës objekt kontesti nga nëna e këtu paditësit, me pretendimet se dhënësi i mbajtjes B.K., nuk ishte kujdesur për mirëqenien e prindërve të tij, pasi që i njëjti kishte qenë jashtë vendit, e po ashtu marrësi i mbajtjes ishte në shkallën e pleqërisë së thellë, ashtu që kishte pësuar sulm në tru.

6. Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e tilla të paditurve kundërpaditësve kanë të bëjë me çështjen e zgjidhjes së kontratës së mbajtjes së përjetshme dhe si të tilla duhet trajtuar në kuptim të dispozitës së nenit 108 të Ligjit mbi Trashëgimin, i datës 30 dhjetor 1974, me të cilin nen është përcaktuar se: "*Palët kontraktuese mund të zgjidhin me marrëveshje kontratën mbi ushqimin e përjetshëm edhe pasi të ketë filluar ekzekutimi i saj. Në qoftë se sipas kontratës mbi ushqimin e përjetshëm kontraktuesit bashkëjetojnë dhe marrëdhëniet e tyre çrregullohen në atë masë saqë bashkëjetesa bëhet e padurueshme, secila palë mund të kërkojë nga gjykata zgjidhjen e*

kontratës. Secila palë mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës në qoftë se pala tjetër nuk përmbush obligimet e veta. Në rast zgjidhjeje të kontratës secila palë ruan të drejtën që nga-pala tjetër të kërkojë zgjidhjen respektivisht të kërkojë shpërblimin që i takon sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës pasurore". Sipas kësaj gjykate të padituri-kundërpaditësit kanë ngritur çështjen në raport me kontratën për mbajtjen e përjetshme që mund të ngritën vetëm nga palët kontraktuese, në këtë rast marrësi i mbajtjes F.K., dhe dhënësi i mbajtjes B.K. Pra të padituri -kundërpaditësit nuk janë palë kontraktuese dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë dhe shkaqet e theksuara nuk mund të kërkojnë zgjidhjen e kontratës për mbajtjen e përjetshme, kjo pasi që kjo e drejtë ju takon palëve kontraktuese në këtë rast, në pikëpamje të shkaqeve të theksuara nga të padituri-kundërpaditësit kjo e drejtë i ka takuar F.K., si marrës i mbajtjes, por siç rezulton nga shkresat e lëndës në kohën sa ka qenë në jetë nuk ka asnjë provë që në ndonjë formë ka kërkuar zgjidhjen e kontratës për shkak të mos përmbushjes.

7. Nga këto arsye, mbështetur në dispozitat nga neni 108 të Ligjit mbi Trashëgiminë, i datës 30 dhjetor 1974, si dhe në parimet themelore të së drejtës kontraktore, kjo gjykatë vlerëson se në pikëpamje të shkaqeve të sipërtheksuara të padituri-kundërpaditësit nuk kanë legjitimitet aktiv për të kërkuar zgjidhjen e kontratës për mbajtje të përjetshme, pasi nuk janë palë në kontratë, kjo drejtë u ka takuar vetëm palëve kontraktuese, pra dhënësit ose marrësit të mbajtjes, ndërsa në mungesë të kërkesës për zgjidhje të kontratës nga marrësi i mbajtjes sa ishte gjallë, tani për tani, në pikëpamje të shkaqeve të sipërtheskuara, nuk ka asnjë bazë ligjore për të konsideruar se një e drejtë e tillë të ketë kaluar të të padituri-kundërpaditësit.

8. Ligji mbi Trashëgiminë i datës 30 dhejtor 1974 (në fuqi në kohën kur është lidhë kontrata), me dispozitën nga neni 105 al. 4 ka përcaktuar se: "*Kontrata mbi ushqimin e përjetshëm duhet të përpilohet me shkresë dhe të legalizohet nga gjykata",* ndërsa me dispozitën e nenit 105 al. 5 parashihet se*: "Në rastin e legalizimit gjyqtari do të lexoj kontratën dhe do t'iu tregoj kontraktuesve pasojat e kontratës*". Ndërsa

me dispozitën nga neni 67 al 1, të LMD-ës, përcaktohet se: " *Lidhja e kontratës nuk i nënshtrohet asnjë forme, përveç nëse me ligj është caktuar ndryshe*", ndërsa për kontratën mbi mbajtjen e përjetshme përveç formës e njëjta është dashur që të kalohet në procedurë gjyqësore- jokontestimore për tu trajtuar si valide. Sipas kësaj gjykate, nga shkresat e lëndës rezulton se kontrata është lidhur në procedurën e përcaktuar me dispozitat e sipërcituara, pra është lidhur para gjykatës dhe sipas procedurave të përcaktuara ku ka qenë obligim që tu lexohet palëve kontrata dhe të njoftohen për pasojat dhe më pas është vërtetuar në gjykatën komunale në Prizren, si Ndr.Nr..../... e datës ..., e lidhur ndërmjet F dhe B.K.

9. Të padituri me kundërpadi kanë kërkuar anulimin e kontratës për mbajtjen e përjetshme, me pretendim se banesa objekt kontesti, fillimisht përmes kontratës së dhuratës e lidhur në mes të dhuratëdhënësit F.K dhe dhuratëmarrësit N.K, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren me numër Leg.Nr..../... të datës ..., i është dhuruar bashkëshortes së tij, respektivisht nënës së paditësit dhe të padituri të parë, e më pas e njëjta përmes kontratës për shitblerjen e paluajtshmërisë e vërtetuar tek noteri B.M., me numër LRP.Nr..../... dhe Ref.Nr..../... të datës ..., të njëjtën banesë ia ka shitur V.D., këtu e paditur - kundërpaditëse. Fakti që në kohën e ekzistimit të kontratës për mbajtjen e përjetshme, marrësi i mbajtjes në këtë rast F.K., ka lidhur kontratë për dhuratën me bashkëshorten e tij N.K, për të njëjtën banesë që ka qenë pjesë e kontratës për mbajtjen e përjetshme, kjo për Gjykatën Supreme nuk paraqet arsye për anulim të kontratës për mbajtjen e përjetshme kjo pasi që kontrata për mbajtjen e përjetshme është kontratë formale dhe e njëjta i nënshtrohet rregullave formale si për lidhjen, ashtu edhe për ndryshimin dhe anulimin e saj. Kjo është përcaktuar edhe me nenin 67 al. 2, të LMD-ës, sipas të cilës dispozitë: " *Kërkesat nga ligji që kontrata të lidhet në një formë të caktuar vlen edhe për të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e më vonshme të kontratës*". Në rastin konkret asnjë ndryshim i më vonshëm nuk ka ndodhë si në formën në të cilën është lidhë kontrata mbi mbajtjen e përjetshme. Pavarësisht faktit që marrësi i mbajtjes ka lidhur kontratën e dhuratës me bashkëshorten e tij, në mënyrën siç përcaktohet zgjidhja

e kontratës për mbajtjen e përjetshme sipas nenit 108 të LTK, kontrata për dhuratën e vitit 2011 nuk mund të ketë asnjë efekt juridik të drejtpërdrejt në validitetin e kontratës për mbajtje të përjetshme, kjo pasi që validitetit i kontratës për mbajtjen e përjetshme mund të ndryshohet me vullnetin e palëve apo vendim të gjykatës, gjë që kjo në këtë rast nuk ka ndodhur.

10. Çështja tjetër që është ngritur nga të paditurit-kundërpaditësit ka të bëjë me atë se kontrata për mbajtjen e përjetshme e lidhur mes babait të paditësit dhe të paditurit të parë, dhe këtu paditësit B.K, është lidhur pa ekzistuar vullneti i shprehur i ushqimarrësit F.K, respektivisht pa u vlerësuar gjendja shëndetësore, mosha e shtyrë dhe aftësia fizike e mendore e tani të ndjerit (baba i paditësit dhe të paditurit të parë). Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët kanë trajtuar pretendimet e të paditurve - kundërpaditësve në lidhje me kërkesën për anulim të kontratës për mbajtjen e përjetshme dhe me provat e siguruara, dëshmitë e dëshmitarëve dhe deklarimet e palëve ndërgjyqëse dhe sqarimet e tyre, është vërtetuar fakti që te tani i ndjeri F.K, në kohën e nënshkrimit të kontratës kontestuese ka ekzistuar vullneti i të njëjtit për lidhjen e kësaj kontrate, respektivisht nuk është vërtetuar se i njëjti ka qenë i paaftë, apo ka pësuar sulm në tru, siç kanë pretenduar kundërpaditësi i parë me revizion.

11. Në raport me pretendimet e paraqitura në revizion nga e paditura e dytë - kundërpaditësja, se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar rregullsinë dhe ligjshmërinë e kontratave të lartcekura, atë të dhuratës, si dhe kontratën e mëvonshme të shitblerjes së banesës objekt kontesti, sipas kësaj gjykate një pretendim i tillë është i pathemeltë, kjo pasi që nga shkresat e lëndës ka rezultuar se kontrata për mbajtjen e përjetshme është lidhur më herët, respektivisht në vitin 2006 mes këtu paditësit dhe tani të ndjerit F.K, nga e cila kontratë ka rezultuar se i ndjeri F.K, e ka shprehur vullnetin e tij lidhur me banesën objekt i kontratës mbi mbajtjen e përjetshme dhe rrjedhimisht është vlerësuar se kontratat tjera, ajo e dhuratës, e më vonë e shitblerjes së banesës nuk mund të prodhojnë efekte juridike në këtë rast, pasi që paraprakisht ka ekzistuar kontrata mbi mbajtjen e përjetshme, e cila është kontratë

formale dhe e njëjta i nënshtrohet rregullave formale si për lidhjen, ashtu edhe për ndryshimin si dhe për anulimin e saj, kjo pasi që me dispozitat e Ligjit mbi Trashëgimin, i datës 30 dhjetor 1974, është parapa mënyra e zgjidhjes së kontratës. Andaj, është vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë kanë refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e të padituve-kundërpaditësve për anulimin e kontratës për mbajtjen e përjetshme, kjo pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar se kontrata është lidhur në kundërshtim me dispozitat e nenit 103 dhe nenit 111 të LMD-së, pra, me parimet dhe rendin juridik kushtetues, me dispozitat imperative etj, të njëjtat nuk janë lidhur me (vi, clam, precario) me mashtrim, kërcënim apo lajthim.

12. Në rastin konkret pretendimet e të padituve - kundërpaditësve në revizionet e paraqitura për anulimin e kontratës, i referohen mungesës së vullnetit në këtë rast të ndjerit F.K., për ta lidhë këtë kontratë, prandaj gjykata kërkesën për anulim të kontratës e trajton në kuptim të dispozitave për rrëzueshmërinë e kontratës-anulimit për shkaqe relative, pasi që është e njohur se lënda edhe baza e kontratës janë shkaqe për të cilat mund të kërkohen anulimi për shkaqe që kontratën e bëjnë absolutisht nule, ndërsa vullneti dhe zotësia e veprimit janë shkaqe të cilat kontratën e bëjnë relativisht nule. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, të padituri me asnjë provë nuk kanë vërtetuar faktin se të ndjerit F.K., me rastin e lidhjes së kontratës mbi mbajtjen e përjetshme i ka munguar vullneti për lidhjen e kontratës.

13. Meqë në këtë rast ka pasur kontratë për mbajtjen e përjetshme, pra nuk është arritur të argumentohet që e njëjta është lidhur në kundërshtim me ligjin, apo ajo të jetë zgjidhur nga palët kontraktuese, rezulton se kontrata ka qenë në fuqi dhe pasuria e cila ka qenë objekt i kontratës nuk ka mundur të kaloj tek personat e tjerë. Me nenit 105 al. 1 të Ligjit mbi Trashëgiminë i datës 30.12.1974, është përcaktuar se: “Kontrata me të cilin një kontraktues obligohet të ushqej për tërë jetën kontraktuesin tjetër, ose ndonjë person të tretë, e në të cilën kontraktuesi tjetër deklaron se i lënë tërë pasurinë e tij ose një pjesë të saj si trashëgim, nuk është kontratë mbi trashëgiminë, por kontratë mbi tjetërsimin me shpërblim të gjitha sendeve të paluajtshme, që i takojnë

ushqim marrësit, në kohën e lidhjes së kontratës, ose një pjesë të caktuar të këtyre sendeve, dorëzimi i të cilave ushqim dhënësit i është shtyrë gjerë me vdekjen e ushqim marrësit (kontrata mbi ushqimin e përjetshëm)". Për nga natyra juridike kjo kontratë nuk është kontratë për trashëgimi por është kontratë me prestime dhe detyrime të dyanshme, me të cilën ushqimmarrësi disponon gjatë jetës me pasurinë e tij. Me këtë kontratë tjetërsohet pasuria e cila është objekt i saj, prandaj, pasuria e cila është objekt i kontratës deri sa kontrata është e vlefshme ajo nuk bën pjesë në masën trashëgimore të ushqimmarrësit dhe e cila nuk mund të shqyrtohet më rastin e shqyrtimit të trashëgimisë së tij, pasi që gjatë jetës së tij është tjetërsuar nga ai. Madje as trashëgimtarët e domosdoshëm nuk mund t'a atakojnë atë as për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme. Nga kjo rezulton se banesa objekt i kontratës për mbajtjen e përjetshme deri sa kjo kontratë ka qenë në fuqi nuk ka mundur të jetë objekt i kontratës së dhurimit e rrjedhimisht i kontratës së mëvonshme të shitblerjes, andaj kjo e bënë që kontratat e mëvonshme të konsiderohen si kontrata që janë lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore nga nenet 46 dhe 51 të LMD-së, që rrjedhimisht i bëjnë si kontrata absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 102 të LMD-së.

14. Nga arsyet e paraqitura kjo gjykatë nxjerr përfundimin se paluajtshmëria - banesa objekt shqyrtimi ka qenë e F.K., tani i ndjerë, e cila në bazë të kontratës për mbajtjen e përjetshme është dashur ti kaloj këtu paditësin B.K, andaj i njëjti mbi bazën e kontratës së lartcekur ka fituar të drejtën e pronësisë, e si rrjedhojë e kësaj këtu paditësit i takon e drejta e pronësisë, si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, të vërtetuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, e mbështetur në nenin 36 të LMTHJP, me të cilin është përcaktuar se: "E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim, e drejta e pronësisë mbi sendin fitohet me anë të trashëgimit në momentin e hapjes së trashëgimisë, po që se me ligj nuk është caktuar ndryshe".

15. Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizioneve të

paraqitura, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

16. Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.511/2024, datë 20.03.2025

"As baza e trashëgimisë e as parashkrimi i pretenduar nuk mund të shërbejë si bazë për fitimin e pronësisë, kjo pasi që paluajtshmëria nuk ka figuruar në emër të paraardhësit të paditësve në mënyrë që kjo të kaloj tek trashëgimtarët - paditësit, e po ashtu të njëjtit nuk janë në posedim për tu vlerësuar pastaj çështja e kalimit të posedimit nga paraardhësi tek pasardhësit dhe fakti më i rëndësishëm është që kjo paluajtshmëri është eksproprijuar me vendim administrativ dhe mbi bazën së këtij vendimi ka kaluar në emër të paditurës.
Mos kompensimi i pretenduar nga paditësit po ashtu nuk paraqet bazë për fitim të pronësisë, pasi që as paraardhësi i paditësve apo paditësit nuk e kanë kontestuar procesin e shpronësimit në ndonjë formë dhe brenda afateve prej 3 dhe 10 viteve, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin mbi Eksproprijimin të vitit 1978, ndërsa paluajtshmëria paditësve u është marrë sipas një procesi ligjorë të eksproprijimit që ka ndodh në vitin 1980, respektivisht sipas vendimit të shpronësimit të formës së prerë, ndërsa paditësit nuk kanë bashkangjitur prova që kanë atakuar në ndonjë formë këtë vendim, andaj në praninë e fakteve të tilla përjashtohet çdo bazë që paditësit ta fitojnë pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.106/2013 të datës 08.11.2018, në paragrafin e parë të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve E., M., M1, dhe R.V nga Podujeva kundër të paditurës Komuna e Podujevës, si e pabazuar me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësit janë pronarë të paluajtshmërisë së ngastrave kadastrale Nr. ... në vendin e quajtur "Q... – rruga ...", me kulturë shtëpi, në sipërfaqe prej 00.00.45 ha, me kulturë arë në sipërfaqe prej 00.05.00 ha, me kulturë arë në sipërfaqe prej 00.00.58 ha, ngastrën kadastrale Nr. ..., në vendin e quajtur "Q", me kulturë arë në sipërfaqe prej 00.05.60 ha, të gjitha të regjistruara në fletën

poseduese ..., ZK Podujevë, si dhe ti paguajë shpenzimet e procedurës. Në paragrafin e dytë të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

2. Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.106/2013 të datës 10.12.2018, është bërë përmirësimi i aktgjykimit C.Nr.106/2013 të datës 08.11.2018, kështu që në këshillë juridike të aktgjykimit në rreshtin e II-të, ku është shënuar gabimisht " se palët e pa kënaqura kundër këtij aktgjykimi kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh", e që duhet të jetë "palët e pa kënaqura kundër këtij aktgjykimi kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh", kurse pjesa tjetër mbetet e pandryshuar. Ky aktvendim është pjesë përbërëse e aktgjykimit C.Nr.106/2013 të datës 08.11.2018.

3. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësve me aktgjykimin Ac.Nr.737/19 të datës 17.07.2023, ka vendosur që të refuzoj të pathemeltë ankesën e paditësve E., M., M1, dhe R.V nga Podujeva, të gjithë nga Podujeva, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.106/2013 të datës 08.11.2018.

4. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditësve, në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranoj revizionin e paditësve, të anuloj aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta dhe çështja ti kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

5. I autorizuari i të padituërs me përgjigje në revizion ka propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës të refuzoj si të pabazuar revizionin e paditësve, dhe të mbeten në fuqi aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta.

6. Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimin Rev.Nr.382/2023 të datës 17.10.2023 e ka hedhë si të palejuar revizionin e të autorizuarit të paditësve, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.Nr.737/19 të datës 17.07.2023.

7. Ndaj vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, i autorizuari i paditësve më datë 20.02.2024 ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke kërkuar mbrojtje juridike, me pretendim se u janë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

8. Gjykata Kushtetuese me aktgjykimin KI43/24, datë 23 tetor 2024, ka deklaruar të pranuar kërkesën e palëve, ka konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, ka shpallur të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev.Nr.382/2023, datë 17 tetor 2023 dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje në pajtim me konstatimin e dhënë me këtë aktgjykim.

9. Marrë për bazë aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese rezulton se Gjykata Supreme duhet që të trajtoj revizionin e paditësve, pra të mos e hedhë atë, sepse kjo është konsideruar si shkelje e të drejtës për qasje në gjykatë.

10. E gjendur në një situatë të tillë Gjykata Supreme është dashur ta trajtoj revizionin në meritat e tij andaj, në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215, ka gjetur se:

11. Revizioni i të autorizuarit të paditësve është i pathemeltë.

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit më datë 11.03.2013, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi, të precizuar me parashtresën e datës 13.06.2013, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se paditësit janë pronarë të paluajtshmërisë Nr. ... në vendin e quajtur “Q... - rruga ....”, me kulturë shtëpi, në sipërfaqe prej 00.00.45 ha, me kulturë oborr në

sipërfaqe prej 00.05.00 ha, me kulturë arë në sipërfaqe prej 00.00.58 ha, ngastrën kadastrale Nr. ..., në vendin e quajtur "Q...-....", me kulturë arë në sipërfaqe prej 00.05.60 ha, të gjitha të regjistruara në fletën poseduese ...., ZK Podujevë.

13. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur lidhur me këtë çështje, ashtu siç është përcaktuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.106/2013 të datës 08.11.2018, elaboruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

14. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë mes tjerash ka theksuar se nuk ishte kontestues fakti që paraardhësi i paditësve R.V., ka qenë pronar i ngastrave kadastrale Nr. ... dhe ..., e po ashtu nuk ishte kontestues as fakti se paraardhësit R.V nga Podujeva i janë eksproprijuar ngastrat kadastrale Nr. ... dhe ... me sipërfaqet e cekura më lart, e kjo sipas aktvendimit të Seksionit Pronësoro Juridik KK. Podujevë me Nr.... të datës .... Kontestues nuk ishte fakti se tani ngastrat kadastrale ... dhe ... tani janë të evidentuara në emër të Komunës së Podujevës si pronë shoqërore, sipas Fletës Poseduese Nr. 1230, e më vonë sipas certifikatës së pronësisë F-..., ZKK Podujevë, datë .... Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet fakti se a i janë paguar të hollat për këto ngastra të eksproprijuara palës paditëse nga e paditura, si dhe a ka të drejtë pala paditëse në deekseproprijim të këtyre ngastrave, me pretendim se këto ngastra e paditura nuk i ka shfrytëzuar dhe përdorur për qëllimin e eksproprijimit dhe nuk është përfunduar objekti i nisur e i pa përfunduar si shtëpi kulturë, si dhe a kanë të drejtë që të njëjtëve tu kthehet dhe njihet e drejta e pronësisë, respektivisht të bëhet deekseproprijimi i paluajtshmërisë për ngastrat e lartcekura. Sipas kësaj gjykate, nga vendimi i datës ..., konstatohet se është bërë eksproprijimi i paluajtshmërive kontestuese në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Eksproprijimin për interes të përgjithshëm - ndërtimin e shtëpisë së kulturës dhe është bërë regjistrimi në librat kadastral në emër të paditurës, ndërsa janë siguruar edhe mjetet për eksproprijimin e këtyre ngastrave, e po ashtu pala paditëse ka nënshkruar edhe marrëveshje me të paditurën, respektivisht me kryetarin e Kuvendit Komunal, kryetarin e Këshillit Ekzekutiv dhe përfaqësues tjerë të KK

Podujevë më datë 31.10.1980, ku është pajtuar që të shpërngulet nga shtëpia dhe të shkoj në banesën shoqërore.

15. Gjykata e shkallës së parë më tej ka shtuar se e paditura paluajtshmëritë kontestuese i mban me mirëbesim dhe në mënyrë të ligjshme, konform nenit 28.2 dhe 4 të LMTHPJ-së. Paditësit nuk kanë të drejtë në pretendimet e tyre se nuk iu ka bërë kompensimi i paluajtshmërive nga e paditura me rastin e eksproprijimit sepse me prova materiale është vërtetuar e kundërta, kjo pasi që paditësi është ka pranuar ta lirojë paluajtshmërinë, përndryshe nëse nuk ishte bërë pagesa nuk do të pranonte lirimin e pronës. Po ashtu ka shtuar se si fakt i rëndësishëm se paditësve iu është bërë pagesa është edhe kërkesa e bërë nga ana e paditësve dhe pronarëve tjerë ku kanë bërë kërkesë për deeksproprijim me datën 21.11.2001, ku vet kërkuesit kanë cekur se: "edhe pse ish pronarëve iu bërë kompensimi i ngastrave ..., ..., ... dhe ... nga ana e Komunës së Podujevës atyre nuk iu është bërë kompensimi adekuat dhe për këtë janë të dëmtuar", nga e cila rrjedh se të njëjtit kanë marrë kompensim., por nuk janë të kënaqur me atë që kanë marrë, e që edhe po të mos kishin marrë fare ata i kanë humbur afatet ligjore për të bërë një kërkesë me kohë.

16. Në fund gjykata e shkallës së parë ka theksuar se duke u bazuar në provat e administruara dhe konform dispozitave të Ligjit mbi Eksproprijimin, në kuptim të dispozitës së nenit 21 paragrafi 4 në të cilin përcaktohet se: "Vendimi në formë të prerë mbi eksproprijimin do të anulohet edhe në bazë të kërkesës së pronarit të mëparshëm të pasurisë së patundshme të eksproprijuar, nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit në afatin prej 3 vitesh nga momenti kur vendimi ka marrë formë të prerë nuk ka kryer sipas natyrës së objektit, punime të nevojshme në atë objekt", edhe pse e paditura e ka nisur objektin por edhe nëse nuk e ka përfunduar atë siç pretendon pala paditëse ajo ka bërë kërkesën me vonesë pranë të padiurës për deeksproprijim, sepse pranë të padiurës e ka dorëzuar kërkesën më datë 21.11.2001, aktvendimin për kompensimin e pronës së eksproprijuar e ka pranuar më datë 27.04.1949, ndërsa padinë e ka paraqitur me datë 01.02.2001,

që do të thotë jashtë afatit të paraparë ligjor prej 10 vjetësh, të paraparë me nenin 21 paragrafi 5 të Ligjit mbi Ekspropriimin.

17. Për bazë ligjore gjykata i është referuar neneve: 20 paragraf 2, 28 paragraf 2 dhe 4, 70 paragraf 1 dhe të LMTHPJ të vitit 1980, nenit 21 paragraf 4 dhe 5 të Ligjit të Ekspropriimit, si dhe nenin 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar i vitit 1976, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 450 të LPK-së.

18. Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes ka vlerësuar se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), i), k) dhe m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i kanë pretenduar palët ankuese me ankesë.

19. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se me rastin e refuzimit të padisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka aplikuar nenin 21 paragrafi 5 të Ligjit për Ekspropriimin ku përcaktohet se: "Pasi të kalojnë dhjetë (10) vjet nga kur vendimi ka marrë formë të prerë mbi ekspropriimin nuk mund të paraqitet kërkesa për anulimin e atij vendimi". Mbi bazën e kësaj gjendje paditësit nuk kanë mundur të fitojnë të drejtën e pronësisë në pronën kontestuese, pasi që përkundër faktit se e njëjta ka qenë pronë e R.V - babai i paditësve, përkatësisht bashkëshorti, mirëpo nga provat e administruara nga gjykata e shkallës se parë ka rezultuar se ngastra Nr.... dhe ..., janë eksproprijuar në favor të BVI-së në Podujevë, me aktvendimin Nr...., të datës ...., i marrë nga Kuvendi Komunal në Podujevë, ndërsa nga vërtetimi i datës ..., ishte siguruar shuma prej 4,000.000,00 dinarë për ekspropriimin e këtyre parcelave. Fakti se paraardhësi i paditësve është kompensuar për pronën e eksproprijuar sipas të cekurave më lartë, vërtetohet edhe nga vet kërkesa e këtu paditësve, të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe

janë administruar si prova materiale nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë drejtim, nga kjo kërkesë konstatohet se ish pronarëve iu është bërë kompensimi i ngastrave ..., ..., ... dhe .... nga ana e Komunës së Podujevës, mirëpo sipas kërkesës atyre nuk iu është bërë kompensimi adekuat dhe për këtë janë të dëmtuar. Nga të gjeturat e këtyre ekspertizave, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se pretendimet e paraqitura në padi, por edhe të përsëritura në ankesë nga pala paditëse se paraardhësi i tyre R.V nuk është kompensuar për pronën e ekspropriuar nuk qëndrojnë, përkatësisht janë vlerësuar plotësisht të pabaza.

20. Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar pretendimin ankimor të palës paditëse që ka të bëjë me mos shfrytëzimin e ngastrës kontestuese në përputhje me qëllimin e ekspropriimit. Kjo përveç faktit se organi ekspropriues e ka filluar ndërtimin e objektit të shtëpisë së kulturës, por edhe për faktin se pala paditëse ka pasur të drejtë ligjore në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ekspropriimin të KSAK të kërkojë kthimin e të drejtës së pronësisë mbi ngastrën kontestuese për shkak të mos shfrytëzimit të ngastrës në përputhje me qëllimin e ekspropriimit, duke i kthyer të paditurës edhe vlerën monetare të marr në emër të kompensimit. Mirëpo, referuar shkresave të lëndës rezulton se paraardhësi i paditësve nuk ka parashtruar kërkesë për deekspropriim, ndërsa këtu paditësit kanë paraqitur kërkesë tek Drejtoria për Çështje Pronësore Juridike e Komunës së Prishtinës tek më datë ..., që do të thotë pas rreth 21 vitesh pas nxjerrjes së vendimit mbi ekspropriim (vendimi është nxjerr më datë ...). Ndërsa nëse i referohemi dispozitës së nenit 21 alinea 5 të Ligjit mbi Ekspropriimin rezulton se pasi që të kalojnë 10 vite nga dita kur vendimi mbi ekspropriimin të merr formë të prerë, nuk mund të paraqitet kërkesë për anulimin e këtij vendimi (kurse procedura për deekspropriim zhvillohet në procedurë administrative e jo gjyqësore). Nga kjo rrjedhë se nëse paraardhësi i paditësit po të kishte ndonjë vërejtje apo pakënaqësi për procedurën e ekspropriimit të ngastrave kontestuese Nr. ... dhe Nr...., atëherë i njëjti i ka pasur të gjitha mundësitë ligjore që brenda afateve të përcaktuara me ligji, të kërkojë deekspropriimin e këtyre ngastrave, mirëpo një gjë të tillë nuk e ka bërë.

21. Sipas Gjykatës së Apelit, e drejta e palës për të kërkuar kompensimin e pronës së eksproprijuar nuk parashkruhet, mirëpo në rastin konkret paditësit kanë kërkuar vërtetimin e së drejtës së pronësisë dhe për këtë çështje gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatim të drejtë të së drejtës materiale. Si rrjedhojë, edhe referimi i gjykatës së shkallës së parë në dispozitat e Ligjit mbi Eksproprijimin dhe Ligjit të Punës së Bashkuar është i drejtë dhe i ligjshëm, andaj, për arsyet e cekura më lart, kjo nuk ka ndikuar që Gjykata e Apelit të merr ndonjë vendim ndryshe në këtë çështje.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura nga përfaqësuesi i paditësve dhe ka dhënë arsye të qarta në lidhje me çështjet e ngritura që kanë të bëjnë me shkeljen esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe me zbatimin e gabuar të dispozitave materiale. Gjykata e shkallës së dytë me arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar me revizion ka përmbushur kërkesat ligjore nga neni 204 të LPK-së, si në pikëpamje të kufijve të shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe në aspektin e dhënies së arsyeve për të gjitha çështjet e ngritura në ankesë.

2. I autorizuari i paditësve në revizionin e paraqitur pretendon se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), lidhur me nenin 160 paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së. Kjo gjykatë ka vlerësuar të pathemelta pretendimet e tilla, kjo pasi që dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë është i qartë, janë dhënë arsye të qarta për faktet vendimtare për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve. Gjykata Supreme vlerëson se aktgjykimet e atakuara me revizion janë mjaft të qarta, të rregullta në strukturë dhe përmbajtje. Gjykata e shkallës së dytë ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në

përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë.

3. Nga faktet e paraqitura rezulton se paraardhësi i paditësve R.V. ka qenë pronar i ngastrave kadastrale Nr. ... dhe ..., e po ashtu të njëjtit sipas aktvendimit të Seksionit Pronësoro Juridik KK. Podujevë me Nr.... të datës ...., i janë eksproprijuar ngastrat kadastrale Nr. ... në vendin e quajtur "Q...– rruga ....", me kulturë shtëpi, në sipërfaqe prej 00.00.45 ha, me kulturë arë në sipërfaqe prej 00.05.00 ha, me kulturë arë në sipërfaqe prej 00.00.58 ha, dhe ngastrën kadastrale Nr...., në vendin e quajtur "...", me kulturë arë në sipërfaqe prej 00.05.60, tani të evidentuara emër të Komunës së Podujevës si pronë shoqërore, sipas Fletës Poseduese Nr. ..., e më vonë sipas certifikatës së pronësisë F-..., ZKK Podujevë, datë ..., fakt ky i cili nuk ishte kontestues mes palëve ndërgjyqëse. Paditësit pretendojnë se për ngastrat kadastrale të eksproprijuara nuk kanë marrë kompensimin, si dhe kanë kërkuar deeksproprijimin e tyre pasi që e paditura të njëjtat nuk i ka shfrytëzuar dhe përdorur për qëllimin e eksproprijimit.

4. Kjo gjykatë çështjen e paditësve e ka trajtuar edhe në frymën e praktikës gjyqësore që i referohet rasteve të tilla, mirëpo duhet pasur parasysh se secili rast ka specifikat e tij dhe në këtë aspekt është trajtuar edhe kërkesa e paditësve, duke i ndërlidhur faktet thelbësore të çështjes me dispozitat materiale, mbi bazën e të cilave është nxjerr me të drejtë përfundimi se paditësve nuk u takon e drejta e pronësisë në paluajtshmëritë kontestuese.

5. Kërkesa e paditësve ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë, andaj fokusi në këtë rast është në trajtimin e fakteve thelbësore që kanë të bëjnë me kërkesën për vërtetimin e pronësisë. Pra paditësit kanë kërkuar vërtetimin e pronësisë të parcelave, të cilat janë eksproprijuar me aktvendimin Nr.... të datës ..., të Seksionit Pronësoro Juridik KK. Podujevë, i ekzekutueshëm sipas konkluzionit Nr. ... të datës ..., por që pretendohet se nuk është bërë kompensimi i tyre. Këtu shtrohet çështja se cila është baza mbi të cilën kërkohet e drejta e pronësisë në këto paluajtshmëri. E para, baza e trashëgimisë e pretenduar, sipas kësaj

gjykate kjo nuk mund të shërbejë si bazë për fitimin e pronësisë në këtë rast, kjo pasi që paluajtshmëria nuk ka figuruar në emër të paraardhësit të paditësve në mënyrë që kjo të kaloj tek trashëgimtarët - paditësit, pastaj këta nuk janë në posedim për mu vlerësuar çështja e kalimit të posedimit nga paraardhësi tek pasardhësit dhe fakti më i rëndësishëm është që kjo paluajtshmëri është eksproprijuar me vendim administrativ dhe mbi bazën së këtij vendimi ka kaluar në emër të padituresë.

6. Mos kompensimi i pretenduar nga paditësit nuk paraqet bazë për fitim të pronësisë, ngase këtu bëhet fjalë për proces të eksproprijimit që ka kaluar nëpër faza të tij, ndërsa paditësit kanë pasur mundësi që këtë ta kontestojnë në cilëndo fazë, duke përfshirë edhe çështjen e kompensimit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka asnjë provë që paraardhësi i paditësve apo paditësit ta kenë kontestuar procesin e shpronësimit në ndonjë formë dhe brenda afateve prej 3 dhe 10 viteve, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin mbi Eksproprijimin të vitit 1978. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit pas 20 viteve, nga vendimi i eksproprijimit të vitit 1980, përkatësisht në vitin 2021 kanë paraqitur te e paditura kërkesë për deeksproprijim, mirëpo kjo kërkesë është refuzuar, me vlerësim se kërkesa është bërë përtej afatit ligjorë të paraparë me ligjin për eksproprijimin (Gazeta zyrtare e Kosovës Nr.27/78) dhe gjithashtu paditësit në atë kohë u është bërë kompensimi për paluajtshmërinë e eksproprijuar. Në kuadër të kësaj kërkese paditësit kanë vlerësuar se nuk u është bërë kompensimi adekuat (që rezulton se ka pasë kompensim por që jo i duhur sipas paditësve), mirëpo pavarësisht kësaj në të gjitha fazat e procesit kontestimore kanë mohuar që ata janë kompensuar për paluajtshmëritë e shpronësuara. Pavarësisht kësaj, Gjykata Supreme pretendimin e tillë për mos kompensim e ka vlerësuar si pa ndikim në vendosje në lidhje me çështjen e ngritur që ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë, kjo pasi që paditësit nuk kanë pasur kërkesë për kompensim të paluajtshmërisë së shpronësuar, ndërsa gjykatat kanë kufizim ligjor që të mos dalin jashtë kufijve të kërkesave të palëve.

7. E dyta, baza e parashkrimit, sipas kësaj gjykate nuk mund të vlejë në këtë rast, kjo pasi që paraardhësit të paditësve dhe paditësve u është marrë pronësia në këto ngastra sipas një procesi ligjorë të ekspropriimit që ka ndodh në vitin 1980, përkatësisht paditësit e kanë humbur të drejtën në paluajtshmërinë kontestuese, ndërsa e paditura sipas nenit 20 të LMTHJP ka fituar të drejtën e pronësisë në këtë paluajtshmëri sipas bazës ligjore, përkatësisht vendimit të organit shtetërorë, në këtë rast vendimit për shpronësim. Në rrethana të tilla kjo gjykatë vlerëson se paditësit nuk mund ta fitojë të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese sipas bazës së parashkrimit fitues nga neni 28 i LMTHPJ, kjo pasi që paluajtshmëria ka kaluar në emër të padiurës sipas bazës së ligjshme-ekspropriimit, paraardhësi dhe paditësit nuk kanë qenë më në posedim të kësaj paluajthsmërie, ndërsa çështja e realizimit të qëllimit për të cilën është bërë shpronësimi dhe ajo e kompensimit janë çështje që ndërlidhen me procesin e deeksproprijimit dhe kërkesës së veçantë për kompensim, por jo në asnjë rrethanë në ndërtimin e ndonjë bazë të vlefshme për vërtetim të drejtës së pronësisë, siç është pretenduar nga paditësit në këtë rast.

8. Në rrethana të tilla kjo gjykatë vlerëson të pranueshme vendimet e gjykatave të instancës më të ulët për refuzim të kërkesëpadisë së paditësve, pasi që paditësit me asnjë provë nuk kanë arritur të vërtetojnë plotësimin e ndonjë kushti për të fituar pronësinë sipas ndonjë bazë të vlefshme ligjore. Parashkrimi fitues nuk ka mundur të përdoret në këtë rast si bazë për fitim të pronësisë, kjo pasi që e paditura ka marrë paluajtshmërinë e paditësve sipas vendimit të shpronësimit që ka marrë formë të prerë, paditësit nuk kanë bashkangjitur prova që kanë atakuar atë në ndonjë formë, pastaj paditësit vetëm pretendojnë se nuk u është bërë kompensuar por që nuk është paraqitë kërkesë për kompensim dhe nuk e argumentojnë të kundërtën. Mbi bazën procesit të shpronësimit konsiderohet se e paditura me bazë ligjore është regjistruar pronare e paluajtshmërisë kontestuese, andaj në praninë e fakteve të tilla përjashtohet çdo bazë që paditësit ta fitojnë pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese.

9. Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

10. Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.591/2024, datë 26.06.2025

"Nuk mundet me qenë kriter për vlerësim të ligjshmërisë së një vendimi për shkarkim të bordit, fakti i mos dhënies së këshillës për ushtrim të mjetit juridik, kjo pasi që kundër vendimit për shkarkim nuk ka pasur mjet juridik ngase nuk ka pasur organ më të lartë për shqyrtimin e ankesave eventuale të paditësve. Megjithatë, edhe pse vendimi nuk ka pasur udhëzim juridik, paditësve në asnjë rrethanë nuk u është mohuar qasja në drejtësi, kjo pasi që të njëjtit kanë paraqitë padi në gjykatë dhe gjykatat padinë e tyre e kanë vlerësuar si të afatshme, por që vendosja në raport me kërkesëpadinë mund të jetë e ndryshme nga gjykatat e instancave të ndryshme, siç ka ndodhë në këtë rast, që Gjykata Supreme mbi bazën e vlerësimit të fakteve të çështjes dhe dispozitave materiale të nxjerr përfundim krejt tjetër nga gjykatat e instancës më të ulët.

Në këtë rast është konsideruar se ndërprerja e marrëdhënies së punës paditësve është bërë në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, i cili ka rregulluar në mënyrë specifike çështjen e emërimit dhe shkarkimit të bordit të drejtorëve, duke përcaktuar kompetencat e Komisionit të Aksionarëve të padituris në këtë rast dhe duke mundësuar shkarkimin e tyre, pa nevojën e arsyetimit të theksuar. Për Gjykatën Supreme vendimtare është funksionimi i ndërmarrjes dhe në kuadër të gjitha dispozitave ligjore të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike, rezulton se kompetencat që i janë dhënë Shoqërisë Aksionare qartë ekziston mundësia e shkarkimit të bordit në çdo kohë kur cenohet interesi i ndërmarrjes, përkatësisht kur funksionimi i saj vihet në pyetje në raport me qëllimin e ekzistimit dhe shërbimeve që ofron"

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.Nr.1047/20 të datës 07.06.2021, në pikën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.Q, nga Ferizaji, A1.Q. nga fshati ..., Komuna e Ferizajit, M.C, nga Fshati ..., Komuna e Ferizajit, N.M, nga Fshati ..., Komuna e Ferizajit, e parashtruar kundër të padituris

Komuna e Ferizajit, dhe është anuluar vendimi i datës ..., numër .../..., dhe me numër të protokolit ..., i lëshuar nga Komisioni Komunal i Aksionarëve i NPL "S..." Sh.a., Ferizaj dhe është detyruar e paditura Komuna e Ferizajit që paditësve A.Q., nga Ferizaji, A1.Q. nga fshati ..., Komuna e Ferizajit, M.C., nga Fshati ..., Komuna e Ferizajit, N.M, nga Fshati ..., Komuna e Ferizajit, në emër të të ardhurave personale të parealizuara për periudhën kohore 01.03.2014 deri më datën 30.06.2016, t'ua paguaj shumat siç vijon: paditësit A.Q., shumën prej 13,344.89 euro, paditësit M.C., shumën prej 11,828.51 euro, paditësit N.M., shumën prej 12,519.97 euro, paditësit A1.Q., shumën prej 12,519.97 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në pikën II të dispozitivit është detyruar e paditura Komuna e Ferizajit që paditësve A.Q., A1.Q., M.C., N.M., në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ua paguaj shumat siç vijon: për hartimin e padisë 104 euro, për 12 seanca të mbajtura 3244.80 euro, për ekspertizën financiare shumën prej 200 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në pikën III të dispozitivit janë detyruar paditësit A.Q., A1.Q., M.C., N.M., që kësaj gjykate në emër të taksës gjyqësore t'ia paguajnë shumën e të hollave prej 150 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, dhe në pikën IV të dispozitivit është refuzuar si e pa bazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditësve A.Q., A1.Q., M.C., N.M., me të cilën kanë kërkuar që ndaj të padituresë NPL S... në Ferizaj, të anulohet vendimi i datës ..., numër .../... dhe me numër të protokolit ..., i lëshuar nga Komisioni Komunal i Aksionarëve i NPL "S..." Sh.a., Ferizaj, të detyrohet e paditura NPL S... në Ferizaj që paditësve A.Q, nga Ferizaji, A1.Q. nga fshati ..., Komuna e Ferizajit, M.C, nga Fshati ..., Komuna e Ferizajit, N.M, nga Fshati ..., Komuna e Ferizajit, në emër të të ardhurave personale të parealizuara për periudhën kohore 01.03.2014 deri më datën 30.06.2016, tua paguaj shumat siç vijon: paditësit A.Q., shumën prej 13,344.89 euro, paditësit M.C., shumën prej 11,828.51 euro, paditësit N.M., shumën prej 12,519.97 euro, paditësit A1.Q., shumën prej 12519.97 euro.

2. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të padituresë së parë, me aktgjykimin Ac.Nr.7817/2021 të

datës 19.07.2024, ka vendosur që të refuzojë pjesërisht të pa themeltë ankesën e të paditurës Komuna e Ferizajt, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.1047/20 të datës 07.06.2021, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit e ka vërtetuar. Në pikën II të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht ankesën e të paditurës Komuna e Ferizajt, dhe ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.1047/20 të datës 07.06.2021, në pikën II, të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës dhe ka gjykuar si në vijim: obligohet e paditura Komuna e Ferizajt që paditësve A.Q, nga Ferizaji, A1.Q. nga fshati ..., Komuna e Ferizajit, M.C, nga Fshati ..., Komuna e Ferizajit, N.M, nga Fshati ..., Komuna e Ferizajit, t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1281.60 euro, brenda afatit prej 7 ditëve nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për shpenzimet e procedurës, përtej shumës së gjykuar, refuzohet si e pabazuar. Në pikën III të dispozitivit ka vendosur që të mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën III dhe IV, në pjesën ku paditësit janë obliguar që ta paguajnë taksën gjyqësore dhe në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë revizion ka paraqitur i autorizuari i paditësve, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin e paditësve, dhe atë lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, ashtu që të ndryshoj aktgjykimin e shkallës së dytë dhe të vërtetoj aktgjykimin e shkallës së parë.

4. Të paditurat nuk kanë paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditësve.

5. Revizion ka ushtruar edhe i autorizuari i të paditurës së parë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranoj revizionin e të paditurës, ashtu që të prishë aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, ose të njëjtat

aktgjykime të ndryshohen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

6. Pala paditëse nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të padituresë së parë.

7. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215, gjeti se:

8. Revizioni i të autorizuarit të padituresë është i themeltë.

9. Revizioni i të autorizuarit të paditësve është i palejuar.

10. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre më datë 17.03.2014 kanë paraqitur padi, kundër të padituarve, ndërsa në seancën e datës 24.05.2021, kanë precizuar padinë kundër të padituresë Komuna e Ferizajit, duke kërkuar anulimin e vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe kompensimin e të ardhurave, me arsye si në padi.

11. Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin, C.Nr.186/14 të datës 07.09.2017, kishte refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Ndërsa Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin, Ac.Nr.4837/17 të datës 05.06.2020, kishte aprovuar ankesën e palës paditëse të paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, si dhe kishte prishur lëndën duke e kthyer të njëjtën në rivendosje.

12. Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.Nr.1047/20 të datës 07.06.2021, me të cilin ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, elaboruar në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi.

13. Gjykata e shkallës parë në arsyetim të aktgjykimit mes tjerash ka theksuar se, me vendimin e datës ..., është vërtetuar se Komisioni Komunal i Aksionarve i Ndërmarrjes Publike "S...", nga Komuna e Ferizajit, i përbërë nga B.B., H.S., N.B., kishte miratuar vendimin për zgjedhjen e katër anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "S...'' dhe me të njëjtin vendim si anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "S..." ishin zgjedhur A.Q., A1.Q., M.C., N.M. Sipas vendimit Nr..../..., të datës ..., me numër të protokollit ..., si dhe me dëgjimin e dëshmitarëve A.S., dhe Xh.S., gjykata ka vërtetuar faktin se më datë ..., Komisioni Komunal i Aksionarëve i NPL "S..." Sh.a., Ferizaj, në përbërje prej A.S., Xh.S., G.Y., kishte shkarkuar Bordin e Drejtorëve të NPL "S..." Sh.a., Ferizaj, i cili ishte i përbërë prej paditësve dhe në pikën II dy të vendimit në fjalë ishte paraparë se shkarkimi bëhet nga momenti i nënshkrimit të vendimit nga Komisioni Komunal i Aksionarve. Ndërsa me vendimin Nr..../..., të datës ..., gjykata ka vërtetuar se paditësit kundër vendimit të sipër përmendur mbi shkarkimin e tyre kishin parashtruar ankesë te kryetari i Komunës së Ferizajit M.S., kurse i njëjti me të njëjtin vendim kishte konstatuar se: ankesa e bërë nga A.Q., A1.Q., M.C., N.M drejtuar kryetarit të Komunës është drejtuar gabimisht, sepse kryetari i komunës nuk është organ kompetent për të vendosur për këtë çështje juridike. Me dëgjimin e dëshmitarit A.S., gjykata ka vërtetuar faktin se Komisioni Komunal i Aksionarve nuk i ka ftuar paditësit për të marrë pjesë me rastin e shkarkimit të tyre as me shkrim as me gojë. Nuk është bërë njoftim me shkrim për faktin se ka me u mbajtur mbledhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve, për shkarkimin e paditësve. Më datë 21.02.2014 Komisioni Komunal i Aksionarëve nuk ka mbajtur mbledhje.

14. Tutje gjykata e shkallës së parë ka shtuar se bazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësve e ka mbështetur në nenin 1 paragrafi 1.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Ligji Nr. 03/L-087, në fuqi nga data 01.07.2008, është paraparë mundësia e zbatimit të Ligjit për Shoqëritë Tregtare Ligji Nr. 02/L-123 në fuqi nga data 16.10.2008. Me nenin 174.1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Ligji Nr. 02/L-123 në fuqi nga data 16.10.2008, është paraparë se një ose më shumë drejtorë të

shoqërisë mund të shkarkohen në mbledhjen e aksionarëve, me ose pa arsye të theksuar, me shumicë votash të aksioneve të papaguara të cilat kanë pasur të drejtë të votojnë për zgjedhjen e drejtorëve, përveç se: a) asnjë drejtor nuk mund të shkarkohet në mbledhjen e aksionarëve përveç nëse në njoftimin për mbajtjen e mbledhjes theksohet se njëri ndër qëllimet e kësaj mbledhjeje është edhe votimi për shkarkimin e këtij drejtori. Nga deklarata e dëshmitarit A.S., gjykata ka vërtetuar se nuk është bërë njoftim me shkrim për faktin se ka me u mbajtur mbledhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve për shkarkimin e paditësve. Pra më datë 21.02.2014 Komisioni Komunal i Aksionarëve nuk ka mbajtur mbledhje, e nga kjo rezulton se e paditura Komuna e Ferizajit, me rastin shkarkimit të paditësit ka cenuar dispozitat e nenit 174 paragrafi 1 dhe pika a e Ligjit për Shoqëritë Tregtare Ligji Nr. 02/L-123, në fuqi nga data 16.10.2008, sepse në lidhje me shkarkimin e paditësve nuk është bërë njoftim me shkrim për faktin se ka me u mbajtur mbledhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve, për shkarkimin e paditësve dhe Komisioni Komunal i Aksionarëve nuk ka mbajtur mbledhje në lidhje me shkarkimin e paditësve në datën e shkarkimit të tyre 21.02.2014. Kurse çështja se në çfarë mënyre duhet të bëhet njoftimi i sipër përmendur është përcaktuar me nenin 193 të Ligjit për Shoqërit Tregtare Ligji Nr. 02/L-123 në fuqi nga data 16.10.2008. Përveç kësaj e paditura nuk i ka ftuar të marrin fare pjesë paditësit me rastin e shkarkimit të tyre më datë 21.02.2014, me qëllim që tu jepet mundësia të deklarohen me shkrim rreth shkarkimit të tyre, dhe se me këtë veprim e paditura ka cenuar nenin 31 paragrafi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës me të cilin është paraparë se Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. Pra meqenëse vendimi i të padituës Komuna e Ferizaji i datës 21.02.2014, numër .../... dhe me numër të protokollit ..., është marrë me shkelje të nenit 174 paragrafi 1 dhe pika a e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Ligji Nr. 02/L-123 në fuqi nga data 16.10.2008, dhe nenit 31 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës gjykata të njëjtin e ka anuluar.

15. Gjykata e shkallës së parë po ashtu ka theksuar se duke marrë parasysh faktin se e paditura me vendimin e sipër përmendur të kundërligjshëm u ka shkaktuar dëm paditësve në formë të pamundësisë së realizimit të ardhurave personale, të cilat paditësit do ti realizonin sikur e paditura Komuna e Ferizajt mos ti shkarkonte, andaj edhe e ka detyruar të padiurën që paditësve tua paguaj shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Lartësinë e dëmit të cilin e paditura Komuna e Ferizajt ua ka shkaktuar paditësve gjykata e ka vërtetuar nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit financiar A.K. Ndërsa baza ligjore për realizimin e të ardhurave personale nga paditësit qëndron në nenin 173 paragrafi 1 dhe 3 të LMD-së së Kosovës, me të cilat dispozita është përcaktuar se: "I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur". Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsideratë fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmerr veprimin. Gjykata ka analizuar edhe nenin 174.2 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, LIGJI Nr. 02/L-123 në fuqi nga data 16.10.2008, me të cilën është përcaktuar se: "Shkarkimi i një drejtori, vetvetiu nuk e paragjykon ndonjë të drejtë për kompensim apo kompensimin e dëmit pas shkarkimit, të cilën drejtori mund ta ketë në bazë të kontratës së tij me shoqërinë apo sipas ligjin për punën. Sidoqoftë, zgjedhja ose pozita e një personi si drejtor, vetvetiu, nuk krijon të drejta të këtilla. Mirëpo kjo dispozitë nga vetë përmbajtja e saj nuk përjashton mundësinë e realizimit të të ardhurave personale sipas LMD-së së Kosovës, neni 173 paragrafi 1 dhe 3 dhe e njëjta tani nuk mund të aplikohet ndaj paditësve, sepse me vet faktin se është anuluar vendimi Nr.86/14, i datës 21.02.2014, me numër të protokollit 45, paditësit nuk konsiderohen persona të shkarkuar, sepse vendimet e anuluara nga gjykata nuk krijojnë efekte juridike. Por paditësit konsiderohen persona që në mënyrë të kundërligjshme e paditura ua ka pamundësuar realizimin e të ardhurave personale të sipër përmendura.

16. Në fund gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve kundër të padiurës NPL S... në Ferizaj, kjo

sepse ka vlerësuar se të njëjtës i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë në procedurë, sepse vendimin Nr..../..., të datës 21.02.2014, me numër të protokollit ..., nuk e ka marr Ndërmarrja Publike ‘’S...’’, por Komisioni Komunal i Aksionarëve, i cili është Komision i Komunës së Ferizajt si aksionare e ndërmarrjes së sipërpërmendur, andaj dhe e paditura Ndërmarrja Publike ‘’S...’’ nuk ka kompetencë ta anuloj vendimin e sipër përmendur, e rrjedhimisht nuk obligohet në kompensimin e dëmit që ka mundur të jetë rezultat i vendimit të sipër përmendur. Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së.

17. Gjykata e Apelit ka refuzuar pjesërisht të pathemeltë ankesën e të paditurës së parë, me vlerësim se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në pjesën e vërtetuar është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë. Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të paqëndrueshme edhe pretendimet tjera lidhur me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenin 183.1 pika n) e LPK-së, kjo pasi që ka vlerësuar se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

18. Gjykata e Apelit ka bërë ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së parë në pjesën sa i përket shpenzimeve të procedurës sepse gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale, prandaj Gjykata e Apelit e ka vendosur si në pikën II, të dispozitivit, duke iu u referuar nenit 453 paragraf 1 të LPK-së, ku përcaktohet se me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për

ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat. Prandaj Gjykata e Apelit ka aprovuar pjesërisht shpenzimet e procedurës duke pasë parasysh shpenzimet e nevojshme apo të domosdoshme që kanë qenë në këtë çështje juridike kontestimore.

19. Pika III dhe IV, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën sa i përket pagesës së taksës gjyqësore për padi dhe në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë nuk është shqyrtuar, sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me këto pika të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale por, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale me aprovimin e pjesërishëm të kërkesëpadisë së paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë dhe të dytë.

2. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, rezulton se paditësit me vendimin e datës 01.07.2013, të Komisionit Komunal të Aksionarve të Ndërmarrjes Publike "S...", nga Komuna e Ferizajit, ishin zgjedhë anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "S...''. Ndërsa nga vendimi Nr..../..., i datës 21.02.2014, me numër të protokollit ..., gjykata ka vërtetuar se më datë 21.02.2014, Komisioni Komunal i Aksionarëve i NPL "S..." Sh.a., Ferizaj, në përbërje prej A.S., Xh.S., G.Y., kishte shkarkuar Bordin e Drejtorëve të NPL "S..." Sh.a., Ferizaj, i cili ishte i përbërë prej paditësve dhe në pikën II dy të vendimit në fjalë ishte paraparë se shkarkimi bëhet nga momenti i nënshkrimit të vendimit nga Komisioni Komunal i Aksionarve. Pastaj paditësit ndaj vendimit të lartcekur kishin paraqitë ankesë te Kryetari i Komunës së Ferizajt, i cili ka vlerësuar se nuk është oragn kompetent për të vendosur lidhur me këtë cështje.

3. Kjo gjykatë vlerëson se në këtë rast nuk mundet me qenë kriter për vlerësim të ligjshmërisë së vendimit numër .../..., të datës 21.02.2014, fakti i mos dhënies së këshillës për ushtrim të mjetit juridik, ashtu siç ka konstatuar Gjykata e Apelit, kjo pasi që kundër vendimit për shkarkim nuk ka pasur mjet juridik ngase nuk ka pasë organ më të lartë për shqyrtimin e ankesave eventuale të paditësve se Bordi i Drejtorëve, andaj me të drejtë paditësit nuk janë udhëzuar në paraqitje të mjetit juridik-ankesës kundër vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Megjithatë edhe pse vendimi nuk ka pasë udhëzim juridik, paditësve në asnjë rrethanë nuk u është mohuar çasja në drejtësi, kjo pasi që të njëjtit kanë paraqitë padi në gjykatë dhe gjykatat padinë e tyre e kanë vlerësuar si të afatshme, por që vendosja në raport me kërkesëpadinë mund të jetë e ndryshme nga gjykatat e instancave të ndryshme, siç ka ndodhë në këtë rast, që Gjykata Supreme mbi bazën e vlerësimit të fakteve të çështjes dhe dispozitave materiale të nxjerr përfundim krejt tjetër nga gjykatat e instancës më të ulët.

4. Kjo gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë vlerësuar dhe kanë nxjerr përfundimin për ligjshmërinë e vendimit të sipër theksuar duke bërë interpretim rreptësishtë formal të dispozitës nga neni 147, paragraf 1, pika a), kjo pasi që në këtë rast është shmangur ajo që është më e rëndësishme funksionimi i një mekanizmi siç ka qenë bordi dhe interesi i kësaj Ndërmarrje Publike që të funksionoj me një bord të tillë, ku para se të ndodhë shkarkimi është vlerësuar se ka pasur dështime dhe parregullsi, të cilat janë raportuar dhe evidentuar në procesverbalin e datës 19.02.2014. Pra gjykatat e instancës më të ulët në interpretimet e tyre kanë shmangur qëllimin e vërtetë dhe rëndësinë e bordit në raport me ndërmarrjen publike, funksionimin dhe zhvillimin e saj. Për Gjykatën Supreme vendimtare është funksionimi i ndërmarrjes dhe në kuadër të gjitha dispozitave ligjore të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike, rezulton se kompetencat që i janë dhënë Shoqërisë Aksionare qartë ekziston mundësia e shkarkimit të bordit në çdo kohë kur cenohet interesi i ndërmarrjes, përkatësisht kur funksionimi i saj vihet në pyetje në raport me qëllimin e ekzistimit dhe shërbimeve që ofron. Kjo qartë është përcaktuar në procesverbalin e datës 19.02.2014, ku janë

evidentuar dështimet e ndërmarrjes, konkretisht të bordit të cilin e kanë përbërë paditësit.

5. Kjo gjykatë vlerëson se vendimi mbi shkarkimin e paditësve nga pozita e bordit të drejtorëve është nxjerrë në përputhje me dispozitat ligjore të cekura më lartë, përkatësisht nenin 174 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, pasi që kjo dispozitë i jep kompetencë ekskluzive aksionarëve në emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve në një ndërmarrje publike, nga ka rezultuar se edhe vendimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve është i drejtë dhe i ligjshëm, për faktin se paditësit nuk kanë arritur që sipas kërkesës së Komisionit Komunal të Aksionarëve ti ofrojnë të gjitha raportet dhe faturat për investime të kërkuara, duke rezultuar në shkelje të ndryshme ligjore.

6. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, duke marr për bazë faktin se paditësve ndërprerja e marrëdhënies së punës nga e paditura nuk u është bërë me shkelje të dispozitave ligjore të sipërcituara, ka vendosur ta refuzoj edhe kërkesën e paditësve me të cilën kanë kërkuar që të, anulohet vendimi numër .../..., i datës 21.02.2014, dhe të obligohet e paditura në kompensimin e të ardhurave personale të parealizuara paditësve në shumën e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Pra është vlerësuar se e paditura pas konstatimit të shkeljeve të lartcekura të paditësve, respektivisht raportit të parregullsive të evidentuara në procesverbalin e datës 19.02.2014, paditësve me të drejtë edhe u është ndërprerë marrëdhënia e punës. Në këtë rast është konsideruar se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, i cili ka rregulluar në mënyrë specifike çështjen e emërimit dhe shkarkimit të bordit të drejtorëve, duke përcaktuar kompetencat e Komisionit të Aksionarëve të padituës në këtë rast dhe duke mundësuar shkarkimin e tyre, pa nevojën e arsyetimit të theksuar.

Lidhur me vendosjen si në pikën II të dispozitivit

7. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditësve ka paraqitur revizion, lidhur me shpenzimet e procedurës, me këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës fillimisht ka vlerësuar se a është i lejuar revizioni duke ju referuar nenit 211.2 të Ligjit për

Procedurën Kontestimore, me të cilën dispozitë është përcaktuar se: "Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë prestimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro". Në këtë rast paditësit me revizionin e paraqitur kanë kontestuar aktgjykimin e shkallës së dytë lidhur me vendosjen si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së dytë, me të cilin është ndryshuar aktgjykimi i shkallës së parë lidhur me shpenzimet e procedurës, respektivisht janë obliguar paditësit që ti paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1281.60 €. Andaj bazuar në dispozitën e lartcekur ligjore Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se revizioni nuk lejohet kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.Nr.7817/2021 të datës 19.07.2024, për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së revizionit e kushtëzuar me vlerën e kontestit e cila duhet të jetë mbi 3,000 € për të qenë i lejuar revizioni, dhe situatës kur revizioni lejohet pavarësisht vlerës së kontestit sipas kriterit përjashtues për natyrën e çështjes kontestuese.

8. Gjykata Supreme e Kosovës në raport me vendimin per shpenzime të procedurës ka vendosur bazuar në nenin 452 të LPK-së , kjo pasi që paditësit kanë humbur kontestin, ndërsa pala e paditur nuk ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

9. Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kjo pasi që pala e paditur nuk e ka atakuar aktgjykimin e shkallës së dytë me të cilin ka mbetur e pashqyrtuar pika III dhe IV e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, në të cilën është vendosur lidhur me refuzimin e pjesës së kërkesëpadisë së paditësve, andaj në këtë pikë nuk ka mundur të trajtohet as aktgjykimi i shkallës së dytë e as ai i shkallës së parë, në mungesë të ushtrimit të mjeteve juridike nga pala e paditur, si palë me interes juridik në këtë rast.
10. Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 224.1 dhe 221 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës
ARJ.Nr.198/2024, datë 11.06.2025

"Gjykata Supreme, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje procedurale dhe materiale kur e ka administruar si provë ekspertizën financiare, pa e paraprirë atë me një ekspertizë profesionale nga fusha e prokurimit publik. Ekspertiza në këtë fushë është e domosdoshme për të sqaruar dhe vërtetuar bazën faktike dhe ligjore mbi të cilën mund të ndërtohet vlerësimi i mëtejmë financiar. Vetëm pasi të jetë administruar dhe verifikuar një ekspertizë profesionale në prokurim publik, dhe nëse nga ajo rezulton se kanë ndodhur shkelje të dispozitave ligjore që rregullojnë procedurat e prokurimit publik, atëherë krijohen kushtet juridike dhe faktike për të shqyrtuar mundësinë e caktimit të një ekspertize financiare.

Gjykata thekson se administrimi i provave duhet të zhvillohet në mënyrë objektive, të plotë dhe të paanshme, në përputhje me parimet e drejtësisë procedurale. Mbështetja ekskluzive në një ekspertizë të njëanshme të propozuar nga pala e paditur cenon standardet e procesit të drejtë gjyqësor dhe parimin e barazisë së palëve. Këto standarde burojnë nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilat garantojnë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke imponuar mbi gjykatat obligimin që administrimi dhe vlerësimi i provave të bëhet në mënyrë të barabartë dhe të drejtë për të dyja palët në procedurë".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e shkallës së parë, KA.Nr.38/22, të datës 25.09.2023, është vendosur: "1. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit "U." Shpk, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi PSH.Nr.336/14, i datës 03.10.2014, i nxjerr nga i padituri i dytë Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Kontrata e datës 22.08.2014 për aktivitetin e prokurimit me Nr. 214-14-148-111, si dhe që të obligohen të padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës që paditësit "U."

Sh.p.k., në mënyrë solidare ti kompensojnë dëmin material në formën e fitimit të humbur në vlerë 851,190.08€ dhe në formën e dëmit real në vlerën prej 29,500.00€. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedural".

2. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.Nr. 455/2024, i datës 24.05.2024, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit "U." Shpk, me seli në Komunën e Pejës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.Nr.14/2022, i datës 19.12.2023, është vërtetuar.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

4. Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala e paditur.

5. Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se: kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e bazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kontestuar të Panelit Shqyrtues të Prokurimit Publik, PSH.Nr.336/14, i datës 03.10.2024, është vendosur: "I. Refuzohet, ankesa e operatorit ekonomik, "U." me seli në Pejë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Uniformë

të re, për PK-në", PK 214/14/148/111, të iniciuar nga autoriteti kontraktues Policia e Kosovës, si e pa bazuar. II. Mbetet në fuqi vendimi i autoritetit kontraktues (AK), Policia e Kosovës për dhënien e kontratës, lidhur me procedurën e prokurimit me titull "Furnizim me Uniform të re për PK-në", PK 214/14/148/111, si i bazuar dhe njëherit i lejohet autoritetit kontraktues që të vazhdojë më tutje me këtë aktivitet të prokurimit. III. Mos respektimi i këtij vendimi detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 25.8 dhe nenit 130 të LPP-së Nr.04/L-042, të ndërmarr masa ndaj autoritetit kontraktues, të cilat janë të parashikuara në nenet e lartpërmendura të LPP-së. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh obligohet ta informoj me shkrim Panelin shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarrura lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. IV. Operatorit ekonomik ankues "U." me seli në Pejë, konform nenit 118.3 të LPP-ës i konfiskohet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë prej 500.00€ (pesëqind euro)".

7. Kundër vendimit të lartë cekur të padituröes, paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

8. Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Ndërsa në aktgjykimin e saj ka theksuar se gjatë vlerësimit të pretendimeve të paditësit lidhur me kriteret për dhënien e kontratës të aplikuara nga autoriteti kontraktues, iu referua nenit 52 par. 1 të LPP-së, i cili përcakton se: *"1. Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret mund të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm",* dhe par. 3 dhe 4 të cilët në mënyrë shprehimore përcaktojnë kriteret dhe atë se: *"3. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla mund të jenë në lidhje me p.sh., cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike. 4.*

Autoriteti kontraktues duhet të sigurojë që të bëje një dallim të qartë në mes kritereve të paragrafit 3. të këtij neni dhe kritereve të përzgjedhjes në lidhje me aftësitë e përgjithshme profesionale, financiare dhe teknike të themeluara në bazë të nenit 51 të këtij ligji dhe se nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive të kritereve".

9. Gjykata e shkallës së parë vlerësoi pretendimet e paditësit lidhur me çmimin më të ulët të ofertuar konform nenit 60 të LPP-së ku përcaktohet se: *"1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 te këtij ligji".*

10. Gjykata e shkallës së parë vlerëson se nga dosja e tenderit dhe raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit është vërtetuar se: Autoriteti Kontraktues me rastin e përzgjedhjes së Operatorit Ekonomik fitues ka zbatuar drejtë kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara me LPP, ashtu që ka shpallur fitues Operator Ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët, pasi që Operatorët Ekonomik tjerë të cilët kanë ofertuar me çmime më të ulëta, nuk kanë qenë të përgjegjshëm.

11. Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar ka konstatuar se i padituri i dytë, ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore formale dhe materiale, si dhe drejtë ka konstatuar gjendjen faktike me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit dhe lejimit të aktivitetit të prokurimit "Furnizim me uniforme të re në Policinë e Kosovës".

12. Gjykata e shkallës së parë, në kuptim të nenit 46 par. 5 të LKA-së, vendosi të refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e dëmit material vlerën prej 29,500.00 € dhe fitimin e humbur në shumë prej 851,190.08€, për shkak se pas vlerësimit të ligjshmërisë së akteve kontestuese, gjeti se të njëjtat janë të drejta e të ligjshme dhe se i padituri i dytë me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen

faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

13. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, e drejta për kompensimin e dëmit lind kur krijohet baza për anulimin e vendimit të organit administrativ, ndërkaq në rastin konkret gjykata ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë arsye për anulimin e aktit kontestues, rrjedhimisht edhe kontratës së nënshkruar më pas, pasi që të njëjtat janë të drejta dhe të ligjshme, prandaj gjykata ka vlerësuar se nuk ekziston as baza ligjore për kompensimin e dëmit përderisa të padituri kanë vepruar në kuadër të dispozitave ligjore dhe kushteve të dosjes së tenderit kanë rekomanduar për kontratë grupin e Operatorëve Ekonomik "S.K & A.I & H." ndërsa paditësin e kanë eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për shkak të mos ofertimit në përputhje me kushtet e kërkuar në dosjen e tenderit e të cilat janë specifikuar në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 22.08.2014.

14. Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e shkallës së parë ka vendosur në kuptim të nenit 64 të LKA-së, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

15. Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditëse në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se është vërtetuar drejtë gjendja faktike me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

16. Kolegji vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit

194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

17. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 41 dhe 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë iu ka referuar dispozitave ligjore nga neni 59 par.1 dhe 4 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik.

18. Autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

19. Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata me vendimin e saj gabimisht ka refuzuar padinë dhe kërkesëpadinë, sepse gjykata nuk i ka analizuar pretendimet e paditësit të cilat janë shtjelluar së bashku me gjykatën, gjatë shqyrtimeve gjyqësore, prandaj gjykata është dashur ta aprovoj padinë dhe të anuloj aktet administrative duke i anuluar vendimet me aktgjykim, sipas kërkesës së paditësit me precizim të padisë së datës 14.12.2016 sepse vendimi i ankimuar me padi në gjykatë përmban shkelje ligjore të cilat janë elaboruar në ankesë. Këto pretendime ankimore kolegji nuk i aprovoi, ngase Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë i është referua nenit 27 par.1, si dhe nenit 28 par 1 dhe 2 si dhe paragrafi 8 të Ligjit për Prokurimin Publik 04/L-042. Po ashtu gjatë vlerësimit të pretendimeve lidhur me kriteret për dhënien e kontratës Dhoma e Shkallës së Parë iu referua nenit 52 par.1, 3 dhe 4, si dhe nenit 60 të LPP-së.

20. Dhoma e Shkallës Dytë i vlerësoi si të pa bazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat nuk kanë gjetur mbështetje në dispozitat ligjore materiale të cilat rregullojnë këtë çështje dhe nuk kanë qenë në përputhje me provat e administruara për të vendosur ndryshe në këtë çështje administrative, andaj ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm, mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund ti pranojë si të drejta pikëpamjet e lartpërmendura të gjykatave të instancave më të ultë, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të parashikuar nga neni 182 par.2 pika (n) dhe 183 par.1, lidhur me nenin 160 par.4, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ku përcaktohet se: *"182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë: n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit", dhe "183.1 Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare",* për të cilat edhe aktgjykimet e instancave më të ulëta duhet të anulohen dhe çështja të i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

2. Gjykata Supreme vlerëson se konstatimet dhe arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë, nuk janë të qëndrueshme dhe nuk gjejnë mbështetje

në provat e administruara në shkresat e lëndës. Në arsyetimin e saj, gjykata e shkallës së parë ka deklaruar se ka vlerësuar pretendimet e paditësit lidhur me (mos) përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, por ka përfunduar se kjo çështje nuk ndikon në vendimmarrje për shkak se përgjegjshmëria e këtij operatori nuk ka qenë objekt shqyrtimi i procedurës pranë OSHP-së. Gjykata ka shtuar se, edhe po të pranohej se operatori i rekomanduar nuk ka qenë i përgjegjshëm, kjo nuk do të ndikonte në vlerësimin e përgjegjshmërisë së paditësit.

3. Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar gjithashtu pretendimin e paditësit se OSHP nuk ka vepruar në përputhje me udhëzimet e dhëna me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, K.A.Nr.14/2022, të datës 19.12.2022, duke arsyetuar se aktgjykimi paraprak kishte anuluar vendimin kontestues dhe kishte kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje për shkak të paqartësive dhe mospajtimeve të brendshme në arsyetim, por nuk kishte dhënë udhëzime lidhur me përgjegjshmërinë e paditësit. Për më tepër, gjykata ka theksuar se, edhe pse i padituri ka konstatuar gabimisht se paditësi nuk i kishte përmbushur kriteret profesionale.

4. Gjykata Supreme, megjithatë, vlerëson se këto përfundime të gjykatës së shkallës së parë janë të pabazuara dhe përbëjnë konstatime të pasakta të gjendjes faktike. Pretendimet e paditësit lidhur me përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, si dhe për mospërputhjen e veprimeve të OSHP-së me udhëzimet e gjykatës, janë të rëndësishme dhe përbëjnë fakte vendimtare që ndikojnë drejtpërdrejt në vendimmarrjen për meritat e çështjes. Duke mos vlerësuar në mënyrë të plotë dhe objektive këto pretendime dhe duke mos angazhuar një ekspertizë profesionale, gjykata ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të nenit 356 të LPK-së, i cili, i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, përcakton se: *"Gjykata mund të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve*

apo rrethanave të caktuara kërkohet njohuri profesionale që nuk i zotëron gjyqtari i çështjes."

5. Mospërdorimi i këtij veprimi procedural për sqarimin e çështjes së përmbushjes së kritereve teknike, përbën mangësi serioze procedurale dhe cenon drejtësinë e vendimit. Për këto arsye, Gjykata Supreme vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i nxjerrë në kundërshtim me ligjin, është i ndërtuar mbi konstatime të pasakta faktike dhe për pasojë duhet të anulohet, ndërsa çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, me qëllim të vlerësimit të plotë të pretendimeve të palëve, administrimit të provave përkatëse përfshirë edhe ekspertizën profesionale, në përputhje me dispozitat e procedurës civile.

6. Gjykata Supreme, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimeve të nxjerra në shkallë të parë dhe të dytë, vlerëson se aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë është i pabazuar në ligj dhe duhet të anulohet, ndërsa çështja të kthehet në rigjykim në shkallën e parë, për arsyet si vijon: Gjykata e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar, ka refuzuar ankesën e palës paditëse dhe ka konfirmuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke pranuar në tërësi vlerësimin faktik dhe juridik të kësaj të fundit, si të drejtë dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), përkatësisht nenet 41 dhe 44, si dhe me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshme sipas nenit 63 të LKA-së, konkretisht neni 194 i LPK-së.

7. Në arsyetimin e saj, gjykata e shkallës së dytë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka refuzuar kërkesëpadinë, duke konstatuar se vendimi i OSHP-së është në përputhje me ligjin, përfshirë edhe dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, konkretisht nenin 59 paragrafët 1 dhe 4. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së dytë nuk ka ndërmarrë një vlerësim të pavarur dhe objektiv të pretendimeve të paditësit, por ka ripërsëritur gjetjet e shkallës së

parë pa dhënë një arsyetim të plotë, konkret dhe të individualizuar mbi secilin nga pretendimet e ngritura në ankesë.

8. Gjykata Supreme vlerëson se ky trajtim i çështjes është i papranueshëm nga pikëpamja procedurale dhe përbën shkelje të të drejtës së palës për një proces të rregullt gjyqësor, pasi që: Gjykata e shkallës së dytë nuk ka bërë analizë të pavarur juridike të çështjes dhe nuk ka dhënë arsyetim të veçantë dhe të mjaftueshëm për refuzimin e pretendimeve konkrete të palës paditëse; Nuk ka shqyrtuar në mënyrë të thelluar dhe objektive çështjen e përgjegjshmërisë së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, e cila ishte fakt vendimtar për vlerësimin e ligjshmërisë së veprimit të autoritetit kontraktues dhe vendimit të OSHP-së; Ka pranuar si të drejta konstatimet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me mungesën e përmbushjes së kritereve teknike nga paditësi, pa administruar prova të reja, pa përjashtuar mundësinë për verifikim përmes ekspertizës profesionale, ndonëse një gjë e tillë ishte thelbësore për sqarimin e plotë të gjendjes faktike; Nuk ka shqyrtuar në mënyrë të plotë zbatimin e nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, konkretisht mundësinë që devijimet në ofertë të jenë të papërfillshme apo të korrigjueshme pa ndryshuar thelbësisht përmbajtjen e saj - siç është e paraparë me paragrafët 1 dhe 4 të këtij neni - dhe rrjedhimisht ka anashkaluar një standard thelbësor të vlerësimit të tenderëve në procedurën e prokurimit publik.

9. Në këtë mënyrë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është nxjerrë në kundërshtim me nenin 194 paragrafi 2 të LPK-së, i cili i obligon gjykatat e shkallës së dytë që, në shqyrtimin e ankesës, të vlerësojnë në mënyrë të pavarur të gjitha faktet dhe provat, dhe nëse është e nevojshme, të ndërmarrin veprime të reja për sqarimin e çështjes. Gjithashtu, është cenuar neni 10 i LPK-së, që parasheh të drejtën e palëve që të kenë një trajtim të drejtë dhe të plotë të pretendimeve të tyre në procedurë. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet për vlerësim të drejtë të ligjshmërisë së vendimit administrativ kontestues dhe se, në këto rrethana, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë duhet të anulohet, ndërsa çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, me qëllim që të bëhet vlerësim

i plotë i pretendimeve të paditësit, të administrohen prova relevante dhe është e nevojshme, të përfshihet ekspertizë profesionale, në përputhje me nenin 356 të LPK-së, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-118.

10. Kolegji i Gjykatës Supreme, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në mënyrë të gabuar kur ka aprovuar propozimin e paditësit për administrimin e provës me ekspertizë financiare. Sipas qëndrimit të Kolegjit, prova me ekspertizë financiare do të mund të administrohej vetëm nëse gjykata do të kishte krijuar më parë bazën juridike për pranimin e saj, konkretisht nëse paraprakisht do të ishte administruar dhe vlerësuar prova me ekspertizë të prokurimit publik. Vetëm nëse përmes asaj ekspertize do të ishte vërtetuar gjendja faktike, ashtu siç pretendohej nga paditësi me padi, atëherë do të kishte bazë të ligjshme për administrimin e mëtejshëm të ekspertizës financiare. Në të kundërtën, nëse nga ekspertiza e prokurimit publik do të rezultonte se pretendimet e paditësit nuk qëndrojnë, atëherë aprovimi i provës me ekspertizë financiare do të ishte i panevojshëm, pasi nuk do të kontribuonte në zbardhjen e çështjes dhe do të sillte vetëm shpenzime të panevojshme dhe zvarritje të procedurës. Nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë rezulton se, pavarësisht administrimit të kësaj prove, padia e paditësit është refuzuar si e pabazuar.

11. Kolegji i Gjykatës Supreme, gjatë shqyrtimit të aktgjykimit të ankimuar, ka gjetur se nuk mund të pranohet si i rregullt juridikisht dhe proceduralisht qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë, lidhur me mënyrën e vendosjes, ashtu siç është formuluar në aktgjykimin e ankimuar. Kjo për faktin se ekziston një mospërputhje thelbësore ndërmjet dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit, gjë që përbën shkelje të rregullave procedurale. Për më tepër, duke u mbështetur edhe në shkeljet e tjera të theksuara më lart në këtë arsyetim, të cilat kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në vlerësimin e gabuar të provave dhe në aplikimin e pasaktë të së drejtës materiale dhe procedurale, aktgjykimet e të dy shkallëve vlerësohen si juridikisht dhe proceduralisht të paqëndrueshme.

12. Në rigjykim të çështjes, gjykata e shkallës së parë obligohet që t'i mënjanojë mangësitë procedurale të theksuara më lart në këtë aktgjykim dhe të kryejë një vlerësim të plotë e të gjithanshëm të rrethanave të çështjes, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Konkretisht, gjykata duhet të vlerësojë: Nëse vendimi administrativ i kontestuar është në kundërshtim me ligjin material; Nëse procedura administrative është zhvilluar në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi; Nëse vlerësimi i kushteve të tenderit në raport me ofertuesit ka qenë objektiv, ligjor dhe i drejtë; Dhe nëse pretendimet e paraqitura nga paditësi në padi qëndrojnë, në aspektin faktik dhe juridik.

13. Në përputhje me nenin 356 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ku në nenin 280 të ligjit bazik, paragrafi 4, togfjalëshi *"me propozimin e palës"* është fshirë nga teksti, gjykata ka autorizim të plotë që, sipas nevojës, të caktojë ekspertizë profesionale nga fusha e prokurimit publik, me qëllim të vërtetimit të bazës ligjore të kërkesëpadisë, duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

14. Caktimi i ekspertizës financiare mund të merret në konsideratë vetëm pas vërtetimit nga gjykata se ka ndodhur shkelje ose tejkalim i dispozitave ligjore që rregullojnë procedurën e prokurimit publik. Vetëm nëse vërtetohet se procedura administrative ka qenë e kundërligjshme dhe vendimi administrativ është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, mund të lindë nevoja për ekspertizë financiare, si mjet për të përcaktuar vlerën e dëmit të pretenduar. Ky vlerësim financiar është i rëndësishëm vetëm në funksion të kompensimit eventual të dëmit material, i cili duhet të rrjedhë drejtpërdrejt nga paligjshmëria e vendimit administrativ dhe nga pasojat juridike të saj, të konstatuara paraprakisht nga gjykata.

15. Kolegji i Gjykatës Supreme vlerëson se, në rrethanat konkrete të çështjes, administrimi i një prove me ekspertizë të pavarur nga fusha e

prokurimit publik ishte i domosdoshëm për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike dhe të bazës ligjore të kërkesëpadisë. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë, në vendimin e saj, ka mbështetur konkludimin përfundimtar në një provë të vetme të paraqitur nga pala e paditur - përkatësisht në ekspertizën e hartuar nga ekspertja shqyrtuese Sh.H, e cila është angazhuar dhe autorizuar nga vetë pala e paditur, me rastin e shqyrtimit të ankesës.

16. Një mënyrë e tillë e administrimit të provës është në kundërshtim me parimet themelore të procedurës civile, veçanërisht me parimin e paanshmërisë dhe objektivitetit në vlerësimin e provave, si dhe me nenin 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat garantojnë barazinë e palëve në proces dhe detyrimin e gjykatës për të zbuluar në mënyrë aktive dhe të gjithanshme të vërtetën materiale.

17. Mbështetja ekskluzive në një ekspertizë të njëanshme, të përpiluar dhe autorizuar nga njëra palë në procedurë, përbën shkelje të rëndë të standardeve të një procesi të drejtë gjyqësor, të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pranimi i një prove të tillë, pa asnjë ekspertizë të urdhëruar nga gjykata, e komprometon seriozisht barazinë procedurale të palëve dhe krijon dyshim të arsyeshëm mbi paanshmërinë e vendimit gjyqësor.

18. Për rrjedhojë, në rigjykim, gjykata e shkallës së parë obligohet që, në përputhje me nenin 356 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-118 (“Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore”), të caktojë një ekspertizë profesionale dhe të pavarur në fushën e prokurimit publik, me qëllim të vërtetimit të bazës ligjore të kërkesëpadisë. Vetëm pas administrimit të ekspertizës profesionale në fushën e prokurimit publik dhe nëse nga e njëjta vërtetohet se ka ndodhur shkelje e dispozitave ligjore që rregullojnë procedurat e prokurimit publik, mund të shqyrtohet mundësia për caktimin e një ekspertize financiare. Kjo e fundit do të ketë për qëllim vlerësimin e dëmit të pretenduar, që eventualisht ka rrjedhur si pasojë e

kundërligjshmërisë së procedurës administrative dhe të vetë vendimit administrativ të kontestuar.

19. Caktimi i ekspertizës financiare, rrjedhimisht, nuk mund të paraprijë verifikimin e bazës ligjore të kërkesëpadisë, por duhet të pasojë vetëm nëse gjykata, përmes provave të administruara, në radhë të parë përmes ekspertizës nga fusha e prokurimit publik, ka konstatuar shkelje materiale të dispozitave ligjore që e justifikojnë ekzistencën e të drejtës për kompensim.

20. Gjykata duhet të vlerësojë çdo provë që është marrë në harmoni me ligjin, përfshirë edhe ekspertizën e njëanshme të ofruar nga pala e paditur, mirëpo për t'ia falur besimin të njëjtës, është e pamundur pasi që kundërshtimet kryesore të padisë së paditësit kanë të bëjnë pikërisht me këtë ekspertize apo raport të ekspertit shqyrtues të paditurës, e në këtë rast gjykata duhet të caktojë një ekspertizë të pavarur për vlerësimin së pari të procedurës së zhvilluar pranë organit administrative, respektimi i dispozitave ligjore materiale dhe procedural nga vetë e paditura, të e pastaj dhe vlerësimi i demit financiar të shkaktuar, në përputhje me LPK, nëse përmbushen kushtet e procedurës nga kundërligjshmëria e vendimit të kontestuar.

21. Në fund, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që, me rastin e rishqyrtimit të çështjes dhe përpilimit të aktgjykimit, t'i përmbahet kërkesave të përcaktuara në nenin 160 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), përkatësisht paragrafëve 3, 4 dhe 5 të këtij neni, të cilat janë të zbatueshme në këtë kontest në bazë të nenit 63 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA).Gjykata duhet që, pas administrimit dhe analizës së plotë të ekspertizës profesionale nga fusha e prokurimit publik dhe, nëse është e nevojshme, edhe të ekspertizës financiare, të trajtojë në mënyrë të plotë dhe të strukturuar të gjitha pretendimet e paraqitura nga paditësi në kërkesëpadinë e tij, duke shmangur çdo formë të paragjykimit ose përvetësimit të qëndrimeve të njërës ndër palët në procedurë. Gjithashtu, gjykata obligohet të bëjë një vlerësim të arsyetuar dhe të detajuar të të gjitha provave materiale të shqyrtuara dhe të administruara gjatë procedurës

gjyqësore, në mënyrë që vendimi përfundimtar mbi kërkesëpadinë të jetë i mbështetur në ligj, në fakte të provuara dhe në arsyetim të brendshëm logjik, në përputhje me standardet e një procesi të rregullt dhe të drejtë gjyqësor.

22. Nga arsyet e paraqitura më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflikte Administrative, gjykata aprovoj të bazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë anulohen ndërsa çështja-lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës
ARJ.Nr.270/2024, datë 24.12.2024

"Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të çështjes, ka gjetur se aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë janë të përfshira me shkelje të së drejtës materiale. Operatori ekonomik ankues nuk i është përgjigjur kërkesës së autoritetit kontraktues për sqarime shtesë lidhur me referencat e kërkesës së dosjes së tenderit, dhe nuk ka ofruar dokumentacion të mjaftueshëm për referencat e kërkuara, dhe si rrjedhojë nuk ka përmbushur kërkesat ligjore për të dëshmuar kualifikimet e nevojshme në tender duke justifikuar kështu anulimin e pjesëmarrjes së tij në procedurë si operator ekonomik i papërgjegjshëm".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, KA.Nr.176/22 të datës 01.12.2023, është vendosur: I. Aprovohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit "B" Sh.p.k me seli në Vushtrri, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë. II. Anulohet vendimi PSH.Nr.113/19-123/19, të datës 20.05.2019, lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim. III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.Nr.570/24 të datës 18.07.2024, refuzohet si e pa bazuar ankesa e të padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, e datës 17.01.2024, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, KA.Nr.176/22 të datës 01.12.2023, vërtetohet.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, të Gjykatës Komerciale, i padituri, në afat ligjor në Gjykatë Supreme ka

parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: aprovohet në tërësi kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, dhe të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë ose të njëjtit të anulohen dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

4. Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA-së mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktgjykimin e kontestuar të dhomës së shkallës së dytë dhe atë të shkallës së parë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës gjen se: kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e bazuar.

5. Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), PSH.Nr.113/19-123/19 të datës 20.05.2019, I. Aprovohen, si pjesërisht të bazuara ankesat e operatorëve "B" Sh.p.k - Vushtrri dhe "L-S" Sh.p.k - Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica në Mitrovicë, bashkëfinancim me MMPH" me numër të prokurimit: 642-18-4186-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Mitrovicës. II. Vërtetohet, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica në Mitrovicë, bashkëfinancim me MMPH" me numër të prokurimit: 642-18-4186-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Mitrovicës. III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet të informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, të Ligjit 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues. V. Meqenëse ankesa e operatorit ekonomik ankues "B"-Vushtrri dhe "L-S" Shpk Prishtinë, aprovohen si pjesërisht të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës

në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

6. Kundër vendimit të lartë cekur të paditurës, paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

7. Gjykata e shkallës së parë ka aprovuar të bazuar kërkesëpadinë ndërsa ka anuluar vendimin e kontestuar. Në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka theksuar se vendimi PSH.Nr. 113/19-123/19, i nxjerrë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i Shtratit të Lumit Sitnica në Mitrovicë, bashkëfinancim me MMPH", me numër të prokurimit 642-18-4186-5-1-1, është përfshirë në shkelje ligjore sa i përket arsyetimit se OE ankues "B" sh.p.k nuk ka ofruar sqarime tek AK lidhur me referencat për projekte të përfunduara të punëve të ngjashme ndërtimore në tre vitet e fundit. Përderisa në dy raste me vendime të plotëfuqishme të OSHP-së, ku janë përfshirë referencat për punë të kërkuara është vlerësuar se oferta e "B" sh.p.k, është e përgjegjshme, ndërsa përmes vendimit të tretë të OSHP-së, për të njëjtën çështje konstaton se nuk janë përmbushur kushtet e tenderit, me arsyetim se dëshmitë për punët e përfunduara të kontratave nga lista e prezantuar në dosje nuk janë ndarë nëpër vite sipas vlerës së tenderit.

8. Gjykata vlerëson se lidhur me dëshmitë për punët e përfunduara të kontratave nga lista e prezantuar në dosje, nuk janë ndarë nëpër vite sipas vlerës së tenderit është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit, në pjesën III.2.4 Vlerësimi i kapacitetit teknik dhe profesional, ku sipas kërkesës specifikohet *"dëshmitë për projektet e përfunduara për punë të ngjashme në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë".* Ku në këtë kërkesë nuk është paraparë lista të jetë e ndarë nëpër vite, siç ka vepruar tani OSHP. Një vlerësim të tillë gjykata e vlerëson edhe në kundërshtim me sqarimet e

dhëna lidhur me interpretimin e KPP-së, në raportin e ekspertit, lidhur me llogaritjen e referencave për punë të kryera, e që sipas sqarimit të KPP-së konsiderohet se për llogaritjen e referencave duhet të merret për bazë data e përfundimit të punimeve.

9. Në referim të nenit 56, 3. të LPP-së, ku theksohet se *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohen nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit",* gjykata e shkallës së parë vlerëson se të njëjtat referenca për projekte të përfunduara brenda periudhës së shkruar tri (3) vjeçare janë ofruar edhe më datë 02 Nëntor 2018, dhe janë shpallur si referenca valide me vendimin e OSHP-së numër PSH.Nr. 670/18/679/18, ndërsa në vendimin e kundërshtuar paditësi është eliminuar në bazë të një kërkese ose kriteri që nuk është cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Rrjedhimisht, konstatohet se vendimi PSH.Nr. 113/19-123/19 i datës 20 maj 2019, është i përfshirë në shkelje të nenit 7, 27, 56, 60, 69 dhe 72, të LPP-së. Prandaj obligohet e paditura, në përputhje me nenin 65 të Ligjit për Konflikte Administrative, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri procedurë të eliminoj shkeljet e konstatuara në këtë aktgjykim dhe t'i mënjanoj të metat në procedurën e tenderimit, ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese në pajtim me përgjegjësitë dhe kompetencat ligjore.

10. Andaj në kuptim të nenit 13 par.1, nën par.1.12 lidhur me par.5 të Ligjit Nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 par.2 të LKA-së, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

11. Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë duke vendosur në procedurë ankimore me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, e refuzon si të pabazuar ankesën e të paditurit, duke e pranuar si të drejtë dhe ligjor qëndrimin juridik të shkallës së parë si në aktgjykimin e saj me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit dhe anulimin e vendimit të

kontestuar, sepse nuk gjen prova se i njëjti është i përfshirë me shkelje të dispozitave të LKA-së të cilat i ekzaminon si në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, vlerëson se gjendja faktike nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të padituri. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

12. Kolegji i kësaj gjykate pretendimet ankimore të të padituri nuk i aprovoi, meqë dhoma e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se e paditura nuk ka arsyetuar fare pretendimet e paditësit por vetëm ka përshkruar kronologjinë e ngjarjes, po ashtu dhoma e shkallës së parë me të drejtë i është referuar nenit 59, 60 dhe 72 të LPP-së.

13. Kolegji konstatoj se nuk është provuar ndryshe nga e paditura në asnjë fazë të procedurës të këtij konflikti administrativ. Prandaj, në një gjendje të tillë të vlerësimit, sipas bindjes edhe të kolegjit të kësaj gjykate e bënë të pa qëndrueshëm arsyetimin e vendimit kontestues, ngase në arsyetim të vendimit të kontestuar është dashur të vlerësohen pretendimet e paditësit që kanë rëndësi vendimtare në mënyrë që të jepen sqarime bindëse. Po ashtu ka theksuar se i padituri nuk ka provuar me asnjë provë të vetme pretendimin për eliminimin e paditësit për shkak të mos plotësimit të kushteve, ku në këtë rast paditësi ka paraqitur dëshmitë siç janë projektet e përfunduara të ngjashme ndërtimore në tri vitet e fundit e cila dëshmi parashihej të paraqitet me rastin e aplikimit për aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica në Mitrovicë, bashkëfinancim me MMPH”, ndërsa në vendimin e kundërshtuar paditësi është eliminuar në bazë të një kërkese ose kriteri që nuk është cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

14. Andaj, dhoma e shkallës së dytë vlerëson se vendimi i kontestuar i të paditurës përmban të meta të tilla esenciale të lartcekura që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij andaj vendosi si në kuptim të nenit 49 lidhur me nenin 200 të LPK-së.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, nuk mund të pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të gjykatës së shkallë së parë lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, ngase aktgjykimi shkallës së parë dhe të dytë janë të përfshirë me shkelje të së drejtës materiale.

2. Për këtë shkak, kolegji i kësaj gjykate duke u bazuar edhe në nenin 224 par.1 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë. Kolegji vlerëson se, gjykata e shkallës së parë në mbështetje të gabuar të nenit 56.3 të LPP-së, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe ka detyruar të paditurën që në rishqyrtim dhe rivendosje në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh të veprojë konform vërejtjeve të kësaj gjykate.

3. Neni 59 par. 4 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, përcakton se *"autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".*

4. Neni 64 i këtij ligji përcakton se: *"Një kandidat ose tenderues do të dëshmoj me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: ... (iii) i plotësojnë Kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 68-71 të këtij ligji".*

5. Neni 69 par.1 i ligjit bazik përcakton se: *"Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen*", dhe par. 6 *"Në procedurat që shpijnë në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet realizimi i projekteve të punëve ose realizimi i aktiviteteve ndërtimore, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre teknike dhe profesionale për kryerjen e projekteve të tilla ose realizimin e aktiviteteve të tilla; në veçanti, autoriteti kontraktues mund të kërkojë të dhëna përkitazi me:* si dhe nën par. 6.2. *"listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; sa herë që është e mundur, autoriteti kontraktues mund të obligohet që të dakordohet me autoritetin publik kompetent në Kosovë ose në vendin tjetër që kopjet e certifikatave përkatëse t'ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues",* si dhe nën par. 6.6.*" informacion tjetër përkatës dhe relevant".*

6. Neni 72 par.2 i Ligjit Nr. 05/L -068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, përcakton se: *"Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji".*

7. Në mbështetje të dispozitave ligjore të lartcekura si dhe nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës rezulton se operatori ekonomik "B",

shpk në procedurën e rivlerësimit nuk i është përgjigjur kërkesës së autoritetit kontraktues, për sqarime shtesë lidhur me referencat e kërkesës së dosjes së tenderit, andaj duke qenë se i njëjti as pranë organit të administratës dhe as pranë gjykatës nuk ka ofruar prova të mjaftueshme se plotëson këtë kërkesë, klasifikimi nga autoriteti kontraktues si operator ekonomik i papërgjegjshëm dhe anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është i bazuar. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, vendimi i të padituri është i drejtë dhe i ligjshëm, i nxjerrë në një procedurë të ligjshme administrative, si dhe pretendimet e të padituës të theksuara sikurse në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, janë të bazuara dhe të pranueshme edhe nga kolegji i kësaj gjykate, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

8. Nga se u theksua si më lartë, dhe në bazë të nenit 54 paragraf 1 dhe 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata ka aprovuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ka ndryshuar aktgjykimin e kontestuar ashtu që ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke lënë në fuqi vendimin e të padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), PSH.Nr.113/19-123/19, të datës 20.05.2019.

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të KosovësARJ.Nr.261/2024, datë 12.12.2024

"Në të drejtën e pronësisë industriale, markat tregtare që kanë karakter përshkrues, në parim, nuk gëzojnë mbrojtje juridike. Kjo për shkak se një markë që përbëhet nga fjalë, shenja ose simbole të zakonshme, të cilat thjesht përshkruajnë cilësinë, llojin, qëllimin, origjinën gjeografike apo karakteristika të tjera themelore të mallrave ose shërbimeve, nuk përmbush funksionin thelbësor të markës tregtare – që është të dallojë mallrat ose shërbimet e një ndërmarrjeje nga ato të ndërmarrjeve të tjera.

Qëllimi i ligjvënësit përjashton markat përshkruese nga mbrojtja ligjore, pasi leja për regjistrimin e tyre do të çonte në kufizimin e padrejtë të konkurrencës dhe në pengimin e operatorëve të tjerë ekonomikë për të përdorur terma të zakonshëm, të cilët u nevojiten për të përshkruar mallrat ose shërbimet e tyre në mënyrë të ndershme. Kjo lidhet me parimin e interesit të përgjithshëm dhe të konkurrencës së lirë, i cili është i njohur si në doktrinën e së drejtës së pronësisë industriale, ashtu edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (p.sh., çështjet *Windsurfing Chiemsee* dhe *Postkantoor*).

Megjithatë, përjashtimi i markave përshkruese nuk është absolut. Legjislacioni dhe praktika gjyqësore parashohin institutin e të ashtuquajturës "distinctiveness acquired through use" (fitimi i veçorisë dalluese përmes përdorimit). Nëse një shenjë, ndonëse në fillim ka qenë përshkruese, përmes përdorimit të gjatë, të vazhdueshëm dhe të gjerë në treg arrin të identifikohet nga publiku relevant si tregues i origjinës tregtare të produkteve ose shërbimeve të një subjekti të caktuar, atëherë ajo fiton veçori dalluese dhe, si pasojë, mund të regjistrohet dhe të gëzojë mbrojtje ligjore".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.Nr.257/23 të datës

05.02.2024, është vendosur: Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit: "S.B C" shpk me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi Nr.09/23, datës 11.05.2023, i të paditurës Agjencia për Pronësi Industriale - Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Prishtinë.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.Dh.Sh.II.Nr.713/24 të datës 24.05.2024, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit "S.B C" shpk me seli në Prishtinë, ndërsa është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.Nr.257/23, i datës 05.02.2024.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

4. Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala e paditur.

5. Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se: kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin kontestues Nr.09/23, të datës 11.05.2023, e paditura Agjencia për Pronësi Industriale - Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Prishtinë, ka Refuzuar

ankesën me Nr.prot. KS/2023-002503, të datës 13.04.2023 të paraqitur kundër vendimit Nr.KS/2023/1712 të datës 15.03.2023, lidhur me aplikacionin KS/M/2021/830, të parashtruar nga paditësi "S.B C" shpk, dhe ka lënë në fuqi vendimin Nr.KS/2023/1712, të datës 15.03.2023 të Agjencisë për Pronësi Industriale.

7. Kundër vendimit të lartë cekur të paditurës, paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

8. Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë paditësit dhe në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka theksuar se: Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 68 par. 4 të Ligjit Nr.08/L-075 për Markat Tregtare (LMT), i cili përcakton se: *"4. Kundër vendimit të komisionit mund të parashtrohet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh"* dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *"Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative".* Gjykata i vlerësoi si të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për rastin konkret dhe me provat e administruara në shqyrtim kryesor.

9. Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit ushtruar ndaj vendimit me të cilin ishte refuzuar ankesa e paditësit e ushtruar ndaj vendimit për anulimin e publikimit të aplikimit për regjistrim të markës tregtare "S.B C" në buletinin Nr.102.

10. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në përputhje me nenin 5 të Ligjit për Markat Tregtare (LMT), i cili përcakton se *"1. Markë tregtare mund të jetë çdo shenjë, në veçanti fjalët, duke përfshirë emrat personal ose vizatimet, shkronjat, numrat, ngjyrat, formën e mallrave ose të paketimeve të tyre ose tingujt, zërat, me kusht që këto shenja mund: 1. 1. të dallojnë mallrat apo shërbimet e një*

subjekti ekonomik nga subjekti tjetër ekonomik; 1.2. të përfaqësohen në regjistër në mënyrë të tillë, që të iu mundësojnë autoriteteve kompetente dhe publikut të përcaktojnë qartë dhe saktë objektin e mbrojtjes që i njihet pronarit të saj".

11. Gjykata po ashtu iu referua nenit 6 të LMT, i cili përcakton se: *"1. Marka tregtare nuk do të regjistrohet apo, nëse është e regjistruar, do të shpallet e pavlefshme, nëse: 1. 1, shenjat të cilat nuk janë në përputhje me markën tregtare sipas nenit 5 të këtij ligji; 1.2, shenjat të cilat nuk përmbajnë ndonjë veçori dalluese; 1.3, markat tregtare të cilat përbëhen ekskluzivisht nga shenja ose tregues që mund të përdoren në tregti për të përcaktuar llojin, cilësinë, sasinë, qëllimin e synuar, vlerën, prejardhjen gjeografike, kohën e prodhimit të mallrave ose të kryerjes së shërbimeve ose për të treguar karakteristika të tjera të mallrave dhe shërbimeve; 1.4. markat tregtare të cilat përbëhen ekskluzivisht nga shenja ose tregues të cilat janë bërë të zakonshme në gjuhën e përditshme ose janë përdorur në mirëbesim (bona fide) dhe që kanë krijuar praktika të zakonshme tregtare"...*Në rastin konkret, gjykata duke iu referuar kërkesave ligjore për regjistrimin e markës tregtare gjeti se marka tregtare "S.B C" është markë përshkruese dhe e përgjithshme e cila përbëhet nga fjalë të përgjithshme dhe me asnjë veçori dalluese për mallrat ose shërbimet ngase përbëhet nga fjalë të rëndomta në gjuhë të përditshme të cilat tregojnë cilësi dhe karakteristika të mallrave dhe shërbimeve.

12. Gjykata vlerëson se markat tregtare përshkruese në parim nuk gëzojnë mbrojtje juridike, përveç në rastet kur ajo markë tregtare ka arritur dallueshmërinë përmes përdorimit të gjerë gjatë disa viteve dhe provohet dallueshmëria e fituar përmes përdorimit, pra edhe pse këto shenja nuk posedojnë veçori dalluese, me kalimin e kohës për shkak të përdorimit apo reklamimit të gjerë të shenjës në treg, fitojnë veçori dalluese të mjaftueshme për të gëzuar mbrojtje, gjë që gjykata në rastin konkret vlerëson se paditësit nuk e ka vërtetuar faktin se marka tregtare "S.B C" ka fituar veçori dalluese të mjaftueshme për të gëzuar mbrojtje, përkatësisht për tu regjistruar si markë tregtare pranë të padituri.

13. Gjykata e shkallës së parë, shqyrtoi edhe pretendimet e paditësit se aktit kontestues është nxjerrë nën shkelje të neni 48 të LPPA-së për shkak i padituri nuk ka dhënë fare shpjegim të situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi. Lidhur me këtë, gjykata në kuptim të nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L.031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjeti se vendimi i kontestuar i nxjerr nga i padituri është në përputhje me dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë përmbajtjen e aktit administrativ, kjo për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës vendimi i kontestuar është i qartë, përmban të gjitha elementet e nevojshme të aktit administrativ si dhe në mënyrë të qartë sqaron arsyet mbi të cilat e refuzon ankesën e paditësit ndaj vendimit për anulimin e publikimit të buletinit Nr.102. Prandaj, gjykata pas administrimit të provave në procedurën e konfliktit administrativ nuk arriti të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar për procedurë administrative nga i padituri, ashtu që vlerësoi se vendimi i kontestuar është i drejtë dhe i ligjshëm, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe është nxjerr në përputhje me dispozitat ligjore të cituara më lartë.

14. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nen par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

15. Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 të dhe nenit 49 të LKA-së, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

16. Kolegji, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejt ligjin, kur nga provat e administruara në konflikt administrativ ka nxjerr konstatimin se paditësi nuk i është përmbajtur kërkesave ligjore me

rastin e aplikimit për regjistrimin e markës tregtare "S.B C". Gjatë procedurës së konfliktit administrativ, gjykata e shkallës së parë me të drejt ka nxjerr konstatimin se paditësi nuk ka vërtetuar faktin se kjo markë tregtare ka fituar veçori dalluese të mjaftueshme për të gëzuar mbrojtje juridike përkatësisht për tu regjistruar si markë tregtare. Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, nuk i aprovoi pretendimet ankimore të paditësit, se vendimi i kontestuar i paditurit është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës administrative të nenit 48 të Ligjit 05/L-031 për PPA, dhe se gjykata e shkallës së parë nuk arsyeton se cilat mallra apo shërbime për të cilat është aplikuar i përshkruan emri "S.B C" shpk.

17. Në vazhdim ka theksuar se, vetë fakti se në aplikacionin për regjistrimin e markës tregtare pranë të paditurës, paditësi ka kërkuar mbrojtjen e markës tregtare me përshkrimin e shenjës "S.B C" ku në aplikacion janë të përfshira edhe emërtimet e mallrave klasa 29, 30, 31, 32, 33, 24 (mallra të rëndomta: mishi, peshku, perimet, kafja, qaji, sheqeri, kafshët e gjalla, birrat etj), kolegji vlerëson se e paditura, dhe gjykata e shkallës së parë, kanë zbatuar drejt dispozitat nga neni 5 dhe 6 të Ligjit 08/L-075 për Markat Tregtare, kur ka refuzuar aplikacionin e paditësit për mbrojtjen e markës tregtare "S.B C" për mallrat që nuk posedojnë veçori dalluese, përmbajnë fjalë të rëndomta në gjuhë të përditshme.

18. Andaj Dhoma e Shkallës së Dytë, gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet në ankesë, gjykata e shkallës së parë, ne bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, në kuptim të nenit 44 të LKA-së dhe në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, dhe në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar vetë gjendjen faktike, dhe ka vendosur meritorisht për çështjen juridike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimit të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës, vlerëson se dhomat e shkallës së dytë kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pa bazuar të kërkesëpadisë së paditësit.

2. Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të paditurës, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm. Me Ligjin Nr. 08/L-075 për Markat Tregtare, janë rregulluar situatat juridike kur përdoren si marka tregtare shenjat që përcaktojnë llojin e mallrave apo shërbimeve.

3. Ky ligj është hartuar në përputhje me Direktivën (BE) 2015/2436 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare, në lidhje me markat tregtare, ku në nenin 4 par. 1 pika, a, b, c dhe d, të saj përcakton që markat tregtare të cilat nuk përmbajnë karakter dallues dhe markat tregtare përshkruese, pra ato që përbëhen ekskluzivisht nga shenja ose tregues që mund të shërbejnë, në treg, për të përcaktuar llojin, cilësinë, sasinë, qëllimin e synuar, vlerën, origjinën gjeografike, ose kohën e prodhimit të mallrave ose të dhënies së shërbimit, ose karakteristikave të tjera të mallrave ose shërbimeve, nuk duhet të regjistrohen ose nëse janë regjistruar mund të shpallen të pavlefshme.

4. Në rastin konkret, për mallrat për të cilat paditësi ka aplikuar për regjistrimin e markës si: mishi, peshku, vajrat, kafja, çaji, produktet

bujqësore, birrat, ujërat mineral, të gazuar joalkolike, pijet alkoolike, duhani, artikujt e duhanxhinjëve, shkrepëse etj., të cilat nuk posedojnë veçori dalluese si dhe përmbajnë shenjë apo emërtues të zakonshëm në gjuhë të përditshme shqipe, i cili nuk identifikon mallrat apo produktet e aplikuesit, nuk mund të i ofrohet mbrojtje përmes regjistrimit të markës tregtare.

5. Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkelje të dispozitave të procedurës apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale, vlerësoj se këto pretendime janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për një vendosje ndryshe në këtë çështje nga çka kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë.

6. Nga gjendja si më lartë rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, LTM. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe me të drejtë kanë vlerësuar se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit.

7. Nga arsyet e theksuara si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflikte Administrative, gjykata refuzoi të pa bazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa vërtetoi aktgjykimin e kontestuar.

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës
ARJ.Nr.151/2024, datë 23.01.2025

"Gjykatat e instancave më të ulëta drejtë kanë vlerësuar se veprimet e të padituresë janë në përputhje me ligjin dhe procedurat doganore, sipas UA Nr. 25/2016, në veçanti për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave laboratorike. Analizat laboratorike të kryera nga Agjencia Kombëtare Doganore e Bullgarisë janë të vlefshme dhe të pranueshme, të cilat kanë konfirmuar se produkti "Olive Oil Dhërmiu" është një përzierje vajrash bimorë (vaj ulliri dhe vaj luledielli) dhe se ky produkt nuk është modifikuar kimikisht përmes proceseve të hidrogjenizimit, interesterifikimit, riesterifikimit apo elaidinifikimit."

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, A.Nr.340/19, të datës 04.10.2021, është vendosur: Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit "E" Shpk, me seli në Pejë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Aktvendimi Nr.01.3.2.2/752, i datës 18.11.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kthej mjetet e paguara në shumë prej 47,690.09€ me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 07.03.2019, e deri në përmbushjen e plotë të këtij detyrimi. Mbetet në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës 01.3.2.2/752, i datës 18.01.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.Nr.635/22, të datës 05.12.2023, Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit, "E" Shpk me seli në Pejë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.Nr.340/19, të datës 04.10.2021, Vërtetohet.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në Gjykatën Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të ndryshohet aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë dhe të parë, ashtu që të: aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, dhe të detyrohet e paditura që t'ia kthej paditësit mjetet e paguara në shumën prej 47,690.09 euro me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 07.03.2019, e deri në përmbushjen e plotë të këtij detyrimi, ose të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

4. Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala e paditur.

5. Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se: kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurës Dogana e Kosovës, Nr.01.3.2.2/752 të datës 18.01.2019, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, "E" Shpk me seli në Pejë, të ushtruar ndaj aktvendimit Nr.03.l.l-2018-559-l të datës 29.11.2018, të Sektorit për Kontroll Pas Importues, si e pa bazuar.

7. Kundër vendimit të lartë cekur të paditurës Dogana e Kosovës, paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

8. Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit ndërsa në arsyetim të aktgjykimit të saj ka theksuar se: Me

qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit respektivisht vërtetimit dhe sqarimit të faktit nëse malli i llojit "Vaj Sallate Dhërmiu" i zhdoganuar nga paditësi gjatë periudhës 2016-2018 sipas DUD-ave përkatës në bazë të nomenklaturës së mallrave të TARIK-ut dhe ligjeve të zbatueshme në Kosovë klasifikohet në kodin tarifor në numër 1512199000, siç është deklaruar nga paditësi në procedurë të zhdoganimit të mallrave apo klasifikohet në kodin tarifor me numër 1516209100, siç e ka klasifikuar e paditura me aktvendimin me Nr.03.l.l-2018-559-l të datës 29.11.2018, bazuar në mendimin për Klasifikim Tarifor 04/1.2 Nr.155/20.11.2018, gjykata në seancën gjyqësore të datës 02.03.2021 duke vepruar sipas propozimit të përfaqësueses së autorizuar të paditësit që të bëhet një ekspertizë, ka caktuar ekspertin e pavarur për klasifikimin tarifor të mallrave Sh.H për ta kryer ekspertizën për arsye se gjykata nga ueb faqja e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë ka vërejtur se ky institucion nuk zhvillon analiza për përcaktimin e kodeve tarifore të mallrave, prandaj meqenëse në listën e ekspertëve të përhershëm të emëruar nga gjykata nuk kishte ekspert gjyqësor profesionist të fushës i cili ka njohuri lidhur me klasifikimin tarifor të mallrave gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 358.3 të LPK-së, dispozitë kjo e zbatueshme përshtatshmërisht në kuptim të nenit 63 të LKA-së, në këtë rast vendosi që ta caktoj ekspertin e pavarur të përmendur më lartë.

9. Nga vlerësimet dhe konstatimet e nxjerra në ekspertizën e pavarur të datës 18.03.2021, të dorëzuar në gjykatë dhe të paraqitura edhe në seancën gjyqësorë të datës 21.04.2021, nga ana e ekspertit të pavarur Sh.H për detyrat e dhëna në ekspertizë është dhënë konstatimi se mendimi për klasifikim tarifor 04/1.2 Nr.155/20 i datës 20.11.2018, nuk përmban asnjë provë materiale me të cilin do të vërtetohej klasifikimi i mallit në pozicionin tarifor 1516209100.

10. Sipas ekspertit nuk plotësohen kërkesat nga numri tarifor 15, 16 ku taksativisht është përcaktuar se çfarë trajtimi kimiko-fizik duhet të nënshtrohet produkti që klasifikohet në këtë numër tarifor (procesi i hidorgjenizimit tërësisht apo pjesërisht, i interesterfikimit, i

riesterfikimit apo i elaidinifikimit). Po ashtu sipas ekspertizës edhe dokumentacioni përcjellës dhe mostra dhe tiketa e produktit nuk përmbajnë asnjë të dhënë për trajtimet kimiko-fizike që kërkohen për klasifikimin tarifor të mallit të numrit tarifor 15.16 dhe se për klasifikimin e saktë të këtij produkti duhet të duhen të dhëna shtesë që mund të sigurohen vetëm pas analizave laboratorike.

11. Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit Nr.04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

12. Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së, nenit 81.H të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

13. Dhoma e Shkallës së Dytë, e miraton si të drejtë dhe ligjor, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sepse nga dëshmitë e administruara ka konstatuar drejtë gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim, pasi që edhe pas ekspertizës të ekspertit të pavarur ishte e pa mundur vërtetimi i faktit nëse malli i llojit "Vaj Sallate Dhërmiu", i zhdoganuar nga paditësi gjatë periudhës 2016-2018, sipas Deklaratave Unike Doganore përkatëse, në bazë të nomenklaturës së mallrave të TARIK-ut dhe ligjeve të zbatueshme në Kosovë klasifikohet në kodin tarifor me numër 1512199000, siç është deklaruar nga paditësi në procedurë të zhdoganimit të mallrave po klasifikohet në kodin tarifor me numër 1516209100, siç e ka klasifikuar e paditura me aktvendimin me Nr.03.l.l-2018-559-l, të datës 29.11.2018.

14. Gjykata nga dispozitat e nenit 21 të UA Nr.25/2016 për marrjen e Mostrave, Dokumentacionit të Mallit dhe Trajtimin e Tyre në Procedurë Doganore Nr.25/2016 ku parashihet se e paditura laboratori i saj zhvillon analiza laboratorike për ti caktuar parametrat e kërkuar dhe se nëse Sektori i Laboratorit nuk mund të kryej analizën laboratorike, përmes njësitit kompetent në Doganë, mostra bashkë me urdhëresën do të dërgohen në njërin nga entet e certifikuara laboratorike konform legjislacionit në fuqi e ka obliguar të padituren që në afat prej 15 ditësh për mallin lëndor "Vaj Sallate 9600" të deklaruar në procedurë të zhdoganimit tek e paditura sipas DUD-ave kontestues, sipas mostrës së marr nga e paditura, të blombuar me Nr.18.219308 që ti bëj analizën kimike - fizike - teknologjike, për të përcaktuar nëse malli lëndor i është nënshtruar procesit të hidorgjenizimit tërësisht apo pjesërisht, i interesterifikimit, i riesterifikimit apo i elaidinifikimit, duke i dhënë mundësinë që në qoftëse e paditura nuk është në gjendje të kryej vet një analizë të tillë përmes laboratorit të saj atëherë ta dërgoj mostrën e marr të mallit lëndor ta dërgoj për analizë në njërin nga entet e certifikuara laboratorike konform legjislacionit në fuqi, siç parashihet me dispozitat e UA Nr.25/2016 për Marrjen e Mostrave, Dokumentacionit të Mallit dhe Trajtimin e Tyre në Procedurë Doganore Nr.25/2016.

15. E paditura përmes parashtresës së dorëzuar në gjykatë të datës 13.09.2021, i ka dorëzuar gjykatës rezultatet laboratorike, përkatësisht Raportin e Analizave Laboratorike për mallin lëndor "Vaj Olive Dhërmiu" të datës 17.06.2021 të Agjencisë Kombëtare Doganore të Bullgarisë, si dhe shkresën e pranuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Doganore të Bullgarisë për Drejtorin e Përgjithshëm të Doganës së Kosovës të datës 01.072021, të përkthyera në gjuhën shqipe, e që gjykata konstatoj se ky laborator ka analizuar mostrën e mallit lëndor "Vaj Olive Dhërmiu" me kodin laboratorik 3047 21, sipas blombës me m. 18-219308 dhe ka zhvilluar analizat fizike-kimike-teknologjike për këtë mall, prej nga është ardhur në përfundim se bazuar në vlerësimin e ekspertëve të rezultatit të testit dhe informatave në dispozicion në pajtim me kushtet në kapitullin 15 të Nomenklaturës së kombinuar, mostra e analizuar e regjistruar me

kodin laboratorik 3047 21 (Olive Oil Dhërmiu) është identifikuar si përzierje e ngrënshme e vajrave bimor.

16. Kolegji, shqyrtoi edhe pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore, si dhe theksimet e tjera në përshkrim të ankesës, dhe të njëjtën e refuzon si të pa bazuar dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse në këtë konflikt administrativ gjykata konstaton se nga shkresat e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Doganore të Bullgarisë për Drejtorin e Përgjithshëm të Doganës së Kosovës e datës 01.07.2021 gjykata e ka konstatuar faktin se përmes kësaj shkrese Agjencia Kombëtare Doganore e Bullgarisë duke i'u përgjigjur Doganës së Kosovës me letrën me Nr.INT 008-11052021, për asistencë administrative, mbi analizat kimike-teknologjike, e ka informuar të paditurën se pas të gjitha testeve të kryera produkti "Olive Oil Dhërmiu" përshkruhet si lëng vajor i pastër homogjen me ngjyrë të verdhë të zbehur dhe nuancë të hapur të gjelbër. Në këtë shkresë thuhet se bazuar në përbërjen e saj me acide yndyrore tri gliceride dhe vlera jodi, mostra e analizuar është identifikuar si përzierje e vajit të ullirit dhe vaj të lule diellit dhe se sipas vetive psiko-kimike përfshirë spektrin infra red, produkti nuk është modifikuar në mënyrë kimike. Prandaj duke marr parasysh rezultatet e testit, produkti i analizuar "Olive Oil Dhërmiu" është përzierje e rafinuar e zbardhur dhe aromatizuar e vajrave bimor, të përshtatshëm për konsum nga njerëzit.

17. Në shkresë është konstatuar se bazuar në kriterin objektiv të produktit dhe sipas Rregullave të Përgjithshme për Interpretim I dhe 6 të Nomnklaturës së Kombinuar për Bashkimin Evropian dhe në vijim Shënimet Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar për kreun 1517 "Olive Oil Dhërmiu" klasifikohet nën kodin NK 15179091 "Vajra fiksuara bimore, lëngje të përziera" dhe se produkti në fjalë nuk mund të klasifikohet si vaj bimor nga kreu 1516 pasi që nuk ka kaluar nëpër trajtime modifikuese siç është hidrogjenizmi (i pjesshëm ose i plotë), inter-esterifikimi, ri esterfikimi ose elaidinizimi.

18. Pretendimet ankimore të paditësit, nga shkaqet ankimore të cekura si më lartë, si dhe theksimet e tjera si në arsyetim, kolegji i shqyrtoi në

baza ligjore dhe i refuzon si të paqëndrueshme dhe me ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës administrative të LKA-së, apo të LPK-së, ligj i zbatueshëm, e po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë sipas çështjes në shqyrtim. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë në fuqi aktvendimin e të padituresë, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimit të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës, vlerëson se dhomat e shkallës së dytë kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pa bazuar të kërkesëpadisë së paditësit.

2. Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të padituresë Dogana e Kosovës, Nr.01.3.2.2/752, të datës 18.01.2019, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, "E" Shpk me seli në Pejë, të ushtruar ndaj aktvendimit Nr.03.l.l-2018-559-l, të datës 29.11.2018, të Sektorit për Kontroll Pas Importues, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

3. Pretendimet e paditësit, të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ku ndër të tjera thekson se: gjykata me aktgjykim ka vërtetuar se vaji objekt i kërkesëpadisë nuk përputhet as me kodin e përcaktuar nga eksportuesi sipas DUD-ve, as me kodin e caktuar sipas vendimit të paditurës, as me kodin e përcaktuar nga ekspertizat-rezultatit të laboratorit dhe prapëseprapë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, si dhe se gjykata sipas detyrës zyrtare është dashur të propozoj superekspertizë.., kolegji i Gjykatës Supreme, i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzoi në tërësi si të pabazuara.

4. Aktgjykimi i kontestuar nuk rezulton as me shkelje të dispozitave të procedurës nga neni 182 par.2 pika n) dhe o), nenit 7 par.2 të LPK-së, si dhe nenit 26 par. 1dhe 2 të LKA-së, ashtu siç pretendon paditësi në kërkesën e tij. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe me të drejtë kanë vlerësuar se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit.

5. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë. Nga gjendja faktike e konstatuar, rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, KDAK-së.

6. Nga theksimet si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflikte Administrative, gjykata ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e kontestuar.

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës
ARJ.Nr.153/2024, datë 23.01.2025

''Gjykata Supreme thekson se në fushën e procedurave doganore, respektimi i detyrimeve dokumentare paraqet një element thelbësor për garantimin e ligjshmërisë dhe transparencës në procesin e zhdoganimit të mallrave. Në këtë drejtim, neni 123 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2009 përcakton në mënyrë eksplicite kategoritë e dokumenteve që duhet të bashkëngjiten deklaratës doganore. Këto dokumente përfshijnë, ndër të tjera, faturën komerciale, dokumentacionin që dëshmon pagesën, si dhe çdo provë tjetër që vërteton vlerën reale të mallrave të importuara.

Roli i këtyre dokumenteve është i shumëfishtë: (i) ato shërbejnë për të siguruar një vlerësim të saktë të detyrimeve doganore dhe tatimore; (ii) garantojnë që organet kompetente të kenë mundësi të verifikojnë përputhjen e deklarimit me gjendjen faktike; dhe (iii) kontribuojnë në parandalimin e praktikave të paligjshme si nënvlerësimi i mallrave, kontrabanda ose shmangia nga detyrimet fiskale.

Në këtë kuptim, Gjykata Supreme rikujton se përmbushja e këtyre kërkesave formale nuk është thjesht një detyrim procedural, por një mekanizëm i domosdoshëm për mbrojtjen e interesit publik dhe për funksionimin korrekt të sistemit doganor. Mosparaqitja ose paraqitja e mangët e dokumentacionit të kërkuar krijon pasojë juridike të drejtpërdrejtë: deklarata doganore konsiderohet e paplotë dhe organi doganor është i autorizuar të refuzojë pranimin e saj, si dhe të ndërmarrë masa ligjore përkatëse.

Ky standard është në përputhje si me parimet e ligjshmërisë dhe sigurisë juridike të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ashtu edhe me obligimet që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e tregtisë dhe doganave. Gjykata, duke u mbështetur në këtë kornizë normative, nënvizon se administrimi rigoroz i dokumentacionit në procedurat doganore është i domosdoshëm për të garantuar barazinë ndërmjet operatorëve

ekonomikë, mbrojtjen e tregut të brendshëm dhe respektimin e konkurrencës së ndershme.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.Nr.781/21, të datës 18.01.2022, është vendosur: Refuzohet kërkesëpadia e paditësit "M.C" Shpk me seli në Prishtinë, si e pa bazuar. Mbetet në fuqi Aktvendimi Nr.01.3.2.2/2539, i datës 03.03.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë

2. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.Nr.1176/22, të datës 06.11.2023, Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit "M.C" Shpk me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.Nr.781/21, të datës 18.01.2022, vërtetohet.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në Gjykatën Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

4. Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala e paditur.

5. Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurës Dogana e Kosovës, Nr.01.3.2.2/2539, të datës 03.03.2021, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit për rishqyrtimin e vendimit Nr.R-398/15.01.2021, R-696/21.01.2021 dhe R-2171/09.02.2021, të Zyrës së Brendshme Doganore Prishtina, me arsyetimin se dokumentacioni i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pamjaftueshme sepse mungon transferi bankar, deklarata eksportuese, pra çmimet e prezantuara nuk mund të pranohen si reale, andaj në këtë kuptim Dogana e Kosovës konstaton se nuk mund të veprohet sipas kërkesës së paditësit.

7. Kundër vendimit të lartë cekur të paditurës Dogana e Kosovës, paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

8. Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit ndërsa në aktgjykimin e saj ka theksuar se: Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar gjykatës provat materiale si faturat e mallit, kontratën e shitblerjes, mirëpo nuk ka arrit të dëshmoj pagesën e mallit lëndor si dëshmi se është deklaruar vlera reale e mallit doganor, prandaj edhe gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e papranueshme, pasi që fakti vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e deklaruar e mallit lëndor e që në këtë rast është transaksioni bankar apo çfarëdo pagese tjetër për mallin e importuar, paditësi nuk ka qenë në gjendje që ta dëshmoj me asnjë provë materiale as në procedurën administrative dhe as në këtë konflikt administrativ. Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit, nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor.

9. Në vazhdim ka theksuar se: si rregull gjykata vendos konfliktin administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative, dhe në bazë të nenit 81.F par.1 të Ligjit 04/L-102, në

këtë rast paditësi bart detyrimin mbi vërtetimin e fakteve që e mbështesin kërkesën e tij. Gjykata nuk mund të merr për bazë pretendimet e paditësit për ta ndryshuar një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar e paditura pas ekzaminimit të mallit lëndor dhe dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor sepse paditësi në procedurën administrative nuk ka paraqit prova të argumentuara që dëshmojnë të kundërtën e mendimit për të vlerësuar mallin sipas metodës së parë të vlerësimit, gjithashtu nuk është kontestuese nga ana e paditësit se ka paraqitur dokumentacion në përpjekje për të provuar se vlera e deklaruar është vlera e paguar për mallin lëndor, prandaj gjykata konstaton se e paditura ka aplikuar drejt dispozitat ligjore dhe ka bërë vlerësimin e mallit sipas metodës së gjashtë të vlerësimit përkatësisht neni 35 i Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës respektivisht të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës.

10. Si fakte vendimtare që kanë ndikuar në rivlerësimin e mallit lëndor ka qenë se e paditura Dogana e Kosovës është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit dosja e vlerave dhe zhdoganimeve të mëhershme. Gjykata vlerëson se provat e tilla me të cilat është rivlerësuar malli lëndor sipas dosjes së vlerave, është provë e bazuar për tu rivlerësuar malli lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, prandaj gjykata konstaton se është aplikuar drejt dispozita ligjore kur është rivlerësuar malli lëndor sipas të dhënave të disponueshme. Gjykata konsideron se në këtë rast paditësi nuk ka arrit të dëshmoj vlerën e transaksionit të paguar për mallin lëndor, kështu që nuk mund të pranohen pretendimet se dokumentacioni përcjellës i mallit është në përputhje me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

11. Gjykata konsideron se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt. Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi Nr. 01.3.2.2/2539 i datës 03.03.2021 i Doganës së Kosovës

në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit Nr.04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

12. Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së, nenit 81.H të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

13. Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar - aktvendimit të Doganës së Kosovës, të atakuar nga paditësi si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, me të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu edhe në procedurë gjyqësore sipas aktgjykimit të atakuar me ankesë, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se paditësi nuk ka dëshmuar me dokumentacion adekuat dhe bindës për tu dëshmuar vlera reale e paguar për mallin lëndor, dhe për tu bërë zhdoganimi sipas DUD-ve të lartcekur me metodën e parë (neni 33 të KDA), andaj me të drejtë nga Dogana e Kosovës i është kontestuar vlera e deklaruar e mallit për zhdoganim, pasi nuk ka mundur të argumentoj me prova konkrete mënyrën e pagesës për blerje në këtë drejtim gjykata nuk ka mund të pranoj pretendimet në kërkesëpadinë e paditësit. Kolegji njëjtë si gjykata e shkallës së parë, vlerëson se Dogana e Kosovës, bazuar në faktet e cekura si më lartë me të drejtë ka aplikuar metodën e 6 (gjashtë) të vlerësimit, neni 35 i KDA-së, në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës për mallin e njëjtë, është bërë përcaktimi i

çmimit real të zhdoganimit, e jo ai i deklaruar nga subjekti me çmim më të ulët, sipas dokumenteve përcjellëse të mallit.

14. Pretendimet ankimore të ankuesit se nuk janë analizuar dokumentet e bashkangjitura deklaratës doganore, faturën dhe pagesën bankare e cila përputhet me vlerën e faturave përkatësisht të DUD-ve kontestues, kolegji i refuzon si të pa bazuara dhe jo me ndikim për vendosjen e çështjes në mënyrë tjetër, nga ajo që është vendosur në gjykatën e shkallës së parë, sepse Dhomat e Shkallës së Dytë, në shkresat e lëndës të paraqitura nga paditësi, nuk ka mundur të vërtetoj se është bërë pagesa për faturat e mallit doganor e që do të dëshmonte vlerën e transaksionit konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109 dhe nga të cilat dokumente do të mund të konstatohet se paditësi ka paraqit dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar në bazë të nenit 123 të UA 11/2009.

15. Kolegji po ashtu vlerëson se dëshmitë në të cilat thirret në ankesë paditësi, vërtetohet se nga gjykata e shkallës së parë janë shqyrtuar në tërësi, por nuk është arrit të dëshmohet se janë prova të qëndrueshme dhe bindëse materiale, për tu dëshmuar vlera reale e mallit, andaj për shkak të metave të tyre nuk janë pranuar si të vlefshme, sepse nuk është dëshmuar vlera reale e mallit lëndor, sipas DUD-ve kontestues. Andaj, në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimit të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës, vlerëson se dhomat e shkallës së dytë kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me

shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pa bazuar të kërkesëpadisë së paditësit.

2. Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të padituërës Dogana e Kosovës, Nr.01.3.2.2/2539 i datës 03.03.2021, me të cilën është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit për rishqyrtimin e vendimit Nr.R-398/15.01.2021, R-696/21.01.2021 dhe R-2171/09.02.2021 të Zyrës së Brendshme Doganore Prishtina 3, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

3. Pretendimet e paditësit, të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ku ndër të tjera thekson se: e paditura nuk ka zbatuar nenin 92 të UA 11/2009, si dhe se paditësi ka parashtruar provën, përkatësisht pagesën bankare për DUD-in kontestues në emër të faturës QI-2018/36, kolegji i Gjykatës Supreme, i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzoi në tërësi si të pabazuara. Gjykata, rikujton se neni 123 par.1 i Udhëzimit Administrativ Nr.11/2009, liston dokumentet që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësi as pranë organit të administratës dhe as pranë gjykatës, nuk ka arritur që të argumentojë me prova konkrete vlerën reale të mallit të zhdoganuar, përkatësisht transaksionin bankar të cilin ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor.

4. Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkelje të dispozitave të procedurës apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale, vlerësoj se këto pretendime janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për një vendosje ndryshe në këtë çështje nga çka kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta.

5. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë. Nga gjendja si më lartë rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, KDAK-së. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe me të drejtë kanë vlerësuar se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit.

6. Nga se u theksua si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflikte Administrative, gjykata ka refuzuar të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa aktgjykimin e kontestuar e ka vërtetuar.

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës
ARJ.Nr.242/2024, datë 18.02.2025

"Gjykata Supreme ka konstatuar se paditësi, si importues i veturave për personat invalidë të luftës, është i liruar nga taksat dhe TVSH-ja. Paditësi pretendimet e veta për faturat kontestuese i ka argumentuar me prova siç janë: Deklaratat Unike Doganore IM4 të liruara nga detyrimet doganore, vërtetimet dhe certifikatat e Invalidëve të Luftës përmes të cilave dëshmohet se personat, blerësit të veturave janë të liruar nga detyrimet doganore, përfshirë Taksat Doganore, Akciza dhe TVSH-ja pasi që janë invalid të luftës dhe në bazë te nenit 6 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-054 janë të liruar nga tatimi dhe dogana."

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së parë, KF.Nr.35/22, të datës 22.03.2023, është vendosur: I. Aprovohet në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit "P.K" Shpk, me seli në Graçanicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.Z-Menaxher i Financave. II. Anulohet vendimi i të padituri Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në Prishtinë, Nr.36/2019 i datës 14.03.2019. II. Detyrohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit "P.K" Shpk, me seli në Graçanicë, t'ia pranoj faturat Nr.011224/11, 014120/12, 011093/10, 014163/11 dhe 014137/12, si deklarime pa TVSH-ë për periudhat tatimore 2010, 2011 dhe 2012 si dhe ta liroj të njëjtin edhe nga ndëshkimet 25% për TVSH-në e kalkuluar për këto fatura, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor. IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.Nr.705/23, të datës 08.05.2024, Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të padituri, Administrata Tatimore e Kosovës, e datës 28.04.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat

e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.Nr.35/22, të datës 22.03.2023, vërtetohet.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes së të drejtës materiale, me propozim që të: aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të prishet apo ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, ndërsa mbetet në fuqi vendimi i të padituresë ATK Nr.36/2019, të datës 14.03.2019, ose aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta të anulohen dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

4. Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala paditëse.

5. Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së padituresë dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se: kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin kontestuese të padituresë Nr.36/2019 të datës 14.03.2019, është vendosur: I. Refuzohet si e pa bazë ankesa Nr.36/2019, e datës 23.06.2018, e tatimpaguesit në ri-procedurë “P.K” Shpk me NRB:xxx, si dhe NF:xxx, me drejtor të përfaqësisë z. F.P, adresa:.., sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore A.Nr.1246/14, në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit Nr. 03/L-222, Për Administratën Tatimore dhe Procedurat. II. Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll për pikat kontestuese konfirmohen si të bazuara. III. Procedura e ankesës nuk ndërprenë sanksionet për mos përmbushje

dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

7. Kundër vendimit të lartcekur të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

8. Gjykata e shkallës së parë ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar vendimin e të paditurës. Në aktgjykimin e saj gjykata ka konstatuar se e paditura vendimin kontestues ndonëse e ka nxjerr në ri procedurë duke vepruar në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.Nr.1246/14 datës 06.12.2018, ajo nuk i ka respektuar pikëpamjet juridike të Gjykatës, pra ka nxjerr vendim në kundërshtim me udhëzimet dhe vërejtjet e Gjykatës, duke anashkaluar kështu detyrimet ligjore nga neni 65 i LKA-së.

9. Gjykata nuk i ka pranuar pretendimet e të paditurës në arsyetimin e vendimit kontestues se faturat e lëshuara nga paditësi të faturuara me 0% TVSH-së janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr.03/L-146 për TVSH, për faktin se paditësi i ka paraqitur gjykatës dëshmitë dhe atë: Deklaratat Unike Doganore IM4 të liruara nga detyrimet doganore, si dhe Vërtetimet dhe Certifikatat e Invalidëve të Luftës përmes të cilave dëshmohet se këta personat janë invalid të luftës e të cilët në bazë neni 6 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-054 janë të liruar nga tatimi dhe dogana. Po ashtu, gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës gjenden Shënimet e Jashtme të lëshuara nga Dogana e Kosovës përmes të cilave është konfirmuar se këta persona, respektivisht blerës të veturave janë të liruar nga detyrimet doganore, përfshirë Taksa Doganore, Akciza dhe TVSH-ja.

10. Gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se pretendimi i të paditurës se vendimi i kontestuar përmban shkelje thelbësore të ligjeve përkatëse, gjegjësisht Ligjit për Procedurën Administrative, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar. Për gjykatën arsyetimi i të paditurës në vendimin e kontestuar se duhet trajtuar si shitje të tatueshme veturën e cila është

në emër të P.B, për shkak se këtu eksportues kemi P.M, kurse për transaksionin në fjalë kemi faturën e lëshuar nga P.K, është i pa bazuar, kjo për faktin se shitja është bërë nga depoja doganore si import i përkohshëm, ndërsa fatura është deklaruar për qëllime të tatimit në fitim po jo edhe për TVSH e cila nuk paguhet për importe të përkohshëm. Tutje, gjykata ka konstatuar se kjo veturë është shitur nga depoja doganore IM7, në procedurë të Importit të Përkohshme me IM5, duke u mbështetur po ashtu edhe në garancionin bankar të datës 18.05.2011 në vlerë prej 7,000.00, € në fund është dëshmuar se procedura e importit të përkohshëm është mbyllë me deklaratën unike doganore EX3 R-4298/14.04.2014.

11. Gjykata ka shqyrtuar bazën ligjore dhe ka konstatuar se e paditura pretendimin e vet e ka mbështetur në dispozitat e nenit 27 dhe 28 te ligjit 03/L-146 për TVSH, mirëpo gjykata ka konstatuar se në bazë të dispozitave të nenit 6 paragrafi 2 të ligjit 04/L-056 thuhet se si beneficion i veçantë është *"Lirimi nga tatimi dhe dogana për veturat speciale për përdorim personal (një veturë në çdo pesë (5) vjet) si dhe i pajisjes ortopedike janë të drejta të cilat i realizojnë invalidët e UÇK nga grupet I deri në grupin VII në përshtatshmëri me shkallën e paaftësisë të përcaktuar me nenin 10 të këtij ligji",* nga rrjedh se përmes këtij neni invalidët e luftës janë të liruar nga Tatimi dhe Dogana. Andaj, në kuptim të nenit 81, par 2, nën par 2.2 të ligjit Nr.04/L-102 dhe nenit 46 par.5 të Ligjit Nr.03/L-202 ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

12. Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur, në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së, nenit 81.H të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe

drejtë është aplikuar e drejta materiale me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit.

13. Kolegji pretendimet ankimore të padituresë nga bazat ankimore të theksuara si më lartë si dhe pretendimet e tjera si në arsyetim të ankesës, i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara, andaj kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

14. Dhoma e Shkallës së Parë, në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8 i LPK-së si dhe shkresave të tjera, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, dhe në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar vet gjendjen faktike, (dhe ka vendosur meritorisht për çështjen juridike si në dispozitiv të aktgjykimit të animuar, bazuar në faktet e paraqitura si në arsyetim të aktgjykimit të mbështetura në dispozitat ligjore tatimore ku pa dyshim vërtetohet se e paditura nuk ka arritur ti mbështes konstatimet e veta se tatimi shtesë i TVSH-së për paditësin ka ardhur si rezultat i lëshimit të faturave për shitjet, e të cilat fatura janë me 0% TVSH, përderisa në anën tjetër paditësi pretendimet e veta për faturat kontestuese i ka argumentuar me prova siç janë: Deklaratat Unike Doganore IM4 të liruara nga detyrimet doganore, vërtetimet dhe certifikatat e Invalidëve të Luftës përmes të cilave dëshmohet se personat, blerësit të veturave janë të liruar nga detyrimet doganore, përfshirë Taksat Doganore, Akciza dhe TVSH-ja pasi që janë invalid të luftës dhe në bazë te nenit 6 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-054 janë të liruar nga tatimi dhe dogana.

15. Prandaj, gjykata e shkallës së dytë konstaton se mbi bazën e provave të paraqitura dhe të administruara në procedurë gjyqësore paditësit duhet ti pranohen faturat Nr.011224/11, 014120/12, 011093/10,

014163/11 dhe 014137/12, si deklarime pa TVSH për periudhat tatimore 2010, 2011 dhe 2012. Kolegji gjithashtu ka konstatuar se drejtë ka vepruar kur e detyron të paditurën që ta liroj paditësin nga ndëshkimet 25% për TVSH-në e kalkuluar për këto fatura. Ka shtuar se, duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Andaj, në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimit të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar të gjykatës së shkallës së dytë dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës, vlerëson se dhomat e shkallës së dytë kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditurës dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon e paditura në kërkesën e saj. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit.

2. Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës-Departamenti i Ankesave, Nr.36/2019 i datës 14.03.2019, nuk është vendim i drejtë dhe i ligjshëm. Gjykatat e instancave më të ulëta me të

drejtë kanë vlerësuar se paditësi në cilësinë e importuesit të veturave, për blerësit të cilët kanë statusin invalid të luftës, janë të liruar nga taksat doganore, akciza dhe TVSH-ja.

3. Pretendimet e të padituruës të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, lidhur me shkeljen e së drejtës materiale, përkatësisht nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr.03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, kolegji i refuzoj në tërësi të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë kanë zbatuar nenin 6 paragraf 2 të Ligjit Nr.04/L-054 kur kanë konstatuar se blerësit janë të liruar nga detyrimet doganore dhe tatimore. Edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate mbi bazën e provave të paraqitura dhe administruara në procedurën gjyqësore paditësit duhet ti pranohen faturat kontestuese.

4. E paditura, në kërkesë pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Megjithatë, këto pretendime janë përmendur vetëm si bazë për atakimin e aktgjykimit të kontestuar, pa specifikuar dhe pa arsyetuar se cila dispozitë konkrete të LKA-së apo LPK-së janë shkelur dhe në ç'mënyrë kjo ka ndikuar në rezultatin e procedurës. Për këtë arsye, Gjykata Supreme, kufizon shqyrtimin e saj vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare, zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt, për çka edhe ka vlerësuar se i njëjti nuk i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë është i qartë, i kuptueshëm dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

5. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë. Nga gjendja si më lartë rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, LATP-së. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe

përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe me të drejtë kanë vlerësuar se është cenuar ligji në dëm të paditësit.

6. Nga arsyet e theksuara si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflikte Administrative, gjykata ka refuzuar të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e kontestuar.

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës
ARJ.Nr.217/2024, datë 21.02.2025

’’Gjykata Supreme vlerëson se mos njohja e mallit të asgjësuar, si shpenzim i zbritshëm për qëllime tatimore me arsyetimin se tatimpaguesi nuk e ka njoftuar ATK-në së paku 10 ditë pune paraprakisht nga data e shkatërrimit të mallit duke iu referuar nenit 13 par.1 pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2009, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Gjykata vërteton se paditësi - tatimpaguesi nuk ka detyrim ligjor të njoftojë ATK-në përpara asgjësimit të mallrave. Dokumentacioni i lëshuar nga organet kompetente komunale (Inspektorati Sanitar) është i besueshëm dhe i mjaftueshëm për të vërtetuar asgjësimin e mallrave.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.Nr.1407/18, të datës 02.04.2021, është vendosur: Aprovohet në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit NTP “A.A, me seli në ..., I. Anulohet vendimi i të padituri, Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, Nr.69/2012, i datës 17.05.2012. III. Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit, NTP “A.A, me seli në ..., t’ia njoh si shpenzim të zbritshëm për periudhën tatimore 2009/TVSH mallin e asgjësuar sipas procesverbalit të datës 11.12.2009, në vlerën furnizuese prej 48,040.89 euro, (dyzet/e/tetëmijë/e/dyzet/euro/e/tetëdhjetë/e/nëntë/cent), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij Aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit ligjor.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.Nr.631/22, të datës 23.02.2024, Refuzohet ankesa e të padituresë, Administrata Tatimore e Kosovës, e datës 06.05.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.Nr.1407/18, i datës 02.04.2021, Vërtetohet.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura në afat ligjor në Gjykatë Supreme, parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës, shkeljes së të drejtës materiale dhe vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që të: aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës ATK Nr.69/2012, të datës 17.05.2012.

4. Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala paditëse.

5. Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditurës dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se: kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin kontestuese të paditurës Nr.69/2012, të datës 17.05.2012, është refuzuar si e pabazuar ankesa e tatimpaguesit NTP "A.A" me NRB:xxx, NRF:xxx, në mbështetje të nenit 136/a të Ligjit 02/L-028"Për Procedurat Administrative" në lidhje me nenin 89 paragrafin 2 të Ligjit Nr.03/L-222 "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat", dhe Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll, vërtetohen si të bazuara.

7. Kundër vendimit të lartcekur të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

8. Gjykata e shkallës së parë ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar vendimin e të paditurës. Gjykata e vlerëson si të paqëndrueshëm arsyetimin e Departamentit të Ankesave në vendimin kontestues për mos njohjen e mallit të asgjësuar

në vlerë 48,040.89€, si shpenzim i zbritshëm për qëllime tatimore me të vetmin argument sipas të paditurës se këtu paditësi nuk e ka njoftuar ATK-në së paku 10 ditë pune paraprakisht nga data e shkatërrimit të mallit duke iu referuar nenit 13 par.1 pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2009, gjithmonë derisa e njëjta pra këtu e paditura nuk e ka kontestuar vërtetësinë e dokumentacionit nga organi kompetent komunal i cili dëshmon se realisht ka ndodhur asgjësimi i mallit, dhe për arsye se pretendimi i paditësit nga ana tjetër është i bazuar dhe në referencë të saktë ligjore dhe atë dispozitën e nenit 12 të Ligjit Nr.03/L071 lidhur me nenin 17.9 të Ligjit Nr.2004/48, i aplikueshëm nga 01 Janar 2009, me të cilin dispozitë nuk parashihet fare njoftimi i ATK-së, por sipas kësaj dispozite mungesa e mallit duhet të dokumentohet me fakte të besueshme të lëshuara nga organet kompetente (e në këtë rast janë organet komunale - inspekcioni sanitar), në të cilën dispozitë thuhet: *"Mungesa e mallit (Mallrat e pa zhvlerësueshme). Prishja, shkatërrimi, djegia dhe humbjet tjera. Për përcaktimin e detyrimeve tatimore, në rastin e prishjes, shkatërrimit dhe djegies së mallit për tu pranuar si shpenzime të veprimtarisë ekonomike, tatimpaguesi mungesën e mallit kërkohet ta dokumentoj me fakte të besueshme të lëshuara nga organet kompetente. Nëse sipas kërkesës së ATK-së, tatimpaguesi nuk dokumenton mungesën e mallrave, atëherë mallrat e tjera konsiderohen si mallra të shitura".*

9. Gjykata nga citimi i dispozitës së mësipërme, neni 12 i Ligjit Nr.03/L-071 lidhur me nenin 17.9 të Ligjit Nr.2004/48, ka vlerësuar si të pakontestueshëm faktin se askund nuk është paraparë me asnjë dispozitë ligjore se për tu njohur vlera e mallit të asgjësuar si shpenzim i zbritshëm duhet të njoftohet edhe ATK-ja, dhe askund në Ligjin e theksuar si më lartë nuk shkruan se në atë rast nuk do të njihet dokumentacioni i lëshuar nga organi kompetent në këtë rast K.K. Prishtinë, nëse paraprakisht subjekti tatimor nuk e njofton ATK-në, tutje akti se këtu paditësi ka provuar përmes dokumentacionit të besueshëm të lëshuar nga organi kompetent komunal-Inspektorati Sanitar pranë Komunës së Prishtinës për asgjësimin e mallit, vërtetohet se a i ka përmbush të gjitha kushtet që dalin nga Ligji.

10. Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur, në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së, nenit 81.H të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit.

11. Në arsyetim të aktgjykimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Pretendimet ankimore të padituresë nga bazat ankimore të theksuara si më lartë si dhe pretendimet e tjera si në arsyetim të ankesës, kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara andaj kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

12. Pretendimin e të padituresë në ankesë se aktgjykimi i kontestuar ka krijuar situatë juridike të paqartë dhe kundërthënëse me vetveten, sepse gjykata edhe pse me aktgjykimin kontestues ka vendosur në mënyrë meritore duke obliguar ATK që t'ia njoh si shpenzim të zbritshëm periudhën tatimore TVSH 2009 mallin e asgjësuar sipas procesverbalit të datës 11.12.2009 në vlerë furnizuese prej 48,040.89€, nuk ka anuluar fare Njoftim Rivlerësimin. Kolegji i kësaj gjykate këtë pretendim e konsideron të pabazuar duke i sqaruar të padituresë se gjykata e shkallës së parë e shqyrton aktin administrativ përfundimtar të nxjerr në procedurë administrative, kjo bazuar në dispozitën e nenit 13 të LKA-së e cila parasheh *"Konflikti administrativ mund të fillojë*

vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë", andaj bazuar në këtë dispozitë ligjore gjykata e shkallës së parë nuk vlerëson ligjshmërinë e akteve fillestare administrative, mirëpo vetëm aktin administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë.

13. Ka shtuar se: Pretendimi tjetër i të paditurës se në bazë të UA 16/2009 neni 13 par.1 pika 1, tatimpaguesi është dashur ta njoftoj me shkrim ATK së paku 10 ditë punë nga data e shkatërrimit të mallit, për kolegjin e kësaj gjykate është i pabazuar për faktin se UA Nr. 16/2009, Për Zbatimin e Ligjit Nr. 2004/48, "Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L071, "Mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, duhet të jetë në harmoni me vet ligjin bazë, dhe assesi nuk mund të përmbaj kufizime shtesë e të cilat vetë ligji bazë që e implementon nuk i përcakton, tutje njoftimi ose mos njoftimi sipas par 1, nën par 1.1 të udhëzimit administrativ si më lartë nuk ka ndikuar në vërtetimin tjetër nga gjendja faktike e konstatuar nga organet kompetente komunale, sepse edhe kështu qëllimi i këtij udhëzimi administrativ, shkon drejtë asaj që të bëhet verifikimi se a ka ndodh asgjësimi i mallit me të vërtetë apo nuk ka ndodhur, ashtu siç përcaktohet qartë dhe saktë edhe në vet këtë Udhëzim dhe atë në pasuesin e dytë të paragrafit 4, të nenit 13, ku thuhet se: *"Dokumentacioni i përshkruar në këtë nen, do të konsiderohet i pranueshëm, përderisa ATK të ketë evidencë të dokumentuar që disa apo i gjithë dokumentacioni i ofruar është fals".*

14. Pra, mos lajmërimi i ATK-së në rastin konkret, nuk ka ndikuar në vërtetësinë e gjendjes faktike, tutje vet vetë e paditura ATK-së duke iu drejtuar Kuvendit Komuna siç e ka theksuar në raportet e kontrollit me Nr. 0537 të datës 10.01.2012 dhe 05.03.2012, në faqen 5, të tyre, ka konfirmuar vërtetësinë e gjithë dokumentacionit në rrugë zyrtare që në të vërtetë malli është asgjësuar nga organet kompetente, me çka nuk kontestohet besueshmëria e këtij dokumentacioni me të cilin provohet se asgjësimi i mallit ka ndodhur. Mbi këtë gjendje të fakteve Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson, se gjykata e shkallës së parë, drejtë kanë

vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-102, dhe të LKA-së, dhe nuk është cenuar e drejta dhe ligji në dëm të palës së paditur, pasi që me thëniet në ankesë aktgjykimi nuk vihet në dyshim, i njëjti vërtetohet si drejtë i bazuar në prova dhe ligj. Andaj, në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

II. Vlerësimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimit të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar të gjykatës së shkallës së dytë dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës, vlerëson se dhomat e shkallës së dytë kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditurës dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala e paditur në kërkesën e saj. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit.

2. Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës-Departamenti i Ankesave, Nr.69/2019 i datës 17.05.2012, nuk është vendim i drejtë dhe i ligjshëm. Gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë kanë vlerësuar se gjykatat e instancave më të ulëta drejtë kanë vlerësuar faktin se me asnjë dispozitë ligjore nuk është paraparë se për tu njohur vlera e mallit të asgjësuar si shpenzim i zbritshëm duhet të njoftohet edhe ATK-ja. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësi ka provuar përmes dokumentacionit të besueshëm të lëshuar nga organi kompetent komunal-Inspektorati Sanitar pranë Komunës së

Prishtinës për asgjësimin e mallit, nga i cili vërtetohet se ai i ka përmbush të gjitha kushtet që dalin nga Ligji.

3. Pretendimet e të paditurës të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, lidhur me shkeljen e së drejtës materiale, kolegji i refuzoj në tërësi të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, e paditura dhe gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë kanë zbatuar nenin 12 të Ligjit Nr.03/L-071 lidhur me nenin 17.9 të Ligjit Nr.2004/48. Edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, mos njohja e mallit të asgjësuar në vlerë 48,040.89€, si shpenzim i zbritshëm për qëllime tatimore me arsyetimin se këtu nuk e ka njoftuar ATK-në së paku 10 ditë pune paraprakisht nga data e shkatërrimit të mallit duke iu referuar nenit 13 par.1 pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2009, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm.

4. Gjykata shqyrtoj pretendimet e parashtruesit të kërkesës, por vlerësoj se të njëjtat janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për një vendosje ndryshe në këtë çështje nga çka kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë.

5. Gjykata nuk shqyrtoi pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pasur parasysh se, sipas dispozitës së nenit 24 paragraf 2 të LKA-së, përcaktohet se: *"Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes".*

6. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në

dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë. Nga gjendja si më lartë rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, LATP-së. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe me të drejtë kanë vlerësuar se është cenuar ligji në dëm të paditësit.

7. Nga arsyet e theksuara si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflikte Administrative, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa aktgjykimi i kontestuar është vërtetuar.

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës PA.Nr.01/2025, datë 20.03.2025

''Gjykata Supreme ka vlerësuar se neni 6 i Udhëzimit Administrativ Nr. 19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal është në kundërshtim me Ligjin për Emrin Personal, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kufizimet e vendosura në këtë nen janë të paarsyeshme dhe cenojnë të drejtën e individit për ndryshimin e emrit personal. Udhëzimi Administrativ tejkalon kompetencat ligjore dhe nuk përputhet me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi, F.M, më datë 16.01.2025, në Gjykatën Supreme, ka parashtruar padi me kërkesë për shfuqizimin e pjesshëm të aktit nënligjor normativ të padituresë, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), me seli në Prishtinë, përkatësisht nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.19/2015, për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, i publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 05.11.2015.

2. Paditësi, me padi, përgjatë seancës së shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga Gjykata Supreme, që të shpall të paligjshëm dhe të shfuqizoj nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.19/2015 (MPB), me arsyetimin se i njëjti është në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 02/L-118 për Emrin Personal, nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të miratuar nga Këshilli i Evropës dhe të zbatueshme drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

3. Gjykata me aktvendimin e datës 10.02.2025, ka njoftuar të padituren MPB, lidhur me padinë e ushtruar, pretendimet për paligjshmërinë e aktit normativ të kontestuar nga paditësi, si dhe detyrimin për paraqitjen e dosjes së plotë të procedurës administrative dhe të gjitha

dokumenteve që kanë të bëjnë me lëndën e çështjes. Gjithashtu, gjykata i ka informuar palët për të drejtat, detyrimet dhe pasojat juridike që lidhen me veprimet procedurale në këtë çështje të konfliktit administrativ, duke u dorëzuar një kopje të padisë, së bashku me provat përkatëse të bashkëngjitura nga paditësi.

4. Gjykata, pasi ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 20.03.2025, e ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ në pajtim me nenin 58 dhe 59 të LKA-së, në praninë e paditësit dhe në mungesë të përfaqësueses ligjore të paditurës-MD-Avokatura Shtetërore, të ftuar në mënyrë të rregullt.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata, duke shqyrtuar nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.19/2015, ka konstatuar se dispozitat e tij janë në kundërshtim me ligjin dhe me aktet më të larta juridike, përfshirë Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

2. Udhëzimi Administrativ, i kontestuar është i përfshirë, me shkeljen e të drejtave themelore të njeriut, ngase kufizimet e përcaktuara në nenin 6 të tij, cenojnë të drejtën individuale për vetë përcaktim dhe autonomi në zgjedhjen e emrit personal. Sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka efekt të drejtpërdrejtë, dhe çdo kufizim që ndikon në identitetin personal duhet të ketë një bazë të qartë kushtetuese dhe të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

3. Kolegji i gjykatës, pas shqyrtimit të kërkesës së paditësit mbi paligjshmërinë dhe shfuqizimin e nenit 6 të aktit nënligjor normativ të kontestuar, ka vlerësuar se kjo kërkesë është e bazuar për disa arsye: Sipas nenit 1 të Ligjit Nr. 02/L-118 për Emrin Personal, ky ligj rregullon kuptimin, përbërjen, procedurën dhe mënyrën e caktimit dhe përdorimit të emrit personal, si dhe kushtet për ndryshimin dhe korrigjimin e tij për qytetarët e Kosovës. Neni 17 i këtij ligji përcakton

procedurën për ndërrimin e emrit, ndërsa neni 18 specifikon pengesat për realizimin e këtij ndryshimi.

4. Në kundërshtim me këtë bazë ligjore, Udhëzimi Administrativ i kontestuar përcakton kritere dhe procedura për ndërrimin dhe korrigjimin e emrit, të cilat shtrëngojnë më tej rregullimin e bërë me ligj. Në veçanti, neni 6 i këtij Udhëzimi vendos kufizime të tepërta që nuk rrjedhin nga dispozitat e ligjit dhe që tejkalojnë kompetencat e një akti nënligjor.

5. Gjykata ka vlerësuar se këto kufizime të vendosura nga Udhëzimi Administrativ janë të pajustifikuara dhe nuk përmbushin kriterin e proporcionalitetit, duke ndikuar drejtpërdrejt në të drejtat qytetare për ndërrimin e emrit personal. Për këtë arsye, kërkesa e paditësit është vlerësuar si e themeltë.

6. Gjykata ka marrë parasysh edhe praktikat juridike në vende të ndryshme të Evropës, ku kufizime të tilla për ndryshimin e emrit nuk janë të pranueshme. Në këtë kontekst, është mbështetur edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila ka trajtuar raste të ngjashme.

7. Në çështjen Güzel Erdagöz kundër Turqisë (2008), GJEDNJ ka konstatuar se kufizimet mbi ndryshimin e emrit mund të përbëjnë shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), i cili garanton të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare (shih rastin: Güzel Erdagöz c. Turquie (Requête no 37483/02), 21 octobre 2008, i qasshëm në gjuhën frënge në linkun: https://hudoc.echr.coe.int.

8. Po ashtu, në çështjen Burghartz kundër Zvicrës (1994), Gjykata ka konfirmuar se emri i një personi përbën një element thelbësor të identitetit të tij personal dhe mbrohet nga neni 8 i KEDNJ-së (shih rastin: Burghartz v. Switzerland (Application no. 16213/90), 22 February 1994, i qasshëm në gjuhën angleze në linkun: https://hudoc.echr.coe.int.

9. Të dyja këto raste trajtojnë çështje thelbësore, duke konfirmuar të drejtën e individëve për të përcaktuar identitetin e tyre përmes emrit dhe duke vendosur një standard mbi mënyrën se si shtetet duhet të trajtojnë kërkesat për ndryshime në regjistrin civil. Jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) e ka theksuar këtë të drejtë si një aspekt kyç të identitetit personal. Këto vendime krijojnë një standard ndërkombëtar për trajtimin e këtyre çështjeve dhe kufizojnë ndërhyrjet shtetërore kur ato nuk janë të justifikuara nga një qëllim i ligjshëm dhe proporcional. Përmes këtyre rasteve, Gjykata ka riafirmuar rëndësinë e autonomisë personale dhe respektimit të identitetit si vlera të mbrojtura nga Konventa.

10. Gjykata thekson se të drejtat për të ndryshuar emrin duhet të jenë në përputhje me parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht me nenin 8 të Konventës, që garanton të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Gjykata vlerësoi se çdo kufizim mbi këto të drejta duhet të justifikohet nga një arsye e ligjshme dhe të jetë proporcional. Gjykata thekson se autoritetet publike duhet të respektojnë të drejtat e individëve për të mbajtur një identitet personal të cilin ata e konsiderojnë më të përshtatshëm për ta, duke përfshirë mundësinë për ndryshimin e emrit nëse ka arsye të arsyeshme.

11. Bazuar në këto arsye, Gjykata ka vlerësuar se neni 6 i Udhëzimit Administrativ Nr. 19/2015 është i paligjshëm dhe duhet të shfuqizohet, pasi aktet nënligjore mund të nxirren vetëm në pajtim me ligjin dhe për nevojat e zbatimit të tij. Në këtë rast, Udhëzimi Administrativ ka vendosur kufizime që nuk rrjedhin nga ligji, duke tejkaluar kompetencat e një akti nënligjor dhe duke u vendosur në kundërshtim me ligjet në fuqi në Kosovë si dhe me standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

12. Gjykata po ashtu konstaton se e paditura në këtë rast, përmes përfaqësueses ligjore të saj, nuk ka paraqitur dosjen e plotë të procedurës administrative dhe të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë

me lëndën e çështjes, siç ka pasur detyrim konform nenit 42 par.1 të LKA-së, për të mundur gjykata të shqyrtoj pretendimet e saj.

13. Vendimin që pala e paditur të ia kompensoj paditësit shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 101 paragraf 1 të LKA-së, dhe nenit 7 lidhur me numrin tarifor 6, pika h) dhe numrin tarifor 7 pika 1 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, si dhe nenit 12 pika 12 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 Për Unifikimin e Taksave Gjyqësore. Meqenëse lartësia e shpenzimeve të procedurës është përcaktuar me dispozitat e lartcekura, aprovimi i kërkesës përtej shumave të përcaktuara nuk do të ishte i drejtë dhe i ligjor.

14. Vendimin për publikimin e aktgjykimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, gjykata e mori konform nenit 70 paragraf 2 të LKA-së.

15. Për arsyet e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 10 paragraf 4, 11 paragraf 3, 59, 70 dhe 101 paragraf 1 të LKA-së, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin PA.Nr.01/2025, të datës 20.03.2025, ka vendosur që të aprovohet e themeltë kërkesëpadia e paditësit, F.M, paraqitur kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), me seli në Prishtinë dhe të shpallet i paligjshëm dhe shfuqizohet neni 6 i Udhëzimit Administrativ Nr.19/2015, për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, i nxjerrë nga Ministri - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), me seli në Prishtinë, i publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 05.11.2015, si dhe të detyrohet e paditura MPB, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurë.

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës
PA.Nr.02/2025, datë 16.04.2025

"Gjykata, pas shqyrtimit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së dispozitave përkatëse të Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, ka konstatuar se disa prej tyre janë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me legjislacionin në fuqi si dhe me standardet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat themelore të qytetarëve. Si rrjedhojë, Gjykata ka shpallur të paligjshme dispozitat përkatëse dhe ka vendosur shfuqizimin e tyre nga rendi juridik.

Në arsyetimin e saj, Gjykata ka theksuar se organet komunale, në ushtrimin e kompetencave të veta rregullative, janë të detyruara të respektojnë hierarkinë e akteve juridike, duke siguruar përputhshmërinë e akteve nënligjore me Kushtetutën dhe ligjet. Vendosja e rregullave që cenojnë barazinë e qytetarëve, proporcionalitetin në raport me të drejtat e tyre, apo që krijojnë kufizime të pajustifikuara në ushtrimin e lirive themelore, përbën shkelje të parimit të ligjshmërisë dhe të shtetit të së drejtës.

Gjykata gjithashtu ka vënë në dukje se Komuna ka obligim pozitiv të hartojë dhe zbatojë rregullore që mundësojnë një sistem të drejtë, transparent dhe të arsyeshëm të pagesës dhe përdorimit të parkingjeve publike, në përputhje me parimin e interesit të përgjithshëm, por pa cenuar në mënyrë disproporcionale të drejtat individuale të qytetarëve. Ky obligim buron si nga Kushtetuta, ashtu edhe nga instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në këtë kuptim, vendimi i Gjykatës jo vetëm që ka efektin e shfuqizimit të dispozitave të paligjshme, por imponon mbi organet komunale përgjegjësinë për të rishikuar kuadrin rregullator, duke siguruar që në të ardhmen aktet nënligjore të jenë të harmonizuara me standardet kushtetuese dhe ligjore, si dhe të garantojnë respektimin e barazisë, proporcionalitetit dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të qytetarëve".

I. Rrjedha e çështjes

1. Paditësja "Q..." përmes përfaqësuesit të autorizuar, më datë 10.03.2025, në këtë gjykatë, ka parashtruar padi me kërkesë për shfuqizimin e të aktit nënligjor normativ të padituës, Komuna e Prishtinës, përkatësisht të Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, e datës 21.12.2023, e nxjerrë nga e paditura Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, Rruga "UÇK", Nr.2 publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 26.12.2023.

2. Paditësja, me padi, përgjatë seancës së shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare ka pretenduar se rregullorja e kontestuar është në kundërshtim parimin e ligjshmërisë, që sipas paditëses paraqet një nga parimet themelore jo vetëm në të drejtën administrative, por edhe në atë kushtetuese, institucionet publike përfshirë këtu edhe komunat, duhet të sigurohen që aktet nënligjore të miratuara nga ana e tyre të jenë në përputhje të plotë me legjislacionin primar. Më tej paditësja thekson se domosdoshmërisht, kjo duhet të ndodh çdoherë kur me këto akte vendoset mbi të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të qytetarëve, të personave juridik ose të palëve tjera, në mënyrë që qytetarët të sigurohen që çdo e drejtë apo obligim që rrjedh nga vendimet e komunës është i bazuar dhe nuk cenon asnjë detyrim që shteti - komuna - ka në raport me ta. Por, në rastin konkret, sipas paditëses pala e Paditur ka miratuar Aktin e kontestuar në kundërshtim me këtë parim dhe me mangësi të shumta.

3. Paditësja po ashtu thekson se dispozitat kryesore të kësaj Rregulloreje bien në kundërshtim të plotë me Ligjin Nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, që ka qenë në fuqi në kohën kur është miratuar Rregullorja, Ligjit Nr. 08/L-186 për rregullat trafikut rrugor që është aktualisht në fuqi nga muaji prill 2024, Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, Ligjit Nr. 04/L-077, për marrëdhëniet e detyrimeve, Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjin Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Rregulloren për shërbimin e transportit me "Merimangë" në territorin e Komunës së Prishtinës,

Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative dhe kolizion me vetë dispozitat e tjera që përmban Akti i kontestuar.

4. Gjykata, në këtë çështje kontestuese, pasi ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 16.04.2025, e ka shqyrtuar në konflikt administrativ në pajtim me nenin 58 dhe 59 të LKA-së, në praninë e në praninë e përfaqësuesit të paditëses, përfaqësuesit të padituréss dhe përfaqësuesve të palës së tretë.

5. E paditura në përgjigje në padi ashtu në seancën në seancën shqyrtimit gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, ka theksuar se kjo çështje ka të bëjë me një nga projektet më madhore, që viteve të fundit është filluar në kryeqytetin e Republikës së Kosovës. Pra, kemi të bëjmë me një Rregullore për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës e datës 21.12.2023, ku qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i kushteve dhe kritereve të vend parkimeve publike dhe private, për caktimin e zonave, mënyrën e pagesës, çmimet dhe llojet e biletave për vend parkim, procedurën e paraparë për krijimin dhe operimin e parkingjeve private, mënyrën e shfrytëzimit të tyre dhe mbikëqyrjen për parkimin e automjeteve me gjithë territorin e Prishtinës. Kjo rregullore nga Komuna e Prishtinës është përcjellë në MAPL me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit r.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale. Sipas Ligji Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 81 Shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë, përcakton *"81.4 Autoriteti mbikëqyrës obligohet që të japë mendimin e tij për ligjshmërinë e çdo akti të regjistruar, brenda 15 ditësh nga pranimi i tij, në pajtim me procedurat e përmendura më lartë."* Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore dhe Infrastrukturës, (tutje MMPHI), jashtë afatit ligjor me datë 25.01.2024 pas shqyrtimit të përmbajtjes të kësaj Rregullore Nr.01-030/01-236535/23 datë 26.12.2023, janë përgjigjur se..."duke vlerësuar kompetencat e nivelit Qendror dhe Lokal që janë përcaktuara me legjislacionin në fuqi, si dhe bazë të vlerësimit profesional nga departamenti përkatës, kanë vlerësuar se rregullorja në fjalë është në pajtueshmëri me legjislacionin e lartcekur, gjegjësisht me nenin 7 të

Ligjit Nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor." (Shtojca I). Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal sipas shkresës 0-1007/4, jashtë afatit ligjor me datë 29.01.2024, kanë specifikuar se *"Duke u bazuar me nenin 3 të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të aktit të lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Drejtësisë si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë."*

6. Më tej e paditura thekson se bazë juridike për hartimin dhe paraqitjen e kësaj përgjigje është: Ligji Nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor. Gjithashtu, Komuna e Prishtinës ka mbajtur edhe diskutim publik me qytetaret të mbajtur me datë 13.04.2023, dhe me Ekstraktin e procesverbalit të mbajtur me datë 12.04.2023, lidhur me rregulloren e kontestuar. Po ashtu e paditura thekson se bazuar në Kërkesën e Paditësit, për shfuqizimin e Aktit nënligjor normativ që është objekt kontesti, argumentet dhe provat e paraqitura në këtë kërkesë, vërtetohet se, paditësi nuk është bazuar në asnjë provë të vetme materiale. Andaj e paditura i propozon kësaj gjykate që të refuzohet në tërësi kërkesa e paditëses, si e pa bazuar, ashtu që të mbetët në fuqi akti i kontestuar.

7. Pala e tretë, si në përgjigje në padi, ashtu në seancën në seancën shqyrtimit gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, ka theksuar se pala e tretë, ka krijuar rrjetë të menaxhimit të parkingjeve në qytetin e Prishtinës, me çka ka vendosur rregull në përdorimin e hapësirave publike të shfrytëzuara si parkingje si dhe hapësirave të përbashkëta të banorëve të Komunës së Prishtinës, në zona të ndryshme duke ju ndihmuar të njëjtëve që të kenë mundësi parkimin e veturave të tyre afër vendbanimit të tyre, pasi që në shumë pjesë të Prishtinës parkingjet e përbashkëta të banorëve rezident janë përdorur edhe nga persona që nuk janë rezident në ato zona dhe kështu duke i pamundësuar banorëve rezident të gjejnë parking për veturat e tyre. Gjithashtu, N.P.L. "P.P" ka siguruar edhe personave juridik qoftë privat ashtu edhe publik shërbimet e parkingjeve me çka ka zgjidhur

problemet e tyre lidhur me qasjen ne parkingjet ne territorin e Prishtinës. Sipas palës së tretë, pranon deri në 6 mijë pagesa të rregullta brenda një dite për parkingje në territorin e Komunës së Prishtinës, ndërsa përafërsisht 190, janë parkingje jo të rregullta e këto konsiderohen si jo të rregullta në momentin që të njëjtat nuk paguhen nga qytetarët për të cilat vendoset biletë 24 orëshe në veturë dhe i jepet bileta 24 orëshe e cila i mundëson të pajisurit, me të që në 24 orët e ardhshme të vendos veturën në të gjitha parkingjet që operon Ndërmarrja, pa pagesa shtesë. N.P.L. "P.P" nuk shqipton gjoba por lëshon bileta 24 orëshe për personat të cilët nuk kanë bërë parking të rregullt.

8. Më tej pala e tretë thekson se, operon në zonat ku parkingjet janë publike që janë pronësi e Komunës së Prishtinës, si dhe në zonat ku janë parkingjet e banimeve kolektive, përjashtimisht në zona të caktuara pasi që ka zona të cilat banorët e atyre vendbanimeve kolektive kanë refuzuar që të lejojnë operimin e Ndërmarrjes, para miratimit të Rregullores së re. Kërkojnë nga Gjykata, të shqyrtohet siguria juridike e palëve të tjera me mirëbesim që mund të penalizohen nga ky vendim, ngase anulimi i kësaj rregullore çoftë i pjesshëm çoftë i tërësishëm mund të ketë pasoja për punëtorët e kësaj Ndërmarrje, e të cilët mund të mbesin pa punë e që nuk janë të pakët. Gjithashtu edhe palëve kontraktuale me të cilat ndërmarrja ka arritur marrëveshje por edhe vet qytetarëve sidomos atyre rezident të cilëve do t'ju mohohet qasja në vend parkingjet e objekteve banesore, dhe do të shkatërrohet një Ndërmarrje fitimprurëse për Komunën e Prishtinës, e tërthorazi edhe për vetë qytetarët e Komunës së Prishtinës, të cilëve ato fitime të kësaj Ndërmarrje, mund t'ju kthehet në investime të ndryshme kapitale me të cilat do t'ju përmirësohej mirëqenia. I kanë propozuar kësaj gjykate që të refuzohet si e pabazuar, kërkesëpadia e paditëses, me të cilën ka kërkuar që të "anulohet akti nënligjor" respektivisht "Rregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës" e datës 26 dhjetor 2023.

9. Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 59 paragraf 8 të Ligjit Nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative, i publikuar në Gazetën

Zyrtare më datë 10.01.2024, dhe ka hyrë në fuqi më datë 10.01.2025 (më tutje: LKA), ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit normativ nënligjor në drejtim të thënieve në padi, thënieve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, për këto arsye:

10. Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Komuna e Prishtinës, ka nxjerr Rregulloren për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, e datës 21.12.2023, e publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 26.12.2023, e cili përcakton dhe rregullon kriteret dhe procedurat për menaxhimin e hapësirave që mund të shfrytëzohen si parkingje, të ndara në zona të ndryshme.

11. Aktin nënligjor normativ të kontestuar, e paditura Komuna e Prishtinës, e ka nxjerr duke u mbështetur në nenin 12, paragrafi 2, shkronja c, nenit 17, shkronja f, dhe të nenit 40, paragrafi 2, shkronja a të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 qershor 2008), të nenit 15, shkronja a dhe f të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/03 qershor 2008), të nenit 7, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.338/shtator 2016, Prishtinë) të nenit 7 të Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, si dhe nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja f, nenit 33, paragrafi 33.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, Nr. 01-110-391 e dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur të datës 21.12.2023.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata, pas shqyrtimit të Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, të datës 21.12.2023, në veçanti të nenit 1, që rregullon vetëm mënyrën e pagesës së parkingut dhe ndërlidhur me të edhe neni 14 dhe 15 i rregullores, konstaton se dispozitat e kësaj rregulloreje, në pjesën ku përcaktohet se pagesa kryhet vetëm *përmes telefonit***,** mënyra e

pagesës dhe biletat e rregullta të parkimit-orëshe dhe ditore, janë në kundërshtim me parimet e përgjithshme të së drejtës administrative, me normat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

2. Sipas nenit 5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative**,** një akt administrativ duhet të jetë i ligjshëm, i arsyeshëm dhe i drejtë. Aktet e nxjerra nga organet publike duhet të respektojnë parimin e proporcionalitetit, duke garantuar që masat e ndërmarra të jenë të domosdoshme dhe të përshtatshme për arritjen e qëllimit të synuar, duke mos i imponuar barrë të panevojshme qytetarëve. Në këtë rast, mënyra e vetme e pagesës përmes telefonit, e imponon një formë teknologjike të detyrueshme që nuk është e përballueshme për të gjithë qytetarët, përjashton ose vështirëson përdorimin e shërbimit për personat që nuk kanë numër lokal telefonik, është në disfavor për personat e moshuar dhe ata me aftësi të kufizuara teknologjike. Kjo cenon barazinë në qasje ndaj një shërbimi publik**,** që është parkingu publik, duke krijuar diskriminim të pashkruar ndërmjet përdoruesve të parkingut.

3. Në përputhje me nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*Barazia para Ligjit*), garantohen të drejta të barabarta dhe ndalim i çdo lloj diskriminimi, përfshirë diskriminimin në qasjen në shërbime publike. E drejta për qasjen e barabartë në shërbime publike, është e garantuar jo vetëm nga Kushtetuta, por edhe nga legjislacioni ligjorë e nënligjor dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

4. Prandaj Gjykata, vlerëson se përcaktimi i vetëm i një forme të teknologjisë digjitale si mjet ekskluziv për realizimin e pagesës, pa paraparë alternativa reale dhe të përfshira për të gjithë përdoruesit, përbën diskriminim të tërthortë, i cili është i ndaluar në mënyrë absolute, sipas dispozitës ligjore të lartcekur. Për më tepër, bazuar në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të zbatueshme në Republikën e Kosovës (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14, dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 9), organet publike janë të detyruara të sigurojnë që

qasja në shërbime publike të jetë universale, efektive dhe jo diskriminuese.

5. Gjykata vlerëson se Kufizimi i mënyrës së pagesës vetëm nëpërmjet telefonit nuk është i arsyetuar objektivisht, Nuk përmbush kërkesën e proporcionalitetit, pasi qëllimi i menaxhimit më efikas të parkingjeve mund të arrihet edhe me mjete më pak kufizuese, si pagesa në para të gatshme në vend parking, me kartelë bankare ose përmes automatikëve të vendosur publikisht. Mënyra e pagesës e përcaktuar si në rregullore, vendos një barrë të tepruar mbi qytetarët, në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës dhe respektimit të dinjitetit njerëzor.

6. Për më tepër, neni 41 paragrafi 1 i Kushtetutës, garanton të drejtën e çdo personi për qasje në shërbime publike të ofruara nga organet shtetërore ose komunale, pa asnjë diskriminim dhe në mënyrë efektive. Me këtë rregullore, duke kufizuar mënyrën e pagesës vetëm përmes telefonit celular, Komuna e Prishtinës ka krijuar pengesa jo të arsyeshme në përdorimin e një shërbimi publik**,** ka rrezikuar efektivitetin dhe gjithë përfshirjen në shërbimet publike, ka tejkaluar kompetencat e saj**,** duke vendosur kufizime që prekin të drejtat kushtetuese.

7. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**,** neni 9 (*Aksesueshmëria*) – Shtetet, janë të detyruara të sigurojnë qasje të barabartë dhe efektive në shërbimet publike për të gjitha kategoritë e personave, përfshirë edhe ata që kanë vështirësi në përdorimin e teknologjisë. Komuna-e paditura, duke mos paraparë alternativa të tjera të qasjes për pagesën, bie ndesh me këto standarde dhe për pasojë, akti i kontestuar është i paligjshëm.

8. Në këtë rast, mungesa e alternativave tjera të pagesës (si pagesa me para të gatshme, kartelë bankare, automat parkingu etj.) është proporcionale dhe shume e nevojshme**,** duke vendosur një mundësi me te lehtë te pagesës për qytetarët.

9. Për të gjitha arsyet e paraqitura më lart, Gjykata konstaton se neni 1 i Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve**,** në pjesën që përcakton mënyrën e pagesës (përmes telefonit) si dhe ndërlidhur me te edhe neni 14 dhe 15 të kësaj rregullore, janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës**,** në kundërshtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative**,** në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut**.**

10. Prandaj, kjo pjesë dispozitë duhet të shfuqizohet dhe obligohet Komuna e Prishtinës që, në kuadër të rregullores, të parashoh**ë** më shumë forma të pagesës, duke përfshirë të paktën edhe mundësinë e pagesës në para të gatshme dhe/ose përmes pajisjeve publike (automat parkingu) për të garantuar barazinë dhe qasjen e plotë për të gjithë qytetarët.

11. Bazuar në atë që u theksua më lart, Gjykata konstatoi se pjesa e dispozitës së kontestuar nuk mund të qëndron para kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, dhe si e tillë, duhet të anulohet, duke obliguar organin kompetent të ofrojë më shumë forma të qasëshme dhe gjithëpërfshirëse të pagesës, në përputhje me të drejtat e barabarta të të gjithë qytetarëve.

12. Gjykata, në shqyrtimin e ligjshmërisë së nenit 8 të Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, të datës 21.12.2023, ka konstatuar se pjesa e dispozitës që *lejon parkimin e vizitorëve në zonat rezidenciale, vetëm nga ora 16:00 deri në 18:00,* paraqet një kufizim joproporcional të së drejtës për qasje dhe lëvizje të lirë të qytetarëve, cenon të drejtën për takime dhe kontakte familjare e sociale, shkel parimet kushtetuese dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Gjithashtu, sipas nenit 36 të Kushtetutës (*E drejta privatësisë*), garantohen: *"Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera."*

13. Kufizimi i mundësisë për vizita familjare ose shoqërore vetëm brenda dy orëve e, cenon domosdoshmërisht, lirinë për të pasur kontakte familjare, lirinë e organizimit të jetës private, qëndrueshmërinë dhe natyrën normale të vizitave shoqërore ose familjare. Ashtu që një kufizim i tillë, në vend që të administrojë në mënyrë të drejtë përdorimin e hapësirave publike, në fakt imponon detyrim të panevojshme dhe cenon të drejta themelore**.**

14. Sipas nenit 55 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, çdo kufizim i të drejtave themelore duhet: *Të jetë i përcaktuar me ligj, të jetë i domosdoshëm në një shoqëri demokratike, të jetë proporcional me qëllimin që synohet të arrihet.*

15. Në këtë rast, megjithëse synimi i Komunës së Prishtinës, për të menaxhuar hapësirat e parkingut në zonat rezidenciale mund të jetë legjitim, mirëpo masa e kufizimit (vetëm dy orë) është jo proporcionale me nevojën reale për administrimin e rregulluar, shumë më kufizuese sesa do të kërkonte ndonjë rregullim efektiv i qarkullimit ose parkimit, dhe shumë e ndjeshme ndaj realiteteve të jetës sociale dhe familjare të qytetarëve të Kosovës.

16. Gjykata më tej konstaton se edhe në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës**,** e cila përcakton se konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut janë të aplikueshme drejtpërdrejt në sistemin tonë juridik, e veçanërisht, neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), (*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*) "*Çdo ndërhyrje në këtë të drejtë duhet të jetë e nevojshme dhe proporcionale*".

17. Gjithashtu kjo dispozitë e rregullores kontestuese bie ndesh edhe me nenin 2 të Protokolit 4 të KEDNJ-së,(*Edrejtaelirisësëlëvizjes)* "*Kufizimet në lëvizje duhet të jenë të bazuara në ligj dhe të arsyetuara nga një interes publik domethënës*".

18. Në këtë rast, kufizimi i mundësisë për qëndrim për vizitorët brenda vetëm dy orëve, në hapësirat banuese të të afërmeve të tyre, bie ndesh me parimet e mbrojtura me këto instrumente ndërkombëtare, sepse nuk është e justifikuar me një nevojë reale dhe të domosdoshme, përkundrazi është shumë më i ashpër sesa kërkon mbrojtja e rendit publik ose administrimi i hapësirave publike.

19. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata konstaton se: kufizimi i parashikuar në nenin 8 të Rregullores për parkingun e vizitorëve nga ora 16:00 deri në 18:00, është i paligjshëm dhe joproporcional**,** shkel të drejtën për jetën familjare dhe private dhe barazinë në qasjen në hapësira publike**,** nuk respekton parimin e proporcionalitetit dhe nevojës në një shoqëri demokratike**,** si dhe është në kundërshtim me Kushtetutën e R. Kosovës dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

20. Prandaj, akti normativ kontestues shpallet pjesërisht i paligjshëm dhe shfuqizohet pjesërisht neni 8 i Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, në pjesën që kufizon parkimin e vizitorëve vetëm në intervalin kohor 16:00-18:00.

21. Gjykata, në shqyrtimin e ligjshmërisë së nenit 12 paragrafi 1, të Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, të datës 21.12.2023, ka konstatuar se pjesa e dispozitës përveç shkeljes së dispozitave të së drejtës civile dhe të mbrojtjes së konsumatorëve, paragrafi i lartcekur, bie ndesh edhe me parimet dhe dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative të Republikës së Kosovës (Ligji Nr. 05/L-031) dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit. Sipas nenit 4 të LPPA-së, organet publike janë të detyruara të veprojnë në pajtim me parimin e ligjshmërisë, që nënkupton se çdo akt administrativ duhet të ketë bazë të qartë dhe të ligjshme në rregullimin e marrëdhënieve juridike. Meqë e paditura, duke nxjerrë këtë rregullore, ka përjashtuar përgjegjësinë e saj për sigurimin e automjeteve të qytetarëve, të cilëve u ofron shërbim kundrejt pagesës,

ajo ka vepruar në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë dhe parimin e proporcionalitetit të përcaktuar në nenin 5 të LPPA-së.

22. Në kuptim të parimit të proporcionalitetit, çdo kufizim i të drejtave dhe interesave të palëve duhet të jetë i arsyetuar, i domosdoshëm dhe në proporcion të drejtë me qëllimin që synohet të arrihet. Në këtë rast, përjashtimi total i përgjegjësisë nga ndërmarrja publike për dëmet eventuale, duke vazhduar të inkasojë tarifat e parkimit, përbën një kufizim të tepruar dhe të paarsyeshëm të të drejtave të konsumatorëve, i cili është në kundërshtim me këtë parim thelbësor administrativ.

23. Për më tepër, kjo dispozitë kontestuese bie ndesh edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), konkretisht me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 *për Mbrojtjen e Pronës, që garanton të drejtën e individit për të poseduar pasurinë e tij në mënyrë të sigurt dhe pa ndërhyrje të paarsyeshme nga autoritetet publike.* Përjashtimi total nga përgjegjësia për dëmet që prekin pronën e qytetarëve (veturat e parkuara) pa ndonjë mbrojtje efektive ose kompensim, cenon këtë të drejtë, duke lënë qytetarët pa mbrojtje efektive ndaj dëmeve të shkaktuara në hapësirat publike të menaxhuara nga autoritetet.

24. Në të njëjtën mënyrë dhe nivel të kundërligjshmërisë, rregullorja është në kundërshtim edhe me parimet e Kartës Sociale Evropiane, e cila, ndër të tjera, parasheh mbrojtjen e konsumatorëve dhe kërkon që shërbimet publike të jenë të sigurta dhe të mbështesin të drejtat themelore të qytetarëve në raport me shërbimet që ata marrin.

25. Kjo qasje është në harmoni edhe me standardet e përcaktuara në Direktivën 93/13/EEC të Këshillit të Bashkimit Evropian mbi klauzolat e padrejta në kontratat konsumatore, e cila ndalon që njëra palë (ofruesi i shërbimit) të përjashtojë ose kufizojë përgjegjësinë e saj për moskryerjen ose kryerjen e papërshtatshme të detyrimeve të kontratës.

26. Përfundimisht, duke qenë se neni 12 paragrafi 1, i rregullores kontestuese shkel këto standarde të brendshme dhe ndërkombëtare,

vendimi për ta shpallur paragrafin e lartcekur të paligjshëm dhe për ta shfuqizuar është i drejtë, i ligjshëm dhe i domosdoshëm për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve dhe për ruajtjen e rendit juridik.

27. Gjykata, në shqyrtimin e ligjshmërisë së nenit 12 paragrafi 9, të Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, të datës 21.12.2023, ashtu që pas shqyrtimit të rrethanave të çështjes dhe analizës ligjore të Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, Gjykata vlerëson se: paragrafi i lartcekur i kësaj rregulloreje është i paligjshëm dhe duhet të shfuqizohet, për arsyet se: shkelja e parimit të proporcionalitetit dhe mbrojtjes së konsumatorit sipas LPPA-së, konkretisht nenit 5 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që përcakton se: *çdo vendim administrativ dhe rregullore duhet të respektojë parimin e proporcionalitetit, që nënkupton se masat e ndërmarra nga organet publike nuk duhet të tejkalojnë atë që është e nevojshme për arritjen e qëllimit të ligjshëm dhe duhet të mbrojnë në mënyrë të drejtë të drejtat dhe interesat e qytetarëve*. Dispozita e kundërshtuar, e cila përjashton përgjegjësinë e ndërmarrjes për rimbursimin e klientëve në rast të gabimeve teknike gjatë pagesës, vendos barrë të padrejtë mbi konsumatorin, duke i mohuar atij të drejtën për kthimin e shumës së paguar gabimisht, edhe kur gabimi mund të jetë pasojë e ndonjë mangësie të sistemit të pagesës të ofruar nga vetë ndërmarrja publike. Një dispozitë e tillë është në disproporcion të qartë me të drejtat legjitime të shfrytëzuesve të shërbimit dhe për pasojë bie ndesh me kërkesat e ligjit për mbrojtje të drejtave të palëve në procedurë administrative.

28. Mungesa e transparencës dhe cenimi i barazisë në marrëdhëniet kontraktore,

    sipas nenit 9 të LPPA-së**,** parimi i administratës së hapur, e cila përcakton se: *organet publike duhet të veprojnë me transparencë dhe të garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët.* Përjashtimi i përgjegjësisë për rimbursim i ndërmarrjes publike është një devijim nga këto parime themelore, duke vendosur konsumatorët në pozitë të

pabarabartë dhe duke i privuar nga mbrojtja që duhet të kenë në rast të gabimeve të natyrshme dhe të parashikueshme gjatë proceseve teknike të pagesës.

29. Gjykata, vlerëson se edhe me standardet ndërkombëtare, mbrojtja e konsumatorëve, e dispozitës së kontestuar bie ndesh me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)**,** veçanërisht me nenin 1 të Protokollit Nr. 1, *që mbron të drejtën e individit për pronën*. Pagesa e bërë nga qytetari është pasuri e tij, dhe mohimi i të drejtës për rikthimin e shumës së paguar padrejtësisht pa një procedurë të drejtë përbën shkelje të kësaj të drejte. Për më tepër, dispozita është në kundërshtim me *Direktivën 93/13/EEC të Bashkimit Evropian për Klauzolat e Padrejta në Kontratat me Konsumatorët*, e cila ndalon që operatorët ekonomikë të vendosin kushte që në mënyrë të padrejtë dhe në mënyrë të njëanshme përjashtojnë përgjegjësinë e tyre në dëm të konsumatorëve. Sipas standardeve të përcaktuara në këtë direktivë dhe jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (si p.sh. çështja C-618/10 Banco Español de Crédito), *çdo term kontraktor ose rregullore që shkakton pabarazi të rëndësishme në dëm të konsumatorit konsiderohet i padrejtë dhe rrjedhimisht i pavlefshëm*.

30. Më tej Gjykata vlerëson se mbrojtja e interesit publik dhe garantimi i shërbimeve cilësore, i një ndërmarrje publike, që operon për ofrimin e shërbimeve publike esenciale si parkingjet, ka për detyrë jo vetëm të ofrojë hapësira për parkim, por edhe të garantojë një sistem të drejtë dhe funksional për pagesën e këtyre shërbimeve. Përjashtimi i përgjegjësisë në rast të gabimeve teknike që nuk përputhet me natyrën publike të këtij shërbimi, cenon rëndë interesin publik në cilësinë e ofrimit të shërbimeve komunale.

31. Për këto arsye e në bazë të gjithë këtyre rrethanave dhe normave të sipërcituara, Gjykata vlerëson se neni 12 paragrafi 9 i Rregullores, së kontestuar është në kundërshtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe me parimet e Konventës

Evropiane për të Drejtat e Njeriut, andaj shpallet paragrafi i lartë cekur i paligjshëm dhe shfuqizohet.

32. Gjykata, në shqyrtimin e ligjshmërisë së nenit 22 paragrafi 1, të Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, të datës 21.12.2023, vlerëson se paragrafi i lartcekur është paligjshëm dhe duhet të shfuqizohet**,** për këto arsye: kemi të bëjmë me shkeljen e parimit të proporcionalitetit dhe mosdiskriminit, të mbrojtjes së të drejtave themelore të qytetarëve sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), nenit 5 dhe 6, *çdo veprim i administratës publike duhet të jetë proporcional me qëllimin që synohet të arrihet dhe të mos tejkalojë atë që është e domosdoshme. Organi publik duhet të veprojë në pajtim me parimin e barazisë dhe mos diskriminimit*.

33. Vendosja e masës së bllokimit të automjetit vetëm për shkak të moskryerjes së pagesës brenda një periudhe prej vetëm 10 minutash nga momenti i parkimit është masë tejet e ashpër dhe jo proporcionale në raport me shkeljen e supozuar. Kjo dispozitë/paragraf nuk merr parasysh rrethanat objektive që mund të ndikojnë në vonesën e pagesës, siç janë: nevoja urgjente për të ndihmuar një person tjetër, probleme teknike në sistemin e pagesës, mungesë e informimit të qartë për mënyrën e pagesës ose ndonjë gjendje emergjente shëndetësore.

34. Masa ndëshkuese duhet të jetë proporcionale me shkeljen, dhe në këtë rast, gjoba administrative ose njoftimi për pagesë shtesë do të ishte shumë më e arsyeshme sesa kufizimi fizik i lëvizjes së qytetarëve përmes bllokimit të automjetit. Kjo paraqet cenim i të drejtës për lirinë e lëvizjes dhe të pronës private, Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane, për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), i cili mbron të drejtën për pronën private. Vendosja e bllokadës në automjet, në mungesë të një procedure të rregullt dhe për një mosveprim të vogël si vonesa në pagesë, cenon disproporcionalisht të drejtën e qytetarëve për të përdorur lirshëm pronën e tyre. Po ashtu, neni 2 i Protokollit Nr. 4 të KEDNJ, garanton lirinë e lëvizjes, gjë e cila kufizohet me marrjen e veprimeve të cilat ky nen kontestues i lejon. Bllokimi i automjetit

përbën një pengesë serioze për lirinë e qytetarëve për të lëvizur, veçanërisht kur nuk është vërtetuar se qytetari ka pasur një qëllim të keq ose ka refuzuar me qëllim të mos e kryej pagesën.

35. Për më tepër Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka theksuar që çdo ndërhyrje në pronën ose lirinë e lëvizjes duhet të jetë e bazuar në ligj, të ketë një qëllim legjitim dhe të jetë proporcionale me synimin që kërkohet të arrihet.(Rasti Sporrong and Lönnroth v. Sëeden, 1982).

36. Shkelja e parimit të së drejtës për trajtim të drejtë dhe të barabartë (LPPA dhe KEDNJ) Neni 6 i LPPA-së, kërkon që çdo organ publik të garantojë trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjitha palët në procedurë. Bllokimi automatik i automjetit pas 10 minutash pa vlerësim individual të rrethanave përbën një qasje mekanike dhe jo të drejtë ndaj qytetarëve. Nuk është vlerësuar mundësia që personi i parkuar mund të ketë bërë përpjekje për të kryer pagesën, por mund të jetë penguar për arsye objektive ose të pavarura nga vullneti i tij.

37. Dispozita- paragrafi i kontestuar nuk parashikon ndonjë mundësi që qytetari të paraqesë ndonjë ankesë ose të kërkojë rishqyrtim para se të merren masa drastike si bllokimi i automjetit. Kjo përbën shkelje të nenit 13 të KEDNJ-së, që garanton të drejtën për mjet juridik efektiv për çdo person që pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij.

38. Në bazë të parimeve të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative**,** Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe standardeve të tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e pronës dhe të lirisë së lëvizjes, Gjykata vlerëson se neni 22 paragrafi 1 i Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës e kontestuar, është në kundërshtim me rendin juridik të brendshëm dhe ndërkombëtar, andaj shpallet i paligjshëm dhe shfuqizohet paragrafi i lartcekur.

39. Gjykata, pas shqyrtimit të nenit 22 paragrafi 8 të Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së

Prishtinës, të datës 21.12.2023, vlerëson se kjo dispozitë është pjesërisht e paligjshme dhe duhet të shfuqizohet, për arsyet në vijim: Kjo përbën cenim të parimit të ligjshmërisë dhe kompetencës së përcaktuar me ligj, sipas nenit 4 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA, Ligji Nr. 05/L-031) dhe nenit 16 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës. Në këtë rast, ndërmarrja publike N.P.L. "P.P" SH.A, si palë e tretë në këtë procedurë gjyqësore, duke pretenduar të bllokojë automjetet, të lëshojë bileta për parkim në zona të palicencuara ("vendparkingje ilegale"), si dhe të marrë masa ndëshkimore si bartja/zhvendosja e mjeteve, ushtron kompetenca që sipas ligjeve në fuqi u përkasin vetëm organeve të rendit publik dhe autoriteteve të trafikut, siç janë Policia e Kosovës dhe inspektoratet kompetente të Komunës, dhe jo një ndërmarrjeje publike komerciale.

40. Në këtë mënyrë, N.P.L. "P.P" , ka tejkaluar kompetencat e veta të ligjshme, duke vepruar jashtë mandatit të saj statutor dhe ligjor. Shkelja e parimit të ndarjes së pushteteve dhe të mbrojtjes së të drejtave themelore Neni 7 dhe neni 31 i Kushtetutës së Kosovës garantojnë të drejtën për procedurë të drejtë dhe ndalojnë marrjen e masave ndëshkimore pa vendim të një autoriteti të pavarur dhe kompetent. Masa të tilla ndëshkimore si: bllokimi, bartja dhe zhvendosja e automjeteve mund të ndërmerren vetëm pas respektimit të procedurave të ligjshme dhe jo në mënyrë të njëanshme nga një ndërmarrje publike, që nuk ka status autoriteti ndëshkues dhe kompetent për të marrë këto veprime të kundërligjshme.

41. E gjithë kjo vjen si pasojë e mungesës së një vendimi administrativ të bazuar në ligj dhe të drejtës së ankesës për qytetarët kundër atij vendimi, e në rastin konkret masa të tilla të marra nga pala e tretë, shkelin të drejtën për qasje në drejtësi dhe mbrojtjen e pronës private. Cenimi i të drejtës së pronës dhe lirisë së lëvizjes (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut - KEDNJ). Sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, çdo person ka të drejtë të gëzojë pa ndërhyrje pronën e tij. Masa e bllokimit dhe zhvendosjes së veturës pa bazë ligjore të qartë

përbën ndërhyrje arbitrare në pronën private të qytetarëve. Gjithashtu, neni 2 i Protokollit Nr. 4 të KEDNJ, garanton lirinë e lëvizjes, e cila cenohen rëndë kur qytetarit i pamundësohet përdorimi i automjetit të tij pa një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë.

42. Këto standarde janë konfirmuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku ndërhyrjet në të drejtën e pronës dhe lirisë së lëvizjes duhet të jenë: të parashikuara me ligj, të kenë një qëllim legjitim, dhe të jenë proporcionale me synimin që kërkohet të arrihet. (rastin "Iatridis v. Greece", 1999 dhe "Sporrong and Lönnroth v. Sëeden", 1982).

43. Mungesa e bazës ligjore për "gjoba" dhe ndërhyrje në "vendparkingje ilegale" Sipas Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor (Ligji Nr. 08/L-186) dhe rregulloreve komunale, vetëm Policia e Kosovës dhe inspektoratet komunale kanë kompetencë të konstatojnë kundërvajtjet dhe të vendosin masa ndëshkuese. Një ndërmarrje publike, si N.P.L. "P.P", nuk mund të marrë vetë iniciativa për të penalizuar qytetarët për parkim të paligjshëm, veçanërisht në hapësira që vetë rregullorja i njeh si të pa licencuara, pa një vendim të qartë të autoriteteve kompetente. Në të kundërt, kjo bie ndesh me parimet e ligjshmërisë dhe sigurisë juridike.

44. Në përputhje me parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, si dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata vlerëson se neni 22 paragrafi 8 i Rregullores së Komunës së Prishtinës është i paligjshëm dhe duhet të shfuqizohet, për arsye se: ndërmarrja publike ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore, masat e parashikuara cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve në mënyrë të pajustifikueshme dhe joproporcionale dhe nuk ka bazë ligjore të qartë për veprime ndëshkuese në vendparkingje të palicencuara.

45. Gjykata, në shqyrtimin e ligjshmërisë së Nenit 22 paragrafi 9 i Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të

Komunës së Prishtinës përcakton që për bllokimin, debllokimin dhe bartjen/zhvendosjen e mjeteve vlen Rregullorja për shërbimin e transportit me "Merimangë" në territorin e Komunës së Prishtinës, si dhe rregullon mënyrën e vendosjes së mjeteve në autopark. Megjithatë, gjykata vlerëson se kjo dispozitë është pjesërisht e paligjshme për arsye si në vijim: Tejkalimi i kompetencave të përcaktuara me ligj, Në bazë të nenit 4 dhe nenit 5 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031)**,** një autoritet publik, përfshirë edhe ndërmarrjet publike, mund të ushtrojë kompetenca vetëm nëse ato jan**ë** shprehimisht të përcaktuara me ligj**.** Bllokimi, debllokimi dhe bartja e automjeteve janë veprime të cilat kufizojnë të drejtën e pronës dhe të lirisë së lëvizjes së qytetarëve, prandaj ato mund të realizohen vetëm nga organet kompetente**,** si: Policia e Kosovës (bazuar në Ligjin për Rregullat e Trafikut Rrugor, Nr. 08/L-186), ose nga inspektoratet komunale të autorizuara në mënyrë eksplicite me akt ligjor ose nënligjor. Një ndërmarrje publike që operon mbi bazë të interesit ekonomik nuk mund të ushtrojë në mënyrë të njëanshme kompetenca të natyrës ndëshkimore ose të kufizojë lirinë dhe pronën e qytetarëve, në mungesë të një autorizimi të saktë dhe të qartë ligjor. Rregullorja e vitit 2010 ("Rregullorja për shërbimin e transportit me Merimangë") nuk mund të shërbejë si bazë autonome për të deleguar masa ndëshkimore një ndërmarrjeje publike, sidomos pa një akt ligjor të nivelit më të lartë që përcakton qartë kushtet, procedurën dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve.

46. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 46 garanton *të drejtën e pronës private dhe ndalon ndërhyrjet arbitrare*. Neni 35 i Kushtetutës garanton *lirinë e lëvizjes*. Po ashtu, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në: Neni 1 i Protokollit Nr. 1 garanton *mbrojtjen e pronës*. Neni 2 i Protokollit Nr. 4 garanton *të drejtën për liri të lëvizjes*. Andaj bazuar në këto dispozita ligjore vendosja e bllokadave, bllokimi dhe zhvendosja e automjeteve, pa një procedurë të qartë administrative, pa njoftim efektiv dhe pa mundësi reale ankimimi, përbëjnë shkelje të këtyre të drejtave themelore. Çdo kufizim i të drejtës në pronë dhe liri të lëvizjes duhet të jetë: i parashikuar me ligj**,** i nevojshëm në një shoqëri demokratik**e**, proporcional me synimin që

kërkohet të arrihet (shih rastin **"**James and Others v. United Kingdom" dhe "Sporrong and Lönnroth v. Sweden"**)**.

47. Në këtë rast, bllokimi arbitrar i automjetit nga një ndërmarrje publike, pa bazë të qartë ligjore dhe pa procedurë garantuese, është masë jo proporcionale dhe në kundërshtim me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare.

48. Parimi i sigurisë juridike kërkon që qytetarët të kenë mundësi të parashikojnë me saktësi të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe pasojat juridike të veprimeve ose mosveprimeve të tyre.

49. Në këtë rast, rregullorja lë hapësirë të paqartë se cilat automjete mund të bllokohen, në çfarë rastesh, kush e merr vendimin për një masë të tillë dhe cilat janë mjetet juridike të mbrojtjes për qytetarët.

50. Pa një akt formal dhe vendim administrativ individual, për secilën masë ndëshkimore, kjo procedurë është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, siç është i mbrojtur me Ligjin për procedurë e Përgjithshme Administrative, me Kushtetutën e R. Kosovës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*e drejta për proces të rregullt gjyqësorë*).

51. Andaj duke u bazuar në: Kushtetutën e Republikës së Kosovës**,** Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative**,** Ligjin për Rregullat e Trafikut Rrugor**,** si dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjykata vlerëson se neni 22 paragrafi 9 i Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, është i paligjshëm dhe duhet të shfuqizohet, pasi qe tejkalon kompetencat e ndërmarrjes publike, cenon të drejtat themelore të qytetarëve për pronë dhe liri të lëvizjes, nuk respekton standardet e sigurisë juridike dhe të proporcionalitetit të masave ndëshkuese administrative.

52. Gjykata, lidhur me pjesën refuzuese të kërkesës së paditëse është bazuar nenin 70 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, Gjykata deklaron paligjshmërinë dhe shfuqizimin e plotë apo të

pjesshëm të aktit nënligjor normativ i cili është në kundërshtim me ligjin. Në këtë rast, paditësja nuk ka ofruar prova të mjaftueshme ose argumente juridike që e vërtetojnë se e gjithë Rregullorja për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën ose me ligjin. Gjykata ka shqyrtuar dispozitat individuale të rregullores dhe ka konstatuar se vetëm disa nene specifike janë të paligjshme, ndërsa pjesa tjetër e rregullores është në përputhje me Kushtetutën, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Parkingjeve Publike, dhe normat e tjera përkatëse juridike në vend. Prandaj, nuk ka bazë ligjore për shfuqizimin e rregullores në tërësi. Andaj, në përputhje me nenin 5 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ndërhyrja e gjykatës duhet të jetë proporcionale dhe të fokusohet vetëm në ato dispozita që vërtet shkelin të drejtat ose parimet ligjore dhe kushtetuese. Gjykata nuk mund të shfuqizojë tërësisht një akt nënligjor nëse paligjshmëria është e shprehur vetëm pjesërisht dhe e kufizuar në disa dispozita. Shfuqizimi total do të përbënte një ndërhyrje të tepërt në kompetencat dhe diskrecionin e pushtetit lokal dhe do të binte ndesh me parimin e ndërhyrjes minimale, të garantuar me Kushtetutë dhe me ligjet përkatëse. Prandaj, është bërë shfuqizimi vetëm i dispozitave të kontestuara dhe të paligjshme, ndërsa pjesa tjetër e rregullores mbetet në fuqi.

53. Duke u bazuar në neni 319 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, I cili përcakton se: *Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*, gjithashtu neni 322 par.2, *Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër,* si dhe neni 322 par. 3, *Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër,* andaj nga këto dispozita ligjore del se në procedurë gjyqësore çdo palë ka për detyrë të vërtetojë pretendimet e saj dhe të ofrojë prova bindëse që mbështesin kërkesën.

54. Gjithashtu edhe sipas Ligjit për Konfliktet Administrative, në nenin 51, *Përgjegjësitë për vërtetimin e fakteve dhe barra e provës* , paragrafi 1, *Gjykata ka përgjegjësinë përfundimtare që sipas detyrës zyrtare, të qartësojë të gjitha faktet e nevojshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Gjykata nuk kufizohet në faktet e paraqitura nga palët*. Në par.2, parashihet se *Gjykata mund të përdorë çdo mjet prove të parashikuar nga ligji përkatës për procedurën gjyqësore civile pa asnjë kufizim*,në paragrafin 3, përcaktohet se *Palët kanë detyrimin të bashkëpunojnë në paraqitjen e fakteve dhe marrjen e provave që janë në disponimin e tyre*.

55. Në rastin konkret, Paditësja ka kërkuar shfuqizimin në tërësi të rregullores së kontestuar me padi, mirëpo përveç pretendimeve të përgjithshme, nuk ka paraqitur prova të sakta, konkrete dhe juridikisht të qëndrueshme që dëshmojnë: kundërligjshmërinë e secilës dispozitë të rregullores, ose ndikimin e saj të paligjshëm ndaj të drejtave të saj ose interesave të ligjshme. Mungesa e provave të mjaftueshme e bën të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë, duke imponuar refuzimin e saj në përputhje me normat procedurale.

56. Në bazë të Ligjit për Konfliktin Administrativ **,** Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe duke respektuar parimet themelore të drejtave të njeriut dhe të sigurisë juridike, gjykata vlerëson se pjesa tjetër e kërkesëpadisë, përtej dispozitave të shfuqizuara si në pikat -II-, , -III-, -IV- dhe -V-, të dispozitvit të këtij aktvendimi, pjesa tjetër e kërkesë padisë, refuzohet si e pabazuar**,** pasi nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shfuqizimin e rregullores në tërësi.

57. Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 450**,** në lidhje me nenet 463 dhe 465 paragrafi 2, të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës (Nr. 03/L-006). Në bazë të nenit 450 të LPK-së**,** në kontestet civile palët kanë të drejtë të kërkojnë nga gjykata kompensimin e shpenzimeve të procedurës në përputhje me parimin e suksesit në kontest, ku pala që humb kontestin në parim obligohet të kompensojë palën fituese për shpenzimet e nevojshme të procedurës. Gjithashtu,

sipas nenit 463 të LPK-së, kërkesa për kompensimin e shpenzimeve duhet të bëhet nga pala gjatë procedurës ose jo më vonë se në përfundim të shqyrtimit kryesor, respektivisht në përfundim të seancës së shqyrtimit para gjykatës. Në këtë rast konkret: As paditësi dhe as paditura nuk kanë paraqitur kërkesë të veçantë për kompensimin e shpenzimeve të procedurës. Sipas nenit 465 paragrafi 2 të LPK-së, në mungesë të një kërkese të tillë, gjykata nuk mund të vendosë për kompensimin e shpenzimeve "ex officio". Prandaj, duke marrë parasysh mungesën e kërkesës për kompensim të shpenzimeve dhe duke respektuar parimin e dispozicionit të palëve në këtë procedurë, gjykata vendosi që secila palë t'i bartë vetë shpenzimet e veta procedurale.

58. Lidhur me publikimin e aktgjykimit, gjykata vendosi në përputhje me nenin 70 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrativ. Në bazë të këtij neni, i cili përcakton se: *Aktgjykimi i arsyetuar dhe pasi ka marrë formë të prerë, publikohet në të njëjtën mënyrë në të cilën është publikuar vetë akti, për efekt të hyrjes në fuqi*. Bazuar në këtë dispozitë ligjore gjykata vendosi si në pikën VIII, të dispozitivit. Në rastin konkret Aktgjykimi, trajton çështje me rëndësi të veçantë publike që lidhen me të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve në raport me një ndërmarrje publike dhe autoritetin komunal, çështja prek të drejtën për shërbime publike të barabarta dhe efektive si dhe garantimin e trajtimit të drejtë administrativ**,** të mbrojtura nga legjislacioni vendor dhe nga standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Publikimi i aktgjykimit kontribuon në transparencën e punës së gjykatës**,** në forcimin e parimit të sigurisë juridike, si dhe në udhëzimin e autoriteteve publike dhe qytetarëve lidhur me të drejtën dhe praktikën administrative. Duke pasur parasysh këto rrethana dhe në funksion të interesit publik, gjykata vlerësoi se është e nevojshme që ky aktgjykim të bëhet i qasshëm për publikun, me respektim të plotë të dispozitave që garantojnë anonimitetin kur është e nevojshme, në pajtim të plotë me kërkesat ligjore të aplikueshme dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve, konform nenit 70 paragrafi 2 të LKA-së, dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**.**

59. Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 10 paragraf 4, neni 11 paragrafi 3, neni 59, neni 70 të LKA-së, ka aprovuar pjesërisht si të themeltë kërkesëpadinë e paditëses, ka shpallur pjesërisht të paligjshëm dhe ka shfuqizuar: pjesërisht neni 1 - vetëm në pjesën që ka të bëjë më *mënyrën e pagesës, si dhe neni 14 dhe 15 i kësaj rregullore*, neni 8 - vetëm në pjesën që ka të bëjë me *parking të vizitorëve, në hapësirat rezidenciale*, i cili parkim nga vizitorët nuk mund të jetë më herët se ora 16:00 dhe më vonë se ora 18:00, neni 12 paragrafët 1 dhe 9, neni 22 paragrafët 1, 8 dhe 9 të Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, e datës 21.12.2023, e nxjerrë nga e paditura Komuna e Prishtinës, të publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 26.12.2023.

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës
P.A.Nr.07/2025, datë 10.06.2025

"Gjykata ka vendosur të shfuqizojë Rregulloren Nr. 01/2025 të nxjerrë nga Autoriteti i Aviacionit Civil, duke konstatuar se ajo është miratuar në kundërshtim me parimet dhe normat e rendit juridik. Në arsyetimin e saj, Gjykata ka vlerësuar se ushtruesi i detyrës së këtij autoriteti ka tejkaluar kompetencat e përcaktuara me ligj, duke vepruar jashtë kufijve të autorizimeve të dhëna me aktin themelor rregullues.

Gjithashtu, është konstatuar se procesi i miratimit të kësaj rregulloreje nuk ka respektuar procedurat e detyrueshme të konsultimit publik, transparencës dhe pjesëmarrjes së palëve të interesuara, të cilat përbëjnë një garanci themelore për legjitimitetin e akteve nënligjore. Mungesa e këtyre procedurave ka ndikuar në cenimin e sigurisë juridike dhe të besimit të ligjshëm të punonjësve dhe qytetarëve.

Në aspektin material, Gjykata ka gjetur se rregullorja ka shkaktuar ndryshime të padrejta dhe të paarsyeshme në pozitën juridike të punonjësve të Autoritetit të Aviacionit Civil, duke krijuar diskriminim dhe trajtim të pabarabartë në kundërshtim me parimin e barazisë para ligjit. Si e tillë, ajo cenon parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe mbrojtjes së të drejtave të fituara.

Për pasojë, Gjykata ka vendosur shfuqizimin e Rregullores Nr. 01/2025, duke i rikujtuar Autoritetit të Aviacionit Civil se ushtrimi i kompetencave rregullative duhet të jetë gjithmonë në përputhje me ligjin, Kushtetutën dhe standardet e qeverisjes së mirë, duke respektuar transparencën, konsultimin dhe barazinë e qytetarëve dhe punonjësve të prekur".

I. Rrjedha e çështjes

1. Paditësit A.I, L.K-B, B.U, M.L, L.I, E.H, përmes të autorizuarit të tyre më datë 28.02.2025, në Gjykatën Supreme, kanë parashtruar padi për shfuqizimin e të aktit nënligjor normativ - Rregullores (AAC) Nr.01/2025, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (AAC)

Nr.02/2024 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, me kërkesën për caktimin e masës së posaçme/të përkohshme të sigurimit, të nënshkruar më datë 27 janar 2025, dhe në fuqi 7 (shtatë) ditë pas nënshkrimit të saj, të nxjerrë nga i padituri Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AAC).

2. Paditësit, me padi, përgjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, kanë kërkuar nga Gjykata Supreme që të shpallë të paligjshëm dhe të shfuqizojë në tërësi Rregulloren (AAC) Nr. 01/2025, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (AAC) Nr. 02/2024 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Gjatë deklarimit, i autorizuari i paditësve ka theksuar se akti i kontestuar karakterizohet nga të meta të mëdha materiale dhe substanciale, të cilat e vënë atë në shpërputhje të plotë me ligjin në fuqi, me parimet themelore të ligjit për zyrtarët publikë, me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, si dhe me aktin themelor të karakterit nënligjor Nr. 06/2024 për Parimet e Organizimit dhe Funksionimit të Shërbimit Civil. Ai ka shtuar se nuk është kontestuese që paditësit, në bazë të nenit 6 të LZP-së, janë zyrtarë apo nëpunës me status të veçantë dhe se akti i kontestuar paraqet, në thelb, shpërputhje të plotë me detyrimin që rrjedh nga aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve nënligjore, sikurse në rastin konkret (Rregullorja e IML-së). Ky akt, pavarësisht se është miratuar në mbështetje të një baze ligjore të paracaktuar, në përmbajtjen e tij tejkalon kufijtë e përcaktuar në Ligjin për AAC dhe, për rrjedhojë, në mënyrë të paligjshme dhe në kundërshtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, zëvendëson pjesërisht rregullimet ligjore dhe krijon rregulla të reja. Se akti i kontestuar prodhon pasoja të drejtpërdrejta që cenojnë interesin juridik të paditësve, është dëshmuar me provën shtesë të datës 30 prill 2025, e cila ka të bashkëngjitur Raportin Përfundimtar të Komisionit për Ristrukturimin e Pozitave në AAC, si dhe me provat shtesë të dërguara në këtë gjykatë më 08.05.2025, të cilat lidhen ekskluzivisht me

ndërrimin e pozitave të punës së paditësve, vendime që cenojnë në mënyrë substanciale interesat e tyre.

3. Në vazhdim, ka shtuar se shkeljet dhe efektet e këtyre shkeljeve janë detajuar si në parashtresën e dorëzuar në seancë, dhe përfshijnë: 1) Klasifikimin e gabuar të inspektorëve në Grupin 16, në kundërshtim me Rregulloren QRK Nr. 06/2024, që ka shkaktuar dëm të drejtpërdrejtë në statusin dhe akt emërimet e tyre, si dhe ka pamundësuar rekrutimin e inxhinierëve të elektroteknikës – kërkesë e domosdoshme nga ICAO; 2) Shkeljen e procedurës për përshkrimin e pozitave të punës, në kundërshtim me nenin 21 të Rregullores QRK Nr. 06/2024, e cila cenon vlefshmërinë e përshkrimeve dhe procesin e klasifikimit duke e privuar stafin nga informacioni dhe pjesëmarrja; 3) Ndryshimet e shpeshta të Rregullores brenda 9 muajsh, që kanë shërbyer për të legalizuar përfitime personale dhe avancime të paracaktuara të anëtarëve të grupeve punuese në AAC, duke dëmtuar transparencën dhe drejtësinë në proces; 4) Vendimet për sistematizim dhe përbërja e grupeve punuese, të cilat janë përdorur si mjet për përfitime personale dhe manipulime në dëm të ligjshmërisë, transparencës dhe interesit publik; 5) Efektet negative të klasifikimit të inspektorëve të AAC-së në kategorinë "profesionale" në vend të asaj të "specialistit", me qëllim që të mundësohet transferimi i stafit administrativ në pozita kyçe të aviacionit, duke cenuar profesionalizmin dhe sigurinë e institucionit, në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret përkatëse; 6) Ndikimin financiar, pasi Rregullorja e re parashikon krijimin e pozitave të reja me kosto të konsiderueshme financiare, ndërsa raporti zyrtar e mohon këtë ndikim, duke ngritur dyshime për moszbatim të parimit kushtetues të barazisë në pagë dhe për keqinformim të organeve përkatëse; dhe 7) Cenimin e sigurisë së aviacionit në Republikën e Kosovës, për shkak se zbatimi i rregullores u jep kompetenca mbikëqyrëse personelit administrativ joprofesional dhe pamundëson rekrutimin e profesionistëve të kualifikuar, duke cenuar funksionin kyç të AAC-së në përputhje me standardet ndërkombëtare.

4. Lidhur me pretendimet e të padituerës, të theksuara si në përgjigjen në padi, i autorizuari i paditësve ka shtuar se të njëjtat i kundërshton në tërësi, pasi në përmbajtjen e saj ngrihet çështja e kompetencës së AAC-së për nxjerrjen e një rregulloreje të tillë, mirëpo kjo nuk është kontestuese nga ana e paditësve. Për më tepër, përgjigjja në padi nuk trajton asnjërën nga pretendimet e paditësve, andaj kërkohet nga gjykata që të njëjtën ta refuzojë si të pabazuar. Nuk qëndron deklarimi i përfaqësuesit të autorizuar të të padituerës në lidhje me këto çështje. E para, procesi i hartimit të aktit të kontestuar: ky akt është hartuar në shpërputhje të plotë dhe në mënyrë shqetësuese me ligjin në fuqi për nismat legjislative si dhe me Rregulloren Nr. 05/2016 për standardet minimale në procesin e konsultimit publik. Akti i kontestuar nuk është dërguar asnjëherë për konsultim publik. Së dyti, lidhur me mos ndryshimin e pozitave: me provat e dorëzuara bashkë me parashtresën e datës 08 maj 2025, provohet fakti se tashmë të gjithë paditësve u është ndërruar pozita, duke u degraduar, ashtu siç përcaktohet në dispozitivin e parë të vendimit përkatës. Së treti, lidhur me pretendimin për shtimin e pozitave, kjo nuk qëndron, ashtu siç është theksuar edhe në pikën 14 të padisë; në kundërshtim me Rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil, me aktin e kontestuar, në shtojcat 1 dhe 2 të tij, janë shuar tri pozita, gjë që ka rezultuar jo vetëm me cenim të të drejtave nga marrëdhënia e punës, por edhe në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe ligjore si pjesë e të drejtës në pronë, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.

5. Sa i përket trajtimit të zyrtarëve teknikë të aviacionit, akti i kontestuar është në shpërputhje të plotë me Ligjin për AAC, duke bërë rregullime dhe përcaktime përtej asaj që parashikohet në këtë ligj. Argumentohet se *"zyrtarët teknikë të aviacionit"* nuk kanë kuptimin e njëjtë me *"personelin teknik të aviacionit",* siç përcaktohet në përkufizimet e ligjit për AAC. Së fundi, sa i përket nenit 35 të LZP-së, sipas paragrafëve 5 dhe 6 të këtij neni, ekziston detyrimi që ushtrimi i pozitës të mos zgjat më shumë se një vit, në të kundërtën, çdo vendim i zyrtarit që ushtron atë pozitë është i paligjshëm. Meqenëse AAC, siç është dëshmuar me prova, po udhëhiqet nga një ushtrues detyre, edhe nxjerrja e aktit të kontestuar është, për pasojë, e paligjshme. Andaj

konsiderojmë se ky akt përbën bazë të mjaftueshme që kjo gjykatë, në mënyrë *prima facie*, ta shfuqizojë pa pasur nevojë të analizohet më tej në lidhje me pretendimet tjera të ngritura me padi, sepse "ushtrimi i pozitës", për qëllime të interpretimit të paragrafëve 5 dhe 6 të nenit 35 të LZP-së, është i lidhur me pozitën dhe jo me personin. Fakti që persona të ndryshëm janë caktuar si ushtrues detyre nuk e legjitimon paligjshmërinë e përkufizuar me këtë nen në raport me aktet që ata kanë nxjerrë. Për këto arsye, është kërkuar nga gjykata që padia dhe kërkesëpadia e paditësve të aprovohen në tërësi si të bazuara.

6. E paditura, si në përgjigjen në padi, ashtu edhe gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, ka theksuar se nuk ka vepruar në mënyrë të njëanshme apo në kundërshtim me ligjin, por në bashkëpunim të plotë institucional dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Sipas saj, është marrë miratimi paraprak nga institucioni përgjegjës - MPB - si dhe opinioni ligjor për ndikimet buxhetore, dhe nuk ka pasur ndryshim të pozitave. Lidhur me pretendimet që lidhen me nenin 5.3 të Rregullores, bazuar në numrin e punonjësve, ato nuk qëndrojnë dhe nuk cenojnë vlefshmërinë e aktit. Sa i përket supozimeve të paditësve për degradim të pozitave kyçe, e paditura thekson se ato nuk qëndrojnë, pasi ndryshimet e bëra përmes Rregullores 01/2025 ndaj rregullores bazë 02/2024 janë minimale, kanë për qëllim shtimin e një pozite të re dhe harmonizimin me katalogun e vendeve të punës, si dhe funksionalizimin më të mirë të punës së institucionit. Ajo thekson se nuk është shtuar asnjë pozitë në kundërshtim me ligjin dhe se rregullorja kontestuese nuk trajton sistemin individual të zyrtarëve, por vetëm organizimin e brendshëm të institucionit, dhe kjo është pjesë e një procesi formal të ristrukturimit që zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Përshkrimi i detyrave të punës, kërkesat profesionale dhe përgjegjësitë për secilën pozitë janë, sipas saj, harmonizuar plotësisht me kornizën ligjore që rregullon fushën e aviacionit civil. Rregullorja nuk ka për qëllim rregullimin e statusit ligjor të nëpunësve me status të veçantë, pasi kjo çështje rregullohet me ligjin bazë.

7. Përshkrimi funksional i pozitave të *"zyrtarëve teknikë"* ose *"personelit teknik"* nuk krijon status të ri, nuk cenon të drejtat ekzistuese dhe nuk është në kundërshtim me ligjin. Ligji për AAC dhe LZP mundësojnë përcaktime të tilla për klasifikimin e brendshëm pa ndryshuar statusin juridik të pozitave. Lidhur me pretendimet për klasifikim të gabuar të pozitave teknike në kategorinë *"profesionale 1",* e paditura i konsideron të pasakta, duke argumentuar se kjo klasë është përcaktuar në përputhje me faktorët e vlerësimit sipas Rregullores Nr. 06/2024 dhe duke marrë parasysh kompleksitetin e detyrës, nivelin e pavarësisë në vendimmarrje dhe ndikimin e përgjegjësisë. Ajo shton se ky klasifikim është miratuar nga organet përkatëse dhe nuk ka asnjë provë se është bërë në mënyrë të gabuar apo arbitrare. Gjatë procesit të ekuivalencimit të pozitave në AAC, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i ka klasifikuar të gjithë drejtorët e departamenteve si udhëheqës të divizioneve, me arsyetimin se njësitë përkatëse ishin emërtuar si *"departamente"* në përputhje me Ligjin për Organizimin e Administratës Shtetërore, por në praktikë kanë funksionuar si divizione dhe nuk plotësonin kriteret ligjore për të pasur statusin e një departamenti. Lidhur me pretendimet se ushtruesi i detyrës së drejtorit është i kundërligjshëm, e paditura e kundërshton këtë, duke theksuar se drejtori, edhe në cilësinë e ushtruesit të detyrës, ka detyra të përcaktuara me ligj dhe është përgjegjës për AAC, dhe se çdo veprim apo vendim i tij është i mbështetur në kompetenca dhe autorizime të plota ligjore.

8. Bazuar në të gjitha këto, është kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia të refuzohet në tërësi si e pabazuar dhe që rregullorja kontestuese të mbetet në fuqi. Sipas Rregullores 01/2020 të Qeverisë, përcaktohen hapat që duhet të ndërmerren për nxjerrjen e rregulloreve të brendshme në institucion, por nuk parashikohet që këto rregullore të dalin në konsultim publik; andaj deklarimi i paditësve lidhur me mungesën e publikimit konsiderohet i paqëndrueshëm. E paditura thekson gjithashtu se ushtruesi i detyrës, i cili kontestohet nga paditësit, jo vetëm që ka nënshkruar rregulloren, por edhe vazhdimisht aprovon trajnime dhe kërkesa të tjera në të mirë të AAC-së dhe të vetë

paditësve, të cilët janë avancuar – konkretisht, dy prej tyre, L. dhe H. – nga i njëjti ushtrues detyre.

9. Lidhur me pretendimet e paditësve, ka deklaruar se pretendimi i tyre se akti i kontestuar është miratuar në kundërshtim me nenin 35 të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe se ushtruesi i detyrës ka tejkaluar afatin ligjor për ushtrimin e funksionit të Drejtorit të Përgjithshëm është i pabazuar. Ushtruesi i detyrës ka vepruar në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, dhe mandati i tij është zgjatur në mënyrë të rregullt përmes dy vendimeve të veçanta të Ministrit kompetent për periudha të njëpasnjëshme prej gjashtë muajsh, duke qëndruar brenda kufijve kohorë të lejuar sipas nenit 35, paragrafi 3, të ligjit përkatës. Ky legjitimitet është konfirmuar edhe nga KPMSHC me vendimin Nr. 1787/2024, datë 21.03.2025. Sipas nenit 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ushtruesi i detyrës është i autorizuar ligjërisht për të ushtruar funksionet dhe për të marrë vendime në cilësinë e titullarit të institucionit, prandaj çdo pretendim për paligjshmërinë e vendimit për shkak të mungesës së autoritetit ligjor të tij është i paqëndrueshëm dhe bie ndesh me realitetin juridik dhe faktik. Nëse do të pranohej ky pretendim, atëherë do të duhej të shpallej i paligjshëm funksionimi i tërë institucionit gjatë kësaj periudhe, gjë që do të ishte një precedent absurd me pasoja të rënda për sigurinë e aviacionit civil. Në bazë të kësaj, vendimi Nr. 62/2024 dhe nënshkrimi i Rregullores Nr. 01/2025 janë të ligjshëm dhe të marrë në përputhje me autorizimet dhe dispozitat ligjore në fuqi.

10. Pretendimi se akti i kontestuar ka tejkaluar përcaktimet e Ligjit për Aviacionin Civil, përmes kategorizimit të ri në nenin 4A për *"zyrtarë teknikë të aviacionit",* është gjithashtu i pabazuar. Në aspektin gjuhësor, termi *"personel"* përfshin të gjithë punonjësit që kryejnë veprimtari të njëjta në një institucion, pa krijuar kategori juridike apo status të veçantë ligjor. Ligji për Zyrtarët Publik rregullon statusin juridik të punonjësve në institucionet publike, dhe termi *"zyrtar publik"* përdoret në mënyrë konsistente për të përfshirë edhe punonjësit e shërbimit civil në AAC. Neni 4A i aktit të kontestuar nuk krijon ndarje të re hierarkike apo funksionale, por synon përshkrimin

më të qartë të pozitave teknike dhe harmonizimin me kërkesat ligjore. Ky nen nuk ndryshon statusin ekzistues të zyrtarëve, nuk cenon të drejtat e tyre dhe nuk ka efekt degradues. Ndryshimet janë të domosdoshme për harmonizim institucional dhe garantimin e sigurisë në aviacionin civil. Pretendimi për mungesën e tri pozitave në katalog nuk qëndron, pasi AAC ka vepruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme për shtimin e pozitave. Mos përditësimi i nenit 5.3 për numrin total të punonjësve është çështje teknike që mund të rregullohet me një akt pasues korrigjues, pa ndikuar në ligjshmërinë e aktit. Pretendimet për *"ndryshime të mëdha në strukturë"* dhe *"degradim të pozitave kyçe"* janë të paargumentuara dhe nuk mbështeten në analiza konkrete. Ndryshimet e bëra në rregullore janë minimale dhe të justifikuara për funksionalitet dhe harmonizim ligjor.

11. Statusi i zyrtarëve me status të veçantë nuk ndryshohet nga ky akt, dhe përshkrimi i pozicioneve si *"zyrtar teknik"* nuk krijon status të ri dhe nuk cenon të drejtat ligjore. Klasifikimi i pozitave teknike në kategorinë *"Profesional 1"* është bërë në përputhje me kriteret ligjore dhe nuk ka prova që ky klasifikim është bërë në mënyrë të gabuar apo arbitrare. Të gjitha pretendimet e paditësve janë të pabazuara si në aspektin formal, ashtu edhe në përmbajtje. Akti i kontestuar është në përputhje me Ligjin për Aviacionin Civil, Ligjin për Zyrtarët Publik dhe me rregulloret përkatëse për klasifikimin e vendeve të punës. Miratimi i këtij akti është bërë në përputhje me të gjithë hapat ligjorë dhe në bashkëpunim institucional me autoritetet kompetente. Në përfundim, ka propozuar që gjykata të refuzojë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve dhe të lërë në fuqi rregulloren kontestuese.

12. Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 59 paragraf 8 të Ligjit Nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative, i publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 10.01.2024, i cili ka hyrë në fuqi më datë 10.01.2025 (më tutje: LKA), ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit normativ nënligjor në drejtim të thënieve në padi, thënieve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është bazuar, për këto arsye:

13. Nga shkresat e lëndës rezulton se i padituri Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AAC), me seli në Prishtinë, më datë 27 janar 2025 ka nxjerrë Rregulloren (AAC) Nr.01/2025 për ndryshimin dhe korrigjimin e Rregullores (AAC) Nr.02/2024 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.

14. Aktin nënligjor normativ të kontestuar e ka nxjerrë në mbështetje të paragrafëve 14.1, 14.2, 15, 23 dhe 24.1 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura; nenit 24, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura; Ligjit Nr. 08/L-197 për zyrtarët publik; nenit 15.1 të Rregullores (AAC) Nr. 02/2024 mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, siç është ndryshuar dhe korrigjuar me Rregulloren (AAC) Nr. 04/2024 (më tutje Rregullorja (AAC) Nr. 02/2024 me ndryshime); Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në institucionet e administratës shtetërore dhe agjencitë e pavarura; Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil; si dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 08/226, datë 23.10.2024.

15. Qëllimi i kësaj Rregulloreje sipas nenit 1 të saj është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores (AAC) Nr. 02/2024 mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, me ndryshime: Shtimi i Nenit 4 A - Specifikat e Zyrtarëve të AAC-së; Ndryshimet në Nenin 5 të Rregullores (AAC) Nr. 02/2024; Ndryshimet në Nenin 6 të Rregullores (AAC) Nr. 02/2024; Shtimi i Nenit 13 A; Ndryshimet në Nenin 14 të Rregullores (AAC) Nr. 02/2024, 1.Shtojca 1 e Rregullores (AAC) Nr. 02/2024, siç është ndryshuar dhe korrigjuar me Rregulloren (AAC) Nr. 04/2024, zëvendësohet me Shtojcën 1 të kësaj Rregullore,

2. Shtojca 2 *"Organogrami"* e Rregullores (AAC) Nr. 02/2024, siç është ndryshuar dhe korrigjuar me Rregulloren (AAC) Nr. 04/2024 zëvendësohet me Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Rregullorja (AAC) Nr. 04/2024 për ndryshimin dhe korrigjimin e Rregullores (AAC) Nr. 02/2024 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit të saj.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Pas shqyrtimit të Rregullores, Gjykata konstaton se dispozitat e saj bien ndesh me parimet themelore të së drejtës administrative, normat kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

2. Gjykata vlerëson se paditësit, në përputhje me nenin 25, paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), kanë legjitimitetin dhe autorizimin ligjor për të ngritur para gjykatës çështjen e kontrollit të ligjshmërisë së aktit nënligjor normativ. Kjo dispozitë parashikon që çdo palë e interesuar mund të kërkojë shqyrtimin e përputhshmërisë së një akti nënligjor normativ me normat ligjore dhe, në rast të gjetjes së shkeljeve, të kërkojë shfuqizimin e plotë ose të pjesshëm të tij. Në këtë kontekst, paditësit janë të autorizuar që të kërkojnë nga gjykata që të konstatojë nëse akti nënligjor i kontestuar është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nëse ai respekton normat kushtetuese dhe ligjore, duke garantuar kështu mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre ligjore.

3. Gjykata vlerëson se palët ndërgjyqëse theksin e argumentimeve kryesore të tyre e mbështesin në këto pretendime: Pretendimet e paditësve: i) Rregullorja Nr.01/2025 është e paligjshme dhe duhet të shfuqizohet në tërësi. ii) Akti ka të meta materiale dhe substanciale dhe është në kundërshtim me ligjet në fuqi, përfshirë Ligjin për Zyrtarët Publik (LZP), aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese dhe aktin nënligjor Nr.06/2024. iii) Rregullorja tejkalon bazën ligjore të Ligjit për AAC

dhe krijon rregulla të reja që zëvendësojnë ligjin në mënyrë të paligjshme. iv) Rregullorja ka prodhuar pasoja të drejtpërdrejta që cenojnë interesat juridike të paditësve, duke ndryshuar pozitat e tyre dhe duke i degraduar. v) Procesi i miratimit të rregullores nuk është përmbushur si duhet, përfshirë mungesën e konsultimeve publike. vi) Klasifikimi i gabuar i inspektorëve dhe zyrtarëve teknikë, duke cenuar profesionalizmin dhe sigurinë në AAC. vii) Ndryshimet kanë krijuar pozita të reja me kosto financiare të konsiderueshme, duke cenuar parimin e barazisë në paga dhe duke rrezikuar sigurinë në aviacion, te cilat edhe sipas gjykatës janë te bazuara dhe qëndrojnë ne raportin aktual te krijuar me këtë akt kontestues.

4. Kundër pretendimet e palës paditëse: i) Rregullorja është miratuar në përputhje me ligjin dhe procedurat, me miratimin paraprak nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe me opinion ligjor për ndikimet buxhetore. ii) Ndryshimet në rregullore janë minimale dhe kanë për qëllim vetëm harmonizimin dhe funksionalizimin e institucionit. iii) Pozitat nuk janë ndryshuar në mënyrë të padrejtë dhe nuk ka asnjë degradim të padrejtë të stafit. iv) Klasifikimi i pozicioneve është bërë sipas kritereve ligjore dhe të miratuara nga autoritetet kompetente. v) Pretendimet për ushtruesin e detyrës janë të pabazuara pasi ai ka autoritet ligjor dhe mandat të zgjatur ligjërisht. vi) Rregullorja nuk krijon kategori të reja juridike apo status të ri për zyrtarët teknikë të aviacionit. vii) Nuk ka shkelje në procedurën e konsultimit publik, sepse rregulloret e brendshme nuk parashikojnë konsultim publik. viii) Ndryshimet nuk cenojnë statusin ligjor të punonjësve dhe nuk kanë karakter degradues.

5. Paditësit theksojnë se Rregullorja AAC Nr.01/2025 është e paligjshme për vetë faktin se është miratuar nga një ushtrues i detyrës në kundërshtim me nenin 35 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht me paragrafin 4 dhe 5 të tij. Sipas nenit 35, paragraf *"3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) mujor, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë",* paragraf 4, *"Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet*

me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. Ndërsa paragraf *5. "Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm".* Nga kjo dispozitë rrjedh qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë.

6. Në rastin konkret, është fakt i dokumentuar dhe i pa kontestuar që pozita udhëheqëse e AAC-së është mbajtur në mënyrë të vazhdueshme nga ushtrues detyre për një periudhë më të gjatë se një vit, pa u bërë emërim i rregullt, dhe për më tepër, rregullorja e kontestuar është nxjerrë pikërisht gjatë kësaj periudhe të tejkaluar. Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra, ndërrimi i personit nuk e ndërpret dhe nuk e rifillon afatin gjashtë mujor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi institucionale në udhëheqjen publike.

7. Prandaj, Rregullorja AAC Nr.01/2025, si akt i nxjerrë jashtë kufijve ligjorë të kompetencës, është i paligjshëm *"ab initio"* dhe duhet të shfuqizohet në bazë të kritereve të qarta të parashtruara në nenin 35 të LZP-së, pa qenë e domosdoshme të shqyrtohen të gjitha aspektet e tjera të padisë. Pra, Gjykata konstaton se: pretendimet e palës paditëse për tejkalim afati janë të bazuara në dispozitat eksplicite ligjore dhe kanë për qëllim mbrojtjen e legjitimitetit të aktit dhe sigurinë juridike në funksionimin e institucionit. Respektimi i kufizimeve kohore është thelbësor për funksionimin ligjor dhe transparent të institucioneve publike. Çdo shkelje e këtyre normave sjell pasoja negative në zbatimin e drejtë të ligjit dhe mund të krijojë precedentë të dëmshëm. Kështu, pretendimet e palës paditëse gjejnë mbështetje në parimet e ligjshmërisë dhe rendit kushtetues, te cilat i mbështet dhe i konstaton edhe gjykata.

8. E paditura në pretendimet e saj ka mbështetur pikëpamjen se nuk ka shkelje në procedurën e konsultimit publik, sepse rregulloret e brendshme nuk parashikojnë konsultim publik dhe për më tepër lidhur me klasifikimin kanë marrë miratimin paraprak të MPB-së. Në këtë drejtim, në analizë të aktit të hartuar nga i padituri për këtë qëllim, Gjykata konstaton se ai nuk përmban të dhëna ose informacione në funksion të konsultimit publik të rregullores, përpara miratimit të saj. Lidhur me këtë pretendim gjykata mbështet qëndrimin se aktet nënligjore që kanë karakter normativ ndonëse mund të mos kërkohet shprehimisht me ligj, duhet që të kalojnë në konsultim publik përpara miratimit, përkatësisht të njëjtat duhet ti nënshtrohen konsultimit me palët e interesuara sidomos nëse ato ndikojnë drejtpërdrejt mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve të ndryshme, përkatësisht në rastin konkret paditësve kur është ndryshuar pozita e tyre e punës.

9. Ndonëse me ligjin për aviacionin civil nuk është përcaktuar në mënyrë shprehimore një situatë e tillë, në frymën e dispozitave të këtij ligji përkatësisht të nenit 7 (Prioritetet e Ministrisë - MTPT) të Ligjit Nr. 03/L-051 Për Aviacionin Civil, është përcaktuar se: 7.1 Gjatë zbatimit të këtij ligji, Ministri duhet: (ii) të avancojë interesin publik përmes, ndër tjera: d) zhvillimit dhe mbajtjes së një sistemi rregullativ të shëndoshë dhe transparent, i cili u përgjigjet nevojave të publikut. Tutje, Neni 15 (Kompetencat dhe përgjegjësitë) e AAC: 1. AAC është përgjegjëse për: i) shpërndarjen e informatave për publikun rreth çështjeve relevante mbi funksionet dhe aktivitetet e AAC, andaj në mbështetje edhe të këtyre dispozitave ligjore mund të konstatohet se edhe fryma e ligjit mbështet pjesëmarrjen publike dhe transparencën përfshirë aktivitetet e aviacionit, përkitazi me hartimin e akteve nënligjore juridike.

10. Rregullorja mbi organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, rregullon çështje substanciale ngase prek interesat ligjore dhe pozitën e paditësve, dhe i njëjti përbën akt nënligjor për zbatimin e ligjit, dhe si e tillë duhet të i nënshtrohet konsultimit. Interpretimi kufizues i konsultimit publik nga i padituri është në kundërshtim me frymën e ligjit dhe standardet evropiane për

transparencën. Mosrespektimi i detyrimit për konsultim publik bie ndesh me dispozitat ligjore dhe me parimet e transparencës dhe pjesëmarrjes publike në procesin e nxjerrjes së akteve që rregullojnë çështje me interes të palëve të interesuara/prekura. Andaj, Gjykata konstaton se rregullorja është miratuar në kundërshtim me parimet e shtetit të së drejtës, transparencës dhe pjesëmarrjes publike.

11. Neni 6 i Ligjit Nr. Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përcakton qartë që zyrtarët e Agjencisë së Aviacionit Civil janë pjesë e kategorisë së nëpunësve civil me status të veçantë dhe, si të tillë, kanë një status juridik të veçantë dhe të mbrojtur ligjërisht. Çdo ndryshim apo kategorizim i ri që cenon këtë status pa bazë ligjore ose pa procedurë të qartë ligjore, do të jetë në kundërshtim me këtë dispozitë dhe do të cenojë të drejtat e këtyre zyrtarëve. Në këtë mënyrë, pretendimet që ndryshimet e rregullores nuk respektojnë këtë status janë të bazuara në dispozitat ligjore dhe mbrojnë legjitimitetin e pozitave dhe statusit ligjor të zyrtarëve teknikë të AAC-së. Për më tepër, parimet kushtetuese të Republikës së Kosovës, konkretisht neni 24, përfshinë të drejtën për trajtim të barabartë, përfshirë edhe vendin e punës.

12. Pozitat të cilat përfshijnë funksione të mbikëqyrjes, kontrollit teknik dhe zbatimit të standardeve të sigurisë së aviacionit, dhe që kërkojnë kualifikime profesionale dhe përvojë të specializuar në fushën e aviacionit civil duhet të klasifikohen në kategorinë *"specialist",* në përputhje me standardet ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO). Klasifikimi jo i drejtë i tyre nuk mund të ketë efekte negative në pagë, avancim dhe status profesional, dhe të mos cenoj të drejtën për trajtim të barabartë apo shkelje të parimeve të Ligjit për Zyrtarët Publik. Ndryshimi i kategorisë ndikon edhe në cilësinë e shërbimit publik dhe sigurinë në aviacionin civil, pasi pozita nuk e reflekton profesionalizmin e nevojshëm për zyrtarë shtetërorë. Klasifikimi i gabuar shkel normat ligjore dhe rregullatore që përcaktojnë kategorizimin sipas nivelit të specializimit dhe përgjegjësive. Ky klasifikim cenon të drejtat dhe interesat legjitime të zyrtarëve dhe komprometon funksionimin profesional dhe sigurinë në Autoritetin e Aviacionit Civil.

13. Gjykata ka kufizuar shqyrtimin vetëm në pretendimet që lidhen me paligjshmërinë e aktit normativ nënligjor, pasi shqyrtimi i akteve administrative/vendimeve, i takon kompetencës së një gjykate tjetër, konkretisht Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, e cila, sipas nenit 10, paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative, ka kompetencën për shqyrtimin dhe vendosjen si gjykatë e shkallës së parë mbi paditë në konflikt administrativ, duke përfshirë edhe paditë deklarative.

14. Gjykata nuk i ka shqyrtuar pretendimet tjera, ngase pretendimet e lartpërmendura ishin thelbësore për aprovimin e kërkesëpadisë së paditësve. Duke u bazuar në paligjshmërinë e Rregullores AAC Nr.01/2025, e cila prek drejtpërdrejt legjitimitetin e aktit, Gjykata ka konstatuar se shqyrtimi i pretendimeve të tjera nuk është i nevojshëm për vendimmarrje mbi kërkesën.

15. Sa i përket shpenzimeve të procedurës, Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 463 të LPK-së. Meqenëse paditësja nuk ka specifikuar shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

16. Lidhur me publikimin e aktgjykimit, gjykata vendosi në përputhje me nenin 70 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrativ. Në bazë të këtij neni, i cili përcakton se: *Aktgjykimi i arsyetuar dhe pasi ka marrë formë të prerë, publikohet në të njëjtën mënyrë në të cilën është publikuar vetë akti, për efekt të hyrjes në fuqi*. Bazuar në këtë dispozitë ligjore gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Publikimi i aktgjykimit kontribuon në transparencën e punës së gjykatës**,** në forcimin e parimit të sigurisë juridike, si dhe në udhëzimin e autoriteteve publike dhe qytetarëve lidhur me të drejtën dhe praktikën administrative. Andaj, gjykata vlerësoi se është e nevojshme që ky aktgjykim të bëhet i qasshëm për publikun, në mënyrën e njëjtë të publikimit të aktit nënligjor normativ për efekt të hyrjes në fuqi, konform nenit 70 paragrafi 2 të LKA-së.

17. Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 10 paragraf 4, neni 11 paragrafi 3, neni 59, neni 70 të LKA-së, ka aprovuar të bazuar kërkesëpadinë e paditësve: A.I, L.K-B, B.U, M.L, L.I, E.H, ka shpallur të paligjshme dhe ka shfuqizuar Rregulloren (AAC) Nr.01/2025, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (AAC) Nr.02/2024 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 27 janar 2025.

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës
P.A.Nr.08/2025, datë 14.07.2025

’’Gjykata Supreme ka vendosur se dispozitat e nenit 21, paragrafi 2 dhe nënparagrafët 2.1 dhe 2.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2025, të cilat parashikojnë përshkallëzimin e subvencioneve për sipërfaqet mbi 100 hektarë në sektorin e vreshtarisë, janë të paligjshme. Në mungesë të ndonjë analize të qartë, të argumentuar dhe të dokumentuar nga ana e të padituërs, që do të justifikonte trajtimin e diferencuar të subvencionimit për sipërfaqet mbi 100 hektarë, gjykata vlerëson se përshkallëzimi i tillë rezulton në një trajtim selektiv dhe për pasojë diskriminues ndaj paditësit, në kundërshtim me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit në trajtimin e subjekteve të së njëjtës kategori.’’

I. Rrjedha e çështjes

1. Paditësja “S.V & W” Sh.p.k, me seli në fshatin ... K..., më datë 06.05.2025, në këtë gjykatë ka parashtruar padi për shfuqizimin e dispozitave ligjore të nenit 21 par.2, nën par. 2.1 dhe 2.2, të aktit nënligjor normativ të padituërs, përkatësisht Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.04/2025 për Pagesat Direkte në Bujqësi për Vitin 2025, i publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 19.03.2025, (tutje: akti i kontestuar).

2. Paditësja pretendon se ky nen cenon nenet 24 dhe 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenin 1 të Protokollit Nr.12 të kësaj konvente, pasi përjashton nga përfitimi i plotë paditësen, për shkak të sipërfaqes së madhësisë së pronës, duke vendosur një standard të padrejtë dhe diskriminues që prek vetëm një subjekt të veçantë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe selektive. Paditësi arsyeton se dispozita që kërkohet të shfuqizohet parashikon që subvencionimi për sipërfaqet mbi 100 hektarë të jetë më i ulët sesa për personat apo kompanitë me deri në 100 hektarë hapësirë. Paditësja është kompania e vetme që ka aplikuar në programin për pagesa direkte me sipërfaqe mbi 100 hektarë, gjë

është konfirmuar edhe me përgjigjen në email të datës 25.04.2025 nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në kuadër të paditurës.

3. Nga provat e paraqitura nga e paditura, përfshirë programin për pagesat direkte për vitin 2025, dhe ndryshimin e tij të datës 18.03.2025, theksohet se ky program ka për qëllim adresimin e objektivave strategjike për zhvillimin e bujqësisë. Megjithatë, programi nuk jep asnjë shpjegim se si është arritur në konkluzionin që për sipërfaqet mbi 100 hektarë, duhet të merret vlera më e ulët e subvencionimit, as arsyet, kriteret apo analizat mbi të cilat është bazuar ky kriter. Ligji bazë mbi të cilin është nxjerrë ky udhëzim është Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, i cili parasheh që masat e politikës bujqësore duhet të zbatohen në bazë të kritereve jo diskriminuese dhe në përputhje me parimet e barazisë dhe efikasitetit. E paditura nuk ka dhënë asnjë arsye se si i ka respektuar këto parime kur përcakton një kriter të tillë jo të barabartë dhe diskriminues.

4. Ka shtuar se paditësja është kompani në pronësi të investitorëve amerikanë dhe është e vetmja që ka hapësirë mbi 100 hektarë, për këtë veprimtari. E paditura ka qenë në dijeni edhe më parë se paditësi është kompania e vetme me këtë hapësirë, dhe kështu ka qenë në dijeni edhe kur ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ dhe dispozitën kontestuese. Për këto arsye, paditësi ka kërkuar nga gjykata që dispozitat e nenit 21, paragrafi 2, përfshirë pikën 2.1 dhe 2.2 të UA Nr.04/2025, të shfuqizohen si të paligjshme, duke përfshirë edhe kufizimin prej 525 euro për hektar, varësisht nga përshkallëzimi deri në fund të paragrafit.

5. Gjykata me aktvendimin e datës 08.05.2025, ka njoftuar të paditurën lidhur me padinë e ushtruar, dhe pretendimet për paligjshmërinë e aktit normativ të kontestuar nga paditësi, si dhe detyrimin për paraqitjen e dosjes së plotë të procedurës administrative dhe të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me lëndën e çështjes. Gjithashtu, gjykata i ka informuar palët për të drejtat, detyrimet dhe pasojat juridike që lidhen me veprimet procedurale në këtë çështje të konfliktit administrativ, duke u dorëzuar një kopje të padisë, së bashku me provat përkatëse të bashkëngjitura nga paditësi.

6. Përfaqësuesi i autorizuar i të padituröes, në përgjigje ndaj padisë dhe përgjatë shqyrtimit gjyqësorë, ka kërkuar nga Gjykata Supreme, që të refuzojë kërkesën e paditësit për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit dhe kërkesëpadinë për ndalimin e prodhimit të efekteve juridike, shpalljen e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e aktit nënligjor normative. Ai ka theksuar se e paditura para hartimit të Udhëzimit Administrativ për pagesa direkte në bujqësi harton programin përkatës që i adreson objektivat strategjike të zhvillimit të bujqësisë, duke u bazuar në rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimit primar bujqësor, rritjen e të hyrave në fermë, përmirësimin e cilësisë së prodhimit, zvogëlimin e importit dhe shpenzimeve të prodhimit, rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe ekonomizimin e aktiviteteve bujqësore përmes kritereve të përgjithshme dhe masave që duhet të mbështeten dhe zbatohen për vitin përkatës.

7. Ai konsideron se kërkesa e paditësit është e pabazuar dhe nuk ka asnjë lidhje shkakore mes paditësit dhe të padituröes, pasi të gjitha kriteret dhe procedurat janë të njëjta për të gjithë aplikuesit në sektorin e vreshtarisë, pa dallim gjinie, moshe apo ngjyre, dhe nuk ekziston asnjë dispozitë diskriminuese siç pretendon paditësi. Ka shtuar se: e paditura nuk është përgjegjëse për veprimet e ndërmarra dhe formën e përshkallëzimit të subvencioneve, i cili është një ndër metodat e aplikuara për dhënien e pagesave direkte në bujqësi, me qëllim zvogëlimin e diferencës së mjeteve të përfituara mes fermerëve të vegjël, të mesëm dhe atyre me sipërfaqe të mëdha të tokës bujqësore. Ai shton se përshkallëzimi nuk aplikohet vetëm në sektorin e vreshtarisë, por edhe në kultura të tjera bujqësore dhe është në diskrecion të ministrisë përgjegjëse, në përputhje me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe nenin 14, paragrafi 7 të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2025. Në fund, ka kërkuar që gjykata të nxjerrë aktgjykim me të cilin të refuzohet në tërësi kërkesa e paditësit dhe të mbetet në fuqi dispozita e kontestuar e nenit 21, paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ.
8. Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 59 paragraf 8 të Ligjit Nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative, i publikuar në Gazetën

Zyrtare më datë 10.01.2024, dhe ka hyrë në fuqi më datë 10.01.2025 (më tutje: LKA), ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit kontestues në drejtim të thënieve në padi, thënieve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ.

9. Nga shkresat e lëndës rezulton se: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), ka nxjerr Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) Nr.04/2025 për Pagesat Direkte në Bujqësi për Vitin 2025, të publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 19.03.2025.

10. Aktin nënligjor normativ të kontestuar, e paditura e ka nxjerr në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, neni 8 paragrafi 2, nën paragrafi 2.2, paragrafi 5 dhe neni 13 paragrafi 2 dhe 4 të Ligjit Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/30 Mars 2023), Nenin 14 paragrafi 7 të Ligjit Nr.08/L-332 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 (Gazeta Zyrtare Nr.22/12 Dhjetor 2024), nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.34/18 Nëntor 2022) Nenit 4, paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, Shtojca 1: pika 11 e Rregullores (QRK)-NR.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023) si dhe në pajtim me Nenin 9, paragrafi 2 të Rregullores (QRK)- Nr.17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.21.06.2024).

11. Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen rregullat, kriteret e pranueshmërisë dhe procedurat e përkrahjes për fermerët aplikues dhe zbatimin e pagesave direkte në bujqësi për vitin 2025. Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të detyrueshme për Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, Drejtoritë Komunale përkatëse për bujqësi dhe fermerët aplikues për pagesa direkte në bujqësi.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Kolegji i kësaj Gjykate, pas shqyrtimit të kërkesëpadisë së parashtruar nga paditësi, administrimit dhe vlerësimit të provave në tërësi, përfshirë kundërshtimet e paraqitura nga e paditura, si dhe interpretimit

të dispozitave përkatëse ligjore të cituara më sipër, vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe e themeltë.

2. Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse lidhur me dispozitat e nenit 21, paragrafi 2 dhe nën paragrafët 2.1 dhe 2.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2025, i cili përcakton kriteret e pranueshmërisë dhe procedurat e përkrahjes për fermerët aplikues dhe zbatimin e pagesave direkte në bujqësi, dhe vlerëson se përshkallëzimi i subvencioneve përbën një praktikë të njohur dhe të pranuar në politikën bujqësore, e cila synon të sigurojë një balancë të drejtë në mbështetjen financiare ndërmjet fermerëve të vegjël dhe atyre me kapacitete më të mëdha prodhuese, një praktik e tillë, kur zbatohet në mënyrë të drejtë, të qëndrueshme dhe transparente, nuk përbën diskriminim në vetvete. Megjithatë, në rrethanat konkrete, gjykata konstaton se dispozita e kontestuar e aktit nënligjor, e cila është objekt i këtij kontesti administrativ, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vetme mbi një subjekt të caktuar - konkretisht paditësin, këtë e pohon edhe vetë e paditura në përgjigjen e saj zyrtare përmes email-it të datës 25.04.2025, duke deklaruar se paditësi është i vetmi subjekt në vend që kultivon vreshta në një sipërfaqe prej mbi 100 hektarësh - një kulturë bujqësore e rrallë dhe me rëndësi të veçantë ekonomike e kulturore për vendin, për shkak të natyrë së saj specifike, sipërfaqes së kufizuar të tokave të përshtatshme dhe potencialit të lartë për zhvillim dhe eksport. Në mungesë të ndonjë analize të qartë, të argumentuar dhe të dokumentuar nga ana e të padituërs, që do të justifikonte trajtimin e diferencuar të subvencionimit për sipërfaqet mbi 100 hektarë, gjykata vlerëson se përshkallëzimi i tillë rezulton në një trajtim selektiv dhe për pasojë diskriminues ndaj paditësit, në kundërshtim me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit në trajtimin e subjekteve të së njëjtës kategori, prandaj gjykata vendosi si në pikën -I- të dispozitvit të këtij aktgjykimi.

3. Gjykata, vlerëson se në përputhje me parimet themelore kushtetuese, si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, çdo ndryshim në trajtimin juridik të subjekteve të së njëjtës kategori, duhet të bazohet në kritere të qarta, objektive, transparente dhe të ligjshme,

të cilat përmbushin një qëllim legjitim dhe proporcional. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se dispozita e kontestuar e udhëzimit administrativ, që parasheh përshkallëzimin e subvencioneve për sipërfaqet bujqësore mbi 100 hektarë, është e paarsyetuar, e paargumentuar dhe ka mungesë të plotë të analizës së ndikimit. Për më tepër, nga vetë përgjigja zyrtare e të padituërës e datës 25.04.2025, rezulton se ky ndryshim normativ prek ekskluzivisht vetëm një subjekt - konkretisht paditësin - i cili është i vetmi që zotëron dhe kultivon vreshta në një sipërfaqe mbi 100 hektarë, në territorin e Republikës së Kosovës. Kjo rrethanë krijon një situatë të trajtimit të pabarabartë dhe selektiv të paditësit, krahasuar me subjektet e tjera të ngjashme, pa ndonjë bazë objektive, arsyetim të dokumentuar apo analizë ligjore e ekonomike, që do ta justifikonte këtë diferencim. Një qasje e tillë bie ndesh me parimin e barazisë para ligjit dhe ndalon diskriminimin për çfarëdo baze të paarsyeshme, siç garantohet me Kushtetutë dhe me instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme në rendin juridik të brendshëm. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se dispozitat e kontestuara të udhëzimit administrativ janë në kundërshtim me parimet e shtetit të së drejtës dhe tejkalojnë autorizimin ligjor të organit nxjerrës, në atë masë që ato kufizojnë në mënyrë të pajustifikuar dhe joproporcionale të drejtën e paditësit për të përfituar nga skemat e subvencionimit në sektorin bujqësor.

4. Gjykata ka marrë parasysh edhe pretendimet e të padituërës se përshkallëzimi i subvencioneve nuk është i aplikueshëm vetëm në rastin e kulturës së vreshtarisë, por është një praktikë e përdorur edhe për kultura të tjera bujqësore në kuadër të politikës së subvencionimit. Megjithatë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, kur përcaktohet një përshkallëzim i tillë, nuk është e domosdoshme që të gjitha kulturat të trajtohen njësoj me kulturën e vreshtarisë, pasi në rastin konkret duhet marrë parasysh ndikimi i faktorëve socio-ekonomikë dhe veçoritë e secilës kulturë bujqësore në lidhje me vendndodhjen e saj gjeografike dhe karakteristikat territoriale të zonës ku zhvillohet.

5. Nga kjo rezulton se trajtimi i ndryshëm mund të jetë i justifikueshëm dhe në përputhje me qëllimet e politikës së subvencionimit, për sa kohë

që bazohet në kritere objektive dhe relevante për llojin e kulturës dhe zonën ku ajo kultivohet. Për më tepër, e paditura nuk ka ofruar asnjë provë shkresore që vërtetojnë zbatimin praktik të përshkallëzimit për kultura të tjera bujqësore në mënyrë që të justifikojë trajtimin e tyre në rastin konkret. Në mungesë të provave objektive dhe të arsyetuara nga ana e të paditurës, Gjykata konstaton se pretendimi për përdorim të përshkallëzimit në kultura të tjera nuk mbështetet nga fakti dhe nuk mjafton për të provuar mos diskriminimin e paditësit, i cili është i vetmi subjekt që preket në mënyrë direkte nga kjo dispozitë për shkak të sipërfaqes së madhe të mbjellë me vreshta konfirmuar nga vetë e paditura sipas email-it të datës 25.04.2025, ku është theksuar se: *" numri i subjekteve afariste, që aktualisht operojnë në Kosovë, dhe që kanë të mbjella vreshta në sipërfaqe prej 100 hektarësh apo më shumë, si dhe numri i atyre që kanë aplikuar për programin për pagesa direkte me një sipërfaqe mbi 100 ha në vitin 2024, është vetëm 1 (një) kompani, përkatësisht "S.V& Ë", në Rahovec,* këtu paditësi. Andaj gjykata vlerëson se diferencimi në përshkallëzimin e subvencioneve, në rastin konkret të kulturës së vreshtarisë, përbën trajtim të pabarabartë dhe diskriminues, pasi nuk mbështetet në faktorë objektivë që do ta justifikonin këtë qasje të diferencuar në raport me sipërfaqet më të mëdha se 100 ha.

6. Në përputhje me parimet e drejtësisë, transparencës dhe barazisë, Gjykata ka shqyrtuar praktikat e deritanishme të përcaktimit dhe shpërndarjes së subvencioneve për sektorin e vreshtarisë në Kosovë, duke marrë parasysh ndikimin e tyre në zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori dhe ruajtjen e interesave të fermerëve të përfshirë, Gjykata ka konstatuar se përcaktimi i subvencioneve për kulturën e vreshtarisë është realizuar pa një analizë të thelluar dhe pa një bazë të qartë dhe të arsyeshme që justifikon përshkallëzimin e tyre, siç është vlerësuar edhe më lart në këtë aktgjykim. Kjo ka çuar në shpërndarje të pasigurt dhe të paqëndrueshme të fondeve, duke krijuar pasiguri për paditësin dhe duke minuar besimin e tij në sistemin e subvencioneve.

7. Në përfundim, Gjykata vlerëson se për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të vreshtarisë dhe për të mbështetur fermerët

në mënyrë efektive, është e domosdoshme të krijohet një sistem i qartë, transparent dhe të qëndrueshëm për shpërndarjen e subvencioneve. Ky sistem duhet të bazohet në analiza të thelluara dhe të arsyeshme, duke siguruar që fondet të shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë fermerët, pa diskriminim dhe pa favorizim të grupeve të caktuara.

8. Sa i përket shpenzimeve të procedurës, Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 463 të LPK-së. Meqenëse paditësi nuk i ka specifikuar shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

9. Lidhur me publikimin e aktgjykimit, gjykata vendosi në përputhje me nenin 70 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrativ. Në bazë të këtij neni, i cili përcakton se: *Aktgjykimi i arsyetuar dhe pasi ka marrë formë të prerë, publikohet në të njëjtën mënyrë në të cilën është publikuar vetë akti, për efekt të hyrjes në fuqi*. Bazuar në këtë dispozitë ligjore gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Publikimi i aktgjykimit kontribuon në transparencën e punës së gjykatës, në forcimin e parimit të sigurisë juridike, si dhe në udhëzimin e autoriteteve publike dhe qytetarëve lidhur me të drejtën dhe praktikën administrative. Andaj, gjykata vlerësoi se është e nevojshme që ky aktgjykim të bëhet i qasshëm për publikun, në mënyrën e njëjtë të publikimit të aktit nënligjor normativ për efekt të hyrjes në fuqi, konform nenit 70 paragrafi 2 të LKA-së.

10. Për arsyet e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 10 paragraf 4, 11 paragraf 3, 59, 60 par.1, 70 të LKA-së, ka aprovuar të themeltë kërkesëpadinë e paditëses: "S.V & W" Sh.p.k, me numër unik identifikues: ..., me seli në fshatin ...., K..., e paraqitur kundër të paditurës: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), me seli në Prishtinë. Shpallet i paligjshëm dhe shfuqizohet neni 21 paragrafi 2 nën paragrafët 2.1 dhe 2.2, të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.04/2025, për Pagesat Direkte në Bujqësi për Vitin 2025, i publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 19.03.2025.

Aktgjykimi i kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme të KosovësPA.Nr.2/2025, datë 14.03.2025

’’Për të caktuar një masë të përkohshme të sigurimit, duhet të vërtetohet saktësisht se ekziston një rrezik real dhe i menjëhershëm që, nëse nuk merret masa, do të shkaktohet dëm i rëndë dhe i pakthyeshëm; se interesi publik është ndjeshëm i rrezikuar dhe masa është e nevojshme për ta mbrojtur atë; si dhe se masa është proporcionale, domethënë e përshtatshme për të arritur qëllimin, e domosdoshme dhe nuk shkakton më shumë cenim sesa përfitim në mbrojtjen e interesit publik ose privat.’’

I. Rrjedha e çështjes

1. Paditësja, Organizata Joqeveritare “G.”- më datë 10 mars 2025, ka parashtruar padi në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër të paditurës, Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, me kërkesën për caktimin e masës së posaçme/të përkohshme të sigurimit.

2. Paditësja, me padi ka kërkuar shfuqizimin e pjesshëm të aktit nënligjor normativ, Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, e miratuar më 21 dhjetor 2023 dhe në fuqi nga 22 janar 2024, ndërsa me kërkesën për caktimin e masës së posaçme/të përkohshme të sigurimit, ka kërkuar moszbatimin apo ndalimin e prodhimit të efekteve juridike të rregullores deri në vendosjen meritore sipas padisë.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin e datës 11 mars 2025, ka njoftuar të paditurën, Komuna e Prishtinës, si dhe palën e tretë, Ndërmarrja Publike Lokale “P.P” Sh.A., të dyja me seli në Prishtinë, lidhur me kërkesën për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit dhe padinë e ushtruar nga paditësja në këtë gjykatë. Gjithashtu, gjykata i ka informuar palët për të drejtat, detyrimet dhe pasojat juridike që lidhen me veprimet procedurale në këtë çështje të konfliktit administrativ, duke u dorëzuar një kopje të kërkesës dhe padisë, së bashku me provat përkatëse të bashkëngjitura nga paditësja.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, pasi shqyrtoi me kujdes kërkesën e paditëses për sigurimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit, pretendimet, argumentimin si dhe provat materiale të deponuara në shkresat e lëndës, konstatoi se: kërkesa e paditëses për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, është e pathemeltë.

5. Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Komuna e Prishtinës, përkatësisht Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më datë 21.12.2023, ka miratuar Rregulloren për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, e cila ka hyri në fuqi më 22 janar 2024. Objekti i kësaj rregullore, ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe kritereve të vendparkimeve publike dhe private, për caktimin e zonave, mënyrën e pagesës, çmimet dhe llojet e biletave për vendparkim, procedurën e paraparë për krijimin dhe operimin e parkingjeve private, mënyrën e shfrytëzimit të tyre dhe mbikëqyrjen për parkimin e automjeteve në gjithë territorin e Prishtinës.

6. Rregullorja, është miratuar në mbështetje të nenit 12, paragraf 2, shkronja c, nenit 17, shkronja f, dhe të nenit 40, paragraf 2, shkronja a të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 qershor 2008), të nenit 15, shkronja a dhe f të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/03 qershor 2008), të nenit 7, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.338/shtator 2016, Prishtinë) të nenit 7 të Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, si dhe nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja f, nenit 33, paragrafi 33.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, Nr. 01-110-391, të datës 25.02.2010.

7. Akti normativ i kontestuar, i është nënshtruar shqyrtimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), e cila ka kërkuar edhe mendimin e Ministrisë së Drejtësisë (MD). Sipas shkresës e cila gjendet në shkresat e lëndës, Ministria e Drejtësisë, më datë 10 janar 2024, ka pranuar për shqyrtim

ligjshmërinë e Rregullores Nr. 01.030/01-236555/23 për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve, të miratuar më datë 21.12.2023 nga Kuvendi Komunal i Prishtinës dhe të parashtruar në MAPL më datë 28.12.2023. Sipas theksimeve, të kësaj Ministrie, rregullorja, në nenin 25 të saj, përmban dispozita ndëshkimore, përkatësisht kundërvajtje dhe sanksione kundërvajtëse me gjoba, të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, veçanërisht me nenin 29 (paragrafi 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtjet. Megjithatë, Ministria e Drejtësisë, gjatë analizimit të kësaj Rregulloreje, ka tërhequr vërejtjen për nenin 22 të saj (shkeljet brenda parkingjeve të menaxhuara), duke theksuar se disa pika, si paragrafët 1, 3, 8 dhe 9 duhet të rishikohen. Ministria e Drejtësisë, gjithashtu thekson se shqyrtimi i sanksioneve kundërvajtëse me gjoba për shkeljen e dispozitave të kësaj Rregullore duhet të bëhet nga organi mbikëqyrës, i cili është Drejtoria e Inspektimeve, e cila ka kompetencën për shqyrtimin e sanksioneve sipas neneve 23 dhe 25 të saj. Gjithashtu, Drejtoria e Inspektimeve duhet të marrë në konsideratë dispozitat relevante të Ligjit Nr.05/L-087 për Kundërvajtjet gjatë shqyrtimit të sanksioneve kundërvajtëse me gjoba. Përfundimisht, Ministria e Drejtësisë ka kërkuar që para miratimit të kësaj Rregulloreje, të rishikohen dhe të mbështeten dispozitat përkatëse për të siguruar përputhshmërinë e plotë me legjislacionin në fuqi.

8. Lidhur me shqyrtimin e kërkesës për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit, gjykata vë në dukje, se paditësja OJQ "Q."me seli në Prishtinë, me kërkesën për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit dhe padi, të datës 10 mars 2025, ka ngritur pretendime lidhur me çështjet ligjore dhe administrative që mund të kenë ndikim në legjitimitetin e aktit nënligjor normativ të kontestuar.

9. Paditësja në kërkesën për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit, ka ngritur disa çështje të cilat përfshinë: i) përputhshmërinë e dispozitave të vetë aktit nënligjor normativ të kontestuar dhe ii) ligjshmërinë e dispozitave të aktit nënligjor normativ të kontestuar, me legjislacionin në fuqi, përkatësisht: Ligjin Nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor që ka qenë në fuqi në

kohën kur është miratuar rregullorja, Ligji Nr.08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor, Ligjit Nr.05/L-087 për Kundërvajtje, Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjin Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Rregulloren për Shërbimin e transportit me "Merimangë", në territorin e Komunës së Prishtinës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative.

10. Në referim të nenit 100 paragraf 1 nën-paragraf 1.1 të Ligjit Nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative, paditësja pretendon se përmbushen kushtet e përcaktuara ligjore me të cilat arsyetohet domosdoshmëria për të shmangur një dëm më të madh që mund të i shkaktohet qytetarëve si shfrytëzues të parkingjeve publike në Komunën e Prishtinës. Tutje, pretendon se akti nënligjor normativ i kontestuar, i cenon të drejtat e qytetarëve dhe interesat e ligjshme, kolektive dhe të gjëra të publikut për shfrytëzimin e parkingjeve publike.

11. Në fund, lidhur me masën e përkohshme të sigurimit, paditësja kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës, që në bazë të argumenteve të lartcekura, të vendos masë të përkohshme për ndalimin e prodhimit të efekteve juridike të dispozitave të rregullores së kontestuar, përkatësisht dispozitave nga neni 2, 3, 8 paragraf 1, neni 9, neni 12 paragraf 11, neni 16, neni 18 paragraf 2, neni 22 paragraf 1, 3, 8 dhe 9 si dhe neni 27 paragrafi për shtojcat, të aktit nënligjor normativ.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata ka vlerësuar se paditësja në cilësinë e organizatës jo-qeveritare me numër të regjistrimit: ..., me seli në Prishtinë, në mbështetje të nenit 25 par.3 të LKA-së, ka legjitimitet për parashtrimin e padisë për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ dhe kërkesës për moszbatimin apo ndalimin e prodhimit të efekteve juridike të rregullores. Ndërsa e paditura, Komuna e Prishtinës, ka miratuar aktin normativ të kontestuar, që si rrjedhojë legjitimiteti është i bazuar në nenin 25 paragraf 5 të LKA-së. Po ashtu, gjykata ka vlerësuar, se efekti juridik i aktgjykimit mund të ndërhyjë drejtpërdrejtë në të drejtat ose

interesat e ligjshme të personit të tretë, në rastin konkret N.P.L“P.P”, Sh.A, për të cilën sipas nenit 30 paragraf 3, lidhur me paragraf 2 të LKA-së, ekziston detyrimi ligjor që ta thërras për pjesëmarrje në procesin gjyqësor, pasi të njëjtës i është besuar menaxhimi i segmenteve të caktuara sipas rregullores.

2. Në dritën e fakteve dhe pretendimeve të kërkesës, gjykata konsideron se aspektet thelbësore të kërkesës së parashtruar nga paditësja ngrenë pretendime mbi arritjen e qëllimeve si: i) mbrojtjen interesave kolektive apo interesave të gjera të publikut, ii) parandalimin e shkaktimit të dëmit për të ardhmen.

3. Me rastin e vendosjes për masën e posaçme/përkohshme të sigurimit të padisë dhe shqyrtimit paraprak të aktit nënligjor normativ përkitazi me vendosjen për masë, gjykata ka vlerësuar rrethanat përcaktuese për përmbushjen e kritereve ligjore për caktimin e masës së sigurimit, si dhe rrethanat se akti nënligjor normativ a është miratuar nga një organ i autorizuar në bazë të ligjit, nëse i njëjti përmban bazën ligjore për miratimin e aktit nënligjor, apo është qartazi i përfshirë në shkelje të rënda të drejtave themelore të njeriut, ndërsa është kufizuar në shqyrtimin e rrethanave për ligjshmërinë e aktit nënligjor, përkatësisht vlerësimin se përmbajtja e aktit nënligjor është apo jo brenda kufijve të përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

4. *Përkitazi me domosdoshmërinë e shmangies së një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm ndaj interesave të propozuesit të masës:* Gjykata ka vlerësuar se, as nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës, dhe as nga provat e dorëzuara, nuk është vërtetuar rrethana e shkaktimit të dëmit të rëndë, dhe të pakthyeshëm, nëse nuk caktohet masa e sigurimit. Gjykata, vë në dukje se akti nënligjor i kontestuar, ka hyrë në fuqi më datë 22 janar 2024, ndërsa kërkesa për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit, përkatësisht për moszbatimin apo ndalimin e prodhimit të efekteve juridike të aktit nënligjor normativ, është parashtruar më datë 10 mars 2025. Pra, distanca në intervalin kohor nga data e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar deri në momentin e parashtrimit të kërkesës, nënkupton tejkalim të periudhës mbi një

vjeçare, brenda të cilës periudhë rregullorja ka qenë në fuqi dhe si rrjedhojë ka prodhuar edhe efekte juridike. Gjykata, nënvizon se duke pasur parasysh këtë interval kohor, dhe provat e dorëzuara nga parashtruesja e kërkesës, nuk ka arritur të vërtetoj se cili ka qenë dëmi real i shkaktuar deri më tani dhe i cili dëm duhet të shmanget apo parandalohet nga gjykata përmes marrjes së masave preventive, përkatësisht caktimit të masës së posaçme/përkohshme të sigurimit, si kërkesë urgjente në drejtim të mbrojtjes së interesit kolektiv apo publik.

5. Gjykata, vëren se nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës, theksi vihet në: mos aplikimin e praktikave më të mira të akteve nënligjore normative (si ajo në Tiranë-Shqipëri), ku banorët rezident janë të liruar nga pagesat për të gjitha veturat e tyre në zonat ku banojnë dhe në parkingjet në prani të njësive banesore, kompetencës së dhënë sipas aktit për NPL "P.P" Sh.a, për menaxhimin e ishujve, oazave gjelbëruese dhe trotuareve përreth parkingjeve, vendosjes së bllokadës për mjetet e parkuara më shumë se dhjetë minuta, largimin e veturës me merimangë, pamundësisë ligjore për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse, keqpërdorimit të mundshëm të dokumenteve apo të dhënave personale, shmangien nga përgjegjësia për shkaktimin e mundshëm të dëmit në parkingje, çmimoren dhe kategorizimin e çmimeve, mungesën e kamerave të sigurisë dhe shenjëzimit, përkatësisht lirimit nga pagesa e tarifave për kategoritë e caktuara të qytetarëve si: invalidët, pjesëtarët e Forcave të Armatosura të Kosovës (FSK).., megjithatë sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate këto pretendime i referohen më tepër ligjshmërisë së aktit normativ të kontestuar se sa përmbushjes së kritereve të përcaktuara ligjore, për caktimin e masës së sigurisë. Gjykata thekson se kërkesa për masën e sigurimit duhet të mbështetet dhe argumentohet mbi bazën e kritereve të qarta ligjore, në këtë rast, pretendimet e parashtruesit, nuk dëshmojnë ekzistencën e një dëmi të rëndë dhe të pakthyeshëm, apo mundësinë e shkaktimit real të tij, dhe i cili dëm do të arsyetonte urgjencën për shmangie nga dëmi me rastin e moszbatimit apo ndalimit të prodhimit të efektit juridik të tij.

6. *Përkitazi me moscënimin e interesit publik:* Gjykata kishte parasysh balancimin mes interesave të individëve dhe shoqërisë, si dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe si rezultat arriti në përfundim se dispozitat e kontestuara nuk përmbajnë elemente që do të mund të i atribuohej shkaktimit të ndonjë dëmi të rëndë dhe të pakthyeshëm dhe që si rrjedhojë të mund të kualifikohej si: shkelje e të drejtave themelore të njeriut. Për më tepër, nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës, gjykata nuk ka mundur që të identifikojë se cilat të drejta themelore të njeriut janë shkelur, dhe si janë shkelur, me rastin e hyrjes në fuqi dhe implementimit të rregullores.

7. Lidhur me kriterin e parë, gjykata thekson se: Për të justifikuar një masë sigurimi, parashtruesja e kërkesës duhet të vërtetojë se shkaktimi i dëmit nuk është vetëm një mundësi, por një rrezik real dhe i drejtpërdrejtë për të pësuar dëm të rëndë dhe të pakthyeshëm. Kjo do të thotë se, parashtruesi i kërkesës duhet të arsyetojë se pa ndërhyrjen e gjykatës për ndërmarrjen e masave të posaçme/përkohshme të sigurimit, ndalimin e zbatimit të aktit nënligjor normativ, pasojat do të ishin të pakthyeshme dhe të rënda dhe se të njëjtat nuk do të mund të kompensoheshin në asnjë formë dhe për këtë arsye kërkohet veprimi urgjent nga gjykata.

8. Ndërsa lidhur, me kriterin e dytë, gjykata thekson se: masa e sigurimit nuk mund të caktohet në mungesë të kushteve që justifikojnë domosdoshmërinë e saj. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se: Interesi publik është i cenuar ndjeshëm për shkak të zbatimit të rregullores dhe ndalimi i mëtutjeshëm i prodhimit të efekteve juridike është i nevojshëm për të ruajtur një balancë të drejtë midis interesave private dhe publike dhe masa është proporcionalisht e justifikuar, pra ndalimi i përkohshëm i zbatimit të rregullores nuk cenon më shumë interesin publik sesa do ta mbronte atë, andaj domosdoshmëria e një mase sigurimi kërkon që ajo të jetë e vetmja mënyrë për të arritur një objektiv të ligjshëm.

9. Ndërsa lidhur me kriterin e proporcionalitetit, gjykata thekson se: Parimi i proporcionalitetit, është një parim themelor në të drejtën

administrative dhe kushtetuese, i cili kërkon që çdo masë e ndërmarrë nga autoritetet publike të jetë e nevojshme, e përshtatshme dhe e balancuar, në kuptimin që duhet të ekzistojë një lidhje e drejtë dhe e arsyeshme mes masës që merret dhe qëllimit që synohet të arrihet. Pra, është e rëndësishme që masat e marra të jenë të justifikueshme dhe të mos shkojnë më tej se sa është e nevojshme për të arritur qëllimin ligjor ose shoqëror.

10. Gjykata, kishte parasysh se sipas Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, aktet nënligjore të nxjerra nga komunat i nënshtrohen shqyrtimit të ligjshmërisë. Kjo nënkupton që këto akte duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe aktet tjera normative në fuqi. Sipas nenit 82 të këtij ligji, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka kompetencë për të mbikëqyrur ligjshmërinë e akteve komunale. Nëse konstatohet se një akt është në kundërshtim me ligjin, MAPL mund të kërkojë ndryshimin ose shfuqizimin e tij, ose mund ta referojë çështjen në Gjykatën Kompetente.

11. Nga një gjendje faktike e tillë e çështjes, gjykata tani për tani, prezumon faktin se akti është miratuar në përputhje me kornizën ligjore të aplikueshme, deri në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike me rastin e shqyrtimit gjyqësor të ligjshmërisë së këtij akti normativ të kontestuar, sipas padisë. Ky parim është i lidhur ngushtë me sigurinë juridike, vazhdimësinë e administratës publike, dhe autorizimet ligjore të institucioneve publike për të garantuar respektimin e parimit të ligjshmërisë.

12. Gjykata është rezervuar në arsyetimin e pretendimeve të cilat mund të kenë ndikim në zgjidhjen meritore të çështjes, me qëllim të mos paragjykimit të themelësisë së kërkesëpadisë, për shfuqizimin e pjesshëm të rregullores. Ndërsa në mungesë të argumenteve të qarta dhe provave konkrete mbi domosdoshmërinë e caktimit të masës së sigurimit, gjykata vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e kërkesës dhe rrjedhimisht refuzon kërkesën për caktimin e

masës së posaçme/përkohshme të sigurimit, përkatësisht moszbatimin apo ndalimin e prodhimit të efekteve juridike të rregullores.

13. Bazuar në të lartcekurat, gjykata refuzoi kërkesën e parashtruar nga pala paditëse për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit, pasi vlerësoi se në mënyrë proporcionale nuk janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 100 paragraf 1, nën paragraf 1.1 dhe 1.2, në lidhje me paragraf 2 të LKA-së, për tu caktuar një masë e tillë, dhe në mbështetje të nenit 10 paragraf 4 si dhe 60 paragraf 2, LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.253/2025, datë 01.09.2025

"Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar revizionin e paditëses H.P, ka prishur aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.6156/2022, të datës 25.11.2024 dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.2145/2013, të datës 25.05.2022, e çështja i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, sepse në rastin konkret nuk e kanë vlerësuar drejtë çështjen e parashkrimit të kërkesëpadisë, pasi që kemi të bëjmë me kërkesë për pagesën në emër të rentës jetësore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit punues dhe se në rastet e tilla, afati i parashkrimit duhet të vlerësohet për secilën periudhë kohore veç e veç, e jo si tërësi e kërkesës dhe të konstatohet nëse kemi parashkrim të kërkesës apo jo. Gjykata e shkallës së parë është dashtë të bëjë vlerësimin e kërkesave në mënyrë periodike dhe të vlerësoj nëse kemi të bëjmë me parashkrim për gjithë periudhën, apo vetëm për një periudhë të caktuar kohore.''

I. **Rrethanat e çështjes**

1. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.Nr.2145/2013, të datës 25.05.2022, ka vendosur: I. Refuzohet e pabazuar kërkesëpadia e paditëses NN, nga P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura NN me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të rentës jetësore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit punues prej 70% për periudhën kontestuese nga data 01.01.1992, e deri më datë 31.01.2022, t'ia paguaj shumën prej 52,681.00 €, ndërsa nga data 01.02.2022, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore por jo më shumë se data 16.03.2025 rentën mujore prej 314.90 € në muaj, e cila në formë të kapitalizuar arrin vlerën prej 8,461.92 €, apo shumën e gjithmbarshme prej 61,142.92 €, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë më datë 03.09.2013, e deri në pagesën definitive. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.6165/2022, të datës 25.11.2024, është refuzuar si e pa themeltë ankesa e paditëses dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.2145/2013, të datës 25.05.2022.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësja në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin e paditëses ashtu që të prish aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.Nr.2145/13, të datës 20.06.2022 dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.Nr.6156/2022 të datës 25.11.2024, dhe çështjen ta ndryshojë ose ta kthej në rigjykim.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së dhe shkresave të lëndës si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion, ka gjetur se: Revizioni i të paditurës është i bazuar.

5. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, më datë 02.09.2013, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e dëmit në formë të rentës dhe zvogëlimit të aftësisë punuese, duke kërkuar më saktësisht si në padi. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditëses, kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin C.Nr.2145/2013, të datës 25.05.2022, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

6. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se: me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C.Nr.76/74 të datës 05.12.1974, aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut C.Nr..96/75 të datës 06.06.1975, vendimin e të paditurës Nr.1657/90 të datës 30.10.1990, vendimin mbi shqiptimin e masës së dënimit në para Nr.4286/64 të datës 15.10.1990, raportet mjekësore të datës

05.04.1990 dhe 05.09.2005, vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 05.09.1991, ekspertizën nga lëmia e mjekësisë së punës e datës 07.09.2020 dhe ekspertizën financiare të datës 31.01.2022. Ka shtuar se nuk është kontestues fakti që paditësja më datë 23.10.1973 ka pësuar lëndime trupore për shkak të kontaktit me përçuesin elektrik, dhe se e njëjta është kompensuar nga paraardhësja e të padituräs për të gjitha format e kompensimit, përveç kompensimit për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese, fakt ky që vërtetohet edhe nga aktgjykimet C.Nr.76/74 të datës 05.12.1974, dhe aktgjykimi Ac.Nr.95/75 të datës 06.06.1975. Kontestuese në këtë çështje juridike ishte baza juridike e kërkesëpadisë, respektivisht nëse paditëses i takon e drejta në shpërblim të dëmit për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese, kjo pasi që pretendimi kryesor i të padituräs është fakti se kërkesa e paditëses është përfshirë në parashkrim, ndërsa sipas paditëses, kërkesa për rentë jetësore është periodike dhe e njëjta nuk parashkruhet derisa paditësja të arrin moshën e pensionimit. Nga ekspertiza mjekësore e asaj kohe është konstatuar se paditësja ka zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallë prej 60% e cila do të manifestohet në të gjitha aktivitetet e saj jetësore. Gjykata nga provat e administruara ka gjetur se paditësja në kohën e lëndimit të pësuar si rezultat i kontaktit me përçuesin elektrik ka qenë në moshën trembëdhjetë (13) vjeçare, kjo ngase paditësja ka lindur më datë …., ndërsa aksidenti është shkaktuar më datë 23.10.1973. Gjykata vlerëson se paditëses e drejta në kompensim për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese, i ka lindur me datë 16.03.1978, datë kjo kur paditësja ka arritur moshën prej tetëmbëdhjetë (18) vjet, pasi që me arritjen e kësaj moshe e njëjta ka fituar aftësi punuese, e cila aftësi si rezultat i aksidentit të vitit 1973 është zvogëluar, andaj pasoja e aksidentit të vitit 1973 tek paditësja është manifestuar me arritjen e moshës madhore. Rrjedhimisht gjykata gjen se afatet e parashkrimit lidhur me kërkesën e paditëses fillojnë të rrjedhin nga 16.03.1978, kur paditësja ka arritur moshën madhore. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 360.3, 372, 373, dhe 376 të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës ju ka referuan nenit 450 të LPK-së.

7. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm, dhe nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Thëniet ankimore për zbatim të gabuar të së drejtës materiale e posaçërisht në drejtim të zbatimit të dispozitave të nenit 372, 373, dhe 376 të LMD- ës, nuk qëndrojnë. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka zbatuar këto dispozita, dhe ka konstatuar faktin se paditëses e drejta në kompensim në formë të dhënieve periodike i ka lindur me datë 16.03.1978, dhe se kërkesa më e vjetër e pa përmbushur periodike është bërë e arritshme po në këtë datë, ndërsa vet e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike ka arritur afatin e parashkrimit me datë 16.03.1983, pra 5 vite nga koha kur kërkesa më e vjetër e pa përmbushur është bërë e arritshme. Gjykata e Apelit, përfundon si gjykata e shkallës së parë se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar dhe si e tillë duhet të refuzohet si e pabazuar.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri të përfundimi mbi refuzimin e kërkesëpadisë. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi refuzimin e kërkesëpadisë. Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Pasi që në revizion pretendimet e paditëses janë vetëm në raport me refuzimin e kërkesëpadisë për shkak të parashkrimit të kërkesës, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë në kontestet që kanë të bëjnë me parashkrimin e kërkesës lidhur me kompensimin e dëmit, gjykata i shqyrton gjithherë sipas prapësimit të palës, prandaj në këtë rast e paditura, ka paraqitur pretendim lidhur me parashkrimin e kërkesës ndaj saj, me pretendimin se ka kaluar afati i parashkrimit, ndërsa gjykata e shkallës së parë dhe të dytë gabimisht e ka vlerësuar këtë fakt dhe ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është parashkruar.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar me kujdes pretendimet e paditëses të paraqitura në revizion, dhe të njëjtat janë të bazuara, për faktin se afatet e përcaktuara me nenin 372 dhe nenit 373 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), janë afate të cilat me kohë pala e humbë të drejtën për të kërkuar përmbushjen e detyrimit, dhe të njëjtat afate nuk mund të zgjatën dhe as të shtyhen, dhe se në rast të kalimit, të afatit kërkesa arrin parashkrimin, ndërsa gjykata sipas prapësimit të palës e vlerëson nëse kërkesa është e parashkruar ose jo, e që në rastin konkret gjykatat e instancave më të ulëta nuk e kanë vërtetuar saktë faktin nëse kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, për arsye se: Me nenin 372 të LMD-së përcaktohet se: "*Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) si kur është fjala për kërkesat periodike akcesore, sikundër është kërkesa e kamatës, ashtu edhe kur është fjala për kërkesën periodike të atilla në të cilat soset vetëm e drejta sikundër është kërkesa e ushqimit, parashkruhen tre vjet nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë*". Me nenin 373 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së përcaktohet se: "1. *Vetë e drejta nga e cila rezultojnë kërkesat periodike parashkruhet për pesë vjet, duke llogaritur nga rrjedhja për pagesë e kërkesës më të vjetër të pa përmbushur pas së cilës debitori nuk ka kryer dhënien. 2. Kur parashkruhet e drejta nga e cila rezultojnë kërkesat periodike, atëherë kreditori humbë të të drejtën jo vetëm të kërkojë dhënie të ardhshme periodike që kanë rrjedhur për pagesë para këtij parashkrimi*".

4. Gjykata Supreme vlerëson se nga dispozitat e lartcekura shihet qartë se gjykata e shkallës së parë dhe as ajo e shkallës së dytë nuk e kanë vlerësuar drejtë çështjen e parashkrimit të kërkesës së paditëses. Në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesë për pagesën në emër të rentës jetësore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit punues dhe se në rastet e tilla afati i parashkrimit duhet të vlerësohet për secilën periudhë kohore veç e veç dhe jo si tërësi e kërkesës dhe të konstatohet nëse kemi parashkrim të kërkesës apo jo. Gjykata e shkallës së parë është dashtë të bëjë vlerësimin e kërkesave në mënyrë periodike dhe të vlerësoj nëse kemi të bëjmë me parashkrim për gjithë periudhën, apo vetëm për një periudhë të caktuar kohor.

5. Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka bërë interpretim të gabueshëm të dispozitës ligjore nga nenin 372 paragrafi 2 të LMD-së, të vitit 1978, duke konsideruar se me kalimin e afatit 5 vjeçar, përkatësisht parashkrimit të vetë të drejtës parashkruhet e tërë kërkesa, sepse kjo dispozitë fletë për kërkesat të cilat kanë rrjedhur për pagesë para parashkrimit sipas afatit 5 vjeçar, dhe nuk vlen për kërkesat që rrjedhin pas këtij afati sepse për këto kërkesa fillon të rrjedh afat i ri i parashkrimit, prandaj konstatimi në këtë mënyrë i gjykatës së shkallës së parë ka rezultuar me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

6. Në rigjykim udhëzohet gjykata e shkallë së parë, që të sqaroj të gjitha dilemat sipas vërejtjeve të cekura më lartë, nëse është e arsyeshme të nxjerr ekspertizë me ekspertin e aktuaristikës. Gjykata duhet t'ia caktoj ekspertit detyrat e ekspertizës, në atë mënyrë që ekspertiza të punohet në variantin sipas vërejtjeve dhe atë: për rentën e arritur për pagesë deri në ditë kur punohet ekspertiza dhe pas ekspertizës renta mujore deri sa të ekzistojnë kushte ligjore, eksperti të ftohet në seancë për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e tij profesional dhe pas kësaj gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.16/2025, datë 07.05.2025

"Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar pjesërisht si të bazuar revizionin e të paditurës, ka prishur aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.Nr.6121/22, të datës 07.10.2024 dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega Podujevë C.Nr.671/2017, të datës 20.07.2017, në pikën II të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë për fitimin e humbur dhe çështjen ia ka kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, sepse në rastin konkret nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Për më tepër gjykata e shkallës së parë nuk e ka marr fare mendimin e ekspertit nga lëmia e aktuaristikës, ngase nuk ka vërtetuar se nga paga të cilën e fitonte i ndjeri, sa është shuma që i ndjeri e ka shpenzuar për nevojat e tij personale dhe sa është pjesa të cilën ia ka dedikuar familjes së tij.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega Podujevë, me aktgjykimin C.Nr.671/2017, të datës 20.07.2017, ka vendosur: I. Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësve NN, si e bazuar. II. Detyrohet e paditura NN., që paditësve në raport me përgjegjësinë dhe atë për 90% të përgjegjësisë e paditura, t'iu kompensoi dëmin material dhe jo material (për shkak të vdekjes së bashkëshortit, djalit dhe babait të tyre, në aksidentin e datës 07.01.2017) dhe atë: Për dhimbje shpirtërore: Paditëses NN, bashkëshortja e tani të ndjerit, shumën prej 7,200.00€, paditëses NN, shumën prej 7,200.00 €, paditëses NN, shumën prej 7,200.00€, paditëses NN, shumën prej 4,500.00€. Për dëmin material: Për shpenzime të varrimit, shumën prej 1,350.00 €, për ngritjen e përmendores, shumën prej 900.00 €, paditëses NN, në emër të dëmit material - fitimit të humbur (në formë të rentës mujore), shumën prej 15,624.00 € (për periudhën e kaluar 01.02.2017 deri 01.04.2022), kontributi në pagë shumën prej 1,703.36 € (për periudhën e kaluar

01.02.2017 deri 01.04.2022), në emër të kamatës vonesës të pagesës së pagës shumën prej 1,591.20 €. Paga mujore për periudhën e ardhshme (nga data 01.04.2022) në shumën prej 252.00 €, derisa për këtë të ekzistojnë kushte ligjore 22.03.2032, në emër të kontributit në pagë shuma prej 27.47 €. III. Përtej shumës së aprovuar shuma tjetër e kërkesës prej total 5,283.11 €, Refuzohet si e pabazuar. IV. Detyrohet e paditura NN që shumat e aprovuara t'iu paguajë paditësve, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 3,524.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

2. Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin Ac.Nr.6121/22, të datës 07.10.2024, ka vendosur: Refuzohet ankesa e të paditurës NN si e pabazuar, vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.671/2017, të datës 20.07.2022.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si i bazuar revizioni i të paditurit NN., e ushtruar ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.Nr. 6121/22 datë 07.10.2024, të anulohet si i pabazuar aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.Nr. 6121/22 i datës 07.10.2024 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë - Dega Podujevë-Departamenti i Përgjithshëm C.Nr. 671/17, i datës 20.07.2017 dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje pranë gjykatës së shkallës së parë.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se: Revizioni i të paditurës është i pjesërisht i bazuar.

5. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, më datë 05.12.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqit padi, kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, duke kërkuar shumat e specifikuara më saktësisht si në precizimin të padisë

të bërë në fjalën përfundimtare. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësve kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e ankimuar C.Nr.671/2017, të datës 20.07.2017, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

6. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: pas administrimit dhe vlerësimit të provave ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar pasi që ka vërtetuar se nuk është kontestuese se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura në kohë të caktuar deri më datë 31.01.2017. Nuk ka qenë kontestuese fakti se tani i ndjeri më datë 07.01.2017, deri sa ishte duke punuar në vendin e tij të punës te e paditura është lënduar dhe si pasojë e këtyre lëndimeve të marra ka humbur jetën - ka vdekur në vendin e tij të punës. Pasi që ka qenë kontestuese baza e kërkesëpadisë si dhe lartësia e kërkesëpadisë së paditësve dhe për të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike se si ka ndodhur aksidenti në punë ka angazhuar ekspertin për mbrojtje dhe siguri në punë Doc. Dr. Ing. Hamit Nuredini, i cili ka ardhur në përfundim se shkaktar kryesor i këtij aksidenti në punë është punëdhënësi këtu e paditura ngase nuk ka zbatuar asnjë masë parandaluese dhe i ndjeri NN., nuk mban asnjë përgjegjësi për lëndimin e tij. Pasi që i autorizuari i të paditurës ka kundërshtuar mendimin e ekspertit të lartcekur, e paditura ka propozuar që gjykata të merr edhe një mendim të një eksperti nga lëmia e sigurisë dhe mbrojtjes në punë dhe gjykata e shkallës së parë ka aprovuar këtë propozim dhe për ekspert ka caktuar ekspertin për mbrojtje dhe siguri në punë Dr. Ing. Gjelush Vataj, i cili ka dhënë mendimin e tij se edhe i punësuari bartë përgjegjësinë për neglizhencën dhe mos kujdesin e tij në punë. I autorizuari i të paditurës ka kundërshtuar përsëri konstatimin dhe përfundimin e dhënë nga dy ekspertët, gjykata ka caktuar grupin e ekspertëve të cilët kanë dhënë mendimin dhe konstatimin e tyre me shkrim më datë 09.03.2022. Sipas grupit të ekspertëve përgjegjësia primare është e të paditurës Fabrika për Përpunimin e Perimeve (Jaha Foods), nga Podujeva, ndërsa përgjegjësia sekondare minimale është e viktimës NN. Bazuar në

ekspertizën e grupit të ekspertëve gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se bëhet fjalë për përgjegjësi të ndarë prej 90% për të paditurën, ndërsa për viktimën NN (tani i ndjerë) përgjegjësi prej 10%. Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë në emër të fitimit të humbur gjykata ka angazhuar ekspertin e aktuaristikës financiare mr. Scc Fahri Bajrami, i cili ka bërë përllogaritjen e të cilën përllogaritje e ka pranuar gjykata e shkallës së parë duke konsideruar se ekspertiza në fjalë është profesionale. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 172, 173, 177 dhe 183 të LMD-së. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 449, 450, 452 dhe 453 të LPK-së.

7. Gjykata e Apelit me aktgjykimin e saj Ac.Nr.6121/22, të datës 07.10.2024, ka vendosur që të refuzoj ankesën e të paditurës dhe ta vërtetoj aktgjykimin e shkallës së parë, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

8. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i goditur është marr me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë në nenin 194 e lidhur me nenin 182 par. 2 pika b), g), j), k) dhe m), për të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare, e as në ato në të cilat thirret ankesa nga neni 182 par. 2 pika n), kjo për faktin se aktgjykimi i goditur është i qartë dhe nuk është kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit dhe në të janë dhënë arsyet për faktet vendimtare e të cilat arsye i pranon edhe kjo gjykatë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë dhe të gjykatës së shkallë së parë për kërkesat për të cilat është refuzuar revizioni, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa në pjesën që është prish sipas vlerësimit të kësaj

gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishet.

2. Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës në pjesën në të cilën është refuzuar revizionin nuk janë të bazuara. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale dhe ka rezultuar si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë. Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, në pjesën në të cilën është refuzuar revizioni, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore sa i përket kësaj pjese dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallë së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

3. Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësëve për 90% të përgjegjësisë, gjënë mbështetje në nenin 136, 140 dhe 176 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i datës 10 maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 dhjetor 2012, nenin 42 dhe 60 të Ligjit të Punës dhe nenin 6 dhe 21 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Me nenin 42 paragrafi 1,2,3,4,5 dhe 6 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: " 1. *I punësuari ka të drejtë në sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit dhe në ambientin e përshtatshëm të punës, në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Mbrojtjen e Ambientit të Punës. 2. Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin. 3. Punëdhënësi detyrohet ta informojë punëtorin me shkrim para angazhimit të tij, për rreziqet në punë dhe për masat mbrojtëse të cilat obligohet t'i marrë. 4. Punëdhënësi obligohet të japë udhëzime që tregojnë rreziqet në punë dhe masat mbrojtëse të cilat duhet të merren në përputhje me udhëzimet e lëshuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. 5. Punëdhënësi është i detyruar t'i zbatojë rregullat dhe procedurat e përgjithshme për mbrojtjen dhe sigurinë në punë, që janë të përcaktuara me Ligjin për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Mbrojtjen e Ambientit të Punës. 6. I punësuari është i detyruar t'i përmbahet rregullave për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në mënyrë që mos të rrezikojë shëndetin dhe sigurinë e vet, si dhe sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve të tjerë* ". Me nenin 5 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë përcaktohet se: *"1. Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës. 2. Punëdhënësi është i detyruar që të mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e të punësuarit që ka pësuar lëndim në punë apo sëmundje profesionale, nëse nuk i ka siguruar në ndonjë kompani të sigurimeve të të punësuarit në pikëpamje shëndetësore. 3. Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilën vend të punës. 4. Punëdhënësi është i detyruar të udhëhiqet nga parimi i trajtimit të barabartë në marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë të*

punësuarit". Me nenin 6 të këtij ligji, përcaktohet se*: " 1. Në kuadër të përgjegjësive të tij, punëdhënësi detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurt, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës. 2. Punëdhënësi duhet të veprojë në vazhdimësi në përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke i ndryshuar dhe plotësuar masat e ndërmarra më parë varësisht prej rrethanave të cilat krijohen me ndryshimet e proceseve teknike – teknologjike. 3. Punëdhënësi i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve "*. Me nenin 21 paragrafi 1, 3 dhe 4 të këtij ligji përcaktohet se: *" 1. Çdo i punësuar ka përgjegjësi të përkujdeset për sigurinë dhe shëndetin e vet dhe të personave të tjerë në punë, në përputhje me trajnimin dhe udhëzimet që i janë dhënë nga punëdhënësi. 3. I punësuari do ta lajmërojë inspektorin e punës, nëse punëdhënësi nuk i ka ndërmarrë masat përkatëse për mënjanimin, evitimin dhe eliminimin e rrezikut të bazuar nga nën-paragrafi 2.4. i paragrafit 2. të këtij neni. 4. I punësuari mund të refuzojë urdhëresën për punë, nëse e ka lajmëruar punëdhënësin, personin për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesin e të punësuarve për rrezikun që i kanoset atij/asaj nëse punon në ato kushte të punës, derisa nuk evitohet rreziku dhe nuk krijohen kushtet normale për punë."* Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: *" Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij "*. Me nenin 176 paragraf 1 të këtij ligji përcaktohet se: *" I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar "*. Me nenin 177 paragrafi 1 dhe 2 përcaktohet se: *" 1. Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t`i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij. 2. Ai ka për detyrë të shpërblejë edhe shpenzimet e mjekimit të tij nga lëndimet e marrura dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me*

mjekimin dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë". Me nenin 178 paragrafi 1 dhe 2 përcaktohet se: *" 1. Personi, të cilin e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht personi që i është shkaktuar vdekja si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga personi, të cilit i është shkaktuar vdekja ka të drejtë të shpërblimit të dëmit që pëson nga humbja e ushqimit ose e ndihmës. 2. Ky dëm shpërblehet me pagimin e rentës në të holla, shuma e së cilës caktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e që nuk mund të jetë më e madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja po të mbetej gjallë".* Me nenin 183 paragrafi 1 dhe 2 përcaktohet se: *" 1. Për dhembjet e pësuara fizike, për dhembjet e pësuara shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. 2. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror".* Me nenin 184 paragrafi 1 dhe 2 përcaktohet se: *"1. Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t`ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore. 2. Ky shpërblim mund t`u caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme".*

4. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, sepse në bazë të provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar

fakti se në këtë rast përgjegjësia është e ndarë 90 % për të padituren dhe 10 % për të ndjerin. Këtë përfundim gjykata e mbështet në provat e administruara e në veçanti në vlerësimin e super - ekspertizës nga lëmia e Makinerisë për Mbrojtje dhe Siguri në Punë, e hartuar nga ekspertet Prof. Dr. Musli Bajraktari, Prof. Dr. Hysni Osmani dhe Prof. Asoc. Dr. Shpetim Lajqi, (të cilët në mendimin e tyre profesional qartë, rrjedhshëm dhe në mënyrë profesionale janë deklaruar lidhur me shkaktarin e incidentit, mendimi i tyre është i bazuar në njohuritë e tij shkencore, dispozitat ligjore në fuqi dhe në pajtueshmëri me provat e administruara në shkresat e lëndës) nga ku rezulton se: Përgjegjësia për 90%, e të padituresë konsiston në faktin se e paditura nuk ka respektuar dispozitat e Ligjit Për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, për arsyeje se punëdhënësi në kuadër të përgjegjësive të tij ka qenë i detyruar ti marr masat për siguri dhe shëndet në punë. Sipas mendimit të ekspertëve të sigurisë në punë, lëndimi i paditësit ka ndodhur për shkak se: Nuk e ka bërë vlerësimin e rrezikut për secilin vend të punës, nuk ka ndërmarr masa për parandalim e rrezikut në punë, nuk i ka trajnuar punëtorët për Siguri dhe Shëndet në Punë, nuk ka caktuar person/përgjegjës për Siguri dhe Shëndet në Punë, pajisjet (mjetet e punës - traktori) nuk kanë qenë në gjendje të rregullt teknike, nuk është ofruar ekspertizë profesionale për ekzaminimin e traktorit se cila ka qenë arsye e mos ndezjes së tij (bateria e dobësuar, motorina/anglaseri nuk ka funksionuar apo ka pasur probleme tjera teknike që nuk ka ndezur), nuk është ofruar dëshmi se Traktori dhe Rimorkio ka qenë i regjistruar dhe si rrjedhojë i është nënshtruar kontrollimeve të rregullta në Qendrat e Kontrollimit Teknik të Automjeteve, nuk është ofruar dëshmi se Traktori dhe Rimorkio ka pasur Policë Sigurimi e cila është i nevojshëm për vazhdimin apo regjistrimin e Traktorit në Qendrat e Regjistrimit të Automjeteve dhe nuk është ofruar dëshmi se i ndjeri ka qenë i trajnuar nga punëdhënësi në aspektin e Mbrojtjes dhe Sigurisë në Punë dhe ka pasur udhëzime për rrezikun kur mjeti i punës në këtë rast traktori nuk është në gjendje të rregullt teknike, dhe në bazë të këtyre rrethanave e paditura ka përgjegjësi 90%, në shkaktimin e rastit tragjik të paditësit në punë, për arsye se punëdhënësi ka përgjegjësi për mos realizimin e sigurt të kushteve nga aspekti i mbrojtës në punë të punëtorit gjatë

kryerjes së detyrave të punës. Përgjegjësia për 10%, e paditësit konsiston në faktin se paditësi në cilësinë e punëmarrësit ka qenë i pakujdesshëm dhe sipas mendimit të ekspertëve të sigurisë në punë pasi që nuk i ka respektuar detyrimet ligjore dhe atë: Nuk ka pasur kujdes të shtuar për sigurinë dhe shëndetin e vet kur ka bërë përpjekje për ndezjen e traktorit në lëvizje i cili teknikisht nuk ka qenë në gjendje të rregull, dhe në bazë të këtyre rrethanave paditësi, i lënduari në punë ka përgjegjësi 10%, në shkaktimin e këtij incidenti ku si pasojë i njëjti ka ndërruar jetë.

5. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së parë dhe e dytë me rastin e vendosjes, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë për dëmin jomaterial, pasi që vlerësoj se shumat e gjykuara janë në përputhje me qëllimin të cilit i shërben kompensimi. Në çdo rast për dëmin jomaterial, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jomaterial e që është satisfaksion për të dëmtuarit. Në këtë rast gjykata ka pasur parasysh raportin e paditësve me tani të ndjerin duke marr për bazë rrethanën se raportet në mes të prindërve dhe fëmijëve dhe në mes të bashkëshorteve janë shumë emocionale, të ndjeshme dhe shpirtërore, dhe në këtë vështrim kjo gjykatë vlerëson se dhimbjet shpirtërore të paditësve për shkak të vdekjes së fëmijës, bashkëshortit dhe babait, kanë qenë të larta, e duke marr parasysh edhe rrethanat familjare në Kosovë, veçanërisht rrethanën se si ka ndodhur incidenti dhe mosha e tani të ndjerit, për arsye se raportet në mes të prindërve dhe fëmijëve, dhe në mes bashkëshorteve janë shumë emocionale dhe humbja e anëtarëve të familjes në incident e veçanërisht humbja e bashkëshortit dhe babait si ka ndodhur incidenti, është manifestuar me dhimbje shpirtërore shumë të larta, dhe se këto dhembje nuk ka nevojë të vërtetohen me ekspertizë mjekësore sepse këto kanë qenë evidente tek paditësit, prandaj shumat e gjykuara për këtë aspekt të dëmit, nga ana e gjykatës është konsideruar se janë në pajtim me të mirën e shkelur dhe me qëllimin të cilit i shërben kompensimi dhe se shumat e gjykuara

nga gjykata e shkallës parë të vërtetuara nga gjykata e shkallës së dytë për paditësit paraqesin një satisfaksion për ta. Gjykatat drejtë kanë vlerësuar dhe vendosur sa i përket kësaj kategorie të dëmit jomaterial sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni me provat e administruara dhe me rrethanat tjera të cilat i ka marrë në konsideratë gjykata e shkallës së parë dhe të dytë, e të cilat ndikojnë në përcaktimin e lartësisë si dhe praktika gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 183 të LMD-së.

6. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë në pjesën që është prishë dhe është kthyer në rishqyrtim sipas pikës I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1, e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi aprovimin e tërësishëm të dëmit material - fitimit të humbur. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi themelësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit material - fitimit të humbur. Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 1

e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore qe kanë të bëjnë me dëmin material - fitimin e humbur. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

7. Në këtë rast nga shkresat e lëndës rezulton se i ndjeri si pasojë e incidentit në punë ka ndërruar jetë, e në cilësi të ekspertit, për të përcaktuar fitimin e humbur në formë të rentës, për rentën e arritur dhe për të ardhmen, është caktuar eksperti financiar, i cili e ka caktuar edhe lartësinë e kërkesëpadisë për rentën e arritur dhe rentën për të ardhmen, ndërsa gjykata e shkallës së parë nuk ka marr fare mendimin e ekspertit nga lëmia e aktuaristikës, sa i përket kësaj pjese. Mirëpo nëse i referohemi shkresave të lëndës gjykata e shkallës së parë me provat e administruara nuk ka vërtetuar faktin se cila është diferenca-gjegjësisht zvogëlimi i të ardhurave personale, nuk ka vërtetuar se nga paga të cilën e fitonte i ndjeri, sa është shuma që i ndjeri e ka shpenzuar për nevojat e tij personale dhe sa është pjesa të cilën ia ka dedikuar familjes së tij. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë ka caktuar rentën për të ardhmen nga data 01.04.2022, deri më datë 22.03.2032, pa e arsyetuar këtë pjesë, se pse gjykata e ka specifikuar datën se deri kur do të zgjas kompensimi i rentës, kur dihet se me ndryshimin e rrethanave mund të ndryshoj edhe pjesa e rentës për të ardhmen, pasi që e njëjta varët nga plotësimi i kushteve. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë e kanë obliguar të paditurën që ti paguaj paditëses kontributi në pagë shumën prej 1,703.36 € (për periudhën e kaluar 01.02.2017 deri 01.04.2022), si dhe për periudhën e ardhshme (nga data 01.04.2022), në emër të kontributit në pagë shuma prej 27.47 €, pa e sqaruar se mbi cilën bazë i takon kjo e drejtë paditëses. Në këtë kuptim e drejta materiale është aplikuar gabimisht, por nuk është ndryshuar aktgjykimi në këtë pjesë sepse ka qenë e pamundur për shkak të shkeljeve të theksuara me lart.

8. Nga arsyet e theksuara u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ndërsa për pjesën që është kthyer në rigjykim udhëzohet gjykata e

shkallë së parë, që në ri-procedurë, të sqaroj se sa është shuma që i ndjeri e ka shpenzuar për nevojat e tij personale dhe sa është pjesa të cilën ia ka dedikuar familjes së tij, nëse është e arsyeshme të nxjerr ekspertizë me ekspertin e aktuaristikës. Gjykata duhet t'ia caktoj ekspertit detyrat e ekspertizës, në atë mënyrë që ekspertiza të punohet në variantin dhe atë: për rentën e arritur për pagesë deri në ditë kur punohet ekspertiza dhe pas ekspertizës renta mujore deri sa të ekzistojnë kushte ligjore, eksperti të ftohet në seancë për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e tij profesional dhe pas kësaj gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 222 dhe 224 paragraf 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
E.Rev.Nr.17/2025, datë 13.06.2025

"Gjykata Supreme e Kosovës, e ka refuzuar revizionin e të paditurës NN, kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë K.Dh.Sh.II.Nr.1236/2024, të datës 09.01.2025, në kontestin civil për kompensimin e të borxhit në emër të qirasë, duke e pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e shkallës së parë dhe Dhomat e shkallës së dytë, pasi që aktgjykimet nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare."

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin KE.Nr.868/23, të datës 13.05.2024, ka vendosur: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NN, ashtu që Detyrohet e paditura NN që në emër të qirasë për shfrytëzimin e tokës ndërtimore në sipërfaqe prej 510 m^2, sipas fletës poseduese 1230, ngastra kadastrale Nr. 69, ZK Podujevë, sipas kontratës Nr. 09-70/2002, e lidhur më datë 01.02.2001, për periudhën kohore prej datës 01.08.2010 deri më 13.04.2013, t'ia paguaj paditësit shumën prej 33,828.84 €, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale në Kosovë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e ushtrimi të padisë, datë 06.08.2013, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. II. Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit NN, mbi shumën e gjykuar si në paragrafin I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për pagesën e borxhit në emër të qirasë, sipas kontratës Nr. 0.., e lidhur më datë 01.02.2001, për periudhën kohore prej 01.02.2001 deri më 31.07.2010, në shumë prej 118,905.42 €. III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

2. Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktgjykimin K.Dh.Sh.II.Nr.1236/2024, të datës 09.01.2025, ka vendosur: Refuzohen si të pabazuara ankesa e paditëses NN dhe ankesa e të paditurës NN, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.Nr.868/23 i datës 13.05.2024, vërtetohet.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, në afat ligjor ka paraqitur revizion i padituri, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni i të paditurës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale KE.Nr.868/23 i datës 13.05.2024 dhe aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë K.Dh.Sh.II.nr1236/24 i datës 09.01.2025, të ndryshohen dhe të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar, apo të njëjtat të prishen dhe të kthehet lënda në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se: Revizioni i paditurës është i pabazuar.

5. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, më datë 06.08.2013, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të padituri, për pagesën e borxhit në emër të qirasë, duke kërkuar më saktësisht si në precizimin e kërkesëpadisë si në seancën e datës 02.04.2024. Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur sipas padisë së paditëses, kundër të padituri, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin KE.Nr.868/23, të datës 13.05.2024, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

6. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se: me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes

faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor bëri administrimin e provave si në vijim: Pasqyrën e detyrimeve të të padituës sipas kontratës së datës 01.01.2001-2012, kontratën mbi dhënien e tokës në pronësi shoqërore për shfrytëzim të përkohshëm të datës 01.01.2001, me numër të protokollit 09-70-2002, vendimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit Nr. 09-52, të datës 01.07.2008, fletë dorëzimet e lëshuara nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë pranë të padituës, konkluzionin mbi lejimin e ekzekutimit me dhunë të vendimit Nr.08-45, të datës 03.09.2010, vendimin mbi caktimin e kompensimit të qirasë për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës ndërtimore Nr. 0..., të datës 12.02.2002, vendimin e Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi për shkëputjen e kontratës për shfrytëzim të përkohshëm të lokacionit në pronësi të Komunës, Nr. 0.., të datës 08.04.2013, vendimi për caktimin e kompensimit të qirasë për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës shoqërore, Nr. 0.., të datës 12.11.2003, vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/29, të datës 08.03.2011, procesverbalin e seancës të datës 10.09.2018, mbi deklarimin e dëshmitarëve B. F., dhe H. D., aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega Podujevë C.Nr. 598/10, të datës 04.12.2015, si dhe ekspertizën financiare të datës 28.02.2024, të punuar nga eksperti gjyqësor Ramadan Ferizi. Ka shtuar se në rastin konkret, mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se e paditura ka qenë në shfrytëzim të sipërfaqes prej 510 m^2, ngastra kadastrale Nr. 6.., sipas fletës poseduese 1230, Zona Kadastrale Podujevë, deri më datë 13.04.2013, fakt ky që vërtetohet edhe nga kontrata mbi dhënien e tokës në pronësi shoqërore në shfrytëzim e datës 01.02.2001, me numër të protokollit 09-70-2002, dëgjimi i dëshmitarëve B. F., e H. D., si dhe nga vet deklarimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në seancat gjyqësore. Megjithatë, kontestuese ishte vlefshmëria e kontratës së lidhur mes palëve për shkak të nënshkrimit nga personi i paautorizuar i të padituës, si dhe parashkrimi i kërkesës së paditësit në kuptim të nenit 373 të LMD-së, nga fakti se kërkesat e paditësit burojnë nga viti 2001, ndërsa padia për pagesën e qirave sipas kontratës është paraqitur në vitin 2013. Nga Kontrata mbi dhënien e tokës në pronësi shoqërore në shfrytëzim e datës 01.02.2001, me numër të protokollit 09-70-2002,

e lidhur në afat të pacaktuar mes paditësit NN dhe të paditurit Korporata Energjetike e Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm të paditurës tokën ndërtimore në sipërfaqe prej 510 m^2, sipas ngastrës kadastrale Nr. 6.., fleta poseduese 1230, ZK Podujevë, me qëllim të vendosjes së objektit të përkohshëm për ushtrimin e veprimtarisë. Ndërsa, e paditura ka marr për obligim që në emër të qirasë për shfrytëzimin e kësaj prone, paditësit t'ia paguaj qiranë mujore në larësi prej 2,040.00 DM, duke filluar prej datës 01.02.2001. Nga vendimi Nr. 09-52/2001, i datës 12.02.2002, mbi caktimin e kompensimit të qirasë për shfrytëzim të përkohshëm të tokës ndërtimore, rezulton se paditësi ka përcaktuar lartësinë e detyrimit të të paditurës për periudhën kohore prej 01.02.2001 deri më 31.12.2001, në shumë të përgjithshme prej 11,473.00Euro. Nga vendimi Nr. 09-143, i datës 12.11.2003, i lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në kuadër të paditëses, rezulton se qiraja për periudhën prej 01.01.2003 deri më 01.10.2003 është përcaktuar në lartësi prej 13,770.00€, ndërsa shuma e përgjithshme e borxhit të të paditurës arrin lartësinë prej 48,960.00 €, tokës në pronësi të komunës. Nga vendimi i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit në kuadër të Komunës së Podujevës, Nr. 09-52, i datës 01.07.2008, rezulton se borxhi i të paditurës për shfrytëzimin e pronës sipas kontratës mes palëve, për periudhën kohore prej datës 01.02.2001, e deri më 30.06.2008 është në lartësi prej 908.60 €. Nga pasqyra e detyrimeve të të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës në bazë të kontratës së datës 01.01.2001-2012, rezulton se detyrimi i të paditurës deri në muajin dhjetor të vitit 2012 ishte në lartësi prej 145,860.00€. Nga fletë dorëzimet, rezulton se e paditura është njoftuar nga Drejtoria për Kadastër në kuadër të paditësit, për të gjitha pagesat e qerasë dhe njoftimet e tjera lidhur me kontratën e datës 01.02.2001, me numër të protokollit 09-70/2002. Nga vendimi Nr. 08/41, lëshuar nga Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, i datës 08.04.2013, rezulton se paditësja ka shkëputur kontratën e lidhur me të paditurën për shfrytëzim të përkohshëm të pronës me numër të protokollit 09-70/2002 për shkëputjen e kontratës për shfrytëzimin e përkohshëm të ngastrës kadastrale Nr. 6.., në sipërfaqe prej 510 m^2, sipas fletës

poseduese 1230, ZK Podujevë. Po ashtu ka cek se bazuar në deklarimet e palëve, provat e administruara në këtë çështje, e në veçanti nga kontrata mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës me numër të protokollit 09-70/2002, e lidhur më datë 01.02.2001, gjykata ka vërtetuar faktin se palët ndërgjyqëse kanë qenë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë, ku si qiradhënie në këtë çështje juridike është paditësi NN, ndërsa qiramarrës e paditura KEK. Sipas kësaj kontrate, palët janë pajtuar që këtu e paditura në emër të qirasë për shfrytëzimin kësaj prone të paguaj shumën mujore prej 2,040.00 DM (marka gjermane). Ndërsa, mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se e paditura ka shfrytëzuar pronën objekt të kësaj kontrate deri në vitin 2013, përkatësisht deri kur paditësi ka ushtruar padi për kompensimin në emër të qirasë. Në këtë drejtim, duke qenë se gjykata ka vërtetuar ekzistimin e raportit juridik mes palëve ndërgjyqëse, ndërsa në anën tjetër e paditura nuk ka përmbushur obligimin e saj kontraktual, përkatësisht nuk ka paguar borxhin e krijuar në emër të qirasë për shfrytëzimin e pronës, rezulton se kërkesëpadia e paditësit është bazuar në nenin 262.1 të LMD-së, pasi që mes palëve është krijuar raporti detyrimor ku paditësi ka cilësinë e kreditorit, ndërsa e paditura cilësinë e debitorit. Prandaj, duke u nisur nga fakti se e paditura me mospagimin e detyrimit i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitave të cekura si më lartë dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase kërkesa e paditësit për pagesën e qirasë për periudhën kohore prej datës 01.08.2010 e deri më 13.04.2013, në shumë të përgjithshme prej 33,828.84€, është e bazuar dhe nuk është përfshirë në parashkrim në kuptim të nenit 375 të LMD-së, ngase për asnjërën nga periudhat periodike mujore nuk kanë kaluar mbi tre vite nga arritja e secilës kërkesë për pagesë e deri në paraqitjen e padisë nga ana e paditësit, veprim ky i paditësit i cili ka pasur për pasojë ndërprerjen e rrjedhës së afatit të parashkrimit të kërkesave prej datës 01.08.2010, në kuptim të nenit 388 të LMD-së. Ndërsa, gjykata duke u mbështetur në nenin 375 të LMD-së, ka vendosur sikurse në pikën e II-të të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dipsoizitivit të këtij aktgjykim, pasi që të gjitha kërkesat e qirasë për periudhën kohore nga 01.02.2001 deri

më 31.07.2010 janë përfshirë në parashkrim nga fakti se kanë kaluar më shumë se 3 vite për secilën kërkesë periodike të arritur për pagesë para datës 01.08.2010.

7. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësja dhe i padituri kanë paraqitur ankesë, ndërsa Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktgjykimin K.Dh.Sh.II.Nr.1236/2024, të datës 09.01.2025, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e paditëses dhe të padituri, ndërsa aktgjykimin e ankimuar e ka vërtetuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

8. Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerësoi se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi: aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, para. 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat shkelje Gjykata ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së; me aktgjykimin e ankimuar është bërë konstatimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike; dhe se është bërë zbatimi i saktë i së drejtës materiale.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e shkallës së parë dhe Dhomat e shkallës së dytë, pasi që aktgjykimet nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë është e përfshirë në

shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale dhe ka rezultuar si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë. Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, sepse e njëjta ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallë së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

3. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, për arsye se: Me nenin 567 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit të datës 30 Mars 1978, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01 tetor 1978, përcaktohet se: "*Me kontratën e qirasë obligohet huadhënësi që t'i dorëzojë sendin e caktuar qiramarrësit në përdorim, ndërsa ky*

obligohet t'i paguajë për këtë qiranë e caktuar". Me nenin 583 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: " *Qiramarrësi ka për detyrë të paguaj qiranë, në afatet e caktuara me kontratë ose me ligj, e në mungesë të kontratës dhe të ligjit ashtu si kundër praktikohet në vendin ku sendi i është dorëzuar qiramarrësit* ". Me nenin 585 paragrafi 1të LMD-së, përcaktohet se: "*Qiramarrësi ka për detyrë që sendin e marr me qira, ta ruajë dhe pas mbarimit të qirasë, ta kthej të pa dëmtuar*". Me nenin 262 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: "*Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij*".

4. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se: Nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses në raport me të padituri është pjesërisht e bazuar për arsye se: faktet e treguara në padi dhe faktet në të cilët mbështetet kërkesëpadia shihet se ka ekzistuar raporti juridik në mes të palëve ndërgjyqëse, ndërsa e paditura nuk ka përmbushur obligimin e saj kontraktual, gjegjësisht nuk e ka paguar borxhin e krijuar në emër të qirasë për shfrytëzimin e pronës. Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar faktin se i padituri për periudhën kohore prej 01.08.2010 deri më datë 13.04.2013, ka qenë në shfrytëzim të lokalit e cila nuk ka qenë kontestues, dhe se për këtë periudhë kohore paditësi nuk e ka përmbushur detyrimin e tij ligjor, ndërsa kërkesëpadia sa i përket kësaj periudhe nuk është e parashkruar për faktin se nga data 01.08.2010 deri më datën 13.04.2013, kur është dorëzuar padia në gjykatë nuk kanë kaluar më tepër se 3 vite ashtu sipas nenit 375 të LMD-së, kështu afati i parashkrimit të kërkesat e qirasë si për atë që është caktuar të paguhet periodikisht ashtu edhe për atë që është caktuar të paguhet në shumë totale, parashkruhet për tre vjet,

nënkupton faktin se për këtë periudhë kohorë kërkesëpadia e paditëses nuk është e parashkruar.

5. Pretendimi i palës së paditur si në revizion se gjykata në rastin konkret gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale duke anashkaluar ligjin për energji 03/1-184 neni 24 i cili në rastin konkret është ligj special në bazë të së cilës rregullohen çështjet e energjisë elektrike, lokacionin e stabilimenteve energjetike dhe aseteve tjera përcjellëse ngase sipas nenit 24 për energjinë i cili thotë se i njihet e drejta e përdorimit të përhershëm (99vite) për të gjitha lokacionet që lidhen me stabilimentet e energjisë elektrike dhe astet përcjellëse kudo që ato në të kaluarën kur janë vendosur. Kështu sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, një pretendim i tillë është i pa bazuar ngase të njëjtat pretendime tani të parashtruar në revizion janë shqyrtuar edhe në procedurën e ankimimit në dhomat e shkallës së dytë të gjykatës komerciale e cila ka dhënë sqarime të mjaftueshme ku i mbështet edhe kjo gjykatë, andaj neni 24 i Ligjit për Energji ka për qëllim të rregulloj situatat kur ndërmarrjet energjetike gjenden në posedim të pronave private pa kontratë, por për shkak të ndërtimit të rrjeteve energjetike me qëllim publik, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një rast të tillë, por me një marrëdhënie të lindur dhe zhvilluar në mënyrë kontraktuale, sepse palët në rastin konkret kanë lidhë kontratën e qirasë Nr. 0.., më datë 01.02.2001, e cila ka krijuar raport detyrimore në mes palëve kontraktuese.

6. Pretendimi tjetër në revizion lidhur me atë se gjykata ka zbatuar gabimisht dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore ngase kontrata është fiktive dhe nule të vitit 2002, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme një pretendim i tillë është i pa bazuar ngase gjykatat e instancave më të ulëta drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale, sepse kontrata në fjalë është lidhur ndërmjet dy palëve që kanë shprehur vullnetin e tyre të lirë dhe është zbatuar faktikisht me vite, kjo e përjashton natyrën fiktive të kontratës, ngase një kontratë fiktive është ajo që bëhet për të krijuar një dukje të rreme pa pasur qëllim të vërtetë për ta zbatuar atë, por në rastin konkret ka ekzistuar shfrytëzimi i pronës që do të thotë marrëdhënia ka qenë e vërtet dhe me efekt juridik,

e për më tepër e paditura ka hyrë në raportin juridik të qirasë dhe këtë raport e ka mbajtur për një kohë të gjatë, ndërsa e paditura nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik që do të ishte provë se kontrata është lidhur në mënyrë të kundërligjshme, andaj e paditura në këtë rast nuk ka arritur me asnjë provë që ti mbështet kundërshtime e saj, ashtu sipas nenit 319 paragrafi 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës së shkallës së parë i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: " *Gjykata është e autorizuar ti vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuara në nenin 3 paragrafi 3 të këtij ligji) në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe*".

7. Gjykata Supreme më rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.329/2025, datë 04.09.2025

"Gjykata Supreme e Kosovës, e ka refuzuar revizionin e paditësit NN, kundër aktgjykimit të gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.4635/2022, të datës 17.03.2025, në kontestin civil për kompensimin e të ardhurave personale, duke e pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e shkallës së parë dhe Dhomat e shkallës së dytë, pasi që aktgjykimet nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare."

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, me aktgjykimin C.Nr.665/2020 të datës 24.05.2022, ka vendosur: I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e precizuar e paditësit NN nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura NN, me seli në Prishtinë, që paditësit t'ia kompensoj të ardhurat personale nga data e largimit në mënyrë të kundërligjshëm 17.06.2011, e deri me skadimin e kontratës së punës 03.04.2014, në shumë të përgjithshme prej 46,012.51€, me kamatë ligjore dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

2. Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin Ac.Nr.4635/2022, të datës 17.03.2025, ka vendosur: Refuzohet e pathemeltë ankesa e paditësit NN nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë -Dega në Lipjan C.Nr.665/2020 i datës 24.05.2022 vërtetohet.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësi për shkak të shkeljeve të procedurës kontestimore si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si i bazuar revizioni i paditësit

dhe të prishet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.4635/2022, i datës 17.03.2025, si dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan C.Nr.665/2020 i datës 24.05.2022, dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar. Përgjigje në revizion ka paraqitur e paditura dhe ka propozuar që të refuzohet si i pa bazuar revizioni i paditësit.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se: Revizioni i paditësit është i pabazuar.

5. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, më datë 06.07.2011, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të padituri, për shkak të kompensimit të të ardhurave personale duke kërkuar më saktësisht si në precizimin e padisë. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit kundër të padituri, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e ankimuar C.Nr.665/20, të datës 24.05.2022, me të cilin ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

6. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: nga ekspertiza financiare e datës 11.06.2021 e ekspertit Shaip Bytyqi është konstatuar se paditësi gjatë periudhës kontestues ka pasur të hyra dhe nga të ardhurat që kishte me i realizuar pas zbritjes së të hyrave shumën që kishte me realizuar është në lartësi prej 46.012.51 €, nga ekspertiza plotësuese e të njëjtit ekspert ku janë hulumtuar edhe llogarit bankare të tij është konstatuar se paditësi gjatë periudhës kontestuese nga data 17.06.2011 e deri më datën 03.04.2014 ka pasur të ardhura nga firma Fox Marblle Limited me seli në Londër, në shuma mujore prej 3,495.00 € dhe gjatë vitit 2011, 2012, dhe 2013 ka realizuar të ardhura me lartësi të njëjta mujore(me përjashtim të deponimeve nga vet paditësi 9000 €, me datë 26.10.2011 shumën prej 7000€, më datë 29.10.2011, transferi nga paditësi më datë 06.01.2012 në shumë prej 5000€, kthim borxhi më datë 15.02.2011 në shumë prej

12,135.00 €, kthim i borxhit nga B. B., më datë 07.06.2013 në shumë prej 8.500€, në lartësi mbi shumën prej 130,000 €. Ka shtuar se mbi bazën e provave të administruara e të cilave gjykata iu fali besimin pasi që me asnjë provë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor nuk u vërtetua e kundërta nga ajo siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, vërtetohet se paditësi NN nga Prishtina, ka realizuar të ardhura për periudhën kontestuese të largimit të kundërligjshëm nga puna më tepër se që kishte me i realizuar e paditura, andaj gjykata kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e të ardhurave personale e refuzoj si të pa bazuar. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 154 dhe 169 paragrafi 3 të LMD-së. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 450 të LPK-së.

7. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i padituri ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.Nr.4635/22, të datës 17.03.2025, ka vendosur që ta refuzoj ankesën e të paditësit, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë -Dega në Lipjan ta vërtetojë, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

8. Gjykata e Apelit e Kosovës në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as

në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të pabazuara. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale dhe ka rezultuar si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë. Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallë së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është

zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se: Me nenin 10, të këtij ligji, përcaktohet se: " *1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji. 2. Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra specifike. 3. Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar. 4. Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite. 5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore. 6. Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindenjëzet (120) ditë brenda një (1) viti. 7. Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj*." Me nenin 11 paragrafi 1 nga pika 1.1) deri në pikën 1.13), të këtij ligji është përcaktuar se çka duhet të përmbaj kontrata e punës. Me nenin 55 paragrafi 2 të këtij ligji, përcaktohet se: "*Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës*". Me nenin 80 të këtij ligji, përcaktohet se: " 1. *Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: 1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose 1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthej të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron*

kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna. 2. Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente ".

4. Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës si dhe nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës edhe Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka konstatuar dhe ka vendosur që kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se nga ekspertiza financiare e datës 11.06.2021, e ekspertit financiar Shaip Bytyqi është konstatuar se paditësi gjatë periudhës kontestuese nga data 17.06.2011 e deri më datë 03.04.2024, ka pasur të ardhura nga firma "Fox Marblle Limited" me seli në Londër në shumë prej 3,495.00 € dhe atë gjatë vitit 2011,2012,dhe 2013 që do të thotë i ka realizuar të ardhurat në lartësi të njëjta mujore, madje edhe më të larta dhe se paditësi nuk ka pasur dëm material me rastin e largimit nga puna, sepse gjatë kësaj periudhe të largimit i njëjti ka realizuar të ardhura më tepër se që do ti realizonte tek e paditura, ngase tek e paditura, paditësi në bazë të kontratës së punës pagën bazë e kishte në shumë prej 2,700.00€, në muaj ndërsa shuma mujore nga firma "Fox Marblle Limited" me seli në Londër, ishin në shuma mujore prej 3,495.00€ dhe i njëjtit gjatë vitit 2011,2012 dhe 2013, paditësi ka realizuar të ardhura me lartësi të njëjta mujore, andaj me të drejtë gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur që kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

5. Nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se paditësi i ka fituar mjetet të cilat nuk janë të ardhura nga marrëdhënia e punës, por janë të hyra nga shteti i Anglisë, një pretendim të tillë kjo gjykatë e refuzoj si të pa bazuar sepse të njëjtat pretendime i ka shqyrtuar në procedurën e ankimimit edhe gjykata e shkallës së dytë ku dhe ka dhënë arsye të mjaftuar të cilat i mbështet edhe kjo gjykatë ngase paditësit gjatë periudhës kontestues ka pasur të ardhura nga firma "Fox Marblle

Limited" me seli në Londër ashtu edhe siç u cek në arsyetimit e këtij aktgjykimi.

6. Paditësi në këtë rast nuk ka arritur ti vërtetojë faktet mbi të cilat e mbështetë kërkesën e tij edhe pse kjo ka qenë detyrë e tij, në kuptim të nenit 322 paragrafi 1 dhe 2 e lidhur me neni 7 paragrafi 1 dhe 319 paragrafi 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: "*Gjykata mund të kërkoi nxjerrjen e provave sipas detyrës zyrtare, për vërtetimin e fakteve edhe pse palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse ato prova po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht të përcaktuara në kuptim të nenit 3 paragraf 3 të LPK-së* ".

7. Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
E.Rev.Nr.36/2025, datë 1.09.2025

"Përkitazi me revizionin e paraqitur nga pala e paditur, kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.Nr.1372/24 dt.30.01.2025, në kontestin civil për shkak të regresit të garancionit bankar, Gjykata Supreme e Kosovës, nga arsyet e mëposhtme, e ka refuzuar të njëjtin si të pa themeltë".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.Nr.1372/24 dt.30.01.2025, refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës, me pjesën e II të dispozitivit të tij, vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, KE.Nr.310/22 dt.7.05.2024, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NLB Prishtina, detyrohet e paditura, që në emër të regresit të garancionit bankar Nr..... dhe aneksit të tij të dt. ..... t'ia paguajë paditësit shumën prej ..... euro, me kamatë ligjore në lartësi prej ..... dhe atë nga data e arritshmërisë së kërkesës më 25.04.2015, deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, me pjesën e II të dispozitivit të tij, refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që në emër të regresit të garancionit bankar t'ia paguajë paditësit edhe shumën prej ..... euro, si e pa bazuar (e cila pjesë, me pjesën e III të dispozitivit të gjykatës së shkallës së dytë, mbetet e pa shqyrtuar), dhe me pjesën e III të dispozitivit të tij, detyrohet e paditura, që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore ti paguajë shumën prej ..... euro, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

2. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Dytë Nr.1372/24 dt.30.01.2025, në afat ligjor, ka paraqitur revizion e paditura për shkak të, shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovojë revizionin e

palës së paditur si të bazuar, të prishen aktgjykimet e gjykatave më të ulëta, dhe çështja ti kthehet Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, në rigjykim.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve të revizionit dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 lidhur me nenin 505 të LPK, gjeti se:

   Revizioni i të paditurës është i pathemeltë.

4. Nga shkresat e lëndës rrjedh se fillimisht paditësi, kundër të paditurës, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi më dt.2.02.2012, për shkak të pagesës së regresit të garancionit bankar, me të dhënat si në padi, petitumin e saj, përkatësisht si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se këtu paditësi , me qëllim të garantimit të përmbushjes së obligimeve nga raporti kontraktual i të paditurës me subjektin e huaj Profine GMBH ka lëshuar garancionin bankar në vlerë prej 100.000,00 euro, dhe atë me efekt deri më dt.31.12.2004, fakt ky që vërtetohet edhe nga garancioni bankar Nr. ..... Po ashtu nuk ishte kontestues fakti se kohëzgjatja e këtij garancioni ishte vazhduar për periudhën kohore deri më 21.07.2005, fakt ky që vërtetohet nga aneksi i garancionit.

5. Kontestuese midis palëve ndërgjyqëse ishte baza juridike e kërkesëpadisë, konkretisht fakti se a i takon paditësit e drejta të kërkoi kthimin e garancionit të paguar ndaj subjektit të huaj Profine GMBH për llogari të palës paditëse si dhe a është përfshirë kërkesa e paditësit në parashkrim. Nga parashtresa e dt.28.03.2006, gjykata konstatoi se e paditura i është drejtuar palës paditëse duke e njoftuar të njëjtën se i padituri e konteston kërkesën për pagesën e garancionit bankar Nr. .... dhe aneksit të saj të kërkuar nga subjekti Profine GBMH , me arsyetimin se pala e paditur, ka përmbushur obligimet ndaj subjektit të huaj të lartë cekur në vlerë ..... euro, ashtu që ka kërkuar nga paditësi që ta anuloi garancionin dhe ta informoj palën shfrytëzuese të garancionit se nuk ka bazë për realizimin e këtij garancioni.

6. Nga aktgjykimi II C.Nr.299/07 i dt.29.01.2008, konstatohet se Gjykata Ekonomike e Qarkut ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e subjektit paditës P. G. me seli në Prishtinë dhe ka detyruar këtu paditësen (ish Kasabank) që t'ia paguajë paditësit shumën e borxhit prej ..... euro, në emër të garancisë së lëshuar bankare, me kamatë vjetore prej .... e cila normë në vendin e përmbushjes paguhet në deponime kursimore pa caktim destinimi mbi një vit, duke filluar prej dt..... deri në pagesën definitive si dhe në emër të shpenzimeve procedurale shumën prej ..... euro, i cili aktgjykim ishte vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, fakt ky që konstatohet nga aktgjykimi Ae.Nr.122/2008 dt.8.11.2011.

7. Nga propozimi për përmbarim i dt....., i lejuar sipas aktvendimit E.Nr.109/12 dt. 6.03.2012, gjykata gjeti se subjekti i huaj P. G. ka iniciuar procedurë përmbarimore ndaj këtu paditësit NLB Prishtina, për realizimin e borxhit në bazë të titullit ekzekutiv, aktgjykimit të plotfuqishëm i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë II C.Nr.299/08 dt.29.01.2008, për shumat e gjykuara si në këtë aktgjykim.

8. Nga urdhëresa për transferim të mjeteve monetare P.Nr.582/15 dt.23.04.2015, gjykata vërtetoi faktin se Përmbaruesi Privat E.M., ka lëshuar urdhëresë që mbi bazën e aktgjykimit të plotfuqishëm, të sipër cekur, nga llogaria bankare e këtu paditësit, të barten mjetet në llogari të përmbaruesit privat e për llogari të palës P. G., shumat si në vijim: për borxhin kryesor në emër të garancionit ..... euro, për shpenzime të procedurës kontestimore shumën prej ..... euro, për kamatë shumën prej ..... euro, për shpenzime të procedurës përmbarimore shumën prej ..... euro, apo në total shumën prej ..... euro.

9. Nga pasqyra bankare e lëshuar nga BQK për llogarinë bankare të paditësit, gjykata vërtetoi faktin se paditësit, nga llogaria bankare e tij, më dt.24.04.2015 i janë tërhequr mjetet në vlerë prej ..... euro, sipas urdhëresës për transferim të përmbaruesit privat E. M.. Me aktvendimin I.C.Nr.244/2007 dt. 27.09.2010, gjykata konstatoi se në çështjen kontestimore të zhvilluar në mes të paditësit P. G. kundër të padituri A.b., Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, në pikën I të

dispozitivit ka shfuqizuar aktvendimin për lejimin e përmbarimit E.Nr.245/07 dt.19.06.2007, ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paditësi P. G. ka tërheq padinë.

10. Pra, nga provat e lartë cekura, dhe atë nga garancioni bankar, i sipër përmendur, gjykata vërtetoi faktin se paditësi, në cilësinë e bankës, ka marrë obligim që në rast se këtu pala e paditur A. SH.P.K. nuk i përmbush obligimet ndaj subjektit të huaj P. G., detyrimet në fjalë do të përmbushen ndaj shfrytëzuesit pa asnjë kundërshtim. Paditësi, ka vepruar fillimisht sipas sugjerimeve të këtu palës së paditur, duke mos ekzekutuar garancionin në mënyrë vullnetare ndaj shfrytëzuesit të saj P. G., por, përfundimisht, detyrimi i këtu paditësit, që të paguaj garancionin Nr..... në vlerë prej ..... euro, për llogari të shfrytëzuesit, është vërtetuar përmes aktgjykimit I.C.Nr.244/2007 dt.27.09.2010, ku është konstatuar se garancioni bankar është kontraktuar sipas klauzolës " pa kundërshtim". Ndërsa, garancioni është ekzekutuar në procedurën përmbarimore P.Nr.582/15 dt.23.04.2015, ekzekutim ky që ka përfshirë borxhin kryesor, shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbarimore, kamatën, pra, shumat dhe totalin përkatës të sipër përmendur.

11. Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, dhe e detyroi të padituren, që palës paditëse, në emër të regresit të garancionit bankar, të ia paguajë shumën përkatëse, prej ..... euro, ndërsa, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, lidhur me shumën prej ..... euro, refuzohet si e pabazuar, (si rezultat i veprimeve të pandërgjegjshme të vet palës paditëse, me arsyet e dhëna, si më lartë, në aktgjykim e saj), ndaj, e njëjta, në bazë të nenit 1083 par.1, nenit 1087 par.2, nenit 382, etj, të LMD-së, ka vendosur si në pjesën I, II, dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

12. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, në tërësi ka aprovuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e cila ka vlerësuar se e njëjta drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën

materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, ndaj, e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka vendosur si në pjesën I, II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes juridiko civile, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse në arsyetim janë dhënë arsyet e mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet e pretenduara procedurale dhe materiale nuk mund t'i vejnë në pyetje aktgjykimet e instancave më të ulëta.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë dhe ajo e shkallës së parë, kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e së drejtës materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe kanë obliguar të padituren, që paditësit, në emër të regresit të garancionit bankar, t'ia paguajë shumën si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

3. Nisur nga kjo gjendje e çështjes civile-juridike, e duke pasur parasysh dispozitat e nenit 1083 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nga të cilat rezulton se," Banka me garancinë e vet obligohet ndaj marrësit të garancisë (shfrytëzuesit) që në rast se personi i tretë nuk ia përmbush detyrimin në afatin e arritjes për pagesë t'i paguajë detyrimin në qoftë se do të përmbushen kushtet e shënuara në garancinë. Garancia duhet të jetë në formë shkresore". Kurse, me nenin 1087.1 dhe 2, të njëjtit Ligj, parashihet garancioni " pa kundërshtim", që dmth. " Nëse garancioni bankar përmban klauzolën " pa kundërshtim" " në thirrjen e parë", apo përmban fjalët që kanë të njëjtin kuptim,...." përkatësisht,

urdhërdhënësi ka për detyrë t'i paguajë bankës çdo shumë që e ka paguar banka në bazë të garancisë të lëshuar me klauzolën nga par. 1 i këtij neni, sikundër edhe është rasti konkret civil – juridik, ndaj, nga gjykatat e instancës më të ulët, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat e të drejtës materiale, të sipër përmendura. Gjithashtu, nga të njëjtat, rezulton se drejtë kanë konstatuar se prapësimi i të padituës përkitazi me parashkrimin, nuk qëndron, për faktin se e drejta e paditësit për të kërkuar regresin e shumës së paguar në emër të garancionit bankar ka lindur me rastin e përmbushjes në mënyrë të detyrueshme në procedurën përmbarimore më dt....., nga rezulton se afati i parashkrimit për realizimin e kësaj kërkese, ka filluar të rrjedhë ditën vijuese, pra, më dt....., e kjo në mbështetje të dispozitës së nenit 361 par.1 të LMD-së, me të cilën është përcaktuar se " Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkoi përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër".

4. Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi edhe thëniet tjera të së padituës në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për arsye se është dhënë pa vlerësim ligjor të pretendimeve ankimore, por, gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara sepse gjykata e shkallës së dytë e ka bërë vlerësimin e thënieve të ankesës që kanë qenë të rëndësisë vendimtare për dhënien e vendimit të saj në kuptim të nenit 204 të LPK-së, sipas të cilës dispozitë është përcaktuar se : në arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht, aktvendimit, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësoi thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësisë vendimtare për dhënin e vendimit të saj, siç edhe ka vepruar ajo gjykatë duke dhënë arsyet për faktet vendimtare për marrjen e një vendimi të tillë. Gjithashtu, gjykatat e instancës më të ulët, në rastin konkret, me rastin e vendosjes, kanë marrë parasysh edhe dispozitat e nenit 7.1, nenit 8, nenit 319.1, nenit 322.3 të LPK-së, me të cilat veç tjerash, parashihet se palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, përkatësisht, se secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, apo se pala

e cila konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të cilit ka pushuar së ekzistuari, po qe se ligji nuk parasheh diç tjetër. Prandaj, nga këtu gjykata Supreme e Kosovës i vlerëson si të pa themelta pretendimet e revizionit për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore dhe ato për zbatimin e të drejtës materiale.

5. Prandaj, kjo Gjykatë, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar dispozitat procedurale dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe në këtë drejtim, vendimi i tyre është i drejtë dhe i ligjshëm.

6. Nga sa u theksua më lartë, e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 lidhur me nenin 505 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.252/2025, datë 10.06. 2025

"Gjykata Supreme e Kosovës e ka refuzuar si të pathemeltë revizionin e të padituri, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.Nr.4277/2022 dt.16.09.2024, për shkak të borxhit, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, drejtë kanë zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale kur kanë vendosur për aprovimin e kërkesëpadisë së palës paditëse, përkatësisht, refuzimin e ankesës së palës së paditur dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.Nr.4277/2022 dt.16.09.2024 është refuzuar si e pathemeltë ankesat e të padituri J. Zh., ndërsa, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.Nr.1706/11 dt.27.01.2022, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses ashtu që detyrohet i padituri, që në emër të borxhit t'ia paguajë paditëses shumën në vlerë të përgjithshme prej .... euro, me kamatë ligjore si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga dt.26.07.2011 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, detyrohet i padituri, që në emër të shpenzimeve të procedurës t'i kompensojë paditëses shumën prej .... euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

2. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat ligjor, i padituri ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni i të padituri, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i shkallës së parë të

anulohen, ashtu që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet apo çështja të kthehet në rigjykim.

3. Përgjigje në revizion ka paraqitur pala paditëse nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të refuzohet si i pabazuar.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion si dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se:

   Revizioni i të padituri është i pa themeltë.

5. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja më datën 26.07.2011, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të padituri, për shkak të borxhit, me të dhënat tjera, si në padi. Pas administrimit të provave, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se; Nga dokumenti i titulluar " B.i v. i J. ka qenë ndaj R. M. dhe M. M.", në këtë dokument janë paraqitur shuma e të hollave që i kishte dhënë paditësja dhe bashkëshorti i saj, këtu të padituri, sa ai i kishte kthyer kohë pas kohe, dhe në fund sa kanë mbetur borxh. Ky dokument është i nënshkruar nga i padituri dhe dy persona të tjerë Xh. A. dhe L.Zh.. Në fund të këtij dokumenti është konstatuar se i padituri ka borxh.... Euro. Nga deklarata e përbashkët familjare – akt noterial LRP .Nr..... dt....., gjykata ka konstatuar se fëmijët e paditëses dhe bashkëshortit të saj (tani i ndjerë), përkatësisht M., Y. dhe F.M. kanë deklaruar se pajtohen që mjetet financiare të cilat iu takojnë lidhur me këtë lëndë kontestimore të kalojnë në xhirollogarinë e nënës së tyre M. M. dhe se ata nuk kërkojnë asnjë kompensim. Nga certifikata Nr.ser..... e vdekjes e R. M., dt....., ka konstatuar se bashkëshorti i paditëses kishte ndërruar jetë më dt..... Nga certifikatat e lindjes, të fëmijëve Y., M., F.M., që gjenden në shkresat e lëndës, ka konstatuar se të lartë cekurit janë fëmijët e përbashkët të paditëses dhe të R.M., tani i ndjerë.

6. Në këtë çështje midis palëve ishte kontestuese nëse dokumenti i quajtur " B.i vjetër i J. ka qenë ndaj R.M. dhe M. M." ishte nënshkruar

nga ana e palës së paditur, përkatësisht J. Zh.. Gjykata në bazë të propozimit të paditurit nxori aktvendimin e dt.15.02.2021, me të cilin aprovoi propozimin e të paditurit për marrjen e provës me ekspertizë të grafologjisë ashtu që si detyrë e ekspertizës ishte caktuar që të vërtetohet se nënshkrimi i paraqitur në faqen e dytë të këtij dokumenti tek emri i J. Zh., a është nënshkrimi i të paditurit apo jo. Megjithatë, edhe pse propozimi ishte i të paditurit, i njëjti e ka pamundësuar nxjerrjen e kësaj ekspertize duke mos iu përgjigjur gjykatës në ftesën për të dhënë nënshkrimet për t'u dërguar për mostër në Laboratorin Qendror të Kriminalitiskës së Kosovës për Forenzikë. Si pasojë e kësaj, gjykata ka marrë aktvendimin procedural për abrogimin e aktvendimit C.Nr.1706/11 dt.15.02.2021, për nxjerrjen e ekspertizës së grafologjisë dhe ka vazhduar me procedurën kontestimore pa marrjen e kësaj prove.

7. Lidhur me rastin konkret civil, është bërë edhe dëgjimi i dëshmitarëve të cilët janë propozuar nga pala paditëse. Dëshmitari E. M., ka deklaruar se " nga viti 2007 deri në vitin 2009 vëllai i tij i ka dhënë para të paditurit sepse e ka pasur shok. Po ashtu, dëshmitari Xh.A., në pyetjen e paditëses, " A e ke nënshkruar ti dokumentin e titulluar si më lartë, ai veç tjerash, ka deklaruar se "Po ky është nënshkrimi im dhe unë e kam nënshkruar këtë dokument. Nuk më kujtohet se e kam lexuar para se ta nënshkruaj por me siguri ato borxhe ashtu janë" Ka shtuar se " Po, J. e ka nënshkruar këtë dokument dhe unë e kam parë duke e nënshkruar... më tej, ka shtuar se, L. Zh. është djali i J.. dhe e ka nënshkruar këtë dokument... nuk di saktë moshën e tij por i ka pasur mbi 18 vjet" etj.

8. Duke u nisur nga gjendja e këtillë faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 17, nenit 262.1, të LMD-së, nenit 319 të LPK-së, etj, të njëjtën e ka miratuar dhe ka vendosur si në pjesën I dhe II, të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

9. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së

parë dhe ka vlerësuar se drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale , kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, ndaj, e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, janë marrë me zbatimin e drejtë të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare.

2. Thëniet në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, sikundër thuhet në të, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin sepse në arsyetimin e aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, përkitazi me faktet vendimtare të sipër përmendura, janë dhënë arsyet e duhura, të plota, të drejta dhe ligjore. Edhe gjykata e shkallës së dytë, në kuptim të nenit 204 të LPK-së, në arsyetimin e aktgjykimit ë saj, gjithashtu, i ka vlerësuar të gjitha thëniet ankimore që kanë qenë të rëndësisë vendimtare për dhënien e vendimit të saj.

3. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta të cilat kishin me vënë në pyetje ligjshmërinë e aktgjykimit edhe përkitazi me zbatimin e së drejtës materiale. Kjo nga se me dispozitën e nenit 17.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashihet se "Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimit janë të detyruar të përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij ". Detyrimi për pagesën e shumës së lartë cekur, rezulton nga provat e administruara, të sipër përmendura, që gjenden në shkresat e lëndës, ashtu që, sikundër u theksua më sipër, pala e paditur nuk e ka

përmbushur në tërësi detyrimin e vet ndaj palës paditëse, të cilës i ka mbetur borxh në shumën si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Kështu që, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar dispozitën e nenit 17.1, sikundër edhe dispozitën e nenit 262.1 të LMD - së, sipas të cilës kreditori, në raportin e detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa, debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje krejtësisht siç është përmbajtja e tij. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë, në kontekstin e mësipërm, dhe me rastin e vendosjes, pati parasysh edhe dispozitën e nenit 319. 1 të LPK-së, me të cilën parashihet se " Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta", ndërkohë që, sikundër u theksua më sipër, vet pala e paditur ka propozuar marrjen e provës nëpërmjet ekspertizës së grafologjisë, për qëllimin e sipër përmendur, mirëpo, ajo, pavarësisht propozimit të vet asaj, nuk është vu në "disponim" të gjykatës së shkallës së parë, për të mundësuar administrimin e provës së lartë cekur.

4. Nga këtu dhe arsyet e lartë cekura, si dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme Rev.E.Nr.9/2025, datë 21.05.2025

"Gjykata Supreme e Kosovës, lidhur me kontestin për shkak të kompensimit të dëmit, fitimit të humbur dhe dëmit jo material, ka refuzuar revizionin e palës paditëse, të paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë ,si të pa themeltë, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, drejt kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për kompensimin e dëmit.... nga neni 136, neni 137, neni 173 të LMD-së, të cilat janë specifikuar në arsyetimin e aktgjykimit".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë K.D.SH.II.Nr.1281/24 dt.22.09.2024, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KE.Nr.262/22 dt.30.04.2024, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit E., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që në emër të eliminimit të kundërligjshëm nga aktiviteti i prokurimit Nr..... i datës .... me titull "Informimi publik për zgjedhjet e përgjithshme ....", t'ia paguajë paditësit dëmin real në shumë prej ..... euro, në emër të fitimit të humbur shumën prej ..... euro, si dhe në emër të dëmit jo material shumën prej ..... euro, apo në total shumën prej ..... euro, me kamatë ligjore prej ... në vit, dhe atë duke e llogaritur nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, dhe me pjesën e II të dispozitivit, secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

2. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, në afat ligjor pala paditëse ka paraqitur revizion, në mbështetje të dispozitës së nenit 214, par.1, pikës b) të LPK-së, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, nenit 32 të Kushtetutës, me

propozim, siç thuhet në të, të pranohet si i bazuar revizioni, ndryshohet aktgjykimi i Dhomës së shkallës së dytë, i sipër përmendur, të aprovohet tërësisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, ashtu që detyrohet e paditura, që paditësit t'ia paguajë shumat si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë, si dhe shpenzimet e procedurës, ose, pranohet revizioni si bazuar, prishet aktgjykimi i shkallës së dytë dhe lënda i kthehet të njëjtës për rivendosje.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 lidhur me nenin 505 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion si dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se:

   Revizioni i paditësit është i pa themeltë.

4. Nga shkresat e lëndës rrjedh se pala paditëse më dt.3.07.2014, kundër të paditurës, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, për shkak të kompensimit të dëmit, fitimit të humbur dhe dëmit jo material, me të dhënat si në petitumin e padisë, përkatësisht, si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së parë, nga administrimi i provave, si shikimi e leximi i kontratës dt.14.04.2014, vërtetoi faktin se e paditura, ka hapur aktivitetin e prokurimit Nr.320-14-023-111 me titull "Informimi publik për zgjedhjet e përgjithshme...." duke aplikuar procedurë të hapur të tenderimit dhe atë të ndarë në tre (...)llote.

5. Nga raporti i vlerësimit Nr.prot..... i dt....., gjykata vërtetoi faktin se komisioni për vlerësimin e tenderit pranë të paditurës, pas vlerësimit të ofertave në aktivitetin e prokurimit Nr....., ka ardhur në përfundim se oferta e përgjegjshme përfshin operatorin ekonomik MDA për lloton... dhe ...., si dhe operatorin ekonomik ASHA Group për ll..... Nga vendimi Nr.810/14 i datës 8.05.2014, gjykata vërtetoi se Presidentja e Republikës së Kosovës ka marrë vendim për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, dhe atë më dt.8.06.2014. Nga njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit Nr..... i dt....., gjykata vërtetoi faktin se e paditura, ka anuluar në tërësi aktivitetin e prokurimit "Informimi publik për zgjedhjet e

përgjithshme 2014", kjo për faktin se Presidentja e Republikës së Kosovës, ka bërë shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme më dt.8.06.2014, andaj, aktiviteti i tillë i prokurimit me procedurë të hapur të tenderimit nuk mund të përfundojë deri në datën e zgjedhjeve të parakohshme. Nga njoftimi Nr.prot.... dt....., gjykata vërtetoi faktin se Drejtori i Prokurimit i të paditurës ka njoftuar Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, se lidhur me aktivitetin "Informimi publik për zgjedhjet e përgjithshme ...." tanimë do të aplikohet procedurë e negociuar e tenderimit, kjo për shkak të afateve të shkurtra kohore. Nga kontrata me Nr.të prokurimit ..... dt.15.05.2014, vërtetoi faktin se e paditura, duke aplikuar procedurë të negociuar të tenderimit, ka lidhur kontratën me operatorin ekonomik MDA në lidhje me aktivitetin e prokurimit " Informimi publik për zgjedhjet e parakohshme ....." . Nga ankesa e paditësit e datës 16.05.2014, gjykata vërtetoi faktin se paditësi, ka drejtuar ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me Nr. ..... "Informimi publik për zgjedhjet e parakohshme .....".

6. Nga vendimi PSH Nr.132/14 i datës 26.05.2014, gjykata vërtetoi faktin se Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pezulluar aktivitetin e prokurimit, të sipër përmendur, deri sa Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të kompletojë dosjen e tenderit dhe ta dorëzoj pranë OSHP-së. Nga vendimi PSH Nr.132/14 i datës 26.05.2014, gjykata vërtetoi faktin se Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka vendosur për heqjen e pezullimit automatik të aktivitetit të prokurimit "Informimi publik zgjedhjet e parakohshme ....." me Nr. të prot. ..... Nga vendimi PSH.Nr. ..... dt....., gjykata vërtetoi faktin se Organi Shqyrtues i Prokurimit, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar ankesën e operatorit ekonomik, këtu paditësit, si të bazuar, në pikën II ka urdhëruar autoritetin kontraktues, këtu të paditurën, që në emër të shpenzimeve procedurale, konform nenit 35 të Rregullores së OSHP-së, t'ia kompensojë paditësit vlerën prej ..... euro në afat prej 10 ditësh nga pranimi i vendimit, në pikën III të vendimit e ka anuluar dhe shpallur nule kontratën e lidhur nga e paditura KQZ, me operatorin ekonomik MDA në Prishtinë, dt.15.04.2024, me arsyetimin se e njëjta është nënshkruar në kundërshtim me nenin 25 lidhur me nenin 19 par.1

të LPP-së, ndërsa, në pikën IV të vendimit, ka urdhëruar autoritetin kontraktues, këtu të paditurën, që kontratën për aktivitetin e prokurimit " Informimi publik zgjedhjet e parakohshme ....", me Nr.prot..... të lidh përsëri me operatorin ekonomik MDA, konform nenit 26 par.2 lidhur me nenin 19 par.2 të LPP-së.

7. Nga aktgjykimi PML.Nr.180/19 i datës 15.10.2019, konstatohet se Gjykata Supreme e Kosovës, ka marrë aktgjykim lirues ndaj N. H., zyrtar i të paditurës, lidhur me dyshimin se i njëjti kishte kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe autoritetit zyrtar, përmes falsifikimit të dokumenteve në dosjen e tenderit në dëm të këtu palës paditëse, lidhur me aktivitetin e prokurimit të sipër cekur.

8. Duke u nisur nga gjendja e këtillë faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se pretendimet e paditësit në padi, për kompensim të dëmit material dhe jo material si dhe fitimit të humbur, janë të pabazuara sepse paditësi nuk ka provuar ekzistimin e përgjegjësisë së të paditurës dhe bazës ligjore për kompensimin e dëmit të kërkuar nga e paditura. Fakt relevant në këtë çështje ishte fakti se e paditura përkitazi me aktivitetin e sipër cekur të prokurimit, me titull si më lartë, e ka zhvilluar me procedurë të negociuar për shkak të shpalljes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme nga Presidentja e Republikës së Kosovës, duke lidhur kontratë me një operator tjetër ekonomik dhe jo me paditësin, ndërkohë që, Organi Shqyrtues i Prokurimit, me vendimin PSH.Nr..... dt....., përkundër që në pikën i dhe II të tij ka aprovuar ankesën e paditësit dhe ka urdhëruar të paditurën që t'i kthejë paditësit shpenzimet e tenderimit, ky organ, në pikën V të saj, përsëri ka urdhëruar të paditurën që lidhur me këtë aktivitet, ta lidh kontratën me operatorin tjetër ekonomik MDA dhe jo këtu me palën paditëse, në njërën anë, dhe fakti se ndaj zyrtarit të së paditurës, që ishte iniciuar procedurë penale, për keqpërdorim të detyrës zyrtare, por, e cila procedurë ka përfunduar me aktgjykim lirues, fakt ky që konstatohet nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës PML.Nr.180/19 dt.15.10.2019. Prandaj, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe në mbështetje të

dispozitave ligjore të nenit 136 të LMD-së, nenit 143, nenit 450 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

9. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se janë të pathemelta pretendimet ankimore të paditësit dhe në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, ndaj, e ka refuzuar ankesën si dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e Dhomave të gjykatës të instancës më të ulët, janë marrë me zbatimin e drejtë të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare.

2. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimet e Dhomave të gjykatës së instancës më të ulët përmbajnë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike , meqë të njëjtat gjykata drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale dhe atë dispozitat përkatëse të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Kështu, edhe kjo Gjykatë, veç tjerash, konsideron se në rastin konkret juridiko - civil, nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative të gjitha parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit të parapara me dispozitat e nenit 136, nenit 137 dhe nenit 173 të LMD-së, siç janë; ekzistimi i subjekteve të marrëdhënies së detyrimit dhe të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, pra, shkaktuesin e dëmit dhe të dëmtuarin, ekzistimi i faktit dëmtues, nga rezulton dëmi, ekzistimi i dëmit të shkaktuar, ekzistimi i lidhjes shkakësore ndërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar si dhe të ekzistojë kundërligjshmëria e veprimit, përkatësisht, e mosveprimit,

gjë që, sikundër u theksua më lart, këto parakushte nuk janë provuar së ekzistuari nga pala paditëse.

3. Nga këtu, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerëson si të pa themelta thëniet e revizionit që kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, nga se gjykata e instancës më të ulët drejtë ka vlerësuar dhe zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit për kompensim të dëmit është e pabazuar, se me provat e administruara nuk janë vërtetuar bindshëm faktet të specifikuara më lartë, me të cilat do të vërtetohej baza juridike e kërkesëpadisë për dëmin e kërkuar, nga se në këtë kontekst pala paditëse nuk ka ofruar prova relevante me të cilat do të vërtetonte bazën juridike dhe ekzistimin e përgjegjësisë së të padituës, sikundër parashihet edhe me dispozitat e nenit 319, nenit 322 të LPK-së, ku veç tjerash, palët ndërgjyqëse kanë për detyrë të provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkesat dhe pretendimet e veta.

4. Dhomat e gjykatës të instancës më të ulët, drejtë kanë vlerësuar se me provat e prezantuara nga paditësi dhe të administruara nga gjykata nuk janë vërtetuar bindshëm faktet përkitazi me themelësinë e kërkesëpadisë që kanë të bëjnë me kërkesën për kompesimin e dëmit të kërkuar si dhe përgjegjësinë e të padituës për kompensimin e atij dëmi.

5. Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 lidhur me nenin 505 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.98/2024, datë 24.12.2024

"Në rastin konkret civil, për shkak të pronësisë, kthimit të paluajtshmërisë ose kompensimit të kundërvlerës, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as me shkelje të së drejtës materiale, dhe se drejtë kanë vendosur kur kanë refuzuar kërkesëpadinë e palës paditëse, nga se pala paditëse nuk ka provuar pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese siç parashihet me nenin 20, nenit 33, nenit 37 etj, të LMTHPJ-së".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.Nr.2841/20 dt.22.01.2024, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë C.Nr.563/19 dt.12.03.2020, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, me të cilën kanë kërkuar që të obligohet e paditura K. e P. që tua kthejë paluajtshmëritë që gjinden në Podujevë, lokalet Nr.... dhe ..ZK- P..., në sipërfaqe prej ...ari e ... m2, në ish rrugën ".....", tani rruga "Z. P..i" ose t'ia paguajnë kundërvlerën e tyre 15 ari X ..... euro, gjithsejtë shumën prej ..... euro, me kamatë ligjore si dhe të obligohet e paditura që paditësit shumën e kërkuar t'ia paguajë në afat prej 15 ditësh pas pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Me pjesën e II të dispozitivit, obligohet pala paditëse që ti paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej .... euro në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

2. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor paditësi ka paraqitur revizion, por, në të cilin nuk i ka specifikuar asnjë nga shkeljet eventuale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, (përveç që, në të thirret, përmend, disa prova të administruara e që kanë të bëjnë me gjendjen

faktike, për çka sipas nenit 214.2 të LPK-së, revizioni nuk lejohet), me propozim që, siç thuhet në të, " Kërkojë nga Gjykata Supreme ta bëjë revizionin përkatës të lëndës dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.Nr.2841/20 dt.22.01.2024 ".

3. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të revizionit dhe aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se:

   Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

4. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi më datën 17.11.2003, atëherë, në Gjykatën Komunale në Podujevë, përkatësisht, më datën 3.09.2004, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në Prishtinë, (më pas lënda e bartur për vendosje në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë), ka paraqitur padi kundër të padituresë Komunës së Podujevës, për shkak të pronësisë, kthimit të paluajtshmërisë, përkatësisht, kompensimit të kundërvlerës, me të dhënat si në petitumin e padisë dhe precizimit të saj, përkatësisht, si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Paditësi ka kërkuar kthimin e paluajtshmërisë ose kompensimin e kundërvlerës, shumës prej .....euro për sipërfaqen prej ..... m2, pasi që sipas tij... ari kushton .... euro, duke theksuar se elaborati Nr.... dhe .. kanë të bëjnë me S. të L., që lokalet e tij ishin në rr. ish "M. T." dhe kishin sipërfaqe prej ... ha, FP.Nr... ngastra ...., ndërsa, elaborati numër lënde ..., ka të bëjë me paluajtshmërinë e babait të tij në rr. Ish "..." e që tani quhet rruga "Z. P.", lokali Nr...dhe..... Nga kontrata për shitblerjen të dt....., gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se e njëjta është lidhur midis shitësit S.S. e lindur A. nga B. dhe blerësve S. Z. dhe S. B. nga P., ku objekt shitblerje kanë qenë dy zyre – hapësira pune – dyqane, të cilat kanë qenë në ish rr."...", tani rruga "Z. P." dhe atë lokali Nr... dhe Nr. ..., për çmimin e përgjithshëm prej .....dinarësh të atëhershëm, pa truallin mbrapa dyqaneve, kurse me truall shuma e përgjithshme prej ..... dinarësh në sipërfaqe prapa të dy lokaleve-trualli më së shumti prej .... metrash, nëse lejohet prej organeve drejtuese, me pagesën e kaparit, dhe të kësteve tjera ashtu siç ishin marrë vesh mes veti dhe si në shkresat e lëndës. Mirëpo, kjo kontratë ishte e pa vërtetuar, vetëm e

nënshkruar nga shitësi dhe blerësit si palë kontraktuese. Nga Vendimi i Komisionit të Qarkut për Nacionalizimin e Këshillit Ekzekutiv të K.. (A...) Nr..... dt...., vërtetohet se ky Komision e ka ndryshuar –prish Vendimin e Komisionit Komunal për Nacionalizim në P. Nr..... dt.... dhe Vendimin e Rrethit për Nacionalizim të P... Nr.... dt.... dhe hapësira objekti i punës i nacionalizuar i S.. B..që gjendet në rr ish "....", tani rruga "Z. P." në P., Nr....hiqet- e ndan nga nacionalizimi dhe i kthehet pronarit të mëparshëm në disponim të lirë – shfrytëzim, me emrin S. B.. Pra, tani nuk kemi personin me emër S. B. por S. B.. Gjithashtu, nuk kemi heqjen e nacionalizimit edhe për lokalin Nr.5, siç pretendon paditësi, por vetëm lokali Nr...., kurse lokali Nr.... është shënuar më vonë me laps kimik me dorë dhe dëshmi e kësaj është vendimi origjinal që gjendet pranë .....në P.. Sa i përket identitetit të personave me emër S. H.B., S. B. dhe S. H., nga provat e administruara, si në shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se nuk është fjala për personin e njëjtë, por, për persona të ndryshëm. Kështu, veç tjerash, nga fotokopja e letërnjoftimit të ofruar nga paditësi për babain e tij, gjykata vërteton se kemi të bëjmë me S.B. B., i lindur më dt... në P., dt. lëshimi ..., por, nuk kemi emrin e babait të S.H. B. siç pretendon paditësi por S. B. .B nga P..

5. Nga Fletë posedimi i lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë, Komuna e Podujevës, Nr..... Nr. Zonës Kadastrale .....dt...., kjo ngastër kadastrale që pretendon paditësi mban Nr.ngast. ..., vendi i quajtur "V. ...." –rr. "....", me kulturë shtëpi – ndërtesë KI.0, me sipërfaqe prej ... ari, ... m2 dhe ...., në të njëjtin vend, njëjta klasë, me kulturë oborr në sipërfaqe prej ... m e gjithsejtë janë.... ari e ... m, dhe evidentohet si pronë shoqërore. Sipas Certifikatës së paluajtshmërive Nr. lënde ..... ZKK P... dt...., vërtetohet se ngastra kadastrale Nr.P- .... në rr. "Z.. P.", evidentohet si pronë shoqërore - pronë e Komunës së Podujevës. Sipas historiatit të D., K. e P.., dt....., ref.Nr....., thuhet se : Sipas ...., lokalet afariste në fjalë, nuk ekzistojnë dhe si të tilla nuk janë të regjistruara në kadastrin zyrtarë. Në regjistrin e lëndëve të nacionalizimit Nr.....dt....., kemi gjetur ... emra S.. të radhitur sipas këtyre numrave rendor: Me Nr.1.... S. B. P., viti i nacionalizimit ...., Nr... S. B. P., viti i nacionalizimit ... dhe Nr... S. B..i L., .Ke P., po

ashtu viti i nacionalizimit ... Sipas kësaj lënde Nr...., lokali Nr...., në rrugën "...", në P., tani "Z. P.", kjo hapësirë në emër të S. B. me sipërfaqe prej ... m2, ZK, P. e nacionalizuar. Në lëndën Nr..., kemi vendimin në emër të S. B.B. nga P., i nacionalizuar në sipërfaqe prej ... m katrorë, ndërtesë në ngastrën kadastrale Nr.... dhe lënda Nr..... Në paluajtshmërinë e pretenduar nga pala paditëse, lidhur me lokalin Nr.... dhe Nr...., e cila evidentohet sipas FP.Nr.....ZK - si pronë shoqërore - pronë e Komunës së P..., që nga nacionalizimi i vitit .... e këtej, (kjo gjendje më tepër se.. vite), e që aty është ndërtuar objekti banesor dhe biznesor ...., tani objekt banesor dhe me lokale afariste.

6. Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave dhe vërtetimit të kësaj gjendje faktike, ka gjetur se është e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, ndaj, të njëjtën e ka refuzuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

7. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se e njëjta gjykatë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, ndaj , e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe as me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhënë arsye përkatëse dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se thëniet e revizionit përkitazi me shkeljet e pretenduara, nuk mund t'i vejnë në pyetje aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta.

2. Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët përkitazi me refuzimin e kërkesës së paditësit, pasi që janë dhënë arsyet bindëse dhe të pranueshme edhe nga kjo Gjykatë. Kështu, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga provat e administruara, nuk mund të përfundohet se paditësi është pronar të paluajtshmërisë kontestuese, të specifikuar në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe e cila duhet ti kthehet atij, nga se me asnjë bazë juridike, në këtë procedurë, nuk ka provuar pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese, sikundër parashihet me dispozitën e nenit 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, sipas së cilës, është paraparë se e drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit, në bazë të veprimit juridik (punës juridike), dhe me trashëgimi apo me vendim të organit shtetëror në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara me ligj.

3. Në kontestet juridike civile, kur kërkohet mbrojtje gjyqësore e pronës, dorëzimi / kthimi i paluajtshmërisë në posedim, paditësi, sipas nenit 37 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, duhet të provojë që është pronar i sendit, me të cilin nënkuptohet edhe vërtetimi i fakteve mbi të cilat bazohet e drejta e tij, dhe atë jo vetëm ndaj paditësit, por edhe ndaj paraardhësve të tij. Paditësi, në rastin konkret është i detyruar të provojnë ekzistimin e fakteve juridike në bazë të së cilave fitohet apo në bazë të së cilave mund të fitohet e drejta e kërkuar e pronës. Gjë që, në rastin konkret civil juridik, paditësi, në kuptim të nenit 20 të këtij ligji, nuk e ka provuar as bazën juridike e as mënyrën e fitimit të pronësisë (iustus titullus – modus aquirendi) të paluajtshmërisë kontestuese, të sipër përmendur.

4. Kështu, edhe me dispozitën e nenit 33 të ligjit të njëjtë, përcaktohet se në bazë të punës juridike e drejta e pronësisë në paluajtshmëri, fitohet me regjistrim në librat e tokës apo në mënyrën tjetër të caktuar me ligj, gjë që, këtu nuk ka ndodhur kështu, sikundër u theksua, sepse, kontrata për shitblerjen e pretenduar si më lartë, veç tjerash, nuk ka qenë e vërtetuar në organin kompetent dhe si pasojë pronësia mbi paluajtshmërinë kontestuese nuk ka mundur të bartet as të regjistrohet

në librat publik, d.m.th. ajo nuk është lidhur në formën përkatëse ligjore, dhe si e tillë nuk ka mundur të trajtohet si punë të vlefshme juridike dhe përkitazi me këto raste vlen parimi " se askush nuk mund të bartë në tjetrin më shumë të drejta se që ka vet ".

5. Dhe kur jemi këtu, në llogari të këtij përfundimi, në kontekstin e mësipërm, veç tjerash, flasin edhe faktet tjera relevante, se pasuria e paluajtshme kontestuese evidentohet edhe aktualisht si P. Shoqërore – pronë e Komunës së Podujevës, që nga viti..... e këtej, (ekspertiza e gjeodezisë, historiati për paluajtshmërinë kontestuese, certifikata pronësore që gjenden në shkresat e lëndës etj.), ku në të njëjtën paluajtshmëri, siç rezulton nga shkresat e lëndës dhe provat e administruara, të sipër përmendura, është ndërtuar objekti biznesor - banesor ....., objekt banesor me lokale afariste etj.

6. Për arsyet e sipër përmendura revizioni i paditësit u refuzua si i pa themeltë, ndaj, sipas dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.159/2025, datë 25.09.2025

"Gjykata Supreme e Kosovës, përkitazi me kontestin civil për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, duke vendosur sipas revizionit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.Nr.8665/2022 dt.4.09.2024, ka marrë aktgjykim me të cilin ka miratuar pjesërisht revizionin e palës së paditur, e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatave të instancës më të ulët, vetëm përkitazi me pjesën që ka të bëjë me kamatën dhe rrjedhën e saj, nga arsyet si në arsyetimin e aktgjykimit".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.8665/2022 dt. 4.09.2024, janë refuzuar si të pathemelta ankesa e paditësit dhe e të paditurit, ndërsa, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.Nr.33/21 dt30.08.2022, me të cilin, është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e dëmit material dhe jo material, detyrohet e paditura KGJK, që paditësit, në emër të privimit të kundërligjshëm nga liria, t'ia kompensojnë dëmin material dhe jo material si në vijim: Në emër të dëmit material shumën prej .....euro, ndërsa, në emër të dëmit jo material për dhimbjet shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit dhe dinjitetit shumën prej ..... euro, respektivisht shumën e përgjithshme prej ..... euro, me kamatë ligjore prej .... nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, së bashku me shpenzimet e procedurës në shumë prej ... euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me forcë. Refuzohet, pjesa tjetër e kërkesëpadisë, përkitazi me lartësinë e pretenduar të dëmit material në shumën prej ..... euro, si dhe në emër të dëmit jo material shumën prej ..... euro, si e pabazuar.

2. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, ka paraqitur revizion paditësi për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me

propozim siç thuhet në të, që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoi revizioni, ashtu që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët t'i ndryshoi, të aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit sipas precizimit të saj, siç parashihet me nenin 224 par.1 të LPK-së.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, ka paraqitur revizion edhe i padituri për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, siç thuhet në të, Gjykata Supreme e Kosovës ta prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe çështjen kontestimore të ia kthejë në rigjykim gjykatës së shkallës së parë ose që të njëjtin ta ndryshojë dhe paditësit të ia njeh të drejtën e kompensimit në emër të dëmit jo material konform kritereve të përcaktuara me Udhëzimin administrativ 01/2023 të KGJK-së, për zbatimin e procedurës së kompensimit të dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa bazë ose t'i njihet vlerë më e vogël në përputhje me standardin jetësor në Republikën e Kosovës.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 215 të LPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizionin përkatës si dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se:

   Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

   Revizioni i të padituri është pjesërisht i themeltë.

5. Nga shkresat e lëndës rezulton se më dt.8.06.2012, paditësi, kundër të padituri, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, mbi bazën e privimit pa të drejtë nga liria, me kërkesën dhe të dhënat si në petitumin e padisë, precizimit të saj, përkatësisht si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë (nga provat e administruara si aktgjykimet dhe aktvendimet përkatëse gjyqësore, fatura, njoftimi i ATK-së, etj, të cilat gjenden në shkresat e lëndës,), ka gjetur se, midis palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësit i është hequr pa bazë liria, prej 91 ditë paraburgim dhe 30 ditë arrest shtëpiak apo nga data 5.11.2008 deri më datën 5.03.2009, si dhe për këtë, paditësit i është ofruar kompensim nga komisioni i të paditurës për kompensimin e personave të dënuar pa arsye dhe

personave që u është hequr pa bazë liria, i cili kompensim është refuzuar nga paditësi më dt.24.04.2012, për shkak të mospajtimit të tij me shumën e ofruar si kompensim.

6. Midis palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por vetëm lartësia e kërkesëpadisë. Sa i përket këtij rasti civil juridik, gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se paditësi ishte arrestuar për veprën penale krim i organizuar, rrëmbim në bashkëkryerje dhe kanosje sipas Kodit Penal të Kosovës dhe mbajtur në paraburgim në kohëzgjatje prej 91 ditësh, përkatësisht ish Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktvendimin PP.Nr.173/2008 dt.5.11.2008 fillimisht i kishte caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej një muaji nga dt. 5.11.2008 deri 5.12.2008, ndërsa, me aktvendimin Kp.Nr.519/2008 të njëjtit i është vazhduar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 muajve, deri më dt.5.02.2009, kurse me aktvendimin PPN.Nr.173/3/2008, GJPP99/08 dt.4.02.2009 i është caktuar masa e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 1 muaji deri më dt.4.03.2009. Më tej , me vendimin GJPP99/08 dt.4.03.2009 ish Gjykata e Qarkut në Prishtinë kishte refuzuar kërkesën e Prokurorisë së Shtetit për vazhdimin e masës së arrestit shtëpiak, kështu duke u liruar nga masat.

7. Lidhur me dëmin jo material, gjykata e shkallës së parë, ka administruar provën me ekspertizën mjekësore të punuar nga eksperti i lëmisë së psikiatrisë Dr.N. M., e cila në mendimin e saj të dhënë më dt.21.09.2015 dhe në sqarimet e dhëna në seancën gjyqësore të dt.17.05.2021, ka theksuar se i ka rezultuar se paditësi ka përjetuar vuajtje shpirtërore të intensitetit të lartë, e cila është shoqëruar me gjendje depresioni reaktiv me rënie të disponimit dhe vullnetit, vështirësi në adaptimin me kushtet penale, e si pasojë e përjetimit të rënd emocional dhe dëmtimit të integritetit personal dhe imazhit të tij, konstatime këto të përshkruara në ekspertizë. Ndërsa, për dëmin material, gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se ky dëm është provuar nga paditësi në bazë të faturës së dorëzuar nga avokati i angazhuar, e cila faturë është vërtetuar edhe nga njoftimi i pranuar nga Administrata Tatimore e Kosovës me Nr.prot..... dt....., për çka ai ka

paguar shumën në fjalë për shërbimet profesionale që i është ofruar nga avokatët.

8. Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë e ka miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe në bazë të dispozitave të nenit 154, nenit 200 të LMD-së, nenit 452 të LPK-së, nenit 529 të KPPK-së, nenit 5, pika 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, etj, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

9. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, ka konstatuar se janë të pabazuara pretendimet ankimore të paditësit dhe të padituri dhe në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit Fikri Hasani, është pjesërisht e bazuar, ndaj, i ka refuzuar ankesat dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktgjykimet e sipër përmendura të gjykatave të instancës më të ulët, nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat pretendohet në revizionin e paditësit dhe të padituri dhe as me shkelje tjera thelbësore të dispozitave të procedurës, në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Në kontekst dhe përkitazi me rastin konkret civil - juridik, kjo gjykatë, konsideron se përgjegjësia e të padituri për të kompensuar dëmin paditësit, veç tjerash, rezulton dhe gjen mbështetje edhe në dispozitat e nenit 154 dhe nenit 200 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978). Sipas nenit 154 të LMD-së, përcaktohet se " Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ". Ndërsa, me dispozitën e nenit

200.1 të LMD-së parashihet shprehimisht se " Për dhimbjet e pësuara fizike, për dhimbjet e pësuara shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, nëse gjen se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material " , ndërsa, me par.2 të këtij neni përcaktohet se " Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror ".

3. Nga këtu, Gjykata Supreme e Kosovës, e pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët gjyqësore, përkitazi me ekzistimin e detyrimit ligjor të palës së paditur për kompensimin e dëmit, palës paditëse, si dhe miratimit të pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësit, përkatësisht, lartësisë së kompensimit të këtij dëmi jo material dhe material nga gjykatat e instancës më të ulët, me ç' rast nga të njëjtat, është bërë zbatimi i drejtë i dispozitave të së drejtës materiale.

4. Përcaktimi i kompensimit për dëmin jo material paraqet zbatim të së drejtës materiale, ndërsa, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, shuma e gjykuar, në emër të kompensimit të dëmit për shkak të privimit pa të drejt nga liria të paditësit F. H., në lartësi prej .... euro, nga gjykata e instancës më të ulët gjyqësore, është adekuate dhe në përputhje me kriteret e parapara me dispozitat e nenit 200 të LMD-së. Sa i përket kësaj shume, kjo gjykatë, vlerëson se e njëjta është në korrelacion me natyrën, peshën, llojin, shkallën e dëmit të pësuar dhe vlerave të dëmtuara të paditësit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të sipër specifikuara, sikundër që është edhe në harmoni me praktikën gjyqësore të kësaj gjykate, për rastet e ngjashme apo identike, dhe me standardin jetësor të qytetarëve në Republikën e

Kosovës, si dhe me Udhëzuesin për caktimin e kritereve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit përkatës GJ.A-Su.A Nr..... të GJSK -së dt..... Dhe kur jemi këtu, gjykata, sipas nenit 200 të LMD-së, duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim. Shuma e gjykuar në emër të kompensimit të sipër cekur, nuk ka qëllim fitimprurës (lukrativ), por, rivendosjen e ekuilibrit psikik të rrënuar tek paditësi, si një satisfakcion për të njëjtin. Gjithashtu, edhe sa i përket kompensimit të dëmit material paditësit, në shumën prej .... euro, gjykata e instancës më të ulët, ka pasur parasysh faktin se ky dëm është vërtetuar me prova përkatëse, veç tjerash, edhe nga fatura dhe njoftimi i ATK-së, të sipër përmendura.

5. Për sa i përket çështjes së kamatës dhe rrjedhës së saj, kjo Gjykatë, lidhur me këtë pjesë i ndryshoi të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, për faktin sepse sipas dispozitës së nenit 1057 të Ligjit Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, (2012) përcaktohet se " Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji", sikundër është rasti konkret, si dhe për faktin sepse, kamata, kur është në pyetje kompensimi i dëmit jo material, duhet të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e që është data 30.08.2022, ndërsa, kur është në pyetje kompensimi i dëmit material, e njëjta duhet të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë..., siç është paraparë me pikën XV dhe XIV të Opinionit Juridik të miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës, dt.1.12.2020, ndaj, nga këtu, kjo Gjykatë, përkitazi me kamatën, i ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6. Nga sa u theksua më lartë, e sipas dispozitës së nenit 222 dhe nenit 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.384/2025, datë 28.08.2025

"Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas revizionit të palës së paditur, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.Nr.7097/21 dt.13.08.2024, të njëjtin e ka refuzuar si të pa themeltë, nga se e paditura nuk ka arritur të provojë pronësinë në bazë të shitblerjes dhe të parashkrimit fitues, siç parashihet me dispozitat përkatëse ligjore, të specifikuara në arsyetimin e aktgjykimit".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.7097/21 dt.13.08.2024 është refuzuar si e pathemeltë ankesa e të padituresë G. P. nga fshati J., Komuna e Sh. dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.Nr.1043/17 dt.15.06.2021, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, aprovohet kërkesëpadia e paditësve R. S., E. S., A.S. dhe R. S. nga f. G., Komuna F., si e bazuar. Me pjesën e II të dispozitivit vërtetohet se paditësi R.S. është pronar i përbashkët i .... të pjesës ideale, kurse paditësit E. S., A. S. dhe R. S. janë pronar të përbashkët secili me nga ... e pjesës ideale në NK.Nr..... në sipërfaqe prej .... m2, dhe NK.Nr....., në sipërfaqe prej.... m2, ZK – G.. Me pjesën e III të dispozitivit, detyrohen të padituri B., B., D., V.B., nga Sh. dhe S. nga B., të gjithë me mbiemër K., M., M., S. dhe S. me mbiemër L., ish nga Sh., tani në adresë të panjohur, G. P. – K. nga fshati J., K. Sh. dhe S. D. trashëgimtar ligjor sipas të drejtës së përfaqësimit për të ndjerën N. S., që të ia pranojnë paditësve të drejtën e pronësisë, të përshkruar si në pikën II të dispozitivit dhe t'ia bartë në emrin e tyre në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në të kundërtën ky aktgjykim pas plotfuqishmërisë paditësve do ti shërbejë si dëshmi tabulare për bartjen e pronësisë në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e F., pa prezencën e të padituri. Me pjesën e IV të dispozitivit, detyrohet e paditura G.P.K. që të paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej ....,në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë dhe me pjesën e V të dispozitivit, detyrohen

paditësit solidarisht që të paguajnë diferencën e taksës gjyqësore për padi në shumë prej ...., brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit.

2. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor e paditura G. P. – K., ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim siç thuhet në të, që të pranohet revizioni si i bazuar, të prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i gjykatës së shkallës së parë, dhe çështjen ta kthejë në rigjykim gjykatës së shkallës së parë apo aktgjykimet e goditura ti ndryshojë dhe paditësit ti detyrojë në pagesën e shpenzimeve të procedurës.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

   Revizioni i të paditurës G. P. – K., është i pathemeltë.

4. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit me dt.3.12.2010, në gjykatën e shkallës së parë, kanë ngritur padi kundër të paditurve, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e së drejtës së pronësisë në bazë të shitblerjes dhe parashkrimit fitues – mbajtjes, në ngastrat kadastrale të sipër përmendura, me të dhënat tjera si në petitumin e padisë dhe precizimit të saj. Gjykata e shkallës së parë, nga shkresat e lëndës dhe nga provat e administruara, si dëgjimi i dëshmitarëve, ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë, shikimit në vend, etj, ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paraardhësi i paditësve dhe paraardhësi i të paditurve, kanë lidhur kontratë (private) jo formale për shitblerjen e patundshmërisë në sipërfaqe prej 2 hektarë e katër dhjetë ari, por kontestuese nga të paditurit G. P. – K. dhe S. D. ishte se a është lidhur nga paraardhësi i tyre apo jo pasi që nuk kanë qenë në dijeni për këtë kontratë. Gjykata e shkallës së parë, përmes kontratës me shkrim, të shkruar me dorë, më datën 15.09.1959, e lidhur midis shitëses N. S. si shitës dhe blerësit R.S., vërtetohet se shitësi ia ka shitur pronën në sipërfaqe prej ..... hektarë e .....ari, e cila pronë gjendet në fshatin G..., vendi i quajtur “

..... " kurse blerësi ia ka paguar çmimin e shitblerjes në shumë prej ..... dinarë, përmes të cilës vërtetohet fakti se paraardhësi i paditësve tani i ndjeri R.S. ka hyrë në posedim të qetë dhe me mirëbesim e të cilin posedim e ka pasur në mënyrë të pa ndërprerë dhe pa u penguar nga askush.

5. Gjykata nga deklarata e të paditurit B. K., të dhënë në seancën e dt.22.08.2017, ka vërtetuar se e ndjera N. pas vetes ka lënë fëmijët B. K. dhe D. K., D. pas vetes ka lënë fëmijët M. K., Q., C. K. të cilët kanë vdekur, kurse M. pas vetes ka lënë të paditurit S. K. dhe G. K. dhe L. K. e cila ka vdekur dhe pas vdekjes ka lënë vetëm një fëmijë S. D., kurse, Q. K. pas vdekjes ka lënë fëmijët M. K. dhe B. K., kurse, C., pas vdekjes ka lënë fëmijët M., M., S. dhe S. K., dhe për këtë gjykata ka lejuar edhe precizimin subjektiv të padisë, këtë e ka vërtetuar edhe nga deklarata e të paditurës G. P. – K., përmes të autorizuarës së saj, në seancën e dt.6.01.2021. Gjykata, përmes certifikatës së vdekjes së të ndjerit E. .S, vërtetoi se ka qenë djali i R. S., kurse, përmes ekstraktit të lindjes së R. S.,, vërtetoi se është djali i R. S., dhe se R. S. ka qenë i martuar me S. S., kurse, nëpërmjet dëshmi vdekjes së lëshuar në emër të S.S. dt.3.03.2015, vërtetoi se i ndjeri R. S. i cili ka qenë i martuar me S. S. pas vdekjes së tij ka lënë dy fëmijë R.S. dhe E.S. i cili ka vdekur më dt.28.12.2015, ku pas vetes ka lënë Gëzim S., S.S., B. S., A. S., E. S. dhe R. S., ku tre nga trashëgimtarët G.S., S. S., B.S., me anë të deklaratës trashëgimore të vërtetuar tek Noteri G.H. Nr. LRP.Nr.3767/2021 dt.28.05.2021, vërtetohet se për NK.Nr.01789-0 dhe 01790-0 për pjesën që i ka takuar tani të ndjerit prindit të tyre E. S. kanë hequr dorë në favor të tre trashëgimtarëve tjerë A., E. dhe R. S.

6. Nga ekspertiza e gjeodezisë, vërtetoi se NK.Nr..... ZK-G. ka sipërfaqe prej .... m2, kurse NK.Nr..... ZK – G. ka sipërfaqe prej.... m2, apo sipërfaqja e përgjithshme e këtyre dy paluajtshmërive është .... m2. Gjykata, me që nuk përputhet sipërfaqja e paluajtshmërisë objekt i shitblerjes ku në kontratën e ..... rezulton se shitësi, ia ka shitur blerësit sipërfaqen prej.....hektarë e ....ari, kurse, sipas gjendjes juridike dhe faktike në teren siç del edhe nga ekspertiza e gjeodezisë

rezulton se prona kontestuese ka sipërfaqe prej... hektarë e .....ari e ....m2 apo një dallim prej 15 ari e .... m2, (në kohën e shikimit në vend, një pjesë livadh dhe një pjesë e mbjellur misër) dhe lidhur me këtë, ajo mori parasysh pozicionin e këtyre dy pronave kufijtë dhe përmasat e saj, duke marrë parasysh periudhën kur është bërë shitblerja në v.... nuk është bërë fare matja e sipërfaqes përkatëse, dhe fakti se vërtetë pala paditëse edhe në pjesën e sipër cekur, edhe në krejt paluajtshmërinë si tërësi, ka hyrë në posedim në vitin ....., pas shitblerjes, të cilën e ka mbajtur në mënyrë të qetë dhe të pa penguar dhe më pas posedimi ka kaluar tek trashëgimtarët e tij, tani paditësit, gjë që, është vërtetuar edhe me dëgjimin e dëshmitarëve A.O. dhe I.O., etj, si në shkresat e lëndës.

7. Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave, ka gjetur se është e bazuar kërkesëpadia e paditësve dhe ka vërtetuar se paditësit janë pronar të ngastrave kadastrale, me të dhënat si më lartë, në bazë të ligjit dhe mbajtjes si posedues me mirëbesim, rreth ....vite të paluajtshmërisë lëndore, (nga viti .... e tutje), si dhe që, nga ajo kohë kjo e drejtë nuk iu ka kontestuar nga askush, as nga të padituri e as nga paraardhësit e tyre juridik, prandaj, e njëjta, ka vendosur si në pjesën I, II, III, IV dhe V të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

8. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e cila drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, se të njëjtit kanë fituar pronësinë me shitblerje, respektivisht, me mbajtje, dhe me mirëbesim, mbi..... vite (rreth ... vite - nga viti .... e tutje), ndaj, edhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat

kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje të së drejtës materiale. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit për shkelje të së drejtës materiale, nuk mund t'i vënë në pyetje aktgjykimet e instancave më të ulëta.

2. Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës më të ulët, përkitazi me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësve, pasi që janë dhënë arsyet ligjore bindëse dhe të pranueshme edhe nga këto gjykata. Kështu, sepse, siç rezulton nga provat e zhvilluara, shikimi në vend, ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, dëgjimi i dëshmitarëve, dëgjimi i palëve ndërgjyqëse dhe shkresat tjera të lëndës, paditësit vërtetë kanë qenë në posedim me mirëbesim dhe të papenguar nga të tjerët në paluajtshmërinë lëndore – kontestuese (rreth ...vite, pra, nga v..... e këtej) dhe se në bazë të parashkrimit fitues (usucapio) – mbajtjes, kanë fituar të drejtën e pronësisë. Kështu me dispozitën e nenit 28.4 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike (që ishte në fuqi), parashihet se " Poseduesi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm në të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë në atë send me mbajtje me kalimin e..... viteve ", siç edhe është rasti konkret juridiko-civil.

3. Pra, vetëm fakti se paluajtshmëria kontestuese, veç formalisht, evidentohet në emër të palës përkatëse të paditur - të padituve përkatës, (si në ekspertizën e gjeodezisë) nuk d.m.th.se për të njëjtit, nga arsyet e sipër cekura, kjo paraqet bazën juridike apo mënyrën e fitimit të pronësisë (i.t. – m. A.), përkatësisht, se ata gëzojnë autorizimet, tagrat pronësore, (i. U., i. f. et a.), ndërkohë që, në anën tjetër, sikundër rezulton nga shkresat e lëndës dhe provat e administruara, kjo Gjykatë konsideron se paditësit (veç tjerash) e kanë fituar pronësinë në paluajtshmërinë e më lartë theksuar, në bazë të ligjit, përkatësisht, në bazë të institutit të së drejtës civile - parashkrimit fitues - mbajtjes, pra, në mbështetje të dispozitave ligjore të nenit 20,

(nenit 30), respektivisht, nenit 28.4 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, prandaj, nga ky aspekt, nuk qëndrojnë thëniet e revizionit për shkelje të së drejtës materiale.

4. Me dispozitat e sipër përmendura përcaktohet se " e drejta e pronësisë fitohet me ligj, në bazë të punës juridike dhe me trashëgim, përkatësisht, poseduesi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm në të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë në atë send me parashkrim fitues – mbajtje me kalimin e 20 viteve", sikundër edhe është rasti konkret civil juridik, ku paditësit, sikundër u theksua më lartë, ishin në shfrytëzim dhe posedim me mirëbesim (konform nenit 72.2 të LMTHPJ-së, pas shitblerjes së bërë nga paraardhësi i tyre) në paluajtshmërinë kontestuese, që nga viti ...., ndaj, kur jemi këtu, edhe pretendimet përkatëse të revizionit të së padituresë G. P., janë vlerësuar si të paqëndrueshme juridikisht dhe jo relevante në raport me faktin dhe argumentin e mësipërm, të vërtetuar katërçipërisht nga provat e administruara dhe të vlerësuara edhe nga gjykatat e instancës më të ulët.

5. Kështu, nuk qëndron as pretendimi tjetër i palës së pa ditur, kur thekson se paluajtshmëria kontestuese i është dhënë palës paditëse në shfrytëzim me qira, gjë që, demantohet, veç tjerash, edhe me vet kontratën e shkruar me dorë, (në gjuhën serbe, në qirilicë), të lidhur më dt..... shtator ...., midis të lartë përmendurve, në të cilën qartë rezulton se bëhet fjalë për shitblerje të paluajtshmërisë përkatëse, pagesën e çmimit shitblerës, etj, dhe jo për qira.

6. Për arsyet e sipërpërmendura revizioni i të padituresë G. P.- K., u refuzua si i pa themeltë, andaj, sipas dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.422/2025, datë 11.09.2025

"Gjykata Supreme e Kosovës, lidhur me kontestin civil për shkak të vërtetimit të ekzistimit të drejtës së servitutit dhe kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas revizionit të palës paditëse – kundër të paditur, ka pranuar pjesërisht si të themeltë revizionin, ka ndryshuar të dy aktgjykimet e instancave më të ulëta gjyqësore, vetëm në pjesën që ka të bëjë me lartësinë dhe rrjedhën e kamatës, nga arsyet e dhëna në arsyetimin e aktgjykimit përkatës".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë C.Nr.512/20 dt.12.09.2022, aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve – kundër të padituve të sipër përmendur, me pjesën e II të dispozitivit të tij, vërtetohet se paditësit – kundër të padituit, e kanë të drejtën e përhershme të servitutit të kalimit me këmbë, automjete të udhëtarëve dhe automjete tjera transportuese nëpër pjesën qendrore afërsisht përmes ngastrës kadastrale shërbyese Nr.698/1, ZK – Pejë, me të dhënat tjera si në këtë pjesë të dispozitivit, me pjesën e III të dispozitivit të tij, detyrohet i padituri – kundër paditësi, që paditësve të ua pranojë dhe lejojë shfrytëzimin e papenguar të këtij servituti të rrugëkalimit të përhershëm, siç u sipër përshkrua, me të dhënat tjera si në këtë pjesë të dispozitivit, me pjesën e IV të dispozitivit, aprovohet pjesërisht si e bazuar kundërpadia e të padituit – kundër paditësit, me pjesën e V të dispozitivit, detyrohen paditësit – kundër të padituit, që të ia paguajnë në mënyrë solidare të padituit – kundër paditësit shumën prej ..... euro, në emër të kompensimit të dëmit për fitimin e humbur për shfrytëzimin e depos së paditësit në sipërfaqe prej..... m2, të ngritur në pjesën juglindore të parcelës ....., ZK- P.., për periudhën prej dt.1.01.2012 deri 22.12.2015, me kamatë ligjore prej ..... duke filluar nga data e nxjerrjes së ekspertizës financiare dt.4.02.2015 e deri tek pagesa definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Me pjesën e VI të dispozitivit, refuzohet pjesërisht si e

pabazuar kundërpadia e të paditurit – kundër paditësit, me të cilën ka kërkuar që të VII. Detyrohen paditësit – kundër të paditurit, që të përmbajnë nga shfrytëzimi për kalim këmbë, me automjete të udhëtarëve dhe me automjete transportuese nëpër pjesën qendrore të patundshmërisë e cila evidentohet si parcelë Nr..... ZK- P., me masa dhe kufi dhe të dhëna tjera si në këtë pjesë të dispozitivit, VIII. Detyrohen paditësit – kundër të paditurit që t'ia paguajnë në mënyrë solidare të paditurit – kundër paditësit shumën prej .....euro, në emër të kompensimit të dëmit të fitimit të humbur për shfrytëzimin e oborrit të paditësit në sipërfaqe prej ....m2,, që shtrihet në anën veri – perëndimore të parcelës Nr..... ZK- P. për periudhën prej 1.01.2012 deri 22.12.2015, me kamatë ligjore prej ..... duke filluar nga dt....., IX. Detyrohen paditësit – kundër të paditurit që të ia paguajnë në mënyrë solidare të paditurit – kundër paditësit shumën prej ..... euro, në emër të kamatës për periudhën ... deri ...., me kamatë ligjore prej ... duke filluar nga dt..... e deri te pagesa definitive, në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit, si e pa bazuar. X. Secila nga palët i bartë shpenzimet e veta procedurale.

2. Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.6992/2022 dt.14.04.2025, refuzohet në tërësi si e pabazuar ankesa e paditësve – kundër të padituve, ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.Nr.512/20 dt.12.09.2022, pika IV dhe V e dispozitivit, vërtetohet. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e të paditurit – kundër paditësit, prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.Nr.512/20 dt.12.09.2022, pika I, II, III, VI dhe VII e dispozitivit dhe këto pjesë i kthehen gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

3. Kundër pikës I të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, ka paraqitur revizion pala paditëse, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të LPK-së dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim siç thuhet në të, që aktgjykimin e goditur në atë pikë ta prish dhe lëndën t'ia kthejë gjykatave të instancave më të ulëta në rivendosje apo edhe që të njëjtat ti ndryshoi

dhe ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë të padituri – kundër paditësit, sa i përket kësaj kërkese.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të revizionit dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, gjeti se:

   Revizioni i paditësve – kundër të padituve është pjesërisht i themeltë.

5. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit - kundër të padituri më dt.1.02.2013, kanë parashtruar padi në gjykatën e shkallës së parë, kundër të padituri – kundër paditësit me të cilën ka kërkuar vërtetimin e ekzistimit të së drejtës së servitutit, përkatësisht, i padituri - kundër paditësi më datën 2.10.2012, ka paraqitur padi / kundërpadi ndaj paditësve – kundër të padituve, lidhur me kompensimin e dëmit, me të dhëna tjera si në padi dhe petitumin e saj, përkatësisht, si në kundër padi dhe petitumin e saj. Gjykata e shkallës së parë nga administrimi i provave, veç tjerash, ka gjetur se, nga vendimi i dt.23.11.1991 i N. " ... N." me Nr...., i nënshkruar nga ushtruesi i detyrës së drejtorit M. V., është vërtetuar se është lejuar kalimi me këmbë dhe automjete si dhe shërbimi i ngas.kad.Nr...., në dobi të pronarit të ngastrës .... të asaj kohe J. R. B. nga P.. Nga deklarata e dt.28.10.2009 dhe deklaratat e palëve ndërgjyqëse është vërtetuar se J. R.B. ka qenë pronar i ngas.kad. .... ZK- P., ndërsa i njëjti iu ka shitur paditësve – kundër të padituve A., Sh. dhe B. S.nga P., këtë ngastër, gjë që vërtetohet edhe me kontratën e dt.25.02.2003 e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë me Nr..... dt..... Nuk është kontestues fakti se paraardhësi juridik i paditësve J.R.B. ka kaluar në mënyrë të papenguar dhe në vazhdimësi përmes kësaj ngastre, ndërsa, me blerjen e paditësve edhe të njëjtit kanë vazhduar të kalojnë në të njëjtën mënyrë edhe pas daljes në shitje të pronës nga ana e kompanisë "... N.", edhe pas blerjes së ngastrës kadastrale nga i padituri – kundër paditësi B. S.. Nga njoftimi i AKP-së, në pikën 2, për shitjen e depos dhe të ngastrës kadastrale nëpër të cilën paditësit pretendonin të drejtën e servitutit të kalimit njoftohen të gjithë ofertuesit e mundshëm se pronari eventual i ardhshëm do të jetë i obliguar që tu lejojë qasje fqinjëve në pronat e tyre nëpër oborrin që shitet, përkatësisht nëpër ngastrën kad.... ZK- P..., andaj, kjo

vërtetohet se i padituri – kundër paditësi B. Sh. si ofertues i mundshëm dhe pronar eventual i ardhshëm ka qenë në dijeni për obligimin që tu lejojë fqinjëve – paditësve kalimin nëpër oborrin e lartë cekur përkatësisht nëpër ngastrën kadastrale Nr..... ZK- P.... Gjithashtu nga neni 2.4 të marrëveshjes për shitjen dhe bartjen e pronës të Agjencisë Kosovare të Privatizimit Nr..... dt....., vërtetohet se i padituri si blerës është pajtuar dhe pajtohet që pronën ta pranojë në gjendje ashtu siç është dhe në gjendje në të cilën është në kohën e transferimit i cili deklaron dhe garanton se nuk do të ketë asnjë kërkesë tjetër lidhur me këtë pronë dhe është i njoftuar lidhur me gjendjen e ngastrës kadastrale. Nuk është kontestues fakti që i padituri – kundër paditësi e ka blerë ngastrën kadastrale Nr....., e ky fakt vërtetohet me marrëveshjen e arritur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit për shitje dhe bartje të pronës të dt..... Nr..... Nga procesverbali i përpiluar me rastin e daljes në teren dt....., ekspertizës së gjeodezisë etj, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar shtrirjen gjeografike të ngas.kad.Nr..... me sipërfaqe prej ... m2, me përkufizimet e saj, nga të gjitha anët, me parcelat tjera përkatëse, Nr.....,....., etj, me të dhënat tjera, të përshkruara në mënyrë detaje, si në ekspertizën përkatëse të ekspertit të gjeodezisë Sh. K. të dt..... Nga provat e administruara, më tej, gjykata e shkallës së parë, gjeti se paditësit kanë realizuar faktikisht servitutin e kalimit mbi 20 vjet, kanë kaluar këmbë dhe me automjete në mënyrë të papenguar, përmes rrugës faktike - të parcelës ....., e cila përfshin sipërfaqen prej..... m2, me dimensione si në ekspertizën e gjeodezisë. Po ashtu, nga administrimi i provave ka vërtetuar faktin se paditësit – kundër të padituri kanë shfrytëzuar depon e cila është ndërtuar në ngastrën kadastrale Nr..... dhe të padituri si pronar i ligjshëm i asaj ngastre prej dt..... deri .... i është pamundësuar shfrytëzimi i saj, e lidhur me këtë, nga aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Themelore në Pejë P.Nr.941/13, dhe Aktgjykimi PA1.Nr.100/2015 dt.16.02.2015, i GJ.A. të Kosovës (që gjenden në shkresat e lëndës), del se paditësi A. S. është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi për shkak të veprës penale " Pushtim i paligjshëm i pronës së paluajtshme" nga neni 259 par.1 të KPK-së si dhe nga deklarimi i dëshmitarit A.B., në seancën e dt....., i cili deklaroi se " depo ka qenë e uzurpuar nga A.S. gjatë tërë kohës", dhe për sa i përket

kërkesës për dëmin e kërkuar dhe lartësisë së tij, lidhur me atë që u sipër theksua, gjykata është bazuar në ekspertizën e ekspertit financiar gjyqësor, U. S., i cili është deklaruar lidhur me dëmin dhe lartësinë e tij, si dhe përkitazi me këtë, ka dhënë mendimin dhe konstatimin e tij, me të dhënat tjera të nevojshme, si në ekspertizën e cila gjendet në shkresat e lëndës.

6. Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve – kundër të paditurve, (lidhur me servitutin) është e bazuar dhe kundër padia e të paditurit – kundër paditësit, është pjesërisht e bazuar, dhe më pas, në mbështetje të dispozitave përkatëse të LMTHPJ dhe të LMD-së, dhe ka vendosur si në pjesën I, II, III, IV, V, VI dhe VII të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

7. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, me pjesën e I të dispozitivit të tij, ka vërtetuar pikën IV dhe V të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, të sipër përmendur, pasi që lidhur me këtë, në tërësi ka aprovuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se e njëjta gjykatë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, ndërsa, me pjesën e II të dispozitivit të tij, e ka prishur në pikën I, II, III, VI dhe VII të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen përkitazi me këto pjesë, e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes juridiko civile, e përkitazi me pjesën e goditur të aktgjykimit, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Dispozitivi i aktgjykimit (në pjesën e goditur) është i çartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse në arsyetim janë dhënë arsyet

e mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet e pretenduara të së drejtës materiale dhe procedurale, nuk mund t'i vejnë në pyetje aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë dhe ajo e shkallës së parë, kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e së drejtës materiale, kur kanë gjetur se kundërpadia e të paditurit - kundër paditësit është pjesërisht e bazuar dhe kanë obliguar paditësit – kundër të paditurit, që atij t'ia kompensojnë solidarisht dëmin-fitimin e humbur, të shkaktuar nga pamundësia e shfrytëzimit të depos në mënyrën dhe kohën e sipër cekur, në lartësinë e shumës e cila është vërtetuar nga ekspertiza përkatëse dhe me prova tjera materiale dhe shkresore që gjenden në dosjen e kësaj lënde dhe si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

3. Në këtë gjendje të çështjes civilo-juridike, duhet theksuar se me dispozitën e nenit 154 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve , parashihet se; kush i shkakton dëm tjetrit ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Në rastin konkret, pala e paditur – kundër paditëse ka arritur që të provojë se pala paditëse – kundër e paditur, në mënyrën e përshkruar më lartë, asaj i ka shkaktuar dëm material, si më sipër, dhe se e njëjta është përgjegjëse për kompensimin e tij, ndaj, nga këtu, edhe kjo gjykatë, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, në mbështetje edhe të dispozitave të nenit 154, nenit 155 të LMD-së, drejtë e kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesa e kundërpadisë së të paditurit – kundër paditësit është pjesërisht e bazuar dhe në këtë drejtim, vendimi i tyre është i drejtë dhe i ligjshëm. Kështu sepse, kjo Gjykatë vlerëson se, në rastin konkret, janë plotësuar të gjitha parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit nga paditësit – kundër të paditurit, siç janë ekzistimi i subjekteve të marrëdhënies detyrimore dhe të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, i dëmtuari dhe shkaktuesi i dëmit, fakti dëmtues nga rezulton dëmi, ekzistimi i dëmit të shkaktuar, lidhja shkakësore, etj, të cilat janë përmbushur

kumulativisht, ndaj, nga këtu edhe përgjegjësia e paditësve – kundër të paditurve për kompensimin e dëmit të paditurit – kundër paditësit. Gjithashtu, veç tjerash, edhe me dispozitën e nenit 189.1 të LMD-së, parashihet se " I dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit real, ashtu edhe për kompensimin i fitimit të humbur", ndërkohë që , me dispozitat e nenit 185 të po të njëjtit ligj, parashihet se personi përgjegjës është i obliguar që të rivendos gjendjen e cila ka ekzistuar para se të ndodh dëmi, përkatësisht, nëse rivendosja e gjendjes së mëparshme, nuk eviton dëmin në tërësi, ose nuk është e mundur rivendosja e gjendjes së mëparshme, personi përgjegjës është i obliguar që për dëmin e mbetur të jep kompensimin në të holla, respektivisht, gjykata e cakton se ai do ti paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse të hollave në emër të kompensimit të dëmit, siç është edhe rasti konkret juridik civil.

4. Ndërsa, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se është pjesërisht i bazuar revizioni i paditësve – kundër të paditurve, vetëm përkitazi me pjesën që ka të bëjë me lartësinë dhe datën e rrjedhës së kamatës, prandaj, lidhur me këtë pjesë, duke pasur parasysh edhe dispozitën e nenit 1057 të LMD-së (të v..... - në të cilin thuhet se " Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji"), ka miratuar pjesërisht revizionin, i ka ndryshuar aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët gjyqësore, ashtu që ka detyruar paditësit – kundër të paditurit, që të njëjtën ta paguajnë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, kjo sepse, veç tjerash, kështu është paraparë edhe me pikën XIV të Opinionit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, të miratuar në Seancën e Përgjithshme të dt.1.12.2020, nga e cila rezulton se për kërkesat që i referohen dëmit material, kamata fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë deri në pagesën e plotë.

5. Nga arsyet e sipër theksuara, e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 dhe nenit 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.466/2025, datë 18.09.2025

"Gjykata Supreme e Kosovës, përkitazi me kontestin civil të diferencës së pagave, ka refuzuar si të pa themeltë revizionin e paditëses të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.2545/2023 dt.10.06.2025, nga arsyet e paraqitura si në arsyetimin e aktgjykimit të saj".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.Nr.1272/22 dt.9.03.2023, aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditëses, detyrohet e paditura, që paditëses, për shkak të ndërrimit të kundërligjshëm të vendit të punës, nga punët dhe detyrat punonjëse Administratore – Dega në Gjilan, në punët dhe detyrat si punonjëse Asistente e Përgjegjësit të Filialit në Gj., në bazë të vendimit me Nr.prot. ... dt.... dhe Aneks Kontratës së punës të dt....., t'ia paguajë diferencën e të ardhurave personale të papaguara, kontributet dhe tatimet për periudhën prej dt..... deri ..., edhe atë : ... euro, për të ardhurat personale ... euro, për kontributet dhe ... euro për tatimin e llogaritur, gjithsej shumën prej ... euro, të gjitha me kamatë ligjore.... duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Me pjesën e II të dispozitivit, detyrohet e paditura që t'ia paguajë paditëses shpenzimet e procedurës në shumën prej .... euro, në afat prej 7 ditësh.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.Nr.2545/23 dt.10.06.2025, aprovohet e themeltë ankesa e të padituës, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.Nr.1272/22 dt.9.03.2023, ashtu që çështja gjykohet si vijon: Refuzohet kërkesëpadia e paditëses, përmes së cilës ka kërkuar që për shkak të ndërrimit të kundërligjshëm të vendit të punës nga punët dhe detyrat e punës administratore dega në Gj., në punët dhe detyrat e punës asistente e përgjegjësit të filialit në Gj., në bazë të vendimit Nr...

dt.... dhe aneks kontratës së punës dt..., t'ia paguajë diferencën e pagave të papaguara, kontributet dhe tatimet për periudhën .... deri ..., dhe atë .... euro, për të ardhurat personale neto .... euro, për kontributet dhe ... euro për tatim gjithsej shumën prej ... euro, me kamatën prej .... vjetore llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej .... euro, në tërësi si e pabazuar.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësja në afat ligjor ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni si i bazuar, ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, të ndryshohet, ndërsa, aktgjykimi i sipër përmendur i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

4. Përgjigje në revizion ka paraqitur pala e paditur nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të refuzohet i pa bazuar.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion si dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se:

   Revizioni i paditëses është i pathemeltë.

6. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, më datën 3.03.2017 në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e diferencës së pagave, me të dhënat tjera si në petitumin e padisë, precizimit të saj, përkatësisht, si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë, nga provat e administruara ka gjetur se e paditura më dt..... ka njoftuar paditësen se më dt.... i skadon kontrata e punës; me vendimin e datës ..., paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës, më dt...., ndërkohë që, paditësja ka parashtruar ankesë te e paditura, më dt... e paditura ka aprovuar ankesën e paditëses (e cila kishte mbi 10 vite përvojë pune, te e paditura, në kohë të caktuar, respektivisht rreth ... vite, e që

konsiderohej marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar), dhe ka propozuar që e njëjta të (risistemohet) caktohet në vendin e punës Asistente e Përgjegjësit të Filialit në Gjilan; me vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të paditurës dt....., paditësja është caktuar në vendin e punës Asistente e Përgjegjësit; më datën 30.01.2017 paditësja ka parashtruar propozim me ankesë për rishqyrtim të vendimit të dt.27.01.2017, të cilën e ka dërguar me postë rekomande më dt.31.01.2017; më dt.1.01.2017 paditësja me të padituri kanë nënshkruar kontratën e punës për vendin e punës Asistente e Përgjegjësit të Filialit; me vendimin e dt.3.04.2017 është miratuar struktura e re organizative dhe është caktuar niveli i ri i pagave për stafin punonjës; më dt.3.04.2017 paditësja me të padituren kanë nënshkruar aneks kontratën për ndryshimin e lartësisë së pagës; me njoftimin e dt.10.05.2019, paditësja ka dhënë dorëheqje nga vendi i punës te e paditura; dhe me vendimin e dt.10.05.2019 është miratuar dorëheqja e paditëses. Gjykata e shkallës së parë, përkitazi me lartësinë e kompensimit të diferencës së pagave të kërkuara nga paditësja, e ka marrë për bazë ekspertizën e ekspertit financiar të dt.29.05.2017, e cila gjendet në shkresat e lëndës.

7. Në këtë gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 10, nenit 17 të Ligjit të Punës, nenit 452 dhe nenit 463 të LPK-së, etj, ka vendosur si në pjesën I, dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të sajë.

8. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, e ka aprovuar si të themeltë ankesën e të padituri, ka vlerësuar se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i papranueshëm, sepse nga gjendja faktike e vërtetuar, rrjedh se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, andaj, e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Në këtë gjendje të çështjes konkrete juridiko - civile, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë, kur ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses, përkatësisht, aprovimin e ankesës së të paditurës dhe ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, përmban arsye të mjaftueshme për faktet relevante, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Pretendimet e revizionit për shkelje thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182 par.2 p.n) të LPK-së, nuk mund ta vënë në dyshim aktgjykimin e goditur dhe si të tilla nuk qëndrojnë. Po ashtu, aktgjykimi i lartë cekur, nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, siç pretendohet në revizion. Gjykata Supreme e pranon në tërësi qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë edhe përkitazi me zbatimin e së drejtës materiale dhe përfundimin se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar.

3. Kështu për arsyet dhe për faktin relevant, se sikundër rrjedh nga shkresat e lëndës dhe nga provat e administruara, i punësuari, këtu paditësja, me të paditurën, në ndërkohë, ka lidhur kontratë të re të punës më dt.1.01.2017, me të cilën janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet mes palëve, përkatësisht është përcaktuar vendi i ri i punës, Asistente e përgjegjësit të filialit të degës të paditurës në Gj.., të cilën paditësja duhet ta kryejë te e paditura, me të drejtat dhe detyrimet si në atë kontratë, si dhe paditësja në kohën e nënshkrimit të kontratës ka qenë në dijeni për vendin e punës dhe lartësinë e pagës, ndërsa, ka pranuar kontratën nën ato kushte, si në dispozitat e saj. Me nënshkrimin e kontratës paditësja ka krijuar raport të ri kontraktues nga marrëdhënia e punës me të paditurën. Më pas, më dt. ....., midis tyre, është lidhur edhe aneks kontrata. Të dy këto kontrata, pos të paditurës, sikundër rezulton nga shkresat e lëndës, janë nënshkruar pa vërejtje edhe nga vet paditësja, kjo më tej, d.m.th. të dy kontratat janë lidhur dhe nënshkruar me vullnetin e shprehur të lirë edhe të paditëses,

dhe nuk është provuar me asgjë se të njëjtat janë lidhur dhe nënshkruar nën lajthim, kërcënim a mashtrim (v., c. , p.). Ndaj, në kontekstin e mësipërm, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret, kontratat e sipër përmendura, janë lidhur në pajtim me dispozitat përkatëse të Kontratës së Punës, në harmoni me dispozitat e nenit 3.1.10, nenit 10, nenit 11, par.1 nënp.1.8, si dhe nenit 55 të Ligjit të Punës. Me këto dispozita specifikohet, veç tjerash, se me Marrëdhënie të Punës kuptohet një marrëveshje ose rregullim kontraktual ndërmjet një punëdhënësi dhe të punësuarit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive specifike nga i punësuari nën mbikëqyrjen e punëdhënësit, kundrejt një pagese të dakorduar, zakonisht në formë të parave. E njëjta lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari dhe që përbën elementet nga neni 11 i Ligjit të sipër përmendur, si kohëzgjatjen e kontratës së punës, lartësinë e pagës bazë, etj, sikundër edhe është vepruar në rastin konkret juridik – civil.

4. Nga këtu, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i goditur i gjykatës së shkallës së dytë, është i drejtë dhe i ligjshëm.

5. Për arsyet e sipërpërmendura dhe në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.469/2025, datë 24.09.2025

"Gjykata Supreme e Kosovës, në kontestin civil përkitazi me kompensimin e pagave jubilare, shujtës ditore, përvojës së punës dhe punën gjatë fund javës, ka refuzuar revizionin e të padituresi të pa themeltë, paraqitur kundër pjesës së I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.8718/2022 dt.10.06.2025, që ka të bëjë me paditësit përkatës, dhe ka hedhur poshtë si të palejuar revizionin e të padituresi, në pjesën që ka të bëjë me dy paditësit përkatës, nga arsyet e dhëna në arsyetimin e tij".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan C.Nr.154/20 dt.2.06.2022, aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, të sipër përmendur dhe detyrohet e paditura, që paditësve të mëposhtë shënuar, t'ia kompensojë shumat si në vijim:1. Për paditësin F. M. në emër të kompensimit për orët e punës gjatë fundjavës shumën prej . euro. 2. Për paditësin F.M., po ashtu për kompensimin për orët e punës gjatë fundjavës shumën prej . euro. 3. Për paditësin M. K., gjithashtu për orët e punës në fundjavë, shumën prej .... euro. 4. Për paditësin M. Z., gjithashtu, shumën prej .... euro. 5. Për paditësin L. M., po ashtu, shumën prej ..... euro dhe 6. Për paditësin B. C., po ashtu, për orët e punës gjatë fundjavës, shumën prej .... euro, për të gjithë me kamatë prej ... duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit dt. ..... e deri në pagesën definitive. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësve t'ua shpërblejë edhe shujtat ditore, përvojën e punës, shpërblimin jubilar, me të dhënat përkatëse dhe në lartësinë e shumave si në pikat 1. deri në 6., të kësajë pjese të dipsozitivit, është refuzuar si e pa bazuar dhe me pjesën e III të dispozitivit të tij, detyrohet e paditura që paditësve t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej .... euro, të gjitha

këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

2. Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.8718/22 dt.10.06.2025, është refuzuar si e pa themeltë ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar në pikën I të dispozitivit aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan C.Nr.154/20 dt.2.06.2022. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, aprovohet si e themeltë ankesa e paditësve të lartë cekur, dhe prishet në pikën II dhe III të dispozitivit aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan C.Nr.154/20 dtz.2.06.2022 , dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

3. Kundër pjesës së I të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura në afat ligjor ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si thuhet në të, që Gjykata Supreme e Kosovës ta pranojë si të bazuar revizionin e paraqitur nga e paditura.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 dhe nenit 218 par.2 pika d) të LPK-së dhe shkresave të lëndës si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion , ka gjetur se:

   Revizioni i të paditurës, në raport me dy paditësit e parë është i palejuar, ndërsa, në raport me paditësit tjerë, është i pa themeltë.

5. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit më datën 28.01.2020, kanë paraqitur padi kundër të paditurës, në gjykatën e shkallës së parë, për kompensimin e pagave jubilare, shujtës ditore, përvojës së punës dhe për punën gjatë vikendeve - fundjavës, me të dhënat tjera si në padi dhe kërkesëpadi, përkatësisht, si në precizimin e saj, dt.26.04.2022. Gjyjkata e shkallës së parë, nga administrimi i provave ka gjetur se nuk është kontestues fakti që paditësit te e paditura janë të punësuar në pozita të ndryshme, e kjo vërtetohet edhe nga konfirmimi mbi

punësimin HR-...../dt....., të lëshuar nga e paditura për paditësin L. M., konfirmimi mbi punësimin HR..... dt....., të lëshuar nga e paditura për paditësin B. C., konfirmimi mbi punësimin HR-..... dt..... të lëshuar nga e paditura për paditësin F.M., konfirmimi HR-../dt....., të lëshuar nga e paditura për paditësinb F.i M., konfirmimi mbi punësimin HR-..-...../dt....., të lëshuar nga e paditura për paditësin M. K., konfirmimi mbi punësimin HR-.dt...., të lëshuar nga e paditura për paditësin M. Z.. Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse është baza juridike, nëse paditësve ju takon e drejta për kompensimin e pagave jubilare, shujtës ditore, përvojës së punës dhe orëve të vikendeve. Nga kërkesa e S.. "A. J." dt....., vërtetohet se Sindikata e punëtorëve të ANP-së, i është drejtuar y.H. F. K., drejtor menaxhues në L. dhe B. Z., menaxher i Burimeve Njerëzore në LKIA, i është drejtuar me kërkesë e cila përfshin 5 pika, e pika 4 e kësaj kërkese ka të bëjë me pagesën e orëve të punës gjatë vikendeve sipas Ligjit të Punës, neni 56 pika 2.5. Nga tërheqje nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, Nr.... dt..., vërtetohet se Oda Ekonomike e Kosovës, si nënshkruese e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, e njofton Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, se ztërhiqet nga zbatimi i MKK-së tre muaj para skadimit të vlefshmërisë së sajë. Nga ekspertiza financiare e dt.31.12.2022, e ekspertit financiar G. B. nga L., vërtetohet se paditësve, për periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2019, vlera e përllogaritur e orëve të punës gjatë vikendeve të papaguara nga e paditura janë: për paditësin F.M. shuma prej . euro, për paditësin F. M. shuma prej ... euro, për paditësin M. K.,shuma prej .. euro, për paditësin M. Z., shuma prej ..... euro, për paditësin L. M., shuma prej . euro dhe për paditësin B. C., shuma prej .... euro, me të dhënat tjera të detajuara si në ekspertizën e tij, e cila gjendet në shkresat e lëndës. Lidhur me këtë, gjyjkata e shkallës së parë, nga provat e administruara, ka konstatuar se me asnjë provë deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor nuk është argumentuar se e paditura ju ka paguar paditësve orët e punës gjatë vikendeve.

6. Në këtë gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësve pagesën për punën shtesë për orët e punës gjatë fundjavës, kurse, mos pagesa e kompensimit

shtesë për punët e lartë cekura, nga ana e të padituerës, veç tjerash, është në edhe me dispoziat përkatëse ligjore, nga se një e drejtë e tillë e punëtorit – e paditësve, parashihet, po ashtu, shprehimisht me dispozitat e nenit 56 par.1 dhe 2, dhe nënp.2.5 të Ligjit të Punës, prandaj, gjykata e shkallës së parë, këtë pjesë të kërkesë padisë së paditësve e aprovoi si të bazuar, kurse, kërkesën e tyre për kompensimin në emër të shujtës ditore, shpërblimit jubilar, përvojës së punës, e ka refuzuar si të pabazuar, ndaj, ka vendosur si në pjesën e I, II, dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të sajë.

7. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të saj, përkitazi me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se e njëjta drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve, në atë pjesë, është e bazuar dhe në atë pjesë e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, kurse, me pjesën e II të dispozitivit të aktgjykimit të saj, e ka aprovuar ankesën e paditësve dhe pjesën e II dhe të III të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, sikundër u theksua edhe më lartë, e ka prishur dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes konkrete juridiko civile, pranon si të themeltë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, lidhur me aprovimin si të themeltë të kërkesëpadisë së paditësve, përkitazi me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, që ka të bëjë me kompensimin e pagës shtesë për punët e sipër përmendura, (gjatë fundjavës) nga se aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe se nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Objekt shqyrtimi në Gjykatën Supreme të Kosovës, ishin edhe pretendimet e revizionit lidhur me shkeljet e dispozitave procedurale dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale etj, por, kjo Gjykatë, vlerëson se këto aktgjykime nuk përfshihen me të meta e pa qartësi as në dispozitiv e as në arsyetimin e tyre, arsyet e dhëna janë të qarta, të mjaftueshme për faktet juridikisht të vlefshme për gjykimin e drejtë të çështjes, të cilat janë të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit, andaj, si të tilla, ato pretendime nuk janë të qëndrueshme juridikisht.

3. Gjithashtu, nuk qëndron as pretendimi vijues i të paditurës, se punëtorëve - paditësve nuk u takon kompensimi shtesë për punët e sipër përmendura. Kështu, nga fakti sepse, një e drejtë e sipër përmendur e punëtoreve, këtu, paditësve, veç tjerash, është paraparë edhe me dispozitat përkatëse ligjore. Dhe kur jemi këtu, duhet theksuar se edhe me dispozitat e nenit 4 të Ligjit të Punës, veç tjerash, parashihet se dispozitat e Kontratës Kolektive, Aktit të Brendshëm të Punëdhënësit, dhe Kontratat e Punës, duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij Ligji (neni 4.1 i LP-së), përkatësisht, ” Akti i Brendshëm i Punëdhënësit dhe Kontrata e Punës, mund të përmbajnë dispozita me të cilat përcaktohen më shumë të drejta dhe kushte të favorshme, nga të drejtat dhe kushtet e përcaktuara me ligj, përveç nëse me këtë ligj është përcaktuar ndryshe “(neni 4.3 i LP-së).

4. Kështu, në kontekstin e mësipërm, duhet theksuar nenin 56.1, veçanërisht, dispozitën e nenit 56 par.2 të Ligjit të Punës, me të cilën shprehimisht parashihet se “ Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë: nënpar. 2.1..... në orë për kujdestari; nënpar. 2.2. ... në orë për punë gjatë natës; nënpar .2.3. .... në orë për punë jasht orarit; nënpar. 2.4. .. në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe nënpar. 2.5.... në orë për punë gjatë fundjavës. Nga këtu, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se të punësuarve, në rastin konkret paditësve, u takon paga shtesë për punët e përshkruara si më lartë, përkatësisht, si në nenin 56 të Ligjit të Punës. Ndërkohë që, te ne, në Republikën e Kosovës, sikundër edhe në pjesën dominuese të

kontinenteve, dita e shtunë dhe e dielë, janë përcaktuar si ditë (weekend) të fundjavës, në të cilat sipas rregullit (në parim) nuk punohet, përpos, rasteve të rregulluara ndryshe me ligj, siç ka vepruar edhe Ligjëdhënësi i ynë, në mënyrën e sipër përmendur. Prandaj, lidhur me këtë që u sipër theksua, Gjykata Supreme e Kosovës, për sa i përket, sipas radhës, katër paditësve të fundit, ka vendosur si në pjesën e parë të dispozitivit të aktgjykimit të saj, ndërsa, përkitazi me dy paditësit e parë, kjo Gjykatë, vendosi si në pjesën e dytë të dispozitivit të aktgjkykimit të saj, nga se me dispozitën e nenit 211.2 të LPK-së, parashihet se " Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit...., po qe se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000-euro". Spas kësaj dispozite ligjore rrjedh se, në rastin konkret, e për sa i përket dy paditësve të parë, vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit është më e vogël se 3.000-euro, revizioni nuk është i lejuar.

5. Ndërkohë që, për sa i përket çështjes së kamatës, përkatësisht, datës për rrjedhën së saj, kjo Gjykatë, pati parasysh faktin se revizion ka paraqitur vetëm pala e paditur dhe në anën tjetër parimin "Reformatio in peius", përkatësisht, dispozitën e nenit 203 të LPK-së.

6. Për arsyet e sipërpërmendura dhe në pajtim me nenin 218, nenin 221 dhe nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.518/2024 datë 25.11.2024

"Gjykata Supreme e Kosovës, lidhur me kontestin civil të kompensimit të dëmit ka refuzuar si të pa themeltë revizionin e palës së paditur, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.4900/21 dt.9.09.2024, nga se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë drejtë kanë zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe kanë obliguar të padituren që të ia kompensojë dëmin përkatës, konformë dispozitave përkatëse të LMD-së, të specifikuara dhe arsyetuara si në arsyetimin e aktgjykimit''.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.4900/21 dt.9.09.2024, refuzohen si e pa bazuara ankesa e paditësit dhe ankesa e të padituresë dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.Nr.608/2009 dt.26.04.2021, me të cilin, aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit. Detyrohet e paditura, që paditësit, të ia kompensojë dëmin e pësuar në aksidentin – kontaktin me rrymën elektrike të datës 15.11.2003 dhe atë: - Në emër të fitimit të humbur (rentës) si vijon: - për fitim të humbur (rentës) për periudhën e kaluar prej 1.09.2011 kur paditësi ka arritur moshën madhore prej ... vjet e deri më dt.30.06.2020, shumën prej ..... euro,- për periudhën e ardhshme prej 1.07.2020 e tutje deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore në emër të rentës mujore nga .. në muaj, duke bërë pagesën prej ..... të çdo muaji vijues. – Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj si vijon: - Për periudhën e kaluar prej lëndimit të tij më ... e deri më ... shumën prej ... euro, dhe - për periudhën e ardhshme prej .....e tutje deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore nga ....euro në muaj, duke bërë pagesën prej .... të çdo muaji vijues. – Në shumën e aprovuar paditësit në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, duhet ti llogaritet edhe shuma prej .....-euro, e paguar paditësit nga e paditura, sipas aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Podujevë C.Nr.54/2007

dt.14.05.2007. – Në emër të protezës shumën prej .....-euro. Detyrohet e paditura që shumat e aprovuara t'ia paguajë paditësit me kamatë ligjor siç paguajnë bankat afariste në Kosovë, për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit dt.26.04.2021 deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për shqyrtimet gjyqësore të mbajtura sipas lëndëve të specifikuara në këtë pjesë të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

2. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, ka paraqitur revizion e paditura për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPK-së dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni i të paditurës, ndërsa, aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta ndryshohen ashtu që refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar.

3. Përgjigje në revizion ka paraqitur pala paditëse, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të refuzohet si i pabazuar.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të revizionit dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, gjeti se:

   Revizioni i të paditurës është i pathemeltë.

5. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka parashtruar padi kundër të paditurës, më datën 2.03.2004,në gjykatën e shkallës së parë, me të dhënat si në petitumin e padisë, precizimit të sajë, përkatësisht, si në dipsozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Paditësi (atëherë) i mitur N. H., i lindur më dt...., deri sa ka qenë duke e ruajtur bagëtinë në livadhe të f. D. e P., në vendin e quajtur "Sh.", K. e P., më datën ....., nga kontakti me rrymën elektrike, telin e vendosur në lartë përçuesin i cili kishte rënë në afërsi të tokës, kishte pësuar lëndime të rënda trupore me rastin e kontaktit të trupit të paditësit dhe elektrizimi nga përçuesi elektrik, në formë të djegies të dy duarve dhe barkut, të dy këmbëve në regjionin e mbi gjunjëve, dora e djathtë i digjet në

tërësi, shkalla e katërt e djegies, (shih fotot në shkresat e lëndës, etj) e cila është përcjellë me karbonifikim, në dorën e majtë ka pësuar lëndime të rënda të shuplakës së dorës dhe parakrahut deri në pjesën distale të tij dhe anës së mbarshme – volare, të shkallës së tretë, përkatësisht në nërkozë – kalbje të lëkurës, nënlëkurës dhe muskujve, djegiet në bark dhe në dy këmbët janë të shkallës së tretë, për shkak të djegieve të pësuara bëhet amputimi i dorës së djathtë – këputja e dorës së djathtë në nivel të ...cm, nën krah, ndërsa në dorën e majtë bëhet këputja e pjesës distale të gishtit të parë, të dytë dhe të tretë, ndërsa, vendet tjera të djegura mjekohen me vraga me cikatrikse të thella të cilat lënë pasoja anatomike dhe funksionale të përjetshme nëpër trup, të cilat lëndime janë me pasoja të përhershme.

6. Gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit, që nga e paditura të kërkoi kompensimin e dëmit dhe se e paditura është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të pësuar të paditësit në kontaktin me rrymën më dt.15.11.2003, është jokontestuese nga se kjo është vërtetuar tani më me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës C.Nr.101/2005 dt.18.04.2006 i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së qarkut në Prishtinë Ac.Nr.516/2006 dt.11.01.2007, si dhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.64/2007 dt.27.12.2007.

7. Ndërsa, kontestues ishte fakti se paditësi pasi që ka mbushur moshën madhore, a ka nevojë për ndihmë dhe kujdes të personit të tretë, fakti se paditësit a duhet ti vendoset ndihma me mjete ortopedike – proteza si dhe fakti se paditësi ka mbushur moshën madhore të vlerësohet lloji dhe natyra e lëndimeve si dhe pasojat e mbetura dhe shkalla e aftësisë punuese- zvogëlimi i aftësisë punuese, dhe lartësia e kërkesëpadisë së paditësit, përkitazi me këto çështje, gjykata e shkallës së parë, veç tjerash, administroi provat me ekspertizën e ekspertit mjekësor D..S. D., ortoped – t., mendimin - ekspertizën e grupit të ekspertëve Dr. N. A.., eksperte e f., Dr. A. H., ekspert i mjekësisë së punës, dhe Dr. Z. B., ekspert i kirurgjisë plastike, nga të cilët, është konstatuar se paditësi edhe pas mbushjes së moshës madhore ka nevojë për ndihmë dhe kujdes të personit të tretë gjatë tërë jetës, po ashtu në kuptim të

përmirësimit të kualitetit të jetës të paditësit është e domosdoshme ndihma në mjete ortopedike – protezë (ka mbushur moshën madhore, përkatësisht, moshën .... vjeçare, që është kusht për vënien e protezës) e cila në varësi nga institucione të specializuara mund të ketë edhe kuptimin e saj mekanik funksional.

8. Gjithashtu, është konstatuar përfundimisht se zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është në shkallë .... kurse zvogëlimi i aftësisë punuese tek paditësi është në shkallën prej ..... si dhe më pas ka administruar edhe ekspertizën e ekspertit financiar - të aktuaristikës, me të gjitha të dhënat e specifikuara si në ekspertizën e tij, e cila gjendet në shkresat e lëndës. Gjykatës së shkallës së parë, lidhur me mendimin e ekspertit ortoped – traumatolog, për nevojën e paditësit, për mjetin ortopedik – protezën, iu ofruan dy pro fatura dhe atë: 1.) pro fatura Nr..... dt....., në shumë prej .. euro, e lëshuar nga Klinika K. GMBH, D. në Gj. dhe 2.) pro fatura dt.., të S. A., në S., T., në shumë prej ... euro. Mirëpo, gjykata, u përcaktua në pro faturën e parë, të dt...., të lëshuar në K.. e sipër përmendur në Gj., nga se kjo pro faturë është më e kompletuar, sepse përpos çmimit të protezës, përmban edhe shpenzimet lidhur me vendosjen e saj, që do të thotë se është e kompletuar me të gjitha të dhënat e nevojshme.

9. Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 188, nenit 189, nenit 193, nenit 195, nenit 173, nenit 174 etj, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, të njëjtën e ka miratuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

10. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, pasi që në tërësi ka aprovuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se e njëjta gjykatë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndaj, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes juridiko civile, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Dispozitivi i aktgjykimit është i çartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse në arsyetim janë dhënë arsyet e mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet e pretenduara të së drejtës materiale dhe procedurale, nuk mund t'i vejnë në pyetje aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë dhe ajo e shkallës së parë, kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e së drejtës materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe kanë obliguar të padituren që atij t'ia kompensojë dëmin për fitimin e humbur, për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë, si dhe vënien e mjetit ortopedik – protezës, për shkak të lëndimeve të rënda, me pasoja të përhershme, në mënyrën dhe kohën (periudhën) e sipër cekur, në lartësinë e shumës e cila është vërtetuar nga ekspertizat përkatëse dhe me prova tjera materiale dhe shkresore që gjenden në dosjen e kësaj lënde dhe si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

3. Në këtë gjendje të çështjes civile - juridike, duhet theksuar se me dispozitën e nenit 154 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve , parashihet se; kush i shkakton dëm tjetrit ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Në rastin konkret, pala paditëse ka arritur që të provojë se e paditura, në mënyrën e përshkruar më lartë, asaj i ka shkaktuar dëm material, si më lartë, dhe se e njëjta është përgjegjëse për kompensimin e tij, ndaj, nga këtu, edhe kjo gjykatë, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, në mbështetje edhe të dispozitave të nenit 154, nenit 155, nenit 188, nenit 189, nenit 193, nenit 195, nenit 173, nenit 174 etj, të LMD-së, drejtë e kanë

zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe në këtë drejtim, vendimi i tyre është i drejtë dhe i ligjshëm.

4. Kështu sepse, kjo Gjykatë vlerëson se, në rastin konkret, janë plotësuar të gjitha parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit nga e paditura, siç janë ekzistimi i subjekteve të marrëdhënies së detyrimeve dhe të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, i dëmtuari dhe shkaktuesi i dëmit, fakti dëmtues nga rezulton dëmi, ekzistimi i dëmit të shkaktuar, lidhja shkakësore, etj, të cilat janë përmbushur kumulativisht, ndaj, nga këtu edhe përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit paditësit. Gjithashtu, veç tjerash, edhe me dispozitën e nenit 189.1 të LMD-së, parashihet se " I dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit real, ashtu edhe për kompensimin i fitimit të humbur ", ndërkohë që , me dispozitat e nenit 185 të po të njëjtit ligj, parashihet se personi përgjegjës është i obliguar që të rivendos gjendjen e cila ka ekzistuar para se të ndodh dëmi, përkatësisht, nëse rivendosja e gjendjes së mëparshme, nuk eviton dëmin në tërësi, ose nuk është e mundur rivendosja e gjendjes së mëparshme, personi përgjegjës është i obliguar që për dëmin e mbetur të jep kompensimin në të holla, respektivisht, gjykata e cakton se ai do ti paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse të hollave në emër të kompensimit të dëmit, siç është edhe rasti konkret juridik civil. Po ashtu, edhe nga neni 173 të LMD-së, rezulton se dëmi i krijuar në lidhje me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme, konsiderohet se buron nga ai send, përkatësisht veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk ishin shkaktar të dëmit. Ndërsa, për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet (sipas parimit – bazës së përgjegjësisë objektive) zotëruesi i tij, kurse, për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të (neni 174 i LMD-së).

5. Gjykata Supreme e Kosovës, për sa i përket pretendimit të paditurës, përkitazi me parashkrimin e kërkesës së paditësit, vlerëson se i njëjti nuk qëndron, është i pa themeltë, në rastin konkret civil nuk ka ndodhur parashkrimi, kjo për shkak të rrethanave specifike, të natyrës faktike dhe juridike të rastit, të cilat ndikojnë në vlerësimin për

rrjedhën, për momentin e rrjedhjes, respektivisht ndërprerjes së parashkrimit.

6. Kështu, në kontekstin e mësipërm, duhet pasur parasysh faktin se në pjesën e IV të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Podujevë C.Nr.101/05 dt.18.04.2006, theksohet se " Për kërkesëpadinë që ka të bëjë me dëmin tjetër material si dhe shpenzimet e procedurale do të vendoset më vonë ", përkatësisht, lidhur me këtë, edhe në pasusin e parafundit të f.7 të arsyetimit të këtij aktgjykimi, theksohet, veç tjerash, se " ....për format e dëmit material të fitimit të munguar (rentës), shpenzimet për protezë dhe shpenzimet procedurale do të vendos, kur për këtë të krijohen kushtet ligjore ". Ndaj, përkitazi me këtë që u sipër theksua, duhet shtuar se me nenin 388 të LMD-së, përcaktohet se " Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës apo organit tjetër kompetent, me qëllim vërtetimi të sigurimit ose realizimi të kërkesës ", siç edhe është rasti konkret civil, nga këtu, për arsyet e sipër theksuara, dhe për këtë rast, nuk mund të bëhet fjalë për parashkrimin e kërkesës nga neni 376 etj, të LMD-së.

7. Nga arsyet e sipër theksuara, e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
AA.Nr.33/2025, datë 05.02.2025

''Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se: derisa nuk mund të ndalohen të drejtat e një subjekti, organizate apo komuniteti të caktuar që në mënyrë të lirshme ti shpreh bindjet e tyre dhe veprimtarinë e saj, po ashtu nuk mund të sanksionohet një subjekt politik i cili mban qëndrim të kundërt kundrejt tyre, pa pasur ndonjë element të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët. Që të vij në shprehje shqiptimi i gjobës duhet të vërtetohet fakti se i njëjti subjekt me veprimet, apo fjalimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore, nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ANr.264/2025, të datës 01.02.2025, është vendosur: I. Pranohet e bazuar ankesa e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm, me seli në P., ANr.264/2025, e datës 30.01.2025. II. Subjektit politik Koalicioni për Familje me seli në P., për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 7,600.00 €. III. Detyrohet Subjekti Koalicioni për Familje, me seli në P., që gjobën e shqiptuar si në pikën II, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

2. Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Koalicioni për Familje, me seli në P., në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke propozuar që Gjykata Supreme të anulojë gjobën e vendosur ndaj Koalicionit për Familjen, ndërsa të njihen deklaratat e koalicionit, si shprehje e mbrojtur politike sipas nenit 10 të KEDNJ-së, dhe të rikonfirmohet rëndësia e lirisë së shprehjes në nxitjen e debatit demokratik.

3. PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Koalicioni për Familje, me seli në P., kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik të dënuar me këtë vendim të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ANr.264/2025, të datës 01.02.2025.

4. Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

   Ankesa është e bazuar.

5. Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 30.01.2025 PZAP, ka pranuar një ankesë nga OJQ Qendra për Barazi dhe Liri (CEL Kosova) dhe Dylberizm, me seli në P., në të cilën pretendon se më datë 28 janar 2025, ora 18:00, gjatë fushatës zgjedhore të subjektit politik Koalicioni për Familje në qytetin e F., ngjarje e cila më pas është postuar në rrjetin social Facebook, janë bërë deklarata të cilat përmbajnë gjuhë nxitëse dhe stigmatizuese ndaj komunitetit LGBTI+, duke shkelur standardet ligjore dhe etike të përcaktuara nga Kodi i Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Deklaratat janë bërë nga kandidati për deputet i këtij subjekti, z. E. Rr., dhe përfshijnë elemente që nxisin urrejtje dhe stigmatizim të drejtpërdrejtë ndaj një komuniteti të caktuar.

6. PZAP më datë 30.01.2025, iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje subjektit politik Koalicionit për Familje, mirëpo ky subjekt politik nuk është përgjigjur në afatin e paraparë deri më datë 31.01.2025.

7. PZAP-i, duke vepruar sipas ankesës, ka nxjerr vendimin ANr.264/2025, të datës 01.02.2025, me të cilën e ka aprovuar ankesën e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në P., duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

8. PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli, pas shikimit të shkresave të ofruara si provë materiale në ankesë, të cilat janë bërë nga Koalicioni për Familjen, respektivisht nga kandidati për deputet E. Rr. i cili gjatë fushatës ka deklaruar duke përdorur fjalët "Andaj, ne si koalicion, në asnjë mënyrë nuk do të dorëzohemi përballë presioneve dhe dënimeve të cilat po provohen përmes gjitha institucioneve, qoftë atyre shtetërore, qoftë organizatave të cilat shërbehen nga ta dhe financohen nga ta. Po thonë që nuk bon me ju thanë "turp", atyre që e cenojnë familjen. Turp edhe marre, secilës, organizatë jo-qeveritare që financon në degjenerimin e fëmive! Turp edhe marre, secilës qeveri e ministri që këto organizata i financon për me prish familjen shqiptare...", si dhe kandidati tjetër i Koalicionit për Familjen A.B. i cili ka shpërndarë një postim nga një mbështetës i koalicionit në rrjetin social Facebook, ku teksti i postimit thotë: "Garant edhe dreqit i kanë dhanë nasihat! Kshtu, këta dy hakaretat e kanë përdorë surrogacinë si mjet për mi ble këto dy zemra i "vogla, drita t 'pafajshme, shpirta t 'vogël". Pra e kanë pagu me qera (for-rent) mitrën e një gruje nevojlike për pak pare që këtyre me ua mundësua m 'u "bo" prindër, gjen se të njëjtat janë të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika L11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet, "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërës si në vijim: "1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë", andaj për Panelin një veprim i tillë i subjektit politik në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

9. Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një

atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

10. Andaj, Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga subjektit politik Koalicioni për Familjen, përkatësisht, nga kandidati i këtij subjekti E. Rr., ndaj LGBTI+, në fushatë zgjedhore dhe rrjetin sociale Facebook, dhe postimi i shpërndarë nga kandidati i këtij koalicioni, A. B., është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike. Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi për të cilin është përdorur gjuha ndaj një komuniteti, faktin që deklaratat janë publikuar në rrjetin social Facebook, prandaj sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrime përçmuese ose nënvlerësuese. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse. Përdorimi i kësaj gjuhe nga kandidatet për deputet sipas Panelit, është shkelur etika zgjedhore dhe standardet e sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. PZAP, me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklarata është bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se fjalitë e përdora i referohen grupeve të caktuara dhe si të tilla përmbajnë elemente të nxitjes së urrejtjes, diskriminimi dhe cenim të drejtave të grupeve që u është referuar.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e PZAP, lidhur me aprovimin e ankesës të parashtruar nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në P..

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se vendimi i PZAP-së, bazuar në

provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar në tërësi ankesën e parashtruara nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në P., duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të vendimit të PZAP-së për arsye se:

Me provat që gjendën në shkresat e lëndës, siç janë ankesa së bashku me dëshmitë e ofruara të paraqitura në PZAP, si dhe ankesa drejtuar kësaj gjykate, shihet qartë se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet se: "1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërës si në vijim: 1.11. përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

3. Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës konkretisht dëshmitë e ofruara me ankesë shihet se kandidatët për deputetët të subjektit politik Koalicioni Për Familje, përkatësisht kandidatët për deputet E. Rr., i cili gjatë fushatës ka deklaruar se: "Andaj, ne si koalicion, në asnjë mënyrë nuk do të dorëzohemi përballë presioneve dhe dënimeve të cilat po provohen përmes gjitha institucioneve, qoftë atyre shtetërore, qoftë organizatave të cilat shërbehen nga ta dhe financohen nga ta. Po thonë që nuk bon me ju thanë "turp" atyre që e cenojnë familjen. Turp edhe marre, secilit, organizate jo-qeveritare që financon në degjenerimin e fëmive! Turp edhe marre, secilës qeveri e ministri që këto organizata i financon për me prish familjen shqiptare.....", si dhe kandidati tjetër i Koalicionit për Familjen A. B. i cili ka shpërndarë një postim nga një mbështetës i koalicionit në rrjetin social Facebook, ku teksti i postimit thotë: "Garant edhe dreqit i kanë dhanë nasihat! Kshtu, këta dy hakaretat e kanë përdorë surrogacinë si mjet për mi ble këto dy zemra t'vogla, drita t 'pafajshme, shpirta t 'vogël". Pra e kanë pagu me qera

(for-rent) mitrën e një gruje nevojlike për pak pare që këtyre me ua mundësua m 'u bo prindër".

4. Nga deklarimet e cituara Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se të njëjtat nuk janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11 të LZP-së. Deklarimet dhe postimi i cituar gjatë fushatës nuk përmbajnë fjalor që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve. Përmes këtyre deklarimeve dhe postimit kandidatët në fjalë shpalosin programin e tyre dhe kërkojnë mbështetjen duke ofruar atë që kanë në planë program gjatë fushatës zgjedhore, ndërsa fjalët të përdorua këtu nuk janë të drejtuara kundrejt një subjekti, organizate apo komuniteti të caktuar, në mënyrë që të ngjall apo nxit urrejtje ndaj tyre. Në këto deklarim në asnjë moment nuk kemi thirrje apo nxitje që të ndërmerret veprime të caktuara kundër këtyre subjekteve caktuara.

5. Nga kjo rezulton se nuk po kërkohet nga qytetarët që të ndërmerret ndonjë veprim i caktuar kundër tyre, mirëpo këto kanë të bëjnë me zotimet në fushatë zgjedhore se nuk do ti lejojnë nismat legjislative sa i përket këtij komuniteti përmes veprimit demokratik, prandaj dhe pse këto qëndrime nuk i shkojnë përshtati ndonjë subjekti, organizate apo komuniteti të caktuar, dhe shto faktin se të njëjtat deklarime nuk i drejtohen qytetarëve për nxitje të urrejtjes apo me kërkesë që ndaj tyre të ndërmerret ndonjë veprim i caktuar, dhe nuk kemi ndonjë veprim apo fjalë e cila fyen apo ofendon të njëjtit, nuk mund të konsiderohen si nxitje e urrejtjes dhe shkelje e kodit të mirësjelljes, prandaj nga kjo rezulton se ankesa e parashtruar nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në P. , është e pabazuara.

6. Përveç të cekurave duhet theksuar se nëse i referohemi gjuha e urrejtjes sipas Strategjisë dhe Planit të veprimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara - OKB-së, rezulton se:

7. Nuk ka përkufizim universal apo të njëjtë rreth gjuhës se urrejtjes por nëse shikohet nga konteksti ndërkombëtar respektivisht nga OKB-ja, si organizata me e madhe botërore, atëherë gjuha e urrejtjes përkufizohet si: "Çdo lloj komunikimi në të folur, shkrim ose sjellje që sulmon ose përdor gjuhë poshtëruese ose diskriminuese duke iu referuar një personi ose një grupi në bazë të asaj se kush janë me fjalë të tjera bazuar në fenë, përkatësinë etnike, kombësinë, racën, ngjyrën, prejardhjen, gjininë ose faktor tjetër identiteti".

8. Sipas Parimeve dhe Udhëzimeve për një qasje gjithëpërfshirëse për të luftuar gjuhen e Urrejtjes shtojcës së rekomandimit CM/REC (2022)16 të Këshillit të Evropës, gjuha e urrejtjes kuptohet si të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, promovojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash, ose që i denigrojnë ata, për shkak të karakteristikave ose statusit të tyre personal, real ose të atribuuar si "raca, ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, mosha, paaftësia, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual".

9. Në anën tjetër, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut - GJEDNJ, në praktiken e saj gjyqësore, lidhur me deklarimet gjatë fushatës zgjedhore deri me tani ka trajtuar një sërë çështjesh në lidhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj-Konventës.

10. GJEDNJ, ka theksuar se ekziston një lidhje të ngushtë ndërmjet të drejtës për zgjedhje të lira dhe lirisë së shprehjes. Në rastin Bowman kundër Mbretërisë së Bashkuar, ka theksuar se këto të drejta, veçanërisht liria e debatit politik, së bashku përbëjnë themelin e çdo sistemi demokratik. Të dy këto të drejta janë të ndërlidhura dhe funksionojnë për të përforcuar njëra-tjetrën: për shembull, liria e shprehjes është një nga "kushtet" e nevojshme për të "siguruar shprehjen e lirë të opinionit të njerëzve në zgjedhjen e legjislaturës". Zgjedhjet e lira dhe liria e shprehjes, veçanërisht liria e debatit politik, së bashku përbëjnë themelin e çdo sistemi demokratik. Për këtë arsye, është veçanërisht e rëndësishme në periudhën para zgjedhjeve që

opinionet dhe informacionet e të gjitha llojeve të lejohen të qarkullojnë lirisht.

11. Me tej, GJEDNJ, në rastin Vajnai kundër Hungarisë, ka theksuar se: kur liria e shprehjes ushtrohet si fjalim politik, kufizimet justifikohen vetëm për aq sa ekziston një nevojë e qartë, urgjente dhe specifike sociale. GJEDNJ, rithekson se: ka pak hapësirë sipas nenit 10 paragrafit 2 të Konventës për kufizime në fjalimin politik ose në debatin e çështjeve me interes publik. Për me tepër, kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjera për një politikan si të tillë sesa për një person privat. Ndryshe nga ky i fundit, i pari në mënyrë të pashmangshme dhe me vetëdije është i hapur ndaj një kontrolli të ngushtë të fjalëve dhe veprave të tij nga gazetarët dhe publiku i gjerë, dhe rrjedhimisht ai duhet të shfaqë një shkallë më të madhe tolerance, (Feldek kundër Sllovakisë).

12. Po ashtu, gjykata në rastin Nilsen dhe Johnsen kundër Norvegjisë, ka ritheksuar më tej se: liria e shprehjes përbën një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike dhe një nga kushtet bazë për përparimin e saj dhe për vetë përmbushjen e çdo individi. Andaj, edhe pse liria e shprehjes mund t'i nënshtrohet përjashtimeve, ato "duhet të interpretohen ngushtë" dhe "domosdoshmëria për çdo kufizim duhet të përcaktohet në mënyrë bindëse".

13. Duhet theksuar se me nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: "1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare".

14. Andaj në kontekstin e paraqitur duke ju referuar te cekurave me lart, rezulton se: në këtë rast shpalosja e një programi politik, i cili synon që të "mbrojë", një vlerë sikur ata pretendojnë në kontekst të

ndryshimeve ligjore që propozohen në asnjë mënyrë nuk mund të kuptohet si gjuhë e urrejtjes, përçarjes apo mos durimit, e aq më pak shkelje e rregullave të fushatës zgjedhore, pasi nga shprehjet e përdorura nuk plotësohen elementet bazë të gjuhës se urrejtjes, sepse nuk rrezikohet statusi i kësaj kategorie personash, nuk rrezikohet siguria fizike, e aq me pak ekzistenca e tyre. Pra ky subjekt politik në programin dhe kauzën zgjedhore me të cilën garon e ka premtimin se ligjet të cilat sipas tyre "rrezikojnë", familjen nuk do të marrin aprovimin e tyre në kuvend dhe se ata në mënyrë demokratike dhe ligjore do të bëjnë përpjekje për këtë dhe jo përmes formave jo demokratike.

15. Kategorizimi i shprehjeve të përfaqësuesve të këtij subjekti politik shprehur në fushat si gjuhë e urrejtjes është kategorizim jo adekuat e madje subjektin politik e vendos në pozitë të pafavorshme në raport me subjektet tjera politike sepse cenon frymën demokratike të fushatës e madje nëse është i pabazë kuptohet si cenim i lirisë së shprehjes.

16. Pozicionet e subjekteve politike përmes fushatës, pastaj edhe gazetarët lejohen në një masë ti shprehin bindjet dhe veprimtarin e tyre në emër të lirisë së shprehjes si e drejte fundamentale.

17. Për t'u kategorizuar një shprehje si gjuhë e urrejtjes duhet të plotësohen edhe elementi i cenimit të diskriminimit apo cenimit të sigurisë përmes pasojave që mund të ketë grupi apo individët brenda grupit.

18. Në këtë rast me infrastrukturën ligjore në fuqi është përcaktuar se martesa është në mes të dy personave me sekse të ndryshme, pra martesa mes personave të sekseve të njëjta nuk është e njohur, pra dhe mbrojtja e këtij qëndrimi nuk nënkupton në mënyrë automatike sidomos kur programi politik është i certifikuar nga institucionet përkatëse.

19. Shprehjet e tilla janë në kuadër të shprehjeve brenda kornizës së rregullave të të shprehurit, nuk nxisin, e as nuk promovojnë urrejtje,

mos durim, e as dhunë, e as nuk cenojnë funksionimin e tyre apo ushtrimin e të drejtave të tyre brenda shoqërisë pavarësisht orientimit të tyre seksual.

20. Rregullat demokratike në një vend garantojnë fushatë demokratike me programe të qarta për të kërkuar votën e votuesit. Mirëpo në raste se të kishin shprehjen: "Me ardhjen tonë në pushtet këta nuk do të kenë vend në shoqërinë tonë, apo se këta nuk janë persona të mirëseardhur në vendin tonë e shprehje tjera të ngjashme ", është situatë tjetër, si të atilla do të pasqyrojnë gjuhë të urrejtjes dhe mos durimit. Në këtë kontekst përpjekja për një rregullim ligjor nuk mund të kuptohet si gjuhë e urrejtjes në asnjë rast, sepse shprehjet e përfolura derivojnë nga programi politik e të cilat synohet të normohen në ligj nëse votuesi i akcepton si të tilla.

21. Pra rregullat demokratike zgjedhore përcaktojnë garë zgjedhore me programe politike, dhe se ky standard i krijuar nga PZAP, në të ardhmen mund të shërbej si precedent që nëse në të ardhmen, një subjekt politik kërkon që me ligj të njihet "Martesa me sekse të njëjta", prapa të përben gjuhë të urrejtjes përball pjesës tjetër që nuk është e një mendimi të tillë. Pra secila vendimmarrje duhet me qenë e matur përball frymës që dëshirojmë që ta kemi në demokracinë zgjedhore.

22. Nga të cekurat me Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se: derisa nuk mund të ndalohen të drejtat e një subjekti, organizate apo komuniteti të caktuar që në mënyrë të lirshme ti shpreh bindjet e tyre dhe veprimtarinë e saj, po ashtu nuk mund të sanksionohet një subjekt politik i cili mban qëndrim të kundërt kundrejt tyre, pa pasur ndonjë element të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët. Që të vie në shprehje shqiptimi i gjobës duhet të vërtetohet fakti se i njëjti subjekt me veprimet, apo fjalimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore, nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve. Prandaj në këtë rast PZAP, nuk ka arritur të konstatoj drejtë dhe saktë gjendjen faktike dhe nuk e ka

zbatuar drejtë të drejtën materiale, për faktin se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk rezulton se kemi të bëjmë me shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, prandaj ankesa e subjektit politik është aprovuar si e bazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është ndryshuar.

23. Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, dhe 34 paragrafi 1 pika 1.11, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës CML.Nr. 8/23, më datë 22.02.2024

''Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore, sepse nga shkresat e lëndës shihet çartë se edhe pse në përgjigje në ankesë e paditura e ka kontestuar gjendjen faktike, gjykata e shkallës së parë nga shkresat e lëndës ka konstatuar me të drejtë se gjendja faktike është e qartë, sepse ka qenë fakt i pa kontestueshëm se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune te e paditura dhe ky fakt vërtetohet nga kontratat që gjenden në shkresa të lëndës.

Gjithashtu edhe pretendimin lidhur me parashkrimin e kërkesës të bërë nga e paditura me përgjigje në padi, gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë pretendim ka pasur prova të mjaftueshme për vlerësimin e të njëjtit pa mbajtur fare seancë gjyqësore, prandaj aktgjykimi është i drejtë dhe në përputhje me dispozitat e LPK-së.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, C.Nr.764/2021, të datës 21.11.2022, është vendosur: I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: N. I., A. B., Sh. Z., Xh. P. dhe Sh. P., të gjithë nga V., dhe detyrohet e paditura Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim në punë paditësit N. I. për periudhën nga data ... e deri më datë..., t'ia paguaj shumën prej ... €, paditësit A. B. për periudhën nga data ...e deri më datë..., t'ia paguaj shumën prej ... €, paditësit Sh. Z. për periudhën nga data ... e deri më datë..., t'ia paguaj shumën prej ... €, paditëses Xh. P. për periudhën nga data ...e deri më datë..., t'ia paguaj shumën prej ... €, dhe paditëses Sh. P. për periudhën nga data ... e deri më datë..., t'ia paguaj shumën prej ... €, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data ... e deri në pagesën definitive, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. II. Detyrohet e paditura Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës, dhe atë: për padi shumën prej...€,

dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 20 €, apo shumën e përgjithshme prej ... €, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.Nr.8826/2022, të datës 04.07.2023, është vendosur: Refuzohet si e pabazuar ankesa e të së padituresë Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri C.Nr.764/2021, i datës 21.11.2022, vërtetohet.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në afat ligjor ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë Prokurori i Shtetit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 247 paragrafi 1 pika b) e lidhur me nenin 398 të LPK-së, me propozim që: të aprovohet, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, dhe të prishet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.Nr.8826/2022 i datës 04.07.2023, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, C.Nr.764/2021, i datës 21.11.2022 dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

4. Përgjigje në kërkesën për mbrojte të ligjshmërisë nuk ka pasur.

5. Për të vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 250 të LPK-së, ka caktuar seancë dëgjimore/seancën e kolegjit më datë 22.02.2024, në të cilën palët nuk kanë marr pjesë edhe pse të njëjtat ishin të ftuara në mënyrë të rregullt.

6. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 245, gjeti se:

   Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

7. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit më datë 11.06.2021, pranë gjykatës së shkallës së parë kanë ushtruar padi për kompensimin e

shujtave për ditët e pranisë në punë, duke kërkuar më saktësisht si në padi.

8. Gjykata e shkallës së parë jashtë seancës gjyqësore ka nxjerrë aktgjykimin C.Nr.764/2021, të datës 21.11.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

9. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes, pasi që në mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor.

10. Ka shtuar se nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në padi, në precizimin e padisë dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune, me të padituren, fakt ky që konstatohet edhe nga kontratat e punës dhe atë për paditësin N. I. kontrata numër..., e datës 22.01.2018, për paditësin A. B. kontrata numër..., e datës..., për paditësin Sh. Z. kontrata numër..., e datës..., për paditësen Xh. P. kontrata numër..., e datës ... dhe për paditësen Sh. P. kontrata numër ..., e datës.... Kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë, nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë.

11. Gjykata e shkallës së parë, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: “ Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë ”.

12. Andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245 paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se: " Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij ", e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) € për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore ", si dhe vërtetimeve të lëshuara për paditësit nga SHFMU "...", fshati S., K. V., dhe atë për paditësin N. I. vërtetimi i datës, për periudhën ...e deri më datë..., për paditësin A. B. vërtetimi i datës..., për periudhën nga data ...e deri më datë..., për paditësin Sh. Z. vërtetimi i datës..., për periudhën nga data ...e deri më datë..., për paditësen Xh. P. vërtetimi i datës..., për periudhën nga data ...e deri më datë ...dhe për paditësen Sh. P. vërtetimi i datës..., për periudhën nga data ...e deri më datë..., erdhi në përfundim se kërkesa e paditësve është e bazuar, andaj edhe paditësit N. I. ia njohu shumën prej ... €, duke përllogaritur një ditë pune me ... € (...), paditësit A. B. i'a njohu shumën prej ... €, duke përllogaritur një ditë pune me ... € (...), paditësit Sh. Z. i'a njohu shumën prej ... €, duke përllogaritur një ditë pune me € (...), paditëses Xh. P. i'a njohu shumën prej ... €, duke përllogaritur një ditë pune me ... € (...) dhe paditëses Sh. P., i'a njohu shumën prej nga . €, duke përllogaritur një ditë pune me ... € (...).

13. Gjykata e shkallës së parë, kundërshtimin e të padituërs lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, gjykata e vlerësoj si të pabazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se: " Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës, ndërsa paditësit kërkesën e tyre e kanë parashtruar për periudhën nga data ... deri më..., që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, ndërsa padinë e kanë paraqitur në gjykatë më...

14. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 245 të LMD-së, nenit 87 të Ligjit të Punës, nenit 253 dhe 398 të LPK-së, nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Për kamatën gjykata ju ka referuar nenit 382 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

15. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.Nr.8826/2022, të datës 04.07.2023, ka vendosur që ta refuzojë si të pathemeltë ankesën e të padituruës, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

16. Gjykata e Apelit e Kosovës, në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se: nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të padituruit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

2. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shteti, mbështetet në pretendime të natyrës së tillë për të cilat kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e kufizuar, prandaj edhe vlerësohen si pretendime të pabazuara, për arsye se:

   Me nenin 245 paragrafi 1, të LPK-së, përcaktohet se: " Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë prokurori publik mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë brenda tre muajsh...".

   Me nenin 246 të LPK-së, përcaktohet se: " Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit nga neni 245 i këtij ligji ngritët nga prokurori publik, në pajtim me ligjin ".

   Me nenin 247 paragrafi 1 të LPK-së, përcaktohet se: " Prokurori publik mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë: a) për shkak te shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore; b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale ". Mirëpo në këtë çështje juridike – kontestimore, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk u referohet shkaqeve për të cilat ka të drejtë Prokurori i Shtetit që përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të kundërshtoj vendimet e formës së prerë.

   Prokurori i Shtetit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmerisë i referohet shkeljeve me referencë në nenin 247 paragrafi 1, pika a), lidhur me nenin 398 të LPK-së, mirëpo kjo bazë ligjore nuk mund të shërbej për të kualifikuar pretendimet e Prokurorit të Shtetit si shkelje. Kjo nga shkaku se edhe pse gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktgjykim pa mbajtur seancë gjyqësore, e njëjta nuk ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të lartcekura.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore, sepse nga shkresat e lëndës shihet çartë se edhe pse në përgjigje në ankesë e paditura e ka kontestuar gjendjen faktike, gjykata e shkallës së parë nga shkresat e lëndës ka konstatuar me të drejtë se gjendja faktike është e qartë, sepse ka qenë fakt i pa kontestueshëm se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune te e paditura dhe ky fakt vërtetohet nga kontratat që gjenden në shkresa të lëndës.

4. Gjithashtu edhe pretendimin lidhur me parashkrimin e kërkesës të bërë nga e paditura me përgjigje në padi, gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë pretendim ka pasur prova të mjaftueshme për vlerësimin e të njëjtit pa mbajtur fare seancë gjyqësore, prandaj aktgjykimi është i drejtë dhe në përputhje me dispozitat e LPK-së.

5. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur sa i përket kundërshtimit lidhur me parashkrimin, për faktin se këto kërkesa janë parashtruar për periudhën 15.07.2019 deri më 15.03.2021, që përfshin periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, e duke u bazuar në dispozitën ligjore nga nenin 87 i Ligjit të Punës, me të cilin përcaktohet se: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës rezulton fakti kërkesëpadia e paditësve është e paraqitur brenda afatit të paraparë ligjor dhe se pretendimi për parashkrim të kërkesës i të padituës është i pabazuar.

6. Përveç të cekurave për hir të praktikës gjyqësore në rastet ku Gjykata Supreme e Kosovës, vendosë për themelësinë e kërkesës për mbrojtën e ligjshmërisë, atëherë vendosë parimisht vetë me aktgjykim. Përjashtimisht vendosë me aktvendim edhe në rast të themelësisë së e kërkesës për mbrojtën e ligjshmërisë nëse janë plotësuar kushtet, siç përcaktohet me nenin 245 - 251 të LPK-së. Me nenin 247 të LPK-së, është përcaktuar se shkak për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë është shkelja e dispozitave të LPK-së, dhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, dhe nëse Gjykata Supreme konstaton se e

drejta materiale është zbatuar gabimisht nga gjykata e shkallës së parë ose gjykata e shkallës së dytë atëherë ajo vendosë vet me aktgjykim në kuptim të dispozitave të LPK-së, duke e aprovuar/refuzuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Duhet të theksohet se konstatimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike nëse i referohemi nenit 247 të LPK-së, nuk është shkak për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Nga kjo rezulton se Gjykata Supreme është e lidhur me gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, përkatësisht gjykata e shkallës së dytë.

7. Nga përmbajtja e dispozitave të cituara rezulton se Gjykata Supreme do ta aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe do ta kthejë lëndën në rishqyrtim, nëse konstaton se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë me kusht që vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ka qenë si rezultat - gjegjësisht pasojë e zbatimit të gabuar të së drejtës materiale ose e ndonjë shkelje të dispozitave të LPK-së. Nga kjo rezulton se Gjykata Supreme, do ta kthejë lëndën në rishqyrtim nëse gjykatat e instancave më të ulëta pa të drejtë nuk kanë lejuar marrjen në pyetje të një dëshmitari, nxjerrjen e provës me ekspertim... etj, dhe si pasojë e kësaj shkelje është konstatuar gjendja faktike në mënyrë jo të plotë, mirëpo duhet të merret për bazë fakti se vërtetimi jo i plotë ose i gabuar i gjendjes faktike duhet të jetë gjithmonë pasojë e zbatimit të gabuar të së drejtës materiale ose pasojë e një shkelje të dispozitave të LPK-së. Pra në këto raste Gjykata Supreme para se të vendosë siç përcaktohet me dispozitat e cituara të LPK-së, duhet gjithmonë të konstatojë edhe lidhjen kauzale në mes të një shkelje të dispozitave të LPK-së, ose zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike.

8. Në këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës, nuk e ka shqyrtuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, bazuar në provat prezentë në shkresat e lëndës, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si

në aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, edhe për faktin se në këtë rast nuk ekziston lidhja kauzale në mes të një shkelje të dispozitave të LPK-së, ose zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me vërtetim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike nga gjykata e instancave me të ulëta.

9. Po ashtu për të vendosur siç përcaktohet me dispozitat e LPK-së, është me rendësi edhe fakti se Gjykata Supreme, nuk mund të ndryshoj vet aktgjykimin e goditur sipas mjeteve të jashtëzakonshme të goditjes, për shkak të konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, e cila gjendje është ardhur si pasojë e zbatimit të gabuar të drejtës materiale ose shkeljet e ndonjë dispozite procedurale.

10. Në këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se kthimi i çështjes në rigjykim do të ishte i pa efekt, dhe se rezultati i gjykimit do të ishte i njëjtë, për arsyet e cituara. Përveç kësaj në rastet kur gjykata me e lartë e kthen lëndën në rigjykim, në gjykatën e shkallës më të ulët, gjykata e shkallës më të lartë duhet që ti konstatoj shkeljet e dispozitave të LPK-së, dhe në çka konsiston shkelja duke sugjeruar se cilat veprime konkret duhet të ndermirën, dhe cilat prova duhet të nxirren dhe administrohen nga ana e gjykatës së shkallës me të ulët me rastin e rigjykimit.

11. Në këtë rast nuk është konstatuar se aktgjykimet e gjykatave të instancave me të ulëta janë përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së, mirëpo bazuar në provat e prezent në shkresat e lëndës, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale, andaj kthimi i çështjes në rigjykim do të ishte i pa efekt, për arsyet e theksuar si me lartë.

12. Parashtrimet e Prokurorit të Shtetit, si në kërkesën për mbrojte të ligjshmërisë, sa i përket shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të pabazuara, dhe se aktgjykimet e instancave me të ulëta nuk janë përfshirë në shkeljet e pretenduara, dhe as me shkeljet të cilat shikohen sipas detyrës zyrtare siç përcaktohet me dispozitat e LPK-së.

13. Andaj nga të cekurat më lartë shihet në mënyrë të çartë se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga nenin 398 i LPK-së, që gjykata e shkallës së parë të vendos lidhur me kërkesëpadinë e paditësit pa mbajtur seancë gjyqësore, prandaj nga kjo rezulton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruar nga Prokurori i Shtetit është në tërësi e pabazuar.

14. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 245 dhe 246 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.6/2025, datë 05.03.2025

''Gjykata Supreme e Kosovës, nga interpretimi i dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë dhe e dytë drejt kanë aplikuar të drejtën materiale, kur kanë konstatuar se paditëses në këtë rast nuk i takon e drejta e trashëgimisë për 1/6, në pjesë ideale të patundshmërisë të evidentuar si njësi kadastrale Nr.P-... dhe ... ZK – P., në sipërfaqe pre ... m^2, për arsye se nuk janë plotësuar kushtet ligjore siç përcaktohet me nenin 126, 126, 130, 133, 134, 135, dhe 137 të Ligji për Trashëgiminë i Kosovës. Në këtë kuptim nuk janë pranuar pretendimet sipas revizionit nga pala paditëse, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancave me të ulëta, në përputhje me gjendjen faktike kanë aplikuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, për mënyrën e vendosjes.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.Nr.141/17 të datës 30.12.2021, është vendosur: I. Refuzohet, kërkesëpadia e paditëses S. K. nga P., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet, se paditësja është pronare në bazë të trashëgimisë për 1/6, në pjesë ideale të patundshmërisë të evidentuar si njësi kadastrale Nr.P-... dhe ... ZK – P., në sipërfaqe pre ... m^2, dhe detyrohet**,** i padituri N. K. nga P., që paditëses t'ia njoh këtë të drejtë, si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.344 €, të gjitha në afat prej 15, ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcenim të përmbarimit, si e pa bazuar. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

2. Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktgjykimin Ac.Nr.1138/2022, të datës 07.10.2024, ka vendosur: Refuzohet e pathemeltë ankesa e paditëses S. K. nga P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.Nr.141/17 i datës 30.12.2021, vërtetohet.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësja, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovojë revizionin, duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë dhe duke e aprovuar në tërësi padinë e paditëses, apo këtë çështje ta prishë dhe të njëjtën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

4. Përgjigje në revizionin e paditësve nuk ka paraqitur i padituri.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

   Revizioni i paditëses është i pabazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, më datë 20.02.2017, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të padituri, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të trashëgimisë, me të cilën kanë kërkuar si në padi.

7. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditëses, kundër të padituri, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin C.Nr.141/17 të datës 30.12.2021, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

8. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se: me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: certifikatën e vdekjes së H. K., me numër rendor Nr..., të datës 20.06.2016, autorizimin dhe deklaratën trashëgimore të paditëses S. K., e vërtetuar tek Noteri F. B., në B., të datës 08.12.2015, aktvendimin

e trashëgimisë të Gjykatës Themelor në Pejë, T.Nr.02/2016, të datës 29.02.2016, raportin e policisë, të datës 14.11.2017, shkresat trashëgimor T.Nr.2/2016, shkresa - njoftimi i Noterit F. B., në B., për verifikim të legalizimit të autorizimit, e siguria përmes rrugës diplomatike, të datës 05 Shkurt.2020, plikon me numër RF ..., të datës 19.02.2016, shkresa - komunikimet përmes emalit, të djalit të paditëses dhe djalit të padituri, të datës 18.01.2016, deklaratën e paditëses e dhënë tek noteri N. G., të datës 08.12.2021, në B., ka dëgjuar të padituren në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 22.12.2021, si dhe deklarimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqësorë.

9. Ka shtuar se gjykata duke u bazuar në shkresat e lëndës, nxjerr përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar, pasi që ka rezultuar si e provuar, se paditësja ka heqë dorë nga trashëgimia e nënës së saj, dhe kjo u vërtetua nga shkresat e lëndës trashëgimorë T.Nr. 02/2016, me konkretisht nga deklarata trashëgimore e nënshkruar nga paditësja S. K., tek Noteri F. B., në B., të datës 08.12.2016, si dhe nga dëshmia e dhënë nga noteri F. B., më datë 05.12.2020, i cili i konfirmoj kësaj gjykatës se vula dhe nënshkrimi në faqen e dytë të dokumentit janë të vendosura nga (unë) që nënkupton nga noteri, dhe bazuar në këtë, dhe sipas dispozitave ligjore nga nenin 130. 1 Ligjit për Trashëgimisë e Kosovë, që parashihet se: "trashëgimtari mund të heq dorë nga trashëgimi me deklaratë të dhënë pranë gjykatës gjersa të përfundojë seanca mbi trashëgimin, ndërsa paragrafi 4, i të njëjtit nenë parasheh se trashëgimtari, i cili ka hequr dorë në emër të vet konsiderohet sikur të mos ketë qenë trashëgimtar, dhe paragrafi 5, i të njëjtit nenë përcakton se në qoftë se për trashëgim kanë hequr dorë të gjithë pasardhësit të cilët i takojnë radhës me të afërt të trashëgimisë në çastin e vdekjes të trashëgimlënësit, në trashëgim thirren pasardhësit e radhës pasuese të trashëgimit, ndërsa nenin 135.1, i të njëjti ligj, përcakton se deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia nuk mund të revokohet, ndërsa paragrafi 2, i të njëjti nenën parasheh se trashëgimtari që ka dhënë deklaratën mund të kërkojë anulimin e kësaj deklarate, po qe se ajo është dhënë me kanosje, dhunë, për shkak të mashtrimit ose lajthimit.

10. Gjykata e shkallës së parë nga një gjendje e tillë faktike të vërtetuar, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, pasi që rezultojë e provuar se paditësja ka shpreh vullnetin e saj të lirë dhe deklarata trashëgimore për heqje dorë apo pranimin e trashëgimisë është e pa revokueshme, mirëpo, edhe nën supozimin se paditësja t'ia kishte lënë pjesën e saj të trashëgimisë vëllait E., ka rezultuar e provuar se ky i fundit nuk e ka pranuar pjesën e vetë të trashëgimisë së nënës që i ka takuar sipas ligjit, pra bazuar në dispozita ligjor të lartcekura, kur trashëgimtaret e trashëgimlënësit nuk e pranojnë trashëgimin apo heqin dorë nga trashëgimia, atëherë konsiderohet sikur të mos ketë qenë trashëgimtar, dhe tani paditësja sipas kësaj baze juridike nuk mund të kërkoj vërtetimin e të drejtës së pronësisë në palujshmerinë sipas bazë së trashëgimisë, mirëpo trashëgimtari ligjor mund të kërkojë anulimin e deklaratës trashëgimore nëse deklarata është dhënë nën ndikimin e shtrëngimit, mashtrimit apo si pasoj e lajthimit, siç përcaktohet me ligj, në rastin konkret dhe bazuar në këtë gjendje faktike, u vendos sikur në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

11. Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes ka vlerësuar dhe analizuar edhe pretendimet e të autorizuarit të paditëses, mirëpo për gjykatën këto pretendime nuk qëndrojnë për faktin se fillimisht pala paditëse është thirrur se aktvendimi i trashëgimisë është i pa ligjshëm, pasi që sipas saj autorizimi dhe deklarata trashëgimor janë të falsifikuar, dhe pas verifikimit dhe eliminimit të kësaj rrethane nga gjykata e me propozimin e palës paditëse, e që u vërtetuar se deklarata trashëgimore është nënshkruar dhe vulosur nga noteri, tani i autorizuari i paditëses e ndryshon pretendimin duke u thirr se procedura trashëgimor në bazë të ligjit duhet të ketë dokumentin në origjinal dhe dokumentet që vijën nga jashtë duhet ta kenë vulën e apostile, dhe krejt këtë duke e ditur se heqja dorë është bërë në harmoni me ligjin, nuk është aspak kontestuese se deklarata trashëgimorë është nënshkruar nga paditësja në prani të noterit si dhe është nënshkruar dhe vulosur nga noteri siç përcaktohet me ligj, mirëpo kjo gjykatë konsideroj se edhe përkundër asaj që po pretendohet nga i autorizuari i paditëses si më lartë, këto pretendime nuk do të kishin ndikim për një vendim më

ndryshe, edhe mbi ketë bazë kërkesa e paditëses është e pabazuar, dhe u refuzua.

12. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 12 paragrafi 1, 130 dhe 135, të LTK-së. Lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 450 të LPK-së.

13. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësja ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.Nr.1138/2022, të datës 07.10.2024, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e paditëses, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

14. Gjykata Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

15. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i paditëses se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2, pika n). Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë i kuptueshëm dhe nuk është kundërthënës me arsyet e tij. Po ashtu aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, janë dhënë arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2, të LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara.

3. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale dhe ka rezultuar më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

4. Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallë së dytë ka

dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

5. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për arsye se paditëse i është mohuar e drejta për tu dëgjuar si palë është pretendim i pabazuar, për arsye se:

   Nëse i referohemi nenit 373, 374 dhe 377 të LPK-së, nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se: me propozimin e palës, gjykata mund të vendosë që të merret prova me anë të dëgjimit të palëve. Gjykata vendos që të pyetet vetëm njëra palë ndërgjyqëse, po që se pala tjetër refuzon të pyetet apo nuk vepron sipas thirrjes së gjykatës. Mirëpo nuk mund të përdoret kurrfarë mase shtrëngimi ndaj palës që nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës për tu pyetur, e as të detyrohet ajo për të dhënë deklaratë.

6. Në këtë rast paditëses nuk ju është mohuar e drejta për tu dëgjuar si palë, sepse nëse i referohemi shkresave të lëndës, rezulton se: gjykata e shkallës së parë, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.08.2019, ka marr aktvendim për dëgjimin e palëve në cilësi të palës, i autorizuari i palës paditëse në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 06.10.2021 është tërhequr nga propozimi për dëgjimin e palëve në cilësi të palës, megjithatë gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për datën 22.12.2021, ku përveç tjerash i ka njoftuar të autorizuarit e palëve që kanë për obligim t'i ftojnë palët për dëgjim, në të kundërtën gjykata do të vepron në kuptim të nenit 374 të LPK-së. Përveç të cekurave paditësja ka nënshkruar një deklaratë te Noteri në B.më datë 18.12.2021, e cila është administruar si provë nga gjykata e shkallës së parë, në të cilinë përveç tjerash është theksuar se: "Sa i përket dëgjimit të palëve, unë nuk kam mundësi të vij në seancë gjyqësore, pasi që tash jam në moshë të shtyer dhe kam familjar i cili është i varuar nga kujdesi im. Përfundimisht gjykatës i propozoj që kërkesëpadia e paditëses ta aprovoj si të bazuar". Në këtë kontekst duke ju referuar të cekurave si dhe deklarimeve të autorizuarit të palës paditëse në seancën e

shqyrtimit kryesor të datës 22.12.2021, rezulton se pala paditëse nuk ka dashur - gjegjësisht ka refuzuar të dëgjohet në cilësi të palës, dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ka mund të përdor kurrfarë mase shtrëngimi ndaj paditëses që nuk i'u ka përgjigjur thirrjes së gjykatës për tu pyetur, e as të detyrojë për të dhënë deklaratë.

7. Përveç të cekurave Gjykata Supreme e Kosovës, e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, edhe për faktin se të njëjtat, palës paditëse nuk ju ka mohuar qasjen në drejtësi, për arsye se:

   Qasja në drejtësi përbën një element kyç të së drejtës për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor të garantuar nga neni 31 i Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga neni 6 i Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, instrument ky drejtpërdrejtë i zbatuar në rendin tonë juridik sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prandaj, çdokush gëzon të drejtën që çështja e tij të dëgjohet nga një gjykatë e pavarur dhe se është pranuar si parakusht i të drejtës për gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor.

   Pra, e drejta e qasjes në gjykatë paraqet një ndër elementet bazë të parimit të sundimit të së drejtës ngaqë kjo u siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar procedurë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile pranë një gjykate.

   Në përgjithësi, e drejta për qasje në gjykatë garanton të drejtën për të filluar seancat gjyqësore përpara një gjykate dhe të drejtën për të marrë një vendim gjyqësor, si rezultat i diskutimeve dhe vlerësimeve të bëra pranë një gjykate të pavarur lidhur me të drejtat dhe detyrimet civile apo akuzat penale që rëndojnë mbi subjektet e së drejtës.

8. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si vlerë të rendit juridik kushtetues ekzistues (neni 7) ka mishëruar parimin e sundimit të së drejtës (ligjit) - ku autoriteti shtetëror përveç se krijon "të drejtën", njëkohësisht i nënshtrohet kësaj të fundit dhe e zbaton dhe detyrohet

nga ajo në mënyrë të barabartë krahas subjektet tjera të së drejtës. Në këtë kontekst, garancia procedurale e qasjes në drejtësi paraqet një ndër "urat", lidhëse midis subjektit të së drejtës që pretendon se i takon, i është shkelur, kufizuar, cenuar apo dëmtuar ndonjë e drejtë apo interes i tij dhe mekanizmave shtetërorë - gjykatat dhe/ose organet tjera të pavarura (kuazi gjyqësore) që janë të mveshur me juridiksion dhe kompetencë për garantimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave. Pra e drejta për qasje në gjykatë, iu jep efekt respektivisht i jetëson parimet e shtetit të së drejtës dhe sundimit të së drejtës.

9. Megjithatë, e drejta për qasje në gjykatë nuk është një e drejtë absolute. GJEDNJ në çështjen Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar është shprehur se vetë natyra e saj (të drejtës për qasje në gjykatë) kërkon rregullim përkatës legjislativ (që mund të ndryshojë në kohë dhe vendndodhje sipas nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve) të hartuara nga shteti, megjithëse rregullime të tilla nuk duhet të cenojnë aspak thelbin/esencën e së drejtës e as të hyjë në konflikt me të drejtat e tjera të mishëruara në KEDNJ. Në këtë kontekst gjykatat e rregullta në ushtrimin e funksionit të tyre kanë për obligim që të gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit dhe Gjykata Supreme e Kosovës në këtë rast ka vlerësuar se qasja në drejtësi është parakusht thelbësor për realizimin e të drejtave të njeriut të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës respektivisht Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

10. Pretendimet e paraqitura në revizion se gjykatat e instancave me të ulëta nuk kanë vlerësuar deklaratën e paditëse të dhënë pranë Noterit në B., më datë 08.12.2021, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara, për arsye se të njëjtën gjykata e shkallës së parë e ka administruar si provë dhe është vlerësuar nga gjykatat e instancave me të ulëta mirëpo nuk ka qenë me ndikim për një vendimmarrje ndryshe.

11. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta

materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

Me nenin 124 paragrafi 1 dhe 2 të Ligji për Trashëgiminë i Kosovës, përcaktohet se: " 1. Me vdekjen e personit hapet trashëgimi i tij. 2.Të njëjtin efekt e ka edhe shpallja e personit si të vdekur".

Me nenin 126 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, përcaktohet se: " Trashëgimtar mund të jetë vetëm personi i cili është i gjallë në çastin e hapjes së trashëgimit. 2. Fëmija i zënë në çastin e hapjes së trashëgimit do të konsiderohet si i lindur, në qoftë se lind i gjallë.''

Me nenin 130 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, përcaktohet se: " 1.Trashëgimtari mund të heq dorë nga trashëgimi me deklaratë të dhënë pranë gjykatës gjersa të përfundojë seanca mbi trashëgimin. 2. Heqja dorë vlen edhe për pasardhësit e atij që ka hequr dorë, përveç nëse shprehimisht ka deklaruar se hequr dorë vetëm në emër të vet. 3. Në qoftë se pasardhësit janë të mitur për këtë heqje dorë nuk nevojitet leja e organit të kujdestarisë. 4.Trashëgimtari, i cili ka hequr dorë në emër të vet konsiderohet sikur të mos ketë qenë trashëgimtar".

Me nenin 133 paragraf 1 të këtij ligji, përcaktohet se: " Heqja dorë nga trashëgimi nuk mund të jetë e pjesshme apo me kusht".

Me nenin 134 paragrafi 1, të këtij ligji, përcaktohet se: " Heqja dorë nga trashëgimi që nuk është hapur nuk ka kurrfarë efekti juridik".

Me nenin 135, paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, përcaktohet se: " 1. Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimi ose për pranimin e trashëgimit nuk mund të revokohet. 2. Trashëgimtari që ka dhënë deklaratën mund të kërkojë nulimin e kësaj deklarate, po qe se ajo është dhënë me kanosje, dhunë, për shkak të mashtrimit ose lajthimit".

12. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë dhe e dytë drejt kanë aplikuar të drejtën

materiale, kur kanë konstatuar se paditëses në këtë rast nuk i takon e drejta e trashëgimisë për 1/6, në pjesë ideale të patundshmërisë të evidentuar si njësi kadastrale Nr.P-... dhe ... ZK – P., në sipërfaqe pre ... m^2, për arsye se nuk janë plotësuar kushtet ligjore siç përcaktohet me nenin 126, 126, 130, 133, 134, 135, dhe 137 të Ligji për Trashëgiminë i Kosovës. Në këtë kuptim nuk janë pranuar pretendimet sipas revizionit nga pala paditëse, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancave me të ulëta, në përputhje me gjendjen faktike kanë aplikuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, për mënyrën e vendosjes.

13. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe saktë ka vendosur kur e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses për faktin se e njëjta ka heqë dorë nga trashëgimia e nënës së saj, dhe kjo u vërtetua nga shkresat e lëndës saktësisht nga aktvendimi T.Nr. 02/2016 i datës 29.02.201, me konkretisht nga deklarata trashëgimore e nënshkruar nga paditësja S. K., tek Noteri F. B., në B., të datës 08.12.2016, si dhe nga dëshmia e dhënë nga noteri F. B., më datë 05.12.2020, i cili ka konfirmuar se vula dhe nënshkrimi në faqen e dytë të dokumentit janë të vendosura nga noteri, që nënkupton se padia e paditëses është në tërësi e pabazuar.

14. Gjykatës Supreme të Kosovës vlerëson se paditësja në këtë rast nuk ka arritur ti vërtetojë faktet mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij edhe pse kjo ka qenë detyrë e saj, në kuptim të nenit 322 paragraf 1 dhe 2 e lidhur me neni 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: " Gjykata mund të kërkoi nxjerrjen e provave sipas detyrës zyrtare, për vërtetimin e fakteve edhe pse palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse ato prova po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht të përcaktuara në kuptim të nenit 3 paragraf 3 të LPK-së ". Në këtë kontekst pretendimet e paraqitur në revizion se paditësja nuk ka dhënë deklaratë trashëgimore duke hequr dorë nga

trashëgimia, por që deklarata e saj e falsifikuar është futur në shkresat e lëndës trashëgimore, janë të pabazuar dhe si të tilla janë vetëm supozimi i palës paditëse.

15. Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij revizioni, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

16. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.89/2025, datë 14.03.2025

’’Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditëses.

Kjo gjykatë nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë dhe të parë, edhe për faktin se e paditura me rastin e marrjes së vendimit, për ndërprerjen së marrëdhënies së punës paditësit, drejt ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike, i cili ligj nuk përcakton themelimin e komisionit disiplinor, apo zhvillimin e një procedure disiplinore, duke përcaktuar se ndërprerja e marrëdhënies së punës nga Bordi i Drejtorëve, mund të behët edhe pa arsye.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.Nr.1014/2018 të datës 21.10.2021, ka vendosur: Aprovohet kërkesëpadia e paditësit R. S. nga P., në tërësi si e bazuar. Anulohet vendimi i paligjshëm mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, Nr. ... i datës 24.10.2018, i lëshuar nga ana e të paditurës Kompania Regjionale e Ujësjellësit - KRU Mitrovica, me seli në Mitrovicë, në bazë të së cilës paditësit R. S., i ndërpritet marrëdhënia e punës. Obligohet e paditura Kompania Regjionale e Ujësjellësit - KRU Mitrovica, me seli në Mitrovicë, që paditësin R. S. ta kthej në punë si zyrtar gjeneral financiar dhe arkëtar ose në ndonjë tjetër vend pune që i përgjigjet kualifikimit dhe aftësive të punës me të gjitha të drejtat e punësimit, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Obligohet e paditura Kompania Regjionale e Ujësjellësit - KRU Mitrovicë, me seli në Mitrovicë, që paditësit në emër të kompensimit për shkak të ndërprerjes së paligjshme të marrëdhënies së punës, për periudhën prej datës 24.10.2018 deri më datë 30.10.2020, t’ia paguaj shumën si vijon: në emër të ardhurave neto shumën prej 22.086,12 €, në emër

kontributit pensional (5% +5%) shumën prej 2.519,10 €, në emër të taksës shumën prej 1.845,33 € dhe atë me kamat vjetore prej 8% nga përmbushja e çdo kërkese veçmas nga pagesa përfundimtare, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Obligohet e paditura Kompania Regjionale e Ujësjellësit - KRU Mitrovicë, me seli në Mitrovicë, që paditësit R. S. në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguaj shumën prej 2,016 €, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

2. Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin Ac.Nr.1176/2022, të datës 10.12.2024, ka vendosur: I. Refuzohet pjesërisht si e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania Regjionale e Ujësjellësit - KRU Mitrovica, me seli në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm C.Nr.1014/2018 i datës 21.10.2021, pika dispozitivit I, më të cilën është anuluar vendimi i të paditurës Nr. ... i datës 24.10.2018, pika III, më të cilën është obliguar e paditura që ta kompenson paditësin në emër të ardhurave personale në shumën prej 22,086.12 €, në emër të kontributit pensional, shumën prej 2,519.00 €, dhe emër të taksës - tatimit në pagë, shumën prej 1,845.33 €, pika IV, për sa i përket lartësisë së kamatës dhe periudhës kohore për përmbushje të detyrimit, si dhe pika V, që ka të bëjë më shpenzimet e procedurës, vërtetohen. II. Aprovohet ankesa e të paditurës Kompania Regjionale e Ujësjellësit - KRU Mitrovicë, me seli në Mitrovicë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.Nr.1014/2018 i datës 21.10.2021, në pikën II, të dispozitivit, ashtu që gjykohet si në vijim: Refuzohet e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditësit R. S. nga P., me të cilën ka kërkuar që të kthehet në punë si zyrtar kryesor financiar, ose në ndonjë tjetër vend të punës që i përgjigjet kualifikimit dhe aftësive të punës me të gjitha të drejtat e punësimit, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës

kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni dhe të anulohen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.Nr.1176/2022 i datës 10.12.2024 dhe atë në pikën I, të dispozitivit, dhe ai i Gjykatës Themelore ne Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm C.Nr.1014/2018 i datës 21.10.2021, ndërsa çështja ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë, ose me aktgjykim të hudhet poshtë padia dhe kërkesëpadia e paditësit e palejueshme përkatësisht e pasafatshme.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

   Revizioni i të paditurës është i bazuar.

5. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, më datë 31.12.2018, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për anulimin e vendimit, kompensimin e të ardhurave personale, duke kërkuar me saktësisht si në kërkesëpadi, të precizuar në fjalën përfundimtare të datës 04.10.2021.

6. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.Nr.1014/2018 të datës 21.10.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

7. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar këto prova: dëgjimin e dëshmitarëve M. Z., T. U., S. M., B. G., H. Th., B. M. dhe Z. B., si dhe dëgjimin e paditësit në cilësi të palës ndërgjygjëse dhe nxjerrjen e provave të dokumentacionit të shkruar si vijon: Kontratën e Punës të paditësit të datës 30.10.2017, kontratën e punës të paditësit, numër ... të datës 07.09.2018, vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditësit, numër ... të datës 24.10.2018,

procesverbalin numër ... të datës 23.10.2018, ankesën e paditësit të datës 19.11.2018, kërkesën e paditësit për sistematizimin për tjetër vend pune, numër ... të datës 26.10.2018, autorizimin e palës së paditur të datës 24.04.2018, datës 09.01.2018, datës 02.08.2017, dhe datës 13.06.2017, vendimin numër ... të datës 24.10.2015, vështrimin në korrespodencën elektronike në mes të paditësit dhe drejtorit ekzekutiv të datës 30.11.2017, kërkesën për sigurimin e nënshkrimit të depozituar të datës 26.12.2018, kërkesën për anulimin e autorizimit të padituës, mendimin e ekspertit financiar të datës 21.06.2021 dhe plotësimin e ekspertizës të datës 24.09.2021.

8. Ka shtuar se gjykata në këtë çështje juridike është nisur nga fakti që rezultoi se në mes të palëve nuk është kontestuese dhe atë: se paditësi ka qenë punëtor i të padituës dhe se i njëjti ka themeluar marrëdhënie pune më datë 20.06.2017 në pozitën e Drejtorit Gjeneral të Financave dhe Arkatar në periudhën gjashtëmujore, si dhe se në mes të paditësit dhe të padituës është lidhur kontratë e re më datë 30.10.2017, me të cilën paditësi është vendosur në pozitën Shef i Administratës Financiare. Paditësi me të padituën ka lidhur kontratë të re më datë 01.08.2018, e cila është e vlefshme deri më datë 30.10.2020, të cilit ndërkohë i është rritë paga prej 30% të pagës bazë. Nuk është kontestues fakti se e paditura ka marrë vendim mbi shkarkimin nga detyra të paditësit dhe për ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës më datë 24.10.2018 dhe atë pas mbajtjes së mbledhjes së Bordit Drejtues të datës 28.10.2018, gjë që është vërtetuar nga mbledhja e deklaratave të gjithë dëshmitarëve të dëgjuar në procedure dhe vetë paditësit.

9. Gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se e ka vërtetuar se e paditura vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës e bie në kundërshtim me nenet e lartcekura të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe dispozitat e Ligjit të Punës, kushteve të cekura në Kontratën e Punës së paditësit, neni 14 dhe 15, duke mos respektuar procedurën e brendshme e cila konsiston në njoftimin e përformancës me shkrim të paditësit, për veprimet e tij kur dyshohet se i njëjti ka shkelur pozitën e tij, pas kësaj vetëm atëherë kur të vërtetohen faktet

relevante për këto shkelje, atëherë do të mund të shqiptohet masa më e rëndë, ajo është ndërprerja e marrëdhënies së punës. Pasi në rastin konkretë, punonjësit nuk i është dhënë mundësia të përdorë të gjitha mjetet juridike vendase prandaj atij i është mohuar e drejta, për arsyetimin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe ankesës, gjykata nuk ka mundur ndryshe të veproj, përveçse të merr parasysh faktorët përkatës për shkeljen e detyrave të punës të cilët e paditura i vie në barrë punonjësit, në mënyrë që të mund t'i ofroj mbrojtje adekuate gjyqësore duke respektuar të gjitha rregulloret e mundshme ndërkombëtare, rregullat ligjore dhe zbatimin e praktikës gjyqësore në gjykatat tona.

10. Ka shtuar se edhe pse neni 79 i Ligjit të Punës, në të gjitha pikat në rastet e parapara kur punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi dhe pa paralajmërimi, ligjvënësi me paragrafin 2 të të njëjtit ligj parasheh edhe kushte shtesë të cilat punëdhënësi duhet t'i respektoj para se të ndërpres kontratën të punësuarit sipas pikës 1.6, dhe atë vetëm kur i punësuari ka pranuar shkresë me shkrim për performancë të pakënaqshme, afat në të cilin i punësuari duhet të përmirësoj performancën, si dhe deklaratën për mos sukses në përmirësimin e performancës e cila do të rezultojë me largim nga puna pa paralajmërim të mëtejshëm me shkrim. Paragrafi 3 i të njëjtit nen edhe një hap më tej në detyra të caktuara të punëdhënësit të mbaj mbledhje në mënyrë që punonjësin ta informoj me arsyet e ndërprerjes së kontratës, si dhe të drejtën e punonjësit që në raste të tilla ka të drejtë të shoqërohet nga një përfaqësues sipas dëshirës së vetë. Në këtë çështje juridike, e paditura nuk ka respektuar absolutisht asnjë nga kushtet e cekura të dispozitës ligjore, ajo ka vepruar në kundërshtim me të gjitha të cekurat, duke marrë vendim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës punonjësit, duke e vendos në pozitë të pa lakmueshme, duke i mohuar të drejtën në procedurë të brendshme e cila zhvillohet brenda punëdhënësit, ku si rezultat i kësaj sjellje rrjedhe se vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit është e kundërligjshme.

11. Nga ana tjetër, gjykata gjënë se punonjësi në pikëpamje të procedurës së brendshme në të gjitha aspektet ishte në përputhje me rregulloret ligjore, sepse pas pranimit të vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ditën e cekur i është drejtuar punëdhënësit me kërkesë në përputhje me nenin 26 të Rregullores në fuqi numër 196 e marrë nga ana e të paditurës, datë 01.07.2011, mundësojnë të drejtën për t'u caktuar në punë të tjera që i përgjigjet arsimimit të tij, ku pas mungesës së përgjigjes nga punëdhënësi, i njëjti paraqiti ankesë më datë 19.11.2018 ku me atë hap ka dashur të ushtrojë të drejtat e tij të shkelura, dhe të gjitha konform nenit 78 paragrafi 1 të Ligjit të Punës.

12. Ka theksuar se gjatë tërë procedurës, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj pohimet e të paditurës se ndërprerja e marrëdhënies së punës, ka pasuar për shkak të shkeljes së detyrave të punës nga punonjësi, sepse në deklaratat e dëshmitarëve, dhe vetë paditësit qartë shihet se nuk ka ekzistuar performanca me shkrim e punonjësit. As e paditura nuk ia vërtetoi gjykatës me asnjë provë të vetme se ka ekzistuar performanca me shkrim apo paralajmërimi i punëdhënësit mbi sjelljen e tij të dobët dhe shkeljen e detyrave të punës, në të kundërtën, gjykata ka vërtetuar se ditën e mbledhjes kur është vendosur për shkarkimin e tij, nga paditësi është kërkuar të lëshoj sallën. Sa i përket nenit 21 Ligji për Ndërmarrjet Publike i cili autorizon Bordin Drejtues që me shumicën e votave të ndërpret marrëdhënien e punës po ashtu nuk është i obliguar të jap arsyetime për arsyen e ndërprerjes, gjykata gjënë se i njëjti nuk mund të konsiderohet i pranueshëm dhe i bazuar, sepse është në kundërshtim me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni I, Protokoll i Konventës së cekur, gjë që është edhe qëndrim i Gjykatës Supreme të Kosovës /Rep.Nr.30/2016/. Gjegjësisht, këto parime shprehin mundësin që secila palë në procedurë duhet të ketë mundësinë të paraqesë rastin e tij sipas kushteve të cilët nuk e vendosin atë në një pozicion dukshëm të pafavorshëm përballë kundërshtarit të tyre, gjë që në këtë çështje juridike gjykata ka konstatuar se është bërë.

13. Ka shtuar se dispozita e nenit 80 par.1 pika 1.2 Ligji i Punës, parasheh: Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e

punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që përsëri punonjësin ta kthej në vendin e punës dhe të urdhëroj t'i kompensoj të gjitha pagat dhe gjithë fitimin e humbur gjatë kohës së shkarkimit të paligjshëm nga puna. Gjykata pas zhvillimit të procedurës dhe vlerësimit të provave, vërtetoi se ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditësit është e kundërligjshme dhe se i njëjti është diskriminuar nga ana e drejtorit ekzekutiv, gjykata konstatoi diskriminim nga të gjitha veprimet e paligjshme të të paditurës, duke filluar nga mosdhënia e mundësive për t'u informuar dhe paralajmëruar mangësitë dhe lëshimet e mundshme për të cilat e paditura pohon se kanë ekzistuar në punën e tij, për faktin se paditësi është konstatuar me veprime të kundërligjshme dhe të parregullta të cilat i janë imponuar për t'u zbatuar, të cilat konsistojnë në nënshkrimin e dokumenteve me të cilat ai konsideron se nuk janë në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave, prodhoi një konflikt në marrëdhëniet drejtori ekzekutiv-paditësi.

14. Gjykata e shkallës së parë, nga të lartcekurat, e paditura me veprimet e saj nga padurimi i drejtorit ekzekutiv, ka diskriminuar paditësin dhe ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 5 të Ligjit të Punës, andaj gjykata bie vendim si në paragrafin e tretë të dispozitivit të aktgjykimit që paditësi të kthehet në vendin e tij të punës apo me ndonjë vend tjetër që i përgjigjet kualifikimit të tij dhe aftësisë së punës me të gjitha të drejtat e punësimit.

15. Pasi që gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar të lartcekurat, kështu që vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e anuloi si të kundërligjshëm, obligoi të padituren ta kthej në vendin e punës apo në ndonjë vend tjetër që i përgjigjet përgatitjes së tij profesionale, njëkohësisht obligoi të padituren që në emër të pagave të papaguara për periudhën nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës e deri në kohëzgjatjen e kontratës t'i paguan paditësit në emër të pagës neto shumën prej 22.086,12 €, në emër të kontributit pensional shumën prej /5% +5%/ shumën prej 2.519,10 €, në emër të tatimit shumën prej 1.845,33 €, dhe atë me kamatë ligjore vjetore prej 8%, nga përmbushja

e çdo kërkese veç e veç deri te pagesa përfundimtare, të gjitha në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Gjykata në tërësi i fali besimin e plotë ekspertizës së ekspertit financiar dhe plotësimin e saj për të cilin konsideron se është bërë në mënyrë të ndershme, me ndërgjegje dhe në mënyrë të paanshme, në përputhje me rregullat e shkencës dhe profesionit, në gjetje dhe mendim nuk ka pasur vërejtje nga ana e të autorizuarit të paditësit si dhe asnjë vërejtje argumentuese nga ana e të autorizuarit të padituresë.

16. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 5, 79 dhe 80 të Ligjit të Punës, nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni I, Protokoll i Konventës, nenit 21 Ligji për Ndërmarrjet Publike, nenin 26 të Rregullores Nr.196 të datës 01.07.2011. Për shpenzimet e procedurës iu ka referuar nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

17. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.Nr.1176/2022, të datës 10.12.2024, ka vendosur që ta aprovojë pjesërisht ankesën e të padituresë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

18. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nuk e aprovon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm, sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar edhe pse nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ndërsa e drejta materiale është zbatuar pjesërisht në mënyrë të gabuar, në pjesën që aktgjykimi gjykatës së shkallës së parë është ndryshuar.

19. Ka shtuar se nuk qëndron pretendimi ankimor i paditësit dhe të padituresë për shkelje të dispozitave procedurale nga neni 182.2 pika n) i LPK-së, pasi që aktgjykimi i atakuar është lehtë i ekzaminueshëm,

dispozitivi i aktgjykimi në pjesën vërtetuese është i qartë dhe në përputhje me arsyetimin, në arsyetim janë dhënë arsye për faktet vendimtare, nuk ka kundërthënie në mes të fakteve vendimtare, mënyrë e të provuarit të tyre nga të cilat ka rezultuar se pjesërisht është e bazuar kërkesëpadia e paditësit.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë dhe të parë, lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, si në pikën I, të dispozitivit të gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i shkallës së dytë dhe të parë, është përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

2. Parashtrimet e të paditurës si në revizion, sa i përket shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të pabazuara, dhe se aktgjykimet e instancave me të ulëta nuk janë përfshirë në shkeljet e pretenduara, dhe as me shkeljet të cilat shikohen sipas detyrës zyrtare siç përcaktohet me nenin 215 të LPK-së, që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt.

3. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, për arsye se:

   Me nenin 2 paragrafi 2 të Ligjit të Punës përcaktohet se: “Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës”.

Më nenin 10 paragrafi 7 të këtij ligji përcaktohet se: "Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj".

Me nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike përcaktohet se: "Bordi i Drejtorëve të NP-së do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, në veçanti, të veprimtarisë së zyrtarëve të NP-së".

Me nenin 21 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: "Zyrtarët e NP emërohen nga Bordi i Drejtorëve të NP. Zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre me ose pa deklarimin e arsyes. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, Komisioni i Auditimit ka kompetencën ekskluzive për emërimin dhe shkarkimin e Zyrtarin për Auditim të Brendshëm, i cili shërben për Komisionin e Auditimit, i cili mundet, në çdo kohë dhe me shumicë votash, ta ndërpresë kontratën e këtij zyrtari me ose pa deklarimin e arsyes. Ky Nen 21.1 mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj, dhe do të pasqyrohet në Rregulloren e NP-së", ndërsa me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: "Secila NP do të ketë këta katër zyrtarë në vijim: (i) Kryeshefin Ekzekutiv, (ii) Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, (iii) Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarit e Korporativ dhe (iv) një Zyrtar për Auditim të Brendshëm. Nëse është e nevojshme për shkak të madhësisë dhe/ose llojllojshmërisë së veprimtarive, NP mundet – nëse vendoset nga Bordi i Drejtorëve dhe përcaktohet në Rregullore - që po ashtu të ketë një ose dy poste të Zëvendës Kryetarit".

Me nenin 162 paragrafi 1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, përcaktohet se: " 1. Kompetencat e Bordit të Drejtorëve përfshijnë marrjen e vendimeve mbi të gjitha çështjet përveç vendimeve të cilat u janë rezervuar aksionarëve me ligj ose me statutin e Shoqërisë Aksionare. Duke marrë parasysh rezervimet e lartpërmendura, çështjet në vijim që bien nën fushëveprimin e Bordit të Drejtorëve: 1.1. miratimi i planeve gjithëpërfshirëse afariste strategjike të Shoqërisë Aksionare, kontrollet

e brendshme, auditimin, si dhe procedurat e menaxhimit të riskut; 1.2. thirrja e kuvendeve vjetore dhe të jashtëzakonshme të aksionarëve; 1.3. përgatitja e agjendës fillestare të kuvendit të aksionarëve; 1.4. përcaktimi i datës për listën e aksionarëve që kanë të drejtë të marrin pjesë në kuvendin e aksionarëve; 1.5. emetimi i aksioneve brenda kufizimeve të përcaktuara në statutin e Shoqërisë Aksionare apo në vendimet e aksionarëve për secilin lloj dhe kategori të aksionit, kur autorizimi në fjalë i është dhënë Bordit të Drejtorëve me statutin e Shoqërisë Aksionare apo me vendim të aksionarëve; 1.6. emetimi i bondeve, mundësive për blerjen e aksioneve dhe letrave tjera me vlerë, kur ajo kompetencë i është dhënë Bordit të Drejtorëve me Statut të Shoqërisë Aksionare apo me vendim të Aksionarëve; 1.7. punësimi i zyrtarëve/menaxherëve të lartë të Shoqërisë Aksionare dhe miratimi i kushteve të marrëveshjeve ndërmjet menaxhmentit të lartë dhe Shoqërisë Aksionare; 1.8. vendosja e kompensimit dhe kushtet tjera të marrëveshjes me auditorin e Shoqërisë Aksionare; 1.9. përcaktimin e shumave dhe caktimin e datave të pagesës dhe procedurat për pagesën e dividendave; 1.10. miratimi i raportit vjetor të Shoqërisë Aksionare, raportit të bilancit vjetor dhe vlerësimeve vjetore të fitimeve dhe të humbjeve të cilat pastaj do të dorëzohen tek aksionarët për miratim; dhe 1.11. Nëse Shoqëria Aksionare ka arritur kufijtë e përcaktuar me ligjin në fuqi për raportimin financiar, Bordi i Drejtorëve angazhon auditor të jashtëm për të kryer auditimin e jashtëm të deklaratës financiare vjetore si dhe të librave e regjistrave të Shoqërisë Aksionare, si dhe raporti i auditimit i bashkëngjitet raportit vjetor të Shoqërisë Aksionare; si dhe 1.12. vendosja e të gjitha çështjeve tjera të cilat kanë të bëjnë me kompetencën ekskluzive të Bordit të Drejtorëve të përcaktuar në statutin e Shoqërisë Aksionare".

4. Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës, Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe nga vlerësimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës sipas vlerësimit të Gjykata Supreme të Kosovës, kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë dhe e dytë në mënyrë të gabuar kanë konstatuar dhe kanë vendosur që kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, për arsye se:

Nëse i referohemi shkresave të lëndës, provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë dhe deklarimi i palëve ndërgjyqëse, rezulton se nuk ishte kontestuese në mes të palëve se paditësi ka qenë i punësuar te e paditura në vendin e punës Zyrtar Kryesor Financiar, fakt që konstatohet edhe nga kontrata e punës e cila është administruar si prova nga gjykata e shkallës së parë. Po ashtu, nuk ishte kontestuese se paditësit i është ndërprerë kontrata e punës në mënyrë të njëanshme nga e paditura.

5. Kontestuese në mes të palëve në këtë çështje juridike - kontestimore, ka qenë ligjshmëria e Vendimit me numër ... i datës 24.10.2018, duke u bazuar në vendimin e Bordit të drejtorëve Nr. ... të datës 23.10.2018.

6. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, duke ju referuar gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykatat e instancave me të ulëta, dhe meqenëse në këtë rast, procedura kontetimore është zhvilluar në mes të paditësit dhe të padituërs si ndërmarrje publike regjionale e cila është kompani në pronësi publike, ndërsa pozita e punës së paditësit për të cilën i është ndërprerë kontrata e punës ka qenë Zyrtar Kryesor Financiar, në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i cili e rregullon mënyrën e emërimit dhe ndërprerjes e marrëdhënies së punës, për pozitën Zyrtar Kryesor i Financave. Në këtë kontekst me nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, përcaktohet se: "Të gjitha NP do të organizohen si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare". Andaj në këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes është mbështetur edhe në dispozitat e Ligjit për Shoqëri Tregtare, duke marr për bazë faktin se e paditura e ka statusin e shoqërisë aksionare. Po ashtu, duke marr për bazë natyrën e kontestit, i cili ka të bëjë me ligjshmërinë e vendimit për ndërprerjen marrëdhënie së punës, është mbështetur edhe në dispozitat e Ligjit të Punës.

7. Nga përmbajtja e nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, rezulton se: Bordi i Drejtorëve i ndërmarrjes publike ka kompetencë ligjore që të emëroj zyrtaret, përfshirë edhe pozitën e Zyrtarit Kryesor

Financiar dhe të Thesarit, gjithnjë sipas kësaj dispozite ligjore të njëjtit zyrtar shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë me shumicën e votave të ndërpresë kontratën e tyre duke dhënë arsye, apo edhe pa dhënë arsye.

8. Nga përmbajtja e nenit 162 paragraf 1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, rezulton se: Bordi i Drejtorëve është organi kryesor përgjegjës për marrjen e të gjitha vendimeve në kuadër të shoqërisë aksionare, pa përjashtuar edhe çështjet e punësimit.

9. Nga përmbajtja e nenit 2 paragrafi 2 dhe nenit 10 paragrafi 7 të Ligjit të Punës, rezulton se: në rastet e lidhjes së kontratës së punës me afat të caktuar, i njëjti i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet përcaktuara me Ligjin e Punës, por me përjashtimin nëse parashihet ndryshe me ndonjë ligj tjetër.

10. Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës, Ligjit për Ndërmarrjet Publike, dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, kjo gjykatë vlerëson se Ligji për Ndërmarrje Publike, në këtë rast paraqitet si ligj special, kjo për faktin se i njëjti i rregullon të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, në raport me mënyrën e emërimit dhe ndërprerjes së kontratës për Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, e po ashtu, duke përcaktuar edhe kompetencat e Bordit të Drejtoreve të ndërmarrjes publike në raport me këtë pozitë. Meqenëse e paditura funksionon si shoqëri aksionare, kurse pozita e paditësit si Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit paraqitet ndër pozitat kryesore, nga dispozitat e lartcekura rezulton se kjo pozitë (si vend pune) ka status të veçantë të rregullimit ligjor, duke i dhënë Bordi të Drejtorëve kompetenca të plota ligjore për ndërprerjen e kontratës së punës, edhe pa deklarimin e arsyes.

11. Në këtë kontekst meqenëse Ligji për Ndërmarrjet Publike, është ligj i zbatueshëm në këtë rast, e duke marr për bazë autorizimet ligjore të cilat i janë bartur Bordit të Drejtorëve, i cili mundet sipas diskrecionit të tij, në çdo kohë dhe me shumicë të votave të ndërpresë kontratën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit, me ose pa deklarimin e

arsyes, e po ashtu, gjithnjë sipas këtij ligji, duke marr për bazë faktin se, ky përcaktim ligjor mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj, kjo gjykatë konstatoj dhe erdhi në përfundim se vendimi me numër ... i datës 24.10.2018 i nxjerr nga Bordi i Drejtorëve i të paditurës, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit në pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit, është vendim i ligjshëm i nxjerr në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

12. Kjo gjykatë ka vlerësuar se, me rastin e ndërprerjes të marrëdhënies së punës nga e paditura me të drejt nuk janë zbatuar dispozitat e Ligjit të Punës. Në këtë kontekst shikuar përmbajtjen e kontratës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, e cila i referohet këtij ligji, si ligj i zbatueshëm, mirëpo siç është theksuar më lartë me nenin 2 paragraf 2 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: "Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës. Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore, rezulton se zbatimi i dispozitave të Ligjit të Punës, ka edhe përjashtime, dhe atë sikurse në këtë rast Ligji për Ndërmarrje Publike, si ligj special ka përcaktuar zgjidhje për çështjen e caktuar që lidhet me emërimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të zyrtarëve në ndërmarrjeve publike, përkatësisht pozitës së paditësit Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit. Po ashtu edhe nga përmbajtja e nenit 21 paragraf 1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike, rezulton se në raport me emërimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kjo dispozitë mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj.

13. Kjo gjykatë nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë dhe të parë, edhe për faktin se e paditura me rastin e marrjes së vendimit, për ndërprerjen së marrëdhënies së punës paditësit, drejt ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike, i cili ligj nuk përcakton themelimin e komisionit disiplinor, apo zhvillimin e një procedure disiplinore, duke përcaktuar se ndërprerja e

marrëdhënies së punës nga Bordi i Drejtorëve, mund të behët edhe pa arsye.

14. Kjo gjykatë vlerëson se, e paditura duke funksionuar si shoqëri aksionare, ku Bordi i Drejtorëve është organi me i lartë menaxhues, dhe rrjedhimisht nuk ka ndonjë organ me të lartë brenda saj i cili do të trajtonte ankesën eventuale të paditësit. Po ashtu, një përcaktim i tillë ligjor përcaktohet me nenin 78 të Ligjit të Punës, me të cilin përcaktohet se: "I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura ". Në këtë kontekst, në këtë rast organ me i lartë për shqyrtimin e ankesës eventuale të paditësit se Bordi i Drejtorëve nuk ka ekzistuar, dhe me të drejtë paditësi nuk është udhëzuar që kundër vendimit, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të paraqet ankesë.

15. Kjo gjykatë nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë dhe të parë, se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies se punës është marrë në kundërshtim me të gjitha procedurat ligjore dhe dispozitat ligjore, veprime këto qe vendimin e atakuar e bëjnë me tepër se të paligjshëm dhe me ketë vendim edhe i cenohet e drejta e tij e punës e mbrojtur edhe me nenin 49 të Kushtetutës se Kosovës, për arsye se: dispozita kushtetuese në aspektin parimor e garanton të drejtën e punës, mirëpo kjo garanci i nënshtrohet dispozitave dhe rregullave ligjore, dhe në këtë rast pozita e paditësit i nënshtrohet përcaktimit ligjor në raport me detyrat dhe përgjegjësit e tij duke përfshirë edhe emërimin dhe shkarkimin e tij. Pra kjo gjykatë në këtë procedurë ka vlerësuar se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit, ishte vendim i ligjshëm dhe në përputhje me dispozita ligjore, ndërsa në raport me nenin 49 të Kushtetutës, paditësi e gëzon të drejtën e punës në vende të tjera të punës sipas zgjedhjes së tij.

16. Kjo gjykatë nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatave të instancave me të ulëta, me konstatimin se paditësit ju ka cenuar e drejta në shfrytëzimin e mjetit juridik efektiv, për arsye se:

    Me nenin 31 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: "1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike".

    Me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: "Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj".

    Me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: "Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".

    Me nenin 13 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, përcaktohet se: "E drejta për zgjidhje efektive Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare".

17. Nga përmbajtja e dispozitave kushtetues dhe konventës të cituara rezulton se në këtë rast paditësit nuk ju ka mohuar e drejta për qasje në drejtësi dhe as cenimi i të drejtës për shfrytëzimin e mjetit juridik efektiv, për faktin se:
    Në këtë kontekst në këtë rast organ me i lartë për shqyrtimin e ankesës eventuale të paditësit se Bordi i Drejtorëve nuk ka ekzistuar, dhe me të drejtë paditësi nuk është udhëzuar që kundër vendimit, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të paraqet ankesë. Ndërsa edhe pse në vendimin me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës,

nuk ka udhëzim juridik, për mjetin juridik nuk ja ka pamundësuar e drejta, për paraqitjen e padisë në gjykatë, gjë të cilin e ka bërë paditësi dhe në këtë kontekst gjykata e ka vlerësuar padinë e paditësit si të lejuar dhe të afatshme dhe ka vendosur lidhur me kërkesën e paditësit në mënyrë meritore, mirëpo paraqitja e padisë në gjykatë nuk nënkupton se kërkesëpadia e palës që ka paraqitur padi është e bazuar.

18. Përveç të cekurave palës paditëse, nuk ju ka mohuar qasjen në drejtësi, për arsye se:

    Qasja në drejtësi përbën një element kyç të së drejtës për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor të garantuar nga neni 31 i Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga neni 6 i Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, instrument ky drejtpërdrejtë i zbatuar në rendin tonë juridik sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prandaj, çdokush gëzon të drejtën që çështja e tij të dëgjohet nga një gjykatë e pavarur dhe se është pranuar si parakusht i të drejtës për gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor.

19. Pra, e drejta e qasjes në gjykatë paraqet një ndër elementet bazë të parimit të sundimit të së drejtës ngaqë kjo u siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar procedurë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile pranë një gjykate.

20. Në përgjithësi, e drejta për qasje në gjykatë garanton të drejtën për të filluar seancat gjyqësore përpara një gjykate dhe të drejtën për të marrë një vendim gjyqësor, si rezultat i diskutimeve dhe vlerësimeve të bëra pranë një gjykate të pavarur lidhur me të drejtat dhe detyrimet civile apo akuzat penale që rëndojnë mbi subjektet e së drejtës.

21. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si vlerë të rendit juridik kushtetues ekzistues (neni 7) ka mishëruar parimin e sundimit të së drejtës (ligjit) - ku autoriteti shtetëror përveç se krijon "të drejtën", njëkohësisht i nënshtrohet kësaj të fundit dhe e zbaton dhe detyrohet nga ajo në mënyrë të barabartë krahas subjektet tjera të së drejtës. Në

këtë kontekst, garancia procedurale e qasjes në drejtësi paraqet një ndër "urat", lidhëse midis subjektit të së drejtës që pretendon se i takon, i është shkelur, kufizuar, cenuar apo dëmtuar ndonjë e drejtë apo interes i tij dhe mekanizmave shtetërorë - gjykatat dhe/ose organet tjera të pavarura (kuazi gjyqësore) që janë të m' veshur me juridiksion dhe kompetencë për garantimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave. Pra e drejta për qasje në gjykatë, iu jep efekt respektivisht i jetëson parimet e shtetit të së drejtës dhe sundimit të së drejtës.

22. Megjithatë, e drejta për qasje në gjykatë nuk është një e drejtë absolute. GJEDNJ në çështjen Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar është shprehur se vetë natyra e saj (të drejtës për qasje në gjykatë) kërkon rregullim përkatës legjislativ (që mund të ndryshojë në kohë dhe vendndodhje sipas nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve) të hartuara nga shteti, megjithëse rregullime të tilla nuk duhet të cenojnë aspak thelbin/esencën e së drejtës e as të hyjë në konflikt me të drejtat e tjera të mishëruara në KEDNJ. Në këtë kontekst gjykatat e rregullta në ushtrimin e funksionit të tyre kanë për obligim që të gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit dhe Gjykata Supreme e Kosovës në këtë rast ka vlerësuar se qasja në drejtësi është parakusht thelbësor për realizimin e të drejtave të njeriut të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës respektivisht Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

23. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, duke marr për bazë faktin se paditësi nuk ka argumentuar se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë me shkelje të dispozitave ligjore të cituara, ka vendosur ta refuzoj edhe kërkesën e paditësit me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura, që në emër të kompensimit të dëmit në formën e pagave të parealizuara prej datës 24.10.202018 deri më datën 30.10.2020, t'i paguaj shumën si në vijim: në emër të ardhurave neto shumën prej 22.086,12 €, në emër kontributit pensional (5% +5%) shumën prej 2.519,10 €, në emër të taksës shumën prej 1.845,33 € dhe atë me kamat vjetore prej 8% nga përmbushja e çdo kërkese veçmas nga pagesa përfundimtare, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Obligohet e paditura

Kompania Regjionale e Ujësjellësit - KRU Mitrovicë, me seli në Mitrovicë, që paditësit R. S. në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguaj shumën prej 2,016 €, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

24. Kjo gjykatë vlerëson se kërkesat nga marrëdhënia e punës janë të ndërlidhura dhe atë: fillimisht duhet të provohet me prova se ka ndodhur shkelja e të drejtave të punëtorit, pra ndërprerja e marrëdhënies së punës të jetë bërë në kundërshtim me dispozita ligjore, e pasi të vërtetohet/konstatohet një shkelje e tillë, e paditura mund të obligohet nga gjykata, për kthimin e paditësit në të njëjtën pozitë apo në një pozitë ekuivalente me të, dhe detyrimin për pagesën e kompensimit përkatës, e që në këtë rast një gjë e tillë nuk ka ndodhur, për arsye se ndërprerja e marrëdhënies së punë është bërë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

25. Për hir të praktikës gjyqësore edhe pse në praktikën gjyqësore, e në veçanti në gjykatat e instancave më të ulëta, si në gjykatën e shkallës së parë ashtu edhe në gjykatën e shkallës së dytë, duke mos përjashtuar edhe këtë gjykatë rreth aplikueshmerisë së ligjeve të cituara si më lartë, se cili ligj në rastet e tilla duhet të aplikohet, ka pasur dilema dhe vendimmarrje ndryshe, këto nuk janë me ndikim për vendimmarrje ndryshe në këtë rast nga kjo gjykatë, për arsye se secili vendim gjyqësor me të cilin përfundon procedura kontestimore mund ti nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë sipas mjeteve të goditjes të rregullta dhe të jashtëzakonshme ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore të LPK-së, mirëpo është fakt jokontestues se praktika gjyqësore si burim i së drejtës mund të përdoret vetëm kur ajo është krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, si e vetmja gjykatë kompetente në bazë të Ligjit për Gjykata, për krijimin e praktikës gjyqësore, si me qëndrime parimore, mendime juridike dhe udhëzues juridik, ashtu edhe me vendime gjatë vendosjes sipas mjeteve të jashtëzakonshme.

26. Sipas vlerësimit të kësaj gjykata, duke ju referuar gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykatat e instancave me të ulëta, dhe meqenëse në këtë

rast por edhe në raste të ngjashme me gjendje faktike dhe juridike të njëjtë, procedura kontetimore është zhvilluar apo zhvillohet në mes të paditësit dhe të padituresi si ndërmarrje publike regjionale/qendrore e cila është kompani në pronësi publike, ndërsa pozita e punës së paditësit për të cilën i është ndërprerë marrëdhënia e punës ka qenë Zyrtar Kryesor Financiar apo pozita tjera siç është përcaktuar me nenin 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, është qartësuar se në këto raste duhet aplikuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i cili e përcakton mënyrën e emërimit dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës, për pozitën Zyrtar Kryesor i Financave, si ligj special i cili në raport me emërimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kjo dispozitë mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj. Në këtë kontekst me nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, përcaktohet se: "Të gjitha NP do të organizohen si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare". Andaj në këtë rast por edhe në raste të ngjashme Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes duhet aplikuar edhe dispozitat e Ligjit për Shoqëri Tregtare, duke marr për bazë faktin se e paditura e ka statusin e shoqërisë aksionare. Po ashtu, duke marr për bazë natyrën e kontestit, i cili ka të bëjë me ligjshmërinë e vendimit për ndërprerjen marrëdhënie së punës, duhet aplikuar edhe dispozitat e Ligjit të Punës, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditësit në këtë rast është pabazuar.

27. Gjykata Supreme e Kosovës, ka refuzuar kërkesën e palës paditëse edhe për kompensimin e shpenzimeve të procedurës, pasi pala paditëse e ka humbur kontestin, ndërsa pala e paditur nuk ka parashtruar sipas revizionit kërkesë për shpenzimet e procedurës, bazuar në nenin 449, 452 paragrafi 1, e lidhur me nenin 463 paragrafi 1 të LPK-së.
28. Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas padisë së paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.
29. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.171/24, datë 15.10.2024

''Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktvendimit të goditur, për të cilin shkak aktvendimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktvendimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 2 paragrafi 1 dhe 4 dhe nenit 182 paragraf 1, e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet.

Gjykata Supreme vlerëson se nga dispozitat e lartcekura dhe nga shkresat e lëndës shihet se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me mungesë të interesit juridik dhe as me çështje administrative e cila do të trajtohet në procedurë administrative, për faktin se paditësja me anë të padisë ka kërkuar vërtetimin e atësisë, e që konkretisht sipas librit amëz të të lindurve, nuk figuron emri i babait të paditëses, e që është e drejtë e pa kontestueshme që paditësja të kërkoj vërtetimin e atësisë.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në NN - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.1905/2021 të datës 31.08.2021, është vendosur: hedhet si e palejuar padia e paditëses NN nga NN, e ushtrua kundër të paditurave NN, nga NN, rr. NN, pn., dhe NN nga NN, rr. NN, pn., për vërtetim të atësisë, në këtë çështje juridiko kontestimore.

2. Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.Nr.8179/21, të datës 10.01.2024, është vendosur: Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses NN nga NN, rruga NN, Nr.NN, ndërsa aktvendimi i Gjykatës

Themelore në NN - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr. 1905/2021 i datës 31.08.2021, vërtetohet.

3. Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësja, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi revizion i paditëses si i bazuar, të anulohet aktvendimi i kundërshtuar dhe çështja kthehet të në rigjykim, ose të vërtetohet se baba biologjik i paditëses NN është NN nga NN ashtu që të obligohet shërbimi kompetent komunal që në LAL, të shënojë emrin e babait të paditëses.

4. Përgjigje në revizion nuk ka pasur.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

   Revizioni i paditëses është i bazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja më datë 28.03.2019, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur, padi, kundër të paditurave, për vërtetim të atësisë, duke kërkuar më saktësisht si në padi.

7. Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktvendimin e atakuar C.Nr.1905/2021 të datës 31.08.2021, me të cilin padinë e paditëses e ka hedhur poshtë si të palejuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit.

8. Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se: gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe shkresave të lëndës, gjeti se çështja e cila është objekt i padisë është më tepër çështje administrativë dhe mendon se pretendimet e ngritura nga pala paditëses në padinë e datës 28.03.2019, duhet të shqyrtohen dhe vendoset në procedurën administrativë, për arsye se me aktvendimin e

Kuvendit të Komunës së NNs Drejtoria për Organizmin dhe Administrimin e Përgjithshëm, me numër 02. Nr. 7/436, të datës 11.09.1969, paditëses NN, e lindur NN, i është lejuar regjistrimi me vonesë në librin amzë të të lindurve, dhe në pasusin e dytë të këtij vendimi, rezulton konstatimi se prindërit e saj, (pra të paditëses) janë NN dhe NN, nga NN. Edhe për kundër këtij aktvendimi, paditësja është regjistruar në librin amzë të lindurve vetëm në emër të nënës NN, pasi që nëna e paditëses kishe dhënë një deklaratë me Nr.278, të datës 28 janar. 1971, që fëmija të regjistrohet vetëm në emër të saj, e jo edhe në emër të prindërit NN. Paditësja tani me padi, po kërkon vërtetimin e atësisë, si fëmijë i lindur nga babai NN (tani i ndjerë) dhe nëna NN, dhe si palë të paditur ka përfshirë nënën biologjike NN dhe motrën e saj nga babai NN nga NN. Në bazë të të dhënave të lartcekura, kjo gjykatë konsideron se pasi që në aktvendimin Nr. 02.Nr.7/436, të datës 11.09.1969, rezulton konstatimi, që prindërit e paditëses janë NN dhe NN, tani shtohet pyetja se ku është interesi juridik i paditëses për padi vërtetimi, dhe si mund të vërtetohet, një fakt, i vërtetuar, gjykata konsideron se ky aktvendim është i vlefshëm, pasi që është lëshuar nga organi kompetent dhe nuk është kundërshtuar në atë kohë nga asnjeri nga prindërit e paditëses, konform ligjit në fuqi të asaj kohe dhe gjykata e udhëzon palën paditëses për ti realizuar të drejta e saja, ti drejtohet organeve tjera kompetente administrativë sipas interesit juridik që ka, e jo siç ka vepruar në rastin konkret, për çka edhe u vendos sikur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

9. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 391 pika f) të LPK-së.

10. Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësja ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin e saj Ac.Nr.8179/21, të datës 10.01.2024, ka vendosur që të refuzojë ankesën e paditëses si të pabazuar, ndërsa aktvendimin e atakuar të vërtetojë, duke vendosur decidicisht si në dispozitiv të aktvendimit.

11. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktvendimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe

përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g),j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë. Gjykata e shkallës së parë drejt ka vlerësuar kur ka marr vendim për hedhjen e padisë në mungesë të interesit juridik të paditëses për shkak se me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1 të LPK-së, është paraparë se: "Në procedurën kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse", ndërsa me paragrafin 4 të kësaj dispozite përcaktohet se: "Pala duhet të ketë interes juridik për padinë dhe për veprimet procedurale tjera që mund të kryhen në procedure".

12. Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktvendimit të goditur, për të cilin shkak aktvendimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishet.

13. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktvendimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 2 paragrafi 1 dhe 4 dhe nenit 182 paragraf 1, e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet.

14. Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë si të drejtë dhe të ligjshëm, për faktin se të njëjtat nuk kanë arritur

të japin arsye lidhur me faktet vendimtare mbi hedhjen e padisë si të palejuar në mungesë të interesit juridik dhe atë:

Me nenin 99 të LFK-së, përcaktohet se: " 1. At i fëmijës së lindur në martesë, do të konsiderohet burri i nënës së fëmijës nëse fëmija është lindur gjatë martesës ose brenda afatit prej 300 ditësh pas mbarimit së martesës. 2. Nëse fëmija është lindur në martesën e mëvonshme të nënës së vet pas kalimit të afatit prej 270 ditësh e deri në afatin prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës së saj të mëparshme, at do të konsiderohet burri i nënës nga martesa e mëparshme, përveç nëse burri i nënës nga martesa e mëvonshme me pëlqimin e saj e pranon fëmijën për të vetin."
Me nenin 100 të LFK-së, përcaktohet se: "1. Konsiderohet se fëmija ka lindur në martesë nëse prindërit e tij janë të martuar në kohën e lindjes së fëmijës. 2. Nëse prindërit e fëmijës të lindur jashtë martesës kanë pasur qëllimin që ta lidhin martesën dhe në këtë gjë kanë qenë të penguar me vdekjen e njërit prej tyre ose me ndonjë pengesë martesore që ka lindur pas zënies së fëmijës, në bazë të kërkesës së njërit prind të fëmijës, gjykata në procedurë jashtëkontestimore do të shpallë se fëmija ka lindur në martesë. 3. Nëse asnjëri prej prindërve nuk është i gjallë ose prindit të gjallë i është hequr aftësia për të vepruar apo i është hequr e drejta prindore, procedurën pranë gjykatës për shpalljen se fëmija i mitur ka lindur në martesë mund ta inicojë Organi i Kujdestarisë. 4. Nën kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni kërkesa për shpalljen e fëmijës martesor mund të parashtrohet gjithashtu edhe në kontestin për vërtetimin e atësisë, nëse atësia nuk është vërtetuar më parë me pranimin ose me vendimin e gjykatës".

Me nenin 101 të LFK-së, përcaktohet se: " At i fëmijës, i cili nuk ka lindur në martesë, as brenda afatit prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës, konsiderohet burri i cili e pranon për të vetin ose atësia e të cilit është vërtetuar me vendimin e gjykatës.".

Me nenin 103 të LFK-së, përcaktohet se: " 1. Personi i cili e konsideron vetën atë të fëmiut mund të pranojë atësinë në procesverbal para ofiqarit. 2. Atësia mund të njihet para Organit të Kujdestarisë, gjykatës

apo organit tjetër të autorizuar me ligj. Këto organe janë të detyruara që pa vonesë të dërgojnë procesverbalin e vërtetuar tek ofiqari kompetent, i cili duhet të regjistrojë fëmiun në regjistrin e të lindurve. 3. Atësia gjithashtu mund të njihet edhe me testament ".

Me nenin 104 të LFK-së, përcaktohet se: "1. Nëna e fëmijës së lindur jashtë martesës, në paraqitjen e lindjes së fëmijës mund ta shënojë personin të cilin e konsideron atë të fëmijës së vet. Ajo mund të ofrojë deklaratë me gojë që do të shënohet në procesverbal te ofiqari ose te organi i autorizuar për përpilimin e dokumenteve publike, në dokumentin e vërtetuar ose në testament. 2. Nëse nëna në paraqitjen e lindjes së fëmijës nuk e ka shënuar personin që e konsideron at të fëmijës, ofiqari do ta udhëzojë për të drejtën e saj që ta bëjë këtë gjë. 3. Kur e merr deklaratën e nënës për identitetin e atit të fëmijës së saj, ofiqari do ta ftojë personin e shënuar të deklarohet për atësinë e vet drejtpërdrejt para ofiqarit ose të ofrojë dokumentin e vërtetuar brenda afatit prej 30 ditësh. Letërthirrja për një person të këtillë medoemos i dorëzohet personalisht dhe sipas mënyrës me të cilën sigurohet fshehtësia. 4. Për veprimet që i ndërmerr dhe për deklaratat me gojë të nënës së fëmijës dhe të personit për të cilin nëna pohon se është atë i fëmijës, ofiqari do të përpilojë procesverbalin. 5. Nëse personi i ftuar deklaron se nuk është atë i fëmijës ose brenda afatit prej 30 ditësh nuk deklarohet për atësinë e fëmijës, ofiqari lidhur me këtë gjë do ta informojë nënën e fëmijës. 6. Nëse personi i ftuar deklaron në procesverbal para ofiqarit se konsideron veten atë të fëmijës, dhe kjo është e regjistruar në procesverbal ose në dokumentin e verifikuar, ofiqari zyrtarisht do ta regjistrojë si atë të fëmijës, në regjistrin amë të të lindurve dhe për regjistrimin duhet të informojë nënën e fëmijës".

Me nenin 106 të LFK-së, përcaktohet se: "1. Njohja e atësisë prodhon efekt juridik dhe regjistrohet në librin amë të të lindurve vetëm nëse me njohjen pajtohet nëna e fëmijës. 2. Deklaratën mbi pëlqimin për njohjen e atësisë mund ta japë nëna sipas rregullave të përcaktuara me nenin 103 të këtij Ligji për njohjen e atësisë. 3. Ofiqari ka për detyrë ta ftojë nënën e fëmijës që brenda afatit prej 30 ditësh të deklarohet për

njohjen e atësisë nëse ajo nuk e ka paraqitur më parë personin e njëjtë si at të fëmijës.

Me nenin 107 të LFK-së, përcaktohet se: "1. Nëse fëmija është më i vjetër se 16 vjeç është i nevojshëm edhe pëlqimi i tij për njohjen e atësisë. Ky pëlqim jepet sipas mënyrës së rregulluar me nenin 109 të këtij Ligji. 2. Nëse fëmija pavarësisht nga kjo moshë, është i paaftë për të gjykuar në mënyrë të vazhdueshme, ose nëna nuk është më e gjallë, apo ka vendqëndrimin e panjohur ose është shpallur e vdekur apo plotësisht i është hequr aftësia për të vepruar, deklaratën mbi pëlqimin për njohjen e atësisë e jep kujdestari i fëmijës me lejen e Organit të Kujdestarisë.

Me nenin 108 të LFK-së, përcaktohet se: "1. Nëse nëna e fëmijës ose fëmija që është më i vjetër se 16 vjeç, ose kujdestari i fëmijës kur nevojitet pëlqimi i tij, nuk pajtohen për njohjen e atësisë, ose nuk deklarohen lidhur me këtë gjë brenda afatit prej 30 ditësh, pasi të marrin në dijeni njohjen, personi i cili e ka njohur fëmijën për të vetin mund t'ia paraqesë padinë gjykatës për vërtetim se ai është at i fëmijës. 2. Padia mund të paraqitet brenda afatit prej tri vjetësh pas marrjes së njoftimit për mospajtimin e nënës, përkatësisht të fëmijës. Nëse në ndërkohë është vërtetuar atësia e personit tjetër, padia nuk mund të paraqitet pas kalimit të afatit për kundërshtimin e atësisë atij personi". Me nenin 109 të LFK-së, përcaktohet se: "1. Deklarata për njohjen e atësisë, si dhe deklaratat e nënës dhe të fëmijës, si dhe pëlqimi për njohjen e atësisë, nuk mund të revokohen. 2. Personi i cili ka dhënë deklaratën për njohjen e atësisë, mund të kërkojë anulimin e deklaratës nëse ajo është dhënë me shtrëngim, për shkak të mashtrimit ose në lajthim. 3. Padia për anulimin e deklaratës mund të paraqitet brenda afatit prej gjashtë muajsh nga data kur shtrëngimi është bërë i ditur, apo gabimi është vërejtur".

Me nenin 110 të LFK-së, përcaktohet se: " 1. Padinë për vërtetimin e atësisë së fëmijës së lindur jashtë martesës, përveç personit i cili e konsideron vetën atë të fëmijës mund ta paraqesin fëmija dhe nëna e fëmijës. 2. Fëmija i lindur jashtë martesës mund të paraqet padinë për

vërtetimin e atësisë në çdo kohë. 3. Nëse fëmija është i mitur ose nuk e ka aftësinë për të vepruar, padinë në emër të tij mund të paraqet nëna. Nëse nëna nuk është e gjallë ose i është hequr aftësia për të vepruar, përkatësisht nga kujdesi prindëror dhe kur nëna ka vendqëndrimin e panjohur, padinë mund të paraqet kujdestari me lejen e Organit të Kujdestarisë. 4. Nëna mund të paraqet padinë për vërtetimin e atësisë derisa të ketë të drejtën të ushtrojë të drejtën prindërore.

Me nenin 37 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: " Familja gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, në mënyrën e rregulluar me ligj ".

Me nenin 50 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: "1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre. 2. Fëmijët e lindur jashtë martese, kanë të drejta të barabarta me të lindurit në martesë. 3. Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi. 4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve. 5. Secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.

15. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore të lartcekura, si dhe nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, rezulton se Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund të pranoj përfundimin e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë si të drejtë dhe të ligjshëm, për faktin se të njëjtat nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me shkaqet e hedhjes së padisë në mungesë të interesit juridik.

16. Gjykata Supreme vlerëson se nga dispozitat e lartcekura dhe nga shkresat e lëndës shihet se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me mungesë të interesit juridik dhe as me çështje administrative e cila do të trajtohet

në procedurë administrative, për faktin se paditësja me anë të padisë ka kërkuar vërtetimin e atësisë, e që konkretisht sipas librit amëz të të lindurve, nuk figuron emri i babait të paditëses, e që është e drejtë e pa kontestueshme që paditësja të kërkoj vërtetimin e atësisë.

17. Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka konstatuar kur ka theksuar se nuk kanë nevojë të provohen faktet e provuara duke iu referuar aktvendimit të Kuvendit të Komunës së NNs Drejtoria për Organizmin dhe Administrimin e Përgjithshëm, me numër 02. Nr. 7/436, të datës 11.09.1969, dhe deklaratës së nënës së paditëses me Nr.278, më datë 28 janar. 1971, për faktin se nga aktvendimi dhe deklarata e lartcekur ka rezultuar që paditësja të regjistrohet në librin amëz të të lindurve pa emrin e babait biologjik, gjë që edhe sot nuk është e konfirmuar vërtetuar se kush është babai i saj biologjik, e që është e drejtë ligjore dhe kushtetuese që paditësja të dijë se kush është babai i saj biologjik dhe të regjistrohet në librat amëz me emër të të dy prindërve.

18. Kjo gjykatë vlerëson se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me çështje administrative ashtu siç ka theksuar gjykata e shkallës së parë, për faktin se organi administrativ në këtë rast ka pasur mundësi të regjistroj paditësen edhe në emër të babait të saj biologjik, vetëm nëse nëna në deklaratën e dhënë me Nr.278, më datë 28 janar. 1971, do ta kishte pohuar - pranuar që personi që pretendon paditësja me padi është babai i saj biologjik dhe kishte kërkuar regjistrimin e tij në librat amëz dhe njëkohësisht babai kishte pohuar një gjë të tillë, ashtu siç përcaktohet me nenin 104 të LFK-së, gjë që nuk është bërë një gjë e tillë në këtë rast, prandaj në këtë rast paditësja ka legjitimitet dhe interes të plotë juridik që të kërkojë vërtetimin e atësisë.

19. Përveç të cekurave Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund të pranoj përfundimin e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë si të drejtë dhe të ligjshëm, edhe për faktin se të njëjtat, palës paditëse ja kanë mohuar qasjen në drejtësi, për arsye se:

    Qasja në drejtësi përbën një element kyç të së drejtës për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor të

garantuar nga neni 31 i Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga neni 6 i Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, instrument ky drejtpërdrejtë i zbatuar në rendin tonë juridik sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prandaj, çdokush gëzon të drejtën që çështja e tij të dëgjohet nga një gjykatë e pavarur dhe se është pranuar si parakusht i të drejtës për gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor.

20. Pra, e drejta e qasjes në gjykatë paraqet një ndër elementet bazë të parimit të sundimit të së drejtës ngaqë kjo u siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar procedurë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile pranë një gjykate.

21. Në përgjithësi, e drejta për qasje në gjykatë garanton të drejtën për të filluar seancat gjyqësore përpara një gjykate dhe të drejtën për të marrë një vendim gjyqësor, si rezultat i diskutimeve dhe vlerësimeve të bëra pranë një gjykate të pavarur lidhur me të drejtat dhe detyrimet civile apo akuzat penale që rëndojnë mbi subjektet e së drejtës.

22. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si vlerë të rendit juridik kushtetues ekzistues (neni 7) ka mishëruar parimin e sundimit të së drejtës (ligjit) - ku autoriteti shtetëror përveç se krijon "të drejtën", njëkohësisht i nënshtrohet kësaj të fundit dhe e zbaton dhe detyrohet nga ajo në mënyrë të barabartë krahas subjektet tjera të së drejtës. Në këtë kontekst, garancia procedurale e qasjes në drejtësi paraqet një ndër "urat", lidhëse midis subjektit të së drejtës që pretendon se i takon, i është shkelur, kufizuar, cenuar apo dëmtuar ndonjë e drejtë apo interes i tij dhe mekanizmave shtetërorë - gjykatat dhe/ose organet tjera të pavarura (kuazi gjyqësore) që janë të mveshur me juridiksion dhe kompetencë për garantimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave. Pra e drejta për qasje në gjykatë, iu jep efekt respektivisht i jetëson parimet e shtetit të së drejtës dhe sundimit të së drejtës.

23. Megjithatë, e drejta për qasje në gjykatë nuk është një e drejtë absolute. GJEDNJ në çështjen Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar është shprehur se vetë natyra e saj (të drejtës për qasje në gjykatë) kërkon

rregullim përkatës legjislativ (që mund të ndryshojë në kohë dhe vendndodhje sipas nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve) të hartuara nga shteti, megjithëse rregullime të tilla nuk duhet të cenojnë aspak thelbin/esencën e së drejtës e as të hyjë në konflikt me të drejtat e tjera të mishëruara në KEDNJ. Në këtë kontekst gjykatat e rregullta në ushtrimin e funksionit të tyre kanë për obligim që të gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit dhe Gjykata Supreme e Kosovës në këtë rast ka vlerësuar se qasja në drejtësi është parakusht thelbësor për realizimin e të drejtave të njeriut të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës respektivisht Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

24. Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoi shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditëses dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

25. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.195/2025, datë 07.07.2025

''E drejta për vendim të arsyetuar gjyqësor është e mishëruar në përmbajtjen e KEDNJ, dhe që ka për qellim mbrojtjen e individit nga arbitrariteti. Një vendim gjyqësor i gjykatës vendore duhet të përmbajë arsye që janë të mjaftueshme për t'ju përgjigjur aspekteve esenciale të argumenteve faktike dhe ligjore – materiale dhe procedurale të palës në kontest. Gjithashtu, arsyetimi duhet të pasqyrojë pajtueshmërinë e gjyqtarëve me parimet e shpallura nga GJEDNJ, përkatësisht respektimin e të drejtës së mbrojtjes dhe të drejtës për një gjykim të drejtë.

Në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ, dhënia e arsyeve në vendim varet nga argumentet e ndryshme të parashtruara nga secila palë, si dhe nga dispozitat e ndryshme ligjore, zakonet dhe opinionet ligjore, si dhe nga praktikat e ndryshme në lidhje me hartimin e aktgjykimeve dhe vendimeve të shteteve të ndryshme. Për të respektuar parimin e gjykimit të drejtë, arsyetimi duhet të tregojë se gjyqtari ka shqyrtuar realisht të gjitha çështjet kryesore që janë parashtruar para tij. Pra, funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar, është t'u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për me tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për tu ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga gjykata e apelit.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.Nr.16/2020, të datës 18.02.2022, ka vendosur: I. Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditësit A. Sh. nga, P. dhe detyrohet i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës, që paditësit, t'ia kompensoj dëmin material dhe jo material, për dhembje shpirtërore për shkak të qëndrimit të paarsyeshëm në paraburgim për 118 ditë, t'ia paguaj shumën e specifikuar si vijon: Në emër të dëmit jo material (moral) në shumën prej 14,160 €, në emër të shpenzimeve për avokat në procedurë penale në shumën prej 3,000 €. II. Detyrohet i padituri: Këshilli Gjyqësor i Kosovës - Prishtinë, që paditësit A. Sh. nga P.,

presimet e cekura si më lartë t'ia paguaj, me kamat ligjor prej 8 %, nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit më datë 18.02.2022, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcenim të përmbarimit me dhunë. III. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit A. Sh. nga P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet, i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës - Prishtinë, që t'ia kompensoj dëmin përtej pjesë aprovuese në shumë prej 69.840 €, në emër të dhimbjeve shpirtërore, në emër të fitim të humbur nga të ardhurat personale të pa realizuara dhe bënifitet tjera përcjellëse, në shumën prej 20.000 €, për vizitat familjar dhe pakove shumën prej 2,000 €, shpenzimet për angazhim në ndihmë të personit të tretë në shumën prej 1,000 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcenim të përmbarimit me dhunë, si e pa bazuar. IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

2. Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin Ac.Nr.2209/2022, të datës 10.12.2024, ka vendosur: I. Aprovohet pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.16/2020, i datës 18.02.2022, në pikën I, të dispozitivit pika 1.1 (një pikë një) që ka të bëjë me dëmin jo material për dhimbje shpirtërore për shkak të qëndrimit të paarsyeshëm në paraburgim për 118 ditë dhe në këtë pjesë gjykohet si në vijim: Detyrohet i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit A. Sh. nga P., t'ia kompensoj dëmin jomaterial në emër të dhimbjeve shpirtërore shumën prej 5,900 €, me kamatë ligjore të caktuar nga data e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë (18.02.2022) deri në pagesën definitive, ndërsa pjesa e tjetër e kërkesëpadisë së paditësit përtej shumës së gjykuar refuzohet e pabazuar. II. Aprovohet pjesërisht e themeltë ankesa e paditësit A. Sh. nga P., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.16/2020, i datës 18.02.2022, në pikën III, të dispozitivit me të cilën është refuzuar e pabazuar kërkesëpadia e paditësit për vizitat familjare dhe pakove dhe në këtë pjesë gjykohet si në vijim: Detyrohet i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit A. Sh. nga P. , t'ia

kompensoj dëmin material për vizitat e familjarëve dhe pakove t'ia paguaj shumën prej 220 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar për këtë kërkesë refuzohet e pabazuar. III. Refuzohet pjesërisht e pathemeltë ankesa e paditësit A. Sh. nga P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.16/2020, i datës 18.02.2022, pika III, e dispozitivit lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit A. Sh. nga P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës - Prishtinë që t'ia kompensoj dëmin jo material përtej pjesë aprovuese në emër të dhimbjeve shpirtërore, në emër të fitimit të humbur nga të ardhurat personale të pa realizuara dhe bënifitet tjera përcjellëse, shpenzimet për angazhim në ndihmë të personit të tretë, dhe ankesa e të padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë, sa i përket pjesës aprovuese në emër të shpenzimeve për avokat në procedurë penale, ashtu që dhe pika I e dispozitivit 1.2 (një pikë dy), vërtetohen. IV. Pika IV e dispozitivit të aktgjykimit Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr. 16/2020, i datës 18.02.2022, mbetet e pashqyrtuar.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si i bazuar revizioni i paditësit, të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.2209/2022 i datës 10.12.2024 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.Nr.16/20 i datës 18.02.2022 dhe të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e bazuar.

4. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion i padituri, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta prish aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.Nr.2209/2022 të datës 10.12.2024, në pikën I, të dispozitivit dhe çështjen kontestimore t'ia kthej në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

   Revizioni i paditësit dhe të padituri është i bazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 08.01.2020, paditësi ka paraqitur padi, kundër të padituri, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, duke kërkuar më saktësisht si në parashtresën për precizimin e padisë të datës 27.01.2022.

7. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, kundër të padituri, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.Nr.16/2020, të datës 18.02.2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

8. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se: për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar këto prova: kërkesën e të autorizuarit të paditësit të datës 26.02.2018, ofertën e ofruar nga komisioni i të padituresë për kompensimin e dëmit personave të dënuar pa arsye dhe personave me heqje pa bazë nga lira, të datës 17.10.2018, ekspertizën e hartuar nga ekspertja e psikiatrisë Dr. Shpresa Povataj të datës 12.10.2021, fletëpagesën e bankës TEB, të datës 19.12.2016.

9. Ka shtuar se në bazë të provave që ka paraqitur paditësi dhe në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi, ka rezultuar e provuar se paditësit, i është shkaktuar dëm material dhe moral si pasojë e paraburgimit të tij të pa drejtë.

10. Pala e paditur e ka pranuar dëmin që i është shkaktuar paditësit, dhe duhet të kompensohet për ditë e qëndrimit në paraburgimi të pa drejt të tij, por e ka parashtrua kundërshtim e tij në lidhje me lartësinë e kompensimit.

11. Ka rezultuar e provuar me fakte dhe prova se për shkak të paraburgimit të pa drejtë, paditësit i është shkaktuar dëmi i cili dëm cilësohet si dëm jo material. Dëmi jo material është shfaqje e brendshëm, e përkohshme, e gjendjes shpirtërorë të njeriut, dhimbje e vuajtjeve shpirtërorë apo gjendje ankthi, mundim shpirtëror që rrjedh si pasojë e rrethanës së paligjshme. Cilido person që pëson cenimi në shëndetin dhe në personaliteti e tij nga veprimi a mosveprimi i paligjshme dhe me faj të një të treti, ka të drejt të kërkojë dhe dëmshpërblimin e dëmit moral të shkaktuar, pra cenimin e të drejtës së personaliteti që shkakton vuajtje shpirtërorë, pra janë të drejta që mbrohen me kushtetutë, aktet ndërkombëtare, si dhe me ligjet vendore, me konkretisht me nenin 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

12. Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit për paraburgim të padrejtë, për pjesën e dëmit jo material (moral), pasi që gjykata mendon se paditësi ka të drejtë të kompensohet për 118 ditë të qëndrimit në paraburgim, në shumë 14.160 €, pasi që u provuar nga ekspertiza e psikiatrisë së punuar dr. Shpresa Pavataj, e datës 12.10.2021, dhe dëgjimi i saj në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 20.01.2020, se paditësi, ka pësuar vuajtur shpirtërore, pa gjumësi dhe ankth dhe mos disponim me netë të tëra, gjendje kjo që ka qenë me e rënd kur ka ndodhur ngjarja, kurse tani vetëm përkujtimi i ngjarjes e bënë të shqetësohet, kjo gjendje ka prekur edhe familjaret e paditësit dhe e drejta e kompensimit të dëmit jo material (moral) gjen mbështetje ligjor në dispozitat e nenit 183 të LMD-së, përcakton se: "Personi qe në mënyrë të paligjshëm pëson dëmin ka të drejtë të kërkoj të shpërblehet kur ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cenuar autoriteti ose të drejta te personalitetit".

13. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në pjesën aprovuese pasi që ka menduar, se kompensim është real me peshën e veprës që është akuzuar paditësit, i cili ka punuar si ... në Q. e P. Sh. në P., dhe për një vepër penale të tillë, ka qëndruar në paraburgim 118 ditë, nga data 11.09.2014 deri më datë 06.01.2015, ndërsa përfundimisht është liruar nga dyshimet për vepër penale më datë 10.07.2017, për çka ka ardhur

deri të rehabilitimi i tij, gjykata mendon se në mbështetje të bindjes se saj të lirë, në kuptim të nenin 323 të LPK-së, që sqaron se gjykata po qe së vërteton se palës i takon e drejta që të shpërblehet dëmi në të holla apo sende të zëvendësueshme, por në pamundësi që të caktohet shuma e të hollave apo sasia e sendeve, apo së një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të madhe atëherë do të vendos sipas çmuarjes se lirë, dhe në ketë kuptim të këtyre rregullave gjykata veproi duke ja pranuar paditësit, shumën si në pjesë aprovuese të dispozitiv te këtij aktgjykimi.

14. Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë, që ndërlidhet me dëmin jomaterial për paditësin, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që ka vlerësuar se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, dhe me qëllim që kompensimi të ishte i drejtë, çdo shumë tjetër përtej shumës së aprovuar do të ishte jo në proporcioni me dëmin që i është shkaktuar paditësit. Dëmi duhet të jetë proporcional me dëmin e shkaktuar, edhe pse për dëmin jomaterial parashihet që personi i dëmtuar të kompensohet në të holla, megjithatë paratë asnjëherë nuk mund të përbëjnë vlerën e vërtetë dhe ekuivalente për dhimbjen apo vuajtjet që ka përjetuar njeriu, pasi ajo periudhë kohore, të cilën e ka përjetuar paditësi me vuajtje dhe shqetësime, nuk mund që të rikthehet edhe sikur të kompensohet në tërësi në shumën e kërkuar, por kompensimin i dëmit është vetë satifaksion për të dëmtuarin, e jo të udhëhiqet nga apetitet e tij/saj, pra të dëmtuarit t'i bëhet e mundur të rivendosë baraspeshën psikike dhe emocionale, siç ka ekzistuar para shkaktimit të dëmit.

15. Gjykata e shkallës së parë, ka aprovuar kërkesën e paditësit, që ti kompensohen shpenzimet e avokatit, për faktin se paditësi, i dorëzojë kësaj gjykata dëshmi që vërtetoj se kishte paguar, avokatin për ta mbrojtur në çështjen penale, ku edhe u provua pafajësia e tij, në shumën prej 3,000 €, e cila shumë është deponuar në xhirollogari të avokatit në TEB, më datë 19.12.2016.

16. Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesën e paditësit për pjesën e dëmit material për mos realizim të ardhurave (fitimit të humbur), në shumën prej 20.000 €, për pako dhe vizita në shumën prej 2,000 €, dhe angazhim për ndihmë të personit të tretë në shumën prej 1,000 €, për faktin se paditësi nuk ofroj prova me të cilat kishte me argumentuar lartësinë e kërkesëpadisë për këto kategori të dëmit, gjykata pa dashtë me mohuar faktin se paditësi i është ekspozuar këtyre shpenzimeve si kërkesa që i referohet, mirëpo kjo kërkesë nuk është e argumentuar në rastin konkret me prova materiale, paditësit nuk i provojë gjykatës se sa ka realizuare të ardhura mujore, pastaj sa i është shkaktuar dëme për vizita dhe pako, si dhe angazhim në ndihmë të personit të tretë, në mënyrë që gjykata të vendos në lidhje me këtë kërkesë, sepse në rastin konkret nuk mund të aplikohen rregullat që parasheh nga neni 323 të LPK - së, kjo për faktin se kjo pjesë e dëmit hynë në kategorinë e dëmit material, dhe është lehtësisht e matshme, në rastin konkret dhe duke u bazuar në dispozitat ligjor nga nenin 7, i po këtij ligji, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat e mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, dhe nenin 319, të të njëjtit ligj, që përcakton se secila palë ka për detyrë të provoj fakte mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, dhe paditësi ka barrën e provës për të provuar se gjatë periudhës së paraburgimit të padrejtë ka pësuar humbje që kanë përkeqësuar gjendjen ekonomike të tij ose të familjes prandaj, gjykata e refuzoi kërkesëpadinë për këto kategoritë të dëmit material.

17. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 527 dhe 529, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nenit 5 të KEDNJ-së, nenit 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, nenin 2, 7, 143, 319 dhe 323 të LPK-së. Lidhur me kamatën ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449 dhe 463 të LPK-së.

18. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi dhe i padituri kanë paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me

aktgjykimin e saj Ac.Nr.2209/2022, të datës 10.12.2024, ka vendosur që ta aprovojë pjesërisht ankesën e paditësit dhe të padituri, dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

19. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g),j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar. Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë nga ana e të padituri për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së.

20. Ka shtuar se nuk mund të pranohet pretendimi për këtë shkelje sepse pjesa e ndryshuar e aktgjykimit ka të bëjë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, e jo me arsyetimin e gabuar. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale e ka paracaktuar edhe arsyetimin e aktgjykimit për secilën kategori të dëmit. Aktgjykimi nuk është i përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Nga ana e palës së paditur nuk janë paraqitur pretendime për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të

goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

2. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) e lidhur me nenin 182 paragrafi 1, dhe 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri të përfundimi mbi aprovimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi aprovimin e pjesshëm të kërkesëpadisë.

3. Nga dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk mund të kuptohet se gjykata çka ka aprovuar, detyruar dhe çka ka refuzuar. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur sipas kërkesave të palëve dhe nuk ka sqaruar saktë se për cilat kategori të dëmit është aprovuar kërkesa dhe për cilat është refuzuar.

4. Duhet theksuar se arsyetimi mirë i vendimeve gjyqësore nuk është thjesht një detyrim ligjor, por gjithashtu një proces i cili ka për qellim të shërbej në disa dimensione. Fillimisht, vendimet gjyqësore të arsyetuara mirë, kanë për qellim të transmetojnë dhe tu tregojnë palëve se argumentet e tyre janë dëgjuar dhe konsideruar në mënyrë meritore nga ana e gjykatës. Përmes arsyetimit adekuat ligjor, palët në procedurë mund të kuptojnë pse dhe si gjykata ka arritur në një përfundim të caktuar në çështjen objekt shqyrtimi dhe, për rrjedhojë,

të marrin parasysh nevojën e përdorimit të mjetit juridik. Në këtë kontekst, arsyetimi i mirë gjithashtu lehtëson pranimin e gjykimit nga palët dhe nga publiku i gjerë. Në përgjithësi, vendimet gjyqësore (aktgjykimet) të arsyetuara mirë janë po ashtu, në funksion të mbrojtjes ndaj gjykimit arbitrar dhe garantojnë dhënien e duhur të drejtësisë, por edhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

5. Pra në këtë kontekst, gjatë procesit të vendimmarrjes, gjykatat janë zakonisht të detyruara sipas ligjit të japin arsyetim të detajuar për vendimet e tyre. Megjithatë, edhe pse vendi ynë nuk është pjesë e KEDNJ, detyrimet thelbësore në lidhje me përmbajtjen e arsyetimit të vendimeve gjyqësore burojnë gjithashtu nga KEDNJ, siç interpretohet nga GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore. Një detyrim i tillë për gjykatat vendore dhe institucionet publike rrjedh nga suprema lex, Kushtetuta se Republikës se Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KRK), dhe atë duke pasur parasysh faktin se, gjykatat, nëpërmjet zbatimit dhe interpretimit të normave kushtetuese për të drejtat e njeriut, në pajtim me praktikën e GJEDNJ, e kanë pranuar interpretimin e dispozitave për të drejtat e njeriut në pajtim me vendimet gjyqësore të kësaj gjykate, prandaj edhe neni 53 i KRK, e kërkon përmbushjen e këtij detyrimi. Përmbushja e këtij detyrimi arsyetohet me faktin se, gjykatat dhe organet tjera që do t'i interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me KRK, do t'i përkrahin vendimet gjyqësore të GJENDJ, dhe të njëjtat rast pas rasti do t'i përfshijnë në përmbajtjen e vendimeve të tyre me rastin e vendosjes. Përveç nenit 53 të KRK, instrumentet kryesore në fushën e mbrojtjes se të drejtave dhe lirive të njeriut zbatohen drejtpërdrejt në territorin e Republikës së Kosovës përmes nenit 22 të KRK, dhe ajo çfarë është shumë me rëndësi është fakti se të këto të drejta dhe liri kanë epërsi në rast të konfliktit ndaj të gjitha dispozitave ligjore dhe akteve tjera të institucioneve publike.

6. Për me tepër, detyrimi i gjykatave vendore për të dhënë arsye për vendimet e tyre është shprehur shprehimisht në praktikën gjyqësore të GJEDNJ, sipas nenit 6 të KEDNJ, i cili është burimi kryesor - por jo i vetmi - i detyrimit të gjykatave vendore për të dhënë një vendim të arsyetuar gjyqësor. Ky detyrim mund të rrjedhë gjithashtu edhe nga

detyrimet pozitive dhe procedurale që rrjedhin nga një sërë dispozitash tjera thelbësore të KEDNJ (p.sh., nenet 2, 3, 5, 8-11 të KEDNJ). Pra, përgjegjësia parësore për një vendim të arsyetuar në harmoni me standardet e GJEDNJ bie mbi gjyqtarin hartues, duke mos lënë anash edhe profesionistet tjerë ligjor, siç janë: prokuroret dhe bashkëpunëtorët profesional, të cilët megjithatë, kanë gjithashtu një përgjegjësi të përbashkët për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar. Kjo nënkupton se të gjithë profesionistet brenda sistemit gjyqësorë janë të lidhur nga një përgjegjësi e përbashkët për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ngritjen e sigurisë juridike dhe përmirësimin e sundimit të ligjit.

7. Pra garancitë e parashikuara në nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ, përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre. Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar, duke vendosur mbi bazën e parashtrimeve të tyre. Pra, vendimi gjyqësor duhet të perceptohet nga palët dhe nga shoqëria në përgjithësi si rezultat i zbatimit korrekt të normave ligjore, i një procedure të drejtë dhe i një vlerësimi të duhur faktik, si dhe i zbatueshëm efektivisht. Megjithëse gjykata e rregullt ka një kufi të caktuar vlerësimi kur zgjedh argumentet dhe pranon provat, ajo është e detyruar të justifikojë aktivitetet e saj duke dhënë arsyet për vendimet e saj.

8. E drejta për vendim të arsyetuar gjyqësor është e mishëruar në përmbajtjen e KEDNJ, dhe që ka për qellim mbrojtjen e individit nga arbitrariteti. Një vendim gjyqësor i gjykatës vendore duhet të përmbajë arsye që janë të mjaftueshme për t'ju përgjigjur aspekteve esenciale të argumenteve faktike dhe ligjore – materiale dhe procedurale të palës në kontest. Gjithashtu, arsyetimi duhet të pasqyrojë pajtueshmërinë e gjyqtarëve me parimet e shpallura nga GJEDNJ, përkatësisht respektimin e të drejtës së mbrojtjes dhe të drejtës për një gjykim të drejtë.

9. Në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ, dhënia e arsyeve në vendim varet nga argumentet e ndryshme të parashtruara nga secila

palë, si dhe nga dispozitat e ndryshme ligjore, zakonet dhe opinionet ligjore, si dhe nga praktikat e ndryshme në lidhje me hartimin e aktgjykimeve dhe vendimeve të shteteve të ndryshme. Për të respektuar parimin e gjykimit të drejtë, arsyetimi duhet të tregojë se gjyqtari ka shqyrtuar realisht të gjitha çështjet kryesore që janë parashtruar para tij. Pra, funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar, është t'u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për me tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t{u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga gjykata e apelit. Neni 6 i KEDNJ, dhe neni 31 i KRK, i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si detyrim i gjykatës për të dhënë përgjigje të hollësishme në çdo argument të palës në kontest.

10. Lidhur me këtë, e drejta për gjykim të drejtë mund të jetë efektive, vetëm nëse gjykata është e detyruar të arsyetoj vendimet e saj, e që është gjithashtu një garancion vital kundër arbitraritetit. Sipas KEDNJ, nëse nuk jepen arsye për vendimin ose nëse arsyet e dhëna bazohen në një gabim të qartë faktik ose ligjor të kryer nga gjykata, kjo pashmangshmërisht rezulton në "mohim të drejtësisë, " e për rrjedhojë në gjykim arbitrar. GJEDNJ në disa raste është ballafaquar jo me mungesë të plotë të arsyeve, por me inkoherencë të hapur të arsyeve të dhëna në aktgjykim, dhe nga gjykata kjo është konsideruar si arbitraritet. Në rastin Tatishvili v. Russia, GEDNJ, ka riafirmuar se, arsyetimi dukshëm i mangët nga gjykata e shkalles se parë, dhe aprovimi i mëvonshëm i një arsyetimi të tillë joadekuat nga gjykata e apelit, nuk përmbush kërkesat e një gjykimi të drejtë, dhe rezulton në vendimmarrje arbitrare.

11. Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e lidhur me nenin 182 paragraf 1, dhe 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet

ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara vetëm sa i përket zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

12. Pra kjo gjykatë vlerëson se Gjykata e Apelit në aktgjykimin e saj nuk ka dhënë arsye në lidhje me pretendimet thelbësore të ngritura nga pala paditëse dhe pala e paditur, e që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit material dhe jomaterial. Po ashtu në aktgjykimin e shkallës së dytë nuk ka asnjë arsye në lidhje me çështjet e ngritura në ankesë nga pala paditëse dhe pala e paditur, as në aspektin e shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, si dhe as në aspektin e aplikimit të gabuar të drejtës materiale. Kjo mënyrë e vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë është në kundërshtim me nenin 204 të LPK, i cili ka përcaktuar si obligim për gjykatën e shkallës së dytë që t'i vlerësoj pretendimet ankimore të palëve e të cilat kanë qenë vendimtare për dhënien e vendimit të saj.

13. Sipas kësaj gjykate, nuk mjafton që gjykata e shkallës së dytë vetëm të konstatoj se nuk ekzistojnë këto shkelje dhe ta përsëritë formulimin e dispozitës ligjore, por është obligim që të paraqes arsye të qarta në lidhje me atë se a ekziston apo jo shkelja e pretenduar nga pala. Duhet pasur parasysh se drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

14. Sipas kësaj gjykate, nuk janë dhënë arsye të qarta nga gjykatat e instancës më të ulët në lidhje me faktet thelbësore të çështjes e që kanë të bëjnë me çështjen e kompensimit të dëmit jomaterial, për shkak të cenimet të nderit, lirive dhe të drejtave të njeriut.

15. Në këtë kontekst nëse i referohemi doktrinës juridike dhe posaçërisht praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, vërehet influenca e të drejtave themelore në sferën e të drejtës private. Pra, ky ndikim i të drejtave themelore në të drejtën private shihet në rastet që kanë të bëjnë me të drejtat e personalitetit, konkretisht me shpërblimin e dëmit jomaterial

në rastin e mbrojtjes se të drejtave të personalitetit, dinjitetit dhe reputacionit. Koncepti i dignitas hominis në mendimin klasik romak ka nënkuptuar kryesisht "statusin". Në fakt, dignitas nuk kufizohej vetëm për njerëzit por aplikohej për institucionet dhe vetë shtetin. Ky koncept i dinjitetit prej kohesh është përfshirë në disa sisteme juridike në kontekstin e së drejtës private, si bazë për sigurimin e mbrojtjes së dinjitetit në kuptimin e "statusit", "reputacionit", dhe "privilegjeve".

16. Në vendin tonë, dinjiteti i njeriut është ngritur në rang kushtetues, dhe paraqet një prej vlerave themelore mbi të cilën mbështetet rendi juridik kushtetues. Në këtë mënyrë, Kushtetuta ka përcaktuar se, "Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut". Si i tillë, dinjiteti i njeriut hynë në kategorinë e të drejtave absolute dhe se shmangia nga kjo e drejtë nuk justifikohet në asnjë rrethanë, madje edhe rrethana të jashtëzakonshme qofshin ato.

17. Sa i përket mbrojtjes se ofruar nga KEDNJ, edhe pse në dispozitat e saj (përveç preambulës) dinjitetin njerëzor nuk e përmend shprehimisht, megjithatë, sipas praktikes gjyqësore të GJEDNJ, është riafirmuar koncepti se respektimi i dinjitetit të njeriut është vet thelbi i konventës.

18. Në të drejtën moderne është përfshirë koncepti i përgjegjësisë për dëmin jomaterial, i njohur si koncepti objektiv i dëmit jomaterial i cili bazohet në parimin e mbrojtjes së të drejtave të personalitetit. Më saktësisht, koncepti objektiv i dëmit jopasuror bazohet në rregullin se çdo shkelje e të drejtave të personalitetit përbën në vetvete një dëm jopasuror.

19. Në këtë mënyrë, kur vjen në shprehje cenimi i dinjitetit të njeriut, GJEDNJ ka përcaktuar inter- alia se kushdo që është ndaluar në kushte që nuk respektojnë dinjitetin personal të individit duhet të jetë në gjendje të marrë shpërblim adekuat. Lidhur me këtë, qëndrimi i praktikes gjyqësore të GJEDNJ, në rastet e cenimit të dinjitetit njeh si mjet juridik, shpërblimin e dëmit jomaterial.

20. Në anën tjetër, GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore, mbrojtjes së reputacionit i ka kushtuar kujdes të veçantë, dhe atë përmes sigurimit të mjetit efektiv juridik në rastet e cenimit të reputacionit. Në këtë mënyrë, sipas praktikës gjyqësore, e drejta për mbrojtjen e reputacionit është e drejtë e mbrojtur sipas nenit 8 të KEDNJ, si pjesë e të drejtës për respektimin e jetës private. Dhe, në mënyrë që të vie në shprehje efekti i këtij neni, sulmi ndaj reputacionit të ndonjë personi duhet të arrij një nivel të caktuar të seriozitetit, dhe të behet në një mënyrë që shkakton paragjykim ndaj gëzimit personal të së drejtës për respektimin e jetës private, (Libicki v. Poland).

21. Humbja e reputacionit vjen shprehje në shumicën e rasteve kur ndodh publikimi i informacioneve rreth jetës private të ndonjë personi, dhe atë përmes artikujve të të përditshmëve apo edhe në ndonjë forme tjetër. Mirëpo, në mënyrë që gjykata të marr në shqyrtim çështjen për cenimin e reputacionit, fillimisht aplikuesi duhet të dëshmoj se shteti nuk i ka ofruar mbrojtje të mjaftueshme, dhe se kjo ka rezultuar në shkeljen e të drejtës për mbrojtjen e reputacionit.

22. Në rastin, Mas Gavarró v. Spain, shteti spanjoll kishte theksuar se, pala është dashur që të parashtroj padi me kërkesë për korrektimin e publikimit brenda afatit ligjor, apo të inicoj procedurë të veçantë për mbrojtjen e nderit të tij, me qellim të sigurimit të shpërblimit, për dëmtimin e reputacionit. Megjithatë, duke zgjedhur vetëm rrugën penale, i njëjti kishte privuar vetveten nga mundësia e sigurimit të shpërblimit, për shkeljen e pretenduar në procedurë civile.

23. Nëse i referohemi dispozitave të LMD-së, rezulton se: kompensimi i dëmit jomaterial për shkak të cenimit të autoritetit/nderit është përcaktuar me nenin 183 paragrafi 1 i LMD-së. Për të ekzistuar mundësia e shpërblimit të këtij dëmi duhet të plotësohen këto parakushte: a) të shkaktohet cenimi i autoritetit, nderit të njeriut, b) të shkaktojë vuajtje psikike të i dëmtuari, c) kjo vuajtje të ketë intensitet të caktuar dhe kohëzgjatje të caktuar, d) të jetë shkaktuar me fajin e dëmtuesit, e) të ekzistojë lidhja kauzale midis këtij cenimi dhe dëmit të shkaktuar, dhe f) nga ky cenim të shkaktohet dëmi jomaterial.

24. Sipas kësaj gjykate, nuk janë dhënë arsye të qarta nga gjykatat e instancës më të ulët në lidhje me faktet thelbësore të çështjes e që kanë të bëjnë me çështjen e kompensimit të dëmit jomaterial, për shkak të heqjes së lirës pa bazë ligjore, për arsye se:

25. Nga perspektiva e praktikes gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta e shpërblimit të dëmit jomaterial lidhur me arrestimin dhe privimin e kundërligjshëm duhet të jetë e vlefshme si në aspektin teorik, po ashtu edhe në atë praktik. Në këtë drejtim, GJEDNJ, në rastin Dubovik v. Ukraine, ka konstatuar mungesë të mundësisë teorike nga ana e aplikuesit, për të kërkuar shpërblimin, për privim nga liria para autoriteteve vendore. Ndërsa, sa i përket vlefshmërisë se shpërblimit nga aspekti praktik, GJEDNJ, në rastin Chitayev v. Russia, ka ripërsëritur se, mos përfundimi i procedurës, përkatësisht pezullimi i saj, i ka pamundësuar efektivisht palës që të kërkoj shpërblimin, për kohen e kaluar në paraburgim. Pra, në secilin rast autoritetet kompetente duhet t'i sigurojnë shpërblim individit i cili në ndonjë rast është subjekt i arrestimit ose paraburgimit të pabazë, dhe kjo mundësi duhet të jetë e vlefshme si në teori, po ashtu edhe në praktikë. Dhe për me tepër, gjatë shqyrtimit të kërkesave për shpërblimin e demit, për paraburgim të paligjshëm, autoriteteve u kërkohet që të interpretojnë dhe zbatojnë të drejtën e brendshme në frymën e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin mëtejmë: KEDNJ), pa formalizëm të tepruar, dhe çdo veprim në kundërshtim më këtë kërkesë, rezulton në shkelje të dispozitave të KEDNJ, përkatësisht nenit 5.

26. Sidoqoftë, KEDNJ ka për qëllim të garantoj jo të drejtat të cilat janë teorike dhe iluzore, por të drejtat të cilat janë praktike dhe efektive, (Cumber v. The United Kingdom). Lidhur me këtë, GJEDNJ në raste të caktuara ka hasur në mungesë të së drejtës, për shpërblim të dëmit jomaterial, për shkak të demit të pësuar si rezultat i paraburgimit të paligjshëm. Në këtë mënyrë, në rastin Khachatryan and Others v. Armenia është konstatuar se, shtetet e caktuara në dispozita të ligjeve civile [Kode Civile], e kanë kufizuar këtë të drejtë vetëm sa i përket shpërblimit të demit material, pa përfshirë edhe shpërblimin për demin

jomaterial, për shkak të stresit dhe ankthit të përjetuar nga ana e personit si pasojë e mbajtjes në paraburgim pabazë ligjore.

27. Në këtë mënyrë, mos njohja e së drejtës, për shpërblim të demit jomaterial nga ana e autoriteteve në strukturën e tyre ligjore, ka për pasojë shkeljen e dispozitave të KEDNJ. Nga kjo perspektive e GJEDNJ, duhet të merret për bazë fakti se në çdo rast të cenimit të të drejtave të subjektit, për arsye të arrestit apo privimit të paligjshëm, e drejta për shpërblim të demit jomaterial, për ankthin dhe stresin e përjetuar duhet të jetë një e drejtë e garantuar, kjo paraqet një garancion të mishëruar në dispozitat e nenit 5.5 të KEDNJ, përndryshe çdo veprim në kundërshtim me këtë garancion, paraqet shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të individit.

28. Përveç dispozitave të KEDNJ, e drejta e shpërblimit, për arrestim dhe privim të paligjshëm është përcaktuar edhe me dispozitat e Kushtetutës së Republikës se Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta). Pra, Kushtetuta garanton të drejtën e shpërblimit pa përmendur apo kategorizuar format e demit të cilat pala mund t'i kërkoj, para organeve/institucioneve shtetërore.

29. Ky garancion është përcaktuar me nenin 29 paragrafi 5 të Kushtetutës, ku përcaktohet se: "Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj".

30. Siç edhe u theksua me lartë, kjo normë kushtetuese garanton të drejtën e shpërblimit, për ndalim apo arrestim të paligjshëm, pa përmendur format e shpërblimit të demit, të cilat pala mund t'i kërkoj në procedure gjyqësore. Dhe, për me tepër, duke pas parasysh faktin se, Kushtetuta me nenit 53, ka përcaktuar se: "Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Andaj, në ushtrimin e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, institucionet duhet t'i marrin për bazë vendimet gjyqësore të GJEDNJ. Kjo është evidente në një

masë si në praktiken gjyqësore të gjykatave të rregullta, ashtu edhe në atë të Gjykatës Kushtetuese. Ky rregullim i dyfishtë në rendin tonë juridik lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve, padyshim se paraqet një mënyrë efektive për sigurimin e realizimit të së drejtës, për shpërblim të dëmit, në rrethanat kur atyre u është mohuar apo pakësuar një e drejtë e tillë, siç mund të ndodhë në rastet e arrestimit apo privimit të paligjshëm.

31. Vlerësimi i shumës së dëmit në rastet e shpërblimit të dëmit jomaterial, nuk është një detyrë e lehtë, veçanërisht kur objekt i padisë është vuajtja personale, qoftë fizike apo psikike. Kjo, ngjashëm vlerësohet edhe nga perspektiva e GJEDNJ, e cila në rastin Vasilevskiy and Bogdanov v. Russia, ka theksuar se, nuk ka asnjë standard me të cilin dhimbja dhe vuajtja, përkatësisht shqetësimi fizik dhe ankthi psikologjik mund të maten në terma parash. Meqenëse, nga vlerësimi i GJEDNJ nuk ka një standard strikt sa i përket njohjes së shumës se shpërblimit, si mënyrë që ka marr parasysh është standardi i jetesës në vendin e caktuar, duke përfshirë, pagën minimale, mesataren e pensionit të pleqërisë, dhe pagën mesatare bruto, (Nikitin and Others v. Estonia). Në rastet kur një individi i njihet shuma e shpërblimit, ajo nuk duhet të jetë tepër e ultë saqë të minojë esencën e së drejtës për shpërblim sipas nenit 5.5 të KEDNJ. Pra, nuk duhet të jetë pa-arsyeshmerisht e ulët, dhe jo në konformitet me standardin e jetesës, përndryshe do të kualifikohet si shkelje e të drejtës së garantuar me këtë dispozitë.

32. Siç është theksuar edhe me lartë, e drejta për shpërblim lidhet kryesisht me kompensimin financiar. Në fakt, ky shpërblim nuk përcakton të drejtën për të siguruar lirimin e personit të ndaluar, e cila e drejtë rregullohet nga paragrafi 4 i nenit 5 të KEDNJ. Pra, neni 5.5 i KEDNJ, përfshin të drejtën e shpërblimit jo vetëm sa i përket demit material, por edhe shpërblimin lidhur me stresin, ankthin dhe vuajtjen shpirtërore që një person mund t'i këtë përjetuar si rezultat i shkeljes se dispozitave tjera të nenit 5 të KEDNJ, (Sahakyan v. Armenia). Në rastet e paraqitjes së padisë, për shpërblimin e demit jomaterial, i cili derivon nga një situatë e privimit të kundërligjshëm, është e nevojshme

që një procedurë e tillë e shpërblimit të zhvillohet nga institucionet shtetërore pa formalizëm të tepruar, dhe në këtë mënyrë t'i mundësohet palës qasje e lehtë në realizimin e të drejtave të tij subjektive. Dhe, ky shpërblim në mënyrë që të jetë në përputhje me garancitë e përmbajtura në dispozitat e KEDNJ, nuk duhet kufizuar në shpërblimin vetëm të demit material, por duhet në çdo rast të jetë e zbatueshme e drejta e shpërblimit të demit jomaterial.

33. Nëse i referohemi dispozitave ligjore të LMD-së, rezulton se: shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial, me rastin e heqjes së lirës pa bazë ligjore, është përcaktuar me nenin 183 paragrafi 1 i LMD-së.

34. Shpërblimi i dëmit jomaterial mund të realizohet edhe kur shkaktohet cenimi i lirisë-gjegjësisht heqja e lirisë pa bazë ligjore. Këto raste të shpërblimit të dëmit janë të shpeshta në praktikën gjyqësore te vendit, sepse janë të shpeshta rastet kur cenohet liria për shkak të heqjes së saj, pa bazë ligjore. Andaj, kur këto raste ekzistojnë në kushte të caktuara, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë realizimin e shpërblimit të dëmit, për shkak të vuajtjes psikike të pësuar si pasojë e heqjes së lirisë pa bazë ligjore.

35. Gjykata Supreme e Kosovës tashmë ka ndërtuar praktikën gjyqësore se mbi cilat kritere do të vendoset për shpërblimet e dëmit të tillë jomaterial, ndërsa rol në këtë ka edhe praktika e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, me seli në Strasburg, që ka përcaktuar se caktimi i kompensimit për këto kategori duhet të trajtohet si satisfaksioni i të dëmtuarve dhe në asnjë mënyrë pasurimi i tyre.

36. Për t'u realizuar e drejta në shpërblimin e dëmit jomaterial, me rastin e heqjes së lirës pa bazë ligjore duhet të plotësohen këto kushte: a) të hiqet liria, b) me heqjen e lirisë të shkaktohet vuajtja psikike e të dëmtuarit, c) të ekzistoj lidhja kauzale midis heqjes së lirisë dhe shkaktimit të vuajtjes psikike, dhe d) heqja e lirisë të shkaktohet me fajin e dëmtuesit.

37. Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se me rastin e gjykimit të shpërblimit për këtë lloj të dëmit, nuk ka arsye për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e psikiatrisë, pasi vuajtjet janë evidente dhe nuk ka nevojë të provohen përmes ekspertizës. Përjashtimisht ekspertiza mund të caktohet nëse i dëmtuari ka histori mjekësore të trajtimit mjekësor të aspektit psikiatrik, dhe atë me qëllim të vlerësimit të dokumentacionit mjekësor dhe dhënies së mendimit nëse ekziston lidhja kauzale në mes dokumentacionit mjekësor dhe privimit nga liria.

38. Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit për këtë lloj të dëmit jomaterial, duhet të marrë parasysh moshën e të dëmtuarit, personalitetin e tij, profesionin, jehonën mediatike që i është dhënë rastit me rastin e arrestimit të dëmtuarit dhe gjatë kohës së heqjes nga liria, kohëzgjatjen e privimit nga liria, nëse heqja e lirisë ka konsistuar vetëm në arrest shtëpiak apo qëndrim në paraburgim, natyrën e veprës për të cilën është mbajtur në heqje lirie, si dhe kritere tjera.

39. Nga kjo rezulton se nga gjykatat e instancës më të ulët në lidhje me faktet thelbësore të çështjes e që kanë të bëjnë me çështjen e kompensimit të dëmit jomaterial, për shkak të cenimet të nderit, lirive dhe të drejtave të njeriut.

40. Gjykata Supreme nuk mund ta pranoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë as për pjesën e kërkesës lidhur me fitimin e humbur, për arsye se:

    Nga përmbajtja e dispozitave të LMD-së, rezulton se: dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur). Për të fituar të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit duhet të ekzistojë dëmi real, apo zvogëlimi i pasurisë të dëmtuarit, ose pengimi i rritjes së pasurisë, që nënkupton fitimin e humbur. Tek dëmi real apo i zakonshëm vlen parimi i kthimit në gjendje të mëparshme, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e LMD-së. Ndërsa te fitimi i humbur duhet të vlerësohet se sa do të rritej ajo pasuri nëse nuk do të paraqitej pengesa.

41. Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën.

42. Po ashtu nga përmbajtja e dispozitave të LMD-së, rezulton se: Fitim i humbur është një lloj i veçantë i dëmit material. Ky lloj i dëmit ekziston kur i dëmtuari pengohet për t'iu rritur pasuria. Nëse i referohemi dispozitave të LMD-së, rezulton se fitimi i humbur mund të realizohet kumulativisht me dëmin real, nëse ekzistojnë kushtet e caktuar për të.

43. Fitimi i humbur sipas dispozitave të LMD-së, nënkupton vetëm atë fitim për të cilin është i sigurt se kreditori sipas rrjedhës së rregullt të gjerave ose sipas rrethanave të veçanta të rastit do ti realizojë.

44. Gjithashtu edhe në raport me pjesën e kompensimit të dëmit material për shpenzimet për avokat në procedurë penale, gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke mos e argumentuar me prova bindëse se cilat kanë qenë shpenzimet e domosdoshme të palës në procedurë penale. Nuk mjafton vetëm fakti se pala ka pasur mbrojtës në këtë procedurë penale, por duhet të shihen edhe rrethanat e tjera se a ka qenë e domosdoshme prezenca e mbrojtësit, nëse po për cilat raste, nëse jo, a ka pas mundësi pala që ti mbroj të drejtat e tij edhe pa prezencën e avokatit, nëse avokati është paguar për seancat të cilat ka qenë, nga pala apo sipas detyrës zyrtare dhe rrethana të tjera që dëshmojnë se kërkesa lidhur me këtë pjesë të dëmit është e bazuar dhe se realisht palës i është shkaktuar dëm në ketë procedurë.

45. Përveç të cekurave, tani për tani nuk mund të pranohet përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, për faktin se hartimi i dispozitivit si nga ana e gjykatës së shkallës së parë, po ashtu edhe nga gjykata e shkallës së dytë është i paqartë dhe kontradiktor, nuk dihet saktë dhe drejtë se çka është aprovuar dhe çka është refuzuar

dhe të njëjtat nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me faktet vendimtare rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, për arsye se: gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë vlerësuar drejtë dhe saktë provat që gjenden në shkresat e lëndës, në arsyetim të aktgjykimit nuk janë dhënë sqarime të mjaftueshme mbi kërkesat të cilat janë aprovuar, dhe ato që janë refuzuar, përveç të cekurave gjykata e shkallës së parë dhe e dytë, nuk i kanë vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimor dhe si rezultat i kësaj kanë bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të LPK-së, andaj aktgjykimet e instancave më të ulëta është dashtë të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

46. Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj gjykata do të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoi shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet që janë krijuar raportet juridike në mes të palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësve dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

47. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.336/25, datë 07.07.2025

’’Sipas Gjykatës Supreme element thelbësor në këtë çështje është mungesa e publicitetit të rastit, pra kallëzimi penal - aktakuza nuk është bërë publik në media dhe nuk ka pasur shpërndarje të informacionit në mënyrë që të krijohet perceptimi publik negativ për paditësin. Pala paditëse vetëm hipotetikisht vlerëson se kjo fletëparaqitje është përhapur si informacion në gjykatë, pastaj edhe në rrethin më të gjerë shoqëror, por që nuk paraqet prova për të argumentuar një pretendim të tillë, apo që ndonjë mënyrë të ketë pasur publikim mediatik për këtë rast. Në mungesë të këtij fakti, nuk mund të argumentohet se ka ndodhur një cenim real dhe i maturueshëm i reputacionit të tij profesional. Në mungesë të një përhapje publike, me të drejtë nxirret përfundimi në këtë rast se nuk ka pasur ndërhyrje të papërshtatshme në jetën private të paditësit. Ndikimi i kallëzimit penal dhe aktakuzës në reputacion duhet të jetë real, i dukshëm dhe me pasoja të qarta, jo hipotetik siç ka pretenduar paditësi në këtë rast.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.Nr.1201/18, të datës 27.04.2022, ka vendosur: I. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit L. M., nga P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura K.R.U, “ Drini i Bardhe ”, Pejë, që në emër të kompensimit të dëmit moral - cenimit të dinjiteti dhe personaliteti , paditësit t’ia paguaj shumat, 15.000 €, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 1841.60 €, në total shumën prej 16.841.60 €, me kamat ligjor prej 8%, duke filluar nga data 25.05.2017, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale kontestimore në shumën 3.487.80 €, të gjitha në afatit prej 15 ditëve, me ditën e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, si e pa bazuar. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

2. Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktgjykimin Ac.Nr.4131/2022, të datës 04.03.2025, ka vendosur: Refuzohet e pathemeltë ankesa e paditësit L. M., nga P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr. 1201/18, i datës 27.04.2022, vërtetohet.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësi, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi revizioni i paditësit si i bazuar, të anulohen aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështja kthehet në rishqyrtim ose të ndryshohen aktgjykimet e kundërshtuar ashtu që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e bazuar.

4. Përgjigje në revizionin e paditësit nuk ka pasur.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

   Revizioni i paditësit është i pabazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, më datë 02.11.2018, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të padituri, për shkak të kompensimit të dëmit, me të cilën ka kërkuar si në precizimin e padisë të bërë me parashtresën e datës 29.03.2022.

7. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, kundër të padituri, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin C.Nr.1201/18, të datës 27.04.2022, me të cilin e ka aprovuar refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

8. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se: me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes

faktike lidhur me këtë çështje, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: ka lexuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore ne Pejë, P.Nr.561/17, të datës 23.10.2018, ekspertizën e psikologes klinike të punuar nga ekspertja Ergita Zajmi, nga Peja, e pa datuar, e dorëzuar drejtpërdrejti në gjykatë, si dhe deklarimet palëve në procedurën gjyqësorë.

9. Ka shtuar se nuk ka qenë kontestuese fakti se e paditura, kishte ngrit kallëzim penal ndaj paditësit për uzurpim prone, dhe pastaj prokurori i shtetit kishte ngrit aktakuzë, dhe gjatë zhvillimit të procedurës penale, prokurori i shtetit është tërheqë nga akuza dhe me aktgjykimin P.Nr. 561/17, të dt.23.10.2018, është refuzuar aktakuza.

10. Ndërsa, nga ekspertiza e psikologes Mr. Sci. Ergita Zajmi, nga Peja, rezulton konstatimi se paditësi (si palë e dëmtuar), si pasojë e ngritjes së kallëzimit penale, ka përjetuar gjendje emocional të renduar e jo stabile , që përcjellët me mungesë të koncentrimit, çrregullim të gjumit - Insomnia, paraqitje e ankthit, raporte të zbehura me familjen, rrethin e shoqërinë, çrregullim të humorit si pasojë e çrregullimit distimik, për të paktën dy vite me humor depresiv të shoqëruar nga simptoma të tjera, i cili mendim nuk është kontestuar nga palët ndërgjyqësorë.

11. Pra nga interpretimi i dispozitave ligjore kjo gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se e paditura nuk bartë përgjegjësi dhe nuk ka për detyrim që paditësit t'ia kompensoj dëmin moralë në shumën e kërkuar si në padi, dhe dëmi material si shpenzimet e krijua në procedurë penale, pasiqë konsideron se kërkesa e paditësit nuk është e bazuar dhe nuk ka mbështetje ligjore. Në rastin konkret për tu konsiderua një kërkesë e bazuar në ligj duhet plotësuar katër kushte që lidhen me detyrimin dhe shkaktim të dëmit material dhe jo material dhe atë me konkretisht: a) ekzistimi i dëmit, b) ekzistimi i paligjshmërisë së veprimit dhe mos veprimit, c) ekzistimi i fajit , d) lidhja shkakore midis veprimit dhe mos veprimit dhe pasojës (dëmit), dhe se këto kushte ligjor nuk janë plotësuar dhe kërkesa e paditësit u refuzua.

12. Kjo gjykatë konsideron se edhe për kundër faktit se e paditura ka ngrit kallëzim penal, veprimi i saj, nuk mund të konsiderohet si i paligjshëm pasi që e njëjta përmes rrugës ligjor është duke e kërkuar një të drejtë të saj dhe cilido person, (përfshirë edhe të paditur), që mendon se i është cenuar një e drejtë apo uzurpuar prona si në rastin konkret e gëzon të drejtën për mbrojte ligjore dhe kjo e drejt është e garantuar me ligj, pra veprimi i të padituresë nuk mund të konsiderohet i paligjshëm, pavarësisht suksesit në procedurën gjyqësorë çoftë në çështjen penale apo edhe në çështjen civile, për çka gjykata në një situatë të tillë, konsideron se kërkesa e paditësit është e pa bazuar, dhe u vendos sikur në dispozitiv të aktgjykimit.

13. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 450, 452, 454, të KPPRK/së, nenin 159, 169, 170, dhe nenit 183, të Ligji mbi Marrëdhënie e Detyrimeve. Për shpenzimet e procedurës ju ka referuan nenit 450 të LPK-së.

14. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.Nr.4131/2022, të datës 04.03.2025, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e paditësit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetojë, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

15. Gjykata Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

16. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

17. Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara.

18. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

19. Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallë së dytë ka

dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

20. Baza juridike e kërkesëpadisë, që i padituri të jetë përgjegjës për të kompensuar dëmin paditësit, nuk gjenë mbështetje në nenin 136, 140, dhe 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i datës 10 maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 dhjetor 2012.

21. Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: " Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ". Me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: " Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ".

22. Me nenin 183 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, përcaktohet se: "1. Për dhembjet e pësuara fizike, për dhembjet e pësuara shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. 2. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror".

23. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për faktin se kallëzimi penal i bërë nga e paditura nuk është vërtetuar se është paraqitur me qëllim të keq apo abuziv, për faktin se vetëm pas konstatimit në ekspertizë e cila është nxjerrë në procedurë penale është vërtetuar se nuk kemi të bëjmë me veprën penale për të cilën është ngarkuar.

Kallëzimi penal është shqyrtuar nga prokuroria dhe është ngritur aktakuzë lidhur me këtë çështje dhe vetëm pas administrimit të provave është vërtetuar se nuk kemi të bëjmë me veprën penale, ku dhe prokurori i çështjes është tërheq nga akuza, që nënkupton se as i padituri nuk ka pas njohuri të qarta rreth pronës dhe se kallëzimi penal nuk është bërë me qëllim të dëmtimit të imazhit paditësit. Edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, në rastin Fernandes v. Portugalia (Nr.42736/15), gjykata thekson se vetë fakti i ndjekjes penale apo kallëzimit penal nuk përbën automatikisht shkelje të nenit 8 të Konventës, në mungesë të qëllimit keqdashës, publicitetit apo pasojave reale ndaj reputacionit.

24. Sipas kësaj gjykate element thelbësor në këtë çështje është mungesa e publicitetit të rastit, pra kallëzimi penal - aktakuza nuk është bërë publik në media dhe nuk ka pasur shpërndarje të informacionit në mënyrë që të krijohet perceptimi publik negativ për paditësin. Pala paditëse vetëm hipotetikisht vlerëson se kjo fletëparaqitje është përhapur si informacion në gjykatë, pastaj edhe në rrethin më të gjerë shoqëror, por që nuk paraqet prova për të argumentuar një pretendim të tillë, apo që ndonjë mënyrë të ketë pasur publikim mediatik për këtë rast. Në mungesë të këtij fakti, nuk mund të argumentohet se ka ndodhur një cenim real dhe i maturueshëm i reputacionit të tij profesional. Në mungesë të një përhapje publike, me të drejtë nxirret përfundimi në këtë rast se nuk ka pasur ndërhyrje të papërshtatshme në jetën private të paditësit. Ndikimi i kallëzimit penal dhe aktakuzës në reputacion duhet të jetë real, i dukshëm dhe me pasoja të qarta, jo hipotetik siç ka pretenduar paditësi në këtë rast.

25. Përveç kësaj, pala paditëse vetëm ka supozuar në shkaktimin e dëmit jomaterial dhe material, por që nuk ka ofruar asnjë provë të drejtpërdrejt për të vërtetuar që në ndonjë formë ti jetë shkaktuar dëmi jomaterial apo material. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në mungesë të plotësimit të kushteve të theksuara i padituri nuk mund të përgjigjet në kuptim të nenit 170 të LMD-së, për dëmin e pretenduar nga paditësi, kjo pasi që pala paditëse nuk ka dëshmuar me prova konkrete për dëmin e pretenduar, por vetëm hipotetikisht ka vlerësuar

se i është shkaktuar dëm jomaterial dhe material. Nga rrethanat e çështjes nuk rezulton se në raport me paditësin kishte dëmtim të reputacionit, cenim nderi dhe autoriteti me faktin që ndaj tij është paraqitë fletëparaqitje penale, kjo pasi paraqitja e rastit i padituri nuk e kishte bërë me qëllim të keq dhe tendencioz për të dëmtuar reputacionin e paditësit, ndërsa ky si rast nuk ishte bërë as publik, pra nuk kishte përhapje publike dhe rrjedhimisht nuk ka pas perceptim publik negativ për paditësin. Nga kjo rezulton se paditësi në mënyrë hipotetike por që nuk ka mundur të argumentoj se kallëzimi penal ka pasur ndikim real, të matshëm dhe me pasoja qarta në reputacionin e tij.

26. Po ashtu në doktrinën juridike dhe posaçërisht praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së, vërehet influenca e të drejtave themelore në sferën e të drejtës private. Pra, ky ndikim i të drejtave themelore në të drejtën private shihet në rastet që kanë të bëjnë me të drejtat e personalitetit, konkretisht me shpërblimin e dëmit jomaterial në rastin e mbrojtjes se të drejtave të personalitetit, dinjitetit dhe reputacionit. Koncepti i dignitas hominis në mendimin klasik romak ka nënkuptuar kryesisht "statusin." Në fakt, dignitas nuk kufizoj vetëm për njerëzit por aplikohej për institucionet dhe vetë shtetin. Ky koncept i dinjitetit prej kohesh është përfshirë në disa sisteme juridike në kontekstin e së drejtës private, si bazë për sigurimin e mbrojtjes së dinjitetit në kuptimin e "statusit" "reputacionit" dhe "privilegjeve."

27. Në sistemet juridike të bazuara në të drejtën romake, dinjiteti shihet si e drejtë e personalitetit, dhe në rast të cenimit të tij, ofrohen mjete juridike të karakterit civil.

28. Në vendin tonë, dinjiteti i njeriut është ngritur në rang kushtetues, dhe paraqet një prej vlerave themelore mbi të cilën mbështetet rendi juridik kushtetues. Në këtë mënyrë, Kushtetuta ka përcaktuar se, "Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut". Si i tillë, dinjiteti i njeriut hynë në kategorinë e të drejtave absolute dhe se shmangia nga kjo e drejtë nuk

justifikohet në asnjë rrethanë, madje edhe rrethana të jashtëzakonshme qofshin ato.

29. Sa i përket mbrojtjes se ofruar nga KEDNJ, edhe pse në dispozitat e saj (përveç preambulës) dinjitetin njerëzor nuk e përmend shprehimisht, megjithatë, sipas praktikes gjyqësore të GJEDNJ, është riafirmuar koncepti se respektimi i dinjitetit të njeriut është vet thelbi i konventës.

30. Në të drejtën moderne është përfshirë koncepti i përgjegjësisë për demin jomaterial, i njohur si koncepti objektiv i demit jomaterial i cili bazohet në parimin e mbrojtjes së të drejtave të personalitetit. Me saktësisht, koncepti objektiv i demit jo pasuror bazohet në rregullin se çdo shkelje e të drejtave të personalitetit përbën në vetvete një dëm jo pasuror.

31. Në këtë mënyrë, kur vjen në shprehje cenimi i dinjitetit të njeriut, GJEDNJ ka përcaktuar inter alia se kushdo që është ndaluar në kushte që nuk respektojnë dinjitetin personal të individit duhet të jetë në gjendje të marrë shpërblim adekuat. Lidhur me këtë, qëndrimi i praktikes gjyqësore të GJEDNJ në rastet e cenimit të dinjitetit njeh si mjet juridik, shpërblimin e demit jomaterial.

32. Në raste të caktuara, vende të ndryshme parashohin krahas kompensimit jomaterial edhe masat preventive si mjet juridik në rastet e cenimit të dinjitetit. Mirëpo, në rast se masat preventive nuk janë efektive në sanimin e shkeljes, atëherë, është detyrim i institucioneve që t'i sigurojnë individit kompensim adekuat për shkeljen e ndodhur.

33. Në anën tjetër, GJEDNJ në praktiken e saj gjyqësore, mbrojtjes se reputacionit i ka kushtuar kujdes të veçantë, dhe atë përmes sigurimit të mjetit efektiv juridik në rastet e cenimit të reputacionit. Në këtë mënyrë, sipas praktikes gjyqësore, e drejta për mbrojtjen e reputacionit është e drejtë e mbrojtur sipas nenit 8 të KEDNJ, si pjese e të drejtës për respektimin e jetës private. Dhe, në mënyrë që të vjen në shprehje efekti i këtij neni, sulmi ndaj reputacionit të ndonjë personi duhet të

arrij një nivel të caktuar të seriozitetit, dhe të behet në një mënyrë që shkakton paragjykim ndaj gëzimit personal të së drejtës për respektimin e jetës private, (Libicki v. Poland).

34. Humbja e reputacionit vjen shprehje në shumicën e rasteve kur ndodh publikimi i informacioneve rreth jetës private të ndonjë personi, dhe atë përmes artikujve të të përditshmëve apo edhe në ndonjë forme tjetër. Mirëpo, në mënyrë që gjykata të marr në shqyrtim çështjen për cenimin e reputacionit, fillimisht aplikuesi duhet të dëshmoj se shteti nuk i ka ofruar mbrojtje të mjaftueshme, dhe se kjo ka rezultuar në shkeljen e të drejtës për mbrojtjen e reputacionit.

35. Në rastin, Mas Gavarró v. Spain, shteti spanjoll kishte theksuar se, pala është dashur që të parashtroj padi me kërkesë për korrektimin e publikimit brenda afatit ligjor, apo të inicoj procedurë të veçantë për mbrojtjen e nderit të tij, me qellim të sigurimit të shpërblimit, për dëmtimin e reputacionit. Megjithatë, duke zgjedhur vetëm rrugën penale, i njëjti kishte privuar vetveten nga mundësia e sigurimit të shpërblimit, për shkeljen e pretenduar në procedurë civile.

36. Një tjetër aspekt që vlen të theksohet sa i përket mbrojtjes se reputacionit, është edhe pyetja se a mundet një person i cili ka kryer një vepër penale të thirret në mbrojtjen e ofruar nga neni 8 i KEDNJ. Lidhur me këtë, GJEDNJ në rastin, Faludy-Kovacs v. Hungary, është shprehur se, një person nuk mund të thirret në nenin 8, për tu ankuar për humbjen e reputacionit, që është pasojë e parashikueshme e veprimeve të tij, siç është p.sh., kryerja e veprës penale. Kjo situatë përjashton të drejtën për tu thirrur në garancinë e ofruara nga ana e konventës. Sikurse edhe në rastet e tjera të mbrojtjes se të drejtave të personalitetit, praktika gjyqësore e GJEDNJ edhe tek cenimi i reputacionit njeh të drejtën e zbatueshme të shpërblimit në formë të demit jo material.

37. Nëse i referohemi dispozitave të LMD-së, rezulton se: shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial për shkak të cenimit të autoritetit dhe nderit është përcaktuar me nenin 183 paragrafi 1 i LMD-së.

38. Ky rast i shpërblimit të demit jomaterial është një prej rasteve të veçanta te shpërblim i dëmit. Cenimi i dinjitetit ekziston kur me ofendim, me rrëfim të rrethanave familjare, me nënçmim ose me kryerjen e veprës penale siç është akti i dhunimit, me rrëfim për paaftësinë punuese të njeriut, të aftësisë profesionale të tij, në krijimin e atmosferës rreth kualiteteve të një personi, rreth afarizmit te tij dhe rreth autoritetit të tij në jetën e përditshme.

39. Për të ekzistuar mundësia e shpërblimit të këtij dëmi duhet të plotësohen këto parakushte: a) të shkaktohet cenimi i autoritetit, nderit të njeriut, b) të shkaktojë vuajtje psikike të i dëmtuari, c) kjo vuajtje të ketë intensitet të caktuar dhe kohëzgjatje të caktuar, d) të jetë shkaktuar me fajin e dëmtuesit, e) të ekzistojë lidhja kauzale midis këtij cenimi dhe dëmit të shkaktuar, dhe f) nga ky cenim të shkaktohet dëmi jomaterial.

40. Përveç të cekurave sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, paditësi në këtë rast nuk kanë arritur ti vërtetojnë faktet mbi të cilat e mbështetin kërkesën e vet edhe pse kjo ka qenë detyrë e tyre, në kuptim të nenit 322 paragrafi 1 dhe 2, e lidhur me neni 7 paragrafi 1 dhe 319 paragrafi 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: "Gjykata është e autorizuar ti vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuara në nenin 3 paragraf 3 të këtij ligji) në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe".

41. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.343/2025, datë 07.07.2025

’’Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe dispozitave të kontratave dhe amendamenteve të kontratave të punës, si dhe nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës edhe Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar.

Në këtë kontekst gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka konstatuar dhe ka vendosur që kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se paditësi dhe i padituri raportin e tyre - të drejtat dhe detyrat e tyre, punëdhënës - punëmarrës i kanë rregulluar me kontratë në formë të shkruar, duke përcaktuar saktë të drejtat dhe detyrat e tyre reciproke, gjykata ka konstatuar se kontratat e punës janë lidhur në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të cekura me lartë, se kushtet e kontratave të punës të lidhura në mes të paditësit dhe të padituri duke marrë për bazë kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, si dhe përfundimin e marrëdhënies së punës, siç ka ndodhur në këtë rast janë në pajtim të plotë me dispozita ligjore të Ligjit të Punës dhe dispozitat e kontratave të punës.

Në këtë rast i padituri me vendim e ka njoftuar paditësin për mos ripërtëritjen e kontratës së punës, për shkak të skadimit të kontratës edhe pse nuk ka pasur detyrim ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të dispozitave ligjore të lartë cekura.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, me aktgjykimin C.Nr.492/20, të datës 06.07.2021, ka vendosur: Aprovohet kërkesëpadia e precizuar e paditësit F. Xh. nga fshati Q., Komuna S., dhe anulohet njoftimi i datës 04.03.2020 i të padituri, për mosvazhdimin e kontratës së punës së paditësit të datës 04.04.2020 dhe detyrohet e paditura “L. K.” I. A. J.S.C me seli në V., që paditësin ta kthejë në punë dhe detyra të punës udhëheqës i ngarkimit, ose në

punë dhe detyra të punës që i përgjigjen përgatitjes profesinale të paditësit me të njëjten pagë mujore, si dhe t'ia kompensojë të ardhurat personale për periudhën kohore prej datës 04.04.2020 e deri më datë 31.01.2021, dhe atë për paga neto në shumën prej 2,770.05 € me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e nxjerrjes së ekspertizës financiare datë 10.02.2021 e deri në pagesën definitive, në emër të trustit pensional në Trustin Pensional të Kosovës në shumë prej 161.27 € në emër të paditësit, në emër të tatimit në pagë shumën prej 124.14 €, si dhe në emër të kamatës së arritshme për pagën neto shumën prej 93.97 €, si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 888.80 €, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

2. Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin Ac.Nr.372/2022, të datës 20.01.2025, ka vendosur: I. Aprovohet e bazuar ankesa e të paditurës A. N. i P. "L. K. I. A." J.S.C, me seli në V., Komuna e L., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.Nr.492/20, i datës 06.07.2021, dhe çështja lëndore gjykohet si në vijim: Refuzohet e pabazuar kërkesëpadia e paditësit F. Xh., nga fshati Q., Komuna S., me të cilën ka kërkuar që të anulohet njoftimi i të paditurës i datës 04.03.2020, për mospërtritjen e kontratës së punës së paditësit të datës 04.04.2020, dhe të detyrohet e paditura A. N. i P. "L. K. I. A." J.S.C, me seli në V., që paditësin ta kthejë në punë dhe detyra të punës udhëheqës i ngarkimit, ose në punë dhe detyra të punës që i përgjigjen përgatitjes profesinale të paditësit me të njëjtën pagë mujore, si dhe t'ia kompensojë të ardhurat personale për periudhën kohore prej datës 04.04.2020 e deri më datë 31.01.2021, dhe atë për paga neto në shumën prej 2,770.05 € me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e nxjerrjes së ekspertizës financiare të datës 10.02.2021 e deri në pagesën definitive, në emër të trustit pensional në Trustin Pensional të Kosovës në shumë prej 161.27 € në emër të paditësit, në emër të tatimit në pagë shumën prej 124.14 €, si dhe në emër të kamatës së arritshme për pagën neto shumën prej 93.97 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të

aktgjykimi nën kërcënimin e përbarimit me detyrim. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësi, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.Nr.372/2022 i datës 20.01.2025 të ndryshohet, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan C.Nr.492/2020 i datës 06.07.2021 të vërtetohet.

4. Përgjigje në revizion ka paraqitur i padituri, me propozim që revizioni i paditësit të refuzohet në tërësi i pabazuar.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

   Revizioni i paditësit është i pabazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, më datë 08.04.2020, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të padituri, për anulimin e njoftimit për mos ripërtëritjen e kontratës së punës dhe kompensim i të ardhurave personale, duke kërkuar më saktësisht si në precizimin e padisë të bërë si në parashtresën e datës 17.06.2021.

7. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit kundër të padituri, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.Nr.492/20, të datës 06.07.2021, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

8. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: me leximin e njoftimit për mos

ripërtëritjen e kontratës se punës të datës 03.03.2020, ankesa e paditësit të ushtruar më datë 11.03.2020, vendimin e shkallës së parë të inspektoratit të punës të datës 02.04.2020, vendimin e shkallës së dytë i IP-së, me numër ... të datës 06.08.2020, parashtresën e datës 25.01.2021 e së bashku me vërtetimin e datës 22.01.2021, lidhur me numrin e punëtorëve të larguar nga puna prej datës 04.03.2020, numrin e tërësishëm të punëtorëve të të paditurës, si dhe aktin e brendshëm të paditurës, konfirmimin e punësimit të paditësit të datës 30.07.2020, (vërtetimin i përvojës së punës) me Nr.HR- ... , Kontratën e punës të paditësit për periudhën që nga fillimi i marrëdhënies së punës siç është kontrata e datës 01.06.2017-31.08.2017, kontratën e datës 01.09.2017-28.02.2018, së bashku me amendamentet e datës 07.03.2018, kontratën e datës 04.04.2018-03.04.2019, dhe amendamentin e datës 04.04.2019, vërtetimin e lëshuar nga shërbimi i asistencës sociale në KK S. me numër të protokollit ... të datës 04.04.2019, monitorimin e transanksioneve të llogarisë bankare të paditësit për periudhën 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020, pasqyrën e trustit pensional të paditësit për periudhën raportuese18.01.2020 deri më datë 18.01.2021, ekspertizën financiare të datës 10.02.2021 të hartuar nga eksperti financiar Shaban Syla, procesverbalin e seancës kryesore të datës 17.05.2021 mbi dhënien e sqarimeve të ekspertit financiar, plotësimin e ekspertizës financiare të datës 17.05.2021 të dorëzuar në gjykatë më datë 27.05.2021, procesverbalin e seancës kryesore të datës 01.06.2021 mbi dëgjimin e dëshmitarit B. L., si dhe provat e deponuara në gjykatë nga dëshmitari në lidhje me takimin e datës 23.08.2019 si dhe shkresat tjera të bashkangjitura, parashtresën e datës 07.06.2021 së bashku me vërtetimin për numrin e punëtorëve të cilët janë larguar nga puna apo nuk u është vazhduar kontrata e punës nga data 21.08.2019 deri më datë 03.04.2020, si dhe numrin e punëtorëve të cilët janë pranuar në të njëjtën periudhë dhe në vendin e punës së njëjtë.

9. Ka shtuar se e paditura me rastin e shkëputjes të kontratës së punës paditësit me vendimin e datës 03.03.2020, nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të parapara me Ligjin e Punës dhe Marrëveshjen Kolektive, si dhe të njëjtat vendime janë marr në kundërshtim me këtë ligj. Kjo për faktin se mbi bazën e të gjitha provave të administruara si

më lartë, të cilave gjykata ia fali besimin në tërësi, u vërtetua se paditësi tek e paditura ka themeluar marrëdhënie pune për periudhë të caktuar dhe atë mbi bazën e kontratës së punës të datës 01.06.2017 në vendin e punës si "Udhëheqës i ngarkimit", me pagën bruto mujore prej 300.00 €, duke iu vazhduar kontrata e punës me amendamentet e saj deri më datë 03.04.2020. Paditësi ishte pjesëmarrës i grevës së datës 19.20 dhe 21.08.2019, të organizuar nga Sh. S. e P.e të paditurës, paditësi asnjëherë nuk i është dhënë performancë e pakënaqshme për kryerjen e detyrave të punës për të cilat është caktuar, u vërtetua se vendi i punës së paditësit është i karakterit të përhershëm, dhe e paditura përkundër marrëveshjes së arritur në takimin e mbajtur më datë 23.08.2019, në mes të SH.S.P (...) ANP "Adem Jashari" dhe Menaxhmentit të të paditurës, në pikën 6 të kësaj marrëveshje palët u dakorduan se: Punëdhënësi të ndaloj dhe të mos ndërmerr masa ndaj punëtorëve grevist, se nuk do të zhvilloj procedurë disiplinore kundër punëtorëve të cilët gjatë grevës kanë bërë veprime të papërshtatshme, andaj e paditura pa zhvilluar procedurë të brendshme për ndonjë cenim të detyrave të punës nga paditësja, me vendim me shkrim të datës 03.03.2020, e ka njoftuar paditësin se në përputhje me nenin nenin 71 paragrafi 2 të LP-së, të njëjtit nuk do t'i vazhdohet kontrata e punës që nga data 04.04.2020, ndaj të cilit vendim paditësi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë tek e paditura më datë 11.03.2020, ankesë kjo e cila nuk është vendosur fare nga e paditura, dhe më pas paditësi në afatin ligjor ka ushtruar padi pranë kësaj gjykate në procedurë kontestimore për mbrojtjen e të drejtave të tij të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

10. Ka shtuar se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe bazuar në dispozitat ligjore të lartshënuara, gjykata e erdhi në përfundim se vendimi i të paditurës për mosripërtëritjen e kontratës së punës është i kundërligjshëm, dhe atë i njëjti si i tillë është marr në kundërshtim me dispozitat e nenit 4 të LMD-së, kjo për faktin se edhe pse vendi i punës së paditësit ku ka punuar tek e paditura që nga fillimi i kontratës së parë të punës të datës 01.06.2017, dhe amendamenteve të kontratës së punës të cekura më lartë, ku paditësi ka punuar, ka qenë vend pune i përhershëm, e paditura si punëdhënëse ka lidhur kontratë pune në kohë

të caktuar, që nga data 01.06.2017 deri më datë 04.04.2020 dhe në mënyrë të pandërprerë me 2 amendamente të saj dhe dy kontrata, kjo kontratë i është vazhduar deri më datë 04.04.2020 dhe deri në atë kohë vendi i punës ku ka punuar paditësi ka qenë vend pune i përhershëm, ashtu që me kontrata e tilla të njëpasnjëshme të lëshuara për kohë të caktuar, është cënuar parimi i ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë, kështu duke u mbajtur paditësin në gjendje të pasigurtë juridike gjatë ekzistimit të marrëdhënies së punës që nga data 101.06.2017 e deri më datë 04.04.2020.

11. Andaj ka theksuae se gjykata vlerëson se punëmarrësi nuk mund të heq dorë nga të drejtat e punëtorëve që rrjedhin nga dispozitat urdhëruese nga neni 5.1 të Ligjit të Punës, ku përcaktohet se është i ndaluar çfarëdo diskriminimi në punësim, profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masa disiplinore, ndërprerja e kontratës së punës ose çështjeve tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe ligjet tjera në fuqi, dhe mbi këtë bazë e paditura ka dështuar për të vërtetuar faktin se i është përmbajtur ndalimit të diskriminimit.

12. Ka theksuar se vendimin për mosripërtëritjen e kontratës së punës është cenuar dispozita e nenit 13 të Ligjit për Greva, ngase e paditura qysh nga koha e mbajtjes së grevave të punëtorëve të të padituërs më datë 21.08.2019, e deri me dt.04.04.2020, po në këtë periudhë paditëses së bashku me 51 punëtor të tjerë të punësuar tek e paditura nuk i është vazhduar kontrata e punës ndërsa tre të tjerëve i është ndërprerë kontrata e punës, fakt ky i cili vërtetohet se paditësit nuk i është vazhduar kontrata e punës vetëm se i njëjti ka qenë njëri prej pjesëmarrëseve në grevën e organizuar nga SH.S.P, më datë 19, 20 dhe 21.08.2019, përkundër marrëveshjes së arritur mes SH.S.P-së, - Aeroportit dhe Menaxhmentit të punëdhënësit (këtu të padituërs), të arritur me dt. 23.08.2019, se punëtorët grevist nuk do të kenë pasoja për shkak të pjesëmarrjes në këto greva.

13. Gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se e paditura me rastin e mosripërtëritjes së kontratës së punës paditësit me vendimin e datës

03.03.2020, nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të parapara me Ligjin e Punës dhe Marrëveshjen Kolektive, si dhe të njëjtat vendime - njoftime janë marr në kundërshtim me këtë Ligj. Kjo u vërtetua nga vendimet e Inspektoratit të punës së shkallës së parë me Nr. Nr.Rap ... të datës 02.04.2020, me të cilin janë anuluar vendimet për mos vazhdimet e kontratës së punës së punëtorëve të tjerë dhe paditësit, dhe vendimit të IP-së, së shkallës së dytë me Nr. ... të dt. 06.08.2020 me të cilin vendim, ankesa e të paditurës është refuzuar si e pabazuar dhe vendimi i shkallës së parë të Inspektoratit të Punës është vërtetuar.

14. Ka theksuar se fakti se vendimi i të paditurës është joligjor vërtetohet edhe në nenin 1 të kontratës së punës së paditësit të lëshuar pikërisht nga e paditura më datë 01.06.2017, në të cilin përcakton se, e njëjta është e lidhur për kohë të caktuar, dhe varësisht nga kushtet e kompanisë dhe rrethanat operacionale, si dhe të performancës së të punësuarit, kontrata mund të vazhdohet, që nënkupton se në mungesë të performancës së të punësuarit - paditësit në cilësinë e të punësuarit nuk mund t'i vazhdohet kontrata e punës, e që në rastin konkret paditësit gjatë kohës sa ka qenë i punësuar tek e paditura ka pasur performancë të shkëlqyer, dhe ndaj të njëjtit asnjëherë nuk i është shqiptuar ndonjë vërejte gojore apo me shkrim, që ndaj të njëjtit asnjëherë nuk është zhvilluar ndonjë procedurë e brendshme disiplinore.

15. Kjo për faktin se në këto vendime cekët se paditësi nuk do ti ofrohet kontratë e re e punës për shkak se bazuar me nenin 71 par.2 të Ligjit të Punës të Kosovës Nr. 03/L-212 të njëjtit nuk do ti ripërtërihet kontrata aktuale e punësimit, andaj në bazë të kësaj edhe vendimit mbi mos ripërtëritjen e kontratës së punës nuk ka bazë ligjore për ndërprerjen e kontratës së punës bazuar në arsyet e cekura më lartë, prandaj gjykata vlerëson se vendimi i të paditurës datë 03.03.2020, me të cilin paditësit i është ndërprerë kontrata e punës, janë marr në shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit të Punës që është ligji themelor dhe rregullon marrëdhënien e punës në Kosovë, ku mbi bazën e këtij ligji janë përcaktuar baza dhe procedurat për ndërprerje të kontratës së punës të punëtorit, në përputhje me Marrëveshjen Kolektive, të cilat i kemi

cekur më lartë, të cilat procedura e paditura nuk i ka respektuar me rastin e mosripërtëritjes së kontratës së punës paditësit, andaj si rezultat i kësaj u vërtetua se njoftimi-vendimi i të padituës për mos ripërtëritjen e kontratës së punës jo vetëm se është i kundërligjshëm, por është edhe në kundërshtim të plotë me Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, andaj edhe vendosi që të njëjtin t'a anuloj si të paligjshëm.

16. Sa i përket lartësisë së kompensimit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se paditësit i takon edhe shpërblimi i dëmit, për shkak të largimit të kundërligjshëm nga marrëdhënia e punës, lartësinë e të cilit dëmshpërblim gjykata e caktoi duke u bazuar në ekspertizën financiare dhe plotësimin e saj të hartuar me shkrim nga eksperti financiar Shaban Syla, ekspertizë kësaj të cilës gjykata në tërësi ia fali besimin dhe e vlerësoi si ekspertizë të hartuar në mënyrë profesionale dhe në bazë të rregullave të shkencës dhe të profesionit, andaj edhe e detyroi të padituën, që përveç kthimit të paditësit në punë në pozitën e mëhershme dhe detyrat e punës së mëhershme të cilat i ka kryer para se t'i ndërpritet marrëdhënia e punës, të njëjtit t'ia shpërblej dëmin material në shumën prej 2,770.05 €, në emër të pagave të pa paguara, dhe atë me kamat ligjore prej 8% vjetore që nga data e hartimit të ekspertizës financiare datë 10.02.2021 e si dhe ta detyrojë të padituën që në emër të kontributit pensional të të punësuarit shumën prej 161.27-€, si dhe shumën prej 124.14-€ në emër të tatimit në në burim, dhe në emër të kamatës së arritshme për paga shumën prej 93.97-€. Të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim ashtu si në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimi.

17. Lartësinë e kompensimit gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur në ekspertizën financiare të ekspertit të autorizuar të gjykatës, të cilës ia fali besimin në tërësi, për shkak se e njëjta është hartuar në mënyrë profesionale dhe në pajtim me rregullat e shkencës dhe të profesionit.

18. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 5, 70 , 78 dhe 79 të

Ligjit të Punës, neniit 24, 49 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore amendamentuar sipas Protokollit Nr.11, shoqëruar nga Protokolli shtojcë dhe Protokollet Nr. 4, 6 e 7, nenit 23 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948), nenit 4 të LMD-së, nenit 13 të Ligjit për Greva. Për kamatën ju ka referuar nenit 382 LMD-së. Për shpenzimet e procedurës ju ka referuar nenit 452 të LPK-së.

19. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i padituri ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.Nr.372/2022, të datës 20.01.2025, ka vendosur që ta aprovojë ankesën e të paditurit, ndërsa aktgjykimin e atakuar, ta ndryshoj, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

20. Gjykata e Apelit e Kosovës, në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e pabazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitivin të aktgjykimit.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuara sipas dispozitave të LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar

se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

Me nenin 10 Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: " 1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji. 2. Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra specifike. 3. Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar. 4. Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite. 5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore. 6. Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindenjëzet (120) ditë brenda një (1) viti. 7. Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

Me nenin 11 paragrafi 1 nga pika 1.1) deri në pikën 1.13), të këtij ligji është përcaktuar se çka duhet të përmbaj kontrata e punës.

Me nenin 67 paragraf 1 pika 1.3, të këtij ligji, përcaktohet se: " Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: ... me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;... ".

Me nenin 71 paragrafi 2 i këtij ligji, përcaktohet se: " Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë të punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

4. Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe dispozitave të kontratave të punës të datës 01.06.2017-31.08.2017, 01.09.2017-28.02.2018 dhe 04.04.2018-03.04.2019 dhe amendamentet e kontratave, të datës 07.03.2018, dhe 04.04.2019, si dhe nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës edhe Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar. Në këtë kontekst gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka konstatuar dhe ka vendosur që kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se paditësi dhe i padituri raportin e tyre - të drejtat dhe detyrat e tyre, punëdhënës - punëmarrës i kanë rregulluar me kontratë në formë të shkruar, duke përcaktuar saktë të drejtat dhe detyrat e tyre reciproke, gjykata ka konstatuar se kontratat e punës janë lidhur në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të cekura me lartë, se kushtet e kontratave të punës të lidhura në mes të paditësit dhe të padituri duke marrë për bazë kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, si dhe përfundimin e marrëdhënies së punës, siç ka ndodhur në këtë rast janë në pajtim të plotë me dispozita ligjore të Ligjit të Punës dhe dispozitat e kontratave të punës. Në këtë rast i padituri me vendim e ka njoftuar paditësin për mos ripërtëritjen e kontratës së punës, për shkak të skadimit të kontratës edhe pse nuk ka pasur detyrim ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të dispozitave ligjore të lartë cekura.

5. Për hir të praktikës gjyqësore edhe pse në praktikën gjyqësore, e në veçanti në gjykatat e instancave më të ulëta, si në gjykatën e shkallës së parë ashtu edhe në gjykatën e shkallës së dytë rreth aplikueshmerisë së nenit 10 paragrafi 5 të Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, me të cilin përcaktohet se: “ Kontrata e Punës, për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme, për një periudhë të punësimit më të gjatë se tri (3) vite, do të konsiderohet si kontratë e lidhur në kohë të pacaktuar, ka pasur dilema dhe vendimmarrje ndryshe, këto nuk janë me ndikim për vendimmarrje ndryshe në këtë rast nga kjo gjykatë, për arsye se secili vendim gjyqësor me të cilin përfundon procedura kontestimore mund ti nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë sipas mjeteve të goditjes të

rregullta dhe të jashtëzakonshme ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore të LPK-së, mirëpo është fakt jokontestues se praktika gjyqësore si burim i së drejtës mund të përdoret vetëm kur ajo është krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, si e vetmja gjykatë kompetente në bazë të Ligjit për Gjykata, për krijimin e praktikës gjyqësore, si me qëndrime parimore, mendime juridike dhe udhëzues juridik, ashtu edhe me vendime gjatë vendosjes sipas mjeteve të jashtëzakonshme. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, me vendimet e saj është qartësuar se Kontrata e Punës, për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme, për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, do të konsiderohet si kontratë e lidhur në kohë të pacaktuar, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditësit në këtë rast është pabazuar.

6. Në raport me pretendimet e paditësit në revizion se me rastin e mos vazhdimit të kontratës së punës kemi të bëjmë me diskriminim dhe shkelje të nenit 5 të Ligjit të Punës, Gjykata Supreme e Kosovës këto pretendime i refuzon si të pabazuara. Duhet të jetë e qartë se kontrata e punës me afat të caktuar është marrëveshje e caktuar në kohë dhe që përfundon automatikisht në përfundim të periudhës së përcaktuar, pa pasur nevojë për ndërhyrje shtesë nga palët. Mos vazhdimi i kontratës me afat të caktuar në përfundim të afatit nuk përbën shkelje ose diskriminim, për arsye se: kjo marrëveshje është e lidhur për një periudhë dhe qëllim të qartë, që i përgjigjet nevojave specifike të punëdhënësit për atë kohë, punëdhënësi nuk është i detyruar të vazhdojë kontratën pas skadimit të afatit nëse nuk ka nevojë më për punëtorin apo shërbimet e tij dhe vendimi për mosvazhdimin e kontratës bazohet në afatin e përcaktuar dhe qëllimin e parashikuar në kontratë, dhe në asnjë kriter diskriminues si gjinia, mosha, përkatësia etnike, bindjet fetare, ose cilindo aspekt tjetër të mbrojtur nga ligji kundër diskriminimit, prandaj në këtë rast nuk kemi të bëjmë fare me çështjen e diskriminimit.

7. Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga paditësi nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së,

përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.

8. Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

9. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.473/2024, më 21.01.2025

’’Në këtë kontekst pretendimi i palës paditëse se në këtë rast i takon e drejta për të kërkuar fitimin e humbur, si i tillë është i pabazuar, për çka edhe Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar, edhe për arsye se:

Nga përmbajtja e dispozitave të LMD-së, rezulton se: dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur). Për të fituar të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit duhet të ekzistojë dëmi real, apo zvogëlimi i pasurisë të dëmtuarit, ose pengimi i rritjes së pasurisë, që nënkupton fitimin e humbur. Tek dëmi real apo i zakonshëm vlen parimi i kthimit në gjendje të mëparshme, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e LMD-së. Ndërsa te fitimi i humbur duhet të vlerësohet se sa do të rritej ajo pasuri nëse nuk do të paraqitej pengesa.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.Nr. 1225/2015, të datës 02.04.2021, është vendosur: I. Miratohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit E. K. nga P., për kompensimin e fitimit të humbur nga shkëputja e njëanshme e kontratës së qerasë me palën e tretë, si pasojë e mos-veprimit të të padituruës Komuna e Prishtinës. II. Detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës që në emër të kompensimit të fitimit të humbur, t’ia paguajë paditësit E. K. nga P. shumën 56,400 €, dhe atë: në emër të fitimit të humbur nga qiraja neto në shumën 50,760 €, në emër të tatimit në fitim nga qiraja, si detyrim ndaj Administratës Tatimore të Kosovës shumën 5,640 €, të gjitha këto me kamatëvonesë 8%, e cila llogaritet nga data e parashtrimit të padisë 23.05.2015 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. III. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e fitimit të humbur, përtej shumave të gjykuara si në pikën I, të dispozitiviti të këtij aktgjykimi. IV. Detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, që në afatin kohor prej 15 ditësh nga data e pranimit të

aktgjykimit, paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën 2,740.40 €, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

2. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së paditurës, me aktgjykimin Ac.Nr.5660/2021, të datës 28.05.2024, ka vendosur: Aprovohet si e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.Nr.1225/2015, i datës 02.04.2021, në pikë I, II dhe IV, të dispozitivit, që ka të bëjë me aprovimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësit E. K. nga P., për kompensimin e fitimit të humbur, si dhe për shpenzimet e procedurës dhe çështja gjykohet si në vijim: Refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit E. K. nga P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës, që në emër të fitimit të humbuar, t'ia paguaj shumën prej 112,800 €, për shkak të ndërprerjes së njëanshme të kontratës së qirasë me palën e tretë Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, si pasojë e mos veprimit të të paditurës Komuna e Prishtinës, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 6,602 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë 28.05.2015, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit. II. Pika III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.Nr. 1225/2015, i datës 02.04.2021, mbetet e pashqyrtuar.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në afat ligjor ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë Prokurori i Shtetit, për shkak të Aplikimit të gabueshëm të drejtës materiale nga neni 247 par. 1. pika b) të LPK-së lidhur me nenin 184 të LPK-së, e lidhur me nenin 136, 140 dhe 168 të LMD-së, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit, të prishet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.Nr.5660/21 i datës 28.05.2024, dhe ti kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

4. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi në afatin ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet, në tërësi revizioni i paraqitur

kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.5660/21 të datës 28.05.2024, juridikisht si i themeltë, të ndryshohet, aktgjykimi i lartcekur, ashtu që të refuzohet në tërësi si e pathemeltë ankesa e datës 14.05.2021 e të paditurës, ndërsa aktgjykimi C.Nr. 1225/21 i datës 02.04.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, të vërtetohet.

5. E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësit.

6. Për të vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 250 të LPK-së, ka caktuar seancë dëgjimore/seancën e kolegjit më datë 21.01.2025, në të cilën ka marrë pjesë i autorizuari i paditësit avokat Atdhe Dika, sipas autorizimit, dhe përfaqësuesi i të paditurës A. Rr., sipas autorizimit, ndërsa në seancë nuk ka marrë pjesë Prokurori i Shtetit, edhe pse i njëjti ishte i ftuara në mënyrë të rregullt.

7. Në seancën e kolegjit i autorizuari i paditësit ka deklaruar se: në referencë të kërkesës së prokurorit për mbrojtjen e ligjshmërisë konsiderojmë që Gjykata e Apelit në kuptim të aktgjykimit Ac.Nr.5660/2021, e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, respektivisht dispozitat ligjore të cekura si në kërkesën e prokurorisë, respektivisht si në revizionin e paditësit sepse nga procedura gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë është vetë Gjykata e Apelit e cila gjithashtu e ka vërtetuar si të pa kontestuar si legjitimitetin e palëve në procedurë ashtu edhe dështimin e të paditurës në respektimin e procedurës si rezultat i veprimeve të ndërmarra nga vetë paditësi për mënjanimin e dëmit që i kanoset, e që në fakt pikërisht ky dështim rezultojë pastaj në pësimin e dëmit nga paditësi. Prandaj propozohet që kolegji i gjyqtarëve në këtë gjykatë të vendosin për njërën nga propozimet e paditësit si në revizion respektivisht që drejtpërsëdrejti të ndryshojnë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit apo që të njëjtin ta prishin dhe çështja të i dërgohet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

8. Në seancën e kolegjit i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se: Për të paditurën Komuna e Prishtinës vendimi meritor i Gjykatës së Apelit, përkitazi me fitimin e humbur është i drejtë dhe i ligjshëm për arsye se

kërkesa e paditësit, lidhur me të njëjtën nuk gjen mbështetje në prova materiale apo personale ashtu që do të vërtetoheshin provat të cilat i mbështesin pretendimet e paditësit në kuptim të nenit 7 në lidhje me nenin 319 të LPK-së. Pretendimet e Prokurorit të Shtetit, si në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e po ashtu edhe ato të paraqitura në revizionin e palës paditëse për Komunën e Prishtinës, janë të pambështetura sikurse nga baza juridike po ashtu edhe nga ajo faktike. Paditësi nuk ka arritur që të vërtetoj lidhjen kazuale ndërmjet veprimeve të Komunës së Prishtinës, dhe dëmit të shkaktuar. Përfundimisht kërkojmë nga kjo gjykatë që kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e po ashtu edhe revizionin ta refuzoj në tërësi.

9. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212, 215 dhe 250 gjeti se:

   Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe revizioni i paditësit janë të pabazuara.

10. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, më datë 28.05.2015, ka parashtruar padi në gjykatën e shkallës së parë, kundër të padituruës, për kompensimin e fitimit të humbur, duke kërkuar më saktësisht si në precizimin e kërkesëpadisë të bërë në seancën e datës 18.03.2021.

11. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, kundër të padituruës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin C.Nr.1225/2015, të datës 02.04.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

12. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se: për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike ka administruar këto provave: Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me Nr. UL-..., lejen

urbanistike me Nr. ... të datës 18.10.2010, konkluzionin me Nr. ... të datës 06.10.2010, aktvendimin me Nr. ... të datës 22.03.2011, aktvendimin me Nr. ... të datës 26.04.2011, kontratën mbi qiradhënien ... të datës 20.03.2012, konstatimin e datës 10.02.2015, kërkesën apo ankesën e datës 12.02.2015, informimin e datës 25.02.2015, kërkesën e datës 17.03.2015, raportin e vlerësimit të datës 06.03.2015, informimin e paditësit të lëshuar nga Ambasada Amerikane i datës 25.03.2015, informimin nga Ambasada Amerikane për ndërprerjen e kontratës së qirasë të datës 17.03.2015, fotodokumentacionet e objektit kontestues, ekspertizën e gjeodezisë të datës 07.07.2020, ekspertiza financiare e datës 31.05.2020, plotësim ekspertizën financiare të datës 14.01.2021, mendimin profesional informues të datës 19.03.2018.

13. Ka shtuar se në mes të palëve ndërgjyqese nuk është kontestues fakti se paditësi ia kishte lëshuar me qera paluajtshmërinë e tij të lartcekur Ambasadës Amerikane të Kosovës, për nevoja banimi. Si çështje kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse mbeti legjitimacioni real pasiv i të padituërës për të qenë palë në procedurë, baza juridike për të kërkuar kompensimin e fitimit të humbur të paditësit nga e paditura dhe caktimi i lartësisë së fitimit të humbur. Lidhur me legjitimacionin real pasiv të të padituërës, gjykata pasi shqyrtoi shkresat dhe provat e gjithmbarshme të lëndës dhe pasi analizoi e shqyrtoi me vëmendje rrjedhën e procesit gjyqësor, konstatoi të gjeturat si në vijim:

Lidhur me konstatimin e shkaqeve deri te dëmi në paluajtshmërinë e paditësit, gjykata shqyrtoi para provën e siguruar në procedurë jokontestimore nga lëmia e gjeologjisë, me të cilën është bërë vlerësimi i rrezikut nga rrëshqitja e dheut në paluajtshmërinë ... . Gjegjësisht pas marrjes dhe analizimit të ekspertizës gjeologjike, si dhe dëgjimit të ekspertëve në procedurë gjyqësore (Agim Muçolli dhe Xhevat Kurti), gjykata ka konstatuar se rrëshqitja e dheut në paluajtshmërinë e paditësit fillimisht kishte ardhur si pasojë e ndërhyrjeve të faktorit njeri në parcelat fqinje, ku janë konstatuar lëvizje të dherave në vendin ku është bërë prerja e shpatit ndërkohë që nuk janë ndërmarrë masat e duhura inxhinierike për mbrojtjen e

skarpates nga rrëshqitja. Sipas ekspertizës, me këtë veprim është prishur ekuilibri gjeologjik natyror dhe si pasojë ka ardhur deri te rrëshqitja e kufizuar. Mirëpo rrëshqitjet e dheut janë bërë në formë të shkallëzuar si pasojë e mos ndërmarrjes së masave mbrojtëse për një kohë të gjatë, ndërsa shpati i është nënshtruar të reshurave atmosferike dhe rrëshqitjet kanë ndodhur shkallë shkallë, të cilat kanë rrezikuar objektin e banimit të paditësit. Tutje sipas kësaj ekspertizë, gjykata konstaton se ujërat sipërfaqësor nuk kanë qenë të sistemuar andaj për shkak të konfirguracionit të njëjtat gravitojnë në sipërfaqen e rrëshqitjes dhe kështu ekzistonte mundësia e inicimit të rrëshqitjeve të tjera. Qëndrimet e njëjta gjykata i konfirmoi nga ekspertët e çështjes edhe pas dëgjimit të tyre dhe sqarimeve të dhëna në seancën e datës 18.03.2021.

14. Gjykata konstaton se paditësi, kishte iniciuar procedurën administrative pranë të paditurës për vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë nga rrëshqitja e dheut, dhe i njëjti ka pranuar Konstatimin nga Komuna e Prishtinës - Sektori për mbrojtje dhe shpëtim, në të cilin është konstatuar se ka rrëshqitje të dheut dhe rrezikim të shtëpisë së paditësit, në bazë të vizitës në vendin e ngjarjes e kryer në datën 09.02.2015. Me këtë konstatim paditësi është referuar që të bëjë kërkesë pranë Drejtorisë së Urbanizmit për formimin e një komisioni profesional për vlerësimin e rrezikshmërisë pasi që ka filluar rrëshqitja e madhe e dheut.

15. Tutje, gjykata konstaton se paditësi më datën 17.03.2015, ka parashtruar kërkesë tek e paditura për pëlqim /stabilizim të banimit nga rrëshqitja e dheut, mirëpo e paditura të njëjtës kërkesë nuk i është përgjigjur. Nga deklarimet e dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata konstatoi se paditësi kërkesën e lartcekur e ka parashtruar tek e paditura ashtu që pëlqimi ti jepet për vendosje të pilotave dhe ndërtimin e murit mbrojtës për paluajtshmërinë e tij nën financim vetanak, mirëpo e paditura nuk i është përgjigjur kërkesës së njëjtë. Rrjedhimisht, nga sa u tha më lartë, gjykata konstaton se e paditura ka dështuar të ndërmarr veprimet administrative të nevojshme për të siguruar paluajtshmërinë e paditësit nga rrëshqitja e vazhdueshme e

dheut të cilat kanë paraqitur rrezik për shtëpinë dhe sigurinë e banimit, gjegjësisht e paditura ka dështuar të ndërmarrë ndonjë veprim të nxjerrë ndonjë pëlqim (apo refuzim) me të cilin do ta lejonte apo t'ia mundësonte paditësit ngritjen e kapaciteteve siguruese në paluajtshmërinë e tij. Për këtë, gjykata konstaton se e paditura mbahet përgjegjëse për shkak të mosveprimit, konform dispozitave nga neni 97 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative", ndërsa komuna nuk kishte njoftuar palën me aktin përkatës apo përgjigjen në kërkesën e tij. Thënë nga këto e lidhur me nenin 136 par. 3 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, e paditura ka legjitimacion real pasiv për të qenë palë në procedurën kontestimore.

16. Gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se paditësi për paluajtshmërinë nga e cila buron kontesti në këtë çështje juridike ka gëzuar kontratë qiraje me Ambasadën e Shteteve të bashkuara të Amerikës në Kosovë, me kohëzgjatje 5 vjeçare (...) (Prova Nr. 6, neni 3 i kontratës). Qeraja e kësaj kontrate është përcaktuar të jetë 2,350 € në muaj /28,200 € në vit (Prova Nr. 6, neni 5 i kontratës). Kjo kontratë parashihte edhe mundësi vazhdimi (neni 4 i kontratës), nën rrethana të njoftimit në avans, ndërkaq kushtet e pagesës ishin përcaktuar në avans (Neni 5 i kontratës).

17. Ka theksuar se nga provat e paraqitura dhe të administruara, gjykata konstaton se Ambasada e Amerikës, e ka shkëputur njëanshëm kontratën e qerasë me paditësin me efektivitet nga data 29.04.2015, në bazë të njoftimit dhe shkresës së shkëmbyer, nën arsyetimin se "land slide was a safety concern and was one of ther reasons considered by the Embassy when we decided to terminate the lease", gjegjësisht se "rrëshqitja e tokës ishte shqetësim i sigurisë dhe njëra nga arsyet e marra parasysh nga ambasada, kur është vendosur për ndërprerje të kontratës së qerasë".

18. Nga të lartcekurat, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se paditësi ka pësuar fitim të humbur nga ndërprerja e kontratës së qerasë me palën e tretë - Ambasadën e Amerikës, si pasojë e rrëshqitjes së tokës - rrëshqitjes së dheut në paluajtshmërinë e tij, e cila gjendje paraqiste shqetësim për kushtet e sigurisë në shtëpinë e paditësit nga ana e qiramarrësit. Duke pasur parasysh përgjegjësinë e të padituröes për mos ndërmarrjen e veprimeve administrative si në referatin e arsyetimit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi ta ngarkojë të njëjtën me kompensimin e paditësit në emër të fitimit të humbur, konform nenit 137 të LMD-së.

19. Ka theksuar se lidhur me periudhën e kompensimit dhe caktimin e lartësisë së kompensimit të dëmit - fitimit të humbur të paditësit, gjykata mori parasysh nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia financiare, të cilën e administroi dhe shqyrtoi si provë në këtë çështje kontestimore, krahas kontratës së qerasë që paditësi kishte lidhur me Ambasadën e Amerikës. Sipas kësaj kontrate, ku në nenin 3 parashihej kohëzgjatja 5 vjeçare (...), ndërsa ndërprerja ka qenë efektive që nga data 29.04.2015, gjykata konstaton se paditësi ka pësuar fitim të humbur nga e ardhura e qerasë për periudhën kontestuese 29.04.2015-29.04.2017, pra, dy qera vjetore të plota. Në këtë pikë gjykata nuk i ka marr parasysh pretendimet e paditësit sa i përket kërkimit të fitimit të humbur, për periudhën deri më 29.04.2019, sepse kohëzgjatja e kontratës së qerasë nuk ka qenë çështje e garantuar me kontratë por me kushtin e njoftimit paraprak së paku 60 ditë para skadimit të kontratës (Neni 4 i kontratës) prandaj edhe të njëjtën gjykata nuk e mori parasysh në llogaritjen e periudhës kontestuese.

20. Gjykata e shkallës së parë për mënyrën e vendosjes është bazuar në nenin neni 97 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme administrative 136 dhe 137 të LMD-së, për kamatën ka vendosur në pajtim me nenin 382 të LMD-së, si dhe për shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 449, 452 paragrafi 2 dhe 453 të LPK-së.

21. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e

saj Ac.Nr.5660/2021, të datës 28.05.2024, ka vendosur që ta aprovojë si të pathemeltë ankesën e të padituërës dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

22. Gjykata e Apelit të Kosovës, në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, rreth mënyrës së vendosjes përkatësisht aprovimit të pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësit, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, edhe pse aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par. 2, pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, mirëpo i njëjti është përfshirë me zbatimin e gabuar të drejtës materiale, për çka edhe dispozitivi i aktgjykimit të atakuar, në pikën I, II dhe IV, është dashur të ndryshohet, konform nenit 195.1, pika e), lidhur me nenin 201 pika d) të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

23. Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit duke marr për bazë pretendimet ankimore të palës së paditur, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit të atakuar sikurse në pikën I, II dhe IV, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditësit E. K., që ka të bëjë me kompensimin e fitimit të humbur nga shkëputja e njëanshme e kontratës së qirasë me palën e tretë, si pasojë e mos-veprimit të të padituërës Komuna e Prishtinës, në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë

të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Paditësi në revizionin dhe në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga Prokurori i Shtetit nuk i është referuar si bazë për parashtrimin e revizionin dhe kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, prandaj Gjykata Supreme sa i përket kësaj baze është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së, me ç' rast ka gjetur se aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, dhe se kërkesëpadia e paditësit në këtë rast është e pabazuar, për arsye se:

   Bazuar në provat të cilat gjendën në shkresat e lëndës, rezulton fakti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, kjo për faktin se i njëjti nuk ka mundur që me prova të argumentoj se paditësi ka pësuar dëm si rezultat i mosveprimit të të padituërës Komuna e Prishtinës. Nëse i referohemi njoftimit për shkëputjen e kontratës së qirasë, nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, shihet qartë se si arsye për shkëputjen e kontratës, në njoftim nuk përmendet fare çështja e rrëshqitjes së dheut dhe rrezikimit të sigurisë. Ndërsa nëse i referohemi përgjigjes të emalit të datës 14.04.2015, të cilën e ka dhënë Ambasada Amerikane për paditësin të datës 17.04.2015, theksohet se rrëshqitja e dheut ishte shqetësim i sigurisë dhe ishte një nga arsyet e marra në konsideratë të shkëputjes së kontratës. Pra nga kjo shihet qartë se ndërprerja e kontratës nga ana e Ambasadës Amerikane me paditësin ka ardhur pas rishikimit të inventarit duke konsideruar se qiraja në fjalë për Ambasadën Amerikane është e tepërt, për nevojat e strehimit dhe se nuk e ka pas si shkak kryesor shqetësimet e sigurisë, lidhur me

rrëshqitjen e dheut, prandaj edhe nuk mund të kërkohet fitimi i humbur nga ana e Komunës së Prishtinës, për shkak të ndërprerjes së kontratës dhe mos ndërmarrjes së veprime lidhur me eliminimin e rrezikut konkret.

4. Në këtë kontekst pretendimi i palës paditëse se në këtë rast i takon e drejta për të kërkuar fitimin e humbur, si i tillë është i pabazuar, për çka edhe Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar, edhe për arsye se: Nga përmbajtja e dispozitave të LMD-së, rezulton se: dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur). Për të fituar të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit duhet të ekzistojë dëmi real, apo zvogëlimi i pasurisë të dëmtuarit, ose pengimi i rritjes së pasurisë, që nënkupton fitimin e humbur. Tek dëmi real apo i zakonshëm vlen parimi i kthimit në gjendje të mëparshme, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e LMD-së. Ndërsa te fitimi i humbur duhet të vlerësohet se sa do të rritej ajo pasuri nëse nuk do të paraqitej pengesa.

5. Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën.

6. Nga vetë përmbajtja e dispozitave të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka detyrim t'ia shpërblejë atë. Sipas kësaj dispozite për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) që të shkaktohet dëmi; b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faji i dëmtuesit; d) që të ekzistojë aftësia delikatore dhe e) të ekzistoj lidhja

kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit. Në këtë raste duhet plotësuar këto parakushte ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e shkaktari të dëmit, për kompensimin e dëmit, të dëmtuarit.

7. Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia. Në këtë kontekst kërkohet që veprimet apo mosveprimet e kryesit të dëmit në raport me dëmin e shkaktuar të jenë me dashje apo nga pakujdesia. Dashja nënkupton se dëmi është shkaktuar në mënyrë të qëllimshme apo thënë ndryshe kur dëmtuesi i dëshiron pasojat, ndërsa pakujdesia ekziston kur kryesi nuk ka qenë i kujdesshëm në ndërmarrjen e veprimeve të tij apo nuk ka vepruar, ndonëse është dashur të veprojë.

8. Po ashtu nga përmbajtja e dispozitave të LMD-së, rezulton se: Fitim i humbur është një lloj i veçantë i dëmit material. Ky lloj i dëmit ekziston kur i dëmtuari pengohet për t'iu rritur pasuria. Nëse i referohemi dispozitave të LMD-së, rezulton se fitimi i humbur mund të realizohet kumulativisht me demin real, nëse ekzistojnë kushtet e caktuar për të.

9. Fitimi i humbur sipas dispozitave të LMD-së, nënkupton vetëm atë fitim për të cilin është i sigurt se kreditori sipas rrjedhës së rregullt të gjerave ose sipas rrethanave të veçanta të rastit do ti realizojë.

10. Përveç të cekurave sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, paditësi në këtë rast nuk kanë arritur ti vërtetojnë faktet mbi të cilat e mbështetin kërkesën e vet edhe pse kjo ka qenë detyrë e tyre, në kuptim të nenit 322 paragrafi 1 dhe 2, e lidhur me neni 7 paragrafi 1 dhe 319 paragrafi 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: " Gjykata është e autorizuar ti vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të

përcaktuara në nenin 3 paragraf 3 të këtij ligji) në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe ”.

11. Andaj duke ju referuar të cekurave me lartë pretendimi i palës paditëse se në këtë rast i takon e drejta për të kërkuar fitimin e humbur, si i tillë është i pabazuar dhe si i tillë nuk ka bazë ligjore.

12. Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 222 dhe 245 dhe 246 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.481/24, datë 21.10.2024

''Gjykata Supreme e Kosovës, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, e pranon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se e drejta e pronësisë është e drejt subjektive e karakterit absolut dhe se për sendet e paluajtshme të cilat janë të regjistruara në librat kadastrale, vlen supozimi se sendi është në pronësi të personit në emër të cilit është e regjistruar, mirëpo edhe nëse paluajtshmëria nuk është e regjistruar në emër të atij që kërkon pronësinë, në këtë rast paditësi ka pasur detyrim ta provojë pronësinë e tij, por edhe të paraardhësit të tij, deri sa mos të gjendet personi i cili pronësinë e ka fituar në ndonjërën prej mënyrave origjinare si mënyra të fitimit të pronësisë, dhe këto fakte në këtë rast, i ka provuar i padituri/kundërpaditësi dhe jo paditësi/kundër i padituri.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, C.Nr.684/2018, të datës 17.11.2021, është vendosur: I. Refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit/kundër të padituri A. B., nga fshati M., Komuna e S., i cili ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si i bazuar kërkesëpadia e paditësit A. (B.) B., të detyrohet i padituri J. (B.) B. që në afat prej 15 ditësh nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm të bëjë dorëzimin e paluajtshmërisë në posedim tek paditësi duke bërë rrënimin e shtëpisë dhe objekteve ndihmëse, kthimin në gjendjen e mëparshme të ngastrës kadastrale ..., në sipërfaqe prej ...m², e cila gjendet në vendin e quajtur "..." Z.K. M., ose të bëhet kompensimi në vlerë të tregut i kësaj parcele. II. Aprovohet në tërësi kërkesëpadia e kundër paditësit J. (B.) B. nga fshati M., Komuna e S., të cilin sipas prokurës e përfaqëson Natal Bullakaj, avokat në S., ashtu që: Vërtetohet se kundër paditësi / i padituri është pronar i ngastrës kadastrale ..., me sipërfaqe prej ... m², e cila gjendet në vendin e quajtur "...", Z.K. M. dhe e cila përkufizohet me këto ngastra: ngastrën me numër ..., në pjesën veriore përkufizohet me ngastrën me numër ..., në pjesën lindore përkufizohet me ngastrën ..., përkufizohet me

ngastrën me numër ..., ndërsa me pjesën perëndimore përkufizohet me ngastrën ..., po ashtu detyrohet paditësi/kundër i padituri që kundër paditësit J. B. t'ia njohë të drejtën e pronësisë. III. Obligohet paditësi/kundër i padituri që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore, t'ia paguaj palës së paditur/kundër paditësit shumën prej 1808 €, brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.10304/2021, të datës 10.07.2024, është vendosur: Refuzohet si e pathemeltë ankesa e paditësit/kundër të padituri A. (B.) B., nga fshati M., Komuna e S., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë C.Nr.684/2018, i datës 17.11.2021, vërtetohet.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësi/kundër i padituri, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 188 i këtij ligji e cila është bërë në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë dhe zbatimit të gabuar të së drejtës material, me propozim që: Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin e palës paditëse/kundër të padituri si të bazuar, dhe ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë C.Nr.684/2021 të datës 17.11.2021, si dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.Nr.10304/2021 të datës 10.07.2024, ose të aprovojë revizionin si të bazuar dhe të kthejë çështjen në rigjykim.

4. Përgjigje në revizionin e paditësit/kundër të padituri, ka paraqituri i padituri/kundërpaditësi, me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi revizionim, me propozim që i njëjti të hudhet ose të refuzohet në tërësi si i pabazuar, ndërsa aktgjykimet e atakuar të vërtetohen.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

   Revizioni i paditësit/kundër të padituri është i pabazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi/kundër i padituri, në gjykatën e shkallës së parë më datë 24.12.2018, ka paraqitur padi, kundër të padituri/kundërpaditësit, me të cilën ka kërkuar dorëzimin e paluajtshmërisë, duke kërkuar më saktësisht si në padi.

7. Pala e paditur/kundër paditëse më datë 03.02.2020, ka parashtruar kundërpadinë me objekt të kërkesës që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit/kundër të padituri, ndërsa të aprovohet kërkesa e të padituri/kundër paditësit, për vërtetimin e pronësisë (duke kërkuar më saktësisht si në kundërpadi).

8. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit/kundër padituri dhe të kundërpadisë së të padituri/kundër paditësit, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.Nr.684/2018, të datës 17.11.2021, me të cilin e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit/kundër të padituri, ndërsa e ka aprovuar kundërpadinë e të padituri/kundër paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

9. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se: për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar këto prova: certifikatën e pronës për parcelën ..., e evidentuar në emër të A. B., të lëshuar më datë 01.12.2017, procesverbalin për hapjen e testamentit me shkrim, i hartuar në Gjykatën Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, të datës 22.07.2003, të evidentuar me Nr. ND.Nr. ..., kontratën e datës 15.05.2004, të lidhur në mes të B. B.nga M. - investitor dhe NTSHP., "..." nga M., deklaratën e dhënë nga M. (A.) Sh. dhe H.(H.) B., vërtetuar pranë gjykatës komunale në Suharekë të datës 19.10.2011, VR.Nr. ..., deklaratën e dhënë nga J. B., të datës 03.06.1982, me Nr... e vërtetuar pranë ZGJC në M., nga zyrtari S. T., Kushtet Ndërtimore (në gjuhën serbe) të lëshuar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Punë, ndërsa e vërtetuar nga referenti F. E., nga drejtoria e urbanizmit më datë 14.06.1982, fotografinë e shtëpisë tani të ndërtuar (...), fotografinë

e shtëpisë të djegur (...), ekspertizën e ekspertit gjeodet F. B., të datës 25.03.2021, së bashku me skicën e terrenit, të datës 22.03.2021. Ndërsa në seancën e datës 25.06.2021 janë dëgjuar dëshmitarët: M. Sh., H.B., M.. dhe H. B.. Në seancën e datës 15.10.2021 janë dëgjuar edhe palët A. B. si paditës/kundër i padituri dhe J. B. i padituri/kundër paditësit.

10. Ka shtuar se sipas provës, certifikatën e pronës, për parcelën ..., e evidentuar në emër të paditësit/kundër të padituri A. B., të lëshuar më datë 01.12.2017, vërtetohet se këtu i njëjti është pronar i ngastrës ..., me sipërfaqe prej ... m², Z.K. M., e cila gjendet në vendin e quajtur "...", ndërsa këtu paditësi/kundër i padituri është bërë titullar juridik sipas mënyrës së trashëgimisë me testament për të cilin është zhvilluar procedura e hapjes së testamentit në vitin 2003 pranë Gjykatës Komunale në Suharekë.

11. Nga prova e administruar, procesverbalin për hapjen e testamentit me shkrim, i hartuar në Gjykatën Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, i datës 22.07.2003, evidentuar me Nr. ND.Nr. ..., gjykata vërtetoi faktin se këtu paditësi/kundër i padituri mbi bazën e saj e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi ngastrën kontestuese, fakt ky i cili vërtetohet edhe nga prova tjetër e administruar siç është certifikatën e pronës, për parcelën ..., e evidentuar në emër të A. B., të lëshuar më datë 01.12.2017, ku këtyre provave gjykata ia fali besimin për faktin se të njëjtat sqarojnë procedurën se si është regjistruar si titullarë juridike këtu pala paditëse/kundër i padituri.

12. Kurse nga dy provat tjera: deklaratën e dhënë nga J. B., të datës 03.06.1982, me Nr. ... si dhe provën Fletëparaqitja për ndërtim (në gjuhën serbe) të lëshuar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Punë, të datës 14.06.1982, gjykata vërtetoi faktin se këtu i padituri/kundër paditësi paraprakisht qysh në vitin 1982 i ka iniciuar procedurat për ndërtimin e shtëpisë së vjetër, e cila ka qenë e ndërtuar në ngastrën këtu objekt kontesti, ku gjykata këtyre provave ia fali besimin pasi që të njëjta ndërlidhen edhe me provat tjera, deklaratat e dëshmitarëve, si dhe

deklarimet e palës së paditur/kundër paditëse i dëgjuar në cilësi të palës.

13. Nga fotografia e shtëpisë së djegur (...) dhe deklaratat e dëshmitarëve M. Sh., H. B., M. T. dhe H. B., të dëgjuar në seancën e datës 25.06.2021, gjykata vërtetoi faktin se shtëpia e djegur si në foto, ka qenë e ndërtuar në ngastrën që është objekt kontesti, e të cilën e ka shfrytëzuar këtu i padituri/kundër paditësi, ku kësaj prove gjykata ia fali besimin për faktin se e njëjta ndërlidhet edhe me dëshminë e dëshmitarëve të lartcekur.

14. Ndërkaq provës tjetër të administruar, deklaratës së dhënë nga M. A. Sh. dhe H. H. B., e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Suharekë, më datë 19.10.2011, VR.Nr. ..., gjykata nga kjo provë vërtetoi faktin se këtu të padituri/kundër paditësit J. B., iu ka ndarë palujatëshmeria (këtu objekt kontesti) në të cilën e ka të ndërtuar tani shtëpinë i njëjti sa ishte gjallë titullari juridik B.B.. Gjykata ia fali besimin dëshmisë së tyre për faktin se të njëjtit kanë theksuar se deri tek kjo ndarje ka ardhur pas ndikimit të tyre në arritjen e kësaj marrëveshje.

15. Nga ekspertiza e ekspertit gjeodet F. B., të datës 25.03.2021, së bashku me skicën e terrenit, të datës 22.03.2021, gjykata vërtetoi faktin se ngastra objekt kontesti ..., ka një sipërfaqe prej ...m², ku si pronar është A. B. . Sipas certifikatës së pronës, sipërfaqja është ...m², ndërsa sipas matjeve grafike sipërfaqja e kësaj ngastre është ...m², ku dallimi në mes të sipërfaqes tekstuale dhe asaj grafike është ... m², e cila është brenda kornizave dhe tolerancës së lejuar. Pra sipas kësaj ekspertize parcela objekt kontesti me numër ..., e cila përkufizohet me këto ngastra: ngastrën me numër ..., në pjesën veriore përkufizohet me ngastrën me numër ..., në pjesën lindore përkufizohet me ngastrën ..., përkufizohet me ngastrën me numër ..., ndërsa me pjesën perëndimore përkufizohet me ngastrën ..., ku komplet ngastra ..., është e përkufizuar me mur dhe rrethojë metalike. Po ashtu eksperti ka theksuar se rruga për kyçje deri tek ngastra objekt kontesti kalon nëpër ngastrat ... dhe ngastrën ... të cilat evidentohen në emër të paditësit/kundër të padituri A.B., e përshkruar më detalisht si në skicën e datës 22.03.2021, e cila është

pjesë e ekspertizës. Gjykata kësaj prove ia ka falur besimin ngase e njëjta është e kompletuar me të dhënat bazë, ndërsa sa i përket pjesës së gjendjes faktike ku theksohet se në ngastrën me numër ..., ka të ndërtuar një shtëpi tre kate dhe se kjo ngastër është e përkufizuar me mure dhe rrethoja metalike, gjykata të njëjtën gjendje e ka konstatuar edhe nga seanca e terrenit të datës 26.02.2021, të gjitha këto janë përshkruar edhe në procesverbalin e kësaj seance, në të cilën kanë prezantuar edhe të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse.

16. Nga dëgjimi i dëshmitarëve: M. Sh., H. B., M. T. dhe H. B., gjykata vërtetoi faktin se këtu i padituri/kundër paditësi qysh prej fillimit të viteve të 80-ta, e ka në shfrytëzim dhe posedim ngastrën objekt kontesti, ku sipas dëshmitarëve në ngastrën e njëjtë ka qenë një shtëpi paraprake e cila është djegur gjatë luftës, ndërsa po në atë ngastër tani i padituri/kundër paditësi e ka të ndërtuar shtëpinë e re. Dëshmisë së tyre gjykata ia fali besimin për faktin se dëshmia e secilit prej tyre vërteton faktin e njëjtë, pra periudhën se prej cilës periudhë këtë ngastre e shfrytëzon i padituri/kundër paditësi. Po ashtu gjykata ia fali besimin deklarimeve të tyre edhe për faktin se dëshmia e dëshmitarëve përputhet edhe me provat tjera siç janë procedurat formale (fletëparaqitja për ndërtim lëshuar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Punë, e datës 14.06.1982), që i kanë paraprirë ndërtimit të shtëpisë së vjetër, e cila është djegur gjatë luftës, të iniciuara nga i padituri/kundër paditësi. Ndërsa nga dëgjimi i palës paditëse/kundër të padituritA.B. në seancën e datës 15.10.2021, i njëjti ka theksuar se i padituri/kundër paditësi, qysh në vitin ..., ka filluar ndërtimin e shtëpisë e cila gjendet në ngastrën objekt kontesti pasi që në këtë vit ka qenë në Kosovë, ku kësaj pjese të dëshmisë gjykata ia fal besimin për faktin se kjo ndërlidhet edhe me provat tjera. Ndërsa pjesës tjetër të dëshmisë së tij, gjykata nuk ia fali besimin për faktin se e njëjta jo vetëm që është në kundërshtim me provat tjera të administruara, por në disa raste dëshmia e saj është kontradiktore në disa pjesë, pra duke filluar nga përgjigjet e tij, ku në një përgjigje deklaron se babai i saj ka vdekur para ...viteve, ndërsa me pas thekson se ... ditë pas vdekjes së tij janë ftuar nga gjykata për hapjen e testamentit duke iu referuar vitit 2003, po ashtu ka deklaruar se pas lufte 10 vite nuk ka qenë në Kosovë,

ndërsa në pjesën tjetër thekson se në Kosovë ka qenë në vitin 2003. Kurse nga dëgjimi i palës së paditur/kundër paditësi J.B., gjykata vërtetoi faktin se edhe para lufte i njëjti ka jetuar në shtëpinë tani të djegur, ku tani e ka të ndërtuar shtëpinë e re trekatëshe. Gjykata dëshmisë së tij ia fali besimin për faktin se e njëjta lidhet edhe me provat tjera si të dëshmitarëve ashtu edhe provat shkresore nga të cilat gjykata vërtetoi faktin se këtij i njëjti qysh në vitin 1982, i ka filluar procedurat pranë organeve kompetente rreth sigurimit të lejes ndërtimore.

17. Ka theksuar se gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit/kundër të padituri si të pabazuar për faktin se i njëjti përkundër faktit se e ka fituar pronësinë sipas mënyrës derivative, përmes trashëgimisë, në bazë të testamentit për të cilin është zhvilluar procedura e hapjes së testamentit në vitin ..., pranë Gjykatës Komunale në Suharekë. Ndërsa sipas nenit 37 parag. 2 të Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (gazeta zyrtare e RSFJ Nr.6 e vitit 1080), theksohet se, citojmë: *"Pronari duhet të provojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet në zotërim faktik të të padituri".*

18. Ku ky fakt është vërtetuar nga certifikata e pronës e datës certifikatën e pronës, për parcelën ..., e evidentuar në emër të A. B., të lëshuar më 01.12.2017, si dhe ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë F. B. të datës 25.03.2021, mirëpo përkundër këtij fakti me asnjë provë të vetme pala paditëse/kundër paditësi nuk e bindi gjykatën, duke vërtetuar faktin se këtu trashëgimlënësi B.B. e ka pasur në posedim dhe shfrytëzim prej vitit 1982, e deri më rastin e vdekjes këtu ngastrën kontestuese. Ku sipas nenit 39 paragrafi 7 të Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore, theksohet se, citojmë: "*Mbajtësi më mirëbesim bëhet mbajtës me keqbesim që nga momenti kur i është dërguar padia, por pronari mund ta provojë se mbajtësi me mirëbesim është bërë mbajtës me keqbesim edhe para dërgimit të padisë".* Po ashtu edhe pala paditëse në kohën e hapjes së testamentit në vitin ..., e ka pasur të njohur faktin se ngastra me numër ... gjendet nën pushtetin faktik të të padituri/kundër paditësit prej vitit 1982, ku të drejtën e posedimit,

shfrytëzimit ia ka bartur trashëgimlënësi. Pra, në kohën e hapjes së testamentit në vitin ..., këtu pala e paditur/kundër paditëse ka filluar ndërtimin e shtëpisë, e ku më këtë rast pala paditëse nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik ndaj të padituri/kundër paditësit përmes të cilave të njëjtit do ti ndalohej shfrytëzimi i ngastrës, por edhe ndryshimi i gjendjes faktike/ndërtimi i shtëpisë. Andaj mbi bazën e këtyre fakteve gjykata vlerëson se këtu pala paditëse/kundër paditësi ka fituar të drejtën e pronësisë në ngastrën objekt kontesti me të meta faktike, kjo për faktin se pala paditëse në këtë ngastër ka ushtruar pushtetin faktik prej vitit ..., kur i është ndarë kjo ngastër nga trashëgimlënësi për së gjalli, shto këtu faktin se këtu pala e paditur prej vitit ..., në kohën kur e ka në shfrytëzim këtë ngastër e deri më datë 24.12.2018, të njëjtën e ka në shfrytëzim më mirëbesim, ku për vërtetimin e faktit të kundërt të mirëbesimit ka qenë dashtë ta vërtetoj vetë pala paditëse përmes provave gjë që nuk e ka bërë. Ndërsa gjykata e aprovoi kërkesën e kundërpadisë së paditësit si të bazuar duke ia njohur të drejtën e pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues, për faktin se marrë për bazë kohën e paraqitjes së padisë, kohën kur këtu kundër paditësi është futur në posedim dhe shfrytëzim të ngastrës kontestuese, kohën kur pala paditëse/ kundër i padituri është njoftuar për testamentin, viti ..., gjykata vlerëson se në këtë çështje kontestimore, si ligj i zbatueshëm paraqitet të jetë Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (gazeta zyrtare e RSFJ Nr.6 e vitit 1080).

19. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 21, 28 paragrafi 2, 37 paragrafi 2, dhe 39 paragrafi 7, të Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (gazeta zyrtare e RSFJ Nr.6 e vitit 1080) dhe nenit 143 të LPK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 të LPK-së.

20. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi/kundër i padituri ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.Nr.10304/2021, të datës 10.07.2024, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e paditësit/kundër të padituri, ndërsa

aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka vërtetuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

21. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se dhe qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkeljet e procedurës kontestimore pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të

rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e titullit përmbarimor dhe i përshtatshëm për përmbarim, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe të dytë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

3. Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallë së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

   Me nenin 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore - Juridike përcaktohet se: “E drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi si dhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushte dhe mënyrën e caktuar me ligj”, me nenin 28 paragraf 4 të këtij ligji përcaktohet se: “Mbajtësi më mirëbesim i sendit të paluajtshëm mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrim fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”, me nenin 30 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji përcaktohet se: “ Koha e nevojshme për parashkrimin fitues fillon të

ecë nga ajo ditë kur mbajtësi ka marrë në posedim sendin dhe mbaron me kalimin e ditës së fundit të kohës së nevojshme për parashkrimin fitues. 2. Në kohën e nevojshme për parashkrimin - fitues llogaritet edhe koha për të cilën paraardhësit e mbajtësit të tanishëm kanë mbajtur sendin si mbajtës me mirëbesim dhe të ligjshëm, respektivisht si mbajtës me mirëbesim, ndërsa me nenin 37 paragraf 1 dhe 2 të këtij ligj, përcaktohet se: "Pronari mund të kërkoj në padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale, mirëpo pronari duhet të pranoj se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronës dhe se sendi gjendet nën zotërimin faktik të të padituri", me nenin 39 paragrafi 7 të këtij ligj, përcaktohet se: "Mbajtësi me mirëbesim bëhet mbajtës me keqbesim që nga momenti kur i është dërguar padia, por pronari mund të provojë se mbajtësi me mirëbesim është bërë mbajtës me keqbesim edhe para dërgimit të padisë.

5. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, e pranon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se e drejta e pronësisë është e drejt subjektive e karakterit absolut dhe se për sendet e paluajtshme të cilat janë të regjistruara në librat kadastrale, vlen supozimi se sendi është në pronësi të personit në emër të cilit është e regjistruar, mirëpo edhe nëse paluajtshmëria nuk është e regjistruar në emër të atij që kërkon pronësinë, në këtë rast paditësi ka pasur detyrim ta provojë pronësinë e tij, por edhe të paraardhësit të tij, deri sa mos të gjendet personi i cili pronësinë e ka fituar në ndonjërën prej mënyrave origjinare si mënyra të fitimit të pronësisë, dhe këto fakte në këtë rast, i ka provuar i padituri/kundërpaditësi dhe jo paditësi/kundër i padituri.

6. Paditësi/kundër i padituri në këtë rast nuk ka arritur ti vërtetojë faktet mbi të cilat e mbështetë kërkesën e tij edhe pse kjo ka qenë detyrë e tij, në kuptim të nenit 322 paragrafi 1 dhe 2 e lidhur me neni 7 paragrafi 1 dhe 319 paragrafi 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: "Gjykata mund të kërkoi

nxjerrjen e provave sipas detyrës zyrtare, për vërtetimin e fakteve edhe pse palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse ato prova po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht të përcaktuara në kuptim të nenit 3 paragraf 3 të LPK-së ".

7. Për të pasur sukses në kërkesëpadinë pala paditëse/kundër e paditur është dashur që të argumentoi me prova konkrete se është pronar të paluajtshmërisë, në këtë rast të palujtshmërisë kontestuese, çka nuk ka arritur të vërtetojë faktin se i padituri/kundërpaditësi në këtë ngastër nuk e ka ushtruar pushtetin faktik prej vitit ..., kur i është ndarë kjo ngastër nga trashëgimlënësi për së gjalli, përkundrazi nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, e sidomos nga dëshmitë e dëshmitarëve është sqaruar në mënyrë të qartë dhe të drejtë se këtu pala e paditur/kundër paditësi prej vitit..., e ka në shfrytëzim me mirëbesim këtë ngastër deri më datë 24.12.2018, ndërsa për vërtetimin e faktit të kundërt se i padituri/kundër paditësi nuk e ka pas paluajtshmërinë kontestuese me mirëbesim, ka qenë dashtë ta vërtetoj vetë pala paditëse përmes provave gjë që nuk e ka bërë.

8. Kjo gjykatë vlerëson se, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka aprovuar kërkesën e kundërpadisë së paditësit si të bazuar duke ia njohur të drejtën e pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues, për faktin se marrë për bazë kohën e paraqitjes së padisë, kohën kur këtu kundër paditësi është futur në posedim dhe shfrytëzim të ngastrës kontestuese, kohën kur pala paditëse/kundër i padituri është njoftuar për testamentin, viti 2003, padyshim vërtetohet fakti se i padituri/kundërpaditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë në ngastrën kontestuese me parashkrim fitues, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (gazeta zyrtare e RSFJ Nr.6 e vitit 1080).

9. Nga provat në shkresat e lëndës rezulton se i padituri/kundërpaditësi është futur në posedim faktik qysh në vitin ..., gjatë kohës sa ka qenë gjallë trashëgimlënësi dhe se prej asaj kohe në mënyrë të pa penguar nga askush ushtron pushtetin faktik deri më tani, ky fakt vërtetohet

edhe nga dëshmitarët M. Sh., H. B., M. T. dhe H. B., të cilët kanë dëshmuar në gjykatën e shkallës së parë. Gjithashtu paditësi/kundër i paditur prej kohës së hapjes së testamentit në vitin ..., e ka pasur të njohur faktin se ngastra kadastrale ..., me sipërfaqe prej ... m², e cila gjendet në vendin e quajtur "...", Z.K., M., gjendet nën pushtetin faktik të të padituri/kundër paditësit prej vitit ..., ku të drejtën e posedimit, shfrytëzimit ia ka bartur trashëgimlënësi dhe se i padituri/kundërpaditësi ka filluar ndërtimin e shtëpisë, ndërsa paditësi/kundër i padituri nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik ndaj të padituri/kundër paditësit përmes të cilave të njëjtit do ti ndalohej shfrytëzimi i ngastrës, por edhe ndryshimi i gjendjes faktike/ndërtimi i shtëpisë, gjë që rezulton se i padituri ngastrën kontestuese e ka fituar me anë të parashkrimit fitues.

10. Gjykata Supreme, e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

11. Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga paditësi/kundër i padituri nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: "Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike".

12. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr. 63/2025, datë 02.06.2025

''Paditësi është i detyruar t'i ofrojë gjykatës ose të paktën të tregojë provat që e bëjnë kërkesën të bazuar, siç kjo është përcaktuar me nenin 7 të LPK-së. Kur bëhet fjalë për fitimin e të drejtës pronësore në bazë të punës juridike, në rastin konkret në bazë të kontratës, është e domosdoshme që puna juridike të jetë e përsosur dhe kontrata të lidhet në formën përkatëse duke u vërtetuar pranë organit kompetent.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Në një gjendje të tillë të fakteve, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesë padia është e pabazuar në kuptim të nenit 36 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, sepse për fitimin e të drejtave të pronësisë së paluajtshmërisë, është e domosdoshme ekzistimi i punës së vlefshme juridike midis blerësit dhe ish-pronarit, dhe të regjistrimi i kësaj pune juridike në librat përkatës publikë.
2. Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes sipas ankesës së paditësi gjen se nga provat e administruara pa mëdyshje vërtetohet se e paditura ka fituar të drejtën pronësore në banesën lëndore me anë të blerjes, ndërsa paditësi me asnjë provë nuk ka provuar se banesën e njëjtë e ka blerë nga e paditura, dhe se kontrata e nënshkruar më 20.09.2018 në formën e një dokumenti privat nuk i plotëson kushtet për fitimin e të drejtës pronësore, ngase nuk është lidhur në bazë të ligjit. Më tej, Gjykata e Apelit deklaron se paditësi nuk i ka paraqitur gjykatës prova që do ta bënin kërkesëpadinë të bazuar. Gjykata e apelit gjithashtu thekson se paditësi ka bërë ndryshimin e padisë pas përfundimit të seancën përgatitore, dhe se ky ndryshim është kontestuar nga e paditura, dhe se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur ka refuzuar që të lejoj ndryshimin e padisë, duke zbatuar në mënyrë të rregullte nenin 258, paragrafin 1 të LPK.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Qëndrimi i gjykatave të instancës më të ulët është i pranueshëm edhe për Gjykatën Supreme të Kosovës, sepse i njëjti themelohet në

zbatimin e drejtë të së drejtës materiale. Paditësi është i detyruar t'i ofrojë gjykatës ose të paktën të tregojë provat që e bëjnë kërkesën të bazuar, siç kjo është parashikuar me nenin 7 të LPK. Kur bëhet fjalë për fitimin e të drejtës pronësore në bazë të punës juridike, në rastin konkret në bazë të kontratës, është e domosdoshme që puna juridike të jetë e përsosur, dhe kontrata e lidhur në formën përkatëse dhe e vërtetuar pranë organit kompetent. Pretendimet në revizion që flasin për lëshimet e gjykatave të instancës më të ulët me të cilat, siç pretendohet në revizion, është vendosur në kundërshtim me ligjin që paditësit të mos i lejohet ndryshimi i padisë, nuk janë të bazuara. Në revizion, në mënyrë të pabazuar pretendohet se paditësi nuk ka dashur të bëj ndryshimin e padisë, por ka dashur që të ndryshoj bazën juridike të kërkesë padisë, Pretendimet e tilla janë të pabazuara për arsye se me këqyrje në parashtresën e datës 17.01.2022, vërtetohet se me parashtresën e njëjtë paditësi bën ndryshimin e padisë, dhe jo si në parashtresë dhe revizion thekson se ndryshimin e bazës juridike të kërkesë padisë. Në fakt, paditësi në parashtresën e cekur kërkon detyrimin e të padituresë që paditësit, në emër të borxhit t'ia kthej shumën prej 17.500.00 euro me kamatën përkatëse e cila duhet llogaritur prej datës së parashtrimit të padisë. Kështu që , në raport me kërkesëpadinë që ka të bëj me vërtetimin e pronësisë, me parashtresën e cekur bëhet ndryshimi i njëjtësisë së kërkesëpadisë, e që në kuptim të nenit 257 par. 1 të LPK, paraqet ndryshimin e padisë. Me nenin 258 të LPK, është përcaktuar afatin deri në të cilin mund të bëhet ndryshimi i padisë dhe duke qenë se paditësi ka provuar që ndryshimin e padisë pas kalimit të afatit të përcaktuar me ligj, përkatësisht pas përfundimit të seancës përgatitore, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka refuzuar që të lejoj ndryshimin e padisë në këtë fazë të procedurës. Duke qenë se paditësi nuk ka provuar përmbushjen e kushteve nga neni 258, paragrafi 4 të LPK, ky ndryshim i padisë nuk ka mundur që të lejohet pa pëlqimin e palës së paditur e cila shprehimisht i është kundërshtuar kësaj.

2. Për arsyet e cekura, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se revizioni nuk është i bazuar, ndaj ka refuzuar të njëjtin dhe duke zbatuar nenin 222 të LPK, vendosi si në dispozitiv.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.73/202, datë 10.06.2025

’’Duke qenë se bëhet fjalë për vepër penale që lidhet me kryerjen e detyrave zyrtare, i padituri ka pasur në dispozicion mundësinë e parashikuar në nenin 70, par. 1, pika 6 të Ligjit të punës, sepse është e pakontestueshme se paditësi ka kryer një shkelje të rëndë të detyrave të punës, e cila në mënyrë të pashmangshme sjell edhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kështu që edhe Gjykata Supreme ndan mendimin e Gjykatës së Apelit se zvarritja në marrjen e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ka përfaqësuar një privilegj për paditësin, dhe jo shkelje të të drejtave të tij të garantuara me ligj.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Në një gjendje të tillë faktike, gjykatat e shkallës së parë ka gjetur se kërkesë padia është e bazuar, ndaj ka aprovuar të njëjtën dhe vendosur siç është paraqitur më lartë.

2. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj thekso se i padituri në kuptim të nenit 73 të Ligjit të Punës, ka qenë i detyruar që paditësin pas skadimit të afatit prej gjashtë muajsh gjatë së cilës paditësi ka qenë i larguar nga puna, që të njëjtin ose ta kthej në marrëdhënie të punës apo të ndërpres kontratën e punës me të. Meqë vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është marrë vetëm pas dhjetë muajsh, sipas qëndrimit të gjykatës së shkallës së parë, i njëjti është i paligjshëm, prandaj edhe duhet që të anulohet.

3. Gjykata e Apelit e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas ankesës së padituri, nuk e ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke theksuar se lëshimi i të padituri që pas skadimit të periudhës prej gjashtë muajsh sa ka zgjatur largimi nga puna e paditësit, që të ndërpres marrëdhënies e punës me të, në fakt paraqet privilegj për paditësin që për edhe disa muaj të realizoj të drejtën në gjysmën e të ardhurave personale, edhe pse baza juridike për ndërprerje të marrëdhënies së punës ka qenëei pakontestueshme.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës e pranon qëndrimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës si të saktë dhe të bazuar në ligj.

2. Neni 73 i Ligjit të Punës parashikon mundësinë e largimit të përkohshëm të punonjësit nga puna në rast se kundër tij është filluar procedurë penale. Neni 74 i Ligjit të Punës përcakton se gjatë largimit të përkohshëm nga puna, punonjësi ka të drejtë për kompensim prej 50% të pagës. Neni 75 i Ligjit të Punës përcakton kohëzgjatjen e suspendimit nga puna më së shumti për gjashtë (6) muaj, periudhë në të cilën punëdhënësi është i obliguar që të punësuarin ta kthejë në punë ose t'ia shkëpusë Kontratën e Punës. Procedura disiplinore të cilën i padituri e ka zhvilluar më 23.07.2019, është pezulluar deri në përfundimin e procedurës penale. Procedura penale në shkallë të parë është përfunduar më 06.03.2020, dhe procedura para gjykatës së shkallës së dytë ka përfunduar më 18.12.2020. Në procedurën penale para gjykatës së shkallës së parë, i akuzuari - këtu paditësi ka pranuar fajësinë për veprën penale që i është vënë në barrë. Duke qenë se bëhet fjalë për vepër penale që lidhet me kryerjen e detyrave zyrtare, i padituri ka pasur në dispozicion mundësinë e parashikuar me nenin 70 par. 2 pika 6 të Ligjit të punës, sepse është e pakontestueshme se paditësi ka kryer shkelje të rëndë të detyrave të punës, e cila në mënyrë të pashmangshme sjell ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kështu që edhe Gjykata Supreme ndan mendimin e Gjykatës së Apelit se zvarritja në marrjen e vendimit për shkëputjen e marrëdhënies së punës përfaqësonte një privilegj për paditësin, dhe jo një shkelje të të drejtave të tij të garantuara me ligj.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 126/2025, datë 17.07.2025

’’Në përputhje me kërkesëpadinë, ashtu siç është parashtruar dhe me të cilën kërkohet kthimi i paluajtshmërisë së kontestuar në posedim në shfrytëzim të përhershëm, Gjykata Supreme në kuptim të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike dhe më vonë të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore, vëren se e drejta e kthimit të pronës së paluajtshme në posedim dhe në pronësi i takon pronarit të paluajtshmërisë, dhe që e njëjta kërkesëpadi e paditësit të mund të aprovohet, do të duhej që në radhë të parë të provoj pronësinë e tij në paluajtshmërinë e kontestuar. E njëjta pronësi, siç u tha tashmë, është ndërprerë me shpronësimin e ngastrës lëndore kadastrale dhe me kalimin e së njëjtës në pronësi, përkatësisht në shfrytëzim të përhershëm të të paditurës - Komunës së Prishtinës, dhe më pas të ministrisë së paditur.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokurori pretendon se edhe 40 vjet pas shpronësimit, toka e shpronësuar nuk është vënë në përdorimin e synuar. Në kuptimin e këtyre pretendimeve të paditësit, gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të rregullt thirren dhe zbatojnë nenin 21 të Ligjit të aplikueshëm për shpronësim i cili parasheh mundësinë e anulimit të aktvendimit për shpronësim kur përdoruesi i shpronësimit në rast se shfrytëzuesi i shpronësimit nuk e vë tokën e shpronësuar në qëllimin e saj të synuar brenda tre vjetësh. Mirëpo, i njëjti ligj, në paragrafët vijues të të njëjtit nen, përcakton afatin prej 10 vjetësh nga plotfuqishmëria e aktvendimit, në të cilën mund të parashtrohet kërkesa për anulimin e atij aktvendimi. Paditësi e ka lëshuar afatin e cekur. Në rrjedhjen e afatit të parashikuar me ligj nuk ndikon fakti që paditësi ka filluar procedurën para organeve administrative për të anuluar aktvendimin për shpronësim sepse paditësi nuk ka provuar se ka tentuar ta vazhdojë këtë procedurë, dhe as se si ka përfunduar procedura administrative. Në pajtim me kërkesëpadinë, ashtu siç e njëjta është parashtruar dhe me të cilën kërkohet kthimi i paluajtshmërisë së kontestuar në posedim për shfrytëzim të

përhershëm, Gjykata Supreme në kuptim të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore juridiko pronësore dhe më vonë të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore, vëren se e drejta e kthimit të sendeve të paluajtshme në posedim dhe pronësi, i takon pronarit të paluajtshmërisë, dhe se për tu aprovuar e njëjta kërkesë, do të duhej që në radhë të parë të provoj pronësinë e tij në paluajtshmërinë e kontestuar. E njëjta pronësi, siç u tha tashmë, ka pushuar me shpronësimin e ngastrës lëndore kadasrale dhe me kalimin e të njëjtës në pronësi, përkatësisht në shfrytëzim të përhershëm të të paditurës – Komunës së Prishtinës, dhe me pas ministrisë së paditur.

2. Situata është e njëjtë, nëse si kërkesë padi merret ajo e dhënë në fjalën përfundimtare të paditësit. Paditësi nuk ofron kurrfarë prova në të cilat bazon kërkesën e tij për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi paluajtshmërinë e kontestuar. Si Ligji i mëparshëm në fuqi për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore ashtu edhe Ligji i mëvonshëm për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore përcaktojnë se e drejta e pronësisë mund të fitohet me vetë ligjin, në bazë të punës juridike, parashkrim fitues, dhe me vendim të organit shtetëror. Paditësi asnjëherë nuk është sqaruar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme se në cilën bazë juridike thirret, në çfarë bazon kërkesën e tij për fitimin e së drejtës pronësore në paluajtshmërinë lëndore.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Nuk është i bazuar pretendimi në revizion me të cilin pretendohet se me aktvendimin e Ministrisë së Financave të Republikës së Serbisë 07 Nr. 465-02-00092/98 të datës 12.10.1998, është anuluar shpronësimi për të cilin bëhet fjalë, por që për shkak të ngjarjeve të vitit 1999, paditësi nuk mund të regjistrohej si pronar i pasurisë së paluajtshme të kontestuar. Në fakt, me aktvendimin e cekur vetëm urdhërohet gjykata e shkallës së parë që sërish të vendos sipas kërkesës së këtu paditësit, sepse siç thuhet në arsyetimin e aktvendimit të cekur në shkresat e lëndës nuk ka prova me të cilat do të vërtetoheshin pretendimet nga aktvendimi i shkallës së parë, si dhe prova se bëhet fjalë për tokë ndërtimore të nacionalizuar. Paditësi nuk ka provuar se i është drejtuar të paditurës me një kërkesë për vazhdimin e procedurës së përmendur,

sepse përveç deklaratës së paditësit se e paditura ka refuzuar të vendosë sipas kërkesës së tij, paditësi nuk ofron asnjë provë për këtë pretendim. Pretendimet e paditësit për shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me kushtetutë dhe konventat evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë të pabaza, sepse palujtshmëria për të cilën bëhet fjalë, është shpronësuar bazuar në ligjin në fuqi në atë kohë, dhe me pagesën e kompensimit, lartësia e të cilit është përcaktuar me marrëveshjen midis përfituesit të shpronësimit dhe ish-pronarit, përkatësisht babait të paditësit.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 164/2024, datë 22.04.2025

’’Në këtë kuptim, Gjykata e Apelit ka marrë parasysh se bëhet fjalë për një lloj specifik kompensimi, me të cilin, nëse nuk i eliminojnë, atëherë të paktën i zbusin çrregullimet në sferën emocionale e shpirtërore të të dëmtuarit. Karshi dhimbjeve dhe shqetësimeve që i duron, ose i ka duruar, të dëmtuarit i jepet i gjykohet një sasi e caktuar parash, me të cilën do mund të sigurojë disa të mira materiale, përkatësisht i mundësohet një ndjenjë e këndshmërisë, satisfakcionit, të gjitha këto me qëllim të arritjes së një baraspeshe të caktuar, si dhe arritjes së gjendjes emocionale që ka ekzistuar para ngjarjes së dëmshme. Me rastin e matjes së lartësisë së dëmit jo material, Gjykata e Apelit në mënyrë të drejtë, duke marrë parasysh shkallën e vërtetuar, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe frikës, të njëjtat i ka shprehur në një ekuivalent përkatës monetar, duke pasur parasysh që shumat e gjykuara të mos jenë në kundërshtim me qëllimet për të cilat është paraparë ky lloj kompensimi. Gjykata e Apelit ka pasur parasysh që bëhet fjalë për një person të moshës më të re, i cili më lehtë do të tejkalojë dhimbjet që i janë shkaktuar, përkatësisht dhimbjet që i ka përjetuar.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Në një gjendje të tillë faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesë padia është pjesërisht e bazuar, dhe të njëjtin në njërën pjesë e pa aprovuar ndërsa pjesën e mbetur ka refuzuar, duke vendosur në mënyrën e paraqitur si më lartë.

2. Gjykata e Apelit të Kosovës gjatë vendosjes sipas ankesës së të paditurës ka gjetur që gjatë caktimit të lartësisë së kompensimit të dëmit jo material për dhimbjet fizike të përjetuara dhe frikën e përjetuar, si dhe kompensimit të dëmit material në emër të ushqimit më të pasur si dhe kujdesit dhe ndihmës nga të tjerët, gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale dhe për këtë arsye aktgjykimin e shkallës së parë në këtë pjesë e ka ndryshuar dhe ka

vendosur siç theksohet më lart, ndërsa pjesën tjetër të aktgjykimit të shkallës së parë e ka vërtetuar.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës e pranon qëndrimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe konstaton që aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës është nxjerrë në zbatim të drejtë të së drejtës materiale. Marrë parasysh që revizion kanë parashtruar vetëm paditësit, dhe se çështja e bazës juridike të kompensimit të dëmit nuk është kontestuar nga e paditura, Gjykata Supreme e Kosovës do kufizohet në arsyetimin e zbatimit të së drejtës materiale në pjesën që është goditur nga revizioni dhe që lidhet me përcaktimin e shumës së dëmit si material ashtu edhe jo material.

2. Neni 183 i LMD-së në paragrafin 1 përcakton që për dhimbjet fizike të përjetuara, për dhimbjet shpirtërore të përjetuara, dhimbjet për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, gjymtimit, të dëmtuarit i takon kompensim i drejtë nëse gjykata konstaton që rrethanat e rastit, veçanërisht intensiteti i dhimbjeve dhe frikës si dhe kohëzgjatja e tyre, e arsyeton atë.

3. Paragrafi 2 i të njëjtit ligj përcakton që gjykata gjatë vendosjes për lartësinë e këtij lloji të kompensimit do të ketë parasysh rëndësinë e të mirës së cenuar dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi, por gjithnjë duke pasur parasysh që kompensimin e gjykuar të mos favorizohen prirje që nuk janë në përputhje me natyrën dhe qëllimin shoqëror të tij.

4. Kur bëhet fjalë për lartësinë e kompensimit për dëmin material, Gjykata e Apelit në mënyrë të drejtë ka zbatuar nenin 179 të LMD, dhe kompensimin në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj dhe ushqimit të përforcuar ka gjykuar në shumat të cilat sipas çmimeve në kohën kur janë kryer këto shpenzime, përfaqësojnë shuma që mundësojnë që gjendja materiale e të dëmtuarit, përkatësisht e personit që e mban, të sillet në gjendjen në të cilën do të kishte qenë nëse nuk do të kishte pasur ngjarje të dëmshme.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.260/2024, datë 14.01.2025

’’Pretendimi në revizion që tregon për mungesën e legjitimitetit pasiv të të paditurit është i pabazuar për arsyen se në shkresat e lëndës gjenden prova, më saktësisht Vendimi i të paditurit Nr. 704/11 i datës 28.12.2011, në të cilin thuhet shprehimisht se të gjitha mjetet dhe detyrimet financiare të ish-Shoqatës së Siguruesve të Kosovës kalojnë në Byronë e Kosovare të Sigurimeve, duke filluar nga data 01.01.2012. Në pajtim me këtë që u tha, i padituri është pasardhësi universal i subjektit ekzistues paraprak, dhe i pabazuar është pretendimi se i padituri përgjigjet vetëm për detyrimet e lindura deri më 31.12.2011, por jo edhe pas kësaj date, sepse veprimi me të cilin është shkaktuar dëmi ka ndodhur para datës 31.12.2011 dhe pasojat e tij, përfshirë dhe dëmin që shkaktohet në bazë të tij, paraqet legjitimitetin pasiv të ish-subjektit.’’

I. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Ligji i Punës në nenin 80, paragrafi 1, përcakton që në situatën kur gjykata vërteton se ndërprerja e kontratës së punës nga punëdhënësi është e paligjshme, gjykata do të urdhërojë punëdhënësin t'i paguajë punonjësit kompensimin përkatës të pagës ose kompensimin e pagës dhe kthimin në vendin e punës. Në pajtim me këtë që u tha, gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale me rastin e vendosjes sipas bazueshmërisë së kërkesëpadisë.

2. Pretendimi në revizion me të cilin tregohet për mungesën e legjitimitetit pasiv të të paditurit është i pabazë për arsye se në shkresa të lëndës gjenden prova, më saktësisht, Vendimi i të paditurit Nr. 704/11 i datës 28.12.2011, në të cilin thuhet shprehimisht se të gjitha mjetet dhe detyrimet financiare të ish-Shoqatës së Siguruesve të Kosovës transferohen në Byronë Kosovare të Sigurimeve, duke filluar nga data 01.01.2012. Në përputhje me këtë që u tha, i padituri është pasardhësi universal i subjektit ekzistues paraprak, dhe pretendimi se i padituri është përgjegjës vetëm për detyrimet e lindura deri më 31.12. 2011 por jo edhe pas kësaj date, është i pabazuar, sepse veprimi me të

cilin është shkaktuar dëmi ka ndodhur para datës 31.12.2011 dhe pasojat e të njëjtit, përfshirë dhe dëmin që shkaktohet mbi këtë bazë, përfaqësojnë legjitimitetitin pasiv të ish-subjektit.

3. Pretendimi në revizion që vë në dukje paafatshmërinë e padisë në raport me Byronë Kosovare të Sigurimit, është gjithashtu i pabazë, sepse padia në raport me të paditurin e mëparshëm është parashtruar në afatin e paraparë ligjor, e njëjta më pas i është drejtuar të paditurit, menjëherë pasi është mësuar për ndryshimet statusore që kanë ndodhur midis këtyre dy subjekteve ekonomike.

4. Siç tashmë është thënë, çështja e paligjshmërisë së ndërprerjes së marrëdhënies së punës është zgjidhur tashmë përfundimisht dhe e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi sipas revizionit të parashtruar, dhe kur bëhet fjalë për kërkesën monetare nga marrëdhënia e punës, përkatësisht kërkesës për kompensim të dëmit për shkak të largimit të paligjshëm nga puna, kërkesa është parashtruar brenda afatit të përcaktuar me nenin 87 të Ligjit të Punës, përkatësisht nenin 376 të LMD të mëparshëm në fuqi, dhe nenin 357 të ligjit të vlefshëm.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 295/2024, datë 17.12.2024

’’Ligji për marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili është i zbatueshëm në rastin konkret, përcakton disa nga parimet themelore në marrëdhëniet e detyrimeve, dhe kështu, ndër të tjera, neni 10 përcakton lirinë e rregullimit të marrëdhënieve të detyrimit brenda kufijve që lejojnë ligji dhe aktet e tjera ligjore, në nenin 12 përcakton parimin e ndërgjegjes dhe ndershmërisë që pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të detyruar t'i përmbahen, në nenin 13 parashikon ndalimin e keqpërdorimit me të drejtat, dhe me nenin 15 përcakton parimin e vlerës së barabartë të dhënies. Në procedurën penale të zhvilluar kundër të padituri këtu dhe të pandehurit atje, në mënyrë të plotfuqishme është vërtetuar se i njëjti me lidhjen e kontratës së cekur nuk ka fituar fitim joproporcional dhe as nuk është sjelle në mënyrë mashtruese, dhe nuk ka detyruar paditësin.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Pranë Gjykatës Komunale në Mitrovicë, më 31.03.2004, nën OV Nr. 388/04, është lidhur një kontratë mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, me anë të së cilës kontratë paditësi i ka shitur të padituri shtëpin që ndodhet në Mitrovicë, në ngastrën kat Nr. 2260/1 në vendin e quajtur "Bashqe", sipas kulturës shtëpi-objekt me sipërfaqe prej 165m2 dhe sipërfaqe oborri prej 528 m2, përkatësisht gjithsej 693 m2.

2. Çmimi i shitblerjes është dakorduar në 410,000.00 euro. Më vonë, midis kontraktuesve është lidhur edhe një kontratë, i pavërtetuar në gjykatë në të cilin është precizuar dinamika e pagesës së çmimit shitblerës. I padituri më 29.03.2004 i ka paguar paditësit shumën prej 260,000.00 eurosh dhe më 01.07.2005, shumën prej 150,000.00 eurosh. Pas pagesës së çmimit të plotë të shitblerjes, i padituri është regjistruar si pronar i paluajtshmerisë së kontestuar.

3. Paditësi, duke konsideruar se bëhej fjalë për çmim joreal të blerjes, ka paraqitur kallëzim penal pranë autoriteteve kompetente, në bazë të të

cilit prokurori publik kompetent ka ngritur aktakuzë kundër të padituritkëtu për shkak të veprave penale të Kontraktimit të përfitimit joproporcional, Mashtrimit dhe Detyrimit në vazhdim. Gjykata Themelore në Mitrovicë për dy veprat e para penale ka hedhur poshtë aktakuzën, ndërsa për veprën e tretë penale ka nxjerr aktgjykimin K.Nr. 304/2015 të datës 20.04.2017, me të cilin të padituri këtu dhe atje të pandehurin e ka liruar nga akuzat për veprën që i është vënë në barrë. Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Nr. 586/2017 të datës 07.06.2017.

4. Paditësi në padi, në parashtresat tjera dhe sipas fjalëve të tij në seancën për shqyrtim pranë gjykatës së shkallës së parë, ka theksuar se palët ndërgjyqëse nuk kanë pasur ndërmend që të përpilojnë kontratë të shitblerjes, por se në fakt kjo duhej të ishte një kontratë për kredi, ku si mjet i sigurimit të kredisë lëndore do të shërbente shtëpia, pronar i së cilës paditësi. I njëjti nuk ka kontestuar se nga i padituri kishte pranuar shumën që është cekur si çmim shitblerës, por ka theksuar se i padituri nuk ka pritur që paditësi t'ia kthente shumën e cekur, por menjëherë pas pagesës së çmimit shitblerës, përkatësisht gjithsejte shumës së kredisë, i padituri e ka regjistruar palujtshmërinë lëndore pranë organit kompetent, dhe është regjistruar si pronar i të njëjtës.

5. I padituri ka pohuar se paditësi dhe vëllezërit e tij kanë ardhur tek ai dhe i kanë ofruar për shitje shtëpinë lëndore, të cilën ai në një moment e ka pranuar, dhe kështu ka ndodhur lidhja e kontratës së kontestuar. Pohon se nuk ka pasur kurrfarë problemesh me paditësin deri në momentin kur ai ka dashur të hyjë në posedim të palujtshmërisë lëndore, dhe që prej atij momenti është në kontest me paditësin.

6. Gjykata e Apelit e Kosovës ka mbështetur qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas ankesës së paditësit kundër aktgjykimit të shkallës së parë, duke pretenduar se nuk ka provuar as edhe një nga pretendimet e tij , dhe se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur ka refuzuar kërkesëpadinë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Pikëpamjet e gjykatave të instancës më të ulët janë të pranueshme edhe për Gjykatën Supreme të Kosovës.

2. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili është i zbatueshëm në rastin konkret, përcakton disa nga parimet themelore në marrëdhëniet e detyrimeve, dhe kështu, ndër të tjera, me nenin 10 përcakton lirinë për të rregulluar marrëdhëniet e detyrimeve brenda kufijve që lejojnë ligji dhe aktet e tjera ligjore, me nenin 12 përcakton parimin e ndërgjegjes dhe ndershmërisë që pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të detyruar t'i përmbahen, me nenin 13 ndalon keqpërdorimin me të drejtat, dhe me nenin 15 përcakton parimin e vlerës së barabartë të dhënies. Në procedurën penale e cila është zhvilluar kundër të padituritkëtu dhe të pandehurit atje, në mënyrë të plotfuqishme është vërtetuar se i njëjti me lidhjen e kontratës së cekur nuk ka përfituar fitim jo proporcional, dhe as nuk është sjellur në mënyrë mashtruese, si dhe nuk ka detyruar paditësin.

3. Nga ana tjetër, i njëjti ligj në nenin 26 përcakton se një kontratë konsiderohet e lidhur kur palët të jenë dakorduar për elementet thelbësore të kontratës. Në mënyrë të pakontestueshme pranë gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar se ndërmjet paditësit dhe të padituritështë lidhur kontratë për shitblerje të paluajtshmërisë në formën e përcaktuar me ligj duke vërtetuar me nënshkrim të kontraktuesve para gjykatës kompetente. Me nenin 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore është përcaktuar detyrimi i palëve në procedurë që për pretendimet e tyre të propozojnë prova përkatëse. Paditësi nuk k aprovuar se në rastin konkret bëhet fjalë për kontratë të rrejshme në kuptim të nenit 66 të LMD, përkatësisht se fjala është për punë juridike të simuluar. Gjithashtu, paditësi nuk ka provuar ekzistencën e një disproporcioni të dhënieve të ndërsjella në kuptimin e nenit 139 të LMD-së, as ekzistencën e lajthimit apo kanosjes me rastin e lidhjes së kontratës, të cilat të gjitha mund të jenë arsye për anulimin e saj. Gjithashtu nuk ka prova se bëhet fjalë për një kontratë nule në kuptimin e nenit 103 të LMD.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr. 348/2025, datë 06.03.2025

’’Rezulton se kjo kontratë kurrë nuk është zbatuar, dhe se paluajtshmëritë që kanë qenë lëndë i kësaj kontrate kanë mbetur në pronësi të kontraktuesit ashtu siç ka qenë edhe para lidhjes së kontratës. Përkatësisht, kjo punë juridike kurrë nuk është përfunduar në mënyrë të vlefshme, nuk është zbatuar deri në fund, nuk ka ardhur deri te ndryshimet përkatëse në librat publike, si dhe secili ka mbetur pronarë i atyre paluajtshmërive që i ka pasur edhe para këmbimit. Në kuptim të kësaj që u tha, i padituri i parë nuk ka mundur të disponoj me gjërat që nuk i ka, më saktësisht nuk ka mundur të shes palujatshmërinë, e cila nuk është në pronësi të tij.’’

I. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Neni 33 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, i vlefshëm në kohën e lidhjes së kontratave të kontestuara, në nenin 33 përcakton: se në bazë të një punës juridike, e drejta e pronësisë fitohet me regjistrim në librin publik, ose në ndonjë mënyrë tjetër përkatëse të përcaktuar me ligj. Kështu që, fakti që i padituri i parë me titullarin e atëhershëm ka lidhur kontratë për shkëmbimin e tokës, nuk do të thotë automatikisht se ai ka fituar të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmerinë që ka marrë në këmbim. Rezulton se kjo kontratë nuk është zbatuar kurrë, dhe se paluajtshmëritë që kanë qenë lëndë e kësaj kontrate kanë mbetur në pronësi të kontraktuesve siç kjo ka qenë edhe para lidhjes së kontratës. Pra, kjo punë juridike nuk është përfunduar në mënyrë të vlefshme, nuk është zbatuar deri në fund, nuk ka ardhur deri tek ndryshimet e përkatëse në librat publikë, kështu që secili ka mbetur pronar i atyre palujtshmërive që i ka pasur edhe para shkëmbimit. Në kuptimin të kësaj që u tha, i padituri i parë nuk ka mundur të disponoj me gjerat që nuk i ka, më saktësisht nuk ka mundur të shes paluajtshmërinë e cila nuk është në pronësi të tij. I pabazuar është pretendimi në revizion në të cilin thuhet se i padituri i parë menjëherë pas shkëmbimit, ka hyrë në posedim në paluajtshmërinë e fituar përmes këmbimit, dhe se është bërë pronar i së njëjtës me rrjedhjen e

periudhës së caktuar në kuptim të nenit 28 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, sepse për këtë mënyrë të fitimit të drejtës së pronësisë, dhe pa u lëshuar në atë nëse duhet zbatuar neni 29 i të njëjtit ligj, është i domosdoshëm vërtetimi i plotfuqishëm i gjykatës kompetente. Më saktësisht, i padituri i parë së pari do të duhej që para gjykatës kompetente të vërtetoj se ai është pronar i paluajtshmërisë së kontestuar, dhe vetëm më pas ai do të kishte të drejtën e disponimit me paluajtshmërinë e kontestuar. Pretendimet në revizion me të cilat pretendohet se e paditura e dytë ka humbur të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmërinë e kontestuar , dhe se të drejtën e pronësisë në të njëjtën e ka fituar i padituri i parë në kuptim të nenit 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, është i pabazuar, ngase nëse parashtruesi i revizionit konsideron se i padituri i parë ka fituar të drejtën pronësore në bazë të punës juridike, kjo punë juridike, siç është thënë më lartë, nuk është përfunduar, nuk ka prodhuar efekt juridik. Pretendimi i paditësit në revizion me të cilin vihet në dukje se neni 12 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, si bazë juridike për fitimin e të drejtës pronësore ka theksuar blerjen, ndërsa lidhur me atë nëse ngastrën lëndore kadastrale është ndërtuar diçka dhe nëse p, kush e ka ndërtuar atë, fare nuk është bërë fjalë në procedurën e zhvilluar para gjykatës së shkallës së parë.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr. 433/2024, datë 25.02.2025

’’Në përputhje me dispozitat ligjore të cekura, është e qartë se termi "zhvillimi i seancës për shqyrtimin kryesor" të LPK, përfshin, ndër të tjera, mbylljen e seancës kryesore, si dhe rihapjen e së njëjtës në situatën kur vlerëson se një gjë e tillë është e domosdoshme me qëllimi të plotësimit të gjendjes faktike. Është e pakontestueshme se e paditura me rastin e parashtrimit të kërkesës për rihapjen e procedurës ka theksuar bazën e gabuar juridike, mirëp oky lëshim i të padituës nuk është me ndikim në ligjshmërinë e procedurës së gjykatës së shkallës së parë.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë është refuzuar si e pabazuar kërkesë padia e paditësit Pajtim Hyseni, me të cilën kërkesë padi paditësi ka kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit për Përzgjedhjen dhe Rekrutimin e Policisë së Kosovës të datës 22.01.2019, dhe detyrimin e të padituës: Policia e Kosovës që me paditësin Pajtim Hyesni të lidhë kontratë për themelimin e marrëdhënies së punës për vendin e punës zyrtar policor, si dhe t detyrohet e paditura që paditësit në mënyrë retroaktive t’i paguajë të gjitha pagat duke filluar nga 17.01.2019 e deri në momentin e lidhjes se kontratës, dhe duke detyruar të padituën që të paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 612.00 eurosh.

2. Kundër këtij aktgjykimi i padituri ka ushtruar ankesë dhe Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur sipas të njëjtës ka gjetur se ankesa nuk është e bazuar, ndaj përmes aktgjykimit Ac.Nr. 2301/2020 të datës 10.03.2023 ka refuzuar të njëjtën, duke vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë C.Nr. 794/19 të datës 27.12.2019.

3. Kundër aktgjykimit së formës së prerë Gjykatës së Apelit të Kosovës, paditësi në afatin ligjor ushtron revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPK dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në revizion.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, pas analizës së shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në revizion, dhe në kuptim të nenit 215 të LPK, ka gjetur se:
   Revizioni nuk është i bazuar.

5. Në procedurën para gjykatave të instancës më të ulët, nuk ka pasur shkelje të dispozitave të LPK, për të cilat gjykata e revizionit është e obliguar të kujdeset sipas detyrës zyrtare.

6. Në revizion në mënyrë të pabazuar tregohet për veprimet e Gjykatës së Apelit me rastin e shqyrtimit të ankesës së paditësit, përkatësisht vihet në dukje se gjykata e shkallës së dytë nuk është përgjigjur në pretendimet ankimore. Pretendimet ankimore për të cilat bëhet fjalë i referohen faktit se e ka përfunduar seancën kryesore më 12.11.2019, dhe më pas, me propozimin e të padituresë të datës 26.11.2019, e ka rihapur seancën kryesore, ka paraqitur prova shtesë, dhe pas kësaj e ka mbyllur shqyrtimin dhe ka nxjerr aktgjykimin. Në përgjigjen ndaj këtij pretendimi i cili është theksuar edhe në ankesë, Gjykata e Apelit në faqen 8 të aktgjykimit të goditur me revizion, thekson: " Kolegji ka vlerësuar pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditësit lidhur me hapjen e serishëm të shqyrtimit kryesor, dhe konsideron se veprimi gjykatës së shkallës së parë nuk paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, gjë që vë në pikëpyetje ligjshmërinë e procedurës së paraqitjes së provave, sepse me asnjë dispozitë e LPK, nuk është përcaktuar ndalimi i hapjes së serishme të seancës kryesore". Tutje, Gjykata e Apelit jep sqarimin se nxjerrja e provave plotësuese në seancën e rihapur nuk paraqet bazë për shfuqizim apo ndryshim të aktgjykimit të ankimuar.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e pranon arsyetimin e Gjykatës së Apelit si të rregullte, dhe thekson si në vijim:

Procedura kontestimore, ashtu siç është rregulluar me LPK zhvillohet në disa faza. Një nga fazat është seanca për shqyrtimin kryesor. LPK përkufizon kushtet për shtyrjen dhe vazhdimin e seancës kryesore, por askund nuk e thotë shprehimisht, dhe as nuk e ndalon rihapjen e seancës kryesore. Neni 436 paragrafi 1 i LPK, përcakton " Pasi të përfundojnë të gjitha fazat e shqyrtimit kryesor dhe pasi të jetë i gatshëm për zgjidhje kontesti, gjykata e shpallë të mbyllur shqyrtimin kryesor". Neni 435 i LPK në par. 1 përcakton se gjykata nuk është e lidhur me aktvendimet që kanë të bëjnë me drejtimin e shqyrtimit kryesor, dhe në paragrafin 2 të të njëjtit nen përcakton se kundër aktvendimeve që kanë të bëjnë me drejtimin e shqyrtimit kryesor nuk lejohet ankim i veçantë.

2. Në përputhje me dispozitat ligjore të lartpërmendura, është e qartë se termi "zhvillimi i seancës kryesore" të LPK, nënkupton, ndër të tjera, edhe mbylljen e seancës kryesore si dhe rihapjen e së njëjtës në situatën kur vlerëson se një gjë e tillë është e domosdoshme me qëllim të plotësimit të gjendjes faktike.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.508/2024, datë 10.03.2025

’’Në kuptimin të kësaj që u parashtrua, nuk ka qenë e mundur të lejohet ndryshimi i padisë në një mënyrë të tillë që në vend të vërtetimit të së drejtës pronësore dhe dorëzimit në posedim, më vonë të lejohet kërkesëpadia me të cilën kërkohet vërtetimi i i së drejtës së servitutit ose madje pengim i servitutit, sepse përveç dallimit në vërtetimin e gjendjes faktike, LPK përcakton dhe procedurë të tjetër të gjykatës kur bëhet fjalë për vërtetimin apo pengimin e servitutit, madje edhe formën e ndryshme të vendimit.’’

I . Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Neni 257 i LPK-së në paragrafin 1 përcakton se ndryshim të padisë përbënë ndryshimi i njëjtësisë së kërkesëpadisë, zmadhimi i kërkesëpadisë apo parashtrimi edhe i një kërkese tjetër krahas asaj ekzistuese. Neni 258 i LPK përcakton se padia mund të ndryshohet më së voni deri në përfundimin e seancës përgatitore apo deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, në qoftë se seancë përgatitore nuk ka pasur fare. I njëjti nen i ligjit parashikon mundësinë e ndryshimit të mëvonshëm të padisë, me kusht që i padituri të pajtohet me këtë dhe që gjykata të vërtetoj se nuk bëhet fjalë për zvarritje të qëllimshme të procedurës nga padia. Në paragrafin IV të ligjit të njëjtë është përcaktuar mundësia që gjykata të lejoj ndryshimin e padisë edhe në rastin kur i padituri kundërshton, në qoftë se gjykata vërteton se paditësi pa fajin e tij, nuk ka mundur më parë ta ndryshojë padinë, dhe se i padituri ka pasur mundësin që të marrë pjesë në seancën e shqyrtimit pa u shtyre seanca kryesore. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë në kuptim të dispozitave ligjore të lartpërmendura, ka pasur mundësinë që edhe më vonë të lejonte ndryshimin e padisë, por këtë nuk e ka bërë meqë paditësi nuk ka provuar përmbushjen e kushteve të kërkuara me ligj në mënyrë që ndryshimi i padisë të mund të lejohej edhe në fazat e vona të procedurës. Faktin që pjesa e kontestuar e ngastrës lëndore kadastrale shërben si rrugë kaluese,

paditësja e ka ditur që në fillim, që në rastin e parashtrimit të padisë. Cilat janë qëllimet që në vend që të kërkojë që t'i lejohet kalimi i lirë nëpër palujatshmërinë e kontestuar, paditësja paraqet kërkesë për vërtetimin e së drejtës së pronësisë dhe dorëzimin në posedim të së njëjtë, për gjykatën është e panjohur dhe e pa rëndësishme. Në kuptimin e kësaj që u tha, nuk ka qenë e mundur të lejohet ndryshimi i padisë që në vend të vërtetimit të së drejtës pronësore dhe dorëzimit në posedim, më vonë të lejohet kërkesë padia me të cilën kërkohet të vërtetohet servituti ose pengimit të servitutit, sepse përveç dallimit në vërtetim të gjendjes faktike, LPK përcakton edhe veprim të ndryshëm të gjykatës kur bëhet fjalë për vërtetimin e servitutit ose pengimit të servitutit, madje edhe formë tjetër të vendimit.

2. Në kuptimin e kësaj që u parashtrua, dhe meqë gjykata e shkallës së parë nuk ka lejuar ndryshimin e padisë, dhe ka vazhduar vendosjen sipas kërkesë padisë që ka të bëj me dorëzimin në posedim, meqë paditësja nuk ka provuar pronësinë në pjesën e kontestuar të ngastrës lëndore kadastrale, rezulton i drejtë vendimi i gjykatave të instancës më të ulët kur kanë gjetur se kërkesë padia nuk është e bazuar, dhe kanë refuzuar të njëjtën.

3. Nuk është i bazuar pretendimi në revizion me të cilin thuhet se ndryshimi i padisë në situatën ku, në vend të vërtetimit të së drejtës pronësore kërkohet vërtetimi i së drejtës së servitutit, e njëjta paraqet zvogëlim të kërkesëpadisë, për arsyet e listuara tashmë, dhe sepse bëhet fjalë për kërkesëpadi krejtësisht të ndryshme për nga përmbajtja dhe forma.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr. 542/24, datë 12.03.2025

’’Pa u lëshuar në verifikimin e vërtetësisë së kontratës të cilën të paditurit-kundërpaditës kanë paraqitur si provë për fitimin e së drejtës pronësore në paluajtshmërin e kontestuar, e pakontestueshme është në kuptim të dispozitave të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, ashtu edhe të Ligjit për qarkullimin e palujtshmërive, askush nuk mund ta tjetërsojë sendin nëse nuk është pronar i tij, nëse nuk është titullar i së drejtës pronësore. Dispozitat e cekura ligjore përcaktojnë se askush nuk mund të bart më shumë të drejta, të drejta më të mëdha se sa që ka vetë.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Mbi një gjendje të tillë faktesh, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia nuk është e bazuar për arsye se me padi nuk janë përfshirë të gjithë personat të legjitimuar pasiv, dhe se paditësi nuk ka provuar pretendimet e tij.
2. Gjithashtu ka refuzuar edhe kundërpadinë, duke pretenduar se provat të cilat paditësit i kanë paraqitur gjykatës nuk kanë të mjaftueshme që të bëjnë kërkesëpadinë të bazuar.
3. Gjykata e Apelit pranon qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas ankesës të paditurve - kundërpaditësve dhe thekson se kontrata të cilën të paditurit - kundërpaditësve ia kanë dorëzuar gjykatës si bazë mbi bazën e së cilës kërkojnë vërtetimin e së drejtës pronësore, nuk është lidhur me pronarin e paluajtshmërisë, dhe se me padi duhej të përfshihej edhe Kisha Adventiste e Krishtere nga e cila, siç pohojnë paditësit, e kanë blerë palujtshmërinë lëndore. Gjithasthu, siç thekson Gjykata e Apelit, të paditurit – kundër paditësve nuk kanë provuar përmbushjen e kushteve për fitimin e së drejtës pronësore përmes mbajtjes /posedimit.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Qëndrimi i gjykatave të instancës më të ulët është i pranueshëm edhe për Gjykatën Supreme të Kosovës. Pa u lëshuar në verifikimin e

vërtetësisë së kontratës të cilën të padituri – kundërpaditësve e kanë paraqitur si provë për fitimin e së drejtës pronësore, e pakontestueshme është se në kuptim të dispozitave të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, si edhe të Ligjit për qarkullimin e paluajtshmërive, askush nuk mund të tjetërsoj sendin nëse nuk është titullar i së drejtës pronësore. Dispozitat ligjore të cekura më lartë përcaktojnë se askush nuk mund të bartë më shumë të drejta, të drejta më të mëdha se sa që i ka vet.

2. Duke e marrë parasysh këtë në rastin konkret, Kisha e Krishterë Adventiste nuk ka mundur të tjetërsonte, të shiste paluajtshmërinë e së cilës nuk është pronare, sepse e njëjta nga i padituri ka blerë ngastrën kadasatrale Nr. 3080/2, por jo edhe ngastrën kadastrale Nr.3080/1. Përveç kësaj, nëse i padituri-kundërpaditësve thekson këtë bazë juridike për të fituar të drejtën pronësore në paluajtshmërinë lëndore, ata, siç këtë në mënyrë të drejtë konkludojnë gjykatat e instancës më të ulët, do të duhej që në padi të përfshijnë edhe shitësin, Kishën e Krishterë Adventiste.

3. Kur bëhet fjalë për bazën e dytë juridike, fitimin e të drejtës pronësore përmes mbajtjes, për të fituar të drejtën pronësore në këtë mënyrë, është e nevojshme të provohet përmbushja e kushteve të caktuara, ndër të tjera edhe mirësbesimi i blerësit. Pa u lëshuar në vlerësimin nëse ndryshimi i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, i cili i referohet mundësisë së fitimit të së drejtës pronësore përmes mbajtës së pronës së paluajtshme në pronën shoqërore, zbatohet në Kosovë, i padituri-kundërpaditësve nuk ka provuar me pamëdyshje nëse paluajtshmërinë lëndore e mbajnë të papenguar, sa kohë zgjat ky posedim dhe siç është thënë tashmë, nuk kanë provuar që të njëjtën e mbajnë me vetëdije se paluajtshmëria e cekur përfaqëson pronë të tyre, përkatësisht nuk kanë provuar mirëbesimin e tyre.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
E.Rev.50/2024, datë 18.12.2024

''Bartja e së drejtës pronësore në paluajtshmërinë – dispozita e nenit 36, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore (Ligji nr.03/L-03/l-154).''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë KP.nr.143/22 i datës 20.07.2023, në pikën I të dispozitivit është refuzuar kërkesë padia e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të provohet se ai është pronar i palujtshmërisë, përkatësisht i ngastrës kadastrale me numër: P-72614051-00659-4 në sipërfaqe të përgjithshme prej 2954m², në vendin e quajtur "Vishesella" me kulturë bujqësore, ZK Miloshevë, K. Obiliqit, si dhe pronarë i objektit të kontrollit teknik me sipërfaqe P+1 i cili është ndërtuar në ngastrën kadastrale të cekur lëndore, më pas të detyrohet i padituri që t'ia njeh të drejtën e pronësisë dhe të obligohet e Drejtoria e Gjeodezisë në Obiliq, të bëj bartjen dhe regjistrimin e patundshmërisë.

2. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

3. Duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga i autorizuari i paditësit, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë me aktgjykimin e saj K.Dh.Sh.II nr.1450/23 të datës 28.03.2024 ka refuzuar të njëjtën duke vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

4. I pakënaqur me aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, i autorizuari i paditësit në afatin ligjor ka ushtruar revizion kundër aktgjykimit të formës së prerë së gjykatës së shkallës së dytë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin si në të njëjtin.

5. Në shkresat e çështjes ekziston parashtresa me shkrim, përkatësisht përgjigjja në revizionin e paraqitur nga i padituri, me të cilën kërkon që të aprovohet revizioni si i bazuar.

6. Gjykata Supreme e Kosovës ka shqyrtuar aktgjykimin e kontestuar në raport me pretendimet në revizion dhe në kuptim të dispozitave të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), dhe ka vlerësuar se revizioni i të autorizuarit të paditësit është i bazuar.

7. Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar dhe gjykata e shkallës së dytë ka vërtetuar se paditësi si blerës nga njëra anë dhe i padituri si shitës nga ana tjetër kanë nënshkruar para kontratën për shitblerjen e paluajtshmërisë më 25.06. 2015, lidhur me ngastrën e kontestuar kadastrale me nr. P-72614051-00659-4 ZK Milloshevë, në para kontratën e cekur ekzistojnë vetëm nënshkrimet e palëve dhe të pavërtetuara. Bazuar në leximin e Certifikatës numër: P-72614051-00659-4 të lëshuar më 10.11.2015 nga Zyra Kadastrale në Obiliq është vërtetuar se i padituri këtu - Naser Kelmendi, është pronar i ngastrës kadastrale kontestuese me 1/1.

8. Me padinë e parashtruar më 10.03.2016, paditësi ka kërkuar konvalidimin e kontratës për shitblerjen, dhe pas precizimit të bërë të padisë në njërën nga seancat e mbajtura gjyqësore, paditësi ka kërkuar njohjen e së pronësore mbi bazën e kontratës së lidhur. Gjykatat e instancës më të ulët pas zbatimit të procedurës së plotë gjyqësore, në të cilën i padituri nuk ka kontestuar padinë dhe kërkesë padinë, kanë vërtetuar se paditësi nuk posedon dokumentacionin valid për bartjen e pronësisë në ngastrën lëndore kadastrale, si dhe objektin që ndodhet në të njëjtën. Paditësi nuk ka arritur që të provoj pronësinë në sendin lëndor, sepse si një prej provave ka paraqitur para kontratën për shitblerjen e pronës e cila nuk është vërtetuar tek noteri, dhe si e tillë ajo nuk përfaqëson një punë të vlefshme juridike për të fituar të drejtën e pronësisë. Nuk ekziston baza ligjore dhe as nuk janë përmbushur kërkesat ligjore për bartjen e pronësisë në paluajtshmërit, të parashikuara në nenin 36, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore. Gjykata e shkallës së dytë ka

vërtetuar konstatimet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me refuzimin e padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit, përkundër faktit se i padituri nuk ka kundërshtuar kërkesë padinë e paditësit, para kontrata e përmendur e shitblerjes të pronës së kontestuar e nënshkruar më 25.06.2015, të cilën paditësi ia ka paraqitur gjykatës, nuk është e vlefshme për bartjen e pronësisë lëndore. dhe gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 3, paragrafi 3, nën paragrafi 3, pika (b). të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë nxjerrë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore nga neni 182, paragrafi II. pika n), për arsye se të njëjtit kanë të meta që i bëjnë të pakuptueshme, dispozitivi i tyre nuk është në përputhje me arsyet mbi faktet thelbësore të dhëna në arsyetim dhe arsyet mbi faktet thelbësore nuk janë në lidhje logjike me provat e paraqitura. Mangësitë e përmendura pengojnë verifikimin e rregullsisë së zbatimit të së drejtës materiale nga gjykatat e instancës më të ulët.

2. Objekt i kontestit konkret është vërtetimi i pronësisë me bazë juridike: para kontratën për shitblerjen e patundshmërisë të nënshkruar më 25.06.2015 nga palët, të pavërtetuar nga organi kompetent. Paditësi ka theksuar se pas nënshkrimit të para kontratës lëndore, i njëjti menjëherë ka paguar çmimin e plotë të shitblerjes, për çka ekzistojnë dëftesat për pagesën e kryer, si dhe menjëherë ka hyrë në posedim të paluajtshmërisë lëndore. I padituri nuk e ka kontestuar padinë dhe kërkesë padinë e paditësit, por në përgjigjen me shkrim ndaj padisë, të dorëzuar në gjykatë më 07.11.2022. ka njohur padinë dhe kërkesë padinë e paditësit, duke theksuar se ai është vetëm pronar formal, duke kërkuar që gjykata të marrë vendim në mungesë të tij. Në kontestin konkret, palët në proces, si dhe palët kontraktuese janë në marrëdhënie familjare, blerësi këtu - paditësi, është vajza e shitësit - e të padituri këtu.

3. Gjykata Supreme e Kosovës vë në dukje se objekt i para kontratës lëndore është, citohet: ''*Ngastra kadastrale numër: P-72614051-006594-4 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2954 m2, ZK Milloshevë, K. e Obiliqit, si dhe objekti i kontrollit teknik P+1, i cili gjendet në ngastrën e cekur me leje të ndërtimit".*

4. Dispozita e nenit 18, par. 1 e Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore (Ligji nr.03/L-154 i datës 04.08.2009) parashikon se pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mundet, përveç nëse kjo nuk është në kundërshtim me ligjin me të drejtat e personave të tretë, të disponoj me atë send sipas dëshirës së tij, gjë që posaçërisht nënkupton mbajtjen dhe shfrytëzimin e a ti sendi, si dhe tjetërsimin e tij, në të cilën gjë asnjë person tjetër nuk mund ta pengoj.

5. Në shkresat e lëndës gjendet Certifikata e së Drejtës Pronësore me numër: P -72614051-00659-4 e lëshuar me datë 10.11.2015 nga KK Obiliq, në të njëjtin thuhet se ngastra lëndore kadastrale me kulture arë e klasës IV, është e regjistruar në emër të padituri me 1/1, por po ashtu thuhej se në ngastrën lëndore me datë 13.12.2013 është vendosur barrë e tatimit në pronë për shkak të mos pagesës së tatimit nga Shërbimi tatimor i Kosovës. Pra, e pakontestueshme është se i padituri është pronar i ngastrës lëndore kadastrale, mirëpo, kontestuese është gjëja se e njëjta e ngarkuar, në para kontratën lëndore nuk ekziston dispozita apo nen që trajton këtë konstatim, si dhe pyetjen se kush do t'ia kthej borxhin Shërbimit Tatimor të Kosovës, sipas rregullit ky detyrim bartet tek blerësi, por kjo duhet të jetë e theksuar në para kontratë apo në kontratë.

6. Gjithashtu me këqyrje në Certifikatën e përmendur, si dhe në Kopjen e Planit e cila gjendet në shkresa të lëndës, nuk evidentohet përkatësisht nuk është i regjistruar objekti i Kontrollit Teknik P+1. Në shkresat e lëndës nuk gjenden dokumente me të cilat provohet se është përfunduar procesi i lëshimit të lejes për ndërtim, përkatësisht nuk ekziston prova se i padituri ka bërë regjistrimin e pronësisë në objektin lëndor. Objekti i cekur i cili gjithashtu është lëndë e para kontratës lëndore nuk i evidentuar në kadastër të paluajtshmërive, për Gjykatën

Supreme mbetet e paqartë se pse gjykatat e instancës më të ulët nuk janë marrë me këtë çështje, e Lartë mbetet e paqartë, pse gjykatat më të ulëta nuk janë marrë edhe me këtë çështje, sidomos për shkak se bëhet fjalë për objektin që gjendet në paluajtshmërinë dhe e ndan fatin e njëjtë me të?

7. Tutje, i padituri gjatë kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore ka njohur padinë dhe kërkesë padinë në tërësi, dispozita e nenit 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashikon që kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për marrjen e vendimit meritor, në atë rast ajo pa caktuar seancat gjyqësore mund të shqiptoj aktgjykimin me të cilin pranon kërkesë padinë si të bazuar. Mbetet e paqartë për Gjykatën Supreme për cilën arsye gjykata e instancës më të ulët nuk janë marrë me çështjen e njohjes së padisë dhe kërkesë padisë së paditësit, në lidhje me nenin 398 të ligjit të përmendur, sidomos kur kihet parasysh e drejta e pronarit që në mënyrë të papenguar të disponoj me sendin e tij?

8. Dispozita e nenit 36, par. 1 dhe 2 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat sendore (Ligji nr. 03/L-154 i datës 04.08.2009) përcakton se për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri. Kontrata për bartjen e paluajtshmërisë duhet të lidhet me shkrim në prezencë të dy palëve në një zyrë kompetente. Në rastin konkret ekziston para kontrata e cila është lidhur në formë të shkruar dhe i nënshkruar nga të dy palët, objekt i para kontratës së cekur është ngastra kadastrale, për të cilën në Parakontratë nuk thuhet se është e ngarkuar (me tatim), si dhe objekti, për të cilin nuk theksohet se nuk është e evidentuar në kadastër të paluajtshmërive.

9. Duke pasur parasysh dispozitat e cituara të ligjeve të cekura, si dhe shkresat e plota të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në të gjitha pyetjet e parashtruara më sipër, gjykatat e instancës më të ulët kanë lëshuar që edhe sipas detyrës zyrtare të sqarohen apo të

arsyetohen në vendimet e tyre. Mangësitë e cekura janë të natyrës së tillë që kërkojnë prishjen e aktgjykimeve të instancës më të ulët, pa mundur fare që Gjykata Supreme të lëshohet në verifikimin e pretendimeve tjera në revizion, si dhe në verifikimin e rregullsisë së zbatimit të së drejtës materiale.

10. Për arsyet e paraqitura, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se aktgjykimet e instancës më të ulët duhet prishur dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje. Në procedurën e përsëritur, të gjitha pyetjet dhe faktet e lartpërmendura do të vërtetohen pa mëdyshje. Gjithashtu, do të vërtetohen edhe faktet tjera relevante, dhe mbi një gjendje të tillë të vërtetuar do të zbatohet e drejta e duhur materiale dhe do të merret një vendim i ligjshëm dhe i drejtë.

11. Për arsyet e parashtruara, u vendos si në dispozitiv në kuptim të nenit 224, par. 2 të Ligjit për procedurën kontestimore.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.408/2024, datë 31.01.2025

’’Arsyetim i pamjaftueshëm dhe jo i plotë i gjykatave të instancës më të ulët – dispozitat e nenit 182, par. 1 të Ligjit për procedurën kontestimore.’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykim të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Deçan, C.nr.140/2014 të datës 02.02.2021, në pikën I të dispozitivit është refuzuar s e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se ai është pronar i banesës që ndodhet në rrugën “Manastirska” banesa nr.8, kati III, me sipërfaqe prej 69.21 m2 në bazë të aktvendimit të nxjerrë nga OP “Zastava Ramiz Sadiku” nën numrin 2593 të datës 26.06.1986. Në pikën II të dispozitivit përcaktohet se secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

2. Kundër këtij aktgjykimi paditësi brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë dhe Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë përmes aktgjykimit Ac.nr.4408/21 të datës 16.07.2024 të njëjtën ka refuzuar si të pabazuar duke vërtetuar aktgjykimin e ankimuar të shkallës së parë.

3. Kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, paditësi brenda afatit ligjor ka ushtruar revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, përkatësisht dispozitës së nenit 182, paragrafi 1, paragrafët: b, f, k dhe n) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së dytë dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në revizion.

4. Në shkresat e lëndës nuk ekziston parashtresë me shkrim përkatësisht përgjigjja në revizion, të paraqitur nga pala kundërshtare.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, pas analizës së shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në revizion, si dhe në kuptim të dispozitave

të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), ka gjetur se:

Revizioni është i bazuar.

6. Nga të dhënat nga shkresat e lëndës vërtetohet gjendja faktike si në vijim:

a. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar, ndërsa gjykata e shkallës së dytë ka vërtetuar gjetjet e saj, përkatësisht se padia dhe kërkesë padia e paditësit janë të pabazuara. Paditësi ka parashtruar padi më 11.08.2014 kundër të padituritduke kërkuar që gjykata t'i njohë të drejtën e pronësisë mbi banesën lëndore, duke theksuar se në bazë të aktvendimit të OP "Zastava Ramiz Sadiku" me seli në Pejë, nr. 2593 të datës 20.06.1986, ka themeluar marrëdhënie pune me ndërmarrjen OP "Zastava Ramiz Sadiku" ku ka qenë i punësuar si inxhinier i makinerisë". Gjykata e Shkallës së Parë ka zhvilluar procedurën e plotë dhe ka vërtetuar se nuk është kontestuese se banesa i është ndarë paditësit përmes aktvendimit të datës 27.09.1999, mirëpo gjykata e shkallës së parë me lexim të vendimit të Komisionit për kërkesa pronësore të Kosovës, KPCC/d/r/229/2014 të datës 13.03.2014, ka gjetur se i padituri parashtruar kërkesë me numër KPA01193 në Agjencinë Kosovare të Pronës për njohjen e së drejtës në posedim të banesës lëndore, të cilën e ka humbur gjatë luftës.

b. Agjencia Kosovare për Kërkesa Pronësore, gjegjësisht Komisioni i saj për Kërkesa Pronësore i Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar ka vërtetuar se i padituri Staleta Mosjiloviq është pronar e 1/1 të patundshmërisë lëndore, përkatësisht banesës. Gjykata e shkallës së parë është thirrur në nenin 2, paragrafit 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23, ku thuhet se vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për zbatim dhe nuk i nënshtrohen rishqyrtimit nga ndonjë organ tjetër gjyqësorë apo administrativ në Kosovë, që do të thotë se kontesti konkret tashmë është gjykuar.

7. Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar sipas ankesës së paditësit, e ka refuzuar ankesën si të pabazuar, duke vërtetuar aktgjykimin e ankimuar të shkallës së parë, duke theksuar në arsyetim se paditësit i është ndarë banesa lëndore në shfrytëzim nga drejtori i fabrikës së

autopjesëve "Ramiz Sadik" në Deçan më 27.09.1999. Gjykata e shkallës së dytë ka vërtetuar se paditësi ka paraqitur kërkesë për tu vendosur në banesën lëndore te drejtori i Fabrikës së Autopjesëve "Ramiz Sadik", si dhe kërkesë për lirim të banesës, të cilën e ka dërguar në Kuvendin Komunal të Deçanit, për shkak se prona e tij është djegur gjatë luftës. Gjykata e shkallës së dytë ka vërtetuar se i padituri ka lidhur Kontratë për shfrytëzimin e banesës me nr. 80 më 24.09.1991 me Ndërmarrjen Publike Banesore, si dhe se i padituri ka lidhur kontratë për shitblerjen e banesës nr. 11474/93 më datën 16.12.1993, që do të thotë se i padituri e ka blerë objektin banesor në të cilin tani ndodhet paditësi.

8. I padituri ka paraqitur kërkesë për lirim të banesës lëndore në Agjencinë Kosovare për Prona me numër KPA01193, dhe Komisioni i tyre ka nxjerrë aktvendimin nr. KPCC/D/R/229/2014 më datë 13.03.2014, me të cilin ka vendosur që i padituri ka të drejtën e pronësisë mbi banesën lëndore, e cila është përfshirë në skemën e qiradhënies nga data 30.10.2014. Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se paditësi posedon vetëm një aktvendim të pasluftës për shfrytëzimin e banesës lëndore, nuk ka kontratë për shitblerjen e banesës, apo ndonjë të drejtë tjetër ligjore për të fituar të drejtë pronësore mbi banesën lëndore, i padituri e ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të punës vlefshme juridike e cila deri më tani nuk i është nënshtruar asnjë kërkese për anulim. Si bazë ligjore për njohjen e së drejtës së pronësisë, paditësi ka marrë vetëm aktvendimin për shfrytëzimin e banesës të lëshuar nga drejtori i Fabrikës "Ramiz Sadiku", i cili nuk mundet banesën lëndore ta jap në shfrytëzim, as num mundet të dispono metë, sepse e njëjta tashmë i ka takuar pronarit – të paditurit këtu.

9. Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkelje tthelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën KOntestimore, nga neni 182, paragrafi II. pika n), ngase kanë të meta që i bëjnë ato të pakuptueshme, dispozitivi i tyre nuk është në përputhje me arsyet mbi faktet thelbësore të dhëna në arsyetim dhe arsyet mbi faktet thelbësore

nuk janë në lidhje logjike me provat e paraqitura. Mangësitë e cekura pengojnë verifikimin e rregullsisë së zbatimit të së drejtës materiale nga gjykatat e instancës më të ulët.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të shiqimit të shkresave të plota të lëndës, ka konstatuar se me Vendimin e Agjencisë Kosovare për Prona Nr.: KPCC/D/R/229/2014 të datës 13.03.2014, në bazë të kërkesës së Staleta Mojsiloviq – të paditurit këtu, atij i është njohur e drejta e pronësisë mbi banesën lëndore. Me këtë vendim, uzurpatori apo çdo person tjetër që ka uzurpuar pronën është urdhëruar ta lirojë atë në afat prej 30 ditësh, nga dita e dorëzimit të vendimit të cekur. Për vendimin e lartpërmendur janë njoftuar palët dhe kanë pasur të drejtë që të parashtrojnë ankese. Bazuar në shiqimin e dokumentit të shkruar: Vërejtja e fundit për Shpërngulje për shkak të uzurpimit të pronës me nr.01193 e datës 12.01.2016. Gjykata Supreme ka vërtetuar se paditësi është njoftuar për vendimin e lartpërmendur të Agjencisë dhe se kundër vendimit të lartpërmendur nuk ka ushtruar ankesë në Kolegjin e Apelit të Gjykatës Supreme për çështje që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Pronës, që do të thotë se vendimi i lartpërmendur është bërë plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm. Në fakt, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/50, e ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079 të Republikës së Kosovës, Agjencia Kosovare e Pronës është autoriteti i vetëm përgjegjës për zgjidhjen e llojeve të caktuara të kontesteve, në të cilat përfshihet edhe kontesti konkret lëndor.

2. Megjithatë, Gjykata Supreme ka vërejtur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka disa mangësi që e bëjnë atë të pakuptueshëm dhe të paqartë, përkatësisht dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk është aspak në përputhje me arsyetimin e të njëjtit. Duke shiquar dispozitivin e aktgjykimit, Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkallës së parë e refuzon padinë dhe kërkesë padinë e paditësit si të pabazuar, por në arsyetim nuk paraqet asnjë arsye se pse padia konkrete dhe kërkesë padia është e pabazuar. Në arsyetim, gjykata e

shkallës së parë thekson vetëm se kontesti konkret tashmë është gjykuar duke u thirrur në dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23.

3. Nëse sipas qëndrimit të gjykatës së shkallës së parë kontesti konkret lëndor është gjykuar, gjykata e shkallës së parë nuk është dashur të vendos meritorisht sipas padisë dhe kërkesë padisë konkrete, por që të njëjtën ta hedh poshtë si të palejueshme.

4. Nëse qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i ndryshëm, në kuptimin që ka refuzuar si të pabazuar padinë dhe kërkesë padinë e paditësit, atëherë e njëjta ka qenë e obliguar që të në arsyetim të jep analizën e gjithë provave të paraqitura, cili nga provat e nxjerra është i rëndësisë vendimtare për vendimin përfundimtar gjyqësorë, përkatësisht të paraqesë të gjitha arsyet dhe provat konkrete se për cilën arsye paditësi nuk ka pasur sukses në kontestin konkret.

5. Duke zbatuar këtë që u parashtrua në rastin konkret, dhe duke pasur parasysh argumentimin e gjykatave të instancës më të ulët lidhur me përfundimin e pabazueshmërisë së kërkesë padisë, Gjykata Supreme konstaton se arsyetimi i vendimeve të gjykatës së shkallës më të ulët vështirë se mund të vlerësohet si i pranueshëm ligjërisht, vëren se arsyetimi i gjykatave më të ulëta vështirë se mund të vlerësohet si i pranueshëm me ligj, ngase nuk jep arsye relevante dhe bindëse për vlerësimin se kërkesë padia e paditësit është e pabazuar, një arsyetim i tillë I dhënë në aktgjykimet e kontestuara nuk përmbush standardin e të gjykuarit të drejtë në mënyrën siç kjo është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

6. Në të gjitha pyetjet e paraqitura më lartë, gjykatat e instancës më të ulët kanë lëshuar që, edhe sipas detyrës së tyre zyrtare, që të sqarojnë ose të arsyetojnë. në vendimet e tyre. Mangësitë e theksuara janë të një natyre të tillë që kërkojnë anulimin e aktgjykimeve të instancës më të ulët, pa mundur që Gjykata Supreme fare të lëshohet në verifikimin e pretendimeve tjera në revizion, si dhe në verifikimin e zbatimit të së drejtës materiale nga gjykatat e instancës më të ulët.

7. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se aktgjykimet e instancës më të ulët duhet prishur dhe lëndën ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje. Në ri procedurë me pa mëdyshje do të vërtetohen të gjitha pyetjet e parashtruara më lartë, përkatësisht faktet. Gjithashtu, do të vërtetohen edhe faktet tjera relevante, dhe mbi një gjendje të tillë të vërtetuar faktike në mënyrë të duhur do të zbatohet e drejta materiale dhe do të merret një vendim ligjor dhe i drejtë.

8. Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptimin e lartpërmendur, dhe me zbatimin e dispozitave të nenit 224 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.190/2025, datë 27.08.2025

''Shqyrtimi i pretendimeve ankimore nga ana e gjykatës ankimore – dipsozita e nenit 194, të Ligjit për procedurën ankimore.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.715/2020 i datës 24.08.2021, në pikën I të dispozitivit është miratuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, ndërsa me pikën II të dispozitivit është konstatuar se paditësit, Halil Hyseni dhe Nebih Hyseni janë bashkëpronarë me nga 5/30 pjesë ideale, ndërsa Arsim Iseni, Selvije Ukaj, Besim Isaj, Lumnije Gjemajli dhe Sabrije Rrahmani janë bashkëpronarë me nga 1/30 pjesë ideale, mbi pasuritë e paluajtshme të identifikuara si: parcela nr. 651-1, sipas kulturës tokë bujqësore e punueshme e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 3285 m², e quajtur vendi "Ledina" ZK Bibaj, parcela nr. 651-2, sipas kulturës tokë bujqësore e punueshme e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 925 m², e quajtur vendi "Ledina" ZK Bibaj, parcela nr. 651-3, sipas kulturës tokë bujqësore e punueshme e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 401 m², e quajtur vendi "Ledina" ZK Bibaj, parcela nr. 651-4, sipas kulturës tokë bujqësore e punueshme e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 415 m², e quajtur vendi "Ledina" ZK Bibaj, parcela nr. 651-5, sipas kulturës tokë bujqësore e punueshme e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 576 m², e quajtur vendi "Ledina" ZK Bibaj, parcela nr. 355-0, sipas kulturës tokë bujqësore e punueshme e klasës së 5-të, me sipërfaqe prej 538 m², e quajtur vendi "Ledina" ZK Bibaj, të cilat janë të regjistruara në emër të të paditurve Alush Tahiri, Sami Tahiri dhe Tahir Tahiri.

2. Të paditurit janë të obliguar t'u mundësojnë paditësve që të regjistrojnë të drejtën e pronësisë mbi këto parcela në regjistrin kadastral pranë komunës kadastrale kompetente, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm të këtij aktgjykimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij aktgjykimi.

3. Me pikën III të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve lidhur me pjesën ideale prej nga 6/12 në parcelat kadastrale: 651-1, 651-2, 651-3, 651-4, 651-5 dhe 355-0, për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv material të të padituve.

4. Me pikën IV të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e të padituve, me të cilën ata kanë kërkuar që paditësit Halil, Isa dhe Nebih, të gjithë Hiseni, t'ua dorëzojnë në posedim të lirë parcelat: parcela nr. 651-1, tokë bujqësore e punueshme, klasa IV, sipërfaqe 3285 m², vendi "Ledina", ZK Bibaj, parcela nr. 651-2, tokë bujqësore e punueshme, klasa IV, sipërfaqe 925 m², vendi "Ledina", ZK Bibaj, parcela nr. 651-3, tokë bujqësore e punueshme, klasa IV, sipërfaqe 401 m², vendi "Ledina", ZK Bibaj, parcela nr. 651-4, tokë bujqësore e punueshme, klasa IV, sipërfaqe 415 m², vendi "Ledina", ZK Bibaj, parcela nr. 651-5, tokë bujqësore e punueshme, klasa IV, sipërfaqe 576 m², vendi "Ledina", ZK Bibaj, parcela nr. 355-0, tokë bujqësore e punueshme, klasa V, sipërfaqe 538 m², vendi "Ledina", ZK Bibaj, të cilat janë të regjistruara në emër të paditësit Halil Hyseni, në pjesën prej nga 6/12.

5. Me pikën V të dispozitivit, të padituri janë të obliguar që t'u kompensojnë paditësve shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 4,305.80 €, brenda 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

6. Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, është paraqitur ankesë nga përfaqësuesi i autorizuar i të padituve, përkatësisht kundërpaditësve, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktgjykimin Gž.nr.8155/2021 të datës 15.10.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paraqitur, duke konfirmuar aktgjykimin e shkallës së parë.

7. Kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, brenda afatit ligjor, është paraqitur revizion nga përfaqësuesi i autorizuar i të padituve, përkatësisht kundërpaditësve, për shkak të

zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim si në revizion.

8. Në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë parashtresë me shkrim, përkatësisht përgjigje ndaj revizionit, e paraqitur nga pala kundërshtare.

9. Në shkresat e lëndës ekziston një parashtresë me shkrim e paraqitur nga i padituri, përkatësisht kundërpaditësi Tahir Tahiri, në të cilën ai deklaron se e ka tërhequr autorizimin e dhënë avokatëve dhe se heq dorë nga e drejta për paraqitjen e revizionit.

10. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve të revizionit, në kuptim të dispozitës së nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), ka konstatuar se:

    Revizioni është i pabazuar.

11. Sipas të dhënave nga shkresat e lëndës, konstatohet gjendja faktike si vijon:

a. Paditësit, përkatësisht kundërpaditësit, më 23.02.2009 kanë paraqitur padi kundër të paditurve, përkatësisht kundërpaditësve, për konstatimin e së drejtës së pronësisë.
b. Të padituri e kanë kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve dhe gjatë zhvillimit të procedurës kanë paraqitur kundër kërkesëpadi, të cilën e kanë precizuar disa herë.
c. Gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën, ka caktuar ekspertizë nga eksperti i fushës gjeodezike, ka dëgjuar palët dhe dëshmitarët e propozuar dhe në fund ka marrë vendimin në mënyrën e përshkruar më sipër.
d. Në arsyetim ndër të tjera është theksuar se të padituri kanë qenë të vetëdijshëm dhe e kanë ditur se është kryer shkëmbimi i pasurisë midis familjes së tyre dhe familjes Hyseni, dhe se ata kanë disponuar lirshëm me pasurinë që kanë marrë nga familja Hyseni që para 45 vjetësh, përmes shkëmbimit.

e. Pretendimet e tyre se u është mohuar e drejta e trashëgimit të pasurisë së babait janë të pabazuara, meqenëse si pasuri të babait ata kanë marrë një pjesë të pasurisë që familja Tahiri e kishte fituar përmes shkëmbimit me familjen Hyseni, kështu që të paditurit nuk mund të kenë të drejtë mbi pasurinë që familja Hyseni posedon dhe shfrytëzon prej më shumë se 40 vjetësh, në bazë të marrëveshjes për shkëmbim të pasurisë së paluajtshme.

12. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar faktin se paditësit i kanë poseduar parcelat kadastrale kontestuese me mirëbesim dhe mirëkuptim për më shumë se 20 vjet; ky fakt ka qenë i njohur përgjithësisht në fshatin Bibaj dhe në rrethin shoqëror të palëve në kontest, madje edhe nga vetë palët në procedurë, duke pasur parasysh se paditësit i kanë përdorur parcelat kadastrale kontestuese si të tyret, ndërsa të paditurit i kanë përdorur dhe kanë disponuar parcelat kadastrale nr. 142-0 dhe 193-0, të cilat kanë qenë objekt i shkëmbimit.

13. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar faktin se paditësit e kanë poseduar në mënyrë efektive pasurinë për më shumë se 40 vjet, dhe se pronari apo trashëgimtarët e tij ligjorë nuk i kanë shqetësuar kurrë pas kësaj periudhe; prandaj paditësit, me mirëbesim, kanë ushtruar posedimin mbi pasurinë kontestuese, gjë që është plotësisht në përputhje me dispozitën e nenit 28 paragrafi 4 të Ligjit për Marrëdhëniet themelore juridiko-pronësore (Ligji nr. 60/80), si dhe me nenin 40, paragrafi 1 të Ligjit përp ronësinë dhe të drejtat e tjera sendore.

14. Duke vepruar mbi ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të të paditurve, përkatësisht kundërpaditësve, në procedurë, gjykata e shkallës së dytë e ka refuzuar ankesën si të pabazuar, duke konfirmuar aktgjykimin e shkallës së parë në mënyrën e përshkruar më sipër.

15. Në arsyetimin e aktgjykimit, gjykata e shkallës së dytë ka theksuar se pretendimet e të paditurve, përkatësisht kundërpaditësve, janë të pabazuara, sepse është konstatuar drejt fakti vendimtar se në vitet 1964/1965, familjet Hyseni dhe Tahiri i kanë shkëmbyer pasuritë e

paluajtshme kontestuese dhe menjëherë kanë hyrë në posedimin e pasurive të shkëmbyera, duke i shfrytëzuar ato për më shumë se 50 vjet.

16. Etërit, përkatësisht paraardhësit juridikë të palëve në procedurë, i kanë shkëmbyer pasuritë në fjalë, mbi të cilat fillimisht kanë qenë të ndërtuara dy shtëpi që më pas janë rrënuar, ndërsa paditësit, përkatësisht kundërpaditësit, kanë ndërtuar gjashtë shtëpi të tjera dhe gjashtë puse në parcelat kontestuese.

17. Paditësit, përkatësisht kundërpaditësit, i kanë shfrytëzuar pasuritë e paluajtshme kontestuese që nga viti 1965, duke ndërtuar shtëpitë e tyre mbi to, ndërsa të padituri, përkatësisht kundërpaditësit, kurrë nuk kanë paraqitur ndonjë kërkesë për kthimin e pasurisë deri në momentin e paraqitjes së përgjigjes ndaj padisë.

18. Sipas mendimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejt faktin, në bazë të ekspertizës gjeodezike, të dhënave nga librat e parë kadastralë të vitit 1964, si dhe të Historikut të parcelave të lëshuar nga Drejtoria për Pasuri, Kadastra dhe Gjeodezi, nr. 96888/20, datë 11.11.2020, se nga të dhënat kadastrale të viteve 1983–1988, pronarët e ligjshëm të pasurive të paluajtshme kontestuese 355-0 dhe 651-0 ZK Bibaj ishin:

    Daut Tahiri me nga 6/12 pjesë ideale, Milikija Musliju Tahiri me nga 2/12 pjesë ideale, Alush (Musli) Tahiri me nga 2/12 pjesë ideale dhe Tahir (Musli) Tahiri me nga 2/12 pjesë ideale.

19. Eksperti i fushës së gjeodezisë ka konstatuar se në vitin 2009 është lidhur Kontratë për shkëmbim, e vërtetuar nga Gjykata Komunale në Ferizaj, Vr.nr.6394/09, ndërmjet Tahir/Daut/Idriz dhe Hysen/Halil/Ibrahimi, nga e cila rezulton se pjesa ideale prej 6/12 e pasurisë së paluajtshme kontestuese 355-0 dhe 651-0 ZK Bibaj, nga Tahir/Daut/Idriz, transferohet tek Hysen/Halil/Ibrahimi, ndërsa pjesa ideale prej 1/2 e parcelave kontestuese nr. 142-0 dhe 193-0, nga Hysen/Halil/Ibrahimi, transferohet tek Tahir/Daut/Idriz.

20. Sipas mendimit të gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejt, në bazë të këtij konstatimi të ekspertit gjeodet, se paditësit, përkatësisht kundërpaditësit, i kanë shfrytëzuar në mënyrë të pandërprerë parcelat kadastrale kontestuese që nga viti 1965 e deri më sot.

21. Sipas qëndrimit të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të bazuara pretendimet ankimore të të padituve, përkatësisht të kundërpaditësve, se në rastin konkret posedimi i paditësve, përkatësisht i kundërpaditësve, ka qenë në keqbesim. Nuk është fakt i kontestuar se të padituit, përkatësisht kundërpaditësit, janë të evidentuar si pronarë të ligjshëm të pasurisë së kontestuar, mirëpo ata nuk kanë qenë posedues të kësaj pasurie për më shumë se 50 vjet.

22. Me asnjë provë materiale të padituit, përkatësisht kundërpaditësit, nuk kanë dëshmuar se brenda afatit prej 20 vjetësh nga dita e marrjes në posedim nga ana e paditësve, përkatësisht kundërpaditësve, është paraqitur ndonjë padi për lirimin e pasurisë ose për pengimin e posedimit, kundër poseduesve aktualë. Për rrjedhojë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në mënyrë bindëse rezulton se të padituit, përkatësisht kundërpaditësit, lidhur me pasurinë e kontestuar, nga viti 1965 e deri në momentin e paraqitjes së kundërpadisë, kanë qenë pasivë ndaj poseduesve të saj.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Në këto rrethana faktike, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182, paragrafi II, pika n), pasi të njëjtat përmbajnë mangësi që i bëjnë ato të pakuptueshme; dispozitivi i tyre nuk është në përputhje me arsyetimin mbi faktet thelbësore të dhëna në aktgjykim, ndërsa arsyet për faktet thelbësore nuk janë në lidhje logjike me provat e administruara. Këto mangësi e pengojnë verifikimin e rregullsisë së zbatimit të së drejtës materiale nga gjykatat e shkallëve më të ulëta.

2. Me shqyrtimin e plotë të shkresave të lëndës, Gjykata Supreme konstaton se objekti i kontestit konkret sipas padisë së paraqitur nga paditësit, përkatësisht kundërpaditësit, është: vërtetimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelat kadastrale të kontestuara, çka e kanë konstatuar edhe gjykatat e shkallëve më të ulëta, si dhe lirimi i pasurisë.

3. Megjithatë, Gjykata Supreme konstaton se sipas kundërpadisë së paraqitur nga të padituri, përkatësisht kundërpaditësve: sipas parashtresës me shkrim të datës 19.02.2013, objekti i kontestit është: vërtetimi i së drejtës së bashkëpronësisë prej 1/12 secili mbi parcelat kadastrale të kontestuara; sipas parashtresës së precizuar me shkrim të datës 17.09.2014, objekti i kontestit është gjithashtu lirimi i pasurisë së kontestuar, e cila është uzurpuar nga Halil, Isa dhe Nebih Hyseni; ndërsa sipas precizimit verbal të dhënë në seancën e mbajtur më 05.03.2021, objekti i kontestit është edhe anulimi i kontratës nr. Vr.6394/2009 për shkak të shkeljes së të drejtës së përparësisë në blerje.

4. Gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e saj, në pikën IV të dispozitivit, ka refuzuar si të pabazuar kundër kërkesëpadinë e të paditurve, përkatësisht të kundërpaditësve, e cila kishte të bënte me lirimin e pasurisë së kontestuar, e cila ishte uzurpuar nga Halil, Isa dhe Nebih Hyseni. Në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë nuk ekziston asnjë fjali që lidhet me pikën IV të dispozitivit, kështu që mbetet e paqartë se për çfarë arsye kjo pjesë e veçantë e kundër kërkesëpadisë së të paditurve, përkatësisht të kundërpaditësve, është refuzuar si e pabazuar. Gjykata e shkallës së dytë, gjithashtu, në asnjë fjali të arsyetimit nuk e përmend këtë kundër kërkesëpadi të të paditurve, përkatësisht të kundërpaditësve.

5. Të paditurit, përkatësisht kundërpaditësit, në përputhje me dispozitat e nenit 256 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, kanë paraqitur kundërpadi, të cilën e kanë precizuar disa herë gjatë procedurës.

6. Me dispozitën e nenit 143, paragrafi 1, të ligjit të lartpërmendur është paraparë se gjykata me aktgjykim vendos për kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore, si dhe për kërkesat dytësore.

7. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata Supreme konstaton se gjykatat e shkallëve më të ulëta fare nuk janë marrë me kërkesat konkrete të parashtruara nga të padituri, përkatësisht kundërpaditësit në kundërpadi.

8. Në revizionin e paraqitur, revizioni atakon aktgjykimet e shkallëve më të ulëta, veçanërisht aktgjykimin e shkallës së dytë, duke theksuar se Gjykata e Apelit nuk është marrë fare me pretendimet e paraqitura në ankesë. Revizioni i paraqet në mënyrë taksative, përkatësisht i përsërit të gjitha pretendimet konkrete që ishin theksuar në ankesën e paraqitur, me të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk është marrë aspak, as nuk i ka arsyetuar.

9. Dispozita e nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton se gjykata e shkallës së dytë shqyrton aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën kontestohet me ankesë, dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të paraqitura në ankesë, duke kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika: b), g), j), k) dhe m) të ligjit të lartpërmendur.

10. Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuara pretendimet e revizionit, ngase me shqyrtimin e plotë të shkresave të lëndës, si dhe të ankesës së paraqitur dhe revizionit, konstaton se arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së dytë vështirë se mund të vlerësohet si i pranueshëm ligjërisht, ngase nuk jep arsye relevante dhe bindëse për të vlerësuar se kërkesëpadia e paditësve, përkatësisht e kundërpaditësve, është e bazuar. Një arsyetim i tillë i aktgjykimit të kontestuar nuk e plotëson standardin e gjykimit të drejtë, ashtu siç është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

11. Për të gjitha çështjet e sipërpërmendura, gjykata e shkallës së dytë ka dështuar të shprehet edhe sipas detyrës zyrtare ose të japë arsyetim në aktgjykimin e saj. Mangësitë e theksuara janë të natyrës së tillë që kërkojnë anulimin e aktgjykimeve të shkallëve më të ulëta, pa pasur nevojë që Gjykata Supreme të hyjë fare në shqyrtimin e pretendimeve të tjera të revizionit dhe në kontrollin e rregullsisë së zbatimit të së drejtës materiale nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

12. Për këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se aktgjykimet e shkallëve më të ulëta duhen anuluar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së dytë për përsësritje të procedurës dhe vendimmarrjes. Në procedurën e përsëritur, do të përcaktohen në mënyrë të padiskutueshme të gjitha çështjet dhe faktet e lartpërmendura. Gjithashtu, do të përcaktohen edhe faktet e tjera thelbësore, dhe mbi gjendjen faktike të tillë të konstatuar do të zbatohet drejt e drejta materiale përkatëse dhe do të merret një vendim ligjor dhe i drejtë.

13. Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të sa më sipër dhe me zbatimin e nenit 224, paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vendosur ashtu siç është shënuar në dispozitiv.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
E.Rev.Nr.50/2025, datë 18.12.2024

''Anulimi i kontratës – dispozitat e neneve: 103, paragrafi 1, 109, paragrafët 1 dhe 2 dhe 110 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr.29/1078)''.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Kolegji i Shkallës së Parë KP.nr.139/2022 të datës 08.10.2024, në pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar padia e paditësve me të cilën është kërkuar që të shpallet nule Kontrata e Kredisë nr. 043/05 e datës 31.01.2005, për shkak se kontrata është lidhur në kundërshtim me rendin juridik dhe normat imperative, pastaj të shpallet si nule Vendimi i Gjykatës Komunale në Klinë për lejimin e intabulimit nr. 14/2005-int nr. 6/2005, për shkak se kontrata është lidhur në kundërshtim me rendin juridik dhe normat imperative, të shpallet nule Kontrata për sigurim përkatësisht kolaterali e datës 31.01.2005, për arsye se kontrata është lidhur në kundërshtim me rendin juridik dhe normat imperative. Të vërtetohet pronësia e paditësit Luigj Ademi mbi parcelën kadastrale nr. 98, 99, nr. 71011021, e cila është identifikuar në bazë të fletës poseduese nr. 151, në vendin e quajtur Bregu, Poterq i Epërm, komuna Klinë, sipas kulturës: tokë bujqësore në sipërfaqe prej 0.48.66 hektarë. Të obligohet e paditura që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij aktgjykimi ta regjistrojë pronësinë në emër të paditësit Luigj Ademi. Në rast se kërkesa nga pika V e këtij aktgjykimi refuzohet, të obligohet e paditura që paditësve t'ua paguajë shumën prej 867.630,00 euro, së bashku me kamatën ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën përfundimtare, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

2. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i bartë vetë shpenzimet e procedurës.

3. Duke vepruar sipas ankesës së paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar i paditësve, Gjykata Komerciale e Kosovës, Kolegji i Shkallës së Dytë,

me aktgjykimin e saj K.DH.SH.II.nr.2290/2024 të datës 05.06.2025, e ka refuzuar të njëjtën dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

4. Të pakënaqur me vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta, përfaqësuesi i autorizuar i paditësve ka paraqitur me kohë revizion ndaj aktgjykimit të plotfuqishëm të shkallës së dytë, për arsye të cekura në të njëjtin dhe me propozim si në të njëjtin.
   Në shkresat e lëndës ekziston edhe parashtresa me shkrim, respektivisht përgjigjja në revizion e paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar i të padituërës.

5. Gjykata Supreme e Kosovës e ka shqyrtuar aktgjykimin e kontestuar në raport me pretendimet revizionale dhe në kuptim të nenit 215 të Ligjit për procedurën kontestimore (Ligji nr.03/L-006), ka vlerësuar se revizioni i përfaqësuesit të autorizuar të paditësve është i pabazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes përfaqësuesit të tyre, më datë 15.10.2018 kanë parashtruar padi për anulimin e kontratës dhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë, së bashku me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, kundër të padituërës. Në padi, si dhe në seancat e mbajtura gjyqësore, kanë deklaruar se më datë 31.01.2005 është lidhur Kontrata e kredisë nr. 043/05 ndërmjet paditësit të parë, si huamarrës, dhe të padituërës, si huadhënëse, dhe se kontrata në fjalë është lidhur si rezultat i veprimeve kriminale të zyrtarëve të lartë të atëhershëm të të padituërës, të cilët tani janë të dyshuar, përkatësisht ndaj tyre është ngritur aktakuzë nga Prokuroria Speciale për shkak të dyshimit të bazuar se kanë ndërmarrë veprime të kundërligjshme, duke keqpërdorur autorizimet e tyre në ekonomi, me qëllim të përfitimit material.

7. Paditësit, në cilësinë e huamarrësve, nuk kanë përfituar nga shuma e paguar e kredisë, ngase shuma e kredisë ka qenë 500.000,00 euro, mirëpo paditësit kanë marrë vetëm shumën prej 80.000,00 euro, ndërsa shumën prej 420.000,00 euro e kanë marrë zyrtarët e lartë të atëhershëm të të padituërës, ndaj të cilëve aktualisht po zhvillohet procedurë penale për mashtrim dhe keqpërdorim të kredisë. Për këtë

arsye, kontrata kontestuese nuk është vetëm nule, por edhe fiktive, mirëpo, pavarësisht këtij fakti, e paditura ka iniciuar procedurë përmbarimore dhe ka realizuar kërkesën e saj përmes pasurisë hipotekare të paditësit të dytë, duke u pasuruar pa bazë në dëm të paditësve. Kanë theksuar se paditësi i dytë është dëmtuar nga kontrata e përmendur, si dhe nga Kontrata e hipotekës, ngase me pasurinë e tij të paluajtshme ka garantuar përmbushjen e shumës së kredisë së paguar në vlerë prej 8.000.000,00 euro, në bazë të Vendimit të Gjykatës Komunale në Klinë për regjistrimin e hipotekës të datës 01.02.2005, me shënimin nr.14/2005 dhe nr.6/2005. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve, gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore, përmes parashtresës me shkrim në seancën e mbajtur më datë 24.04.2023, ka bërë precizimin e padisë dhe kërkesëpadisë në mënyrën e cekur më lart.

8. E paditura e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë të paditësve dhe ka kërkuar nga gjykata që të njëjtat t'i refuzojë si të pabazuara. Përfaqësuesi i autorizuar i të padituës ka deklaruar se mënyra e shfrytëzimit të mjeteve financiare nga llogaria bankare e paditësit të parë është çështje e paditësit të parë, ndërsa nëse ka pasur keqpërdorim ose shfrytëzim të paautorizuar të këtyre mjeteve, kjo është çështje për gjykatën penale dhe përbën vepër penale. Kjo do të thotë se nëse paditësit janë mashtruar, ata mund të ndjekin penalisht personat që pretendohen të jenë përgjegjës për mashtrimin, por kjo çështje nuk mund të zgjidhet në procedurën kontestimore civile. Ai ka theksuar se në procedurën penale me nr: PKR.nr.569/17 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda, pala e dëmtuar është e paditura, jo paditësit, dhe se kjo procedurë penale nuk është përfunduar në mënyrë të plotfuqishme. Sa i përket kontratave kontestuese për të cilat paditësit e kërkojnë anulimin, sipas mendimit të përfaqësuesit të të padituës, Kontrata e kredisë është plotësisht e ligjshme dhe për këtë kontratë ekziston bazë ligjore relevante, po ashtu edhe Kontrata e hipotekës dhe Vendimi për regjistrimin e hipotekës. Këto kontrata në procedurën përmbarimore janë vlerësuar si tërësisht të ligjshme dhe shërbejnë si tituj ekzekutivë në të gjitha shkallët gjyqësore. Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Klinë, në procedurën përmbarimore ka

refuzuar ankesën e palës së tretë lidhur me shfuqizimin e Kontratës së hipotekës, ndërsa Gjykata e Apelit, duke shqyrtuar ankesën, e ka refuzuar atë si të pabazuar dhe ka konfirmuar vendimin e shkallës së parë. Bazuar në këto vendime është konfirmuar përmbarimi për pasurinë e paluajtshme, të cilin e ka lejuar dhe përcaktuar përmbaruesi privat. Gjykatat e përmendura kanë kryer vlerësimin e ligjshmërisë së dokumenteve që kanë shërbyer si dokumente/tituj ekzekutivë dhe nuk kanë konstatuar shkelje të ndonjë dispozite të procedurës përmbarimore. Përfaqësuesi i të padituruës ka shtuar se është propozim absurd ai i paditësve për vlerësimin e pronës që është shitur në procedurën e përmbarimit gjyqësor, ku shitja dhe vlera e asaj prone janë përcaktuar fillimisht me dokumente relevante dhe kontratën e hipotekës, vlerë kjo që është pranuar nga vetë kreditori hipotekar, e cila vlerë është përdorur në procedurën e përmbarimit dhe është transferuar sipas rregullave të procedurës përmbarimit bazuar në vlerësimin që kanë pranuar palët në procedurë.

9. Gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar tërë procedurën, ka marrë në shqyrtim të gjitha provat të shkruara të propozuara, ka dëgjuar palët në procedurë, dhe pas kësaj ka e ka nxjerrë aktgjykimin në mënyrën e përshkruar më sipër. Gjykata u mbështet në dispozitën e nenit 17 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton detyrimet e palëve në marrëdhëniet e detyrimeve, si dhe në dispozitën e nenit 1065 të këtij ligji, që parashikon se me kontratën e kredisë, banka angazhohet që t'i vërë në dispozicion përdoruesit të kredisë një shumë të caktuar parash për një periudhë të caktuar apo të pacaktuar, për një qëllim të caktuar ose pa qëllim të caktuar, ndërsa përdoruesi është i detyruar që t'i paguajë bankës interesin e kontraktuar dhe t'i kthejë shumën e marrë në kohën dhe në mënyrën e përcaktuar me kontratë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se huadhënësi, pra e paditura, ka lejuar dhënien e shumës së parave në bazë të detyrimeve kontraktuale, ndërsa huamarrësi, pra paditësi i parë, nuk ka përmbushur detyrimin për kthimin e kredisë brenda afatit të paraparë dhe për interesin e kontraktuar. Duke qenë se huamarrësit, pra paditësit, nuk i kanë përmbushur detyrimet e marra, huadhënësi, pra e paditura, ka iniciuar procedurën e përmbarimit dhe ka realizuar

kërkesën e saj në bazë të hipotekës. Gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar gjithashtu dispozitën e nenit 111 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, e cila përcakton në cilat situata një kontratë është nule, gjë që nuk është rasti në këtë çështje konkrete, sepse palët kanë lidhur me dëshirë kontratën e kredisë dhe kontratën e hipotekës, kanë pasur kapacitet të plotë për të lidhur marrëveshjet në fjalë dhe nuk është vërtetuar që kontratat e kundërshtuara janë lidhur nën kërcënim, mashtrim ose ndonjë formë tjetër që konsiderohet kontratë nule ose e rrëzuar. Gjykata e shkallës së parë u mbështet edhe në dispozitën e nenit 321, paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që përcakton se nuk ka nevojë për të provuar fakte të njohura publikisht ose fakte që gjykata i ka vërtetuar në gjykime të mëparshme, dhe theksoi se duke mos u plotësuar kushtet për shfuqizimin ose anulimin e veprimeve juridike sipas padisë, gjykata e shkallës së parë nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë e kontratave që janë vlerësuar tashmë si plotësisht ligjore dhe që kanë shërbyer si tituj ekzekutivë në të gjitha shkallët e gjykatave, dhe mbi bazën e tyre është konfirmuar përmbarimi mbi pronën e paluajtshme i cili është lejuar dhe caktuar nga përmbaruesi privat. Në fund, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se, meqenëse kërkesa për **anulimin e** kontratës nuk është aprovuar, përkatësisht ajo pjesë e kërkesëpadisë është refuzuar si e pabazuar, atëherë është refuzuar edhe pjesa e kërkesëpadisë që ka të bëjë me **konstatimin e të drejtës pronësore**, pasi nuk është përmbushur asnjë nga kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 36, paragrafi 1, të Ligjit nr. 03/L-154 për pronën dhe të drejtat tjera sendore, me të cilin është përcaktuar se, për kalimin e pronësisë për pasuritë e paluajtshme, kërkohet akt juridik i vlefshëm ndërmjet bartësit dhe përfituesit si bazë juridike, si dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në Regjistrin e të Drejtave mbi Pasuritë e Paluajtshme. Në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi i dytë ka qenë pronar i pasurisë së paluajtshme kontestuese, mirëpo, mbi bazën e një akti juridik të vlefshëm, i cili është vërtetuar gjatë procedurës përmbarimore nga të gjitha instancat gjyqësore, e njëjta pasuri ka kaluar në pronësi të të padituës. Sa i përket pjesës së kërkesëpadisë që ka të bëjë me kompensimin e dëmit mbi bazën **e pasurimit pa bazë juridike**, gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar

si të pabazuar, duke vlerësuar se për të ekzistuar pasurimi i pabazë juridikisht, duhet të jenë përmbushur këto kushte kumulative: rritje e pasurisë (pasurim) në anën e një pale; varfërim apo zvogëlim i pasurisë së palës tjetër; dhe që pasurimi të ketë ndodhur pa ndonjë bazë juridike. Mirëpo, nga faktet e konstatuara, rezulton se e paditura, mbi bazën e një marrëveshjeje të vlefshme juridike (që përbën bazë juridike), pasi paditësit nuk e kanë përmbushur obligimin e marrë përsipër, ka iniciuar procedurën përmbarimore dhe ka realizuar kërkesën e saj duke u kompensuar nga objekti i hipotekës. Në fund, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka refuzuar propozimin për dëgjimin në cilësinë e dëshmitarëve të paditësit të dytë si dhe të një numri të caktuar të dëshmitarëve tjerë, për shkak se të njëjtit tashmë janë dëgjuar në procedurën penale dhe deklaratat e tyre të dhëna në atë rast janë proceduar si prova në këtë procedurë kontestimore.

10. Duke trajtuar sipas ankesës së parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i paditësve, gjykata e shkallës së dytë e ka refuzuar të njëjtën si të pabazuar, duke e **konfirmuar aktgjykimin e shkallës së parë**, ndërsa në arsyetim ka përsëritur qëndrimet e gjykatës së shkallës së parë, duke shtuar se kjo gjykatë ka konstatuar në tërësi gjendjen e saktë faktike dhe mbi të njëjtën ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale përkatëse.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar, Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë zbatuar drejt të drejtën materiale dhe kanë vepruar në mënyrë të rregullt kur kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar.

   Gjykata Supreme konstaton se objekti i kontestit konkret është:

   - kërkesa për shpalljen si të pavlefshme (nule) e Kontratës së Kredisë nr. 043/05 të datës 31.01.2005, pastaj të Vendimit të Gjykatës Komunale në Klinë për lejimin e intabulimit nr. 14/2005-int nr. 6/2005, si dhe të Kontratës së Sigurimit, përkatësisht kolateralit të datës 31.01.2005, me arsyetimin se sipas qëndrimit të paditësve,

kontratat e sipërcekura janë lidhur në kundërshtim me rendin juridik dhe normat imperative.

- Të konfirmohet pronësia e paditësit të dytë, Luigj Ademi, për parcelën kadastrale nr. 98.99, nr. 71011021, e identifikuar bazuar në listën poseduese nr. 151, në vendin e quajtur Bregu, Poteriq i Epërm, komuna e Klinës, sipas kulturës: tokë e punueshme me sipërfaqe prej 0.48.66 hektarë, dhe të detyrohet e paditura që të pranojë regjistrimin e pronësisë në emër të paditësit të dytë, Luigj Ademi.

- Në rast se kërkesat e mësipërme refuzohen nga gjykata, atëherë e paditura të detyrohet që paditësve t'u paguajë shumën prej 867,630.00 euro, së bashku me kamatën ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatë, si dëmshpërblim për pasurim të pabazuar.

2. Gjykata Supreme thekson se për sigurimin e mbrojtjes gjyqësore në rastin konkret zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 29/1978), si dhe dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr. 6/1980).

3. Dispozita e nenit 103 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve parashikon se kontrata që është në kundërshtim me dispozitat detyruese, me rendin publik apo me zakonet e mira është nule, nëse qëllimi i normës së shkelur nuk nënkupton ndonjë sanksion tjetër ose nëse ligji në rastin konkret nuk parashikon ndryshe. Dispozitat e nenit 109 paragrafët 1 dhe 2 të të njëjtit ligj parashikojnë se nulitetin gjykata e shqyrton sipas detyrës zyrtare dhe për të mund të parashtrojë kërkesë çdo person i interesuar. E drejta që të kërkojë konstatimin e nulitetit i takon edhe prokurorit publik. Ndërsa dispozita e nenit 110 të po të njëjtit ligj parashikon që e drejta për të parashtruar nulitetin nuk shuhet.

4. Duke pasur parasysh këto nene të ligjit përkatës, si dhe të gjithë shkresat e lëndës, Gjykata Supreme vlerëson se Kontrata kontestuese e kredisë, Vendimi kontestues për lejen e intabulimit, si dhe Kontrata kontestuese për sigurim (kolateral), janë të përbëra dhe të lidhura në

përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe me të gjitha ligjet relevante që kanë qenë në fuqi në atë kohë. Gjykata Supreme i refuzon si të pabazuara pretendimet konkrete të ankesës së rishikimit që lidhen me ligjshmërinë e kontratave të lartpërmendura. Andaj, Gjykata Supreme pranon tërësisht qëndrimin e gjykatave në shkallë të ulët lidhur me ligjshmërinë e dokumenteve kontestuese, të cilat kanë vlerësuar se gjykata nuk mund të rishikojë ligjshmërinë e kontratave që tashmë janë konsideruar plotësisht ligjore dhe që kanë shërbyer si tituj ekzekutivë në të gjitha nivelet gjyqësore dhe mbi bazën e të cilave është konfirmuar përmbarimi mbi pasurinë e paluajtshme, përmbarimi i cili është lejuar dhe urdhëruar nga përmbaruesi privat. Gjykata Supreme shton se ligjshmëria e dokumenteve kontestuese është shqyrtuar përmes kundërshtimeve dhe ankesave në të gjitha fazat e procedurës përmbarimore, e cila është zhvilluar me respekt të plotë të dispozitave të neneve të Ligjit të cilat ishih atëherë në fuqi për procedurë përmbarimore, si dhe të Ligjit për procedurën kontestimore, me një gjendje faktike të saktë dhe të rregullt dhe me aplikim të drejtë të së drejtës materiale; kjo procedurë përmbarimore ka përfunduar me vendim gjyqësor të plotfuqishëm.

5. Dispozita e nenit 20 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike - pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 6/1980), parashikon se e drejta e pronësisë fitohet në bazë të vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe trashëgimisë.

6. Me dispozitën e nenit 33 të ligjit të lartpërmendur është përcaktuar se në bazë të veprimit juridik, e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrim në librat publike përkatëse apo në mënyrë tjetër të përcaktuar me ligj.

7. Dispozita e nenit 63 të po të njëjtit ligj parashikon se, për sigurimin e një kërkese të caktuar, pasuria e paluajtshme mund të ngarkohet me të drejtën e hipotekës në dobi të kreditorit, i cili, në mënyrën e paraparë me ligj, është i autorizuar të kërkojë plotësimin e kërkesës së tij nga vlera e asaj pasurie, përpara kreditorëve të tjerë që nuk kanë hipotekë mbi të, si dhe përpara atyre që kanë fituar hipotekën më vonë, pa marrë

parasysh ndryshimin e pronarit të pasurisë së paluajtshme të ngarkuar. Hipoteka përfshin të gjithë pasurinë e paluajtshme, frytet e saj përderisa janë të pandara, si dhe pjesët përbërëse dhe pasuritë përcjellëse të saj. Për sigurimin e një kërkese të vetme, hipoteka mund të vendoset mbi më shumë pasuri të paluajtshme (hipotekë e përbashkët). Pasuria e paluajtshme e hipotekuar siguron në tërësi kërkesën e kreditorit deri në shlyerjen e plotë të saj, pavarësisht ndarjes së mëvonshme të pasurisë (pandashmëria e hipotekës).

8. Me dispozitën e nenit 64 të ligjit të lartpërmendur është paraparë se, në bazë të një akti juridik apo aktgjykimi gjyqësor, hipoteka fitohet me regjistrim në librin publik përkatës ose në mënyrë tjetër të përcaktuar me ligj. Në bazë të ligjit, hipoteka fitohet në momentin kur plotësohen kushtet e përcaktuara me ligj.

9. Duke pasur parasysh dispozitat e cituara të Ligjit mbi bazat e marrëdhënieve pronësore-juridike (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 6/1980), si dhe të gjithë shkresat e lëndës, Gjykata Supreme vlerëson se është i pabazuar pretendimi në kërkesën për rishikim, i cili ka të bëjë me pjesën e kërkesëpadisë të paditësit të dytë, përmes së cilës kërkohet të vërtetohet e drejta e tij pronësore për parcelat kadastrale nr. 98/99, nr. 71011021, të identifikuara në bazë të fletës poseduese nr. 151, në vendin e quajtur Bregu, Poteriq i Epërm, Komuna e Klinës, me kulturë: tokë bujqësore në sipërfaqe prej 0.48.66 hektarë.

10. Gjykatat e shkallëve më të ulëta me të drejtë e kanë refuzuar si të pabazuar këtë pjesë të kërkesëpadisë të paditësit të dytë, ngase ky i fundit e ka themeluar hipotekën si pronar i pasurisë së paluajtshme në fjalë, përkatësisht ai e ka ngarkuar pasurinë e tij të paluajtshme për sigurimin e borxhit të paditësit të parë.

11. Paditësi i parë ka lidhur me të padituren Kontratë Kredie, e cila paraqet akt juridik të vlefshëm dhe që përbën bazë ligjore për themelimin e hipotekës. Në kohën e themelimit të hipotekës, pasuria e paluajtshme kontestuese ka qenë në pronësi ekskluzive të paditësit të dytë, dhe i njëjti e ka ngarkuar atë me hipotekë në mënyrë të vlefshme juridikisht.

12. Paditësit të dytë nuk i është kërkuar pëlqimi i asnjë anëtari të familjes, përfshirë as bashkëshortin/bashkëshorten, ngase nuk është dëshmuar me asnjë provë se pasuria në fjalë ka përbërë pronë të përbashkët.

13. Revidenti në kërkesën për rishikim pretendon se pasuria kontestuese paraqet pronë të përbashkët martesore, dhe se për themelimin e hipotekës është dashur pëlqimi i bashkëshortes. Mirëpo, gjatë gjithë zhvillimit të procedurës përmbarimore, si dhe gjatë procedurës para gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, revidenti nuk ka parashtruar e as përmendur ndonjëherë se pasuria në fjalë ka qenë në bashkëpronësi, dhe gjithashtu nuk ka dorëzuar asnjë provë për të mbështetur këto pretendime të ngritura në rishikim.

14. Për këto arsye, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës e ka refuzuar si të pabazuar këtë pretendim konkret të kërkesës për rishikim.

15. Dispozita e nenit 210, paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 29/1978), përcakton se kur një pjesë e pasurisë së një personi kalon në pasurinë e ndonjë personi tjetër në çfarëdo mënyre, dhe ky kalim nuk ka bazë në ndonjë akt juridik apo në ligj, përfituesi është i detyruar ta kthejë atë, e kur kjo nuk është e mundur, ta kompensojë vlerën e përfitimeve të realizuara.

16. Duke pasur parasysh dispozitën e cituar të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe të gjithë shkresat e lëndës, Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e shkallëve më të ulëta me të drejtë kanë konstatuar se është i pabazuar ajo e pjesë e kërkesë padisë të paditësve, përmes së cilës është kërkuar që, në rast se pjesët e përmendura të kërkesë padisë refuzohen nga gjykata, atëherë e paditura të obligohet t'u kompensojë paditësve shumën prej 867.630,00 eurosh, bashkë me interesin ligjor prej 8%, që do të llogaritet nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatë, si kompensim dëmi për pasurim të pabazë.

17. Gjykata Supreme e refuzon si të pabazuar këtë pretendim konkret në kërkesën për rishikim dhe në tërësi e pranon qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta, të cilat kanë konstatuar se e paditura, në bazë të një marrëveshjeje të vlefshme juridike (që përbën bazë juridike), ka iniciuar procedurën përmbarimore dhe ka realizuar kërkesën e saj përmes hipotekës, për shkak se paditësit nuk i kanë përmbushur obligimet e marra përsipër.

18. Kjo nënkupton se nuk ekziston pasurim i pabazë në anën e të padituërës, ngase e njëjta e ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të një marrëveshjeje të vlefshme, e cila përmban edhe bazën juridike.

19. Revidenti, në kërkesën e parashtruar për rishikim, i kanë përsëritur pretendimet ankimore, të cilat janë vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykatat e shkallëve më të ulëta.

20. Gjykata Supreme ka shqyrtuar edhe të gjitha pretendimet e tjera të parashtruara në kërkesën për rishikim, mirëpo të njëjtat nuk kanë qenë relevante për vendimmarrje, andaj nuk janë trajtuar veç e veç në arsyetimin e aktgjykimit.

21. Për këto arsye, është vendosur si në dispozitiv, në kuptim të nenit 222 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.18/2025, datë 21.05.2025

''Mos ekzekutueshmëria e vendimeve të instancës më të ulët – dispozita e nenit 182, par. 2, pika (n) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykim të Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, Gž.nr.6943/21 të datës 17.10.2024 ankesa e të paditurës së parë u refuzua si e pabazuar dhe u vërtetua aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1240/18 i datës 12.07.2021. Në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë pjesërisht u aprovua si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, dhe e paditura e parë u obligua që paditësit në emër të kompensimit për tokën që është marrë në interes publik dhe atë: ngastra kadastrale nr.131/1 dhe 131/3 ZK Gllaviçicë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 365 m2, sipas kulturës Rrugë, t'ia paguajë shumën prej 7,665.00 euro, me kamatë ligjore prej 7%, e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë, saktësisht prej datës 09.11.2018 deri në pagimin e plotë, brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit. Tutje në dispozitiv, e paditura e parë u obligua që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 1728 euro, brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit, ndërsa për shumën e kërkuar në emër të shpenzimeve që është më e lartë sesa shuma e vendosur me aktgjykim kërkesëpadia e paditësit u refuzua si e pabazuar. Tutje, në dispozitiv u refuzua si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar shumën paushallë prej 2.500 euro në emër të bezdisë së shkaktuar, si dhe fitim e humbur nga viti 2017, shumën prej 10.000 euro për zvogëlimin e vlerës së tërësishme të pronës së mbetur të paditësit përmes zhvendosjes së pajustifikuar të rrugës së asfaltuar në formë cik-cak nga traseja shumëvjeçare deri te këndet vitale të pronës së paditësit, shumën prej 9.000 euro në emër të shpenzimeve të shkaktuara nga veprimet e ndërmarra nga paditësi, përkatësisht ndërtimin e murit mbrojtës me gjatësi prej 160 metrash, të imponuar

nga detyrimi për mbrojtjen e pasurisë nga rrëshqitja e vazhdueshme e zhavorrit të vendosur rreth 70 cm. mbi sipërfaqen e tokës. Gjithashtu, kërkesëpadia e paditësit refuzohet si e pabazuar në raport me të paditurën e dytë.

2. Kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të shkallës së dytë, përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës së parë brenda afatit ligjor ka parashtruar revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 188 i Ligjit për procedurën kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe shkaqeve tjera të përmendura, me propozim si në të njëjtin.

3. Në shkresat e lëndës nuk ekziston parashtresë me shkrim, përkatësisht përgjigje ndaj revizionit të parashtruar nga ana e palës kundërshtuese.

4. Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në revizion, në kuptim të dispozitës së nenit 215 të Ligjit për procedurën kontestimore (Ligji nr.03/L-006), vlerësoi që revizioni i përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës së parë është i bazuar.

5. Sipas gjendjes faktike të konstatuar, nuk është kontestuese mes palëve në procedurë se në periudhën 2013-2014, asfaltimin e rrugës në fshatin Gllaviçicë, komuna e Pejës, e ka kryer e paditura e parë, ashtu që për kryerjen e punëve fizike e ka angazhuar të paditurën e dytë. Ky fakt është vërtetuar me shikimin e Marrëveshjes Kornizë të lidhur me datën 03.09.2013 mes të paditurës së parë, si porositës i punimeve, dhe të paditurës së dytë, si kryerës i punimeve. E paditura e parë ka deklaruar që komuna gjithmonë i ka asfaltuar dhe i asfalton rrugët me pajtimin e qytetarëve, dhe në rast se shfaqet pengesë nga ndonjë qytetar, punimet automatikisht ndërpriten, e që në rastin konkret kjo nuk ka ndodhur. Pas realizimit të plotë të procedurës, gjykatat e shkallës më të ulët kanë konstatuar që e paditura e parë obligohet ta kompensojë dëmin e shkaktuar si pasojë e marrjes arbitrare të pronës, në përputhje me nenet 1, 2. paragrafi 1dhe 3, paragrafi 1 i nenit 8 të Ligjit për marrëdhëniet themelore pronësore-juridike të Kosovës. Lartësinë e shumës

monetare në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar, gjykata e shkallës së parë e konstatoi në bazë të ekspertizës së ekspertit të caktuar nga gjykata për vlerësimin e patundshmërisë, të cilës gjykata e shkallës së parë dhe të dytë ia fali besimin.

6. Kontestuese mes palëve në procedurë është pretendimi i përfaqësuesit të autorizuar të së padituresë së parë, sipas të cilit paditësi nuk ishte pronar i ngastrave kadastrale të kontestuara në kohën e asfaltimit të rrugës lëndore, pasi që ai ishte regjistruar si pronar me datën 26.01.2016, dhe në këtë kuptim, ai nuk ka legjitimitet aktiv real për të parashtruar padi dhe për të iniciuar procedurë konkrete kontestimore, pasi që pronësinë e ka fituar shumë më vonë nga koha kur është kryer asfaltimi, dhe i njëjti e ka pranuar gjendjen ekzistuese lidhur me rrugën konkrete. Gjykata e shkallës së parë konstatoi dhe gjykata e shkallës së dytë vërtetoi që prona e kontestuar, përkatësisht ngastra 131/1 dhe 131/3 ZK Gllaviçicë, në kohën e riparimit të rrugës së kontestuar, saktësisht në periudhën 2013-2014 i përkiste familjes Krasniqi, pasi që paditësi e kishte fituar pronën e kontestuar si dhuratë nga gjyshi i tij Mark Krasniqi, i cili pronën e kishte blerë nga Danilo (Miloš) Gašić në vitin 2012. Kjo është vërtetuar në bazë të Historikut të patundshmërive të datës 08.11.2018 të cilin e kishte lëshuar kadastri kompetent, që do të thotë se në rastin konkret paditësi kishte të drejtë të kërkonte kompensimin e dëmit për pronën që i është marrë për riparimin e rrugës së fshatit, meqë prona e kontestuar në tërësi i ishte dhuruar paditësit. Gjithashtu, kontestuese mes palëve kontestuese është pretendimi i përfaqësuesit të autorizuar të së padituresë së parë se kërkesëpadia konkrete në lidhje me kompensimin e dëmit ishte parashtruar jashtë afatit të parashikuar ligjor, duke pasur parasysh që baza juridike e padisë konkrete është kompensimi i dëmit, për të cilin parashihet afati ligjor prej 3 vitesh, meqë marrë parasysh që asfaltimi është bërë në periudhën 2013-2014 dhe kërkesëpadia është parashtruar me datën 09.11.2018, e njëjta është parashtruar pas afatit prej 3 vitesh. Për sa i përket këtij pretendimi konkret, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e vendimit të saj nuk është marrë fare me të, ndërsa Gjykata e Apelit ka theksuar se në rastin konkret nuk ekziston parashkrim, përkatësisht parashkrimi nuk ka mundur të fillojë pasi që prona i është

marrë paditësit në mënyrë arbitrare, dhe paditësi nuk ka mundur ta shfrytëzojë pronën e tij.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga kjo gjendje e lëndës, nuk mund ta pranojë qëndrimin e gjykatave të shkallës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshme, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në aktgjykimin e shkallës së dytë është përfshirë edhe aktgjykimi i shkallës së parë, i cili është nxjerrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të përcaktuara në nenin 182, paragrafi 2, pika (n) e Ligjit për procedurën kontestimore dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë me shkelje esenciale të përcaktuara në dispozitën e nenit 204 të Ligjit për procedurën kontestimore, dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët duhet të anulohen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim.

2. Me shikimin e plotë të shkresave të lëndës, Gjykata Supreme konstatoi që nuk është kontestuese mes palëve kontestuese që pjesët e ngastrave kadastrale të kontestuara në kohën e zgjerimit dhe asfaltimit të rrugës në vitin 2013-2014, faktikisht kanë kaluar në posedim të së paditurës së parë.

3. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në rastin konkret dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pa ekzekutueshëm dhe i paqartë. Në të njëjtin theksohet se në emër të kompensimit të tokës së dy parcelave kadastrale nr. 131/1 dhe 131/3 ZK Gllaviçicë me sipërfaqe të përgjithshme prej 365 m2, e cila është marrë në interes publik, e paditura e parë obligohet të paguajë një shumë të caktuar monetare. Mbetet e paqartë për Gjykatën Supreme se sa është sipërfaqja e përgjithshme e ngastrës kadastrale nr. 131/1 dhe sa prej asaj sipërfaqe është marrë, si dhe në cilën pjesë të kësaj ngastre dhe brenda cilave kufij është marrë ajo, e njëjta vlen edhe për ngastrën kadastrale nr. 131/3?

4. Me shikimin e shkresave të lëndës, përkatësisht Certifikatën nr.59137 të lëshuar me datën 22.05.2018 nga Zyra Kadastrale Komunale në Pejë, Gjykata Supreme konstatoi që paditësi me datën 26.01.2016 ka qenë bashkëpronar në pjesën prej 1/3 të ngastrave kadastrale të kontestuara nr.131/1 dhe 131/3 ZK Gllaviçicë. Nuk ekziston provë në shkresat e lëndës nëse në atë kohë është bërë ndarja fizike e ngastrave kadastrale të kontestuara mes bashkëpronarëve të atëhershëm. Në Historikun e lartpërmendur të pronave të lëshuar me datën 04.12.2018 nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Gjykata Supreme konstatoi që Mark (Pren) Krasniqi përmes kontratës për shitblerje Ov.nr.3883/12 të datës 26.12.2012, në cilësinë e blerësit e kishte blerë pjesën prej 1/3 të ngastrave kadastrale nr. 131/1 dhe 131/3 ZK Gllaviçicë nga Danilo (Miloš) Gašić, në cilësinë e shitësit. Me datën 13.11.2015 përmes Kontratës mbi dhuratë nr.rend.6719/2015, nr. ref. 2254/2015 paditësi u bë pronar i pjesës prej 1/3 të ngastrave kadastrale të kontestuara. Gjendja faktike aktuale është se Jeton Krasniqi, këtu paditësi, është bashkëpronar në pjesën prej 2/3 të ngastrave kadastrale të kontestuara, ndërsa Vladimir (Đoko) Gašić është bashkëpronar në pjesën prej 1/3. Paditësi ka dorëzuar edhe një dokument të shkruar me titullin, citojmë: "*Certificate draft*", të lëshuar me datën 15.04.2019, dhe me shikimin e të njëjtit, Gjykata Supreme konstatoi që paditësi është pronar me pjesën prej 1/1 të ngastrave kadastrale të kontestuara. Duke marrë parasysh të lartcekurat, për Gjykatën Supreme mbetet e paqartë mbi bazën e cilave provave gjykatat e shkallës më të ulët kanë konstatuar se paditësi ka qenë pronar i ngastrave kadastrale të kontestuara në kohën kur janë marrë pjesët e sipërfaqeve të atyre ngastrave kadastrale? Edhe sikur Gjykata Supreme të pranojë pjesërisht qëndrimin e gjykatave të shkallës më të ulët se në kohën e marrjes së pjesëve të ngastrave kadastrale të kontestuara pronar ka qenë gjyshi i paditësit, megjithatë ai nuk ka qenë pronar por bashkëpronar në pjesë prej 1/3 të ngastrave kadastrale të kontestuara, dhe po ashtu mbetet e paqartë nëse në atë kohë është bërë ndarja fizike dhe nëse në atë kohë bashkëpronarët e atëhershëm kanë qenë në dijeni se cilat pjesë të ngastrave kadastrale të kontestuara u përkisnin atyre?

5. Për të gjitha pyetjet e lartpërmendura, gjykatat e shkallës më të ulët kanë dështuar edhe sipas detyrës zyrtare që të deklarohen ose t'i japin arsyetimet në vendimet e tyre. Këto mangësi janë të natyrës së tillë që kërkojnë anulimin e aktgjykimeve të shkallëve më të ulëta, pa u futur fare Gjykata Supreme në shqyrtimin e pretendimeve tjera në revizion dhe pa verifikuar sa drejtë është zbatuar e drejta materiale nga ana e gjykatave të shkallës më të ulët. Për këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se aktgjykimet e shkallëve më të ulëta duhet të anulohen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje. Gjatë rishqyrtimit padyshim se do të përcaktohen të gjitha pyetjet dhe faktet e lartcekura. Gjithashtu do të përcaktohen edhe faktet tjera, dhe mbi bazën e gjendjes faktike të përcaktuar, në mënyrë të drejtë do të zbatohet e drejta materiale përkatëse dhe do të merret një vendim i ligjshëm dhe i drejtë.

6. Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të sa më sipër dhe në zbatim të dispozitës së nenit 224 paragrafi 2 i Ligjit për procedurën kontestimore, vendosi si në dispozitiv.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.96/2025, datë 16.06.2025

''Fitimi i së drejtës pronësore – dispozita e neit 36, par. 1 dhe 2 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore.''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm P.nr.196/2017 i datës 25.11.2019, në paragrafin I të dispozitivit, padia e paditësit është refuzuar si e pabazuar me të cilën ka kërkuar:
   Të vërtetohet se paditësi është pronar i paluajtshmerisë të regjistruar në listën poseduese të Shërbimit Kadastral, Vitomiricë, plani kadastral nr. 11 dhe 12, me numrat e parcelave: 1778/16 me sipërfaqe prej 63 m2 dhe 1778/19 me sipërfaqe prej 456 m2, në të cilat ndodhen shtëpia dhe toka duke uzurpuar sipërfaqen prej 519 m2, dhe të cilat janë të regjistruara në emër të të padituri, edhe pse paditësi i ka blerë ato më 08.12.2013, t'i posedojë dhe t'i shfrytëzojë ato pa pengesa nga askush, dhe i padituri të obligohet ta njohë këtë të drejtë pronësie të pasurisë së paluajtshme që paditësi e ka blerë dhe e shfrytëzuar pa pengesa, që nga dita e blerjes deri më sot, dhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij aktgjykimi, të bëhet ndryshimi i titullarit në parcelat e lartpërmendura. Bazuar në këtë aktgjykim, Agjencia Kadastrale e Kosovës, zyra në Pejë, do të ndryshojë bartësit e të drejtave të pronësisë në ngastrat e lartë theksuara. Gjithashtu, të urdhërojë të padituri që t'i paguajë paditësit shpenzimet e procedurës dhe shpenzimet gjyqësore brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Në paragrafin II. të shqiptimit, përcaktohet që secila palë të bartë shpenzimet e veta të procedurës.

2. Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit paraqiti ankesë, dhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur mbi të njëjtin, gjeti se ankesa ishte e pabazuar, duke e refuzuar të njëjtën me aktgjykimin Ac.nr.2732/2020 të datës 13.03.2023, dhe e vërtetoi aktgjykimin e

Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C. nr. 196/2017 të datës 25.11.2019.

3. Kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës së Apelit të Kosovës, revizioni është paraqitur brenda afatit ligjor nga i autorizuari i paditësit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në revizion.

4. Në shkresat e lëndës, ekziston një parashtresë me shkrim, respektivisht përgjigje në revizion, e paraqitur nga pala kundërshtare.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, pas analizimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve të revizionit ne përputhje me dispozitat e nenit 215 të Ligjit të procedurës kontestimore, dhe gjeti se:

   Revizioni është i pa bazuar.

6. Me revizion aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit të procedurës kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

7. Me revizion aktgjykimi i atakuar është mjaftueshëm i qartë dhe i arsyetuar, dispozitivi i tij është në përputhje me arsyet për faktet thelbësore të dhëna në arsyetim, dhe arsyet për faktet thelbësore janë në një lidhje logjike me provat e administruara, kështu që pretendimet e revizionit me të cilat theksohen shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi II pika n) janë të pabazuara.

8. Sipas të dhënave nga shkresat e lëndës, vërtetohet gjendja faktike si në vijim:
   Më 08.03.2017, paditësi parashtroi padi në gjykatë duke kërkuar vërtetimin e të drejtës në pronësisë në par.kat. me numër: 1778/16 dhe 1778/19 ZK Vitomiricë, kundër të padituri. Gjykata e shkallës së parë zhvilloi procedurën në tërësi, ka kryer shikimin në vendin e ngjarjes,

caktoi ekspertizën e ekspertit te gjeodezisë, dëgjoi palët në procedurë, dëgjoi dëshmitarët e propozuar, i ka administruar provat e tjera të propozuara dhe më pas mori vendim në mënyrën e lartë theksuar. Paditësi theksoi në padi dhe në deklaratat në shqyrtime, se i bleu ngastrat në fjalë me çmim prej 62,500 eurosh, përmes një kontrate private të lidhur më 8 dhjetor 2013, midis tij si blerës nga njëra anë dhe Arijanit Blakaj, si shitës nga ana tjetër. Që nga momenti i blerjes, paditësi u vendos në të po atë muaj pas rinovimit të shtëpisë ekzistuese, dhe që atëherë ai ka jetuar atje vazhdimisht me gruan dhe djalin e tij të moshës 7-8 vjeç. Përveç kontratës joformale të shkruar të theksuar, paditësi i ka dorëzuar edhe fatura, të cilat vërtetojnë se paditësi jeton në paluajtshmerinë lëndore dhe se ai paguan rregullisht për ujin e shfrytëzuar, mjedisin jetësorë, energjinë elektrike dhe tatimin në pronë. Paratë për blerjen e pronës kontestuese i siguroi përmes shitjes së mëparshme të pasurisë, të cilën e kishte trashëguar nga babai i tij, dhe arsyeja pse parcelat kadastrale kontestuese u regjistruan në emër të djalit të tij, këtu të padituri, ishte për të shmangur detyrimet që kishte ndaj ish-gruas së tij, me të cilën ishte në proces divorci. Paditësi kërkon që gjykata të vërtetojë se ai është pronar i parcelave kadastrale kontestuese bazuar në faktin se ai është blerësi i vërtetë dhe shfrytëzues real i të njëjtave, që nga momenti i blerjes.

9. Gjykata e shkallës së parë vërtetoi, dhe gjykata e shkallës së dytë e vërtetoi, se padia e paditësit është e pabazuar, sepse i padituri e fitoi të drejtën e pronësisë nëpërmjet punëve të vlefshme juridike, respektivisht akteve, ai ishte regjistruar si pronar i ngastrave kadastrale në fjalë nr. 1778/16 dhe 1778/19 ZK Vitomiricë. Kjo situatë faktike u vërtetua dhe u konfirmua me shikim në listën poseduese e lëshuar nga Shërbimi Kadastral Komunal në Pejë me nr. 01-664-16 të datës 15 shkurt 2016 dhe me kopjen e planit të lëshuar më 22 korrik 2019. Gjykatat e shkallëve më të ulëta iu referuan dispozitës së nenit 36 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore. Gjithashtu, shtuan se paditësi nuk e plotëson as kushtin tjetër ligjor për fitimin e të drejtës në pronësi përmes mbajtjes, sepse nuk ka kaluar koha e nevojshme për fitimin e të drejtës në pronësi në këtë mënyrë, sepse blerja e paluajtshmerisë sipas padisë së paditësit ka ndodhur në vitin 2013, dhe

paditësi e ka parashtruar padinë në fjalë në vitin 2017. Gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar si të plotë dhe të saktë gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, dhe ka nxjerrë të njëjtin përfundim si gjykata e shkallës së parë mbi zbatimin e së drejtës materiale.

10. Me këtë gjendje faktesh, gjykatat e shkallëve më të ulëta arritën në përfundimin e saktë se padia është e pabazuar andaj e refuzuan të njëjtën.

11. Dispozita e nenit 36 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore (Ligji Nr. 03/L-154) përshkruan metodën e fitimit të të drejtave të pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe në paragrafët 1 dhe 2, parashikon që për bartjen e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, është e nevojshme puna e përshtatshme juridike e vlefshme midis tjetërsuesit dhe fituesit, si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në regjistrin e të drejtave të pasurive të paluajtshme. Kontrata për bartjen e paluajtshmerisë duhet të lidhet me shkrim në prani të të dyja palëve në një zyrë kompetente. Si provë, paditësi dorëzoi një dokument me shkrim të quajtur kontratë private, në të cilën ekziston data 08.12.2013, dhe nënshkrimet e paditësit dhe Arianit Blakaj, pa treguar numrat e parcelave kadastrale, ose vendin ku ndodhen shtëpia dhe 5 ari tokë, ai gjithashtu dorëzoi dëftesa të caktuara për pagesë në emër të energjisë elektrike, ujit të konsumuar, etj. Në shkresat e lëndës, ekziston një kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme, pra të parcelave kontestuese, e lidhur midis Arianit Blakaj, si shitës, dhe Zymber Tarllamishaj, këtu i padituri, si blerës, e përpiluar dhe e vërtetuar nga noteri Ylli Mekaj, me numër LRP.nr. numri rendorë 3369/2012, me nr. ref. nr. 340/2013 të datës 24.12.2013. I padituri gjithashtu është i regjistruar si pronar i ngastrave kadastrale kontestuese, gjë që konstatohet me shikim në listën poseduese të lëshuar nga Zyra Komunale e Kadastrës në Pejë me nr. 01-664-16 të datës 15.02.2016, në të cilën theksohet se të dhënat janë azhurnuar më 12 mars 2014, si dhe një kopje e planit të lëshuar më 22 korrik 2019 në emër të të padituri.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Në kuptimin të lartë theksuarave, dhe duke pasur parasysh nenin e cituar të ligjit përkatës, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se paditësi nuk e ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të dokumenteve të theksuara, kështu që ai nuk ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të vërtetojë të drejtën e tij të pronësisë.

2. Parashtruesi i revizionit përsëriti pretendimet dhe arsyet që ai i kishte theksuar tashmë gjatë procedurës së shkallës së parë, dhe në ankesë, por ato janë të pabazuara, vendimi mbi kërkesën padinë e përmbajtur në aktgjykimet e shkallëve më të ulëta bazohet në arsye të sakta dhe të plota të cilat i pranon edhe Gjykata Supreme e Kosovës. Në aktgjykimin e atakuar gjykata e shkallës së dytë paraqiti arsye të vlefshme dhe të mjaftueshme për vlerësimin e pretendimeve thelbësore të ankesës së paditësit, të cilat ai tani i përsërit pjesërisht në përmbajtjen e revizionit të tij.

3. Gjykata Supreme i referohet përsëri nenit 36, paragrafëve 1 dhe 2 të lartpërmendur të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore, dhe përsërit se gjykatat e shkallës së parë kanë zbatuar drejt të drejtën materiale kur kanë vërtetuar se paditësi nuk është pronar i parcelave kadastrale në bazë të shitblerjes, sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar e drejta e pronësisë së paditësit, pra se ai është pronar i pasurisë së paluajtshme kontestuese. Puna juridike që shërben si e drejtë për bartjen e pronësisë duhet të përmbushë kushtet formale për qarkullimin e pasurisë së paluajtshme, prandaj, kur nuk ekziston puna e vlefshme juridike për bartjen e pronësisë, atëherë marrëdhënia juridike civile midis shitësit dhe blerësit, nëse nuk është formalizuar me kontrata të shkruara, të legalizuara, të vërtetuara dhe të regjistruara, mund të shërbejë, sipas praktikës gjyqësore, në procedurat gjyqësore, vetëm për qëllimin e vërtetimit të posedimit me mirëbesim të pasurisë, por nuk mund të shërbejë si bazë për fitimin e pronësisë. Por, në rastin konkret, edhe nëse ka pasur një transaksion jo formal midis paditësit dhe ish-pronarit, i njëjti nuk ka krijuar një posedim me mirëbesim të

pronësisë, respektivisht nuk ka kaluar afati i kërkuar për mbajtje i përcaktuar me nenin 40 i ligjit të lartë theksuar.

4. Së fundmi, Gjykata Supreme shton se në rastin konkret, paditësi nuk ka deklaruar një arsye të qartë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, në këtë rast vërtetimin e të drejtës në pronësi, por pavarësisht kësaj, gjykatat e shkallës së parë, bazuar në provat e administruara dhe vërtetimin e fakteve, kanë arritur në përfundimin se baza e padisë në bazë të fakteve të cekura në padi nuk mund të mbështeten në asnjë nga bazat për fitimin e të drejtës në pronësi.

5. Duke marrë parasysh situatën faktike të vërtetuar, Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se gjykatat e shkallës së parë kanë zbatuar drejt të drejtën materiale kur e kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

6. Gjykata i ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera nga revizioni, por ato nuk ishin të rëndësishme për vendosje, kështu që gjykata nuk i ka arsyetuar ato veçmas.

7. Nga arsyet e theksuara, është vendosur si në shqiptim në kuptim të dispozitave të nenit 222 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.541/2024, datë 13.01.2025

’’Kompensim i dëmit – dispozitat e neneve: 464, 465, 468 dhe 471 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077).’’

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj C. nr. 38/2020 të datës 31.08.2021, në pikën 1 të dispozitivit, pjesërisht është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit. Në pikën II të dispozitivit, e padituri detyrohet t'i paguajë paditësit shumën prej 26,758,00 eurosh në emër të kompensimit për dëmin material, për shkak të investimit në mbjelljen dhe rritjen e fidanëve të mjedrës, dhe në emër të fitimit të humbur për periudhën kohore trevjeçare t’i paguajë shumën prej 37,530,00 eurosh, përkatësisht gjithsejte shumën prej 64,288,00 eurosh, së bashku me kamatën ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e ngritjes së padisë, përkatësisht nga data 11.10.2016, e deri në pagesën përfundimtare, brenda 15 ditëve nga data e plotfuqishmërisë së vendimit. Në pikën III të dispozitivit, pjesërisht refuzohet kërkesë padia e të paditësit i cili i referohet shumës prej 92,470 00 eurosh në emër të kompensimit për fitimin e humbur, si e pabazuar. Në pikën IV të dispozitivit, e paditura detyrohet t'i paguajë paditësit shumën prej 2,903 eurosh për shpenzimet e procedurës kontestimore, dhe atë në afatin prej 15 ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në pikën V të dispozitivit, paditësi detyrohet të paguajë diferencën bazuar në vlerën e kontestit në shumën prej 150 eurosh në emër të taksave gjyqësore për padinë, dhe atë në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, pasi që ai ka paguar vetëm shumën prej 20 eurosh.

2. Duke vepruar sipas ankesave të parashtruara nga të autorizuarit e palëve në procedurë, Gjykata e Apelit e Kosovës nxori aktgjykimin Ac.nr. 9620/21 më 30.09.2024, me të cilën refuzoi ankesat si të pabazuara, duke vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

3. Kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës së Apelit të Kosovës, i autorizuari i të paditurës brenda afatit ligjor ka ushtruar revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në të njëjtin.

4. Në shkresat e lëndës ekziston parashtresa me shkrim, përkatësisht përgjigjja në revizion e paraqitur nga i autorizuari i palës së kundërt, me propozim si në të njëjtën.

5. Gjatë ekzaminimit të aktgjykimit të goditur në raport me pretendimet në revizion, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare në shkeljet thelbësore të parashikuara në dispozitën e nenit 25 të Ligjit për procedurën kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006), dhe zbatimit të ligjit material nga gjykatat e instancës më të ulët, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se revizioni është i bazuar.

6. Sipas të dhënave nga shkresat e lëndës, rezulton gjendja faktike si në vijim: nuk është kontestuese midis palëve në procedurë se të njëjtat kanë hyrë në marrëdhënie kontraktuale përmes lidhjes dhe nënshkrimit të kontratës më 09.10. 2014, me të cilën paditësi, si blerës, ka blerë nga e paditura, si shitëse, 20,000.00 fidanë mjedre me një çmim prej 0.60 centësh për fidanë, në shumën e përgjithshme prej 12,000.00 eurosh. Gjithashtu, nuk kontestohet as fakti që paditësi, si blerës, ka përmbushur detyrimin e tij duke paguar shumën e kontraktuar më 07.12.2015, dhe se e paditura, si shitëse, ka dorëzuar sasinë e kontraktuar të fidanëve të mjedrës, të cilët paditësi ka mbjellë. Ajo që është kontestuese midis palëve ndërgjyqëse është çështja e cilësisë së fidanëve të mjedrës që e paditura ia ka dorëzuar paditësit, sepse paditësi pretendon se nuk i janë dorëzuar fidanët e caktuar me kontratë, ngase të njëjtit kanë qenë të infektuara dhe të dëmtuara për shkak të infeksionit, ndërsa e paditura pretendon se fidanët kanë qenë të cilësisë së duhur. Për të përcaktuar faktet e kontestuara, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën e plotë, ka paraqitur prova duke dëgjuar dëshmitarët e propozuar dhe ka caktuar ekspertizë nga disa ekspertë të

ndryshëm në profesionet përkatëse. Më 17.01.2019, eksperti i caktuar nga gjykata në fushën e bujqësisë Mr.Sc.Agim Cukaj deklaroi në ekspertizën e tij ka theksuar se bazuar në dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës, ai ka vërtetuar se fidanët e mbjellë të mjedrës ishin të infektuar me dy shkaktar të sëmundjes, përkatësisht: tharjen e fidanëve dhe karcionom të rrënjës, i njëjti ka përcaktuar se shumën prej 26,758.00 eurosh në emër të kompensimit për dëmin e shkaktuar, si dhe shumën prej 96,758.00 eurosh në emër të kompensimit për fitimet e humbura për paditësin. Eksperti i cekur ka marrë pjesë në seancën gjyqësore të mbajtur më 06.04.2021, dhe ai i është përgjigjur pyetjeve të gjykatës dhe palëve në procedurë, meqenëse e paditura nuk ishte pajtuar me mendimin e ekspertizën e cekur, dhe theksuar disa kundërshtime, është caktuar një ekspert tjetër i bujqësisë. Më 12.05.2021, eksperti i caktuar nga gjykata nga fusha e bujqësisë dhe vlerësuesi i licencuar i pronave, Prof. Hajrulla Muli, në ekspertizën e tij ka konstatuar se në toka në të cilin ishin mbjellë fidanët e mjedrës së kontestuar është një vend shumë i përshtatshëm dhe plotëson të gjitha kushtet për kultivimin e mjedrës, duke llogaritur sipërfaqen e dëmtuar prej 2 hektarësh, fitimi neto për pronarin e tokës për një vit do të ishte 13,000.00 euro, ndërsa shuma e dëmit material të shkaktuar për shkak të investimit do të ishte 26,758.00 euro. Eksperti i cekur ka marrë pjesë në seancën gjyqësore të mbajtur më 07.08.2021, dhe i është përgjigj pyetjeve të gjykatës dhe palëve në procedurë, i njëjti gjithashtu ka theksuar se bazuar në këqyrjen e dokumentacionit, vërteton se fidanët janë të sëmura me karcinom, e paditura përsëri nuk është pajtuar as me këtë ekspertizë mendim eksperti, kështu që ka propozuar ekspertizë nga një grup ekspertësh. Më 30.07.2021, grupi i ekspertëve: Sami Bruçi, Januz Kabashi dhe Agron Çerkini, kanë përpiluar ekspertizën në të cilën kanë konstatuar se gjithsejtë vlera e dëmeve për rendimentin vjetor në sipërfaqen prej 19,857 m2, me të gjitha investimet e bëra, arrin në vlerën prej 39,268.00 eurosh, ndërsa rendimenti vjetor nga fitimi neto arrin në vlerën prej 12,510.00 eurosh, dhe është llogaritur për periudhën e vitit të parë, si dhe për periudhën prej tre vitesh. Të njëjtit kanë theksuar se përjashtohet mundësia që toka të jetë e infektuar, sepse paditësi ka ndërmarrë masa të caktuara me qëllim përgatitjen e tokës për mbjelljen e fidanëve të mjedrës. Në

pyetjen e të autorizuarit të të padituresë nëse fidanët konkret të mjedrës kanë qenë të sëmura para blerjes apo para importimit, ekspertët e cekur formuan mendimin e tyre bazuar në këqyrjen e dokumentacionit që gjendet në shkresat e lëndës, i cili tregon faktin se fidanët ishin të sëmurë. Në seancën gjyqësore të mbajtur më 31.08.2021, ka marrë pjesë edhe eksperti Sami Bruçi i cili i është përgjigjur pyetjeve të gjykatës dhe palëve, i njëjti ka përsëritur mendimin që ka dhënë në ekspertizën e përmendur. Gjykata e shkallës së parë në tërësi ia ka falur besimin mendimit të grupit të ekspertëve, e ka vlerësuar atë si ekspertizë profesionale dhe shkencore, dhe ka arritur në përfundimin se nëpërmjet kontratës për blerjen dhe shitjen e fidanëve, palët ndërgjyqëse kanë hyrë në marrëdhënie detyrimi, dhe për këtë arsye nuk mori si bazë pretendimin e të padituresë se ajo nuk është përgjegjëse për shkaktimin e dëmit. Lidhur me bazën ligjore të kërkesë padisë, e njëjta është thirrur në dispozitat e nenit 173 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

7. Gjykata e shkallës së dytë ka vërtetuar gjetjet e gjykatës së shkallës së parë, duke shtuar se është i pabazuar pretendimi i të padituresë, se kërkesë padia e paditësit është parashkruar. Bazuar në dispozitën e nenit 257 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, e cila shprehimisht përkufizon se për parashtrim të kërkesës për kompensim të dëmit është i përcaktuar afati prej tre vitesh, i cili afat llogaritet nga dita kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar atë. Në rastin konkret, paditësi e ka pashtruar kërkesë padinë më 11.10. 2016, ndërsa për dëmin ka mësuar më 16.06.2015, kur është njoftuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë se 50% e fidanëve të tij të mbjellë kishin dështuar dhe se të njëjtat ishin të infektuara. Gjithashtu, gjykata e shkallës së dytë i ka pranuar plotësisht gjetjet e gjykatës së shkallës së parë, të cilat i ka bazuar në ekspertizën e punuar nga një grup ekspertësh, e cila sipas gjykatës së shkallës së dytë ishte punuar në mënyrë profesionale, të saktë dhe të drejtë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, nuk mund ta pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të

ulët, si të drejtë dhe të ligjshëm, sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate, me vendimin e shkallës së dytë është i përfshirë edhe vendimi i shkallës së parë, i cili është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara në nenin 182, paragrafi 2, pika (n) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, ndërsa vendimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 204 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për të cilën arsye vendimet e instancës më të ulët duhet shfuqizuar dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

2. Objekti i kontekstit konkret është kompensimi për dëmin dhe fitimet e humbura, ndërsa kontestuese është nëse fidanët e mjedrës ishin të sëmurë ose të infektuar në kohën kur paditësi i bleu ato nga e paditura, si dhe nëse paditësi ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për kultivimin e suksesshëm të fidanëve të mjedrës dhe nëse ka pasur lëshime nga ana e tij.

3. Gjatë procedurës së plotë të zbatuar, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, deklaratave e palëve dhe dëshmitarëve, si dhe të gjitha ekspertizave të punuara, u vërtetua pa dyshim se paditësi ka ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme që kanë të bëjnë me mbjelljen dhe rritjen e fidanëve të mjedrës, i njëjti ka bërë testimin dhe verifikimin e tokës, e përgatiti atë dhe në mënyrë të drejtë ka mbjellë fidanët e mjedrës së blerë.

4. Ajo që mbetet ende e kontestueshme sipas mendimit të parashtruesit të revizionit është se nuk është vërtetuar fakti nëse fidanët e mjedrës ishin të infektuar apo të sëmurë në momentin kur paditësi i bleu ato nga e paditura.

5. Bazuar në shikimin e aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, si dhe në bazë të këqyrjes së shkresave të plota të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës nuk mundi të përcaktoj ditën e mbjelljes së fidanëve të kontestuar të mjedrës. Duke pasur parasysh faktin se kontrata e pakontestueshme lëndore është lidhur më 09.10.2014, se

analiza e tokës është bërë më 07.08.2014, dhe se inspektorati kompetent ka dalur në terren dhe ka vërtetuar gjendjen faktike më 08.07.2015, mbetet e paqartë se kur saktësisht paditësi i mbolli fidanët e mjedrës së blerë? (Sipas rregullit, fidanët e mjedrës mbillen në vjeshtë ose pranverë). A kanë qenë ato fidanë njëvjeçarë të mjedrës, apo fidanë shumëvjeçarë të mjedrës? A ishin ato fidanë të mjedrës që kanë filiza të pjekur ose rrënjë të reja? A ishin mbjellë bimë të tjera pranë fidanëve të mjedrës? Sa të vjetër ishin fidanët e mbjellë të mjedrës kur inspeksioni kompetent kishte dalë në terren më 07/08/2015? Kur vuri re paditësi se të fidanët e mjedrës kishin pësuar ndryshime përkatësisht se mjedrat kanë mangësi materiale? Paditësi, me rastin e pranimit të fidanëve, a i ka kontrolluar ato? Kur paditësi, si blerës, zbuloi se kishte defekte të caktuara materiale në fidanët e mjedrës, a e ka njoftuar ai për këtë shitësen - të padituren këtu?

6. Dispozita e nenit 464, paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/Z-077) përcakton se blerësi ka për detyrë që sendin e pranuar ta shikojë ose ta japë në shikim sapo kjo të jetë e mundur sipas rrjedhës së rregullt të gjërave dhe për të metat e dukshme ta lajmërojë shitësin në afat prej tetë (8) ditësh, ndërsa te kontratat midis ndërmarrësve pa shtyrje përndryshe e humb të drejtën që i takon mbi këtë bazë.

7. Dispozitat e nenit 465, paragrafi 1 dhe 2 të ligjit të lartpërmendur përcaktojnë se kur pas marrjes së sendit nga blerësi shihet se sendi ka ndonjë të metë e cila nuk ka mundur të zbulohet me shikim të rëndomtë me rastin e marrjes së sendit (e meta e fshehtë), blerësi është i detyruar me kërcënim të humbjes së të drejtës, që për atë të metë të lajmërojë shitësin në afat prej tetë (8) ditësh duke llogaritur prej ditës kur e ka zbuluar të metën, ndërsa te kontrata midis ndërmarrësve menjëherë. Shitësi nuk përgjigjet për të metat të cilat shfaqen pasi të kalojnë gjashtë (6) muajve nga dorëzimi i sendit, përveç nëse me kontratë është caktuar ndonjë afat më i gjatë.

8. Dispozita e nenit 468 të ligjit të lartpërmendur përcakton se blerësi nuk e humb të drejtën që të thirret në ndonjë të metë edhe kur nuk e kryen

detyrimin e vet që sendin ta shikojë pa shtyrje ose detyrimin që brenda afatit të caktuar ta njoftojë shitësin mbi ekzistimin e të metës, si dhe kur e meta të jetë shfaqur vetëm pasi të kenë kaluar gjashtë (6) muaj nga dorëzimi i sendit, po që se për këtë të metë shitësi ka qenë në dijeni apo nuk ka mundur të mos jetë ne dijeni.

9. Dispozita e nenit 471 të ligjit të përmendur në paragrafin 1 përcakton se blerësi i cili e ka njoftuar shitësin me kohë dhe në mënyrë të rregullt mbi të metën, mundet: 1.1. të kërkojë nga shitësi që të metën ta mënjanojë, ose t'ia dorëzojë sendin tjetër pa të meta (përmbushja e kontratës); 1.2. të kërkojë zbritjen e çmimit; 1.3. të deklarojë zgjidhjen e kontratës. Paragrafët 2 dhe 3 të nenit të përmendur përcaktojnë se në secilin nga këto raste blerësi ka të drejtë për shpërblimin e demit. 3. Përpos kësaj dhe pavarësisht nga kjo, shitësi i përgjigjet blerësit edhe për dëmin të cilin e ka pësuar ky për shkak të të metave të sendit në të mirat e tjera të veta, dhe këtë sipas rregullave të përgjithshme mbi përgjegjësinë për dëmin.

10. Dispozita e Nenit 6, paragrafi 1 i Ligjit për Mbrojtjen e Bimëve (Ligji Nr. 04/1-120) përcakton se prodhuesi bujqësor është përgjegjës mes tjerash edhe për kontrollin e shëndetit të bimëve gjatë kultivimit të tyre, për të identifikuar e parandaluar përhapjen e organizmave të dëmshëm në zonat ku kultivohen si: ngastra, plantacione, fidanishte, kopshte, pemëtore, serra, bimë natyrore dhe produktet bimore, si edhe objekte të tjera në pronësi të tij apo që dikush tjetër i shfrytëzon në emër të tij.

11. Mbetet e paqartë për Gjykatën Supreme të Kosovës, nëse e padituri ka qenë e regjistruar në regjistrin zyrtar të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në kohën e importimit të fidanëve të mjedrës së kontestuar dhe në kohën e lidhjes së kontratës? Pastaj, gjatë importimit, transportimit dhe ruajtjes së fidanëve të mjedrës së kontestuar, e paditura a i ka ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për t'i ruajtur ato? Dispozita e nenit 15, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Materialin Fidanor (Ligji Nr. 2004/13) përcakton se materiali fidanor do të tregtohet vetëm nga personat e regjistruar për atë veprimtari nga

Ministria. Materiali fidanor i cili do të tregtohet duhet të ruhet dhe transportohet në kushte të cilat do ta ruajnë cilësinë e materialit fidanor të përcaktuara me Udhëzim Administrativ. Dispozita e nenit 16, paragrafi 1 i ligjit të lartpërmendur përcakton se materiali fidanor do të importohet vetëm nga personat që janë të regjistruar për atë qëllim sipas nenit 3 të këtij Ligji.

12. Gjykata Supreme e Kosovës ka vërtetuar se në shkresat e lëndës ekziston kopja e Certifikatës Fitosanitare të lëshuar nga vendi eksportues nga i cili është importuar materiali fidanor i kontestuar, me numër PCNU002395422 i datës 31.10.2014, mbetet e paqartë nëse e paditura posedon edhe certifikatën tjetër që lidhet me origjinën dhe autenticitetin e materialit fidanor? Dispozita e nenit 16, paragrafi 2 i ligjit të përmendur përcakton se materiali fidanor bazë i certifikuar, standard dhe materiali fidanor CAC – Conformitas Agraria Communuitatis do të lejohet të importohet vetëm nëse i përket varietetit që është në Listën e Varieteteve të Kosovës dhe nëse është i shoqëruar me certifikatë të prejardhjes dhe autenticitetit të llojit, certifikatë fitosanitare, varietetit dhe llojit të lëshuar nga Autoriteti zyrtar i vendit eksportues, duke vërtetuar se materiali fidanor i plotëson kërkesat e këtij Ligji dhe Udhëzimeve Administrative.

13. Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës vërtetoi se në shkresat e lëndës gjendet një kopje e dokumentit PIKF 031232/14 përshkrim i dërgesës numër PCNU002395422, mbi të cilin gjendet vula e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë-Inspektoratit Fitosanitar Kufitar i datës 03.11.2014, me të cilin lejohet importi-tranziti-eksporti, ekziston edhe nënshkrimi i inspektorit fitosanitar. Mirëpo, kopja e cekur është e cilësisë së dobët dhe nuk është e mundur të përcaktohet nëse, dhe cilat kontrolle ose verifikime i ka kryer inspektori fitosanitar. Dispozita e nenit 16, paragrafi 3 të Ligjit për Materialin Fidanor përcakton që të gjitha dërgesat e materialit të importuar fidanor do të inspektohen zyrtarisht në pikat e vend-hyrjes në Kosovë ose në lokalet e shfrytëzuesve të fundit, në përputhje me dispozitat e Ligjeve në fuqi, mbi shëndetin e bimëve lidhur me paraqitjen, shpërndarjen, asgjësimin

e sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve, prodhime bimore dhe në objekte të destinuara.

14. Dispozita e nenit 23, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Mbrojtjen e Bimëve (Ligji Nr. 04/L-120) përcakton se 1.1.Importi i bimëve lejohet nëse: 1.1. importuesi është i pajisur me licencë importi të lëshuar nga organi kompetent i Ministrisë, 1.2. dërgesa e bimëve importohet nëpërmjet pikave hyrëse në të cilat ekziston inspekcioni fitosanitar. Pikat e hyrjes duhet të përmbushin kushtet e përcaktuara për kryerjen e kontrollit shëndetësor të dërgesave bimore.

15. Tutje, dispozita e nenit 28 të ligjit të cekur përcakton se nëse pas kontrollit janë përmbushur gjithë kërkesat sipas neneve 24 dhe 25 të këtij ligji, Inspektori fitosanitar verifikon certifikatën fitosanitare origjinale dhe certifikatat e mundshme të rieksportit duke vulosur dhe shënuar datën e hyrjes dhe lëshon certifikatën fitosanitare për importim. Në fund, Gjykata Supreme shton se pas këqyrjes së dokumentacionit të paraqitur nga e paditura, u vërtetua se ajo kishte importuar sasi më të mëdha të fidanëve të mjedrës, kështu që mbetet e paqartë nëse i gjithë importi ka qenë i synuar për shitje tek paditësi, apo edhe tek palë të treta? Nëse fidanët e importuar janë blerë edhe nga palë të treta, atëherë pyetja mbetet e paqartë, çfarë ndodhi me ato fidanë? (A u sëmurën dhe u infektuan edhe ato?)

16. Mangësitë e cekura janë të natyrës së tillë që kërkojnë prishjen e aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, pa mundur fare që Gjykata Supreme të lëshohet në verifikimin e pretendimeve tjera në revizion, si dhe në verifikimin e rregullsisë ë zbatimit të së drejtës materiale nga gjykatat e instancës më të ulët.

17. Për arsyet e lartcekura, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se vendimet e instancës më të ulët duhet të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje. Në procedurën e përsëritur, pyetjet përkatësisht faktet e lartpërmendura do të përcaktohen në mënyrë të padyshimtë. Përveç kësaj, do të vërtetohen edhe faktet tjera thelbësore, dhe mbi gjendje të tillë të vërtetuar faktike

në mënyrë të drejtë do të zbatohet e drejta materiale dhe do të merret një vendim i ligjshëm dhe i drejtë.

18. Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të sa më sipër, dhe me zbatimin e dispozitës së nenit 224, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurën Civile, vendosi si në dispozitiv.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.Nr.157/2025, datë 10.07.2025

''Baza juridike e kërkesë padisë dhe shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore nga neni 182, par, II, pika n).''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, Dega në Shtërpcë, P.nr.60/2016 të datës 17.06.2021, në paragrafin I të dispozitivit është miratuar si i bazuar kërkesëpadia e paditëses, në paragrafin II të dispozitivit është konstatuar se paditësja, mbi bazën e trashëgimisë pas vdekjes së bashkëshortit të saj, Milutin Tirić nga Shtërpca, është pronare me pjesëmarrje 1/1 në parcelën kadastrale nr.06398, në vendin e quajtur "Tršenja"(treshnja), me kulturë shtëpi-ndërtesë, livadh, me sipërfaqe 25.96 ari, dhe në parcelën kadastrale nr.06399 në vendin e quajtur "Tršenja" me kulturë pyll, me sipërfaqe 17.16 ari, të regjistruara në Certifikatën mbi të drejtat në pasurinë e paluajtshme, Zyra Kadastrale Shtërpcë, si njësi kadastrale: P-72717094-1691, ZK Shtërpcë. E paditura Komuna e Shtërpcës është obliguar të njohë të drejtën e pronësisë mbi pasuritë e lartpërmendura dhe të mundësojë regjistrimin e së drejtës së pronësisë në Kadastërin e paluajtshmërive të Komunës së Shtërpcës, përndryshe ky aktgjykim do të shërbejë si akt intabulues për regjistrimin e së drejtës së pronësisë. Me paragrafin III të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar padia e paditëses në raport me të paditurën e parë, Ministrinë e Infrastrukturës me seli në Prishtinë, me të cilën ajo kishte kërkuar të konstatohet se ajo, mbi bazën e trashëgimisë pas vdekjes së bashkëshortit të saj Milutin Tirić nga Shtërpca, është pronare me pjesëmarrje 1/1 në parcelën kadastrale nr.06398, në vendin e quajtur "Tršenja", me kulturë shtëpi-ndërtesë, livadh, me sipërfaqe 25.96 ari, dhe në parcelën kadastrale nr.06399 në vendin e quajtur "Tršenja", me kulturë pyll, me sipërfaqe 17.16 ari, të regjistruara në Certifikatën mbi të drejtat në pasurinë e paluajtshme, Zyra Kadastrale Shtërpcë, si njësi kadastrale: P-72717094-1691, KZ Shtërpcë. Po ashtu, që e paditura e parë të obligohej të njohë të drejtën e pronësisë mbi pasuritë e lartpërmendura dhe të mundësojë

regjistrimin e së drejtës së pronësisë në Kadastërin e paluajtshmërive të Komunës së Shtërpcës, përndryshe ky aktgjykim do të shërbente si akt intabulues për regjistrimin e së drejtës së pronësisë, për shkak të mungesës së legjitimimit pasiv të të padituris së parë. Me paragrafin IV të dispozitivit, e paditura Komuna e Shtërpcës është obliguar t'i kompensojë paditëses shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 411 euro, brenda 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të detyruar.

2. Kundër këtij aktgjykimi janë paraqitur ankesat brenda afatit ligjor nga përfaqësuesit e autorizuar të të padituris së parë dhe të padituris së dytë, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktgjykimin Gž.nr.8308/2021 të datës 13.08.2024, e ka hedhur si të palejuar ankesën e të padituris së parë: Ministria e Infrastrukturës, ndërsa ankesën e të padituris së dytë: Komuna e Shtërpcës e ka miratuar si të bazuar. Në paragrafin I të dispozitivit, gjykata e shkallës së dytë ka hedhur si të palejuar ankesën e paraqitur nga e paditura e parë: Ministria e Infrastrukturës me seli në Prishtinë. Me paragrafin II të dispozitivit, gjykata e shkallës së dytë e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë në pikën I dhe III të dispozitivit, në këtë mënyrë: Refuzohet si e pabazuar padia e paditëses me të cilën ajo kishte kërkuar të konstatohet se ajo, mbi bazën e trashëgimisë pas vdekjes së bashkëshortit të saj Milutin Tirić nga Shtërpca, është pronare me pjesëmarrje 1/1 në parcelën kadastrale nr.06398, në vendin e quajtur "Tršenja", me kulturë shtëpi-ndërtesë, livadh, me sipërfaqe 25.96 ari, dhe në parcelën kadastrale nr.06399 në vendin e quajtur "Tršenja", me kulturë pyll, me sipërfaqe 17.16 ari, të regjistruara në Certifikatën mbi të drejtat në pasurinë e paluajtshme, Zyra Kadastrale Shtërpcë, si njësi kadastrale: P-72717094-1691, ZK Shtërpcë. E paditura Komuna e Shtërpcës obligohet të njohë të drejtën e pronësisë mbi pasuritë e lartpërmendura dhe të mundësojë regjistrimin e së drejtës së pronësisë në Kadastërin e paluajtshmërive të Komunës së Shtërpcës, përndryshe ky aktgjykim do të shërbejë si akt intabulues për regjistrimin e së drejtës së pronësisë. Me paragrafin III të dispozitivit, gjykata e shkallës së dytë ka përcaktuar që secila palë të bartë shpenzimet e veta të procedurës.

3. Kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, brenda afatit ligjor është paraqitur revizion nga përfaqësuesi me prokurë i paditëses, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin si në revizion.

4. Në shkresat e lëndës nuk ekziston parashtresë e shkruar apo përgjigje ndaj revizionit e paraqitur nga pala kundërshtare.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve të revizionit, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji nr.03/L-006), ka gjetur:

   Revizioni është i bazuar.

6. Sipas të dhënave nga shkresat e lëndës përcaktohet gjendja faktike si vijon:

   Paditësja ka paraqitur padi më datë 31.10.2016 kundër të padituve për vërtetimin e së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme. E paditura e parë dhe e paditura e dytë, në përgjigjet e tyre të shkruara ndaj padisë, e kanë kundërshtuar plotësisht padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke kërkuar nga gjykata që ta refuzojë si të pabazuar. Më datë 21.03.2021, përfaqësuesi me prokurë i paditëses me parashtresë të shkruar ka bërë rregullimin e padisë duke përcaktuar si objekt të kontestit: vërtetimin e pronësisë dhe gjithashtu, është tërhequr padia në raport me të padituren e parë: Ministrinë e Infrastrukturës me seli në Prishtinë. Gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën e plotë dhe pas kësaj ka marrë vendim në mënyrën e lartpërmendur. E njëjta ka konstatuar se me Vendimin nr.02-465-14/2 të Kuvendit Komunal të Ferizajt të datës 20.10.1976 është kryer eksproprijimi i parcelave kadastrale kontestuese nr.06398 dhe 06399, të cilat ishin në pronësi të bashkëshortit të ndjerë të paditëses, Milutin Dobrosavljević. Me shqyrtimin e Fletës së Pasurisë të lëshuar nga Komuna Kadastrale e Shtërpcës më 12.08.1974, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar faktin se pronar i parcelave kadastrale nr.6398 dhe 6399 ishte paraardhësi juridik i paditëses, bashkëshorti i saj i ndjerë, Milutin

Milisav Dobrosavljević, ish-banor i Shtërpcës. I njëjti, me kërkesë të shkruar më 24.06.1975, iu drejtua Drejtorisë Komunale për Çështje Pronësore-Juridike në Komunën e Ferizajt duke kërkuar deeksproprijimin e një pjese të tokës së eksproprijuar. Nga procesverbali i datës 04.12.1985, gjykata e shkallës së parë konstatoi se kërkesa e paraqitur ishte refuzuar nga Komuna e Ferizajt. Bazuar në Certifikatën e lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Shtërpcës, nr.P-72717094-06398-0, e regjistruar me nr. 27-1691 më 26.10.2016, gjykata e shkallës së parë konstatoi se parcela kadastrale nr. 06398-0 me sipërfaqe 25.96 ari ishte e regjistruar në emër të BVI-së për rrugë magjistrale të Prishtinës.

7. Me shqyrtimin e Vendimit të BVI-së për rrugët rajonale dhe magjistrale të KSA të Kosovës në Prishtinë nr.1000/1 i datës 05.10.1988, gjykata e shkallës së parë konstatoi faktin se një pjesë e rrugës rajonale Brezovicë–Sharri, si tokë sipas fletës poseduese nr.677 KO Shtërpcë, me nr. 40/2902 në vendin e quajtur "Tršenja", i ishte dhënë Komunës së Shtërpcës dhe i ishte transferuar në pronësi. Vendimi i lartpërmendur thoshte se transferimi i pronësisë u krye për shkak të një ndryshimi në trasenë e rrugës rajonale, duke marrë parasysh se traseja e vjetër e planifikuar e rrugës ishte braktisur dhe rruga ishte ndërtuar mbi një trase të re. Nga dokumentet e përmendura, gjykata e shkallës së parë konstatoi se pasuritë e paluajtshme të kontestuara nuk ishin shfrytëzuar për ndërtimin e rrugës Brezovicë-Shtëpia e Stojkovës, por rruga kishte kaluar krejtësisht në një trase tjetër, gjë që qartë tregon se paditësja ka të drejtë për rivendosjen e të drejtave të mëparshme pronësore. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë konstatoi se e paditura Komuna e Shtërpcës nuk dëshmoi se paraardhësit juridik të paditëses i ishte paguar një kompensim i drejtë, domethënë, ajo pagoi një kompensim simbolik, e cila nuk korrespondonte as afër vlerës reale të tokës.

8. Duke vepruar mbi ankesat e përfaqësuesve të autorizuar të të paditurve në procedurë, gjykata e shkallës së dytë e ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë në mënyrën e lartpërmendur. Në arsyetimin e aktgjykimit, gjykata e shkallës së dytë në disa fjali ka theksuar se kërkesëpadia e paditëses në tërësi është e pabazuar, sepse baza faktike

e rastit nuk ka çuar në bazueshmërinë e bazës juridike të paditëses, për shkak se provat materiale të lëndës tregojnë se pasuria që është objekt i kontestit ka kaluar në emër të të paditurës së dytë mbi bazën e një vendimi administrativ të formës së prerë pas një procedure të zhvilluar të ekspropriimit, gjatë së cilës paraardhësi juridik i paditëses ka marrë kompensim. Gjykata e Apelit refuzoi kërkesëpadinë e paditëses për shkak të mungesës së bazës juridike, si dhe pretendimin në lidhje me faktin se paditësja ka të drejtë në deekspropriim për shkak se qëllimi i ekspropriimit në pasurinë e paluajtshme kontestuese nuk është arritur. Sipas gjykatës së shkallës së dytë, kërkesa konkrete e përmendur është e pabazuar dhe e paligjshme, meqenëse kërkesa për deekspropriim e paraqitur nga paraardhësi i paditëses, si ish-pronar, ishte refuzuar në procedurën administrative.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Në një gjendje faktike të tillë, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktgjykimet e shkallëve më të ulëta janë nxjerrë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi II pika n), ngase ato përmbajnë mangësi që i bëjnë të pakuptueshme, dispozitivi i tyre nuk është në përputhje me arsyet për faktet vendimtare të dhëna në arsyetim, ndërsa arsyet për faktet vendimtare nuk janë në lidhje logjike me provat e administruara. Këto mangësi e pamundësojnë kontrollin e zbatimit të drejtë të së drejtës materiale nga gjykatat e shkallëve më të ulëta.

2. Gjykata Supreme ka vërejtur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka mangësi të caktuara që e bëjnë atë të pakuptueshëm dhe të paqartë. Konkretisht, dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë nuk është fare në përputhje me arsyetimin e tij. Me shqyrtimin e dispozitivit të aktgjykimit në gjuhën shqipe, në paragrafin II, Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkallës së dytë ka ndryshuar aktgjykimin e kontestuar të shkallës së parë në paragrafin I dhe III; ndërsa me shqyrtimin e dispozitivit të aktgjykimit në gjuhën serbe, në paragrafin II, Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkallës së dytë ka ndryshuar aktgjykimin e kontestuar të shkallës së parë në paragrafin II

dhe III. Duke marrë parasysh se versioni origjinal i aktgjykimit të shkallës së dytë është ai në gjuhën shqipe, nënkuptohet se Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë në paragrafin I dhe III. Me shqyrtimin e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, Gjykata Supreme konstaton se në paragrafin I është miratuar në tërësi kërkesëpadia e paditëses si e bazuar, ndërsa në paragrafin III është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses në raport me të paditurën e parë – Ministrinë e Infrastrukturës me seli në Prishtinë. Mbetet krejtësisht e paqartë për Gjykatën Supreme se çfarë ndodh me paragrafin II të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, me të cilën është konstatuar se paditësja është pronare 1/1 e parcelave kadastrale të objektit në kontest?

3. Me shqyrtimin e shkresave të plota të lëndës, Gjykata Supreme konstaton se objekti i kontestit është: konstatimi i së drejtës së pronësisë. Megjithatë, as aktgjykimi i shkallës së parë, as ai i shkallës së dytë, e as padia dhe padia e precizuar, nuk japin përgjigje në pyetjen themelore: cili është baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses? Përmendet trashëgimia, eksproprijimi, deeksproprijimi, shfrytëzimi i vazhdueshëm i pasurisë etj.

4. Gjykata Supreme vëren se përfaqësuesi i paditëses me parashtresën me shkrim të datës 01.03.2021 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, duke theksuar se e tërheq padinë ndaj të paditurës së parë – Ministrisë së Infrastrukturës me seli në Prishtinë. Megjithatë, as gjykata e shkallës së parë, as ajo e shkallës së dytë nuk e kanë marrë parasysh këtë parashtresë. Madje, gjykata e shkallës së dytë në dispozitivin e saj, në paragrafin II, ka ndryshuar paragrafin III të aktgjykimit të shkallës së parë, e cila lidhet me të paditurën e parë dhe refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses ndaj saj për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv.

5. Gjithashtu, Gjykata Supreme thekson se nëse qëndrimi i gjykatës së shkallës së dytë është ndryshe nga ai i gjykatës së shkallës së parë, në kuptimin që gjykata e shkallës së dytë e ka refuzuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, atëherë i njëjti ka qenë i detyruar që në arsyetim të japë analizë të të gjitha provave të

administruara, të tregojë se cila prej provave të administruara është me rëndësi vendimtare për vendimin përfundimtar të gjykatës, si dhe të paraqesë të gjitha arsyet dhe provat konkrete përse paditësja nuk ka pasur sukses në këtë kontest.

6. Duke e zbatuar të lartshënuarën në rastin konkret, dhe duke marrë parasysh argumentimin e gjykatës së shkallës së dytë për përfundimin mbi të pabazuarit e kërkesëpadisë, Gjykata Supreme konstaton se arsyetimi i vendimit të shkallës së dytë vështirë se mund të vlerësohet si i pranueshëm sipas ligjit, ngase nuk jep arsye relevante dhe bindëse për të vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar. Një arsyetim i tillë i aktgjykimit të kontestuar nuk i plotëson standardet e gjykimit të drejtë, ashtu siç janë të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

7. Në të gjitha çështjet e sipërpërmendura, gjykata e shkallës së dytë ka dështuar, edhe sipas detyrës zyrtare, të deklarohet apo të japë arsyetim në vendimin e saj. Këto mangësi janë të një natyre të tillë që kërkojnë anulimin e aktgjykimeve të shkallëve më të ulëta, pa pasur nevojë që Gjykata Supreme të hyjë fare në verifikimin e pretendimeve të tjera të revizionit dhe në kontrollin e zbatimit të drejtë të së drejtës materiale nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

8. Për këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se aktgjykimet e shkallëve më të ulëta duhet të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së dytë për rigjykim dhe vendimmarrje. Në procedurën e përsëritur do të vërtetohen në mënyrë të padiskutueshme të gjitha çështjet dhe faktet e sipërpërmendura. Po ashtu, do të përcaktohen edhe faktet tjera vendimtare dhe mbi një gjendje të tillë faktike të saktësuar do të zbatohet në mënyrë të drejtë e drejta materiale dhe do të merret një vendim i ligjshëm dhe i drejtë.

9. Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptimin e mësipërm dhe me zbatimin e dispozitave të nenit 224, paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vendosur si në dispozitiv.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr. 5/2025, datë 15.07.2025

''Arsyetimi i vendimit të shkallës së dytë dhe shqyrtimi i arsyeve ankimore të paraqitura theksuara - dispozita e nenit 160, par. 4 i Ligjit për procedurën kontestimore.''

I. **Rrethanat e çështjes**

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm P.nr.647/2019, më datë 14.09.2022, në dispozitiv është miratuar kërkesëpadia e paditësit dhe është konstatuar se paditësi është pronar i pasurisë së paluajtshme, përkatësisht parcelës kadastrale nr.1759-10, me sipërfaqe prej 88 m², në ZK Pejë, si dhe objektit ndërtimor (zdrukthëtari) me sipërfaqe prej 45 m², në bazë të parashkrimit fitues të paditurit janë obliguar që t'ia njohin këtë të drejtë paditësit dhe të lejojnë që pasuria e paluajtshme në fjalë të regjistrohet në emër të paditësit në librat e pasurive të paluajtshme pranë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi në Pejë, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Në dispozitiv është përcaktuar që secila palë t'i bartë vetë shpenzimet e procedurës.

2. Kundër këtij aktgjykimi, përfaqësuesi me prokurë i të paditurve ka paraqitur ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur mbi të njëjtën, ka gjetur se ankesa nuk është e bazuar, andaj me aktgjykimin Gž.nr.7345/2022, më datë 15.10.2024, e ka refuzuar ankesën dhe ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm P.nr.647/2019, më datë 14.09.2022.

3. Kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit të Kosovës, përfaqësuesi me prokurë i të paditurve ka paraqitur revizion brenda afatit ligjor, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim sipas përmbajtjes së revizionit.

4. Në shkresat e lëndës ekziston një parashtresë me shkrim, përkatësisht përgjigje ndaj revizionit, e paraqitur nga përfaqësuesi me prokurë i palës kundërshtare.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, duke shqyrtuar aktgjykimin e kontestuar në raport me pretendimet e revizionit dhe në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji nr.03/L-006), ka vlerësuar se revizioni i përfaqësuesit me prokurë të të paditurve është i bazuar.

6. Aktgjykimet e kontestuara me revizion janë të përfshira nga shkelja esenciale e dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore sipas nenit 182, paragrafi 2 ,pika n), pasi ato përmbajnë të meta që i bëjnë të paqartë, dispozitivi e të njëjtës nuk është në përputhje me arsyet për faktet thelbësore të dhëna në arsyetim, ndërsa arsyet për faktet thelbësore janë të paqarta dhe pa lidhje logjike me provat e administruara.

7. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar, ndërsa gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar, gjendjen faktike në vijim: se kërkesëpadia e paditësit, pas zhvillimit të plotë të procedurës, administrimit të të gjitha provave të propozuara, dëgjimit të dëshmitarëve të propozuar, vëzhgimit në vendngjarje si dhe bazuar në ekspertizën e kryer nga eksperti i fushës së gjeodezisë, është plotësisht e bazuar. Konkretisht, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se i ndjeri Hajrullah Mala, i cili është paraardhës juridik i palëve në procedurë, gjatë vitit 1960, ende gjallë, e ka ndarë pasurinë e paluajtshme ndërmjet vetes dhe djemve të tij, duke mbajtur për vete një parcelë më të madhe dhe për paditësin me të cilin jetonte në bashkësi familjare. Pas ndarjes së bashkësisë familjare, i padituri Mahir Mala i ka kërkuar babait të tij Hajrullah Mala një pjesë të parcelës me qëllim të zgjerimit dhe ndërtimit të shtëpisë banesore. I ndjeri Hajrullah Mala, përmes Kontratës së Dhurimit të përpiluar më 20.03.1978, me numër Vr.nr.54378 dhe të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Pejë më 13.04.1978, ia ka dhuruar parcelën kadastrale kontestuese djalit të tij, këtu të padituritit Mahir Mala, ndërsa në pikën IV të kontratës së lartpërmendur është paraparë se parcela në fjalë nuk mund të

tjetërsohet. I padituri Mahir Mala në vitin 1979 e ka shitur shtëpinë, ndërsa parcelën kadastrale kontestuese që nga viti 1980 e ka shfrytëzuar në tërësi paditësi, i cili në vitin 1997 në të njëjtën, ndërtoi një ndërtesë (zdrukthëtari) të cilin edhe sot e shfrytëzon paditësi, duke ditur se prona e kontestuar është e tij. Paditësi e ka shfrytëzuar pa ndërprerje dhe pa ndërhyrje nga askush, nuk pati ndërhyrje as nga i padituri Mahir Mala dhe as nga të paditurit e tjerë , ata kurrë nuk e kontestuan të drejtën e tij të posedimit dhe shfrytëzimit. Në fund, gjykata e shkallës së parë arriti në përfundimin se në rastin konkret janë plotësuar tre kriteret themelore që përbëjnë bazë për fitimin e së drejtës së pronësisë në bazë të posedimit ose parashkrimit fitues, siç janë: reciprociteti, posedimi dhe koha, në përputhje me dispozitën ligjore të nenit 28, paragrafi 4, të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore, dhe kjo është përcaktuar me nenin 40, të Ligjit në fuqi mbi Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore. Sipas qëndrimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi ka fituar të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme që është objekt i procedurës gjyqësore mbi bazën e posedimit përkatësisht parashkrimit fitues, ngase ka qenë posedues i ndërgjegjshëm, i mirëbesueshëm dhe i ligjshëm që nga viti 1980, që nënkupton më shumë se 20 vjet.

8. Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar sipas ankesës së përfaqësuesit me prokurë të paditurve, e ka refuzuar ankesën si të pabazuar, duke vërtetuar vendimin e shkallës së parë, duke theksuar se është vërtetuar se paraardhësi i paditësit dhe paditësi kanë ardhur në posedim të pasurisë së paluajtshme të kontestuar në vitin 1980, dhe se që atëherë askush, madje as i padituri, nuk i kanë penguar ata ta përdorin këtë pasuri të paluajtshme. Paditësi në vitin **1997** mbi parcelën kontestuese ka ndërtuar një objekt zdrukthëtarie, për ndërtimin e të cilit ka qenë i informuar i padituri i parë, i cili madje ia ka rekomanduar paditësit ndërtimin dhe nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim ndaj këtij ndërtimi. Nga mosveprimi i të paditurve gjatë gjithë këtyre viteve, për më shumë se 30 vjet, rrjedh se ata e kanë ditur që kjo parcelë është në posedimin e paraardhësit të paditësit dhe të vetë paditësit, por nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim juridik për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, për të penguar paditësin ta marrë në posedim dhe

për të ndaluar ndërtimin. I padituri i parë e ka shitur tokën dhe shtëpinë e tij në vitin 1979, pa përfshirë pjesën kontestuese, edhe pse ajo figuronte në emrin e tij. Blerësi i ri e ka rrethuar pjesën e vet, përkatësisht atë që e kishte blerë, por jo pjesën kontestuese apo parcelën me sipërfaqe prej 88 m² – ka mbetur në posedimin e paditësit që nga viti 1980 e deri më sot. Që nga viti 1980 paditësi ka qenë në posedim të mirëbesueshëm të pasurisë së paluajtshme kontestuese, ku përveç që e ka shfrytëzuar pa pengesa nga askush, në vitin **1997** ka ndërtuar objektin e drurit mbi parcelën kontestuese dhe mbi pjesën e parcelës së tij. Sipas qëndrimit të gjykatës së shkallës së dytë, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se paditësi ka qenë në posedim të pasurisë së paluajtshme kontestuese, në mirëbesim, dhe koha e nevojshme për fitimin e së drejtës së pronësisë sipas parashkrimit fitues ka kaluar. Gjykata e shkallës së dytë ka theksuar se fakti që i padituri i parë e ka shitur shtëpinë dhe tokën e tij në vitin **1979**, pa përfshirë pjesën kontestuese, dhe që kjo pjesë ka mbetur në oborrin e paditësit; fakti që i padituri nuk i është kundërvënë posedimit të paditësit mbi parcelën e tij për më shumë se **30 vite**, duke përfshirë edhe ndërtimin e një objekti zdrukthëtarie në vitin 1997, megjithëse e ka ditur për ndërtimin, dhe as atëherë nuk ka kërkuar kompensim dëmi – të gjitha këto çojnë në përfundimin se i padituri i parë, si pronar, ka pranuar që ky pjesë të mbetej fillimisht te i ati i tij, e më pas te vëllai i tij, këtu paditësi.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se me revizionin e përfaqësuesit me prokurë të të padituve me të drejtë është vënë në dukje se aktgjykimi i shkallës së parë është i paqartë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë ka dështuar t'i heqë këto paqartësi, ose të paktën t'ia urdhërojë gjykatës së shkallës së parë që në procedurë të përsëritur t'i sqarojë ato.

2. Dispozita e nenit 160 paragrafi 4 e Ligjit për Procedurën Kontestimore parasheh që arsyetimi i aktgjykimit duhet të përmbajë: kërkesat e palëve, faktet e paraqitura, provat e propozuara, cilat nga këto fakte

janë vërtetuar, përse dhe si janë vërtetuar ato, dhe nëse janë vërtetuar përmes provave – cilat prova janë përdorur dhe si janë vlerësuar ato.

3. Duke aplikuar këtë në rastin konkret dhe duke pasur parasysh argumentimin e gjykatës së shkallës së dytë, Gjykata Supreme konstaton se arsyetimi i aktgjykimeve të shkallëve më të ulëta vështirë se mund të vlerësohet si i pranueshëm sipas ligjit, ngase nuk ofron arsye relevante dhe bindëse për të arritur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Një arsyetim i tillë i aktgjykimeve të kontestuara nuk e plotëson standardin e gjykimit të drejtë, ashtu siç është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

4. Në fakt, Gjykata Supreme vëren se me padinë e paraqitur më 06.06.2019, objekti i kontestit ishte konstatimi i të drejtës së pronësisë mbi bazën e ndarjes së pasurisë së paluajtshme që i përkiste paraardhësit juridik të palëve në procedurë, dhe në bazë të parashkrimit fitues mbi numrin e parcelës kadastrale të lartpërmendur: 1759-10 me sipërfaqe prej 88 m², ZK Pejë, e cila është e regjistruar në emër të Mahir Mala, i padituri i parë, vëllai i paditësit. Përfaqësuesi me prokurë i paditësit ka bërë dy herë precizimin e padisë dhe të kërkesëpadisë – një herë me shkrim më 26.04.2021 dhe një herë në seancën gjyqësore më 15.12.2021, kur e ka zgjeruar kërkesëpadinë në kuptim objektiv, duke shtuar përcaktimin e të drejtave të pronësisë për punishten e ndërtuar të zdrukthëtarisë në një pjesë të parcelës kadastrale të kontestuar me një sipërfaqe prej 45m2. Duke shqyrtuar komplet shkresat e lëndës, Gjykata Supreme ka konstatuar se është e padiskutueshme që Hajrullah Mala ka qenë paraardhës juridik i palëve në procedurë, gjithashtu, është e padiskutueshme se Hajrullah Mala, si dhurues, përmes Kontratës së Dhurimit të përpiluar më 20.03.1978, nr.Vr.nr.54378 dhe të vërtetuar nga Gjykata Komunale e Pejës më 13.04.1978, ia ka dhuruar parcelën kadastrale kontestuese të paditurit të parë Mahir Mala, si dhuratëmarrës. Po ashtu, në pikën IV të kontratës është paraparë që dhuratëmarrësi Mahir Mala nuk mund ta tjetërsojë parcelën në fjalë. Nuk është e kontestueshme as fakti që Mahir Mala, i padituri i parë, e ka shitur parcelën tjetër kadastrale ku

jetonte dhe është shpërngulur në një pjesë tjetër të qytetit të Pejës, ndërsa pronari i ri ka ngritur gardh muri përreth asaj parcele të blerë. Ndërmjet palëve në procedurë nuk është e kontestueshme as fakti që Mahir Mala është pronar formal-juridik i parcelës kontestuese.

5. Kontesti midis palëve ndërgjyqëse është nëse paditësi është bërë pronar i parcelës kadastrale të kontestuar në bazë të mirëmbajtjes dhe ndërtimit të ndërtesës në një pjesë të parcelës kadastrale të kontestuar?

6. Për Gjykatën Supreme mbetet e paqartë një fjali që është formuluar dhe përsëritur disa herë nga gjykatat më të ulëta, përkatësisht: I padituri Mahir Mala e shiti shtëpinë në vitin 1979, ndërsa parcela kadastrale e kontestuar është përdorur tërësisht nga paditësi që nga viti 1980, për të cilin i padituri nuk ka treguar interes për më shumë se 30 vjet. Është e paqartë, mbi çfarë baze ligjore paditësi dhe paraardhësi ligjor i palëve, i ndjeri Hajrullah Mala, e kanë përdorur parcelën kadastrale të kontestuar që nga viti 1980? Vetëm dy vjet para kësaj, më saktësisht në vitin 1978, paraardhësi ligjor i palëve në procedurë, Hajrullah Mala, ia ka dhuruar parcelën kadastrale të kontestuar të padituri të parë Mahir Mala në vitin 1978, dhe ai është regjistruar si pronar i parcelës kadastrale. Formulimi në padi është i paqartë dhe i palogjikshëm në pjesën që i referohet përcaktimit të të drejtave të pronësisë bazuar në ndarjen e pasurisë së paluajtshme që i përkiste paraardhësit ligjor të palëve në procedurë. Meqenëse i ndjeri Hajrulla Mala e ndau pronën e paluajtshme gjatë jetës së tij, për të qenë i saktë, diku nga viti 1960 dhe në vitin 1978, ai ia dhuroi parcelën kadastrale të kontestuar të padituri të parë Mahir Mala nëpërmjet një Marrëveshjeje Dhurate.

7. Parcela kadastrale e kontestuar ka një sipërfaqe totale prej 88 m2, paditësi pretendon se e ka përdorur atë me ndërgjegje, pa u shqetësuar dhe vazhdimisht që nga viti 1980, për Gjykatën Supreme mbetet e paqartë se si e ka përdorur/në çfarë mënyre dhe si e përdor paditësi parcelën kadastrale të kontestuar? Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, lidhur me faktin se shteti nënkupton autoritet faktik mbi gjërat, në procedurat para gjykatave më të ulëta nuk u sqarua se nga çfarë përbëhet ajo pronësi ekskluzive shtetërore e parcelës kadastrale të kontestuar, ose cilën pjesë reale të parcelën kadastrale të kontestuar

e mban paditësi, dhe në çfarë masash dhe kufizimesh, pasi paditësi ndërtoi një ndërtesë në një pjesë të parcelës kadastrale të kontestuar në vitin 1997.

8. Pastaj, gjykatat e shkallës së parë vërtetuan se në vitin 1997, paditësi ndërtoi një ndërtesë (zdrukthëtari) në një pjesë të parcelës të kontestuar, e cila shtrihet në një pjesë të parcelës të tij, të cilën paditësi e përdor pa ndërhyrjen e të paditurve dhe të tjerëve. Eksperti gjeodezik vërtetoi se paditësi ndërtoi një punëtori zdrukthëtarie në një pjesë të parcelës kadastral të kontestuar me një sipërfaqe prej 45 m2. Për Gjykatën Supreme mbetet e paqartë, nga viti 1980 deri në vitin 1997, për çfarë qëllimesh dhe në çfarë mënyre e përdori paditësi parcelën kadastral të kontestuar? Duke pasur parasysh faktin e vërtetuar nga eksperti gjeodezik, përkatësisht se një ndërtesë u ndërtua nga paditësi në një pjesë të parcelës kadastral me një sipërfaqe prej 45 m2, mbetet e paqartë se çfarë ka dhe për çfarë përdoret pjesa e mbetur e parcelës kadastrale në sipërfaqen e mbetur?

9. Dispozita e nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ 6/80) parashikon se e drejta e pronësisë fitohet me ligj, mbi bazën e kontratës, trashëgimisë ose vendimit të organit shtetëror, në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me ligj. Dispozita e nenit 21 të po këtij ligji parashikon se e drejta e pronësisë fitohet me krijimin e sendit të ri, bashkimin, përzierjen, ndërtimin mbi tokën e huaj, ndarjen e fryteve, parashkrimin fitues, fitimin e pronësisë nga jo-pronari, okupacionin dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligj. Dispozita e nenit 28 paragrafi 4 e këtij ligji parashikon se poseduesi i ndershëm i sendit të paluajtshëm mbi të cilin dikush tjetër ka të drejtë pronësie, fiton të drejtën e pronësisë mbi atë send me parashkrim fitues pas kalimit të 20 viteve. Dispozita e nenit 72 e po këtij ligji parashikon se posedimi është i ligjshëm nëse bazohet në një titull juridik të vlefshëm të nevojshëm për fitimin e së drejtës së pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, mashtrim ose keqpërdorim të besimit. Posedimi është i ndershëm nëse poseduesi nuk e di ose nuk mund të dijë se sendi që posedon nuk është i tij. Ndërgjeshmëria supozohet.

10. Duke pasur parasysh të gjitha sa u tha më sipër, si dhe dispozitat e cituara të Ligjit, Gjykata Supreme vëren se paditësi me kërkesëpadi kërkon konstatimin e së drejtës së pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues, duke theksuar se për më shumë se 30 vjet ka përdorur në mënyrë të ndershme, të pandërprerë dhe pa pengesa parcelën kadastrale kontestuese. Dispozitat ligjore të lartpërmendura rregullojnë fitimin e të drejtave të pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet parashkrimit fitues. Parashkrimi fitues është mënyrë origjinare e fitimit të të drejtave subjektive në bazë të posedimit të një cilësie të caktuar dhe me kalimin e një afati të caktuar. Për fitimin e së drejtës së pronësisë me anë të parashkrimit fitues për pasuritë e paluajtshme, kërkohet posedim i ligjshëm dhe me mirëbesim dhe kalimi i një afati prej dhjetë vitesh, ose parashkrim fitues i jashtëzakonshëm, i cili në rastin konkret kërkon posedim me mirëbesim të sendit dhe kalimin e një afati prej njëzet vitesh. Ligji mbi bazat e Marrëdhënieve Pronësore në dispozitat e nenit 72 të përmendur përcakton më saktë posedimin e ligjshëm dhe me mirëbesim. Posedimi i nevojshëm për fitimin e të drejtës së pronësisë me parashkrim fitues të jashtëzakonshëm duhet të jetë me mirëbesim. Ligji përcakton se posedimi me mirëbesim ekziston nëse poseduesi nuk e di ose nuk mund ta dijë që sendi që ai mban nuk është i tij.

11. Sipas nenit 72 të përmendur të Ligjit parashikohet që mirëbesimi i posedimit të prezumohet, megjithatë, në rastin konkret, të padituri kundërshtojnë ekzistencën e mirëbesimit nga ana e paditësit. Të padituri disa herë gjatë zhvillimit të procedurës, si në ankesë, ashtu edhe tani në revizion, kanë përsëritur ndër të tjera se paditësi ishte i vetëdijshëm për faktin se parcela kadastrale në kontestim ishte dhuruar të padituri të parë nga babai Hajrullah Mala, pastaj, se makinat dhe pajisjet e zdrukthëtarisë së babait (pasuri e luajtshme) ndodhen në parcelën kadastrale të kontestuar, të cilat nuk u ndanë kurrë midis vëllezërve pas vdekjes së babait, por u përdorën bashkërisht për nevojat familjare.

12. Paditësi e dinte gjatë gjithë kohës se parcela nuk ishte i tij, dhe për shkak të faktit se aty ndodheshin makinat dhe pajisjet e zdrukthëtarisë së babait të tij, të cilat janë pronë e përbashkët e të gjithë trashëgimtarëve dhe të cilat nuk u ndanë kurrë midis vëllezërve pas vdekjes së babait të tyre, por u përdorën bashkërisht për nevojat familjare.

13. Gjykata Supreme e Kosovës, me shqyrtimin e plotë të dosjes së lëndës, ka konstatuar gjithashtu se paditësi kërkon konstatimin e së drejtës së pronësisë mbi punëtorinë e ndërtuar të zdrukthëtarisë në një pjesë të parcelës kadastrale të kontestuar me një sipërfaqe prej 45 m2, punëtoria është ndërtuar në vitin 1997.

14. Dispozita e nenit 24, paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko- Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 6/80) përcakton se personi që ndërton një ndërtesë ose ndonjë ndërtim tjetër (objekt ndërtimi) në tokën mbi të cilën dikush tjetër ka të drejtën e pronësisë (ndërtuesi), fiton të drejtën e pronësisë edhe mbi tokën mbi të cilën është ndërtuar objekti ndërtimor, si dhe mbi tokën që është e domosdoshme për përdorimin e rregullt të atij objekti ndërtimor, nëse nuk e ka ditur ose nuk ka mundur ta dijë se po ndërton në tokën e dikujt tjetër, dhe pronari i tokës ka ditur për ndërtimin dhe nuk ka kundërshtuar menjëherë. Rregullat mbi ndërtimin në tokën e tjetrit janë të parashikuara në nenet 24 deri 26 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr. 6/80). Duke u nisur nga këto dispozita materiale-juridike, Gjykata Supreme vëren se gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk kanë sqaruar faktet thelbësore lidhur me kushtet konkrete për fitimin e së drejtës së pronësisë me ndërtim në tokën e tjetrit.

15. Për të gjitha çështjet e përmendura më sipër, gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë lënë pa u shprehur edhe sipas detyrës zyrtare, ose nuk kanë dhënë arsyetim në vendimet e tyre. Mungesat e përmendura janë të natyrës së tillë që kërkojnë shfuqizimin e vendimeve të shkallëve më të ulëta, pa mundur Gjykata Supreme të hyjë fare në shqyrtimin e pretendimeve të tjera të revizionit dhe kontrollin e zbatimit të drejtë të

së drejtës materiale nga gjykatat më të ulëta. Për këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se vendimet e shkallëve më të ulëta duhet të shfuqizohen dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim dhe vendimmarrje. Në procedurën e përsëritur do të sqarohen në mënyrë të padiskutueshme të gjitha çështjet dhe faktet e përmendura më sipër. Po ashtu do të përcaktohen edhe faktet e tjera të rëndësishme dhe mbi gjendjen faktike të sqaruar do të zbatohet drejt e drejta materiale përkatëse dhe do të merret një vendim i ligjshëm dhe i drejtë.

16. Për arsye të përmendura më sipër, duke u zbatuar dispozitat e nenit 223 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është miratuar revizioni i përfaqësuesit me prokurë të paditëses dhe janë shfuqizuar aktgjykimet e shkallëve më të ulëta, ndërsa lënda është kthyer në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim dhe vendimmarrje.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr. 129/202, datë 24.06.2025

''Kompensim i dëmit – dispozitat e neneve: 47, 52, dhe 54 të Ligjit të Ksovës për familjen (Ligji nr. 2004/32)''

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.972/2016 od 16.11.2021, në pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesë padia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësja është bashkëpronare në paluajtshmërit si në vijim:
   - Ngastrës kadastrale numër: P-70403013-24190-0, me sipërfaqe prej 3055 m², në vendin e quajtur „Kodra e Dëshmorëve“, arë e klasit të tretë, për pjesën ideale prej 1016 m², dhe shtëpisë e cila është trikatëshe me të padituri nga ½, e cila njësi evidentohet në Departamentin për Katastër në emër të Lumni (Rustem) Pajaziti, sipas certifikatës së pronës me nr. të lëndës 127531-2019 e datës 1010.2019.
   - Ngastrës kadastrale numër: P-70403013-00623-13, me sipërfaqe prej 500m² në vendin e quajtur "Petigovc", dhe shtëpisë të cilën në këtë ngastër e ka ndërtuar paditësja me nga ½ me të padituri, e cila njësi në Departamentin për Kadastër evidentohet në emër të Lumni (Rustem) Pajaziti, sipas certifikatës së pronës së paluajtshme me numër të lëndës 127531-2019e datës 10.10.2019.
   - Se është bashkëpronare e objektit ku është themeluar njësia biznesore „Kosmoplant“ shpk, me numër të biznesit 810279415, e cila ndodhet në Stanqiq - Stanaj KK Gjilan, dhe bashkëpronare në aksionet që i padituri i ka në këtë biznes, si dhe dhe në llogaritë bankare në emër të padituri me nga ½.
   - Që të pronarët e këtyre palujatshmërive të obligohen që të pranojnë dhe lejojnë që paditësja të regjistrohet pranë organit kompetent të gjeodezisë në Gjilan si pronare të palujtshmërisë dhe biznesit.

2. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

3. Kundër aktgjykimit i autorizuari i paditëses ka ushtruar ankesë dhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur sipas të njëjtës, ka gjetur se ankesa nuk është e bazuar, ndaj përmes aktgjykimit Ac.nr. 1280/2022 të datës 17.12.2024 ka refuzuar atë, dhe vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm CP. nr. 972/2016 të datës 16.11.2021.

4. Kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit të Kosovës, i autprizuari i paditëses në afatin ligjor ka ushtruar revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në revizion.

5. Në shkresat e lëndës, çështjes, ekziston parashtresa me shkrim, përkatësisht përgjigjja në revizion, paraqitur nga ana e kundërt.

6. Gjykata Supreme e Kosovës ekzaminoi aktgjykimin e kontestuar në raport me pretendimet në revizion dhe në kuptim të dispozitës së nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006), dhe vlerësoi se revizioni i të autorizuarit të paditëses është e bazuar.

7. Aktgjykimet e kontestuara me revizion janë të përfshira me shkeljen thelbësore të dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika n), ngase të njëjtat kanë mangësi që i bëjnë ato të pakuptueshme, dispozitivi i tyre nuk është në përputhje me arsyet për faktet thelbësore të dhëna në arsyetim, dhe arsyet për faktet thelbësore janë të paqarta, pa një lidhje logjike me provat e paraqitura.

8. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar dhe gjykata e shkallës së dytë ka vërtetuar gjendjen faktike si më poshtë: kërkesë padia e paditëses është e pabazuar për arsye se në rastin konkret kemi mungesë të legjitimitetit pasiv në anën ne të padituri, sepse i njëjti nuk është pronar i ngastrave që janë objekt i kontestit, për të paditësja kërkon vërtetimin e pronësisë, ky fakt vendimtar në këtë çështje juridike kontestimore vërtetohet nga certifikatat e pronësisë për ngastrat lëndore. Sa i përket legjitimitetit pasiv të të padituri, gjykata kujdeset

për të sipas detyrës zyrtare sepse është i natyrës materialo-juridike. Pala kundër së cilës drejtuar kërkesa duhet të legjitimohet në aspektin pasiv, sepse vetëm nëpërmjet saj mund të realizohet kërkesëpadia, nëse janë përmbushur kushtet ligjore për fitimin e të drejtës pronësore.

9. Duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga i autorizuari i paditëses, Gjykata e Apelit e Kosovës ka vërtetuar se nuk ekzistojnë shkelje të procedurës civile, dhe as shkelje së drejtës materiale në të cilat ankuesi thirret në ankesë. I njëjti i ka përsëritur pretendimet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me mungesën e legjitimitetit pasiv nga ana e të paditurit, duke shtuar se lidhur me ndërmarrjen e regjistruar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dh të bindshme dhe prova juridike për faktet relevante për vendosje sipas kësaj çështjeje juridike, gjë të cilën në tërësi e ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së dytë.

II. Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se në revizionin e të autorizuarit të të paditëses në mënyrë të bazuar vihet në dukje se aktgjykimi i shkallës së parë është i paqartë dhe se gjykata e shkallës së dytë ka lëshuar që të këto paqartësi të mënjanoj, ose që të urdhëroj gjykatën e gjykatës së shkallës së parë që të njëjtat në procedurën e përsëritur t'i mënjanoj.

2. Dispozita e nenit 160, par. 4 të Ligjit për procedurën kontestimore përcakton se Arsyetimi i aktgjykimit duhet të përmbaj: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.

3. Duke zbatuar këtë që u parashtrua në rastin konkret, dhe duke pasur parasysh argumentimin e gjykatës së shkallës së dytë, Gjykata Supreme konstaton se arsyetimet aktgjykimeve të instancës më të ulët vështirë se mund të vlerësohen si të pranueshme me ligj, sepse ato nuk japin arsye relevante dhe bindëse për vlerësimin se kërkesëpadia e

paditëses është e pabazuar, arsyetimi i dhënë në këtë mënyrë i aktgjykimeve të kontestuara nuk përmbush standardin e gjykimi të drejtë siç kjo përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

4. Në fakt, Gjykata Supreme vë në dukje se sipas padisë së parashtruar më 24.11.2016 objekti i kontestit është vërtetimi i pronësisë mbi bazën e kontributit martesor në dy ngastrat kadastrale të lartpërmendura, të cilat janë të regjistruara në emër të Lumni (Rrustem) Pajazitës, i cili është djali i vëllait i të padituri këtu. I autorizuari i paditëses me parashtresën me shkrim të datës 29.10.2019, ka bërë precizimin e padisë dhe të kërkesëpadisë, duke kërkuar vërtetimin e së drejtës pronësore në bazë të kontributit martesor si në dy ngastrat lëndore kadastrale të cekura, ashtu edhe në dy objektet banesore përkatësisht shtëpive në ato ngastra, si dhe te drejtën e pronësisë në objektin përkatësisht fabrikën në të cilën gjendet ndërmarrja e cekur "Kosmoplant" shpk, pastaj një pjesë në pjesëmarrje në aksione të ndërmarrjes së cekur, si dhe të pjesës në llogarite bankare të të padituri.

5. Pas këqyrjes së shkresave të plota të lëndës, Gjykata Supreme vërteton se e pakontestueshme është që paditësi dhe paditësja kanë lidhur kurorë më 30.12. 1979 dhe se në atë martesë ata kishin tre fëmijë të përbashkët që tani të moshës së rritur, dhe se ata kanë jetuar dhe punuar në Bazel të Zvicrës. Në bashkësinë martesore kanë jetuar për 37 vite. Paditësja në padi dhe në seancat e mbajtura gjyqësore ka theksuar se nuk është aspak kontestuese se ngastrat e kontestuara kadastrale janë të regjistruara në emër të Lumni (Rrustem) Pajaziti, djalin e vëllaut të të padituri, por se kontestuese është se gjatë kohëzgjatjes së martesës ajo gjithashtu ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në ndërtimin e dy shtëpive të banimit në ngastrat lëndore, si dhe të objektit apo fabrikës në të cilën është themeluar ndërmarrja "Kosmoplant" shpk, në themelimin e së cilës edhe ajo gjithashtu ka marrë pjesë.

6. Gjykatat e instancës më të ulët fare nuk janë marrë me pretendimet e përsëritura për disa herë të paditëses, të njëjtat vetëm shkurt kanë arsyetuar aktgjykimet e tyre që i padituri nuk ka legjitimitet pasiv që

të jetë palë në procedurë, pasi që ngastra kadastrale lëndore nuk janë të regjistruara në emër të tij. Mbetet absolutisht e paqartë për Gjykatën Supreme pse gjykatat e instancës më të ulët nuk janë marrë fare me vërtetimin e së drejtës pronësore në bazë kontributit martesor? Gjykata Supreme vë në dukje se në procesverbalin e përpiluar më 19.08.2021, ku dëshmitari Lumni Pajaziti, i cili është i regjistruar si pronar i ngastrave kadastrale të kontestuara, ka deklaruar se shtëpitë në ngastrat e kontestuara i kanë ndërtuar xhaxhallarët Isuf (i padituri këtu) dhe Pajaziti, se Pajaziti ka paguar për 7-8 ari të ngastrës, dhe se Isuf (i padituri këtu) nuk ka paguar për ngastrën sepse ka pasur probleme martesore.

7. Gjithashtu, në shkresat e lëndës gjenden edhe faturat ose dëftesat për shërbimet e paguara komunale (energji elektrike, ujë, kanalizime, etj.) në emër të të paditurit. Nuk është vërtetuar se me çfarë janë marrë paditësi dhe paditësi gjatë kohëzgjatjes së martesës, për shembull: a ka qenë e punësuar paditësja, nëse po, ku ka qenë e punësuar dhe sa të ardhura ka realizuar, apo ka qëndruar në shtëpi dhe kujdesur për familjen, a ka qenë dhe ku ka qenë i punësuar i padituri dhe sa të ardhura ka realizuar? Pastaj, mbetet e paqartë për Gjykatën Supreme pjesa e kërkesë padisë që i referohet objektit ose fabrikës në të cilën është e themeluar ndërmarrja "Kosmoplant" sh.p.k., përveç faktit se ndërmarrja është themeluar dhe se i padituri është një nga bashkëpronarët, se e njëjta nuk është aktive, gjykatat e instancës më të ulët fare nuk janë marrë me çështjen se cila ishte pjesa e të paditurit në të njëjtën, pastaj, se ku ndodhet objekti ose fabrika, në pronësi të kujt është, si dhe nëse i padituri posedon llogari në njërën nga bankat në Kosovë, dhe nëse posedon, cila është shuma e parave në të njëjtën?

8. Dispozita e nenit 52 të Ligjit të Kosovës për familjen (Ligji nr. 2004/32) parashikon se asnjëri nga bashkëshortët nuk mund që në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e tij. Ndërsa dispozita e nenit 47 të ligjit të cekur parashikon se pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë. Pasuria e përbashkët mund të përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të detyrimeve. Pasuria e

bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët. Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh. Pastaj, dispozita e nenit 54 të ligjit të cekur, parashikon se nëse nuk arrihet marrëveshja, pjesa e secilit bashkëshort në pasurinë e përbashkët, do të caktohet në bazë të kontributit të bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, përkatësisht kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me menaxhimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. Në rast të kontestit, gjykata kompetente merre vendimin lidhur me pjesën e bashkëëshortëve të parashikuara në këtë nen.

9. Duke pasur parasysh të gjitha që u thanë më lartë, si dhe dispozitat e cituara të Ligjit, Gjykata Supreme vë në dukje se paditësja, me padi kërkon ndarjen në pjesë ideale të pronës së pretenduar së përbashkët. Gjykatat e instancës më të ulët kanë lëshuar që të vërtetojnë nëse, pas 37 vitesh martesë, ekziston pronë e përbashkët midis paditëses dhe të padituri? Megjithëse, këtu prona e përbashkët përfaqëson pasojë logjike të kohëzgjatjes së një martese (37 vjet në këtë rastin konkret), dhe ka ekzistuar një bashkësi e jetës dhe e punës së bashkëshortëve. Nëse gjykatat e instancës më të ulët vërtetojnë se ekziston pronë e përbashkët, atëherë shtrohet pyetja: cila është pjesa e paditëses, dhe sa e të padituri? Është shumë e rëndësishme të theksohet se në këtë rast gjykata kujdeset për të gjitha rrethanat relevante për marrjen e një vendimi të drejtë.

10. Në të gjitha pyetjet parashtruara më lartë, gjykatat e instancës më të ulët kanë lëshuar që edhe sipas detyrës zyrtare në vendimet e tyre të sqarohen ose të arsyetojnë. Mangësitë e paraqitura janë të natyrës së tillë që kërkojnë prishjen e aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, pa pasur fare që Gjykata Supreme të lëshohet në verifikimin e

pretendimeve tjera në revizion, si dhe në verifikimin e rregullshmërisë së zbatimit të së drejtës materiale nga gjykatat e instancës më të ulët.

11. Për arsyet e cekura, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se aktgjykimet e instancës më të ulët duhet prishur dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje. Në riprocedurë me pa mëdyshje do të vërtetohen të gjitha pyetjet parashtruara më lartë, përkatësisht faktet. Gjithashtu, do të vërtetohen edhe faktet tjera thelbësore, dhe në një gjendje të tillë të vërtetuar në mënyrë të drejtë do të zbatohet e drejta materiale dhe të merret vendim i ligjshëm dhe i drejtë.

12. Për arsyet e numëruara, duke zbatuar dispozitat e nenit e nenit 223, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, revizioni i të autorizuarit të paditëses është aprovuar dhe janë prishur aktgjykimet e instancës më të ulët, dhe lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës Pallati i Drejtësisë – Lagjja "Prishtina e Re"

Prishtinë

T1: +383 (0) 38/200 18775

T1: +383 (0) 38/200 18779

Email: gjykatasupreme@rks-gov-net